



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE 2014

Vëllimi I

Botues:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës

Bordi redaktues:

Prof. Dr. Enver Hasani, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar i Gjykatës Kushtetuese
Almiro Rodrigues, Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Snezhana Botusharova, Gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese
Milot Vokshi, Sekretar i Përgjithshme e Gjykatës Kushtetuese
Njësia Ligjore e Gjykatës Kushtetuese

Kontribuesit:

Z. Malte Kirchner , Menaxher i projektit, GIZ
Znj. Pranvera Ejupi- Hajzeraj, Kordinatore e projektit, GIZ
Z. Lavdim Krasniqi, Ekspert Ligjor
Premium Consulting

© 2015 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës

Të drejtat e autorit:

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjetes, elektronike apo mekanike, duke përfshirë fotokopjimin dhe incizimin, apo ruajtjen në sisteme ripërdorimi, pa lejen paraprake me shkrim nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, përveç nëse një kopjim i tillë në mënyrë të qartë lejohet nga ligji përkatës për të drejtat e autorit.

Përjashtim i përgjegjësisë:

Sipas nenit 116.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, e cila është burim primar për vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Ky Buletin nuk zëvendëson burimin primar për vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Në rast të ndonjë konflikti apo mospërputhje në mes të vendimeve të botuara në këtë Buletin dhe vendimeve të botuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, mbizotëron versioni i botuar në Gazetën Zyrtare.

Qëllimi i përmbledhjes së vendimeve është për të dhënë një pasqyrë të përgjithshme faktike dhe juridike të rasteve dhe një përmbledhje të shkurtër të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Përmbledhja e vendimeve dhe aktgjykimeve është përpiluar nga “Projekti për Reformë Juridike” implementuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), dhe si i tillë, nuk zëvendëson vendimet e Gjykatës Kushtetuese, dhe nuk përfaqësojnë formulimin e vërtetë të vendimeve/aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese.



Published by **giz** Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE 2014

I GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Ky Buletin është mundësuar nga “ Projekti për Reformë Juridike” implementuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, nën mbështetjen e Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ).

Tabela e përmbajtjes

Parathënie	16
Nr.1. KI21/13, Elfete Haxhiu, Aktvendim i datës 17 tetor 2013 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës, GSK-KPA-A-63/12, të 17 janarit 2013	18
Nr.2. KI132/12, Bahtir Beqiri, Aktvendim i datës 19 nëntor 2013 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Apelit, Ac.nr.1076, të 8 prillit 2013	26
Nr.3. KI128/13, Shukri Maxhuni dhe Arian Bytyqi, Aktvendim i datës 16 tetor 2013-. Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 365/2012, të 18 prillit 2013	33
Nr.4. KI107/13, Hasan Salihu, Aktvendim i datës 21 tetor 2013 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit SCEL-09-0001-C1060 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, të 25 marsit 2010	45
Nr.5. KI61/13, Blerim Shabi, Aktvendim i datës 18 nëntor 2013 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. nr. 119/2012, të 21 dhjetorit 2012	53
Nr.6. KI152/13, Komuna e Gjakovës, Aktvendim i datës 20 nëntor 2013 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. Nr. 49/2012, të 3 qershorit 2013.....	62
Nr.7. KI182-13, Xhevat Rrustemi, Aktvendim i datës 5 dhjetor 2013 - Vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit ASC-11-0035 të Kolegjit për Ankesa të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 23 nëntorit 2012	69
Nr.8. KI75/13, Bajrush Gashi, Aktvendim i datës 5 dhjetor 2013 - Kërkesë për sqarim të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, KI 06/12, të 9 majit 2012 dhe Aktvendimit për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese, KI 123/12, të 29 janarit 2013.....	75
Nr.9. KI110/13, Shaqir Përvetica, Aktvendim i datës 2 dhjetor 2013 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 142/2013, të 14 qershorit 2013	82
Nr.10. KI153/13, Adem Dushi, Aktvendim i datës 20 nëntor 2013 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së vendimit të Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 10 janarit 2010	90

- Nr.11. KI65/13, Rasim Hoxha dhe Remzije Hoxha-Prelvukaj, Aktvendim i datës 18 nëntor 2013 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. 291/2009, të 4 shtatorit 2012 .. 96
- Nr.12. KI96/13, Branko Radec, Aktvendim i datës 3 shkurt 2014 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Vendimit, PZ. nr. 169/12, të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, të 21 janarit 2013..... 106
- Nr.13. KI146/13, Idriz Neziri, Aktvendim i datës 19 nëntor 2013 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Vendimit të Kolegjit të Ankesave të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 23 nëntorit 2012124
- Nr.14. KO18/14, Vesna Mikić dhe 20 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Aktvendim i datës 10 shkurt 2014- Kërkesë për "[...] interpretim të dispozitave të Kushtetutës së Kosovës lidhur me vendet e rezervuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë" 131
- Nr.15. KI135/13, KI137/13, KI138/13, Isuf Isufi, z. Tahir Sejdiu dhe z. Abedin Halimi, Aktvendim i datës 2 dhjetor 2013 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Vendimit ASC-11-0069 të Kolegjit për Ankesa të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 22 prillit 2013.....138
- Nr.16. KI186/13, Korporata Energjetike e Kosovës, Aktvendim i datës 5 dhjetor 2013 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. Nr. 151/2013, të 5 qershorit 2013144
- Nr.17. KI138/11, Nazife Xhafolli, Aktgjykim i datës 4 shkurt 2014 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 492/2008, të 10 marsit 2009155
- Nr.18. KI185/13, Korporata Energjetike e Kosovës, Aktvendim i datës 18 shkurt 2014 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. Nr. 368/2011, të 2 majit 2013172
- Nr.19. KI06/14, Olga Petrović, Svetolik Patrnogić, Vesna Dejanović dhe Miroslava Ivanović, Vendim për Masë të Përkohëshme i datës 10 shkurt 2014 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Pc. Nr. 559/10 të 18 shtatorit 2013.. 188
- Nr.20. KI14/14, Abdyl Islami, Aktvendim i datës 26 shkurt 2014 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 225/2013, të 18 dhjetorit 2013193

- Nr.21. KI23/14 Qendra Shoqërore, Sportive dhe Ekonomike, Aktvendim i datës 10 shkurt 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjyqimeve të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, ASC-09-0101 dhe ASC-09-0084, të 13 shtatorit 2012206
- Nr.22. KI158/13, Prend Prenkpalaj, Aktvendim i datës 23 janar 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prizren, P. nr. 13/09, të 16 prillit 2010214
- Nr.23. KI65/12, Fuad Gjakova, Aktvendim i datës 2 dhjetor 2013 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac.nr. 246/2011, të 5 korrikut 2011.....221
- Nr.24. KI88/12, Emrije Asllani, Aktvendim i datës 2 dhjetor 2013 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Prokurorit të Shtetit, të 29 prillit 2009 226
- Nr.25. KI117/12/A, KI119/12/A, KI121/12/A, KI138/12, Nexhmije Brezhnica, Fatmire Bardhi, Feriha Shala, Rifat Sadiku, Aktvendim i datës 19 nëntor 2013 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Ac. nr. 130/12, të 17 shtatorit 2012, Ac. nr. 1070/2012, të 2 majit 2013, Ac. nr. 138/12, të 9 korrikut 2012, Ac. nr. 1068/2012, të 2 majit 2013.....231
- Nr.26. KI11/12, Zef Lekaj, Aktvendim i datës 3 dhjetor 2013 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 235/08, të 5 shtatorit 2011. 239
- Nr.27. KI125/13, Mehmet Kahirmani, Aktvendim i datës 3 dhjetor 2013 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së vendimeve të publikuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit përkitazi me listat përfundimtare të punëtorëve me të drejtë të përfitimit të një pjese të të ardhurave nga privatizimi i NSH "Ramiz Sadiku" dhe NSH "Meto Bajraktari"... 246
- Nr.28. KI149/13, Lukë Kuzhnini, Aktvendim i datës 5 dhjetor 2013 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR. nr. 1990/12, të 7 majit 2013..... 253
- Nr.29. KI154/13, Beqir Halili, Aktvendim i datës 20 nëntor 2013 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Vendimit të Trupit Gjyqësor të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, nr. 1204, të 8 prillit 2010260
- Nr.30. KI131/13, Luan Spahiu, Aktvendim i datës 19 nëntor 2013 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 313/2012, të 17 prillit 2013 266

- Nr.31. KI192/13, Hatixhe Avdyli, Aktvendim i datës 24 shkurt 2014 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. Nr. 11/2013, të 23 korrikut 2013..... 275
- Nr.32. KI72/13, Isa Halimi, Aktvendim i datës 3 dhjetor 2013 –Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 241/2010, të 10 janarit 2013.....284
- Nr.33. KI140/13, Ramadan Cakiqi, Aktvendim i datës 2 dhjetor 2013 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, SCEL-09-0001, të 10 qershorit 2011, të 10 qershorit 2011. 293
- Nr.34. KI42/12, Rizah Ismajli, Aktvendim i datës 9 shtator 2013 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së kërkesës për dhënien e mendimit . 299
- Nr.35. KI144/13, Ramë Hoxha, Aktvendim i datës 3 dhjetor 2013 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev. nr. 300/2011, të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 3 majit 2013306
- Nr.36. KI161/13, KI162/13, KI164/13, KI165/13, KI166/13, KI167/13, KI168/13, KI169/13, KI170/13, KI171/13, KI172/13, KI173/13, KI174/13, KI175/13, KI176/13, KI177/13, KI178/13 dhe KI179/13, Ramiz Isufi dhe 17 individë të tjerë, Aktvendim i datës 7 shkurt 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së 18 aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, të 14 qershorit 2013.....318
- Nr.37. KI147/13, Ilir Bunjaku, Aktvendim i datës 5 dhjetor 2013 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Udhëzimit Administrativ Nr. 20/2012 të Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe Teknologjisë për krahasueshmërinë dhe barasvlerën e diplomave dhe programeve studimore para sistemit të Bolonjës dhe sistemit të Bolonjës.....330
- Nr.38. KI59/13, Ibrahim Rizvanolli, Aktvendim i datës 18 nëntor 2013 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 105/2010, të 29 nëntorit 2012 336
- Nr.39. KI150/13, Halit Lahu, Aktvendim i datës 20 nëntor 2013 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit SCEL-09-0001 të Trupit Gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 15 marsit 2011... 346
- Nr.40. KI197/13, NTP “Beni Dona”, Aktvendim i datës 21 janar 2014 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. Mlc. nr. 141/2012, të 18 shtatorit 2013351
- Nr.41. KI188/13, Fetije Bajrami-Shala, Aktvendim i datës 24 janar 2014 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev. nr. 181/2013, të 9

	korrikut 2013, dhe të Aktgjykimit Rev. nr. 48/2003, të 11 shtatorit 2003, të Gjykatës Supreme.....	358
Nr.42.	KI134/12, N.P.N.T. “ÇLIRIMI”, Aktvendim i datës 13 maj 2013 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. E. nr. 5/2010, të 8 nëntorit 2012.....	368
Nr.43.	KI157/13, Emin Maxhuni, Aktvendim i datës 20 janar 2014 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, nr. GSK-KPA-A-27/12, të 30 tetorit 2012.....	376
Nr.44.	KI112/13, Bajram Sfishta, Aktvendim i datës 2 dhjetor 2013 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Vendimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC-11-0035, të 23 nëntorit 2012	384
Nr.45.	KI195/13, Asllan Krasniqi, Aktvendim i datës 21 janar 2014 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev. nr. 126/2012, të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 2 gushtit 2013	390
Nr.46.	KI139/13, Zorica Đokić, Aktvendim i datës 20 janar 2014 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Njoftimit të Prokurorit të Shtetit, KMLP. I. Nr. 8/13, të 3 majit 2013.....	397
Nr.47.	KI90/13, Lumni Limaj, Aktvendim i datës 20 janar 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Panelit për Lirim me Kusht në Ministrinë e Drejtësisë, MD/PLK. Nr. 457/12, të 28 dhjetorit 2012.....	405
Nr.48.	KI209/13, Mustafë Musa, Aktvendim i datës 21 janar 2014 - Kërkesë për “[...] interpretim të një pjese të Aktgjykimit” në rastin Ko108/13, të 9 shtatorit 2013.....	411
Nr.49.	KI215/13, Selim Emërllahu, Aktvendim i datës 11 shkurt 2014 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së moszbatimit të Ligjit për amnisti.	417
Nr.50.	KI76/13, Duriqe Kurshumlja, Shpresa Kurshumlja dhe Orhan Kurshumlja, Aktvendim i datës 16 tetor 2013 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 218/2010, të 7 shkurtit 2013.....	422
Nr.51.	KI32/14, Arben Krasniqi, Aktvendim i datës 12 mars 2014 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Vendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKRNR 47/13, PPS Nr. 107/2012, të 20 janarit 2014	432
Nr.52.	KI156/13, Reshat Sahitaj, Aktvendim i datës 21 janar 2014 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Njoftimit të Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit - Prishtinë	448

- Nr.53. KI123/13, Afrim Karaxha, Aktvendim i datës 20 janar 2014 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. Mlc. nr. 93/2011, të 1 shkurtit 2013 454
- Nr.54. KO44/14, Aktgjykim i datës 31 mars 2014 - Vlerësimi i amendamenteve të Kushtetutës të propozuara nga Qeveria, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 11 mars 2014, me shkresën Nr. 04-DO-2186 470
- Nr.55. KI120/13, Ismete Veseli, Aktvendim i datës 20 janar 2014 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 60/2012, të 4 qershorit 2013 490
- Nr.56. KI148/13, Sylejmon Pllana, Aktvendim i datës 20 janar 2014 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 30/2013, të 12 korrikut 2013 498
- Nr.57. KI189/13, Avdullah Rrustemi, Aktvendim i datës 24 janar 2014 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev. I. nr. 121/2012, të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 29 korrikut 2013 505
- Nr.58. KI181/13, NTSH "WITT`PEN", Suharekë, Aktvendim i datës 21 janar 2014 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 34/2013, të 11 korrikut 2013 515
- Nr.59. KI133/13, Shefqet Hasimi, Aktvendim i datës 24 janar 2014 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 90/2013, të 23 korrikut 2013 522
- Nr.60. KI214/13, Kadrush Beqa, Aktvendim i datës 23 janar 2014 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit, Rev. nr. 75/2013, të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 16 shtatorit 2013 532
- Nr.61. KI141/13, Bajram Aliu, Aktvendim i datës 20 janar 2014 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Vendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, në rastin nr. SCEL-09-0001-C1131 540
- Nr.62. KI155/13, Xhemajl Sylejmani, Aktvendim i datës 24 janar 2014 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 302/2012, të 3 qershorit 2013. 547
- Nr.63. KI194/13, KI202/13, KI203/13 dhe KI204/13, Rrahman Rashiti, Ali Dragusha, Isak Dragusha, Nazim Dragusha, Aktvendim i datës 21 janar 2014 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Vendimit të Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, SCEL-09-0001, të 4 shkurtit 2010 555
- Nr.64. KI94/13, Avni Doli, Mustafa Doli, Zija Doli dhe Xhemile Osmanaj, Aktgjykim i datës 24 mars 2014 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së

- Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 324/12, të 21 dhjetorit 2012 563
- Nr.65. KI187/13, N. Jovanović, Aktgjykim i datës 1 prill 2014 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë për mospërmbarimin e Vendimit të Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme GSK-KPA-A-001/12, të 8 majit 2012 dhe të Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/114/2011, të 22 qershorit 2011..... 585
- Nr.66. KI200/13, Belkize Kallaq, Aktgjykim i datës 24 mars 2014 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimeve Rev. Mlc. nr. 329/2012, të 24 qershorit 2013, dhe Rev. nr. 356/2009, të 20 janarit 2012, të Gjykatës Supreme të Kosovës, dhe të Aktgjykimit Ac. nr. 52/2012, të Gjykatës së Qarkut në Prizren, të 11 majit 2012 ..608
- Nr.67. KI61/11 dhe KI 55/13 Naxhije Hasani dhe Vjollca Shoshi, Aktvendim i datës 25 qeshor 2013 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së dy aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës: Rev. nr. 434/2008, të 23 shkurtit 2009, dhe Rev. nr. 164/2010, të 11 janarit 2013..... 632
- Nr.68. KI83/13, Dragoljub Stanković, Aktvendim i datës 20 janar 2014 Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Njoftimit Fi 21/90 lidhur me listën preliminare të punëtorëve të kualifikuar për të marrë kompensimin nga privatizimi i NSH-së „Stan/Banesa“ në Prizren, të publikuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.....641
- Nr.69. KI34/14, Durrës Shahini, Aktvendim i datës 24 mars 2014 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 26/2014, të 31 janarit 2014, dhe kërkesa për vendosjen e masës së përkohshme 649
- Nr.70. KI43/13, Selam Shoshaj dhe Bashkim Krasniqi, Aktvendim i datës 17 tetor 2013 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 31/2013, të 13 marsit 2013 ... 663
- Nr.71. KI134/13, Shaban Puka, Aktvendim i datës 11 mars 2014- Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, SCEL-10-00013 të 26 dhjetorit 2012, dhe Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme, AC-I-13-0004, të 22 gushtit 2013 672
- Nr.72. KI190/13, Ansambli “Shqiponjat e Dukagjinit”, Gjakovë, Aktvendim i datës 14 mars 2014 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së aktit përcjellës të kryetarit të Komunës së Gjakovës, të 8 nëntorit 2011.....680

- Nr.73. KI218/13, Afrim Zeqiri, Aktvendim i datës 14 mars 2014 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Mlc. Rev. nr. 57/2013, të 30 korrikut 2013..... 686
- Nr.74. KI143/13, Nebih Sejdiu, Vendim për heqjen e kërkesës nga lista i datës 7 shkurt 2014- Vlerësim i Kushtetutshmërisë së një vendimi të pidentifikuar të një organi të pidentifikuar publik..... 695
- Nr.75. KI206/13, Tanasko Đorđević, Milorotka Jelić, Srboljub Đorđević, Serafina Đorđević, Jagoda Janković dhe Milorad Đorđević, Aktvendim i datës 13 mars 2014 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Mlc. nr. 377/2009, të 8 majit 2012 703
- Nr.76. KI196/13, Alisait Qerimi dhe katër të tjerë , Aktvendim i datës 7 shkurt 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 235/2011, të 12 korrikut 2013.....710
- Nr.77. KI201/13, Sofa Gjonbalaj, Aktvendim i datës 2 prill 2014 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 299/2011, të 17 prillit 2013 717
- Nr.78. KI205/13, Feti Islami, Aktvendim i datës 13 mars 2014 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 85/2012, të 3 qershorit 2013 725
- Nr.79. KI207/13, Rexhep Kabashi, Jusuf Mejzini dhe Meleqe Bexheti, Aktvendim i datës 24 prill 2014 - Kërkesë “për interpretimin e dispozitës së nenit 109, para. 5 dhe nenit 105, para. 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përkitazi me moshën e pensionimit të prokurorëve dhe gjyqtarëve”. 735
- Nr.80. KI226/13, Ali Lushaku, Aktvendim i datës 25 mars 2014 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, të Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP),742 GSK-KPA-A-012/13, t
- Nr.81. KI233/13, Erton Beka, Aktvendim i datës 13 mars 2014 - Vlerësi i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Pn. nr. 745/2013 të 19 dhjetorit 2013 750
- Nr.82. KI37/14, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Aktvendim i datës 25 mars 2014- Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, AC-II-12-0078, të 23 janarit 2014, me kërkesën për aplikimin e masës së përkohshme 758

- Nr.83. KI136/13, Rashit Alidema, Aktvendim i datës 19 nëntor 2013 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit, Rev. nr. 131/2013, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të 25 marsit 2013 768
- Nr.84. KI78/13 Roland Bartetzko, Aktvendim i datës 20 janar 2014 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Panelit për Lirim me Kusht, MD/CRP-nr. 474/12, të 29 dhjetorit 2012 dhe Udhëzimit Administrativ 2009/1 të Ministrisë së Drejtësisë776
- Nr.85. KI145/13, Agjencia Kosovare të Privatizimit, Aktvendim i datës 24 mars 2014 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, nr. AC-II-12-0120, të 20 qershorit 2013 784
- Nr.86. KI191/13, Fejzullah Fejzullahu, Aktvendim i datës 25 mars 2014 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN. nr. 624/2012, të 11 tetorit 2013797
- Nr.87. KI221/13, Shaqir Përvetica, Aktvendim i datës 14 mars 2014 - Kërkesë për rishqyrtimin e Aktvendimit për papranueshmëri, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Rasti nr. KI67/13, i 12 shtatorit 2013..... 807
- Nr.88. KI89/13, Arbresha Januzi, Aktgjykim i datës 12 mars 2014 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. Nr. 74/2011, të 12 marsit 2013815
- Nr.89. KIo8/14, Skënder Gashi, Aktvendim i datës 27 mars 2014 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 118/2010, të 4 marsit 2013 853
- Nr.90. KI222/13, Rrustem Veseli dhe z. Xhafer Zeqë Smajli, Aktvendim i datës 25 mars 2014- Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 118/2012, të 10 qershorit 2013.....862
- Nr.91. KI230/13, Tefik Ibrahim, Aktvendim i datës 25 mars 2014- Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 7.5 të Ligjit për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-072.....869
- Nr.92. KIo7/14, Lulzim Gosalci dhe Gjylymsere Ferataj, Aktvendim i datës 14 mars 2014 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 231/2013, të 24 dhjetorit 2013..... 875
- Nr.93. KI160/13, Desa Aleksić, Aktvendim i datës 27 mars 2014-Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit AC-II- 12-006, të Kolegjit të Ankesave të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 30 majit 2013.....884

- Nr.94. KI180/13, Radomir Nikolić, Aktvendim i datës 27 mars 2014- Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. 125/2013, të 29 korrikut 2013893
- Nr.95. KI92/13, Shefqet Tolaj, Aktvendim i datës 17 mars 2014 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 272/2011, të 16 prillit 2013904
- Nr.96. KI232/13, Fatos Kakeli, Aktvendim i datës 14 mars 2014 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. Mlc. nr. 197/2011, të 14 majit 2013915
- Nr.97. KI223/13, Xhafer Murati, Vendim i datës 2 prill 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të paspecifikuar të autoritetit publik 920
- Nr.98. KI210/13, Haxhi Morina, Aktvendim i datës 23 janar 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit Ankimor të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, AC-II-12-0108, të 10 tetorit 2013.928
- Nr.99. KI77/13, Fatmir Rushiti, **Vendim** i datës 11 mars 2014 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 82/2011, të 15 marsit 2013 935
- Nr.100. KI231/13, Alisait Qerimi, Aktvendim i datës 14 mars 2014 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ac. nr. 4375/2012, të 4 korrikut 2013.....941
- Nr.101. KI15/14, Reshat Murati, Aktvendim i datës 12 maj 2014 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, CA. nr. 2453/2012, të 27 marsit 2013.....948
- Nr.102. KI224/13, Mustafë Osmani, Aktvendim i datës 14 mars 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit për papranueshmëri KI93/13, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 2 dhjetorit 2013 954
- Nr.103. KI79/14, Adnan Rrustemi, Aktvendim i datës 19 maj 2014 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, AA. nr. 3/2014, të 21 shkurtit 2014960

Parathënie

Me kënaqësi të madhe po e shkruaj këtë parathënie në Buletinin e Praktikës Gjyqësore të vitit 2014 të Gjykatës Kushtetuese, si publikim i katërt i këtij lloji që nga themelimi i Gjykatës në vitin 2009. Falënderoj përzemërsisht Sekretariatin e Gjykatës për përgatitjen e këtij buletini me kujdesin dhe me përkushtimin më të madh, duke ndjekur qasjen e njëjtë sikurse në buletinet paraprake të Gjykatës. Ashtu sikurse publikimi i Buletinit për vitin 2013, edhe publikimi i këtij buletini është mundësuar falë një donacioni zemërgjerë të Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) për çka Gjykata është shumë falënderuese.

Gjithashtu, ky buletin përmban një numër të rasteve më kryesore. Siç e kam përmendur tanimë në parathënien e Raportit vjetor të vitit 2013 të Gjykatës, një nga këto raste kishte të bënte me kërkesën nga ana e Avokatit të Popullit të Kosovës, i cili kontestonte kushtetutshmërinë e disa neneve të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare. Një kërkesë tjetër, gjithashtu e rëndësishme, e parashtruar nga deputetët e Kuvendit të Kosovës, kishte të bënte me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes së Parë Ndërkombëtare të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë si dhe të Planit të Zbatimit për këtë Marrëveshje. Nga Gjykata kërkohej që të konfirmojë se amendamentet e propozuara nuk pakësonin të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] të Kushtetutës. Në një rast tjetër, Gjykata ka trajtuar çështjen e ngritur nga një numër i deputetëve të Kuvendit, nëse Ligji për Amnistinë ishte në kundërshtim me Kushtetutën, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga procedura e ndjekur për miratimin e Ligjit.

Nuk mund të theksoj sa duhet se sa është e rëndësishme që parashtruesit e mundshëm dhe praktikuesit e tyre ligjorë nëse kanë, të cilët synojnë të dorëzojnë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, duhet që, duke përdorur këtë dhe buletinet e mëparshme, ose duke kërkuar në faqen e internetit të Gjykatës, të konsultojnë me vëmendje vendimet e Gjykatës në rastet e ngjashme dhe, nëse ka ndonjë, të marrin parasysh nëse rasti i tyre mund të ketë ndonjë mundësi suksesi në dritën e rasteve të ngjashme. Kuptohet parimisht që e drejta e ankesës nuk mund t'i mohohet asnjë parashtruesi, por do të ishte më mirë që të mos kenë shpresa të rreme për raste të pashpresa.

Qëllimi i publikimit të vendimeve të Gjykatës në Buletinin dhe në faqen e internetit të Gjykatës është edhe, siç kam thënë në Buletinin e vitit 2012, t'i tregohet botës se gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese marrin vendimet e tyre në mënyrë të pavarur dhe plotësisht transparente duke zbatuar standardet më të larta të të drejtave të njeriut dhe të drejtësisë kushtetuese.

Prof. Dr. Enver Hasani
Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

**KI21/13, Elfete Haxhiu, Aktvendim i datës 17 tetor 2013-
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës
Supreme të Kosovës Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të
Pronës, GSK-KPA-A-63/12, të 17 janarit 2013**

Rasti KI21/13, vendimi i 17 tetorit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, e drejta e pronës, qartazi e pabazuar

Parashtruesi e parashtroi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 dhe rregullin 56 paragrafi 2 të Rregullores së punës.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i Kolegjit të Apelit AKP, GSK-KPA-A-63/12, i 17 janarit 2013, i shkel të drejtat e saj të garantuara kushtetuese dhe atë: të drejtën e pronës dhe të drejtën e lirisë së banimit.

Gjykata në bazë të shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstatoi se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se për çfarë arsye dhe si i janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutë. Deklarata e thjeshtë se është shkelur Kushtetuta, nga Gjykata nuk mund të konsiderohet si ankesë kushtetuese. Prandaj, në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe për këtë arsye është e papranueshme.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në**

Rastin nr. KI21/13

Parashtrues

Elfete Haxhiu

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës
Supreme të Kosovës Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të
Pronës, GSK-KPA-A-63/12, të 17 janarit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar

Ivan Čukalović,

zëvendëskryetar

Robert Carolan,

gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe

Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është znj. Elfete Haxhiu, nga Vitia (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilën e përfaqëson avokati z. Sahit Musa nga Vitia.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës – Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit AKP-ja), [GSK-KPA-A-63/12], të 17 janarit 2013, i cili i është dorëzuar asaj më 6 shkurt 2013.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pretendon se Aktvendimin i Kolegjit të Apelit AKP, GSK-KPA-A-63/12, të 17 janarit 2013, i shkel të drejtat e saj të garantuara kushtetuese dhe atë: e drejta e pronës dhe e drejta e lirisë së banimit.

Baza juridike

4. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 22 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56, paragrafin 2 të Rregullores së punës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 25 shkurt 2013, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, dhe e njëjta është regjistruar me numrin KI 21/13.
6. Më 28 maj 2013, Kryetari caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi si Gjyqtare raportuese dhe caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
7. Më 17 tetor 2013, Kolegji shqyrtues pasi shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues, i propozoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Më 19 shtator 2001, z. M. S., kishte parashtruar kërkesë në Komisionin për kërkesa pronësore banesore në Gjilan (në tekstin e mëtejme: KKPb), për konfirmimin e së drejtës pronësore mbi pronën, gjegjësisht mbi banesën, e cila gjendet në Viti.
9. Të njëjtën ditë, KKPb-ja e regjistroi kërkesën e z. M. S. me numrin DS 200669.
10. Më 29 prill 2003, z. A. A., gjithashtu paraqiti kërkesë në KKPb në Gjilan, për konfirmimin e së drejtës pronësore mbi pronën, gjegjësisht banesës, e cila gjendet në Viti.
11. Të njëjtën ditë, KKPb-ja e regjistroi kërkesën e A. A., me shenjë DS 605934.
12. Më 15 maj 2003, z. M. S. parashtroi kërkesë në KKPb në Gjilan, me të cilën kërkoi tërheqjen e kërkesës, të cilën e kishte paraqitur më 19 shtator 2001.

13. Më 5 prill 2004, në Gjykatën Komunale të Vitisë, z. M. S. ka lidhur kontratën e shitblerjes së banesës me parashtruesin e kërkesës.
14. Në një ditë të pacaktuar, z. M. S. paraqiti kërkesë në Gjykatën Komunale në Viti, me të cilën kërkoi që Gjykata ta aprovojë lidhjen e kontratës së shitblerjes së banesës, të cilën ai e ka nënshkruar më 5 prill 2004.
15. Më 29 prill 2004, Gjykata Komunale në Viti mori Aktvendimin [nr. N. Nr. 26/2004], me të cilin aprovoi propozimin e z. M. S. dhe e aprovoi lidhjen e kontratës për shitblerjen e banesës.
16. Në dispozitivin e aktvendimit, Gjykata ka theksuar: *„Gjykata e ka bërë administrimin e provave të propozuara nga përfaqësuesi i propozuesit dhe kundër-propozuesit: kontratën mbi shitblerjen e banesës me nr. 250/94, të 05.04.1994, e vërtetuar te kjo gjykatë, autorizimin me nr. 150/2000, të 14.09.2000, formularin për intervista të Drejtorisë për çështje banesore dhe pronësorë - Komisionit për kërkesa banesore dhe pronësore në Gjilan, në emër të M. S. me nr. DS -200669 të 23.12.2002, pëlqimin e administratorit komunal në Viti, nr. 223 të 29.09.2003, sipas Rregullores 2001/17, dhe në fund ka konkluduar se propozimi i propozuesit është tërësisht i bazuar dhe u aprovua në tërësi si i bazuar”.*

Procedura në KKPБ me rastin e kërkesës së z. A. A.

17. Më 17 tetor 2003, në procedurën e shkallës së parë, KKPБ-ja mori Aktvendimin [nr. HPCC/D/93/2003], me të cilin z. A. A. i njihet e drejta e pronësisë së banesës në Viti.
18. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në kolegjin e shkallës së dytë të KKPБ-së ndaj Aktvendimit të shkallës së parë të KKPБ-së [HPCC/D/93/2003], të 17 tetorit 2003.
19. Në një datë të paspecifikuar, kolegji i shkallës së dytë i KKPБ-së nxori Aktvendimin [HPCC/REG/95/2007], me të cilin refuzohet kërkesa e parashtruesit të kërkesës për shqyrtim të sërishëm të kërkesës së shkallës së parë të KKPБ-së [HPCC/D/93/2003], të 17 tetorit 2003.
20. Më 14 maj 2012, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Kolegjin e Apelit të AKP-së kundër aktvendimit të shkallës së parë dhe të dytë të KKPБ-së.

21. Më 17 janar 2013, Kolegji i Apelit të AKP-së nxori Aktgjykimin [GSK-KPA-A-63/12], me të cilin u refuzua ankesa e parashtruesit të kërkesës si e palejueshme.
22. Në arsyetimin e aktgjykimit, Kolegji i Apelit të KPA-së thotë:

“Vendimet e lartpërmendura janë nxjerrë në bazë të Rregullores së UNMIK-ut, 2000/60 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja). Me Vendimin HPCC/REG/95/2007, është refuzuar kërkesa e parashtruar nga pala ankuese për shqyrtim të sërishëm kundër vendimit HPCC/D/93/2003. Rregulloret e UNMIK-ut nuk parashohin mjet juridik (ankesë apo mjet të jashtëzakonshëm juridik) kundër vendimeve të formës së prerë të Komisionit për çështje pronësore banesore - argument sipas nenit 22 dhe 23, në të njëjtin vend. Në këtë aspekt, kjo është gjithashtu edhe praktikë gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (shih Rastin nr. KI104/10, paragrafi 64, 74 dhe 75). Prandaj, ankesa e përmendur, e ushtruar kundër vendimit të formës së prerë është e palejueshme dhe duhet të hedhet poshtë.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktvendimet e KKPb-së dhe të Kolegjit të Apelit të AKP-së janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë, dhe atë: e drejta në pronë dhe e drejta e banimit.
24. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me kërkesë që:

„Gjykata të vendosë në dobinë time, sepse mua dhe familjes sime i janë shkelur të drejtat kushtetuese”.

Vlerësimi pranueshmërisë së kërkesës

25. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata Kushtetuese duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
26. Gjykata i referohet nenit 113 (7) të Kushtetutës, i cili përcakton se:

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

27. Gjykata thekson se parashtruesi ka përmbushur kushtet e parapara me nenin 113 të Kushtetutës, dhe prandaj parashtruesi është person i autorizuar për të parashtruar në këtë Gjykatë.

28. Gjithashtu, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, i cili thotë:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

29. Përveç kësaj, Gjykata e merr parasysh edhe rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse (...) kërkesa është qartazi e bazuar”.

30. Gjykata Kushtetuese dëshiron të rikujtojë se sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e apelit, në lidhje me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta që t’i interpretojnë dhe t’i zbatojnë rregullat e caktuara të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ], 1999-I.

31. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kësaj kërkesë të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, ndër burime të tjera, Raport i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, kërkesa Nr. 13071/87, i miratuar më 10 korrik 1991).

32. Gjykata thekson se me vendimet e KKPb-së është marrë në rastin KI 104/10 dhe se më 29 prill 2012, nxori Aktgjykimin AGJ221/12, në të cilin thuhet: *“Gjykata është e mendimit se Vendimi i KKPb-së i datës 15 korrik 2006 duhet konsideruar si vendim i formës së prerë dhe që është bërë res judicata me rastin e certifikimit nga*

ana e sekretarit të KKPb-së më 4 shtator 2006, siç konfirmohet me Letrën e Konfirmimit të KKPb-së të 7 majit 2008 drejtuar parashtruesit të kërkesës. Ne këtë letër po ashtu, thuhej se procedura në lidhje me kërkesën e parashtruesit i ishte bartur Drejtorisë së Çështjeve Pronësore Banesore në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 dhe se kishte përfunduar, ndërsa mjetet juridike në dispozicion të palëve në bazë të dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 ishin shterur. (shih Rastin Draža Arsić, nr. KI104/10, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Gjykatës së Qarkut në Gjilan Gž nr. 78/2010 të 7 qershorit 2010).”

33. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata Kushtetuese nuk mund të përfundojë se veprimet e KKPb-së dhe të Kolegjit të Apelit të KPA-së ishin të padrejta apo arbitrare (shih mutatis mutandis Vanek kundër Republikës Sllovaqe, Vendim i GJEDNJ-së lidhur me pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, të 31 majit 2005).
34. Sipas kësaj, parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se për çfarë arsye dhe si i janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutë. Deklarata e thjeshtë se është shkelur Kushtetuta, nuk mund të konsiderohet ankesë kushtetuese. Prandaj, në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe për këtë shkak është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113 (7) të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit, dhe rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, më 17 tetor 2013, njëzëri

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË vendimin palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe
- IV. TË SHPALLË që ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Arta Rama-Hajrizi

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

**KI132/12, Bahtir Beqiri, Aktvendim i datës 19 nëntor 2013-
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së
Apelit, Ac. nr. 1076/2013, të 8 prillit 2013...**

Rasti KI 132/12, vendimi i 19 nëntorit 2013.

Fjalët kyçe: cenimi i të drejtave dhe lirive kushtetuese , nenet 53 dhe 54, kërkesë individuale, mosë shterje e mjeteve juridike

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat dhe liritë e tij kushtetuese janë cenuar me aktgjykimin e gjykatave të rregullta. Parashtruesi pretendon se ai ka punuar ne NSH "Qyqavica" ne Vushtrri deri me 1991, kur forcat serbe e debuan më force nga puna dhe e diskriminuan. Parashtruesi pretendon së ishin shkelur të drejtat e tij, të garantuara me Kushtetute, sepse ai ka te drejtë në një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH "Qyqavica", si forme e kompensimit për pagën e tij prej vitit 1991 deri më 1999. Parashtruesi thirret në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe në nenin 54 [Mbrojtja Gjyqesore e të Drejtave] të Kushtetutes.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtrusit ishte e papranushme bazuar ne Rregullit 36 (1) a), nenin 113.7 të Kushtetutes dhe në nenin 47.2 të ligjit i cili parasheh "Individi mundë ta ngreje kërkesën në fjale vetem pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të percaktuara me ligj". Gjykata deshiron të theksoje se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'ua ofroje autoriteteve në fjale, duke perfshirë edhe gjykatat, mundesinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutes. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese, duke pasur këtë në mendje, nga dokumentet e dorezuara nga ana e Gjykates Themelore në Vushtrri, shihet qarte se rasti është ende në pritje pranë kësaj gjykate të rregullt. Nga kjo rrjedh se parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas ligjit në fuqi, siç kerkohet nga ai, që të jete në gjendje të paraqese një kërkesë në Gjykatë. Gjykata Kostaton që parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas ligjit të aplikueshem. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata vendosi të hedhe poshte kërkesen si të pa pranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rasti Nr. KI132/12
Parashtrues
Bahtir Beqiri
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së
Apelit,
Ac. nr. 1076/2013, të 8 prillit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Bahtir Beqiri, me vendbanim në Vushtrri.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi në kërkesë veçanërisht konteston Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Vushtrri të Republikës së Kosovës, C. nr. 215/06 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Komunale në Vushtrri), të 3 korrikut 2006, i cili iu dorëzua atij në një datë të pacaktuar.
3. Mirëpo, vendimi përfundimtar në këtë rast është Vendimi i Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, Ac. nr. 1076/2012 (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit), i 8 prillit 2013.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të lartpërmendur të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës.

5. Pavarësisht nga kjo, parashtruesi në kërkesë e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Vushtrri, C. nr. 215/06, të 3 korrikut 2006, për shkak të mospërmbarimit të vendimit.

Baza juridike

6. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit, Nr. 03/L-121, për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën më 24 dhjetor 2012.
8. Më 6 dhjetor 2012, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. KI-132/12, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. KSH. KI132/12, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.
9. Më 19 prill 2013, kërkesa iu komunikua Gjykatës Themelore në Vushtrri (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
10. Më 17 tetor 2013, Gjykata Themelore në Vushtrri dorëzoi në Gjykatë vendimet e Gjykatës Komunale në Vushtrri dhe të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, të cilat nuk u dorëzuan fillimisht nga parashtruesi.
11. Më 31 tetor 2013, Gjykata informoi parashtruesin në lidhje me dokumentet e dorëzuara nga Gjykata Themelore në Vushtrri, por nuk mori asnjë përgjigje nga ai.
12. Më 13 nëntor 2013, parashtruesi i dorëzoi komentet e tij.
13. Më 19 nëntor 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmëri.

Përmbledhja e fakteve

14. Parashtruesi ishte punonjës në Ndërmarrjen shoqërore “Qyqavica”, deri më 1992.

15. Sipas dokumenteve të dorëzuara, bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Vushtrri, C 215/06, të 3 korrikut 2006, NSH “Qyqavica” në Vushtrri ishte e detyruar t’i përmbushë obligimet e saj në lidhje me kompensimin e pagës ndaj të gjithë parashtruesve të kërkesës, nga viti 1992 deri më 1999, me një kamatë prej 4.5% në vit, që nga 29 qershori 2005 deri në pagesën përfundimtare.
16. Parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Komunale në Vushtrri për përmbarimin e Aktgjykimit të mëparshëm të Gjykatës Komunale, C. nr. 215/05, të 3 korrikut 2006.
17. Më 15 shtator 2006, Gjykata Komunale në Vushtrri nxori Vendimin E. nr. 784/06 për përmbarimin e Aktgjykimit C. nr. 215/06, të 3 korrikut 2006. Llogaria e NSH

“Qyqavica” ishte bllokuar dhe “Banka e Re në Kosovë”, dega në Vushtrri, ishte urdhëruar t’ua paguajë parashtruesve shumën e caktuar së bashku me kamatën e caktuar.
18. Megjithatë, më 20 shkurt 2008, Gjykata Komunale në Vushtrri nxori Vendimin E. nr. 258/08, për pezullimin e procedurës së përmbarimit.
19. Në vendimin e saj, Gjykata Komunale në Vushtrri e arsyetoi vendimin për pezullimin e ekzekutimit, duke iu referuar shkresës së 31 dhjetorit 2007 të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, duke kërkuar nga Gjykata Komunale që “... lidhur me të gjitha rastet që kanë të bëjnë me NSH “Qyqavica”, të pezullojë përmbarimin, pasi që Rregullorja e UNMIK-ut 2005/4 parasheh se me miratimin e rregulloreve të veçanta në lidhje me rregullimin e fushave të caktuara është përjashtuar LPP-ja [Ligji për procedurën përmbarimore] dhe se NSH-ja e përmendur nuk është në procedurë të likuidimit, por kreditori mund t’i realizojë të drejtat e tij në AKM [Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit] dhe se këto kërkesa do të konsiderohen si tituj ekzekutivë dhe në procedurën përmbarimore të ndërmarrjes, kërkesat do të përmbushen nga Komisioni i likuidimit të NSH-së”.
20. Kundër Vendimit të Gjykatës Komunale në Vushtrri, E. nr. 258/08, të 20 shkurtit 2008, parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit.
21. Më 8 prill 2013, Gjykata e Apelit nxori Vendimin Ac. nr. 1076/2012, me të cilin kishte vendosur që të aprovojë ankesën e

parashtruesit si të bazuar dhe të prishë Vendimin e Gjykatës Komunale, E. nr. 258/2008, të 20 shkurtit 2008.

22. Gjykata e Apelit, në vendimin e lartpërmendur gjeti se Gjykata Komunale në Vushtrri i ka zbatuar gabimisht dispozitat e së drejtës materiale. Për më tepër, ka theksuar se gjykata e instancës më të ulët nuk e ka arsyetuar mjaftueshëm vendimin e vet për të anuluar procedurën përmbarimore.
23. Më 13 nëntor 2013, parashtruesi në përgjigjen e tij lidhur me vendimet e dorëzuara nga Gjykata Themelore, ndër të tjera ka theksuar *“se sipas interpretimit të tyre vendimet e dorëzuara janë arbitrare dhe nuk kanë bazë ligjore”*.

Pretendimet e parashtruesit

24. Parashtruesi pretendon se ai ka punuar në NSH “Qyqavica” në Vushtrri deri më 1991, kur forcat serbe e dëbuan me forcë nga puna dhe e diskriminuan.
25. Parashtruesi pretendon se ishin shkelur të drejtat e tij, të garantuara me Kushtetutë, sepse ai ka të drejtë në një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH “Qyqavica”, si formë e kompensimit për pagën e tij prej vitit 1991 deri më 1999. Parashtruesi thirret në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe në nenin 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

Vlerësimi i pranueshmërisë

26. Gjykata vëren se që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, duhet së pari të vlerësojë nëse ai i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës.
27. Në fillim, Gjykata dëshiron të përsërisë se ajo mund të vendosë për pranueshmërinë e kërkesës vetëm nëse parashtruesi i kërkesës tregon se i ka shteruar të gjitha mjetet efektive juridike në dispozicion, sipas ligjit të aplikueshëm, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe me rregullin 36.1.a i Rregullores së punës, të cilët parashohin:

Neni 113.7

“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.

Neni 47.2

“Individi mund ta ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Rregulli 36.1.a

“Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar”.

28. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t’ua ofrojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë edhe gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese (shih rastin KI65/11, parashtuesi Holding Corporation "Emin Duraku", Aktvendimi për papranueshmëri, i 21 janarit 2013).
29. Duke pasur këtë në mendje, nga dokumentet e dorëzuara nga ana e Gjykatës Themelore në Vushtrri, shihet qartë se rasti është ende në pritje pranë kësaj gjykate të rregullt. Nga kjo rrjedh se parashtuesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas ligjit në fuqi, siç kërkohet nga ai, që të jetë në gjendje të paraqesë një kërkesë në Gjykatë.
30. Për më tepër, Gjykata përsërit se parashtuesi është i obliguar që të njoftojë Gjykatën për të gjitha rrethanat relevante në lidhje me kërkesën dhe të mos mbajë ndonjë informatë që ai ka në dijeni. Përndryshe, ruajtja apo vënia e Gjykatës në lajthitje, mund të ngrejë çështjen e keqpërdorimit të së drejtës për peticion.
31. Gjykata vëren se në rastin konkret, parashtuesit nuk e kanë njoftuar Gjykatën lidhur me Vendimin e Gjykatës Komunale në Vushtrri, E. nr. 256/08, të 20 shkurtit 2008, për të anuluar procedurën e përmbarimit dhe Vendimin e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 1076/2012, të 8 prillit 2013, për të prishur vendimin e lartpërmendur të Gjykatës Komunale në Vushtrri. Një sjellje e tillë nuk është në pajtim me të drejtën e individit për peticion, sipas standardeve juridike evropiane (shih *mutatis mutandis*, Vendimi i KEDNJ Hadabrova dhe të tjerët kundër Republikës Çeke, Vendimi i KEDNJ-së për papranueshmërinë e kërkesës nr. 42165/02 dhe 466/03, të 25 shtatorit 2007).

32. Gjykata më tej thekson se nuk ka vendim përfundimtar që do të kontestohet në këtë gjykatë.
33. Si përmbledhje, parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas ligjit të aplikueshëm.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, rregullin 36 (1) a) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 19 nëntor 2013, njëzëri

VENDOS

- I. TA REFUZOJË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI128/13, Shukri Maxhuni dhe Arian Bytyqi, Aktvendim i datës 16 tetor 2013 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 365/2012, të 18 prillit 2013

Rasti KI128/13, vendimi i 16 tetorit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kërkesë për vendosjen e masës së përkohshme.

Parashtruesit e kërkesës kanë dorëzuar kërkesën e tyre në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenet 27 dhe 47 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009 dhe rregullat 28 dhe 54 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Më 16 gusht 2013, parashtruesit kanë dorëzuar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, me të cilën kerkuan vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Parashtruesit në kërkesë pretendojnë se me Aktgjykimin e Gjykatës Supremeja në shkelur nenet e Kushtetutës së Kosovës, si në vijim: neni 31 [E drejtë për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] si dhe neni 6i Konventës Evropiane për të Drejtat Njeriut [E drejta për një proces të rregullt].

Gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës as nuk kanë ndërtuar, e as nuk kanë provuar një rast *prima facie*, qoftë mbi bazën e meritave, qoftë mbi bazën e pranueshmërisë së kërkesës, prandaj Gjykata konstaton se kërkesa është e papranueshme si qartazi e pabazuar.

Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e kërkesës së parashtruar, Gjykata Kushtetuese e Kosovës në seancën e mbajtur më 16 tetor 2013, vendosi ta refuzojë kërkesën si të papranueshme, parashtruesit nuk kanë ofruar prova që tregojnë se janë shkelur të drejtat dhe liritë e tyre të garantuara me Kushtetutën epse faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese.

Gjykata më tej konstaton se, pasi që kërkesa e parashtruesit është e papranueshme, kërkesa për masën e përkohshme është pa objekt shqyrtimi, dhe, si e tillë, duhet të refuzohet.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në**

Rastin nr. KI128/13

Parashtrues

Shukri Maxhuni dhe Arian Bytyqi

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme të Kosovës, Rev. nr. 365/2012, të 18 prillit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë z. Shukri Maxhuni dhe z. Arian Bytyqi nga Prishtina, të cilët i përfaqëson avokati z. Ibrahim Dobruna nga Gllgovci.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 362/2012, të 18 prillit 2013, me të cilin është refuzuar revizioni kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 1492/2008, të 30 dhjetorit 2011, për lirim dhe dorëzimin në posedim të banesave.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 362/2012, i 18 prillit 2013, dhe çështja nëse me aktgjykimin e lartpërmendur parashtruesve të kërkesës u janë shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe protokollet e saj.

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), në nenin 27 dhe 47 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), si dhe në rregullat 28 dhe 54 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Parashtruesi i kërkesës, respektivisht përfaqësuesi i tij ligjor, më 16 gusht 2013, përmes postës, dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 27 gusht 2013, me Vendimin e Kryetarit, nr. GJR. KI 128/13, gjyqtari Altay Suroyu emërua gjyqtar raportues. Në të njëjtën ditë, me Vendimin e Kryetarit, nr. KSH. KI 128/13, u emërua Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (gjyqtar kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
7. Më 5 shtator 2013, Gjykata Kushtetuese e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme të Kosovës se është iniciuar procedura e vlerësimit të kushtetutshmërisë të aktgjykimeve të ndërlydhura me rastin nr. KI 128/13.
8. Më 16 tetor 2013, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Altay Suroy, Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani, i paraqiti Gjykatës në përbërje të plotë rekomandim për papranueshmërinë e kërkesës.
9. Njëkohësisht, Kolegji shqyrtues i propozoi Gjykatës në përbërje të plotë të refuzojë kërkesën e parashtruesit për masë të përkohshme me arsyetimin se i njëjti nuk ka bashkëngjitur asnjë provë bindëse me të cilën do të arsyetonte vendosjen e masës së përkohshme si të domosdoshme për shmangien e ndonjë dëmi të pariparueshëm ose ndonjë provë se një masë e tillë është në interesin publik.

Përmbledhja e fakteve

10. Në vitin 1999, pas luftës në Kosovë, sipas pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, atyre iu siguroa strehim humanitar në banesa, si vijon: Shukri Maxhuni (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), banesa nr. 17, kati III, hyrja IV, objekti nr. 9/4, lagjja „Çezma e bardhë” (Dardani) dhe Arian Bytyqi (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), banesa nr. 18, kati III, hyrja IV, objekti nr. 9/4, lagjja „Çezma e bardhë” (Dardani), me qëllim të strehimit të përkohshëm, sepse nuk kishin strehim tjetër. Banesat e lartpërmendura ishin në fazën e ndërtimit të vrazhdë, kështu që parashtruesit e kërkesës kishin bërë shpenzime të caktuara financiare lidhur me rregullimin e këtyre banesave për një jetë normale.
11. Më 29 nëntor 2005, Ndërmarrja Publike Banesore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: NPB) inicioi padi për lirim të banesës nga sendet dhe njerëzit, kundër parashtruesve të kërkesës dhe personave të tjerë, të cilët sipas pretendimeve të NPB-së, shfrytëzonin banesat e lartpërmendura pa bazë ligjore dhe nuk ishin të gatshëm t'i lironin ato. Për banesat e sipërpërmendura, sipas pretendimeve të NPB-së, e njëjta u shpall investitore, e cila për shkak të shfrytëzimit të banesave nga parashtruesit e kërkesës dhe personave të tjerë, nuk ishte në gjendje që t'i kryejë punët ndërtimore të parapara me kontratën e ndërtimit.
12. Më 28 mars 2007, Agjencia Kosovare e Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP) informoi parashtruesit e kërkesës se është duke u shqyrtuar vendosja e banesave të kontestuara nën administrimin e AKP-së dhe se parashtruesit e kërkesës në afatin ligjor mund t'i drejtohen AKP-së.
13. Më 17 korrik 2007, AKP-ja në pajtim me vendimin e Komisionit për kërkesa pronësore në Kosovë, lëshoi urdhër për dëbim të parashtruesve nga banesat e lartpërmendura, me arsyetim se banesat e kontestuara nuk ishin të kualifikuara si banesa për strehim të mëtejshëm humanitar.
14. Më 2 gusht 2007, Kryeministri i atëhershëm i Kosovës i dërgoi propozim AKP-së dhe NPB-së që të pezullonin përkohësisht urdhrin për dëbimin e 136 familjeve nga kompleksi banesor „Çezma e bardhë” (Dardani), të 84 familjeve në „Ulpianë”, dhe në „Kodrën e diellit”, të familjeve në kushte të vështira ekonomike dhe raste të rënda sociale dhe humanitare.
15. Më 22 shtator 2008, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktgjykimin C. nr. 2326/05, miratoi si të bazuar kërkesëpadinë e

NPB-së dhe i obligoi parashtruesit e kërkesës që t'i lironin nga sendet dhe njerëzit banesat e lartpërmendura kontestuese.

16. Më 22 tetor 2008, parashtruesit e kërkesës ushtruan ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 2326/05, të 22 shtatorit 2008, për shkak të (sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës), shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale të LPK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit për lirim e banesave.
17. Më 5 shtator 2011, parashtruesit e kërkesës paraqitën plotësim të ankesës në Gjykatën e Qarkut, ku ndër të tjera përmendën faktin se disa dokumente nga shkresat e lëndës në rastin C. nr. 2326/05, të 22 shtatorit 2008, u ishin dorëzuar në gjuhën serbe, e cila nuk është gjuhë e tyre amtare, përkatësisht në gjuhën të cilën ata nuk e kuptojnë.
18. Më 30 dhjetor 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin Ac. nr. 1492/2008, e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 2326/05, të 22 shtatorit 2008.
19. Më 13 mars 2012, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 1492/2008, të 30 dhjetorit 2012, dhe Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 2326/05, të 22 shtatorit 2008, për shkak të (sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës) shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimet e lartpërmendura të Gjykatës Komunale dhe Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.
20. Më 18 prill 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Rev. nr. 365/2012, e refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 1492/2008, të 30 dhjetorit 2012, dhe Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 2326/05, të 22 shtatorit 2008, me arsyetimin:

“Gjykata Supreme e Kosovës, e konsideron si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik dhe arsyetimin e gjykatave më të ulëta, lidhur me aprovimin e kërkesëpadisë dhe refuzimin e

ankesës së të paditurve, pasi që janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse dhe të pranueshme edhe për këtë gjykatë për faktin se aprovimi i kërkesëpadisë së paditëses është i drejtë dhe i ligjshëm, me që është vërtetuar se paditësja si investitore ka të drejtën e pronësisë në banesat kontestuese.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se:

“gjykata e shkallës së parë dhe asaj të dytë, dhe së fundi me nxjerrjen e Aktgjykimit të datës 18 prill 2013, Rev.nr. 365/2012 nga Gjykata Supreme e Kosovës, kanë bërë shkelje esenciale të shumëfishtë të: dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit për Procedurën Kontestimore, Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe Ligjit për përdorimin e gjuhëve, në momentin që parashtruesve të kërkesës u ka bërë dorëzimin e dokumentacionit: Aktvendimin për leje urbanistike të datës 26.01.1996, Aktvendimin e datës 14.12.1995, Aktvendimin e datës 15.11.1995 dhe Kontratën mbi ndërtimin të datës 6.12.1995, Kontratave mbi Investimet në gjuhën serbe – pra në gjuhën jo-amtare, duke mos përkthyer kështu Kontratën mbi Ndërtimin nr. 02.2932/1, të datës 06.12.1995, nga gjuha serbe në gjuhën shqipe, në gjuhën të cilën palët e kuptojnë, nga gjuha serbe, në gjuhën shqipe. Kjo shkelje është thelbësore dhe si e tillë ka për pasojë prishjen e aktgjykimit, dhe është në kundërshtim të plotë me kërkesat e përcaktuara me Kushtetutën e Kosovës si dhe Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.”

Dispozitat përkatëse ligjore lidhur me procedurën kontestimore

22. *LIGJI PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE nr. 03/L-006*

Neni 96

96.1 Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë kanë të drejtë që në procedurën para gjykatës të përdorin gjuhën e vet apo gjuhën të cilën e kuptojnë.

96.2 Në qoftë se procedura nuk zhvillohet në gjuhën e palës, gjegjësisht të pjesëmarrësve të tjerë në procedurë, do të sigurohet sipas kërkesës së tyre përkthimi gojarisht në gjuhën e tyre apo në gjuhën që e kuptojnë, i të gjitha parashtrësve

dhe provave shkresore, si dhe i asaj që parashtrohet në seancë gjyqësore.

Kërkesa për masë të përkohshme

23. Parashtruesi gjithashtu kërkon që Gjykata të vendosë masë të përkohshme:

“LEJON masën e përkohshme deri në kohën kur Gjykata Supreme e Kosovës të vendos për çështjen sipas ratio decidendi të Gjykatës Kushtetuese.”

24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 116.2. [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktoj dëme të pariparueshme.”

25. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh nenin 27 të Ligjit, i cili parasheh:

“Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik.”

26. Përveç kësaj, rregulli 54 (1) i Rregullores së punës parasheh:

“Në qfarëdo kohe, përderisa kërkesa është e pazgjidhur para Gjykatës dhe meritat e kërkesës nuk janë vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme.”

27. Së fundi, rregulli 55 (1) i Rregullores së punës parasheh:

“Kërkesa për masë të përkohshme do të shqyrtohet me shpejtësi nga Gjykata dhe do t'i jepet përparësi para të gjitha kërkesave të tjera.”

28. Për më tepër, në mënyrë që Gjykata të vendosë masën e përkohshme, në pajtim me rregullin 55 (4) të Rregullores së punës, duhet të konstatojë që:

“ (a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme; dhe

(c) masa e përkohshme është me interes publik.”

Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës..

Vlerësimi pranueshmërisë së kërkesës

29. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtresit, Gjykata para së gjithash duhet të vlerësojë nëse parashtresi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

30. Në këtë rast, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i cili përcakton:

1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. (...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

31. Neni 47 (2) i Ligjit për Gjykatën, gjithashtu, parasheh se:

„Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

32. Gjykata, po ashtu, i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh se:

„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

33. Për më tepër, rregulli 36 (1) a), b) dhe c) i Rregullores së punës përcakton se:

1. Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

(a) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar;

(b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi; ose

(c) kërkesa është qartazi e bazuar.

34. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës e ka respektuar afatin ligjor prej katër muajsh duke e llogaritur nga data kur i është dorëzuar aktgjykimi i Gjykatës Supreme; kjo mund të shihet nga shkresat e lëndës, pra që Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. 365/2012, është nxjerrë më 18 prill 2013, ndërsa parashtruesi e ka parashtruar kërkesën në Gjykatë përmes postës më 16 gusht 2013, që do të thotë se kërkesa është parashtruar brenda afatit katërmujor, ashtu siç është e paraparë me Ligj dhe me Rregullore të punës.
35. Parashtruesi i kërkesës kryesisht pretendon se me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, gjykatës së shkallës së dytë, si dhe me aktgjykimin e Gjykatës Supreme, i është shkelur e drejta e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrotjtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe protokollet e saj.
36. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se i janë shkelur të drejtat:

“...në momentin e dorëzimit të dokumenteve të caktuara në gjuhën serbe –jo-amtare, duke mos i përkthyer këto dokumente nga gjuha serbe në gjuhën shqipe, ku ka pasur shkelje esenciale të Kushtetutës së Kosovës, si dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut...”

37. Nga dispozitat ligjore të lartcekura të Ligjit për procedurën kontestimore, nr. 03/L-006, të 30 qershorit 2008, neni 96.2, shihet qartë se:

“Në qoftë se procedura nuk zhvillohet në gjuhën e palës, gjegjësisht të pjesëmarrësve të tjerë në procedurë, do të sigurohet sipas kërkesës së tyre përkthimi gojarisht në gjuhën e tyre apo në gjuhën që e kuptojnë, i të gjitha parashtresave dhe provave shkresore, si dhe i asaj që parashtrohet në seancë gjyqësore.”

Pas shqyrtimit të dokumenteve të paraqitura në Gjykatën Kushtetuese, shihet qartë se parashtruesi i kërkesës në asnjë fazë të procesit në gjykatat e rregullta nuk ka parashtruar kërkesë për përkthimin e dokumenteve të kontestuara, siç është e paraparë me Ligjin për procedurën kontestimore të cituar më lart, prandaj Gjykata Kushtetuese konstaton se parashtruesit e kërkesës me mosparashtrimin e kërkesës zyrtare për përkthim të dokumenteve kontestuese nuk kanë shfrytëzuar të drejtën ligjore të garantuar për përkthim të dokumenteve në procedurë. Gjykata Kushtetuese nuk ka gjetur që procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, Aktvendimin për papranueshmëri, Beqiri kundër Vendimit nr. 50116335 të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale KI 10/09, të 25 janarit 2010, Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës).

38. Gjykata Kushtetuese më tej vëren se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, i shkallës së dytë, si dhe aktgjykimi i Gjykatës Supreme është i arsyetuar dhe kjo Gjykatë nuk ka vërejtur që gjatë gjykimit të rastit ka pasur shkelje procedurale, të cilat do të rezultonin me shkelje të të drejtave themelore të parashtruesit të kërkesës të garantuara me Kushtetutë. Parashtruesit të kërkesës i janë ofruar të gjitha mundësitë për t'u mbrojtur gjatë gjithë procesit të gjykimit të rastit.
39. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka argumentuar dhe vërtetuar me dëshmi pretendimet e shkeljeve të të drejtave të tij nga gjykata e shkallës së parë, nga gjykata e shkallës së dytë, si dhe nga Gjykata Supreme.
40. Në fakt, pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e të drejtave kushtetuese nuk paraqesin *prima facie* bazë të mjaftueshme për të ngritur një rast në Gjykatë; pakënaqësia e

parashtruesit të kërkesës me vendimin e gjykatave të rregullta nuk paraqet bazë kushtetuese për t'u ankuar në Gjykatën Kushtetuese.

41. Për më tepër, Gjykata vëren se, në mënyrë që një rast *prima facie* t'i përmbushë kërkesat e pranueshmërisë së kërkesës, parashtruesi i kërkesës duhet të provojë se procedurat në gjykatën e shkallës së parë, të shkallës së dytë, si dhe në Gjykatën Supreme, shikuar në tërësinë e tyre, nuk janë zhvilluar në atë mënyrë që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur një gjykim të drejtë apo se shkelje të tjera të të drejtave kushtetuese mund të bërë nga gjykatat e rregullta gjatë gjykimit të rastit.
42. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 36 (2) a) të Rregullores së punës, i cili përcakton se “*Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se: a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie*”.
43. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë), që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).
44. Prandaj, Gjykata nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM], Nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1;).
45. Sidoqoftë, parashtruesi i kërkesës nuk shpjegon se pse dhe si është bërë shkelja e të drejtave të tij, ai nuk mbështet pretendimin *prima facie* mbi baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar prova që tregojnë se të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut dhe protokollet e saj janë shkelur nga gjykatat e rregullta.
46. Gjykata Kushtetuese nuk mund të konsiderojë se procedurat përkatëse në gjykatën e shkallës së parë, në gjykatën e shkallës së dytë, si dhe në Gjykatën Supreme ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmëri të kërkesës, nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).

47. Në fakt, parashtruesi i kërkesës nuk ka provuar *prima facie* se pse dhe si gjykata e shkallës së parë, e shkallës së dytë, si dhe Gjkata Supreme ia kanë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe protokollet e saj.
48. Prandaj, Gjkata konstaton se parashtruesi i kërkesës as nuk ka ndërtuar, e as nuk ka provuar një rast *prima facie*, qoftë mbi bazën e meritave, qoftë mbi bazën e pranueshmërisë së kërkesës.
49. Në përfundim, Gjkata konstaton se kërkesa është e papranueshme si qartazi e pabazuar.
50. Gjkata më tej konstaton se, pasi që kërkesa e parashtruesit është e papranueshme, kërkesa për masën e përkohshme është pa objekt shqyrtimi, dhe, si e tillë, duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjkata Kushtetuese e Kosovës, në mbështetje të neneve 27 dhe 48 të Ligjit dhe në mbështetje të rregullave 36 (2) a) dhe 56 të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 16 tetor 2013, njëzëri

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për vendosje të masës së përkohshme;
- III. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI107/13, Hasan Salihu, Aktvendim i datës 21 tetor 2013 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit SCEL-09-0001-C1060 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, të 25 marsit 2010

Rasti KI107/13, vendimi i 21 tetorit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, e drejta e pronës, jashtë afatit kohor

Parashtruesi e parashtroi kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 dhe rregullit 56 paragrafi 2 të Rregullores së punës.

Objekti i çështjes i kësaj kërkesë është e drejta e supozuar e parashtruesit të kërkesës që të përfshihet në listën e të punësuarve që gëzojnë të drejtën për një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH KNI “Ramiz Sadiku”.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë për shkak se nuk është përfshirë në listën e të punësuarve që gëzojnë të drejtën për një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH “Ramiz Sadiku”. Parashtruesi i kërkesës nuk i referohet shkeljes së ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti.

Në këto rrethana, Gjykata vërejti se vendimi që kontestohet nga parashtruesi i kërkesës është i 25 majit 2010, ndërsa kërkesa në Gjykatë është dorëzuar me 19 korrik 2013, çka nënkupton se kërkesa e parashtruesit nuk është në përputhje me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.

Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit është hedhur poshtë si e paafatshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI107/13
Parashtrues
Hasan Salihu
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit SCEL-09-0001-
C1060 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, të 25
marsit 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Hasan Salihu nga fshati Bajçinë, komuna e Podujevës.

Vendimi i kontestuar

2. Aktgjykimi SCEL-09-0001-C1060 i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, i 25 marsit 2010.

Baza juridike

3. Kërkesa është e bazuar në Nenin 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), Nenin 49 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009, (në tekstin e mëtejme: Ligji); dhe rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Objekti i çështjes

4. Kërkesa ka për objekt çështjeje të drejtën e supozuar të parashtruesit të kërkesës që të përfshihet në listën e të punësuarve

që gëzojnë të drejtën për një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH KNI “Ramiz Sadiku” Prishtinë.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 19 korrik 2013, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 5 gusht 2013, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI107/13, caktoi gjyqtarin Altay Suroy Gjyqtar raportues. Të njëjtën datë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI107/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
7. Më 30 gusht 2013, parashtruesi u njoftua për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën datë, kërkesa iu komunikua Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme: Dhoma e Posaçme).
8. Më 21 tetor 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve siç janë evidencuar nga dokumentet e dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës

9. Më 2 prill 2009, parashtruesi i kërkesës dorëzoi një ankesë në Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP), me ç'rast kishte kërkuar të përfshihej në listën e të punësuarve që gëzojnë të drejtën për një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH KNI “Ramiz Sadiku” Prishtinë.
10. Më 5 maj 2009, AKP-ja kishte njoftuar Dhomën e Posaçme se parashtruesi i kërkesës nuk kishte ofruar asnjë dëshmi relevante se ka qenë në vazhdimësi në marrëdhënie pune në NSH “Ramiz Sadiku” Prishtinë dhe se në kohën e privatizimit të kësaj NSH-je, gjegjësisht më 27 qershor 2006, ai nuk kishte qenë punëtor i regjistruar i NSH-së. Për më tepër, AKP-ja po ashtu kishte njoftuar Dhomën e Posaçme se parashtruesi i kërkesës nuk kishte dorëzuar ankesën e tij në AKP brenda afatit të caktuar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (pararendësi i AKP-së), më 31 gusht 2007.
11. Në përgjigjen e sipërpërmendur të 5 majit 2009, AKP-ja i ishte përgjigjur Dhomës së Posaçme “*...duke marrë parasysh faktet e siguruara nga ankuesi (parashtruesi i kërkesës) dhe pas hetimeve*

shtesë të ndërmarra nga AKP-ja, AKP-ja është e mendimit se pretendimet e bëra nga ankuesi nuk mbështesin padinë e tij në pajtim me Rregulloren Nr. 2003/13 të UNMIK-ut, Neni 10, Pika 10.4”.

12. Dhoma e Posaçme, me urdhrin SCEL-09-0001, kërkoi nga parashtruesi i kërkesës të theksojë qartë se përse ai ka ushtruar ankesën e tij në Dhomën e Posaçme pas afatit ligjor. Parashtruesi i kërkesës u përgjigj ndaj urdhrit duke deklaruar se ai kishte parashtruar një ankesë të vonshme, sepse ai jeton në një fshat ku dërgesat postare janë gjithnjë me vonesë dhe se është informuar përkritazi me listën e publikuar nga bashkëfshatarët e tij që kishin shkuar në zyrën postare dhe kishin marrë dërgesën me vonesë.
13. Më 25 mars 2010, Dhoma e Posaçme, me Aktgjykimin SCEL-09-0001-C1060, hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të pabazuar.
14. Me Aktgjykimin e sipërpërmendur të 25 marsit 2010, Dhoma Posaçme kishte konstatuar se justifikimi i parashtruesit të kërkesës për dorëzim të ankesës me vonesë, është i pabazë dhe si i tillë nuk do të merret në konsideratë, sepse ligji në fuqi nuk përshkruan asnjë kërkesë ndaj AKP-së për njoftimin e secilit punëtor, por vetëm publikimin e listës në gazetë ditore me një këshillë rreth mundësisë për të parashtruar një ankesë në Dhomën e Posaçme brenda 20 ditësh.
15. Dhoma e Posaçme po ashtu në pajtim me nenin 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4, kishte cekur në këshillë juridike se parashtruesi i kërkesës mund të paraqesë ankesë kundër vendimit të saj brenda tridhjetë (30) ditësh te Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme nga dita e pranimi të vendimit.

Ligji

“RREGULLORE NR. 2003/13
UNMIK/RREG/2003/13
9 maj 2003*

*MBI TRANSFORMIMIN E SË DREJTËS PËR PËRDORIMIN E
PRONËS SË
PATUNDSHME NË PRONËSI SHOQËRORE*

*Neni 10
TË DREJTAT E TË PUNËSUARVE*

10.4 Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri (3) vite. Kjo kërkesë nuk i ndalon punëtorët, të cilët pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar, nëse nuk do të kishin qenë diskriminuar, që të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6.

10.6 Pas paraqitjes së kërkesës nga individë apo individët me të drejtë të cenuar, ankesa lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime, e përcaktuar nga Agjencia dhe shpërndarja e fondeve nga llogaria e garancimbajtjes e paraparë në paragrafin 10.5, i nënshtrohet shqyrtimit nga Dhoma e Posaçme, në pajtim me nenin 4.1 (g) të Rregullores 2002/13.

(a) Ankesa duhet të dorëzohet në Dhomën e Posaçme brenda 20 ditëve pas shpalljes përfundimtare në media nga Agjencia, në bazë të paragrafit 10.3, të listës së të punësuarve me të drejta legjitime. Dhoma e Posaçme shqyrton çfarëdo ankese në bazë të përparësisë dhe merr vendim për këto ankesa brenda 40 ditëve pas dorëzimit të tyre”.

Pretendimet e parashtruesit

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon: “...se ishte punësuar në NSH “Ramiz Sadiku” Prishtinë qysh nga viti 1981 ndërsa më 28 shkurt 1990 forcat serbe e kishin diskriminuar atë dhe e kishin larguar nga puna”.
17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë për shkak se nuk është përfshirë në listën e të punësuarve që gëzojnë të drejtën për një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH “Ramiz Sadiku” Prishtinë. Parashtruesi i kërkesës nuk i referohet shkeljes së ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti.

Vlerësimi i pranueshmërisë

18. Për të qenë në gjendje për ta shqyrtuar kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

19. Përkitazi me kërkesën e parashtruesit, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

20. Gjykata i referohet nenit 47 të Ligjit, që përcakton:

“Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

21. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Dhoma e Posaçme, në pajtim me ligjin në fuqi, me këshillë juridike ka njoftuar parashtruesin e kërkesës rreth mundësisë së tij që të ankohet te Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme kundër vendimit të Trupi gjykues të Dhomës së Posaçme.
22. Nga dokumentet e dorëzuara, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka sjellë asnjë provë që ka vepruar sipas këshillës juridike të Dhomës së Posaçme dhe që ka çuar deri në fund procedurën e iniciuar gjyqësore, përkatësisht ai nuk ka provuar se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit.
23. Arsyeimi mbi rregullin e shterimit është që t'u ofrohet autoriteteve kompetente, duke përfshirë gjykatat, mundësia për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e supozuara të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (shih rastin KI41/09, parashtrues i kërkesës AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtinë, Aktvendimi për papranueshmëri, i 21 janarit 2010, dhe mutatis mutandis, shih rastin Selmouni kundër Francës, Nr. 25 803/94, GJEDNJ, Vendimi i 28 korrikut 1999).
24. Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, që përcakton:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.

25. Gjykata, po ashtu, i referohet rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës, që përcakton:

“Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

[...]

b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi...”.

26. Në këto rrethana, Gjykata vëren se vendimi që kontestohet nga parashtruesi i kërkesës është i 25 majit 2010, ndërsa kërkesa në Gjykatë është dorëzuar më 19 korrik 2013, çka nënkupton se kërkesa e parashtruesit nuk është në përputhje me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, sepse është dorëzuar në Gjykatë për më shumë se tri vjet vonesë.
27. Gjykata rithekson se neni 49 i Ligjit dhe rregulli 36 (1) b) i Rregullores së punës kërkojnë nga parashtruesit, që pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike, të jenë të kujdesshëm që kërkesat t’i dorëzojnë në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit katër mujor nga dita kur është pranuar vendimi i fundit gjyqësor.
28. Rezulton se kërkesa është e paafatshme.
29. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të hidhet poshtë si e papranueshme për shkak të mospërmbushjes së kriterëve të përcaktuara me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, më 21 tetor 2013, njëzëri

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI61/13, Blerim Shabi, Aktvendim i datës 18 nëntor 2013 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. nr. 119/2012, të 21 dhjetorit 2012

Rasti KI61/13, vendimi i 18 nëntorit 2013

Fjalët kyçe: kërkesa individuale, mbrojtje e pronës, qartazi e pabazuar.

Më 22 prill 2013, parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, duke kërkuar nga Gjykata vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar.

Parashtruesi në kërkesë ka pretenduar se me Vendimin e Gjykatës Supreme i janë shkelur këto nene të Kushtetutës së Kosovës: neni 21 [Parimet e Përgjithshme], neni 23 [Dinjiteti i Njeriut], neni 24 [Barazia para Ligjit], neni 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] dhe neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], si dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në tërësi.

Gjykata, gjatë shqyrtimit të rastit, konsideron se nuk ka asgjë në kërkesë që tregon se gjatë dëgjimit të rastit, gjykatave u mungonte paanshmëria apo që procedurat ishin të padrejta. Gjykata konstaton se parashtruesi nuk është viktimë e mohimit të mbrojtjes së barabartë gjyqësore të të drejtave të tij. Gjykata, gjithashtu gjen se pretendimet e parashtruesit nuk janë të arsyetuara dhe duhet të refuzohen si qartazi të pabazuara.

Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e kërkesës së paraqitur, Gjykata Kushtetuese vendosi ta deklarojë kërkesën të papranueshme, sepse faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e justifikojnë pretendimin për shkeljen e të drejtave kushtetuese.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI61/13
Parashtrues
Blerim Shabi
Vlerësimi i kushtetutshmërisë
së Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. nr. 119/2012,
të 21 dhjetorit 2012**

**GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË
KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Blerim Shabi, nga komuna e Pejës. Ai është i përfaqësuar nga avokati z. Isë Osdautaj nga Deçani.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. nr. 119/2012, të 21 dhjetorit 2012.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pretendon se vendimet e lartpërmendura i kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, gjegjësisht neni 21 [Parimet e Përgjithshme], neni 23 [Dinjiteti i Njeriut], neni 24 [Barazia para Ligjit], neni 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], dhe neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]. Parashtruesi gjithashtu pretendon shkeljen e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në tërësi.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 22 prill 2013, parashtruesi parashtroi kërkesë në Gjykatë.
6. Më 25 prill 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën e plotësuar në Gjykatë dhe kopjet e vendimeve gjyqësore në rastin të tij.
7. Më 29 prill 2013, Kryetari caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović si gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Artë Rama-Hajrizi.
8. Më 10 maj 2013, Gjykata Kushtetuese njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën Supreme të Kosovës se ka filluar procedura e shqyrtimit të kushtetutshmërisë së rastit nr. KI61/13.
9. Më 18 nëntor 2013, pasi shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i paraqiti Gjykatës në përbërje të plotë rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Faktet e rastit

10. Nga shkresat e lëndës del se më 15 tetor 2009, përafërsisht në orën 20:30, ndodhi një kacafytje fizike, ose 'përleshje' në një lagje të Pejës, ku ishin të përfshirë parashtruesi i kërkesës dhe disa persona të tjerë. Një person humbi jetën në vendin e ngjarjes, si pasojë e plagëve të marra nga një thikë.
11. Më 15 tetor 2009, parashtruesi u arrestua dhe u vendos në paraburgim. Më pas, parashtruesi u akuzua për veprë penale të vrasjes dhe rasti iu transferua Gjykatës së Qarkut në Prizren.
12. Më 15 korrik 2011, Gjykata e Qarkut në Prizren (P. nr. 59/2010) e shpalli parashtruesin fajtor për veprë penale të vrasjes nga neni 146 të Kodit Penal të Kosovës dhe e dënoi atë me burgim prej 15 vjetësh. Parashtruesi nuk ka qenë i pranishëm kur i është shqiptuar aktgjykimi, por përfaqësuesi i tij ligjor ishte i pranishëm.

13. Në vendimin e saj, Gjykata e Qarkut parafrazoi më tej raportin e ekspertit mjekoligjor: *“Sipas autopsisë dhe përshkrimeve janë dy plagë shpuese, prerëse në anën e pasme të trupit me kahje mbrapa-përpara, poshtë-lartë, djathtas-majtas. Me plagët e tilla të marra, i ndjeri në momentin e lëndimit nuk ka pasur mundësi të rezistojë më tutje, e as të sulmojë.”*
14. Parashtruesi ushtroi padi në Gjykatën Supreme kundër këtij aktgjykimi. Parashtruesi kërkoi nga Gjykata Supreme, ose ta lirojë nga akuza për vrasje, ose ta kthejë rastin në Gjykatën e Qarkut për rigjykim. Parashtruesi pretendon se gjykata e shkallës së parë kishte bërë shkelje të ligjit dhe të procedurës penale, si dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të fakteve. Parashtruesi në veçanti theksoi se lëndimet e tij, të pësuar nga përleshja në Pejë, nuk janë marrë parasysh nga Gjykata e Qarkut. Parashtruesi gjithashtu kërkoi që të jetë i pranishëm gjatë seancës në Gjykatën Supreme dhe deklaroi se ai nuk kishte qenë i pranishëm kur ishte shpallur aktgjykimi dhe dënimi nga gjykata e shkallës së parë.
15. Më 8 shkurt 2012, Gjykata Supreme (Ap. nr. 446/2011) e shpalli ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe e vërtetoi Vendimin e Gjykatës së Qarkut, P. nr. 59/2010. Parashtruesi dhe përfaqësuesi i tij ligjor ishin të pranishëm në seancën e udhëhequr nga Kolegji i Ankesave i Gjykatës Supreme. Në vendimin e saj, Gjykata Supreme shqyrtoi gjerësisht faktet dhe ligjin lidhur me këtë rast, si dhe bazat e veçanta të ankesës të paraqitura nga parashtruesi i kërkesës.
16. Parashtruesi paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër këtij vendimi. Ai pretendoi shkelje thelbësore të ligjit dhe procedurës penale. Ai përsëriti pretendimin se lëndimet e tij nuk ishin marrë parasysh nga gjykatat e rregullta. Ai gjithashtu iu referua në mënyrë eksplicite faktit se gjykata e shkallës së parë e kishte dënuar atë me një burgim shumë të gjatë, pa praninë e tij në gjykatë, përkundër faktit se ai ishte sjellë nga vendi i paraburgimit në Pejë në gjykatë në Prizren, disa herë më përpara në mënyrë që të marrë pjesë në seanca.
17. Më 21 dhjetor 2012, Gjykata Supreme (Pkl. nr. 119/2012) e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë. Në vendimin e saj, Gjykata Supreme e shqyrtoi vlerësimin e fakteve të rastit, të dhënë nga gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë. Gjykata Supreme gjithashtu vlerësoi se parashtruesi nuk kishte vepruar në vetëmbrojtje dhe konstatoi se gjykatat e rregullta nuk kanë bërë asnjë shkelje të Ligjit të procedurës penale. Gjykata

Supreme nuk e ka adresuar çështjen e mungesës së parashtruesit gjatë shpalljes së dënimit nga gjykata e shkallës së parë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Supreme lidhur me ankesën e tij i kanë shkelur të drejtat e tij si person i akuzuar dhe të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në veçanti sepse parashtruesi nuk ishte i pranishëm në Gjykatën e Qarkut kur i ishte shqiptuar vendimi për dënim.
19. Parashtruesi pretendon se ai kurrë nuk ka pranuar nga Gjykata e Qarkut një kopje të një incizimi digjital të seancave gjyqësore, të cilin e kishte kërkuar dy herë me letër. Ai pretendon se ky mohim i qasjes në incizimin dixhital i kishte shkelur të drejtat e tij si person i akuzuar, si dhe të drejtën e tij për mbrojtje të barabartë të të drejtave në procedurë para gjykatave, siç garantohet me nenin 31 (1) të Kushtetutës.
20. Parashtruesi gjithashtu pretendon se të dy gjykatat, Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Supreme lidhur me ankesën, nuk kanë marrë parasysh lëndimet që ai kishte pësuar gjatë përlëshjes në Pejë, dhe ndikimin e këtyre lëndimeve në aftësinë e tij për të kryer vrasjen, për të cilën ai ishte dënuar. Parashtruesi pretendon se nga gjykatat, plagët e tij nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë me ato të viktimës dhe personave të tjerë të përfshirë në përlëshje, dhe se kjo ka shkelur të drejtën e tij për barazi të trajtimit siç garantohet me nenin 24 të Kushtetutës.

Vlerësimi pranueshmërisë së kërkesës

21. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata para së gjithash duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
22. Neni 113 i Kushtetutës përcakton kornizën e përgjithshme të kriterëve juridike për pranueshmëri. Ai parasheh:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

23. Neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese gjithashtu parasheh:

„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

24. Përveç kësaj, rregulli 36 (2) i Rregullores parasheh se:

“(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...], ose

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

[...], ose

(d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij;”

25. Gjykata vëren se parashtruesi i ka ngritur argumentet e tij në Gjykatën Supreme në lidhje me mungesën e tij në gjykatë, kur Gjykata e Qarkut e ka shpallur vendimin për dënimin e tij. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi ngriti çështjen e vlerësimit faktik të lëndimeve të tij në ankesë dhe në procedurë për mbrojtje të ligjshmërisë.
26. Prandaj, Gjykata konkludoi se parashtruesi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion në lidhje me pretendimet e tij, jo vetëm formalisht, por edhe në përmbajtje.
27. Sidoqoftë, Gjykata Kushtetuese rithekson që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, që të veprojë si Gjykatë e Apelit, ose si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i këtyre të fundit që të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, Avdyli kundër Gjykatës Supreme të Kosovës, KI 13/09, 18

qershor 2010; shih *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës, [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut 1999-1)

28. Gjykata Kushtetuese mundet vetëm të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në atë mënyrë, dhe se procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në mënyrë të tillë sa që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, *inter alia*, Komisioni Evropian për të Drejta të Njeriut, Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr. 13071/87, 10 korrik 1991).
29. Në këtë rast, parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta të paraqesë rastin e tij dhe të kontestojë interpretimin e fakteve dhe të ligjit të cilin e konsideron se është i pasaktë, si në Gjykatën Supreme në lidhje me ankesën, po ashtu edhe në procedurë për mbrojtje të ligjshmërisë.
30. Gjykata vëren se teksti i vendimeve të Gjykatës Supreme lidhur me ankesën e tij, dhe në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, nuk i referohen shprehimisht mungesës së parashtruesit në Gjykatën e Qarkut, kur ishte shpallur vendimi për dënim.
31. Gjykata megjithatë vëren se parashtruesi i kërkesës ka qenë i pranishëm gjatë seancave të tjera në gjykimin e tij në Gjykatën e Qarkut, si dhe në një seancë në Gjykatën Supreme lidhur me ankesën e tij. Për më tepër, përfaqësuesi ligjor i parashtruesit ishte i pranishëm në seancën kur ishte shpallur vendimi për dënim.
32. Në këto rrethana, Gjykata gjen se mungesa e parashtruesit në seancën kur ishte shpallur vendimi për dënimin e tij, nuk mund të thuhet se i ka shkelur të drejtat e tij për gjykim të drejtë.
33. Lidhur me refuzimin e pretenduar për të furnizuar përfaqësuesin ligjor të parashtruesit me një kopje të një incizimi digjital të seancave gjyqësore, nga parashtresat e parashtruesit në Gjykatën Supreme dhe nga vendimi i detajuar i Gjykatës Supreme lidhur me ankesën, rezulton se parashtruesi ishte i pranishëm gjatë seancave gjyqësore në rastin e tij dhe ishte i përfaqësuar nga avokati gjatë tërë procedurës.
34. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se të drejtat e parashtruesit për pajisje adekuate për përgatitjen dhe kryerjen e mbrojtjes së tij, të garantuara me nenin 30 (3) të Kushtetutës, u plotësuan në mënyrë të mjaftueshme nga gjykatat e gjykimit, pa marrë parasysh nëse një incizim digjital i seancave i është vënë apo jo në dispozicion parashtruesit.

35. Lidhur me dështimin e pretenduar të gjykatave të rregullta për të marrë parasysh lëndimet fizike të parashtruesit gjatë kacafytjes së lartpërmendur, me rastin e përcaktimit të përgjegjësisë së tij për vdekjen e viktimës, Gjykata vëren se Gjykata Supreme në procedurën për mbrojtje të ligjshmërisë kundërshtoi haptazi argumentin se parashtruesi mund të ketë qenë duke vepruar në vetëmbrojtje.
36. Lidhur me dështimin e pretenduar të gjykatave të rregullta për të vlerësuar në mënyrë të drejtë veprimet e palëve të tjera në ngjarje, të kryera ndaj parashtruesit, si dhe faktorëve të cilët kanë kontribuar në vdekjen e viktimës, Gjykata Kushtetuese konstaton se kjo është jashtë fushëveprimit të autoritetit të Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenin 113 (7) të Kushtetutës, siç thuhet në paragrafët 28 dhe 29 më sipër.
37. Pas shqyrtimit të procedurës penale në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk gjen se procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta ose të prekura nga arbitrariteti (shih *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
38. Gjykata konsideron se nuk ka asgjë në kërkesë që tregon se gjatë dëgjimit të rastit, gjykatave u mungonte paanshmëria apo që procedurat ishin të padrejta. Fakti i thjeshtë që parashtruesi është i pakënaqur me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (Shih, Memetoviq kundër Gjykatës Supreme të Kosovës, Kërkesa nr. KI50/10, Aktvendimi i 21 marsit 2011; shih, *mutatis mutandis*, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, Nr. 5503/02, i 26 korrikut 2005).
39. Në bazë të këtyre vlerësimeve, Gjykata konstaton se parashtruesi nuk është viktimë e mohimit të mbrojtjes së barabartë gjyqësore të të drejtave të tij.
40. Prandaj, Gjykata Kushtetuese gjen se pretendimet e parashtruesit nuk janë dëshmuar dhe duhet të hidhen poshtë si qartazi të pabazuara.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 48 të Ligjit, dhe në mbështetje të rregullit 36 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 18 nëntor 2013, njëzëri

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI152/13, Komuna e Gjakovës, Aktvendim i datës 20 nëntor 2013 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. Nr. 49/2012, të 3 qershorit 2013

Rasti KI152/13, vendimi i 20 nëntorit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kontest pronësor, kërkesë për zhdëmtim, kërkesë qartazi e pabazuar.

Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës pretendonte se, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. Nr. 49/2010, i 3 qershorit 2013, përmbante të meta të dukshme në vlerësimin e ligjit material dhe të dispozitave ligjore të Ligjit për procedurën kontestimore. Ai pretendonte se arsyetimi i aktgjykimit të asaj gjykate ishte tejet konfuz dhe i shabllonizuar, për faktin se ajo gjykatë nuk bëri hulumtimin e mjaftueshëm të fakteve dhe provave materiale.

Në këtë rast, Gjykata gjeti se, kërkesa e parashtruesit, për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, konsiston në: a) shkeljen e ligjit material dhe b) shkeljen e dispozitave ligjore të Ligjit të procedurës kontestimore. Pretendimet e parashtruesit, në këtë rast, nuk janë ngritur mbi bazën e ankimit kushtetues (kushtetutshmërisë) për shkeljen e ndonjë të drejte. Në këtë kontekst, *Gjykata konsideroi se, pretendimet e parashtruesit ishin të natyrëssëligjshmërisë dhe si të tilla nuk ngritur çështje kushtetuese, përkitazi më shkeljen e ndonjë të drejte themelore të garantuar me Kushtetutë, në mënyrë që Gjykata të mund të ndërhynte.*

Nga arsyet e lartcekura, Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbushi kriteret e pranueshmërisë, sepse parashtruesi kishte dështuar të provojë se me vendimin e kontestuar i ishte shkelur ndonjë e drejtë e garantuar me Kushtetutë. Në tërësi, Gjykata përfundoi se kërkesa e parashtruesit ishte qartazi e pabazuar.

**AKTVENDIM PËR PAPARANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI152/13
Parashtrues
Komuna e Gjakovës
Vlerësimi i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës,
Rev. Nr. 49/2012, të 3 qershorit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Komuna e Gjakovës, e përfaqësuar nga Avokatura Publike Komunale në Gjakovë (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë, Rev. 49/2012, të 3 qershorit 2013, të cilin parashtruesi e ka pranuar më 28 korrik 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi pretendon se i është shkaktuar dëm i konsiderueshëm monetar, si rezultat i shkeljes së ligjit material dhe shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Supreme).

Baza juridike

4. Neni 113.7, neni 21 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121, të 16 dhjetorit 2008, i hyrë në fuqi më 15 janar 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 25 shtator 2013, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në Gjykatë.
6. Më 30 shtator 2013, Kryetari, për këtë rast caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova (anëtare) dhe Arta Rama-Hajrizi (anëtare).
7. Më 9 tetor 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën Supreme të Kosovës, përkitazi me regjistrimin e kësaj kërkesë.
8. Më 20 nëntor 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

9. Sipas pasqyrës së fakteve të parashtruara, në këtë kërkesë flitet për një kontest civil, mes parashtruesit si e paditur dhe paditësit me inicialet K. N.
10. Në vitin 1966, Fondi për rregullimin e tokave, rrugëve dhe veprimtarive komunale në Gjakovë, kishte shpallur ankand publik për investime të përbashkëta, përkitazi me ndërtimin e lokaleve afariste në Gjakovë, përkatësisht ndërtimin e tregut të gjelbër. Paditësi, sipas marrëveshjes së arritur me Fondin, në bazë të faturës nr. 03/96, të 3 shtatorit 1996, ka paguar shumën prej 246.398,00 dinarësh në emër të pagesës së avansit të lokalit nr. 3 në lokacionin Hani i Kaqit. Paditësi ka vazhduar me pagesa deri në përmbushjen e shumës së caktuar dhe në këtë mënyrë në tërësi e kishte përmbushur marrëveshjen e arritur. Mirëpo, atij nuk i është dorëzuar lokali dhe po ashtu nuk i është kthyer shuma e paguar.

11. Më pas, fondi në fjalë, në procedurë jogjyqësore, paditësit ia kishte ndarë në shfrytëzim një truall në sipërfaqe prej 0.03,75 ha, mirëpo, fare në fund është konstatuar se ky truall, në vitin 1995 i është ndarëz. D. J., i cili e ka paguar shumën në lartësi prej 9.375,00 dinarësh dhe kështu Fondi është tërhequr nga kjo marrëveshje.
12. Paditësi, në kërkim të kthimit të shumës së paguar sipas marrëveshjes së arritur me fondin e lartcekur kishte ushtruar padi në Gjykatën Komunale në Gjakovë.
13. Më 16 prill 2010, Gjykata Komunale në Gjakovë, me Aktgjykimin C. Nr. 531/2005, e refuzoi në tërësi padinë e paditësit, e cila ishte ushtruar kundër parashtruesit (e paditura). Paditësi përmes padisë kishte kërkuar që të detyrohej parashtruesi, që në emër të fitimit të pabazë, t'ia paguajë paditësit shumën monetare në vlerë prej 76.415,90 eurosh.
14. Paditësi, kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale të Gjakovës, ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë.
15. Gjykata e Qarkut në Pejë, më 24 shkurt 2011, Aktgjykimi Ac. Nr. 375/2010, ndryshoi aktgjykimin e atakuar nga paditësi dhe konstatoi se parashtruesi në këtë rast, posedon legjitimitet pasiv, prandaj detyrohet që në emër të fitimit të pabazë, t'ia paguajë paditësit shumën monetare në vlerë prej 76.415,90 eurosh, me kamatë, të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë.
16. Parashtruesi i kërkesës, kundër vendimit të gjykatës së instancës së dytë, parashtrroi revizion në Gjykatën Supreme. Ai nga Gjykata Supreme kërkoi shqyrtimin e vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, për shkak të shkeljes së ligjit material dhe shkeljes së dispozitave të ligjit për procedurën kontestimore.
17. Më 3 qershor 2013, Gjykata Supreme, Aktgjykimi Rev. 49/2012, refuzoi si të pabazë kërkesën e parashtruesit për revizion. Gjykata Supreme, në këtë rast, kishte konstatuar se: *“Thëniet e revizionit se e paditura nuk mund të jetë përgjegjëse për obligimet që kanë krijuar organet komunale të regjimit të mëparshëm, se nuk ka suksesion me komunën e mëparshme, janë të pabazuara, më që gjykatat e shkallës së dytë, duke u bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/45, të 11 gushtit 2000, ka gjetur se e paditura e ka legjitimitetin pasiv të palës së paditur në këtë çështje juridike, sepse sipas nenit 2.4 parashihet se, çdo komunë e*

ka statusin e vet juridik, të drejtën për të poseduar dhe për të administruar pronën.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. Nr. 49/2010, i 3 qershorit 2013, përmban të meta të dukshme në vlerësimin e ligjit material dhe të dispozitave ligjore të Ligjit për procedurën kontestimore. Ai mëton se arsyetimi i aktgjykimit të asaj gjykate është tejet konfuz dhe i shabllonizuar, për faktin se ajo gjykatë nuk bëri hulumtimin e mjaftueshëm të fakteve dhe provave materiale.
19. Për më tepër, parashtruesi pretendon se: 1. *“Revizioni i ushtruar ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 375/10 ishte thelbësisht i fokusuar në faktin notor, se Komunës së Gjakovës, në këtë raport juridiko-civil I MUNGON LEGJITIMITETI I PLOTË PASIV, me justifikim të bazuar se marrëdhënia kontraktuale lidhur me shitblerjen e palujtshmërisë ishte e lidhur ndërmjet ish-“Fondit” të Gjakovës, më pas trashëgimtari i “Fondit” Ndërmarrja Banesore “Housing Company”, e regjistruar pranë MTI-së dhe paditësit K.N. 2. Në këtë marrëdhënie kontraktuale, në asnjë rast në asnjë moment nuk është e përfshirë Komuna e Gjakovës. 3. Nga aktgjykimi i atakuar rezulton se, objekti kontestues është lokali afarist, gjersa nga kërkesëpadia e paditësit rezulton se, objekti i kontestit është palujtshmëria-parcela ndërtimore e pandërtuar, nr. 4446/165, nr. i parcelës 378 KK, Gjakovë, në qytet, në sipërfaqe prej 375 m²”.*

Pranueshmëria e kërkesës

20. Për të qenë në gjendje që të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata, para së gjithash duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
21. Në këtë rast, kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, që parasheh:

113.7 “Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale,

të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Dhe në nenin 21.4 të Kushtetutës, që përcakton:

21.4 “Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.”

22. Për qëllime të pranueshmërisë, Gjykata, gjithashtu duhet të marrë parasysh nëse kërkesa e parashtruesit i plotëson kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në rregullin 36.1 (c) të Rregullores, që përcakton se:

36 (1) “Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

[...]

c) Kërkesa është qartazi e bazuar”.

23. Për më tepër, rregulli 36.2 i Rregullores së punës parasheh që:

36 (2) “Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie;

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;

c) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë; ose

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

24. Në këtë rast, Gjykata vëren se, kërkesa e parashtruesit, për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar konsiston në: a) shkeljen e ligjit material dhe b) shkeljen e dispozitave ligjore të Ligjit të procedurës kontestimore. Pretendimet e parashtruesit, në këtë rast, nuk janë ngritur mbi bazën e ankimit kushtetues (kushtetutshmërisë) për shkeljen e ndonjë të drejte.

25. Në këtë kontekst, Gjykata konsideron se, pretendimet e parashtruesit janë kryesisht të natyrës së ligjshmërisë dhe si të tilla nuk ngrenë çështje kushtetuese, përkitazi më shkeljen e ndonjë të drejte themelore të garantuar me Kushtetutë, në mënyrë që Gjykata do të mund të ndërhynte.
26. Gjykata, duhet t'ua përkujtojë palëve kërkuese se Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e shkallës së katërt që të vlerësojë ligjshmërinë dhe saktësinë e vendimeve të dhëna nga gjykatat e rregullta, përveç nëse ka prova bindëse se vendimet e tilla janë dhënë në një mënyrë dukshëm të padrejtë dhe të paqartë.
27. Edhe më tutje, është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
28. Nga arsyet e lartcekura, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë, sepse parashtruesi ka dështuar të provojë se me vendimin e kontestuar i është shkelur ndonjë e drejtë e garantuar me Kushtetutë.
29. Në tërësi, Gjykata përfundon se kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 (7) të Kushtetutës, në pajtim me rregullin 36 (2) b) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 20 nëntor 2013, njëzëri

VENDOS

- I. TA REFUZOJË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetë Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI182/13, Xhevat Rrustemi, Aktvendim i datës 5 dhjetor 2013 - Vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit ASC-11-0035 të Kolegjit për Ankesa të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 23 nëntorit 2012

Rasti KI182/13, vendimi i 5 dhjetorit 2013.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, e drejta e pronës, e paafatshme.

Parashtruesi e parashtroi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 dhe rregullin 56 paragrafi 2 të Rregullores së punës.

Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin ASC-11-0035 të Kolegjit për Ankesa të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji për Ankesa të Dhomës së Posaçme), të 23 nëntorit 2012, i cili sipas pohimeve të parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar atij më 25 shkurt 2013, derisa në bazë të vërtetimit për pranimin e dokumentit, të lëshuar nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, ai i është dorëzuar atij më 9 shkurt 2013.

Parashtruesi në kërkesë nuk ka specifikuar konkretisht se cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë i janë shkelur me vendimin e kontestuar, por vetëm thekson se këto janë të drejta nga marrëdhënia e punës.

Gjykata në bazë të shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoi se parashtruesi e kishte dorëzuar kërkesën e tij më 24 tetor 2013, përderisa vendimi i fundit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, sipas pretendimit të parashtruesit, i është dorëzuar atij më 25 shkurt 2013, që është 3 muaj dhe 29 ditë pas skadimit të afatit ligjor të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, derisa në bazë të vërtetimit të pranimin të dokumentit të lëshuar nga ana e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, Aktgjykimi i është dorëzuar parashtruesit më 9 shkurt 2013, që është 4 muaj dhe 15 ditë pas skadimit të afatit ligjor të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36. (1) b) të Rregullores së punës.

Nga kjo rrjedh se në të dy rastet kërkesa e parashtruesit është e paafatshme.

AKTVENDIM PËR PAPARANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI182/13
Parashtrues
Xhevat Rustemi
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit ASC-11-0035 të
Kolegjit për Ankesa të Dhomës së Posaçme të Gjykatës
Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të
Privatizimit, të 23 nëntorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Xhevat Rustemi (në tekstin e mëtejme: parashtruesi), nga fshati Pakashticë e Epërme, komuna e Podujevës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin ASC-11-0035, të Kolegjit për Ankesa të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji për Ankesa të Dhomës së Posaçme), të 23 nëntorit 2012, i cili sipas pohimeve të parashtruesit të kërkesës, i është dorëzuar parashtruesit më 25 shkurt 2013, derisa në bazë të vërtetimit për pranimin e dokumentit, të lëshuar nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, ai i është dorëzuar atij më 9 shkurt 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit, i cili pretendohet se i pamundëson parashtruesit të kërkesës që ta

realizojë të drejtën në pjesën e 20%, nga privatizimi i Ndërmarrjes shoqërore “Ramiz Sadiku” (në tekstin e mëtejme: NSH “Ramiz Sadiku”), në Prishtinë.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 24 tetor 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 31 tetor 2013, Kryetari caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
7. Më 11 nëntor 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 5 dhjetor 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i propozoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi ishte në marrëdhënie pune në NSH „Ramiz Sadiku“ prej 30 korrikut 1974, deri më 28 shkurt 1990.
10. Më 27 qershor 2006, NSH „Ramiz Sadiku“ e përfundoi procesin e privatizimit.
11. Më 7 prill 2010, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme kundër listës përfundimtare të punëtorëve, të cilën e ka hartuar Agjencia Kosovare e Privatizimit, pasi që ai si punëtor i mëparshëm nuk ishte i përfshirë në atë listë.
12. Në ankesën drejtuar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, parashtruesi kishte theksuar se ai në mënyrë të padrejtë ishte

përrjashtuar nga lista që paraqet diskriminim sepse marrëdhënia e tij e punës ishte ndërprerë kundër vullnetit të tij.

13. Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme, gjatë dëgjimit në procedurën ankimore kishte konkluduar se ankesa e parashtruesit është e pabazuar.
14. Në arsyetimin e vendimit të tij, Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme thekson: *“se ankesa të cilën parashtruesi e kishte paraqitur kundër listës përfundimtare është e paqftashme”, dhe pastaj thekson: „se parashtruesi në ankesën e tij nuk kishte arritur të vërtetojë se për çfarë arsye kishte ndodhur lëshimi i afatit, i cili ishte paraparë me ligj, prandaj në pajtim me këtë, Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme merr vendim që ankesa e parashtruesit të hidhet poshtë si e pabazuar.“*
15. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi ushtroi ankesë në Kolegjin për Ankesa të Dhomës së Posaçme kundër vendimit të Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme.
16. Më 23 nëntor 2012, Kolegji për Ankesa i Dhomës së Posaçme nxori Aktgjykimin ASC-11-0035, me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar, ndërsa vërtetoi në tërësi vendimin e Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme.

Pretendimet e parashtruesit

17. Parashtruesi në kërkesën e tij nuk cek konkretisht se cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë i janë shkelur me vendimin e kontestuar, por vetëm thekson se këto janë të drejta nga marrëdhënia e punës.
18. Parashtruesi iu drejtua Gjykatës me kërkesën si në vijim:

„Dëshiroj ta fitoj të drejtën në 20%, e cila më takon sikurse punëtorëve të tjerë, sepse unë kam punuar gjashtëmbëdhjetë vjet në organizatë...“

Vlerësimi i pranueshmërisë

19. Gjykata thekson se për të qenë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, duhet që së pari të vlerësoj nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

20. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të llogaritet që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor (...)”.

21. Gjykata më tej merr parasysh rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

...

b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi...”.

22. Në bazë të dokumenteve të dorëzuara, Gjykata konstaton se parashtruesi e kishte dorëzuar kërkesën e tij më 24 tetor 2013, përderisa vendimi i fundit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, sipas pretendimit të parashtruesit, i është dorëzuar atij më 25 shkurt 2013, që është 3 muaj dhe 29 ditë pas skadimit të afatit ligjor të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, derisa në bazë të vërtetimit të pranimit të dokumentit të lëshuar nga ana e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, Aktgjykimi i është dorëzuar parashtruesit më 9 shkurt 2013, që është 4 muaj dhe 15 ditë pas skadimit të afatit ligjor të paraparë me nenin 49 të Ligjit, dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.
23. Nga kjo rrjedh se në të dy rastet kërkesa e parashtruesit është e paafatshme.
24. Prandaj, kërkesa duhet hedhur poshtë si e papranueshme në pajtim me nenin 49 të Ligjit, dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhshmëri me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, më 5 dhjetor 2013, njëzëri

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20(4) të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Arta Rama-Hajrizi

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI75/13, Bajrush Gashi, Aktvendim i datës 5 dhjetor 2013 - Kërkesë për sqarim të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, KI 06/12, të 9 majit 2012 dhe Aktvendimit për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese, KI 123/12, të 29 janarit 2013

Rasti KI75-13, vendimi i 5 dhjetorit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, res judicata

Parashtruesi e parashtroi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 dhe rregullin 56 paragrafi 2 të Rregullores së punës.

Parashtruesi në kërkesë nuk i konteston vendimet e autoriteteve publike, por kërkon sqarim të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, të 9 majit 2012 dhe Aktvendimit për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 29 janarit 2013.

Gjykata konstaton se kjo kërkesë e parashtruesit nuk është e bazuar dhe ndërtuar në baza kushtetuese dhe duke pasur parasysh që Gjykata paraprakisht ka trajtuar dhe ka nxjerrë vendim lidhur me kërkesën e parashtruesit, si të tillë Gjykata kërkesën e parashtruesit e konsideron si *res judicata*. Prandaj, në pajtim me rregullin 36.1.(c) dhe 36.2.(a) dhe 36.2.e të Rregullores së punës, kërkesa është hedhur poshtë si qartazi e papabazuar dhe rrjedhimisht e papranueshme.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në**

Rastin Nr. KI 75/13

Parashtruesi

Bajrush Gashi

**Kërkesë për sqarim të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, KI
06/12, të 9 majit 2012 dhe Aktvendimit për papranueshmëri të
Gjykatës Kushtetuese, KI 123/12, të 29 janarit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Bajrush Gashi, nga fshati Hoçë e Vogël, komuna e Rahovecit (në tekstin e mëtejme: parashtruesi), të cilin e përfaqëson avokati z. Nexhat Elshani.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi në kërkesë nuk i konteston vendimet e autoriteteve publike, por kërkon sqarim të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), të 9 majit 2012, dhe të Aktvendimit për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese, të 29 janarit 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës së dorëzuar në Gjykatë, të 28 majit 2013, është kërkesa për sqarim të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009, (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 28 maj 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 28 maj 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me vendimin nr. GJR. KI 75/13 caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović si Gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, me vendimin nr. KSH. KI 75/13, Kryetari caktoi edhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 11 shtator 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 5 dhjetor 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 28 maj 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë, në të cilën kërkonte që Gjykata të sqarojë Aktgjykimin e 9 majit 2012, si dhe Aktvendimin për papranueshmëri, të 29 janarit 2013, në të cilët ai paraqitet si parashtrues i kërkesës.

Përmbledhja e fakteve lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, KI 06/12, të 9 majit 2012

10. Parashtruesi i kërkesës e ka parashtruar kërkesën në Gjykatë, më 27 janar 2012, në të cilën e kishte kontestuar Vendimin e Gjykatës Supreme, [Pzd. nr. 67/2001], të 12 dhjetorit 2011, me të cilin kërkesa e tij për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit ishte refuzuar si e pabazuar.
11. Parashtruesi në kërkesë kishte theksuar se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe me nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), sepse sipas parashtruesit

të kërkesës, “*procedurat gjyqësore kanë shkuar gjithmonë shumë të parregullta*”

12. Më 9 maj 2012, Gjykata duke marrë parasysh faktet dhe provat nga shkresat e lëndës, e shpalli kërkesën e parashtruesit të pranueshme, dhe konstatoi se: „ka shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të KEDNJ-së me arsyetimin se „[...] në rrethanat e këtij rasti, paanshmëria e Gjykatës Supreme ka mundësi të vihet në dyshim, si dhe që brengat e parashtruesit në këtë kuptim mund të konsiderohen të arsyetuara subjektivisht dhe objektivisht „sepse [...] i njëjti gjyqtar, i cili ishte kryetar i Trupit gjykues në Gjykatën e Qarkut në Prizren ishte anëtar i Trupit gjykues të Gjykatës Supreme kur vendosi për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit.“

13. Pastaj, Gjykata e „SHPALLI“ të pavlefshëm Vendimin e Gjykatës Supreme [Pzd. nr. 67/2011], të 12 dhjetorit 2011, i cili shkel nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të

KEDNJ-së dhe “E KTHEU” Vendimin [Pzd. nr. 67/2011], të 12 dhjetorit 2011, në Gjykatën Supreme për rishqyrtim në pajtueshmëri me aktgjykimin e kësaj gjykate në bazë të rregullit 74. (1) të Rregullores së punës.”

14. Më 17 tetor 2012, Gjykata Supreme e njoftoi Gjykatën se e kishte shqyrtuar vendimin e saj në pajtim me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, gjegjësisht, morën vendimin me përbërje tjetër të gjyqtarëve (Vendimi Pzd. nr. 65/2012, i 10 shtatorit 2012).

Përmbledhja e fakteve lidhur me Aktvendimin për papranueshmëri të kërkesës së Gjykatës Kushtetuese, KI123/12, të 29 janarit 2013

15. Më 4 dhjetor 2012, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë, duke kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme [Pzd.nr. 65/2012], të 10 shtatorit 2012.
16. Parashtruesi pretendoi në kërkesë se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 6 [E Drejta për Proces të Rregullt] të KEDNJ-së.

17. Gjykata vuri në dukje se në rastin KI 06/12 tanimë ishte marrë me ankesën e parashtruesit, kur me Aktgjykimin KI 06-12, të 9 majit 2012, gjeti se Gjykata Supreme me Aktgjykimin Pzd. nr. 67/2011, të 12 dhjetorit 2011, ia ka shkelur të drejtat parashtruesit të kërkesës nga neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 [E Drejta për Proces të Rregullt] të KEDNJ-së.
18. Gjykata theksoi më tej se Gjykata Supreme, me Aktgjykimin e ri, Pzd. nr. 65/2012, të 10 shtatorit 2012, ka korrigjuar shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës si dhe të nenit 6 [E Drejta për Proces të Rregullt] të KEDNJ-së, të cilat i kishte gjetur Gjykata Kushtetuese në Aktgjykimin e 9 majit 2012.
19. Parashtruesi i kërkesës nuk kishte paraqitur në Gjykatë fakte ose dëshmi të reja, të cilat do të paraqisnin bazë të mirë për një vendim të ri.
20. Rrjedhimisht, Gjykata në këtë rast konkret nuk gjeti shkelje të të drejtave të tij, të garantuara me ligj, Kushtetutë të Republikës së Kosovës si dhe me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut nga ana e gjykatave të rregullta, më saktësisht, me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Pzd.nr. 65/2012], të 10 shtatorit 2012.
21. Në bazë të të gjitha fakteve dhe rrethanave që janë paraqitur në kërkesë, Gjykata, më 29 janar 2013, konkludoi se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (3)(e) të Rregullores së punës.

Pretendimet e parashtruesit

22. Parashtruesi në kërkesën e tij pretendon se Gjykata në Aktgjykimin KI 06/12 kishte vlerësuar se ekzistojnë shkelje të natyrave të ndryshme, dhe rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës i rekomandoi Gjykatës Supreme që t'i marrë parasysh të gjitha shkeljet, të cilat në ndonjë nga procedurat e ardhshme, do t'i kishte mënjeluar në mënyrë meritore.
23. Parashtruesi më tej thekson se *“Gjykata Kushtetuese më vonë ka marrë vendim tjetër me të cilin kërkesa e tij ishte refuzuar si e pabazuar, pa arsyetim.”*
24. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata:

„që Gjykata të sqarojë vendimet, respektivisht cili vendim është autentik.“

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

25. *Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet që së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore.*

26. *Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, i cili thekson:*

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë.”

27. *Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe rregullit 36 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës, i cili parasheh:*

*(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: (...)
c) kërkesa është qartazi e bazuar.”*

(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie“ ...

e) Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri.”

28. *Megjithatë, me qëllim të sqarimit të vendimeve, Gjykata rikujton se, në Aktgjykimin KI 06/12, të 9 majit 2012, Gjykata konstatoi se ka shkelje procedurale të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të KEDNJ-së, ndërsa si bazë për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë të parashtruesit të kërkesës, Gjykata gjeti se “i njëjti gjyqtar që kryesonte trupin gjykues në Gjykatën e Qarkut në Prizren, ka marrë pjesë në Trupin gjykues të Gjykatës Supreme me kërkesë për zbutje të dënimit”.*

29. Gjykata gjithashtu shton se Gjykata Supreme, më 10 shtator 2012, në procedurën e përsëritur, mori vendim tjetër [Pzd. nr. 65/2012], në përbërjen e Trupit gjykues, që ishte bazë që kishte shkaktuar shkeljen procedurale të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të KEDNJ-së, të cilat Gjykata i kishte gjetur në Aktgjykimin KI 06/12, të 9 majit 2012.
30. Prandaj, Gjykata vëren se Gjykata Supreme, me Vendimin [Pzd. nr. 65/2012], e ka mënjeluar shkeljen e lartpërmendur procedurale të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të KEDNJ-së.
31. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk është e bazuar dhe ndërtuar në baza kushtetuese dhe duke pasur parasysh që Gjykata paraprakisht ka trajtuar dhe ka nxjerrë vendim lidhur me kërkesën e parashtruesit, si të tillë Gjykata kërkesën e parashtruesit e konsideron si *res judicata*. Prandaj, në pajtim me rregullin 36.1.c, 36.2.a dhe 36.2.e të Rregullores së punës, Kërkesa është qartazi e pabazuar dhe rrjedhimisht e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës; në pajtim me nenin 20 të Ligjit; dhe në pajtim me rregullin 36.1, 36.2 dhe 56.2 të Rregullores së punës, më 5 dhjetor 2013, me shumicë votash:

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KOMUNIKOJË vendimin palëve;
- III. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI110/13, Shaqir Përvetica, Aktvendim i datës 2 dhjetor 2013 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 142/2013, të 14 qershorit 2013

Rasti KI110/13, vendimi i 2 dhjetorit 2013.

Fjalët kyçe: kërkesa individuale, qartazi e pabazuar

Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 47 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009, dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Më 23 korrik 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, ku ka kërkuar nga Gjykata vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Gjykata, gjatë shqyrtimit të rastit, konstatoi që kushtet për pranueshmeri nuk janë plotësuar në këtë kërkesë. Parashtruesi nuk e ka theksuar dhe nuk e ka mbështetur me prova pretendimin se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese. Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës të veprojë si gjykatë e apelit, ose si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale.

Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e kërkesës së paraqitur, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në seancën e mbajtur më 2 dhjetor 2013, vendosi të hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme, sepse faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e justifikojnë kërkesën për shkeljen e të drejtave kushtetuese.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në**

Rastin nr. KI110/13

Parashtrues

Shaqir Përvetica

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës
Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 142/2013, të 14 qershorit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Shaqir Përvetica nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 142/2013, i 14 qershorit 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme të Kosovës (Rev. Nr. 142/2013, i 14 qershorit 2013), që i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 8 korrik 2013, dhe me të cilin kishte përfunduar kontesti ligjor ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe Policisë së Kosovës. Parashtruesi i kërkesës nuk specifikon konkretisht se cilat nene të Kushtetutës janë shkelur.

Baza juridike

4. Kërkesa është bazuar në nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009(në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe

rregullin 56, paragrafi 2, i Rregullores së punës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 23 korrik 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 5 gusht 2013, me Vendimin e Kryetarit (Nr. GJR. KI110/13), gjyqtari Ivan Čukalović u caktua gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, me Vendimin e Kryetarit, Nr. KSH. KI110/13, u caktua Kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 29 gusht 2013, Gjykata Kushtetuese e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme të Kosovës se është iniciuar procedura për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve në lidhje me rastin Nr. KI110/13. Përmes këtij njoftimi, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të paraqesë prova për datën e marrjes së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. Nr. 1411/09, të 13 korrikut 2012.
8. Më 13 shtator 2013, Gjykata Supreme, respektivisht Gjykata Komonale dorëzoi prova (kopjen e fletëdërgesës së Gjykatës) se parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, më 27 gusht 2012.
9. Pas njoftimeve të Gjykatës dërguar parashtruesit të kërkesës më 29 gusht 2013, brenda afatit të paraparë ligjor nuk është dorëzuar asnjë dokument shtesë nga parashtruesi.
10. Më 2 dhjetor 2013, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit Ivan Čukalović, Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi, i paraqiti Gjykatës në përbërje të plotë rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesi i kërkesës ankohet lidhur me një rast ku Policia e Kosovës ia kishte marrë atij armën e gjahut, ndërkaq që nuk përmend datën, përshkrimin e rrethanave, si dhe arsyet që shpjen në marrjen e armës së gjahut.

12. Më 8 shtator 2009, duke vendosur sipas padisë së parashtruesit të kërkesës, Gjykata Komunale në Prishtinë nxori Aktvendimin C. Nr. 1649/07, me të cilin e hodhi poshtë si të paqartë dhe jo të plotë padinë e parashtruesit të kërkesës kundër Policisë së Kosovës lidhur me marrjen e armës së gjahut, me arsyetimin se vetë padia dhe plotësimi i padisë nuk përmbanin objektin e kontestit, bazën ligjore, vlerën e kontestit si dhe kush është i padituri në kontestin gjyqësor.
13. Më 13 korrik 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, duke vendosur sipas ankesës së parashtruesit të kërkesës, nxori Aktvendimin Ac. Nr. 1411/2009, me të cilin e refuzoi kërkesën nga ankesa e parashtruesit si të pabazuar dhe e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 1649/07, të 8 shtatorit 2009, me arsyetimin se:

“Nisur nga një gjendje e tillë e çështjes, kolegji vlerëson se pretendimet ankimore të paditësit se padia është e qartë sepse asaj i është bashkëngjitur urdhëresa për t’ia kthyer armën pronarit, janë të pabazuara dhe si të tilla janë refuzuar, me arsyetim se paditësi me parashtrësën e 7 prillit 2009 nuk e ka bërë përmirësimin e padisë, andaj gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë i ka zbatuar dispozitat e nenit 102.3 të LPK-së, kur e ka hedhur poshtë padinë e paditësit.”

14. Më 14 qershor 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur në lidhje me ankesën e parashtruesit të kërkesës, nxori Aktvendimin Rev. Nr. 142/2013, me të cilin e hodhi poshtë revizionin e parashtruesit të kërkesës, me arsyetim se ai është i paafatshëm, sepse:

“Nga fletëdorëzimi për pranimin e aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë është konstatuar se paditësi, Aktvendimin nr. 1411/2009 të 13 korrikut 2012, e ka pranuar më 27 gusht 2012, ndërsa revizionin (ankesën) e ka paraqitur më 5 tetor 2012”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi i kërkesës konsideron se “Gjykata Supreme ka bërë gabim në llogaritjen e afatit, sepse unë e kam pranuar Vendimin AC. NR. 1411/09, të 13 korrikut 2012 më 8 shtator 2012, e jo më 27 gusht 2012. Për ta vërtetuar këtë, paraqes fletëlëshimin, me të cilin vërtetohet se më 27 gusht 2012 kam qenë i shtrirë në spital.”

16. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon: “Ankesa ime (mendon në revizionin – vër. e përkth.) nuk u mor parasysh sepse nuk ishte caktuar vlera e padisë, duke menduar se vlera do të caktohet në njërën nga seancat, por, gjatë këtyre 9 viteve, gjykata nuk më ftoi asnjëherë që të marrë një deklaratë nga unë”.
17. Parashtruesi i kërkesës kërkon gjithashtu nga Gjykata Kushtetuese “që ta detyrojë Policinë e Kosovës që ta kompensojë dëmin, dhe atë:

*Të më kthehet arma ose të më kompensohet dëmi
Specifikimi i vlerës*

1. Padia-	80 €
2. Arma-	650
3. Certifikata e mjekut-	30
4. Leja për armë-	40
5. Certifikata për trajnim në gjueti-	300
6. Ankesa - 2001-	80
7. Padia -II- 2007-	80
8. Ankesa - 18 nëntor 2009-	80
9. Taksa gjyqësore - 3 tetor 2012-	31
10. Ankesa - 3 tetor 2012-	80
11. Taksa gjyqësore - 5 nëntor 2012-	31
12. Ankesa - 23 korrik 2013-	80
13. Taksa - 22 korrik 2013-	31
Gjithsej	1.593
Kamata në vit	2.867,4
	4.460,40”

Vlerësimi pranueshmërisë së kërkesës

18. Për të qenë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe me Rregullore të punës.
19. Në rastin konkret, Gjykata duhet të përcaktojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet nga neni 113 (1) i Kushtetutës, neni 49 i Ligjit, si dhe rregulli 36 (1) b) i Rregullores së punës.
20. Gjykata i referohet nenit 113. 7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të

garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

21. Parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj.
22. Neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës parasheh:

„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

23. Përveç kësaj, rregulli 36 (2) i Rregullores parasheh se:

“(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

(d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

24. Siç mund të shihet më lart, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme ka gabuar në llogaritjen e afatit dhe e ka hedhur poshtë ankesën (revizionin) e tij si të paafatshme.
25. Megjithatë, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar si dhe pse i është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, si dhe nuk i ka mbështetur pretendimet e tij për këto shkelje.
26. Në anën tjetër, Gjykata vëren se nga paragrafi 8 i këtij aktvendimi mund të konstatohet qartë se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për llogaritje të gabueshme të afateve nuk janë të sakta, pasi që nga provat e dorëzuara nga Gjykata Supreme e Kosovës, respektivisht nga Gjykata Komunale në Prishtinë, më 13 shtator 2013 (kopja e fletëdorëzimit të Gjykatës), mund të përcaktohet në mënyrë të pakontestueshme se parashtruesi i kërkesës e ka pranuar aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, më 27 gusht 2012, ashtu që me veprimet e autoriteteve publike nuk i është shkelur asnjë e drejtë e garantuar me Kushtetutë.
27. Fakti i thjeshtë se parashtruesi është i pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të Kushtetutës ose të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut,

(Shih, Memetoviq kundër Gjykatës Supreme të Kosovës, KI50/ 10, 21 mars 2011; shih, *mutatis mutandis*, Meztur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, GJEDNJ, Kërkesa nr. 5503/ 02, e 26 korrikut 2005).

28. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës të veprojë si gjykatë e apelit, ose si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, Avdyli kundër Gjykatës Supreme të Kosovës, KI13/09, 18 qershor 2010; shih *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës, [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut 1999-1).
29. Gjykata Kushtetuese mund vetëm të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në atë mënyrë, që procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë ashtu që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, *inter alia*, Komisioni Evropian për të Drejta të Njeriut, Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr. 13071/87, 10 korrik 1991).
30. Në rastin e tanishëm, parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta të paraqesë rastin e tij dhe të kontestojë interpretimin e fakteve dhe të ligjit, për të cilin e konsideron se është i pasaktë, në Gjykatën Komunale dhe të Qarkut në Prishtinë dhe, në Gjykatën Supreme të Kosovës. Interpretimi i afatit ligjor për ushtrimin e ankesës (revizionit) kundër Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut është çështje që duhet përcaktuar nga Gjykata Supreme dhe është jashtë fushëveprimit të vlerësimit kushtetues të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm nga ana e Gjykatës.
31. Gjykata Kushtetuese gjen se procedurat përkatëse ishin të drejta dhe nuk ishin arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituaniës, Vendim i GJEDNJ-së Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009). Përveç kësaj, nuk është konstatuar asgjë në kërkesë që do të tregonte se Gjykatës Supreme të Kosovës i ka munguar paanshmëria apo që procedura ishte e padrejtë.
32. Përfundimisht, kushtet për pranueshmëri nuk janë plotësuar në këtë kërkesë. Parashtruesi nuk e ka theksuar dhe nuk e ka mbështetur me prova pretendimin se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese.
33. Prandaj, Gjykata Kushtetuese gjen se pretendimet e parashtruesit nuk janë dëshmuar dhe duhet të refuzohen si të papabazuara.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 48 të Ligjit, dhe rregullit 36 (2) d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 2 dhjetor 2013, njëzëri

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI153/13, Adem Dushi, Aktvendim i datës 20 nëntor 2013 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së vendimit të Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Rasti KI153/13, vendimi i 20 nëntorit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kërkesë e jasht afatshme

Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Më 29 shtator 2013, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në të cilën kërkoi nga Gjykata vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i përmendur i shkel të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenin 21 dhe 22 të Kushtetutës së Kosovës.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Gjykata vërejtí se parashtruesi i kishte humbur afatet e përcaktuara me Ligjin dhe Rregulloren e punës.

Në këtë kuptim, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit është e paafatshme.

Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e kërkesës së parashtruar, Gjykata Kushtetuese e Kosovës e hodhi poshtë kërkesën si të papranueshme për shqyrtim.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në**

Rastin nr. KI153/13

Parashtrues

Adem Dushi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimit të Trupit gjykues të
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për
çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
SCEL-09-001, të 10 janarit 2010**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Adem Dushi nga fshati Lupç i Epërm, komuna e Podujevës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Vendimin e Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme), SCEL-09-001, të 10 janarit 2010, i cili i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 13 korrik 2010.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit, me të cilin pretendohet se ia pamundëson parashtruesit të realizojë të drejtën për pjesëmarrje në 20%, të të ardhurave nga privatizimi i Ndërmarrjes Shoqërore “Ramiz Sadiku” (në tekstin e mëtejme: NSH “Ramiz Sadiku”), në Prishtinë.

Baza juridike

4. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009,(në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 29 shtator 2013, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 30 shtator 2013, Kryetari me Vendimin GJR. Nr. KI153/13 e caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. Nr. 153/13, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.
7. Më 9 tetor 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme në lidhje me regjistrimin e kërkesës.
8. Më 20 nëntor 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmëri.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi i kërkesës ishte në marrëdhënie pune në NSH “Ramiz Sadiku” prej 11 majit 1979 deri më 28 shkurt 1990.
10. Më 27 qershor 2006, NSH “Ramiz Sadiku” e kishte përfunduar procesin e privatizimit.
11. Më 23 shkurt 2009, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme kundër listës përfundimtare të punëtorëve, të hartuar nga Agjencia e Privatizimit, sepse ai, si punëtor i mëparshëm, nuk ishte në atë listë.
12. Në ankesën e ushtruar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, parashtruesi i ankesës kishte theksuar se ai kishte themeluar

marrëdhënie pune me NSH “Ramiz Sadiku” prej 11 majit 1979 e deri më 28 shkurt 1990, dhe se ai më 1999 ishte paraqitur te menaxhmenti i ndërmarrjes me kërkesë që t’i mundësohet kthimi në vendin e punës, të cilin e kishte pasur në bazë të kontratës së 11 majit 1979.

13. Gjatë dëgjimit, Trupi gjykues, në bazë të letërnjoftimit personal të parashtruesit të kërkesës, përcaktoi se ai kishte lindur më 15 shkurt 1941, respektivisht se më 15 shkurt 2006 ai i kishte mbushur 65 vjet dhe me këtë e ka fituar të drejtën e pensionit në bazë të moshës.
14. Më 10 janar 2010, Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme nxori vendimin SCEL-09-001, me të cilin e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të papranueshme.
15. Në arsyetimin e vendimit të vet, Trupi gjykues theksoi: “... gjatë seancës dhe paraqitjes së provave përcaktoi se parashtruesi në momentin e privatizimit të NSH “Ramiz Sadiku” ka qenë më i vjetër se 65 vjeç. Sipas kësaj, Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme konsideron se ankesa e parashtruesit nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (shih paragrafin 15)”.

Ligji relevant

16. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/13, e 9 majit 2003, MBI TRANSFORMIMIN E SË DREJTËS PËR PËRDORIMIN E PRONËS SË PATUNDSHME NË PRONËSI SHOQËRORE

Neni 10.4 (Të drejtat e të punësuarve)

„Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri (3) vjet. Kjo kërkesë nuk i ndalon punëtorët, të cilët pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar, nëse nuk do të kishin qenë diskriminuar, që të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i lartpërmendur i shkel të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenin 21 dhe 22 të Kushtetutës së Kosovës.

18. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me kërkesë:

„Që edhe ai dëshiron që atij t'i takojë 20% nga privatizimi, në të cilin ai ka të drejtë sipas ligjit në fuqi“.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

19. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, para së gjithash Gjykata duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë së kërkesës, të parapara me Kushtetutë dhe më tej të precizuara në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës.

20. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se neni 113. 7 i Kushtetutës parasheh:

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

21. Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit ku thuhet:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.

22. Megjithatë, Gjykata gjithashtu merr parasysh edhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës që parashikon:

“(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

...

b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi”.

23. Në bazë të dokumenteve të bashkëngjitura Gjykata konstaton se parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën në Gjykatë më 29 shtator 2013, ndërsa vendimi i fundit i Trupit Gjykues të Dhomës së

Posaçme atij i është dorëzuar më 13 korrik 2010, që do të thotë pas kalimit të afatit ligjor të paraparë me nenin 49 të Ligjit, dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.

24. Nga kjo rezulton që kërkesa e parashtruesit është e paafatshme.
25. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të hedhet poshtë si e papranueshme për shqyrtim në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, në mbështetje të nenit 20 të Ligjit dhe në mbështetje të rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës, më 20 nëntor 2013, njëzëri

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI65/13, Rasim Hoxha dhe Remzije Hoxha-Prelvukaj, Aktvendim i datës 18 nëntor 2013 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. 291/2009, të 4 shtatorit 2012

Rasti KI65/13, vendimi i 18 nëntorit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, e drejta e pronës, qartazi e pabazuar

Parashtruesi e parashtroi kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 dhe rregullit 56 paragrafi 2 të Rregullores së punës.

Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar që pretendohet “se është i padrejtë dhe kundër kushtetues sepse me refuzimin si të pabazuar të revizionit të parashtruesve të drejtat e tyre për proces të rregullt dhe në pronë janë cenuar”.

Në këtë drejtim, parashtruesit pretendojnë se neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës janë cenuar.

Përfundimisht, parashtruesit kërkojnë nga Gjykata që të vlerësojë ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e vendimeve të gjykatave të rregullta dhe që atyre t’iu kthehet e drejta në pronë që pretendohet se iu është mohuar nga gjykatat e rregullta në mënyrë arbitrare.

Duke shqyrtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. 291/2009, të 4 shtatorit 2012, Gjykata Kushtetuese konstatoi se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtave kushtetuese dhe se parashtruesi i kërkesës nuk i ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij dhe rrjedhimisht, kërkesa e tij është qartazi e pabazuar.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI65/13
Parashtrues
Rasim Hoxha dhe Remzije Hoxha-Prelvukaj
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. 291/2009, të 4
shtatorit 2012**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesit e kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Rasim Hoxha dhe znj. Remzije Hoxha-Prelvukaj (në tekstin e mëtejme: parashtruesit), të përfaqësuar nga z. Gani Asllani, avokat nga Prishtina.

Vendimet e kontestuara

2. Parashtruesit kontestojnë Aktgjykimin Rev. 291/2009, të 4 shtatorit 2012, të Gjykatës Supreme të Kosovës, që iu është dorëzuar atyre më 28 dhjetor 2012.

Baza juridike

3. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009, (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjeje është vlerësimi kushtetues i vendimit të kontestuar që pretendohet *“se është i padrejtë dhe kundër kushtetues sepse me refuzimin si të pabazuar të revizionit të parashtruesve të drejtat e tyre për proces të rregullt dhe në pronë janë cenuar”*.
5. Në këtë drejtim, parashtruesit pretendojnë se neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës], të Kushtetutës janë cenuar.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 29 prill 2013, parashtruesit dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 29 prill 2013, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI65/13, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën datë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI65/13, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Ivan Čukalović (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani.
8. Më 26 qershor 2013, parashtruesit u njoftuan për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën datë, kërkesa iu komunikua Gjykatës Supreme të Kosovës.
9. Më 3 korrik 2013, Gjykata kërkoi nga parashtruesit dhe Gjykata Themelore në Pejë që të dorëzojnë dokumente shtesë.
10. Më 19 korrik 2013, Gjykata Themelore në Pejë – Dega në Istog dhe parashtruesit u përgjigjën.
11. Më 18 nëntor 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

12. Më 27 maj 2002, Gjykata Komunale në Istog, me Aktgjykimin C. nr. 133/01, vërtetoi se parashtruesi Rasim Hoxha është pronar i shtëpisë së kontestuar dhe shfrytëzues i ngastrës mbi të cilën është ngritur shtëpia dhe detyroi të paditurin G. M. që paluajtshmërinë

në fjalë t'ia lirojë parashtruesit. Gjykata Komunale në Istog refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtrueses Remzije Hoxha-Prelvukaj, për njohje të bashkëpronësisë në paluajtshshmërinë e kontestuar.

13. Më 7 nëntor 2002, Gjykata e Qarkut në Pejë, me Aktvendimin Ac. nr. 163/02, prishi Aktgjykimin C. nr. 133/01, të 27 majit 2002, të Gjykatës Komunale në Istog dhe lëndën e ktheu për rigjykim.
14. Më 23 korrik 2004, Gjykata Komunale në Istog, me Aktgjykimin C. nr. 9/03, refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesve për të vërtetuar se janë bashkëpronarë të paluajtshmërisë (truallit dhe shtëpisë) së kontestuar dhe vërtetoi se kundërpaditësi G. M. është pronar i paluajtshmërisë së kontestuar në bazë të shitblerjes, mbajtjes dhe ndërtimit.
15. Më 20 tetor 2004, Gjykata e Qarkut në Pejë, me Aktvendimin Ac. nr. 283/2004, prishi Aktgjykimin C. nr. 9/03, të 23 korrikut 2004, të Gjykatës Komunale në Istog dhe lëndën e ktheu për rigjykim.
16. Më 28 prill 2005, Gjykata Komunale në Istog, me Aktgjykimin C. nr. 1794/04, refuzoi si të pabazë kërkesëpadinë e parashtruesve për të vërtetuar se janë bashkëpronarë të paluajtshmërisë së kontestuar dhe vërtetoi se kundërpaditësi G. M. është pronar i paluajtshmërisë së kontestuar.
17. Më 11 janar 2006, Gjykata e Qarkut në Pejë, me Aktvendimin Ac. nr. 219/05, prishi Aktgjykimin C. nr. 1794/04, të 28 prillit 2005, të Gjykatës Komunale në Istog dhe lëndën e ktheu për rigjykim.
18. Më 6 nëntor 2007, Gjykata Komunale në Istog, me Aktgjykimin C. nr. 10/06, refuzoi si të pabazë kërkesëpadinë e parashtruesve për të vërtetuar se janë bashkëpronarë të paluajtshmërisë së kontestuar dhe vërtetoi se kundërpaditësi G. M. është pronar i paluajtshmërisë së kontestuar.
19. Më 19 shkurt 2009, Gjykata e Qarkut në Pejë, me Aktgjykimin Ac. nr. 13/08, refuzoi si të pabazuara ankesat e parashtruesve dhe vërtetoi Aktgjykimin C. nr. 10/06, të 6 nëntorit 2007, të Gjykatës Komunale në Istog.
20. Më 4 shtator 2012, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Rev. nr. 291/2009, refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesve dhe vërtetoi Aktgjykimin Ac. nr. 13/2008, të 19 shkurtit 2009, të Gjykatës së Qarkut në Pejë.

21. Me Aktgjykimin Rev. nr. 291/2009, të 4 shtatorit 2009, Gjykata Supreme ndër të tjera arsyetoi:

“... nga shkresat e lëndës del se paditësit-kundërpaditurit (parashtruesit) janë vëlla e motër, ndërsa të paditurit kundërpaditësin G. M. e kanë dhëndër. Se paditësi-kundërpadituri Rasim (parashtruesi) është pronar i ngastrës 5/1, në të cilën të drejtën e pronësisë e ka fituar në bazë të kontratës mbi ndarjen e truallit familjar, të vërtetuar pranë Gjykatës Komunale në Gjurakovc, V. nr. 467/72, të 6 shtatorit 1972. Në bazë të kësaj kontrate, paditësit-kundërpaditurit (parashtruesit) Rasim i është lëshuar tapia. Në bazë të lejes së ndërtimit të lëshuar nga organi kompetent komunal, paditësi-kundërpadituri i parë (parashtruesi) Rasim ka filluar të ndërtojë objektin familjar me paditësen-kundërpaditurën e dytë (parashtruesja) Remzije, në bazë të kontratës mbi ndërtimin e përbashkët. Megenëse paditësi-kundërpadituri (parashtruesi) Rasim kishte vendosur të jetojë në Prishtinë dhe të blejë shtëpi në Prishtinë, është arritur marrëveshja mes tij dhe të paditurit kundërpaditësit G. M., që ky ta shesë shtëpinë e tij në Banjë të Pejës dhe çmimin shitës t’ia dorëzojë paditësit-kundërpaditësit (parashtruesit) Rasim. I padituri kundërpaditësi G. M. në vitin 1979 e shet shtëpinë e tij në Banjë të Pejës personit S. Z. për shumën e atëhershme prej 120 milionë dinarë dhe sipas marrëveshjes, këtë shumë ia ka dorëzuar paditësit-kundërpaditurit (parashtruesit) Rasim. Në bazë të kësaj marrëveshjeje, paditësi-kundërpadituri (parashtruesi) Rasim ka qenë i obliguar që të paditurit-kundërpaditësit G. M. t’ia ndërtojë ose t’ia blejë një shtëpi në Banjë të Pejës, në Prishtinë ose në Gjakovë dhe atë në afat prej 5-6 vitesh. Paditësi-kundërpadituri (parashtruesi) ka vendosur që i padituri-kundërpaditësi G. M. të banojë në shtëpinë kontestuese. Këto fakte ishin jokontestuese në mes të ndërgjyqësve.

Paditësi-kundërpadituri (parashtruesi) Rasim megenëse nuk ka përmbushur obligimin nga marrëveshja që të paditurit-kundërpaditësit G. M. t’ia ndërtojë apo t’ia blejë një shtëpi në Banjë të Pejës, në Prishtinë ose në Gjakovë, i njëjti në shtëpinë kontestuese ka investuar me qëllim që të njëjtën ta përshtatë për banim duke instaluar ujin, sanitarinë, rrymën dhe ndërtimet e tjera me mjetet e tij dhe është vendosur në shtëpinë kontestuese në vitin 1980. Megenëse paditësi-kundërpadituri (parashtruesi) nuk e ka përmbushur marrëveshjen e arritur më parë, i njëjti bashkëshortes së të paditurit-kundërpaditësit

G. M. që e ka motër dhe nipave të tij, në vitin 1986, ia bën për hajër shtëpinë në fjalë...

I padituri-kundërpaditësi G. M. ka bërë investime në shtëpinë kontestuese, duke konsideruar se këtë e bën në shtëpinë e tij, ndërsa paditësi-kundërpadituri (parashtruesi) për këto investime të paditurit-kundërpaditësit G. M. nuk ka kundërshtuar. Ka pasur më vonë tentime që të arrihet një marrëveshje në mes të ndërgjyqësve lidhur me shtëpinë kontestuese, por kanë qenë të pasuksesshme...

Duke u nisur nga gjendja e tillë faktike, gjykata e revizionit gjen se është i drejtë përfundimi i gjykatës së shkallës së dytë se i padituri-kundërpaditësi G. M. ka fituar të drejtën e pronësisë në bazë të nenit 24 par. 1 të LTHMPJ-së, pasi që si ndërtues i ndërgjegjshëm kishte dijeni se ndërton në objektin e vet. Me investimet e bëra nga ana e paditurit-kundërpaditësit G. M., në objektin e ndërtuar fitohet e drejta e pronësisë në qoftë se ndërtuesi i ndërgjegjshëm ka bërë investime të konsiderueshme, ndërsa pronari i paluajtshmërisë ka ditur për investime dhe se nuk ka kundërshtuar në kuptim të nenit 24 par. 1 të LTHMPJ-së. Duke u nisur nga gjendja e vërtetuar faktike nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se i padituri-kundërpaditësi G. M. në shtëpinë kontestuese është vendosur në vitin 1980 në bazë të marrëveshjes paraprake me paditësin-kundërpaditurin (parashtruesin) dhe se prej vendosjes në këtë shtëpi, i padituri-kundërpaditësi G. M. ka bërë investime të konsiderueshme e që sipas raportit të ekspertit të ndërtimtarisë, këto investime kapin shumën prej 81.822,95 €...

I padituri-kundërpaditësi G. M. ka qenë i ndërgjegjshëm se ndërton në shtëpinë e tij, pasi që sipas marrëveshjes me paditësin-kundërpaditurin (parashtruesin) në vitin 1980, në shtëpinë kontestuese dhe ka bërë investime duke e sjellë objektin në gjendje të tanishme, ndërsa paditësi-kundërpadituri (parashtruesi) deri në paraqitjen e padisë as që ka kundërshtuar..."

Pretendimet e parashtruesve

22. Parashtruesit pretendojnë se gjykatat e rregullta nuk kanë nxjerrë vendime të drejta dhe të paanshme duke i shkelur dispozitat ligjore, kushtetuese dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

23. Parashtruesit pretendojnë se atyre iu është shkelur e drejta në pronë, e garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenin 1 [Mbrojtja e Pronës] të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së. Parashtruesit po ashtu pretendojnë se është shkelur neni 36 i Ligjit Nr. 03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore.
24. Parashtruesit pretendojnë se janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës paragrafët 1 dhe 3 sepse ata: *“... kanë kundërshtuar vlerësimin e shtëpisë sipas ekspertizës së ekspertit, të cilin e ka caktuar gjykata, me qëllim që të bëhet ekspertiza nga ana e ekspertëve të ndërtimtarisë nga Fakulteti i Ndërtimtarisë në Prishtinë, ose të bëhet superekspertizë, kjo e drejtë është mohuar nga gjykata në mënyrë kategorike, duke mos e futur kërkesën tonë as në procesverbalet e gjykatës...”*.
25. Përfundimisht, parashtruesit kërkojnë nga Gjykata që të vlerësojë ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e vendimeve të gjykatave të rregullta dhe që atyre t’iu kthehet e drejta në pronë që pretendohet se iu është mohuar nga gjykatat e rregullta në mënyrë arbitrare.

Vlerësim i pranueshmërisë së kërkesës

26. Gjykata vëren se, për të qenë në gjendje për të gjykuar kërkesën e parashtruesve, së pari është e nevojshme të shqyrtojë nëse janë përmbushur të gjitha kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
27. Përkitazi me kërkesën e parashtruesve, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

28. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesit i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike siç përcaktohet në nenin 113.7 të Kushtetutës.
29. Gjykata po ashtu i referohet nenit 49 të Ligjit, që përcakton:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të llogaritet që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati

fillon të llogaritet në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të llogaritet që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.

30. Gjykata merr parasysh rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, që përcakton:

“Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

[...]

b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi...”.

31. Në këtë drejtim, Gjykata po ashtu i referohet rregullit 27 (6) të Rregullores së punës, që përcakton:

“Periudha kohore e përcaktuar në Kushtetutë, në ligj dhe në këtë Rregullore të punës llogaritet si më poshtë:

[...]

(4) Kur periudha shprehet në muaj dhe në ditë, së pari llogariten muajt e plotë e pastaj ditët;

(5) Periudhat përfshijnë të shtunat, të dielat dhe festat zyrtare;

(6) Ndryshe, nëse periudha përfundon të shtunën, të dielën ose në ndonjë festë zyrtare, ajo do të vazhdojë deri në fund të ditës së parë të punës që vjen pas saj”.

32. Gjykata vëren se kërkesa është dorëzuar më 29 prill 2013, kurse Aktgjykimi i Gjykatës Supreme iu është dorëzuar parashtruesve më 28 dhjetor 2012.

33. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesit nuk kanë mundur ta dorëzojnë kërkesën më 28 prill 2013, sepse ka qenë ditë e diel, dhe sipas rregullit 27 (6) të Rregullores së punës, në raste të tilla, kërkesa duhet të dorëzohet në ditën e parë të punës që vjen pas ditës së diel, gjë që parashtruesit e kanë bërë.

34. Rezulton se kërkesa është e afatshme, sepse është dorëzuar në Gjykatë brenda afatit katër (4) mujor të përcaktuar me Ligj dhe Rregullore të punës.
35. Përkitazi me pretendimet e ngritura në kërkesë, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, që përcakton:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

[...]

c) kërkesa është qartazi e bazuar”.

36. Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk kanë ofruar ndonjë provë *prima facie* që do të tregonte se procedurat e zhvilluara në gjykatat e rregullta kanë qenë të njëanshme apo të karakterizuara nga arbitrariteti; dhe për më tepër, pretendimet e parashtruesve të kërkesës ngrenë çështje të fakteve dhe të ligjit, çka përbën juridiksion të plotë të gjykatave të rregullta.
37. Gjykata Kushtetuese rithekson se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve. Gjykata Kushtetuese dëshiron të theksojë se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta dhe se roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (shih rastin Akdivar kundër Turqisë, Nr. 2189/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65 dhe po ashtu shih rastin KI-86/11, parashtrues i kërkesës Milaim Berisha, Aktvendimi për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).
38. Përveç kësaj, kërkesa nuk tregon që gjykatat e rregullta kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese ta zëvendësojë vlerësimin e vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta dhe, si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave që t’i vlerësojnë provat e vëna në dispozicion të tyre. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta ishin të drejta në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave (Shih rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).
39. Fakti që parashtruesit nuk pajtohen me rezultatin e rastit, nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës (Shih rastin Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

40. Në këto rrethana, parashtuesit nuk e kanë mbështetur me prova pretendimin e tyre për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, sepse faktet e paraqitura nga ata nuk tregojnë në asnjë mënyrë që gjykatat e rregullta ua kanë mohuar atyre të drejtat e garantuara me Kushtetutë.
41. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të hidhet poshtë si e papranueshme në përputhje me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit, dhe rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, më 18 nëntor 2013, njëzëri

VENDOS

- I. TA REFUZOJË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI96/13, Branko Radec, Aktvendim i datës 3 shkurt 2014 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Vendimit, PZ. nr. 169/12, të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, të 21 janarit 2013

Rasti KI96/13, vendimi i 3 shkurt 2014

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, qartazi e pabazuar

Parashtruesi i kërkesës, Branko Radec, parashtroi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke kontestuar Vendimin, PZ. nr. 169/12, të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, të 21 janarit 2013, pasi që është marrë në shkelje të Kushtetutës për shkak se "veprimete gjykatave të Republikës së Kosovës kanë shkelur të drejtat [e tij] për të gëzuar pronën [e tij] personale dhe të drejtën për siguri, sepse ekziston dualitet ndërmjet vendimeve gjyqësore dhe administrative". Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës pretendon se "shteti ka marrë përgjegjësinë për mbrojtjen e pronës së të gjithë qytetarëve të tij dhe njëherësh është pasardhës juridik i institucioneve ndërkombëtare në Kosovë dhe juridikisht është e pamundshme situatë që askush nuk është përgjegjës për dëmin që i është shkaktuar [atij] në trazirat e vitit 2004."

Përkitazi me çështjen e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata konstatoi se kërkesa ishte e papranueshme, sepse parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar dëshmi se procedurat përkatëse kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare. Prandaj, Gjykata konstatoi se kërkesa ishte qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36(1) c) të Rregullores së punës.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në**

Rastin Nr. KI96/13

Parashtrues

Branko Radeč

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit PZH. nr. 169/12, të
Gjykatës së Apelit në Prishtinë, të 21 janarit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Branko Radeč (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi), me vendbanim në Beograd, Serbi.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Vendimin PZH. nr. 169/12, e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, të 21 janarit 2013, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 5 mars 2013.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit PZH. nr. 169/12, të Gjykatës së Apelit, i cili pretendohet të ketë shkelur nenin 3 [Barazia para Ligjit], 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 46 [Mbrojtja e Pronës], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme] dhe 156 [Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur

Brenda Vendit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) dhe nenin 6 [E Drejta për Proces të Rregullt], 8 [E Drejta për Respektimin e Jetës Private dhe Familjare], 13 [E Drejta për Zgjidhje Efektive], dhe 14 [Ndalimi i Diskriminimit] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ). Përveç kësaj, parashtuesi më tej pretendon se gjithashtu janë shkelur neni 1 i Protokollit 1 [Zbatimi i disa të drejtave dhe lirive që nuk janë përfshirë në nenin 1 të Konventës] dhe Protokollin 12 [Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit] të KEDNJ-së.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 56. 2 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 5 korrik 2013, parashtuesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 5 gusht 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 5 shtator 2013, parashtuesi u informua për regjistrimin e kërkesës dhe atij iu kërkuar të dorëzojë dokumentet vijuese në Gjykatë:
 - a. Vendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, PZH. nr. 169/12, të 21 janarit 2013;
 - b. Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Vushtrri, të 15 tetorit 2010;
 - c. Padia për kompensim të dëmit në Gjykatën Komunale në Vushtrri; dhe
 - d. Ankesën ndaj Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Vushtrri.

8. Më 14 tetor 2013, Gjykata pranoi dokumentet e kërkuara nga parashtruesi i kërkesës.
9. Më 21 tetor 2013, Gjykata e informoi Gjykatën e Apelit në Prishtinë, për regjistrimin e kërkesës.
10. Më 2 dhjetor 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i propozoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 25 maj 2004, parashtruesi i kërkesës paraqiti padinë në Gjykatën Komunale në Vushtrri kundër Komunës së Vushtrrisë, Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë dhe Qeverisë së Kosovës duke kërkuar kompensim për pronën e dëmtuar. Në ankesë, parashtruesi pretendoi se *“pas arritjes së KFOR-it në Kosovë, ndërtesat që gjenden në ngastrën e përmendur ishin shkatërruar plotësisht dhe prona e paluajtshme ishte vjedhur dhe shkatërruar, pemishtja, plantacioni me akacie dhe pylli ishin prerë dhe toka bujqësore ishte përdorur nga persona të paautorizuar”*.
12. Më 15 tetor 2010, Gjykata Komunale në Vushtrri (P. nr. 303/2004) nxori vendimin për padinë e parashtruesit të kërkesës. Në vendim, Gjykata përcaktoi se padia e parashtruesit ishte tërhequr për shkak se i njëjti nuk e ka paguar taksën e detyrueshme për paraqitjen e padive. Gjykata Komunale konstatoi se: *“Një vërejtje i është dorëzuar paditësit lidhur me pagesën e taksës gjyqësore për padi, përmes tabelës së njoftimeve të gjykatës më 29 shtator 2010, por deri më tani i njëjti nuk e ka paguar taksën për padi, në pajtim me nenin 3 pika 1 dhe nenin 10 pika 1 të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së. Prandaj, Gjykata në pajtim me nenin 253, pika 5 të LPK-së [Ligji i procedurës kontestimore] vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi”*.
13. Më 21 janar 2013, Gjykata e Apelit në Prishtinë (PZH. nr. 169/12) e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe e vërtetoi vendimin e Gjykatës Komunale në Vushtrri (P. nr. 303/2004, të 15 tetorit 2010). Gjykata e Apelit konstatoi se: *“Gjykata [Gjykata Komunale në Vushtrri] u ka dërguar paditësve vërejtje për pagesë të taksës për padi nëpërmjet tabelës së shpalljeve të gjykatës, më 29 shtator 2010, por ata nuk e kanë paguar taksën për padi, e cila është e përcaktuar me nenin 3 pikën 1 dhe 10 të Udhëzimit Administrativ, prandaj gjykata e shkallës së*

parë, në pajtim me nenin 253 pika 5 të LPK-së [Ligji i procedurës kontestimore], ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të kontestuar...Kjo gjykatë konsideron se nuk qëndrojnë pohimet ankimore të paditësve, për shkak të faktit se gjykata e shkallës së parë ka ndërmarrë disa veprime ndaj paditësve me qëllim që ata t'i paguajnë taksat gjyqësore për padi. Lëshimet lidhur me urdhrin e pagesës së taksës gjyqësore të 27 janarit 2010, i janë dërguar me shkresë Ministrisë së Drejtësisë, Zyrës për Bashkëpunim Ndërkombëtar, më 3 shkurt 2010, Aktvendimin e 29 shtatorit 2010 etj, por paditësit nuk i kanë paguar taksat gjyqësore për padi, ndërsa në bazë të dispozitave të nenit 253.4 të LPK-së, është paraparë që paditësi ia bashkëngjet padisë vërtetimin për pagesën e taksës gjyqësore, ndërsa me nenin 253.5, parashihet se nëse nuk paguhet taksa e caktuar gjyqësore për padi, edhe pas vërejtjes së dërguar nga ana e gjykatës dhe nëse nuk janë përfitues të lirimit nga taksa, konsiderohet se padia është tërhequr dhe për sa i përket kësaj, duhet theksuar se paditësi lidhur me propozimin për lirim nuk ka ofruar asnjë provë, do të thotë as vërtetimin për gjendjen financiare të lëshuar nga organi kompetent, por edhe me dispozitat përkatëse të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/2, për njëjtësim të taksave gjyqësore (shih nenin 5.6 të udhëzimit të lartpërmendur)”.

Pretendimet e parashtruesit

14. Parashtruesi pretendon se “veprimi i gjykatave të Republikës së Kosovës ka shkaktuar shkeljen e të drejtave (të tij) për shfrytëzimin e pronës (së tij) personale dhe të drejtën për siguri sepse ekziston dualitet ndërmjet vendimeve gjyqësore dhe administrative”. Përveç kësaj, parashtruesi pretendon se “shteti ka marrë përgjegjësinë për mbrojtjen e pronës së të gjithë qytetarëve të tij dhe njëherësh është edhe pasardhës juridik i institucioneve ndërkombëtare në Kosovë dhe juridikisht është e pamundshme situata që askush nuk është përgjegjës për dëmin që më është shkaktuar në trazirat e vitit 2004”.
15. Parashtruesi më tej pretendon se janë shkelur nenet e Kushtetutës si në vijim:
 - a. Neni 3 [Barazia para Ligjit], duke argumentuar se “pjesëtarët e popullit serb nuk trajtohen njësoj si qytetarët e tjerë të Kosovës”.

- b. Neni 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare], duke argumentuar se në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është shkelur e drejta e tij për shfrytëzimin e pronës sepse ajo është shkatërruar për më shumë se 10 vjet, dhe ai nuk është në gjendje të *“realizojë të drejtën [e tij] për kompensim të drejtë”*.
- c. Neni 24 [Barazia para Ligjit], duke argumentuar se *“mbi bazën e njëjtë faktike dhe juridike, e njëjta gjykatë, njërin e vendos, ndërsa tjetrin e refuzon për shkak të mospagesës së taksës gjyqësore, të cilën pala nuk ka mundësi as faktike dhe as formale që ta paguajë”*.
- d. Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], duke pretenduar se për shkak se neni 24 është shkelur, është shkelur edhe neni 31 *“duke pasur parasysh se dy aktgjykime të së njëjtës gjykatë, për të njëjtën çështje janë në kundërshtim me njëra-tjetrën”*.
- e. Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike], duke theksuar se shkresat që ai i dorëzoi *“vërtetojnë se procedurat e zhvilluara për kompensim të dëmit material në bazë të shkatërrimit të paluajtshmërive me aktet terroriste janë ndërprerë në mënyrë selektive - vetëm për pjesëtarët e nacionalitetit serb”*.
- f. Neni 46 [Mbrojtja e Pronës], duke argumentuar se duke mos marrë kompensim nga organet kompetente që nga viti 2004, ai ka pësuar dëm material, për të cilën parashtruesi pretendon se është shkelje e të drejtave të tij kushtetuese.
- g. Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], duke pretenduar se ai *“ka qenë i diskriminuar nga gjykatat, për shkak se procedura është pezulluar për shkak të mospagesës së taksës gjyqësore kjo gjë e dëmtoi qasjen time në gjykatë gjë që edhe sipas praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, paraqet shkelje të Konventës”*.
- h. Neni 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme].

- i. Neni 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], duke pretenduar se rastet e ngjashme me të tijn, kur është fjala për qytetarë të nacionalitetit serb, është çështje se nëse *“pushteti gjyqësor nuk është i pavarur, i paanshëm dhe apolitik, kkur është fjala për qytetarët e nacionalitetit serb, paraqiten një varg çështjesh specifike në kontekst të Kosovës- nuk është gjithnjë e qartë se kush janë bartësit e obligimeve, edhe pse është e qartë se janë persona të zhvendosur brenda vendit, të ndjekur nga shtëpitë e tyre, të cilat u janë shkatërruar më vonë, ndërsa kur duhet të identifikohet bartësi i obligimeve për kompensim të dëmit, atëherë kjo faktikisht është e pamundshme, gjë që të drejtat e personave të zhvendosur i bën të pakuptimshme”*.

Qëndrimi i parashtruesit është që duke u nisur nga rregulli i përgjithshëm *“që personat e zhvendosur brenda vendit gëzojnë të njëjtat të drejta si çdo qytetar i shtetit në të cilin e kanë vendbanimin, kur zbatohet në situatën e personave të zhvendosur në Kosovë, kjo do të thotë se mund t'i realizojnë të drejtat e tyre pronësore si çdo banor tjetër i Kosovës”*. Sidoqoftë, përkundër kësaj, parashtruesi argumenton se: *“qytetarët e nacionalitetit serb nuk trajtohen njësoj nga ana e organeve relevante vendore dhe ndërkombëtare dhe kërkesat e tyre mbesin pa përgjigje”*.

Për ta mbështetur këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës vëren se paditë e paraqitura nga personat e zhvendosur brenda vendit nga Kosova, janë *“padi që i kanë paraqitur kundër UNMIK-ut dhe KFOR-it si dhe kundër Institucioneve të Përkohshme në Kosovë”* për kompensim të drejtë të dëmit të shkaktuar pronës së tyre, dëm i cili është shkaktuar si pasojë e *“bombardimeve të NATO-s, në vitin 1999, si dhe nga trazirat e marsit të vitit 2004”*. Padiat e parashtruesit, në mesin e mijëra padive të tjera, ka qenë *“e ngrirë”* një kohë të gjatë me kërkesë të drejtorit të UNMIK-ut, Departamenti i Drejtësisë (shkresë dërguar të gjithë kryetarëve të gjykatave komunale dhe atyre të qarkut si dhe Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës, më 26 gusht 2004). Qëllimi i “ngrirjes” ishte për të përcaktuar mënyrën më të mirë për të trajtuar fluksin e kërkesave. (Shih par. 15 Opinioni i Panelit Konsultativ për të Drejtat e Njeriut, të 23 shkurtit 2011, Rasti Nr. 27/08, et al.). Paneli Konsultativ për të Drejtat e Njeriut ka

konstatuar se ky pezullim i procedurës ishte një shkelje e drejtpërdrejtë e nenit 6 § 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe e drejta për gjykim të drejtë.

- j. Neni 156 [Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur Brenda Vendit], duke argumentuar se *“me vendimet e autoriteteve dhe të gjykatave në Republikën e Kosovës nuk janë mbrojtur të drejtat e mia të garantuara me nenin 156 të Kushtetutës, por drejtpërsëdrejti janë shkelur me vendime kontestuese dhe kundërthënëse të marra në dëmim tim”*. Parashtruesi tërheq vërejtjen në faktin se procedimi i rastit të tij, në mesin e shumë rasteve të tjera, kishte filluar jo shumë moti nga gjykatat, vetëm që t'i refuzojnë. Çështja në të cilën parashtruesi e tërheq vërejtjen është *“se kush është përgjegjës për kthimin e pronës dhe për kompensim për pronën e shkatërruar”*.

Parashtruesi argumenton se kjo është e thjeshtë, sepse *“18.000 padi kanë mbetur “të pazgjidhura dhe shpeshherë paraqiten si ngarkesë për drejtësinë kosovare që duhet hequr sa më parë. Siç duket, e drejta e atyre që kanë paraqitur padi të parët, nuk ka prioritet”*. Me fjalë të tjera, ngarkesa e sistemit gjyqësor nuk është arsye e kënaqshme për t'i mohuar individit të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me Kushtetutë. *“Gjykatat në Kosovë kanë filluar t'i refuzojnë paditë e tilla, ndërsa në të njëjtën kohë paditësit e varfër, personat e zhvendosur brenda vendit, japin shuma të konsiderueshme të të hollave për shpenzime gjyqësore në përpjekje për t'i realizuar të drejtat e tyre”*.

- k. Neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], duke argumentuar se *“ekzistojnë shumë shembuj të vendimeve që vërtetojnë se në këtë rast janë bërë shumë shkelje të të drejtave të njeriut nga ana e gjykatave të Kosovës”*.
- l. Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], duke pretenduar se *“Legjislacioni dhe krijimi i institucioneve, proceset e ndërmarra në Kosovë nuk i kanë proceduar në mënyrë të mjaftueshme nevojat specifike të personave të zhvendosur brenda vendit në krahësim me kërkesat e tyre dhe nuk kanë siguruar suaza adekuate institucionale”*. Parashtruesi më tej pretendon se pasi që *“sistemi gjyqësor nuk i njeh pengesat specifike me të cilat*

ballafaqohen personat e zhvendosur brenda vendit, e drejta e gjykimit të drejtë dhe shumica e të drejtave themelore të garantuara me ligjet vendore, janë premtime të kota". Në një argument të gjatë, të parashtruar në kërkesë, parashtruesi pretendon se kërkesa për pagesën e taksave gjyqësore është një pengesë për të drejtën e tij për qasje të barabartë në gjykata.

Parashtruesi i kërkesës argumenton se janë tri pengesa tipike për qasje në gjykatë: i) përdorimi i gjuhës zyrtare; ii) sistemi i taksave gjyqësore dhe iii) "*pamundësia faktike që të marrë pjesë në procedurën gjyqësore*" për personat e zhvendosur brenda vendit. Parashtruesi argumenton se kur kemi të bëjmë me ligjin neutral apo praktikën institucionale, diskriminimi mund të jetë i drejtpërdrejtë ose i tërthortë. Parashtruesi pranon se diskriminimi i tërthortë në gjykata, është më i butë nga diskriminimi i drejtpërdrejtë, por të dytë janë "*njësoj të rrezikshëm për parimet e mbrojtjes së barabartë të të drejtave*".

Duke cituar Komitetin për të Drejtat e Njeriut të Sesionit të Nëntëdhjetë Komentet e Përgjithshme të KB-së, nr. 32, parashtruesi nxjerr në pah se, "*E drejta për qasje në gjykata dhe tribunale dhe barazia para tyre nuk është e kufizuar për qytetarët e shteteve anëtare, por duhet të kenë qasje të gjithë individët, pa marrë parasysh nacionalitetin apo pashtetësinë, apo pa marrë parasysh statusin e tyre, qoftë nëse kërkojnë azil, refugjatë, punëtorë të migruar, fëmijë pa përcjellje apo persona të tjerë që mund të gjenden në territorin apo kompetencën e shtetit kontraktues. Një situatë në të cilën përpjekjet e një individi për të pasur qasje në gjykata kompetente ose tribunale janë frustruese në mënyrë sistematike de jure ose de facto shkon ndesh me garancinë e nenit 14, paragrafi 1, fjalia e parë. Kjo garanci gjithashtu ndalon çfarëdo dallimi në lidhje me qasjen në gjykata dhe tribunale që nuk janë të bazuara në ligj dhe nuk mund të justifikohet në baza objektive dhe të arsyeshme. Garancia është shkelur nëse persona të caktuar janë të ndaluar të ngrenë padi kundër një personi tjetër për shkak të racës së tyre, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes apo statusi tjetër*". (Shih, par. 9 të Komentit të Përgjithshëm, Nr. 32, neni 14, të

GJEDNJ-së,
<http://www.refworld.org/docid/478b2b2f2.html>).

16. Parashtruesi gjithashtu pretendon se janë shkelur nenet vijuese të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut:

- a. Neni 6, paragrafi 1 [E Drejta për një Proces të Rregullt] parasheh se *“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij ..., çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme”*. Parashtruesi argumenton se është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Në mbështetje të pretendimit të tij, parashtruesi tërheq vëmendjen e Gjykatës në disa raste të GJEDNJ-së, ku janë adresuar shkeljet e tilla të nenit 6 (1).

Në rastin Kutíć kundër Kroacisë, GJEDNJ-ja gjeti se kërkesa ishte e pranueshme në lidhje me çështjen se çfarë është një kohë e arsyeshme për të cilat procedurat mund të pezullohen. (Shih, Kutíć kundër Kroacisë, nr. 48778/99, 4 tetor 2001). Në rastin Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar, gjykata arsyetoi faktin *“se e drejta e qasjes përbën një element që është i qenësishëm në të drejtën e cekur me nenin 6 par. 1,... [e cila gjithashtu] i siguron çdokujt të drejtën që të ketë ndonjë pretendim në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij civile, të ngritura në një gjykatë apo tribunal”*. (Shih, Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 4451/70, § 36, 21 shkurt 1975).

Në mbështetje të mëtejme të argumenteve të tij, parashtruesi i referohet rastit të Ashingdane kundër Mbretërisë së Bashkuar (Shih, Ashingdane kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 8225/78, § 57, 28 maj 1985), në të cilin konstatohet se *“duhet të vërtetohet se shkalla e qasjes së ofruar sipas legjislacionit nacional ka qenë e mjaftueshme që të sigurojë të drejtën e individit në gjykatë, duke respektuar sundimin e ligjit në shoqërinë demokratike”*. Në Airey kundër Irlandës, GJEDNJ-ja vëren se qëllimi i Konventës nuk është të garantojë *“të drejta që janë teorike ose iluzore, por të drejta që janë praktike dhe efektive”*. (Shih Airey kundër Irlandës, nr. 6289/73, § 24, 9 tetor 1979). Në rastin De Cubber kundër Belgjikës, GJEDNJ-ja përcaktoi se interpretimi kufizues i

nenit 6 (1) *"nuk do të ishte në pajtim me objektin dhe qëllimin e kësaj dispozite, duke pasur parasysh vendin e shquar që e drejta për një gjykim të drejtë mban në një shoqëri demokratike brenda kuptimit të Konventës"*. (Shih, de Cubber kundër Belgjikës, nr. 9186/80, § 30, 26 tetor 1984).

- b. Neni 13 [E Drejta për Zgjidhje Efektive] parasheh se *"Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë... ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare"*. Parashtruesi i kërkesës argumenton se në bazë të fakteve të paraqitura, *"asnjë nga autoritetet mbikëqyrëse të palës së paditur, ose ndonjë autoritet tjetër, organizatë ose individ i autorizuar, nuk e pa të udhës të reagojë dhe të heqë nga sistemi i drejtësisë të palës së paditur, këtë situatë diskriminuese, e cila për një grup qytetarësh të Kosovës, të përcaktuar me përkatësinë e tyre etnike serbe, është praktikisht e pamundur për të mbrojtur të drejtat e tyre të parashikuara me Konventën Evropiane"*. Parashtruesi qartë argumenton se për shkak se është serb, ai nuk ka pasur trajtim të barabartë nga autoritetet e Kosovës në kërkim të një mjeti efektiv juridik për situatën e tij, prandaj e kërkon ndihmën e Gjykatës për të zgjidhur këtë çështje.

Parashtruesi tërheq vëmendjen e Gjykatës në rastin Tolstoy Miloslavsky kundër Mbretërisë së Bashkuar, ku KEDNJ-ja përcaktoi se *"e drejta e qasjes në gjykata, e siguruar nga neni 6 par. 1 mund t'i nënshtrohet kufizimit në formën e rregullimit nga shteti... Shteti gëzon një margjinë të caktuar të vlerësimit. Megjithatë, Gjykata duhet të jetë e kënaqur, së pari, se kufizimet e zbatuara nuk e kufizojnë apo zvogëlojnë qasjen e lënë individit në mënyrë të tillë ose në një masë të tillë që çdo thelb i së drejtës është zhvlerësuar. Së dyti, një kufizim duhet të ndjekë një qëllim legjitim dhe duhet të ketë një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet"*. (Shih, Tolstoy Miloslavsky kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 18139/91, § 59, 13 korrik 1995). Në argumentin e parashtruesit, ai tërheq vëmendjen e Gjykatës përsëri në rastin Kutic kundër Kroacisë (i cili

është faktikisht një rast i ngjashëm me atë të parashtruesve: prona e shkatërruar në vitin 1994 për shkak të bombardimeve, pala tani kërkon kompensim për dëmet, gjykata e pezulloi procedurën për një kohë të pacaktuar), ku GJEDNJ-ja konstatoi se kërkesa ishte e pranueshme. (Shih, Kutić kundër Kroacisë, nr. 48778/99, 4 tetor 2001).

Si duket, pas kërtimeve të gjera të objektit të çështjes, parashtruesi i kërkesës argumenton se *"pala e paditur ka shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës në mënyrën më të vrazhdë në bazë të nenit 6 të Konventës Evropiane (E Drejta për një Proces të Rregullt) dhe të drejtës nga neni 13 i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (E Drejta për Mjet Efektiv Juridik) dhe përndryshe janë shkelur të drejtat e parashtruesit të parashikuara me nenin 8 të Konventës Evropiane (E Drejta për Shtëpi), neni 1 Protokollin 1 i Konventës Evropiane (E Drejta për të Gëzuar Paqësisht Pronën) dhe atje mund gjithashtu të nënkuptohen shkeljet e të drejtave të parashikuara me nenin 14 të Konventës Evropiane (Ndalimi i Diskriminimit)"*.

- c. Neni 8 [E Drejta për Respektimin e Shtëpisë] parasheh se *"(1) Çdokush ka të drejtën e respektimit të... banesës... (2) Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve"*.

Parashtruesi pretendon se, sipas fakteve të paraqitura në kërkesë si dëshmi, *"pala e paditur me veprimet e saj ka cenuar... të drejtën [e tij] për respektimin e shtëpisë, e cila është e garantuar me nenin 8 të Konventës. Pala e paditur nuk ka bërë asgjë për të mbrojtur pronën e parashtruesit të kërkesës dhe të ngjashme"*. Parashtruesi vjen në përfundim se pasi që të paditurit kanë dështuar për të mbrojtur pronën e tij dhe më pas është penguar në marrjen e kompensimit për dëmtimin e pronës, ai mundet vetëm të përfundojë se kjo është bërë *"me qëllimin e mundshëm politik të spastrimit etnik dhe parandalimit të kthimit"*.

Parashtruesi pretendon se, sipas KEDNJ-së, në rastin Kroon dhe të tjerët kundër Holandës, *“qëllimi themelor i nenit 8 është që t'i mbrojë individët nga ndërhyrja arbitrare e autoriteteve publike. . . [dhe] një ekuilibër i drejtë. . . duhet të krijohet në mes të interesave konkurruese të individit dhe të komunitetit si tërësi.*”(Shih, Kroon dhe të tjerët kundër Holandës, nr. 18535/91, § 31, 27 tetor 1994). Në përcaktimin nëse ka pasur shkelje të nenit 8, parashtruesi i kërkesës e drejton vëmendjen e Gjykatës në rastin e KEDNJ-së, Niemetz kundër Gjermanisë, i cili shqyrton zbatueshmërinë e nenit 8 në lidhje me një biznes. (Shih, Niemetz kundër Gjermanisë, nr. 13710/88, § § 30-31, 16 dhjetor 1992). Arsyeja se kjo është relevante për rastin e parashtruesit është për shkak se prona në fjalë është përdorur për fitim, e jo vetëm për kultivim për përdorim personal.

Duke iu referuar Nënkomisionit (Rezoluta 1998/26) për Strehim dhe Rikthim të Pronës në Kontekstin e Kthimit të Refugjatëve dhe Personave të Zhvendosur, Komisioni vërejtë se *"e drejta e të gjithë të kthyerve për ushtrimin e lirë të së drejtës së tyre për liri të lëvizjes dhe të zgjedhjes së vendbanimit të dikujt, duke përfshirë të drejtën për t'u regjistruar zyrtarisht në shtëpitë e tyre dhe vendet e banimit të përhershme, të drejtën e tyre për privatësi dhe respekt për shtëpi, të drejtën e tyre për të banuar në mënyrë paqësore në sigurinë e shtëpisë së tyre dhe të drejtën e tyre të gëzojnë qasje në të gjitha shërbimet e nevojshme sociale dhe ekonomike, në një mjedis të lirë nga çdo formë e diskriminimit"*. Prandaj, parashtruesi i kërkesës argumenton se pasi që ai e ka këtë të drejtë të garantuar për të përdorur dhe gëzuar pronën e tij, të paditurit e kanë shkelur këtë të drejtë duke e parandaluar atë nga marrja dhe kompensimi i drejtë dhe përfundimisht në shkelje të nenit 8 të Konventës Evropiane.

- d. Protokolli 1, Neni 1 [Mbrojtja e Pronës] parasheh se *“Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë të gëzojë në mënyrë paqësore zotërimet e tij. Askush nuk do të privohet nga zotërimet e veta përveçse në interes të publikut dhe kur është subjekt i kushteve të përcaktuara me ligj e sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare"*. Parashtruesi pretendon se në bazë të këtij neni, i janë shkelur të drejtat e mëposhtme: *"e drejta në gëzimin e*

qetë të pronës, dhe më vonë (me shkatërrimin e saj të plotë) ai ishte ndaluar ta gëzojë të drejtën e tij në mënyrë paqësore për shkak të shkatërrimit të pronës (e drejta për kompensim për dëm material dhe jomaterial dhe e drejta për të kryer procedurën për mbrojtjen e kësaj të drejte)".

Parashtruesi prandaj thirret, duke u mbështetur në rastin Loizidou kundër Turqisë, ku GJEDNJ-ja deklaroi se *"duke refuzuar qasjen e saj në pronë, gradualisht, gjatë gjastëmbëdhjetë viteve të fundit, ka prekur të drejtën e parashtrueses si një pronar të pronës dhe në veçanti të drejtën e saj për gëzimin paqësor të pasurisë së saj, duke përbërë kështu shkelje të vazhdueshme të nenit 1 [të Protokollit i]* (Shih, Loizidou kundër Turqisë, nr 15318/89, § 60, 18 dhjetor 1996; shih gjithashtu Raportin e Komisionit të 8 korrikut 1993, fq 21; Chrysostomos, Papachrysostomou dhe Loizidou kundër Turqisë, DR 68, p 228).

- e. Neni 14 [Ndalimi i Diskriminimit] parasheh se *"Gëzimi i të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë konventë duhet të sigurohet, pa asnjë diskriminim të bazuar në baza të tilla si gjinia, raca, ngjyra, gjuha, feja, opinioni politik apo tjetër, origjina kombëtare ose sociale, lidhur me një pakicë kombëtare, lindjen apo status tjetër".* Parashtruesi pretendon se kjo që më shumë se tetë (8) vjet ai nuk ka qenë në gjendje të *"realizojë të drejtën [e tij] për kompensim të dëmit për shkak të shkatërrimit të shtëpive të tij, rezulton në shkeljen e së drejtës për gëzimin paqësor të pronës, për të cilën Republika e Kosovës është drejtpërdrejt përgjegjëse".*

GJEDNJ-ja, në rastin Pecevi kundër IRJ të Maqedonisë, përcaktoi se *"Shteti ka një detyrim pozitiv për të organizuar një sistem për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore që është efektiv edhe në ligj edhe në praktikë dhe siguron zbatimin e tyre pa ndonjë vonesë. Një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta. Megjithatë, vonesa nuk mund të jetë e tillë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës së mbrojtur sipas nenit 6 § 1"* (Shih, Pecevi kundër Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 21839/03, § 29, 6 nëntor 2008; Shih, gjithashtu, Fuklev kundër Ukrainës, nr. 71186/01, § § 83 dhe 84, 7 qershor 2005).

Parashtruesi gjithashtu tërheq vëmendjen në "Parimet e Pinheiros" përcaktuar në Manualin për kthimin e pronave dhe banesave për refugjatët dhe personat e zhvendosur, Parimi 2 [E Drejta për Strehim dhe Rikthim të Pronës] parasheh si në vijim: "2.1 Të gjithë refugjatët dhe personat e zhvendosur kanë të drejtë në rivendosje të ndonjë strehimi, toke dhe / ose prone prej së cilës ata ishin të privuar në mënyrë arbitrare apo të paligjshme, ose të kompensohen për çdo strehim, tokë dhe/ose prone që është faktikisht e pamundur të rivendoset siç përcaktohet nga një gjykatë e pavarur, tribunal i paanshëm. 2.2 Shtetet duhet dëshmuar prioritetet për të drejtën për kthim si mjet i preferuar juridik për zhvendosje dhe si një element kyç i drejtësisë restauruese. E drejta e kthimit ekziston si një e drejtë e veçantë, dhe nuk paragjykohet as me kthimin aktual, e as me moskthimin e refugjatëve dhe personave të zhvendosur, me të drejtë të kthimit të strehimit, të tokës apo të pronës".

Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i referohet parimit 21 [Kompensimi] të Parimeve Pinheiros, i cili thotë se "21.1 Të gjithë refugjatët dhe personat e zhvendosur kanë të drejtën e kompensimit të plotë dhe efektiv si një element përbërës të procesit të kthimit. Kompensimi mund të jetë monetar ose në natyrë. Shtetet duhet, në mënyrë që të jenë në përputhje me parimin e drejtësisë restauruese, të sigurojnë që mjete të kompensimit është përdorur vetëm kur mjete të rikthimit nuk është faktikisht i mundur, ose kur pala e dëmtuar me vetëdije dhe vullnetarisht e pranon kompensimin në vend të kthimit, ose kur kushtet e një zgjidhjeje paqësore të negociuar të sigurojnë një kombinim të kthimit dhe kompensimit". (http://www.ohchr.org/Documents/Publications/pinheiro_principles.pdf).

- f. Protokoll 12, neni 1 [Ndalimi i Përgjithshëm i Diskriminimit] parasheh që "(1) Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si gjinia, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, lidhja me një minoritet kombëtar, pasurinë, lindjen ose çdo status tjetër... (2) Askush nuk duhet të diskriminohet nga një

autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1”.

Parashtruesi pretendon se sipas parimit të barazisë në kuadër të Protokollit 12 dhe të gjithë Konventës Evropiane, *“secila palë në procedurë duhet t’i ketë të njëjtat mundësi për t’i paraqitur argumentet e veta dhe që asnjëra nga to nuk bën të ketë epërsi në krahasim me kundërshtarit e vet në procedurë”*. Parashtruesi pretendon se atij nuk i është dhënë trajtim i barabartë dhe më pas ishte diskriminuar me tërheqjen e padisë së tij nga Gjykata Komunale në Vushtrri.

Në argumentin e tij, parashtruesi i kërkesës konkludon se sipas Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, një shtet duhet të ketë një arsye objektive për ta ndaluar atë nga kërkitimi i kompensimit për dëmin e pronës. Megjithatë, në këtë situatë, parashtruesi pretendon se ku *“një shtet që mundëson (me apo pa vetëdije), respektivisht se është aq keq i organizuar që nuk është i aftë për të parandaluar vjedhjen e pasurisë se e ka vënë nën sundimin e tij, është përgjegjës për dëmin që ka lindur si rezultat i kësaj, dhe çështja e kompensimit të tij nga dëmtuesi i vërtetë nuk mund të vihet në kurriz të pronarit të pronës dhe unë nuk do të doja të vija në përfundime për qëllimet e organeve vepruese që trajtonin atë pronë, dhe se si ata vepruan në drejtim të pronës së luajtshme të parashtruesit dhe të ngjashme”*. Prandaj, parashtruesi kërkon nga Gjykata të marrë parasysh rastin e z. Veton Berishës dhe znj. Ilfete Haziri: Vlerësimi i kushtetutshmërisë së A. Nr. 1053/2008 (Shih KI72/12, të 7 dhjetorit 2012), ku konstatoi *“dështimi i Gjykatës Supreme të sigurojë përgjigje të qarta dhe të plota vis-a-vis kërkesave vendimtare pronësore i shkel të drejtat e parashtruesit që të dëgjohet, si dhe të drejtën për një vendim të arsyetuar, si një element i së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm”* (Shih, KI72/12 at § 63).

Pranueshmëria e kërkesës

17. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka

plotësuar të gjitha kushtet për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe Rregullore të punës.

18. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, i cili parasheh se *“Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: kërkesa është qartazi e bazuar”*.
19. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmërisë), që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Prandaj, kjo gjykatë nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM], Nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEONJ] 1999-1).
20. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Gjykata Komunale në Vushtrri e konsideroi padinë e parashtruesit si të tërhequr në bazë të asaj se parashtruesi nuk i kishte paguar taksat gjyqësore. Sipas nenit 253(5) të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK), parashihet që *“Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr”*.
21. Në vendim, Gjykata Komunale iu referua Udhëzimit Administrativ Nr. 2008/02, për unifikimin e taksave gjyqësore, nenet 3(1) dhe 10(1). Neni 3(1) parasheh që *“Përcaktimi i taksave gjyqësore, që duhet paguar në kohën e dorëzimit të parashtrësës, bëhet në bazë të vlerës së kontestit të parashtrësës, gjegjësisht natyrës së parashtrësës”*. Neni 10(1) përcakton një shkallë të tarifës që lidhet me shumën e kontestit për *“Të gjitha parashtrësat për të cilat është e matshme vlera, duke përfshirë qfarëdo rasti të ndërlidhur me borxhet monetare, pronën e luajtshme apo të paluajtshme, dëmtimet, kontratat me vlerë monetare, trashëgiminë dhe ekzekutimin civil të borxheve.”*
22. Gjykata e Apelit i referohet nenit 6.5 të Udhëzimit Administrativ, i cili parasheh që *“Nëse nuk paguhen taksat deri në datën e caktuar, gjykata do ta njoftojë personin që është dashur t' i paguajë taksat, se ka përcaktuar një datë përfundimtare deri kur duhet të paguhen të gjitha taksat e papaguara, duke përfshirë edhe taksat shtesë, sipas neneve 6.4 dhe 10.25. Nëse ato nuk paguhen deri në datën përfundimtare, gjykata do të hedhë poshtë*

parashtrësën për të cilën nuk janë paguar taksat”. Për më tepër, Gjykata e Apelit konstatoi se Gjykata Komunale në Vushtrri ka ndërmarrë veprime në mënyrë që ta njoftojë parashtruesin e kërkesës, siç është njoftimi i Ministrisë së Drejtësisë, Zyrën për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe ajo gjithashtu konstatoi se parashtruesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi mbi atë pse parashtruesi duhet të lirohet nga pagesa e tarifës gjyqësore.

23. Prandaj, Gjykata nuk mund të konkludojë se procedurat përkatëse kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare. Edhe Gjykata Komunale, edhe Gjykata e Apelit hodhën poshtë, ndoqën rregullat dhe procedurat përkatëse dhe i arsyetuan vendimet e tyre.
24. Prandaj, në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme si qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhshmëri me rregullin 36 (1) c) dhe me rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 3 shkurt 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA REFUZOJË kërkesën si të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20(4) të Ligjit; dhe
- IV. TË SHPALLË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI146/13, Idriz Neziri, Aktvendim i datës 19 nëntor 2013 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Vendimit të Kolegjit të Ankesave të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Rasti KI146/13, vendimi i 19 nëntorit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, e jashtë afatshme

Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Më 13 shtator 2013, parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në të cilën kërkoi nga Gjykata vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimet e lartpërmendura shkelin të drejtat e tij themelore dhe në veçanti nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Gjykata vërejti se parashtruesi i kishte humbur afatet e përcaktuara me Ligjin dhe Rregulloren e punës.

Në këtë kuptim, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit është jashtë afatit kohor.

Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e kërkesës së parashtruar, Gjykata Kushtetuese e Kosovës e refuzoi kërkesën si të papranueshme për shqyrtim.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në**

Rastin nr. KI146/13

Parashtrues

Idriz Neziri

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Kolegjit të
Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të
Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të
Privatizimit, ASC-11-0035, të 23 nëntorit 2012**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović,
zëvendëskryetar
Robert Carolan,
gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova,
gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Idriz Neziri, nga Fushë-Kosova (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Vendimin e Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Ankesave të Dhomës së Posaçme), ASC-11-0035, të 23 nëntorit 2012, i cili i ishte dorëzuar atij më 10 janar 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit, me të cilin pretendohet se i pamundëson parashtruesit të realizojë të drejtën për pjesëmarrje në 20% të të ardhurave nga privatizimi i

Ndërmarrjes Shoqërore “Ramiz Sadiku” (në tekstin e mëtejme: NSH “Ramiz Sadiku”), në Prishtinë.

Baza juridike

4. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, neni 47 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 13 shtator 2013, parashtruesi i kërkesës e parashtrroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 24 shtator 2013, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI146/13, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI146/13, caktoi edhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Cukalović.
7. Më 11 tetor 2013, Gjykata e informoi parashtruesin e kërkesës dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 19 nëntor 2013, Kolegji shqyrtues pasi shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues i propozoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Në një periudhë kohore (e cila nuk ishte cekur në kërkesë) parashtruesi i kërkesës kishte lidhur kontratë pune me NSH “Ramiz Sadiku” në vendin e punës së depoistit.
10. Më 27 qershor 2006, NSH “Ramiz Sadiku” përfundoi procesin e privatizimit.
11. Më 24 shkurt 2010, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme kundër listës përfundimtare të punëtorëve të përpiluar nga Agjencia e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Agjencia), sepse ai, si ish-punëtor, nuk ishte në listë.

12. Në ankesën e ushtruar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, parashtruesi i kërkesës theksoi se ai kishte kontratë pune me NSH “Ramiz Sadiku“, në vendin e punës së depoistit, se ai e ka humbur afatin ligjor për ushtrimin e ankesës kundër vendimit të Agjencisë, për shkak se nuk ka pasur qasje në arkivat e ndërmarrjes, kështu që nuk ka arritur që me kohë të sigurojë dokumentacionin e nevojshëm për të justifikuar pretendimet e tij.
13. Më 24 shkurt 2011, Trupi gjykues i Gjykatës Supreme nxori Vendimin [SCEL-09-0001], me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të palejueshme.
14. Në arsyetimin e vendimit të tij, Trupi gjykues i Gjykatës Supreme theksoi: *„duke marrë parasysh se ankesa ishte paraqitur pas skadimit të afatit ligjor (afati ka skaduar më 27 mars 2009), nuk ekziston mundësia e kthimit në gjendjen e mëparshme dhe që ankesa e parashtruesit të konsiderohet si e ushtruar në afatin ligjor. Rrjedhimisht, Trupi gjykues e hedh poshtë ankesën e parashtruesit si të palejueshme“.*
15. Më 8 prill 2011, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Kolegjin e Ankesave të Gjykatës Supreme, kundër Aktvendimit të Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme [SCEL-09-0001], të 24 shkurtit 2011.
16. Më 23 nëntor 2012, Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme nxori vendimin [ASC-11-0035], me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar.
17. Në arsyetimin e vendimit të tij, Kolegji i ankesave i Dhomës së Posaçme theksoi:

“Parashtruesi ushtroi ankesë kundër listës përfundimtare të punëtorëve të 24 shkurtit 2010, e cila konsiderohet si jashtë afatit ligjor. Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të palejueshme, për shkak të afateve të humbura. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Kolegjin e Ankesave të Dhomës së Posaçme ku përsëriti pretendimet nga ankesa të cilën e kishte ushtruar te Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme, por nuk paraqiti asnjë dëshmi relevante me të cilën do të kishte arsyetuar pretendimin e tij. Rrjedhimisht, Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme është i mendimit se ankesa e parashtruesit të kërkesës duhet të hidhet poshtë si e pabazuar“.

Pretendimet e parashtruesit

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se aktvendimet e lartpërmendura shkelin të drejtat e tij themelore dhe në veçanti nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës, pasi që gjykatat nuk kishin vendosur në mënyrë meritore në lidhje me ankesat e tij.
19. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me kërkesë:

„Që Gjykata t'i anulojë aktvendimet e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës [SCEL-09-0001], të 21 shkurtit 2011, dhe të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme [ASC-11-0035], të 23 nëntorit 2012, si joligjore dhe të detyrojë Dhomën e Posaçme që në lidhje me këtë çështje ligjore të vendosë në mënyrë meritore, ashtu që të pranojë të drejtën time në pjesëmarrje të 20%, si punëtorëve të tjerë me të cilët kishte punuar“.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

20. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata Kushtetuese duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të cilat përcaktohen me Kushtetutë dhe që saktësohen me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe me Rregullore të punës.
21. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se neni 113.7 i Kushtetutës përcakton:

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

22. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, përkatësisht në Trupin gjykues të Dhomës së Posaçme, si dhe në Kolegjin e Ankesave të Dhomës Posaçme, dhe në këtë mënyrë i plotësoi kërkesat e nenit 113 të Kushtetutës dhe për këtë arsye parashtruesi është person i autorizuar të paraqesë një kërkesë para kësaj gjykate.
23. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 49 të Ligjit, që përcakton:

„Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të llogaritet që nga dita kur parashtruesit i është

dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të llogaritet në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të llogaritet që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.

24. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh edhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

...

b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi”.

25. Bazuar në dokumentet e paraqitura, Gjykata konstaton se parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 13 shtator 2013, ndërsa vendimi i fundit i Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme iu dorëzua atij më 10 janar 2013, që do të thotë 8 muaj dhe 3 ditë pas skadimit të afatit ligjor që parashihet në nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.
26. Nga kjo rrjedh se kërkesa e parashtruesit është jashtë afatit kohor.
27. Bazuar në këtë, kërkesa duhet të refuzohet si e papranueshme për shqyrtim, sepse është në kundërshtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, në përputhje me nenin 20 të Ligjit dhe në përputhje rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, më 19 nëntor 2013, njëzëri

VENDOS

- I. TA REFUZOJË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20(4) të Ligjit; dhe
- IV. TË SHPALLË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KO18/14, Vesna Mikić dhe 20 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Aktvendim i datës 10 shkurt 2014 - Kërkesë për "[...] interpretim të dispozitave të Kushtetutës së Kosovës lidhur me vendet e rezervuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë"

Rasti KO18/14, vendimi i 10 shkurtit 2014

Fjalët kyçe: kontroll abstrakt, kërkesë për interpretim, palë e paautorizuar

Parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesë në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës së Kosovës me kërkesë për "[...] interpretim të dispozitave të Kushtetutës së Kosovës lidhur me vendet e rezervuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë"

Lidhur me çështjen e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata konstatoi se kërkesa ishte e papranueshme, sepse parashtruesit e kërkesës nuk janë palë e e autorizuar për të parashtruar kërkesë për interpretim të dispozitave kushtetuese. Prandaj, Gjykata konstatoi se kërkesa ishte e papranueshme në pajtim me nenin 113.1 të Kushtetutës

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në**

Rastin Nr. KO18/14

Parashtrues

**Vesna Mikić dhe 20 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës
së Kosovës**

**Kërkesë për “[...] interpretim të dispozitave të Kushtetutës së
Kosovës lidhur me vendet e rezervuara për përfaqësuesit e
komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë”**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues janë: Vesna Mikić, Petar Miletić, Jelena Bontić, Kostić Biserka, Saša Milosavljević, Jasmina Živković, Emilija Ređepi, Albert Kinolli, Danush Ademi, Saša Đokić, Hamza Balje, Milivoje Stojanović, Vesimir Stojanović, Xhevdet Neziraj, Müfera Şinik, Fikrim Damka, Enis Kervan, Boban Todorović, Mursel Haljilji, Etem Arifi dhe Goran Marinković, të gjithë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës).

Objekti i çështjes

2. Objekt i çështjes së kërkesës është kërkesa për “interpretim të dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) lidhur me vendet e rezervuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk e përbëjnë shumicën në Kosovë”, përkatësisht, nëse “[...] komunitetet kanë të drejtë edhe për një mandat tjetër të vendeve të rezervuara, së bashku me vendet e garantuara, në përputhje me nenin 148, Kapitullin XIV [Dispozitat Transicionale për Kuvendin e Kosovës] të Kushtetutës

së Republikës së Kosovës të datës 15.06.2008, për mandatin e radhës, gjegjësisht për zgjedhjet e ardhshme parlamentare, të cilat do të mbahen në vitin 2014”.

Baza juridike

3. Kërkesa bazohet në nenin 113 të Kushtetutës dhe në rregullin 56.2 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

4. Më 31 janar 2014, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatë.
5. Më 3 shkurt 2014, kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KO18/14, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KO18/14 caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Arta Rama-Hajrizi.
6. Më 4 shkurt 2014, Gjykata i njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe e informoi Kuvendin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi) lidhur me kërkesën.
7. Më 10 shkurt 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandim për papranueshmërinë e kërkesës.

Deklaratat e parashtruesve

8. Parashtruesit kërkojnë nga Gjykata që të interpretojë nëse komunitetet, që nuk janë shumicë në Kosovë, kanë të drejtë të përfitojnë nga sistemi i vendeve të rezervuara edhe një mandat tjetër në Kuvendin e Republikës së Kosovës, përkatësisht mandatin e radhës, për zgjedhjet e ardhshme parlamentare në vitin 2014. Kërkesa e tyre lidhet me nenin 148 të Kapitullit XIV [Dispozitat Transicionale] të Kushtetutës.
9. Parashtruesit i referohen nenit 3, paragrafi 2, të Propozimit Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës, ku thuhet: *“Për dy (2) mandatet e para zgjedhore, Kuvendi i Republikës së Kosovës do të ketë njëzet (20) vende të rezervuara për përfaqësim të komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë në mënyrën si vijon: Dhjetë (10) vende do t’u ndahen partive,*

koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, që janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin Serb të Kosovë, dhe dhjetë (10) vende do t'u ndahen komuniteteve të tjera si vijon: komunitetit Rom një (1) vend; komunitetit Ashkali një (1) vend; komunitetit Egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë do t'i jepet komunitetit Rom, Ashkali ose Egjiptian, i cili ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komunitetit Boshnjak tri (3) vende, komunitetit Turk dy (2) vende dhe komuniteti Goran një (1) vend. Çdo vend i fituar përmes zgjedhjeve, do të jetë vend shtesë, përveç dhjetë (10) vendeve të rezervuara që u ndahen përkatësisht komunitetit Serb të Kosovës dhe komuniteteve të tjera”.

10. Parashtruesit, më tej, i referohen nenit 148 [Dispozitat Transicionale për Kuvendin e Kosovës] të Kushtetutës, i cili parasheh: *“Për dy (2) mandatet e para zgjedhore, Kuvendi i Republikës së Kosovës do të ketë njëzet (20) vende të rezervuara për përfaqësim të komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë në mënyrën si vijon: Dhjetë (10) vende do t'u ndahen partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, që janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin Serb të Kosovë, dhe dhjetë (10) vende do t'u ndahen komuniteteve të tjera si vijon: komunitetit Rom një (1) vend; komunitetit Ashkali një (1) vend; komunitetit Egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë do t'i jepet komunitetit Rom, Ashkali ose Egjiptian, i cili ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komunitetit Boshnjak tri (3) vende, komunitetit Turk dy (2) vende dhe komuniteti Goran një (1) vend. Çdo vend i fituar përmes zgjedhjeve, do të jetë vend shtesë, përveç dhjetë (10) vendeve të rezervuara që u ndahen përkatësisht komunitetit Serb të Kosovës dhe komuniteteve të tjera”.*
11. Në këtë drejtim, parashtruesit pretendojnë se *“Pavarësisht nga pika 1 e këtij neni, mandati ekzistues në kohën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute do të konsiderohet si mandati i parë zgjedhor i Kuvendit, në rast se ky mandat zgjat për së paku dy vite nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute”.* Prandaj, parashtruesit konsiderojnë se *“[...] mandati i parë nuk mund të trajtohet si mandat i plotë, sepse në Propozimin Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës thuhet - pas miratimit të Kushtetutës dhe mandati ishte i shkurtuar”.*
12. Përveç kësaj, parashtruesit pretendojnë se *“[...] shkurtimi i mandatit dhe zbatimi retroaktiv është në kundërshtim me të drejtat e njeriut dhe të drejtat e komuniteteve, gjegjësisht që*

vendimet në përputhje me Kushtetutën dhe Propozimin Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës janë të vlefshme për dy mandate dhe vetëm pas miratimit të Kushtetutës”.

Pranueshmëria e kërkesës

13. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesve, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesit i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregulloren e punës.
14. Në këtë drejtim, Gjykata vlerëson nëse parashtruesit janë palë e autorizuar për dorëzimin e kërkesës përkatëse.
15. Në rastin në fjalë, parashtruesit kërkojnë një interpretim për mënyrën e zbatimit të dispozitave të caktuara të Kushtetutës lidhur me vendet e rezervuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk e përbëjnë shumicën në Kosovë. Në veçanti, parashtruesit pyesin nëse komunitetet kanë të drejtë edhe për një mandat të vendeve të rezervuara së bashku me vende të garantuara, në bazë të nenit 148 [Dispozitat Transicionale për Kuvendin e Kosovës] të Kushtetutës për mandatin e ardhshëm në lidhje me zgjedhjet e përgjithshme që do të mbahen gjatë vitit 2014.
16. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.1 të Kushtetutës, i cili parasheh: *“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.*
17. Gjykata vëren se parashtruesit kërkojnë një interpretim të zbatueshmërisë së një dispozite kushtetuese lidhur me zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Dispozita kushtetuese në fjalë është neni 148 i Dispozitave Transicionale, i cili ishte fshirë nga Kushtetuta e Kosovës me Vendimin e Kuvendit nr. 04-V-436, të 7 shtatorit 2012.
18. Parashtruesit konkretisht pohojnë se neni 148 kishte për qëllim të zbatohet për dy mandate zgjedhore të Kuvendit të Kosovës dhe se mandati i parë zgjedhor nuk duhet të llogaritet si mandat i plotë në kohën e hyrjes në fuqi të Kushtetutës. Në arsyetimin e parashtruesve, kjo do të nënkuptonte se sistemi i vendeve të rezervuara për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, të përfshira në nenin 148, do të vazhdonte të zbatohet pas zgjedhjeve të ardhshme për Kuvendin e Kosovës, të caktuara për vitin 2014.

Parashtruesit argumentojnë se, nëse sistemi i vendeve të rezervuara nuk vazhdohet në mandatin e ardhshëm të Kuvendit, kjo do të përbënte një shkelje të të drejtave të njeriut të komuniteteve joshumicë. Parashtruesit nuk saktësojnë se cilat të drejta të njeriut do të shkeleshin as se si do të shkeleshin këto të drejta.

19. Ndryshe, mund të kuptohet që parashtruesit kërkojnë një interpretim abstrakt të kuptimit të fshirjes së nenit 148 nga Kushtetuta, përkatësisht se dispozitat e tij në lidhje me zbatueshmërinë e tij për mandatet e Kuvendit në njëfarë mënyre do të kishin mbijetuar fshirjen e këtij neni dhe do të zbatoheshin ende. Megjithatë, edhe në këtë kuptim, kërkesa e parashtruesve për interpretim nuk ka asnjë bazë kushtetuese. Siç kuptohet nga Gjykata, sa i përket kërkesës për interpretim në lidhje me dispozitat e Kushtetutës, nuk ka dispozitë kushtetuese që autorizon deputetët e Kuvendit për të sjellë një kërkesë të tillë në Gjykatë.
20. Gjykata rithekson se, sipas nenit 93 (10) [Kompetencat e Qeverisë] të Kushtetutës, *“Qeveria ka këto kompetenca: mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese”*. Për më tepër, në rastin Nr. KO98/11, Gjykata gjeti se *“Sipas nenit 93 (10) të Kushtetutës, Qeveria mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese. Nëse çështjet janë çështje kushtetuese, atëherë Qeveria do të jetë palë e autorizuar dhe kërkesa do të jetë e pranueshme”* (Shih rastin KO98/11, Parashtruesi: Qeveria e Republikës së Kosovës, Aktgjykimi i 20 shtatorit 2011).
21. Për më tepër, Gjykata po ashtu rithekson se, në bazë të nenit 84 (9) [Kompetencat e Presidentit] të Kushtetutës, *“Presidenti i Republikës së Kosovës mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese”*.
22. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se kompetencat e organeve shtetërore kushtetuese duhet të ushtrohen sipas dispozitave të Kushtetutës.
23. Duke pasur parasysh dispozitat e cituara të Kushtetutës, Gjykata konkludon se parashtruesit nuk janë palë e autorizuar për të parashtruar një kërkesë të tillë.
24. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesve është e papranueshme, në pajtim me nenin 113.1 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.1 të Kushtetutës dhe në mbështetje të rregullit 56.2 të Rregullores së punës, më 10 shkurt 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në përputhje me nenin 20 (4) të Ligjit;
- IV. TË DEKLAROJË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI135/13, KI137/13, KI138/13, Isuf Isufi, z. Tahir Sejdiu dhe z. Abedin Halimi, Aktvendim i datës 2 dhjetor 2013 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Vendimit ASC-11-0069 të Kolegjit për Ankesa të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 22 prillit 2013

Rasti KI135/13, KI137/13, KI138/13, vendimi i 2 dhjetorit 2013.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, rastet e bashkuara, e drejta e pronës, jashtë afatit kohor.

Parashtruesit i parashtruan kërkesat në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, në të cilat kërkuan vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit ASC-11-0069 të Kolegjit për Ankesa të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 22 prillit 2013.

Objekt i çështjes së kërkesave është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit, i cili i privonte parashtruesit nga e drejta për një pjesë të të ardhurave, që pretendohet të jenë fituar nga privatizimi i Ndërmarrjes Shoqërore "Ramiz Sadiku" në Prishtinë.

Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe Dhoma e Posaçme i kanë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë, sepse ata kanë kontribuar në NSH "Ramiz Sadiku" për shumë vite, dhe, prandaj, pretendohet të kenë të drejtë në një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së së lartcekur. Parashtruesit e kërkesës nuk thirren në asnjë dispozitë kushtetuese në veçanti.

Gjykata konstatoi se parashtruesit i kanë dorëzuar kërkesat e tyre më 3 shtator 2013, përderisa vendimi i fundit i Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme u është dorëzuar atyre më 29 prill 2013. Kështu, 29 gushti 2013 ishte dita e fundit e afatit që parashtruesit të paraqesin kërkesë.

Në bazë të kësaj, Gjykata i hodhi poshtë kërkesat sepse ato ishin të paafatshme.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastet Nr.KI135/13, KI137/13, KI138/13
Parashtrues
Isuf Isufi, Tahir Sejdiu dhe Abedin Halimi
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit ASC-11-0069 të
Kolegjit për Ankesa të Dhomës së Posaçme të Gjykatës
Supreme të Kosovës, të 22 prillit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesit e kërkesës

1. Kërkesat KI 135/13, KI 137/13 dhe KI 138/13 janë dorëzuar, respektivisht, nga z. Isuf Isufi, z. Tahir Sejdiu dhe z. Abedin Halimi, që të gjithë nga Podujeva (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kontestojnë, Vendimin ASC-11-0069 të Kolegjit për Ankesa të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 22 prillit 2013, dhe në lidhje me Aktgjykimin SCEL-09-0001 të Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme, të 10 qershorit 2011. Vendimi i fundit u ishte dorëzuar parashtruesve më 29 prill 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesave, është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili i privonte parashtruesit, nga e drejta për një pjesë të të ardhurave, që pretendohet të jenë fituar nga privatizimi i Ndërmarrjes shoqërore “Ramiz Sadiku” në Prishtinë, (në tekstin e mëtejme: NSH “Ramiz Sadiku”). Parashtruesit e kërkesës *“besojnë se (...) të drejtat e njeriut*

dhe të drejtat e punës janë shkelur dhe (...) janë diskriminuar”.

Baza juridike

4. Kërkesat janë bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit Nr.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregullat 29 dhe 37 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 3 shtator 2013, parashtruesit kërkesat e tyre i kanë dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 24 shtator 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 8 tetor 2013, Kryetari e urdhëroi bashkimin e kërkesave KI137/13, dhe KI138/13, me kërkesën KI135/13.
8. Më 9 tetor 2013, Gjykata në pajtim me rregullin 37 të Rregullores së punës, i njoftoi parashtruesit lidhur me regjistrimin dhe bashkimin e kërkesave. Po të njëjtën ditë, Gjykata ia komunikoi kërkesat Dhomës së Posaçme. Parashtruesit e kërkesës, nuk paraqitën ndonjë kërkesë lidhur me bashkimin e kërkesave të tyre.
9. Më 31 tetor 2013, Gjykata kërkoi dokumente shtesë nga Dhoma e Posaçme.
10. Më 4 dhe 13 nëntor 2013, Dhoma e Posaçme iu përgjigj kërkesës së Gjykatës.
11. Më 2 dhjetor 2013, Kolegji shqyrtues pasi shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Në mars të 2009, parashtruesit filluan procedurën gjyqësore në Trupin gjykues të Dhomës së Posaçme, për t'u përfshirë në listën e punonjësve të kualifikuar për një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH "Ramiz Sadiku", e cila ishte privatizuar më 27 qershor 2006.
13. Përfundimisht, më 22 prill 2013, Kolegji i Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (Aktgjykimi ASC-11-0069), i refuzoi ankesat e parashtruesve, dhe e vërtetoi aktgjykimin e Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme duke konstatuar, se parashtruesit nuk i kanë plotësuar kushtet nga neni 10.4 i Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut 2003/13, pasi që ata e kanë arritur moshën e pensionimit para privatizimit të NSH-së "Ramiz Sadiku".

Pretendimet e parashtruesve

14. Parashtruesit pretendojnë se *"ata kanë punuar në NSH "Ramiz Sadiku" në Prishtinë, për shumë vite deri më 28 shkurt 1990, kur forcat serbe i dëbuan ata me dhunë nga puna dhe i diskriminuan"*.
15. Parashtruesit pretendojnë se Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe Dhoma e Posaçme i kanë shkelur të drejtat e tyre, të garantuara me Kushtetutë, sepse ata kanë kontribuar në NSH "Ramiz Sadiku" për shumë vite, dhe, prandaj, pretendohet të kenë të drejtë në një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së së lartcekur. Parashtruesit nuk thirren në asnjë dispozitë kushtetuese në veçanti.

Vlerësimi i pranueshmërisë

16. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesit i kanë plotësuar kriteret për pranueshmëri, të parapara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës.
17. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 .7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

18. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të llogaritet që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor".

19. Gjykata më tej merr parasysh rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

*"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: ...
b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi..."*

20. Gjykata vëren, se parashtruesit i kanë dorëzuar kërkesat e tyre më 3 shtator 2013, përderisa vendimi i fundit i Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme u është dorëzuar atyre, më 29 prill 2013. Kështu, 29 gushti 2013, ishte dita e fundit e afatit, që parashtruesit të paraqesin kërkesë.
21. Gjykata konsideron se parashtruesit, i kanë paraqitur kërkesat e tyre në Gjykatë katër (4) ditë më vonë, se afati i fundit ligjor i paraparë me nenin 49 të Ligjit, dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.
22. Rrjedh se kërkesat janë të paafatshme.
23. Prandaj, kërkesat duhet hedhur poshtë si të papranueshme, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhshmëri me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, më 2 dhjetor 2013, njëzëri

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesat si të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe
- IV. TË SHPALLË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI186/13, Korporata Energjetike e Kosovës, Aktvendim i datës 5 dhjetor 2013 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. Nr. 151/2013, të 5 qershorit 2013

Rasti KI186/13, vendimi i 5 dhjetorit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kontest civil, e drejta në punë, kërkesë qartazi e pabazuar.

Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës pretendonte se Gjykata Suprem gjykoi në bazë të ligjeve që nuk kanë qenë në fuqi, andaj aktgjykimi i saj ishte i paligjshëm dhe i padrejtë dhe si i tillë duhet të prishej. Prandaj, parashtruesi pretendonte vendimi i kontestuar i shkeli të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenin 31 dhe 102.3 të Kushtetutës, si rezultat i shkeljes së nenit 214.2 të Ligjit për procedurën kontestimore.

Në këtë kontekst, parashtruesi nuk përcakton qartë se si dhe pse pretendimi se “zbatimi i akteve të tjera që nuk kanë qenë në fuqi” përbën një shkelje kushtetuese të të drejtave të tij themelore për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Për më tepër, citati i gjerësishëm më lart i vendimit të Gjykatës Supreme tregon se vendimi i kontestuar ka dhënë arsyetim të gjerësishëm dhe gjithëpërfshirës përkitazi me faktet e rastit dhe gjetjet e tyre.

Sa i përket pretendimit të parashtruesit për shkeljen e nenit 102.3 të Kushtetutës, “gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit”, Gjykata vlerëson se parashtruesi, edhe në këtë pretendim ka dështuar të argumentojë se me vendimin e kontestuar i është cenuar kjo e drejtë e garantuar me dispozitën e lartcekur të Kushtetutës, sepse i njëjti nuk ka ngritur ndonjë argument ose ndonjë dëshmi se Gjykata Supreme nuk ka respektuar dispozitat në fjalë. Përkitazi me pretendimin e parashtruesit “për shkeljen e dispozitave ligjore”, Gjykata vlerëson se pretendimet e tilla janë të natyrës ligjore, dhe si të tilla nuk paraqesin bazë kushtetuese për shkeljen e të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutë.

Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë, sepse parashtruesi nuk ka arritur t'i arsyetojë pretendimet e tij dhe të dorëzojë dëshmi për të mbështetur pretendimet për shkelje kushtetuese të shkaktuar nga vendimi i kontestuar. Prandaj, në pajtim me rregullin 36 (2) b) dhe d) të Rregullores së punës, kërkesa e parashtruesit shpallet qartazi e pabazuar.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI186/13
Parashtrues
Korporata Energjetike e Kosovës
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. Nr. 151/2013, të 5
qershorit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Korporata Energjetike e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi), e përfaqësuar nga znj. Shukrije Miftari, juriste.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. 49/2012, të 3 qershorit 2013 (në tekstin e mëtejshëm: vendimi i kontestuar), të cilin parashtruesi e ka pranuar më 28 korrik 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe të nenit 102. paragrafi 3 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Neni 113.7, në lidhje me nenin 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 47 i Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 16 dhjetorit 2008, i hyrë në fuqi më 15 janar 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 28 tetor 2013, parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 31 tetor 2013, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI186/13, caktoi, gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Në të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI186/13, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.
7. Më 14 nëntor 2013, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi dokumentacion shtesë. Të njëjtën ditë, u njoftua edhe Gjykata Supreme.
8. Më 5 dhjetor 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

9. Në një datë të pacaktuar, A. Th. (në tekstin e mëtejme: i punësuari) inicioi në procedurë gjyqësore një kontest pune kundër parashtruesit si punëdhënës.
10. I punësuari ka qenë në marrëdhënie pune te parashtruesi me kontratë për kohë të caktuar.
11. Më 11 dhjetor 2009, parashtruesi ia shqipton të punësuarit një vërejte me shkrim (procesverbali nr. 1498) për shkak të performansës së dobët dhe mospërbushjes së detyrave të punës.

12. Më 2 prill 2010, parashtruesi e njoftoi (Vendimi: nr. 499/1) të punësuarin se marrëdhënia e punës ishte shkëputur “*në bazë shkak të nenit 11 pika (ë), (ç), nenit 11.4 pika (b) të Rregullores së UNMIK-ut 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë dhe nenit 8.1, 8.2 dhe 8.3 të Rregullores nr. 3 për operacionet e distrikteve të KEK-ut.*”
13. Më 6 prill 2010, i punësuar, kundër Vendimit nr. 499/1 për shkëputjen e marrëdhënies së punës, parashtoi kërkesë për rishqyrtimin e vendimit.
14. Më 12 prill 2010, drejtori i Divizionit të Furnizimit (Vendimi nr. 85) refuzoi kërkesën e të punësuarit për shqyrtimin e shkëputjes së marrëdhënies së tij të punës, pa dhënë arsye për shkaqet e refuzimit.
15. I punësuar ushtroi padi në Gjykatën Komunale të Prizrenit, duke pretenduar se vendimet e lartpërmendura ishin të kundërligjshme dhe duke kërkuar anulimin e tyre.
16. Më 23 maji 2011, Gjykata Komunale e Prizrenit (C. nr. 309/2010) e refuzoi si të pabazuar padinë të punësuarit.
17. I punësuar ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren “*për shkak të shkeljeve substanciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të ligjit material.*”
18. Më 24 shkurt 2011, Gjykata e Qarkut në Prizren, (Ac. nr. 362/2011), refuzoi ankesën e të punësuarit dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Prizrenit, duke arsyetuar si më poshtë:

“Sipas vlerësimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, aktgjyrimi i ankimuar nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 i LPK-së, për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Aktgjyrimi i ankimuar është i qartë, konkret nuk ka kundërthënie dhe përmban arsye të mjaftueshme mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështjeje juridiko civile. Në arsyetimin e tij janë dhënë arsyetime të duhura faktike dhe juridike të cilat si të drejta dhe të ligjshme i pranon edhe kjo gjykatë... Kështu, konkludimet e nxjerra kanë mbështetje në provat e administruara dhe ato jo vetëm që janë vërtetuar drejt, por edhe janë arsyetuar në mënyrë të plotë dhe të qartë.

Arsyet e dhëna në aktgjykimin e ankimuar i pranon edhe kjo gjykatë.”

19. I punësuar i parashtroi revizion në Gjykatën Supreme. I punësuar i “ushtroi revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të ligjit material, me propozim që të ndryshohen ose që të prishen që të dy aktgjykimet dhe padia (e parashtruesit) të aprovohet dhe të kthehet çështja në gjykatën e instancës së parë për rigjykim”.
20. Më 5 qershor 2013, Gjykata Supreme e Kosovës (Rev. 151/2013), aprovoi si të bazuar revizionin e të punësuarit dhe ndryshoi aktgjykimet e gjykatave të instancës së parë dhe të dytë. Gjykata Supreme arsyetoi si në vijim:

“Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimin të atakuar, konform dispozitës së nenit 215 të Ligjit mbi procedurën kontestimore (LPK), ka gjetur se: Revizionet janë të themelta.

Duke u nisur nga gjendja e vërtetuar faktike e çështjes, Gjykata Supreme ka gjetur se një qëndrim i tillë juridik i gjykatave të instancave më të ulëta nuk mund të pranohet si i drejtë dhe i ligjshëm ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate mbi gjendjen e vërtetuar faktike gabimisht është zbatuar e drejta materiale, kur të dy gjykatat kanë gjetur se kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar dhe si të tillë e kanë refuzuar, për të cilën arsye do të duhej që të pranohen revizioni i paditësit dhe përfaqësuesit e tij” si të bazuar dhe të ndryshohen aktgjykimet e atakuara dhe të aprovohet kërkesëpadija e paditësit si e bazuar, ashtu siç është përshkruar në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Supreme e Kosovës i vlerëson si të bazuara pretendimet e paditësit dhe të përfaqësuesit të tij të parashtruara në revizion se gjykatat e instancave më të ulëta gabimisht kanë aplikuar të drejtën materiale në dëm të paditësit kur kanë refuzuar kërkesëpadinë për anulimin e vendimeve si të kundërligjshme për shkeljet e kontratës së punës, ngase për këto shkelje e paditura nuk ka udhëhequr procedurë disiplinore, sepse në bazë të dispozitave të nenit 11. 2 të Ligjit mbi marrëdhënien e punës të Kosovës nr. 12/1989, i cili ka qenë në aplikim në bazë të Rregullores së Kosovës nr. 1999/24 deri në hyrje në fuqi të Ligjit të punës të Republikës së Kosovës nr. 03/L-212, në muajin dhjetor të vitit 2010, i cili ligj me dispozitën e nenit 99.1 shfuqizon Rregulloren e UNMIK-ut

nr. 2001/27 për Ligjin themelor të punës në Kosovë, Ligjin për narrëdhënie të punës të KSA të Kosovës, të vitit 1989 dhe Ligjin e punës të vitit 1977 me amendamentet përkatëse, është paraparë se organet e autorizuara kanë për detyrë të paraqesin kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore brenda 8 ditësh pasi të marrin vesh për shkeljet e detyrave të punës, ose për ndonjë shkelje tjetër të disiplinës së punës dhe për kryerësin, ndërsa sipas dispozitës së nenit 113 par. 2 është paraparë se para se të shqiptojë masën disiplinore, largim nga puna, organi punëdrejtues respektivisht punëtori i caktuar me autorizimet dhe përgjegjësitë e veçanta, ka për detyrë ta marrë në pyetje punëtorin.

Nga neni 11 i kontratës së punës e lidhur në mes të paditësit si punëmarrës dhe së paditurës si punëdhënës, është përcaktuar se kontrata e punës ndërpritet sipas nenit 11 dhe 12 të Ligjit themelor të punës në Kosovë, marrëveshjes kolektive dhe Rregullores së punës së KEK-ut.

Sipas nenit 24 të Kontratës së përgjithshme Kolektive, është paraparë se komisionin disiplinor e emëron punëdhënësi, gjegjësisht organi kompetent me aktin e përgjithshëm të punëdhënësit, ndërsa e paditura me Rregulloren mbi përgjegjësinë disiplinore dhe materiale të nxjerrë më 10 tetor 2000. Në pjesën II të kësaj rregulloreje në detaje janë përcaktuar dispozitat për zbatimin e procedurës disiplinore, e cila rregullore nuk është lënë jashtë fuqie me Rregulloren nr. 3 të 30 nëntorit 2009. Po ashtu, me asnjë dispozitë të Rregullores nr. 2001/27 për Ligjin themelor të punës në Kosovë, nuk është lënë jashtë fuqie Ligji mbi marrëdhëniet e punës nr. 1211989 i KSAK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës, nga arsyet e cekura si dhe të dhënat të cilat gjenden në shkresat e çështjes gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe atë për shkak se gjykatat e instancave më të ulëta gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale, do të duhej që të dy aktgjykimet e atyre gjykatave të ndryshohen dhe kërkesëpadia e paditësit si e tillë të aprovohet si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, “Gjykata ka gjykuar në bazë të ligjeve që nuk kanë qenë në fuqi, andaj aktgjykimi i saj është i paligjshëm dhe i padrejtë dhe si i tillë duhet të priset. KKEK Sh. a

është në dijeni që Gjykata Kushtetuese e Kosovës nuk vepron si shkallë IV, por ka juridiksion kushtetues që ta prishë-anulojë çdo akt juridik të cilit do organ, në qoftë se gjen se ka shkelje të dispozitave ligjore dhe atyre kushtetuese, e që për rastin konkret nuk është fare kontestuese se janë shkelur dispozitat ligjore duke aplikuar ligjet dhe aktet e tjera që nuk kanë qenë në fuqi.”

22. Prandaj, parashtruesi pretendon se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenin 31 dhe 102.3 të Kushtetutës, si rezultat i shkeljes së nenit 214.2 të Ligjit për procedurën kontestimore.
23. Për më tepër, parashtruesi shton se, *“bazuar në nenin 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ka të drejtë ligjore që të kërkojë të shqyrtohet ligjshmëria e një vendimi të autoriteteve publike, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike, andaj kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës që pas shqyrtimit të kërkesës të njëjtën ta aprovojë si të bazuar duke anuluar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 368/2011, të datës 2.5.2013”.*

Pranueshmëria e kërkesës

24. Gjykata, së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur të gjitha kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
25. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës:

113.7 “Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 21 [Parimet e Përgjithshme]

[...]

21.4 “Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”.

26. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton se:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

27. Për më tepër, Gjykata merr parasysh rregullin 36 (1) c) dhe rregullin 36 (2) të Rregullores së punës, që parashohin:

36 (1) “Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

[...]

(c) Kërkesa nuk është qartazi e pabazuar.

36 (2) “Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie;

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;

c) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë; ose

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

28. Gjykata vëren se, kërkesa e parashtruesit pretendon kryesisht në: (a) shkeljen e nenit 31 dhe 102.3 të Kushtetutës, dhe (b) shkeljen e dispozitave ligjore.

29. Përkitazi me pretendimin e parashtruesit për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka qartësuar se si dhe pse kjo e drejtë konkrete kushtetuese i është shkelur me vendimin e kontestuar, i cili pretendohet të kishte gjykuar “*duke zbatuar aktet tjera që nuk kanë qenë në fuqi*”.

30. Gjykata thekson se, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm ngërthen elemente të shumta dhe paraqet përbërës kyçë në mbrojtjen e të drejtave themelore të individit, nga shkeljet, kushtimisht, të shkaktuara nga gjykatat a autoritetet publike me vendimet e tyre.

31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, që qartazi përcakton se:

1. “Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.”

32. Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) gjithashtu përcakton se:

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile...”

33. Në këtë kontekst, parashtruesi nuk përcakton qartë se si dhe pse pretendimi se “zbatimi i akteve të tjera që nuk kanë qenë në fuqi” përbën një shkelje kushtetuese të të drejtave të tij themelore për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

34. Për më tepër, citati i gjerësishëm më lart i vendimit të Gjykatës Supreme tregon se vendimi i kontestuar ka dhënë arsytim të gjerësishëm dhe gjithëpërfshirës përkitazi me faktet e rastit dhe gjetjet e tyre.

35. Më tutje, pakënaqësia me vendimin ose thjesht përmendja e neneve dhe dispozitave të Kushtetutës nuk është e mjaftueshme që parashtruesi të ndërtojë një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendon në shkeljet e kushtetutës, parashtruesi duhet të ofrojë një argument bindës dhe të arsyetuar mirë në mënyrë që kërkesa të jetë e bazuar.

36. Si përmbledhje, parashtruesi nuk mbështet dhe nuk dëshmon që Gjykata Supreme, siç pretendon se duke gjykuar “në bazë të ligjeve që nuk ishin në fuqi”, ka shkelur të drejtat e tij kushtetuese.

37. Sa i përket pretendimit të parashtruesit për shkeljen e nenit 102.3 të Kushtetutës, “gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit”, Gjykata vlerëson se parashtruesi, edhe në këtë pretendim ka dështuar të argumentojë se me vendimin e kontestuar i është cenuar kjo e drejtë e garantuar me dispozitën e lartcekur të Kushtetutës, sepse i njëjti nuk ka ngritur ndonjë argument ose ndonjë dëshmi se Gjykata Supreme nuk ka respektuar dispozitat në fjalë.

38. Përkitazi me pretendimin e parashtruesit “*për shkeljen e dispozitave ligjore*”, Gjykata vlerëson se pretendimet e tilla janë të natyrës ligjore, dhe si të tilla nuk paraqesin bazë kushtetuese për shkeljen e të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutë.
39. Në fakt, Gjykata nuk shqyrton vendimet të gjykatave të rregullta për çështjet e ligjshmërisë, e as nuk shqyrton saktësinë e fakteve të çështjes, përveç nëse ka prova bindëse se vendimet e tilla janë marrë në një mënyrë qartazi të padrejtë dhe arbitrare.
40. Për më tepër, nuk është detyrë e Gjykatës të vendosë nëse Gjykata Supreme i ka shqyrtuar argumentete parashtrueseve për zgjidhjen e çështjeve juridike. Kjo mbetet edhe më tutje në juridiksionin e gjykatave të rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta që t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [GC], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
41. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është që të vlerësojë nëse gjatë procedurave në gjykatat e rregullta, gjykatat kanë shkelur ndonjë nga të drejtat themelore të garantuara me Kushtetutë.
42. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë, sepse parashtruesi nuk ka arritur t'i arsyetojë pretendimet e tij dhe të dorëzojë dëshmi për të mbështetur pretendimet për shkelje kushtetuese të shkaktuar nga vendimi i kontestuar.
43. Prandaj, në pajtim me rregullin 36 (2) b) dhe d) të Rregullores së punës, kërkesa e parashtruesit shpallet qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit, dhe në pajtim me rregullin 36. (2) b) dhe d), dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 5 dhjetor 2013, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI138/11, Nazife Xhafolli, Aktgjykim i datës 4 shkurt 2014 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 492/2008, të 10 marsit 2009

Rasti KI138/11, Vendimi i 4 shkurtit 2014.

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, Mbrojtja e Pronës, E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm.

Parashtruesja pretendon se me vendimin e KEK-ut ishin shkelur të drejtat e saj pronësore dhe e drejta për gjykim të drejtë, duke i anuluar në mënyrë të njëanshme marrëveshjet e tyre. Parashtruesja thekson më tej se ata nuk kanë pasur mundësi të korrigjojnë shkelje të tilla në gjykatat e rregullta.

Përveç kësaj, parashtruesja pretendon se KEK duhet të vazhdojë me pagesën e shumë s të caktuar edhe pas vdekjes së bashkëshortit të saj, deri në funksionimin e Fondit Pensional Invalidor.

Gjykata vëren që në rastin konkret, si në rastet e ngjashme, bashkëshorti i ndjerë i parashtrueses, që nga viti 2006 dhe deri me vdekjen e tij, pësoi nga ndërprerja e njëanshme e marrëveshjeve të nënshkruara nga KEK-u. Parashtruesja ka ngritur të njëjtin argument ashtu si parashtruesit e mëhershëm, në kuptimin se është vërtetuar që Fondi Pensional dhe Invalidor nuk është themeluar deri më sot dhe se ekziston një situatë e vazhdueshme. Meqenëse rrethanat në bazë të të cilave parashtruesit kanë paraqitur ankesat e tyre kanë vazhduar, atëherë afati prej katër (4) muajve siç përcaktohet me nenin 49 të Ligjit, nuk është i zbatueshëm për këto raste.

Gjykata Kushtetuese gjithashtu vëren se bashkëshorti i ndjerë i parashtrueses S. XH. nuk ka qenë më i vjetër se 65 vjet, në kohën e vdekjes së tij. Në të vërtetë, sipas njoftimit të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, më 15 maj 2009, vetëm personave që e kanë arritur moshën e pensionimit prej 65-vjetësh, dhe që i kanë së paku 15 vjet përvojë pune u takon pensioni në shumë mujore prej 82 eurove.

Gjykata Kushtetuese, më 5 dhjetor 2013, njëzëri deklaroi kërkesën pjesërisht e pranueshme dhe konstatoi shkelje të nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për periudhën deri më 1 maj 2008, si dhe shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për periudhën deri më 1 maj 2008.

AKTGJYKIM
në
Rastin Nr. KI138/11
Parashtrues
Nazife Xhafolli
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme,
Rev. nr. 492/2008, të 10 marsit 2009

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan,
gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova,
gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar,
dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga znj. Nazife Xhafolli(në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 492/2009, i 10 marsit 2009, të cilin parashtruesja e ka pranuar në një datë të pacaktuar.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, i cili pretendohet t'i ketë shkelur parashtrueses së kërkesës të drejtën pronësore dhe të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të

Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ), respektivisht me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Ky rast është i ngjashëm me rastet vijuese, për të cilat Gjykata Kushtetuese tashmë ka vendosur (në tekstin e mëtejshëm: rastet identike):

- a) Rasti Nr. KI40/09, “Imer Ibrahimimi dhe 48 ish-punëtorë tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës kundër 49 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës”;
 - b) Rasti Nr. KI58/09, “Gani Prokshi dhe 15 ish-punëtorë tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës kundër 16 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës”;
 - b) Rasti Nr. KIo8/10, “Isuf Mërlaku dhe 25 ish-punëtorë tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës kundër 17 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës”;
 - c) Rasti Nr. KI76/10, “Ilaz Halili dhe 19 ish-punëtorë tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës” dhe
 - e) Rasti Nr. KI132/10, “Istref Halili dhe 16 ish-punëtorë tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës kundër 17 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës”.
4. Gjykata konstatoi se në të gjitha rastet identike ka pasur shkelje të nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Mbrojtja e Pronës), në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, si dhe nenit 31 të Kushtetutës (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm), në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, lidhur me disa nga parashtruesit e lartpërmendur.
 5. Rrjedhimisht, Gjykata vendosi t’i shpallë të pavlefshme aktgjykimet e nxjerra nga Gjykata Supreme në rastet identike dhe t’ia kthejë ato raste Gjykatës Supreme për rivendosje, në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 20 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 21 tetor 2011, parashtruesja parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese. Në kohën e dorëzimit, kërkesa ishte dorëzuar me disa mangësi (përkatësisht nuk ishte nënshkruar). Pas komunikimit me parashtruesen, formulari i kërkesës u nënshkrua kah mesi i vitit 2013. Kërkesa u shqyrtua pas kompletimit nga ana e parashtrueses.
8. Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
9. Më 5 dhjetor 2013, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i paraqiti Gjykatës rekomandimin për pranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Në përgjithësi, faktet e kësaj kërkesë janë të ngjashme me rastet e lartpërmendura në pikën 4.
11. Në të vërtetë, gjatë vitit 2001 dhe 2002, bashkëshorti i ndjerë i parashtrueses nënshkroi marrëveshje për kompensim të përkohshëm të pagesës për shërbime të kontratës së punës me punëdhënësin e tij, Korporatën Energjetike të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KEK).
12. Neni 1 i marrëveshjes përcaktoi se, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit për Sigurim Pensional dhe Invalidor në Kosovë, (Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës nr. 26/83, 26/86 dhe 11/88) dhe konstatimit të Komisionit Invalidor të KEK-ut, përfutuesi (d.m.th. secili parashtrues) ka të drejtë për kompensim të përkohshëm për ndërprerje të hershme të

marrëdhënies së punës, deri në themelimin dhe funksionimin e Fondit të Kosovës për Sigurim Pensional dhe Invalidor.

13. Për më tepër, neni 2 i Marrëveshjes përcaktoi se shuma mujore që duhet t'i paguhet bashkëshortit të ndjerë të parashtrueses ishte 206 marka gjermane.
14. Përveç kësaj, neni 3 i Marrëveshjes, përcaktoi që “pagesa do të përfundojë në ditën e funksionalizimit të Fondit të Kosovës për Sigurim Pensional dhe Invalidor. Prej asaj dite e tutje, shfrytëzuesi mund t'i realizojë të drejtat e veta në Fondin e Kosovës për Sigurim Pensional dhe Invalidor (Fondi Pensional Invalidor i Kosovës), dhe KEK-ut do t'i hiqen obligimet ndaj shfrytëzuesit, sipas kësaj Marrëveshjeje”.
15. Më 1 nëntor 2002, Bordi Ekzekutiv i KEK-ut miratoi një vendim për themelimin e Fondit Pensional, në përputhje me kriteret e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/30 për pensionet në Kosovë. Neni 3 i këtij vendimi thotë: "Fondi Pensional do të vazhdojë të ekzistojë për një periudhë të pacaktuar kohore, në pajtim me kriteret dhe përgjegjësitë e përcaktuara me ligjet për pensione, të miratuara nga Bordi i Fondit Pensional dhe KEK-u, në përputhje me këtë vendim, apo derisa kushtet ligjore për ekzistimin dhe funksionimin e Fondit të jenë në përputhje me rregulloret për pension ose rregullat për pension të miratuara nga ABPK-ja”.
16. Më 25 korrik 2006, Bordi Ekzekutiv i KEK-ut e anuloi vendimin në fjalë për themelimin e Fondit Pensional Suplementar dhe ndërpreu financimin dhe punën e Fondit Pensional Suplementar, që nga 31 korriku 2006.
17. Sipas vendimit të 25 korrikut 2006, të gjithë përfituesve u garantohej pagesa e plotë në përputhje me statutin e Fondit. Vendimi më tutje thotë se punëtorët e KEK-ut të cilët Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale i pranon si persona me aftësi të kufizuar për punë do t'i gëzojnë të drejtat e parapara nga Ministria.
18. Më 14 nëntor 2006, KEK-u e informoi Autoritetin Qendror Bankar se "vendimi për revokimin e Fondit Pensional të KEK-ut bazohet në vendimin e Bordit Ekzekutiv të KEK-ut dhe në vendimin e

Bordit Menaxhues për Pensione... për shkak të rrezikut financiar që kjo skemë paraqet për KEK-un në të ardhmen".

19. Në verën e vitit 2006, KEK-u ndërpreu pagesën e paraparë me marrëveshje pa asnjë njoftim.
20. Bashkëshorti i ndjerë i parashtrueses ngriti padi kundër KEK-ut në Gjykatën Komunale në Prishtinë, me të cilën kërkonte që Gjykata ta urdhëronte KEK-un t'ua paguante pagesat e papaguara dhe të vazhdonte t'ua paguante nga 105 euro, (që është e barabartë me 206 marka gjermane) deri në përmbushjen e kushteve për ndërprerjen e pagesës.
21. Më 14 dhjetor 2007, Gjykata Komunale në Prishtinë e aprovoi padinë e parashtruesit (Aktgjykimi C. nr. 2216/06) dhe urdhëroi kompensimin monetar. Gjykata Komunale e Prishtinës gjeti se kushtet e parapara me nenin 3 të Marrëveshjes nuk ishin plotësuar. Neni 3 i Marrëveshjes parasheh kompensimin e pagës deri në realizimin e së drejtës së parashtruesit, "që do të thotë e drejta në skemën e pensionit".
22. KEK-u paraqiti ankesë kundër aktgjykimeve të Gjykatës Komonale në Gjykatën e Qarkut, duke thënë, ndër të tjera, se aktgjykimi i Gjykatës Komonale nuk ishte i drejtë sepse marrëveshjet ishin nënshkruar me parashtruesit për shkak të invaliditetit të parashtruesve të kërkesës dhe se nuk mund të kërkojnë vazhdimin e marrëdhënies së tyre të punës për shkak të invaliditetit të tyre. KEK-u ritheksoi se Gjykata ishte e detyruar të vendoste duke u bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2003/40 për shpalljen e Ligjit për Pensionet Invalidore, sipas të cilit parashtruesit kishin të drejtë për pension invalidor.
23. Më 21 korrik 2008, Gjykata e Qarkut (Aktgjykimi Ac. nr. 391/2008) i refuzoi ankesat e KEK-ut si të pabazuara.
24. KEK parashtroi revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkeljen thelbësore të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. KEK përsëriti që parashtruesit kishin të drejtë për pension sipas Ligjit 2003/40, dhe se ajo për shkak të arsyeve humanitare, kishte vazhduar të paguante kompensimet mujore edhe pas hyrjes në fuqi të Ligjit. KEK pohonte më tej që nuk ishte në pyetje moshë e parashtruesit, por invaliditeti i tij.

25. Më 1 maj 2008, bashkëshorti i parashtrueses S. XH. ndërroi jetë.
26. Më 22 shtator 2008, Gjykata Komunale në Prishtinë, (Vendimi T. nr. 356/2008) e shpall parashtruesen trashëgimtare të vetme të pasurisë së luajtshme të bashkëshortit të saj të ndjerë.
27. Më 10 mars 2009, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 492/2008) e refuzoi si të pabazuar padinë e S. XH. dhe i prishi aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut dhe të Gjykatës Komunale. Gjykata Supremeerdhi në përfundim se ndërprerja e punësimit ishte e ligjshme, në pajtim me nenin 11.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë.
28. Në Aktgjykimin e S. XH. (Rev. nr. 492/2008 të 10 marsit 2009), Gjykata Supreme theksoi: *“Duke marrë parasysh faktin e pakontestueshëm që pala e paditur e ka përmbushur obligimin ndaj paditësit, që është pagesa e kompensimit të pagave sipas periudhës së specifikuar, që është deri në themelimin dhe funksionimin e Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor në Kosovë, në fuqi prej 1 janarit 2004, Gjykata vërejtë që pala e paditur e ka kryer obligimin sipas marrëveshjes. Kështu, pohimet e paditësit që pala e paditur ka për obligim t’ia paguajë atij kompensimin e përkohshëm të pagave pas themelimit të Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor në Kosovë konsiderohen nga kjo Gjykatë si të pabazuara për shkak se palët kontraktuese, deri në shfaqjen e kushtit shfuqizues - themelimin e fondit të lartpërmendur, i kanë kryer obligimet e tyre kontraktuese...”*.
29. Më 15 maj 2009, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale të Kosovës lëshoi këtë njoftim: *“Konstatimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, në arsyetimin e vet të p.sh. Aktgjykimi Rev. Nr. 454/2008, që në Republikën e Kosovës ekziston Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor që është funksional që nga 1 janari 2004, nuk është i saktë dhe është i pabazuar. Ne dhënien e kësaj deklarate, ne kemi parasysh faktin që Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/40 shpall Ligjin Nr. 2003/213 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar në Kosovë, i cili i rregullon rastet e personave me paafhtësi të përhershme, të cilët mund të gëzojnë këtë skemë në pajtim me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë ligj. Prandaj, më lejoni të theksoj që dispozitat e këtij Ligji nuk parashikojnë themelimin e Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor të vendit. Themelimi i Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor në Republikën e Kosovës*

përcaktohet me Ligjin për Sigurim Pensional dhe Invalidor i cili është në proces të hartimit dhe miratimit në Qeverinë e Kosovës". Në të njëjtin njoftim shpjegohej që në kohën e shkrimit të atij njoftimi, pensioni inter alia ekzistonte "pensioni invalidor në shumë prej 45 eurove, siç rregullohet me Ligjin për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar (përfitues të tyre janë të gjithë personat me aftësi të kufizuara të plote dhe të përhershme)", si dhe "pensionet e kontributdhënësve prej 82 eurove, që rregullohen me vendim të Qeverisë (përfitues të të cilit janë gjithë pensionistet që e kanë arritur moshën e pensionimit prej 65-vjetësh, si dhe të cilët kanë së paku 5 vjet përvojë pune)".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

30. Parashtruesja pretendon se ndërprerja e pagesës është në kundërshtim me marrëveshjen e nënshkruar.
31. Parashtruesja gjithashtu pretendon se dihet shumë mirë se Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Kosovës, nuk është themeluar ende. Në anën tjetër, në rastin Nr. KI40/09, KEK i kontestoi pretendimet e parashtruesve, duke theksuar se botërisht dihet se Fondi Pensional dhe Invalidor është funksional që nga 1 janari 2004.
32. Sipas KEK-ut, bashkëshorti i ndjerë i parashtrueses ishte mbuluar automatikisht me skemën kombëtare invalidore, në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2003/40 për shpalljen e Ligjit për Pensionet Invalidore në Kosovë (Ligji Nr. 2003/23).
33. KEK-u më tutje pohoi që më 31 gusht 2006, lëshoi një njoftim, sipas të cilit të gjithë përfituesit e Fondit Suplementar të KEK-ut ishin njoftuar se Fondi ishte mbyllur. I njëjti njoftim konfirmonte se të gjithë përfituesve u garantohej pagesa e plotë në përputhje me Statutin e FPS-së, që do të thotë 60 muaj pagesë ose derisa përfituesit ta arrijnë moshën 65-vjeçare, në përputhje me Vendimin e Bordit Menaxhues të Fondit Pensional të 29 gushtit 2006.
34. KEK-u pohoi më tej që parashtruesja nuk i kishte kontestuar udhëzimet për pension invalidor dhe nënshkrimin për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës në përputhje me konkluzionet e Komisionit Invalidor.

35. Si përmbledhje, parashtruesja pretendon se me vendimin e KEK-ut ishin shkelur të drejtat e saj pronësore dhe e drejta për gjykim të drejtë, duke i anuluar në mënyrë të njëanshme marrëveshjet e tyre. Parashtruesja thekson më tej se ata nuk kanë pasur mundësi të korrigjojnë shkelje të tilla në gjykatat e rregullta.
36. Përveç kësaj, parashtruesja pretendon se KEK duhet të vazhdojë me pagesën e shumës së caktuar edhe pas vdekjes së bashkëshortit të saj, deri në funksionimin e Fondit Pensional Invalidor.

Pranueshmëria e kërkesës

37. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesja i ka përmbushur kriteret e përcaktuara me Kushtetutë dhe Ligj.
38. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

39. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47.2 dhe 49 të Ligjit. Neni 47.2 parasheh se *"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*. Neni 49 parasheh se *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve (...)"*.
40. Gjykata vëren që në rastin konkret, si në rastet e ngjashme, bashkëshorti i ndjerë i parashtrueses, që nga viti 2006 dhe deri me vdekjen e tij, pësoi nga ndërprerja e njëanshme e marrëveshjeve të nënshkruara nga KEK-u. Parashtruesja ka ngritur të njëjtin argument ashtu si parashtruesit e mëhershëm, në kuptimin se është vërtetuar që Fondi Pensional dhe Invalidor nuk është themeluar deri më sot dhe se ekziston një situatë e vazhdueshme. Meqenëse rrethanat në bazë të të cilave parashtruesit kanë paraqitur ankesat e tyre kanë vazhduar, atëherë afati prej katër (4) muajve siç përcaktohet me nenin 49 të Ligjit, nuk është i zbatueshëm për këto raste.
41. Gjykata Kushtetuese gjithashtu vëren se bashkëshorti i ndjerë i parashtrueses S. XH. nuk ka qenë më i vjetër se 65 vjet, në kohën e vdekjes së tij. Në të vërtetë,

sipas njoftimit të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, më 15 maj 2009, vetëm personave që e kanë arritur moshën e pensionimit prej 65-vjetësh, dhe që i kanë së paku 15 vjetë përvojë pune u takon pensioni në shumë mujore prej 82 eurove.

42. Thelbi i këtij njoftimi u konfirmua nga përfaqësuesi i Ministrisë në seancën publike që Gjykata Kushtetuese e mbajti më 30 prill 2010, në rastin "Ibrahimi dhe të tjerët".
 43. Çështja që duhet shqyrtuar në këtë rast është nëse parashtruesja e kërkesës mund të konsiderohet të ketë "statusin e viktimës".
 44. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se një person mund të pretendojë se është prekur drejtpërdrejt si pasojë e shkeljes së të drejtave të bashkëshortit të saj, duke u ankuar se dëmtimi i pronës së bashkëshortit të saj të ndjerë e ka prekur pronën e saj.
 45. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesja e ka statusin e viktimës, duke marrë parasysh faktin se ankesa në fjalë, mund të konsiderohet e transferueshme, dhe njëkohësisht duke e marrë parasysh edhe Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, (Aktvendimi T. nr. 356/2008) me të cilin parashtruesja është shpallur si trashëgimtare e vetme e tërë pasurisë së luajtshme të bashkëshortit të saj të ndjerë.
 46. Prandaj, kërkesa e parashtrueses është pjesërisht e pranueshme.
- Aspektet substanciale të kërkesës** (në lidhje me periudhën 2006-2008)

i. Sa i përket Mbrojtjes së Pronës

47. Parashtruesja ankohet se i janë shkelur të drejtat për shkak se KEK e ka anuluar në mënyrë të njëanshme marrëveshjen e nënshkruar nga bashkëshorti i saj i ndjerë, edhe pse kushti i përcaktuar me nenin 3 (pra themelimi i Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor) nuk ishte përmbushur. Në thelb, parashtruesja ankohet se ka pasur shkelje të të drejtave të saj pronësore.
48. Që në fillim, duhet rikujtuar nenin 46 dhe 53 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës thekson:

- “1. E drejta e pronës është e garantuar.*
- 2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
- 3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet”.*

Neni 1 i Protokollit nr. 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përcakton:

“Secili person fizik apo juridik ka të drejtë të gëzojë posedimet e tij në mënyrë të qetë. Askush nuk mund të privohet nga posedimet e tij/saj përveç për interes publik si dhe duke iu nënshtruar kushteve të përcaktuara me ligj, si dhe me parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Megjithatë, dispozitat paravajtëse nuk do të pengojnë në asnjë mënyrë të drejtën e Shtetit që të zbatojë ligje që i konsideron të domosdoshme për kontrollimin e shfrytëzimit të pronës në pajtim me interesin e përgjithshëm, apo për të siguruar pagesën e tatimeve apo kontributeve e dënimeve tjera”.

49. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një parashtrues mund të pretendojë shkeljen e nenit 1 të Protokollit nr. 1 vetëm deri në atë masë në të cilën vendimet e kundërshtuara kanë të bëjnë me "posedimet" e tij në kuptim të kësaj dispozite.
50. Për më tepër, "posedimet" mund të jenë ose "posedime ekzistuese" ose asete, duke i përfshirë kërkesat, në kuptimin e të cilave parashtruesi mund të argumentojë që ai apo ajo ka së paku "pritje

legjitime" të fitimit dhe gëzimit efektiv të një të drejte pronësore. Në kundërshtim me këtë, shpresa e njohjes së një të drejte pronësore e cila ka qenë e pamundur të ushtrohet në mënyrë efektive, nuk mund të konsiderohet "posedim" sipas kuptimit të nenit 1 të Protokollit nr. 1, dhe as kërkesa me kusht, e cila mbaron si rezultat i mospërbushjes së kushtit" (Shih aktgjykimet në rastet identike).

51. Çështja që duhet shqyrtuar në këtë rast është nëse rrethanat e rastit, të marra si tërësi, i japin parashtrueses pronësi ndaj një interesi thelbësor të garantuar me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së (Shih aktgjykimet për rastet identike).
52. Gjykata vëren se në kohën e nënshkrimit të marrëveshjeve ndërmjet bashkëshortit të ndjerë të parashtrueses dhe KEK-ut, ky lloj i marrëveshjeve ka qenë i rregulluar me Ligjin për Marrëdhëniet Detyrimore (Ligji për Obligimet), të shpallur në Gazetën Zyrtare të RSFJ-së 29/1978 dhe të ndryshuar në 39/1985, 45/1989, 57/1989.

Neni 74 (3) i Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore thotë me sa vijon:

"Pas lidhjes sipas kushtit shfuqizues, kontrata pushon të jetë e vlefshme pasi ai kusht është i vlefshëm".

53. Prandaj, thelbi i çështjes është nëse është përmbushur kushti shfuqizues sipas të cilit marrëveshja ishte nënshkruar. Përgjigja në këtë pyetje do t'i mundësojë Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë nëse rrethanat e kësaj kërkesë, të shqyrtuara si tërësi, i japin parashtrueses të drejtën ndaj interesit thelbësor të mbrojtur me nenin 1, Protokollin nr. 1 të KEDNJ-së.
54. Gjykata Kushtetuese vëren se është e pakontestueshme ndërmjet palëve, se "kushti shfuqizues", sipas të cilit janë nënshkruar marrëveshjet, është themelimi dhe funksionimi i Fondit të Kosovës për Sigurim Pensional dhe Invalidor.
55. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese vëren që sipas Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, themelimi i Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor do të duhej të parashikohej me Ligjin për Fondin për Sigurim Pensional dhe Invalidor. Ky ka qenë në proces të hartimit dhe miratimit në Qeverinë e Kosovës.

56. Gjykata Kushtetuese konsideron se bashkëshorti i ndjerë i parashtrueses, me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes me KEK-un, ka pasur pritje legjitime që do të gëzonte dëmshpërblim mujor në shumë prej 105 eurove, deri në themelimin e Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor.
57. Një pritje e tillë legjitime garantohet me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, natyra e saj është konkrete, dhe jo vetëm shpresë e thjeshtë, dhe bazohet në një dispozitë ligjore apo akt ligjor, d.m.th. në marrëveshjen me KEK-un (aktgjykimet për rastet identike; po ashtu, *mutatis mutandis*, Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës së Çekisë (vendim), nr. 39794/98, paragrafi 73, ECHR 2002-VII).
58. Prandaj, Gjykata Kushtetuese konsideron se bashkëshorti i ndjerë i parashtrueses ka pasur "pritje legjitime" që kërkesa do të trajtohej në pajtim me ligjet në fuqi, në veçanti në pajtim me dispozitat e lartpërmendura të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore dhe të Ligjit për Sigurim Pensional dhe Invalidor në Kosovë, dhe si rrjedhojë do të miratohej (shih aktgjykimet për rastet identike).
59. Megjithatë, anulimi i njëanshëm i Marrëveshjes, para përmbushjes së kushtit shfuqizues, i ka shkelur interesat materiale të S. XH. që ishin të njohura me ligj dhe të mbrojtura me nenin 1 të Protokollit nr. 1 (shih aktgjykimet për rastet identike).
60. Si rrjedhojë, Gjykata Kushtetuese konstaton se ka shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

ii. Sa i përket të drejtës për gjykim të drejtë

61. Parashtruesja më tej ankohet se nuk ka qenë në gjendje të zhdëmtohet për shkeljen e të drejtave të saj pronësore në gjykatat e rregullta.
62. Gjykata i referohet nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës thotë me sa vijon:

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike”.

Neni 6 i KEDNJ-së thotë:

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet ... nga [një] gjykatë ... e cila do të vendosë në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile...”.

63. Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, që të veprojë si gjykatë apeli, apo gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta, duke përfshirë Gjykatën Supreme. Në përgjithësi, "gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit" (neni 102 i Kushtetutës). Më saktësisht, roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
64. Në anën tjetër, “Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe të pajtueshmërisë së ligjeve me Kushtetutën” (neni 112.1 i Kushtetutës). Pra, Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë përkatëse dhe nëse procedurat në përgjithësi, shikuar në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë ashtu që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, miratuar më 10 korrik 1991).
65. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së i obligon gjykatat që të japin arsyetime për aktgjykimet e tyre, por kjo nuk mund të kuptohet si kërkesë për përgjigje të hollësishme për secilin argument. Përmasa në të cilën zbatohet detyra e ofrimit të arsyetimeve mund të dallojë varësisht nga natyra e vendimit.
66. Për më tepër, është e domosdoshme të merret parasysh, ndër të tjera, shumëllojshmëria e parashtrësve që një palë mund të dorëzojë në gjykata dhe dallimet që ekzistojnë në shtetet kontraktuese lidhur me dispozitat ligjore, rregullat zakonore, mendimet juridike si dhe paraqitjen dhe hartimin e aktgjyimeve.

Prandaj, çështja nëse gjykatat kanë dështuar në përmbushjen e obligimit të parashtrimit të arsyeve, që burojnë nga neni 6 i Konventës, mund të përcaktohet vetëm në bazë të rrethanave të rastit (shih aktgjykimet në rastet identike).

67. Në rastin konkret, parashtruesja e kërkesës ka kërkuar nga gjykatat e rregullta të vendosin për mosmarrëveshjen pronësore me KEK-un. Parashtruesja i është referuar në veçanti dispozitës së nenit 3 të Marrëveshjeve, duke theksuar se Ligji për Pensionet, që themelon Fondin për Sigurim Pensional dhe Invalidor, nuk është miratuar ende. Ky fakt është vërtetuar nga përfaqësuesi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.
68. Megjithatë, Gjykata Supreme nuk ka bërë asnjë përpjekje për t'i analizuar paditë e parashtrueseve nga ky këndvështrim, përkundër referencës së qartë para çdo instance tjetër gjyqësore. Në vend të kësaj, pikëpamja e Gjykatës Supreme ka qenë se është fakt i pamohueshëm që pala kundërshtare (KEK) i ka përmbushur obligimet e veta ndaj paditësit, që ka qenë pagesa e kompensimit të pagave sipas afatit të përcaktuar deri në themelimin dhe funksionimin e Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor në Kosovë, në fuqi nga 1 janari 2004.
69. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të vendosë se cila do të ishte mënyra më e mirë që gjykatat e rregullta t'i trajtojnë argumentet e parashtruesve, d.m.th., përmbushjen e kushtit shfuqizues të nenit 3 të marrëveshjeve, përmbushje kjo që përcaktohet po ashtu me nenin 74 (3) të Ligjit për Marrëdhëniet Detyimore i marrë në lidhje me nenin 18 të Ligjit për Sigurim Pensional dhe Invalidor të vitit 1983.
70. Megjithatë, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme duke shpërfillur në tërësi vlerësimin e kësaj pike, edhe pse ishte specifike, relevante dhe e rëndësishme, ka dështuar në obligimin e saj sipas nenit 6 të paragrafit 1 të KEDNJ-së (shih rastet identike).
71. Nga sa u tha më lart, Gjykata Kushtetuese konkludon se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
72. Lidhur me periudhën pas 1 majit 2008, dhe në lidhje me arsyetimin e Gjykatës Kushtetuese në aktgjykimet e saj të mëparshme përkritazi me ish-punëtorët e KEK-ut, i njëjti nuk mund të zbatohet në rastin e parashtrueses pas 1 majit 2008, (data kur

bashkëshorti i ndjerë i parashtrueses kishte ndërruar jetë) për arsye se parashtruesja nuk ka qenë nënshkruese e marrëveshjes së nënshkruar me KEK-un dhe si e tillë është e natyrës jo të transferueshme (Shih Aktvendimin për papranueshmëri në rastin Vahide Hasani dhe 8 të tjerë, të 22 janarit 2012).

PËR KËTO ARSYE GJYKATA NJËZËRI VENDOS:

- I. TË SHPALLË pjesërisht të pranueshme kërkesën KI138/11, e parashtruar nga parashtruesja Nazife Xhafolli;
- II. TË KONSTATOJË QË:
 - a) Ka pasur shkelje të nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për periudhën deri më 1 maj 2008;
 - b) Ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për periudhën deri më 1 maj 2008;
- III. TA SHPALLË TË PAVLEFSHËMaktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 492/2009, të 10 marsit 2009;
- IV. T'IA KTHEJËkëtë aktgjykim Gjykatës Supreme për rishqyrtim në pajtim me aktgjykimin e kësaj Gjykate, në mbështetje të rregullit 74 (1) të Rregullores së Punës;
- V. TA URDHËROJËGjykatën Supreme që t'i paraqesë Gjykatës Kushtetuese informacione lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në pajtueshmëri me rregullin 63 (5) të Rregullores së Punës;

- VI. T'UA KUMTOJËkëtë aktgjykim palëve;
- VII. TA PUBLIKOJËkëtë aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;
- VIII. TË SHPALLËse ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë;
- IX. TË MBETETfuqimisht e angazhuar në këtë çështje në pritje të zbatimit të këtij Urdhri.

Përgatitur në Prishtinë, më 4 shkurt 2014

Gjyqtari raportues
Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI185/13, Korporata Energjetike e Kosovës, Aktvendim i datës 18 shkurt 2014- Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. Nr. 368/2011, të 2 majit 2013

Rasti KI185/13, vendimi i 18 shkurtit 2014

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm qartazi e pabazuar,

Parashtruesi i kërkesës, Korporata Energjetike e Kosovës parashtroi kërkesë në pajtim me nenin 113.7 dhe nenin 21.4 të Kushtetutës së Kosovës, duke kontestuar Aktgjykimin, e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 368/2011, të 2 majit 2013, si të nxjerrë me shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sepse gjykata e rregullt e kishte gjykuar rastin bazuar në ligj që nuk ishte në fuqi.

Lidhur me çështjen e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata konstatoi se kërkesa ishte e papranueshme, sepse parashtruesi i kërkesës nuk kishte paraqitur dëshmi se procedurat relevante ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare. Prandaj, Gjykata konstatoi se kërkesa ishte qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (2) b) të Rregullores së punës.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI185/13
Parashtrues
Korporata Energjetike e Kosovës
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. Nr. 368/2011,
të 2 majit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almira Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharava, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Korporata Energjetike e Kosovës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi), me selinë kryesore të afarizmit në Prishtinë, e cila përfaqësohet nga z. Bilall Fetahu, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktgjykimin Rev. Nr. 368/2011, të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 2 majit 2013, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 9 korrik 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet të ketë shkelur të drejtën e parashtruesit për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-131, (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 28 tetor 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 31 tetor 2013, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues si gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 15 nëntor 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi autorizimin, të cilin parashtruesi ende nuk e kishte dorëzuar. Në ditën e njëjtë, Gjykata Supreme dhe pala e tretë, P. D., u informuan në lidhje me regjistrimin e kërkesës, përmes një kopjeje të kërkesës.
8. Më 6 dhjetor 2013, parashtruesi dorëzoi autorizimin, në të cilën thuhet se parashtruesi përfaqësohet nga Bilall Fetahu.
9. Më 13 dhjetor 2013, parashtruesi më tej dorëzoi dokumente shtesë.
10. Më 7 shkurt 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Në një datë të pacaktuar, P. D. (në tekstin e mëtejme: punëmarrësi) inicioi procedurë gjyqësore lidhur me kontestin e punës kundër parashtruesit si punëdhënës.
12. Punëmarrësi ishte në marrëdhënie pune te parashtruesi për një periudhë të pacaktuar kohore (kontrata e punës Nr. 9260/O, e 1 shkurtit 2010) derisa njëra nga palët nuk e ndërprente kontratën.

13. Më 25 mars 2010, parashtruesi shqiptoi vërejtjen e fundit me shkrim (procesverbali Nr. 532) ndaj punëmarrësit *“për shkak të mospërbushjes së performancës për 3 (tre) muajt e fundit, dhe atë dhjetor 2009, janar dhe shkurt 2010”*.
14. Më 19 nëntor 2010, parashtruesi e njoftoi punëmarrësin (njoftimi Nr. 2399) se kontrata e punës do t'i ndërpritej *“për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës, të përcaktuara në nenin 11.1 (11.1 ç), 11.4 (b) të Rregullores 2001/28 për Ligjin Themelor të Punës, rezultateve të pakënaqshme në punë nga neni 8.1, 8.2, 8.3 (c), 8.4 (a) të Rregullores për muajin tetor 2010”*.
15. Më 29 nëntor 2010, drejtori i Divizionit të Furnizimit (Vendimi Nr. 2399, i 12 nëntorit 2010, dhe Vendimi Nr. 417, i 29 nëntorit 2010) e refuzoi kërkesën e punëmarrësit për shqyrtimin e ndërprerjes së kontratës së tij të punës.
16. Punëmarrësi paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Gjakovë, duke pretenduar se vendimet e lartcekura ishin të paligjshme dhe kërkoj anulimin e tyre.
17. Më 7 prill 2011, Gjykata Komunale (C. Nr. 560/10) e refuzoi si të pabazuar padinë e punëmarrësit.
18. Punëmarrësi ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë, *“për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale”*.
19. Më 30 shtator 2011, Gjykata e Qarkut (Ac. Nr. 253/2011) e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale (C. Nr. 560/10) të 7 prillit 2011 dhe e refuzoi ankesën e punëmarrësit. Gjykata e Qarkut arsyetoi se:

“[A]ktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 të LPK, të cilat i heton dhe vështron gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK, për shkak të së cilave nuk do të kishte mundësi të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i qartë, i kuptueshëm, dispozitivi nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e theksuara në arsyetim, si dhe përmban arsye të mjaftuara bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare për të vendosur në këtë çështje juridike. Për shkak të hetimit të

rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore dhe se faktet vendimtare janë vërtetuar me provat e sigurta, gjykata e shkallës së parë drejt e ka zbatuar edhe të drejtën materiale”.

20. Punëmarrësi ushtroi revizion në Gjykatën Supreme, “për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të dy aktgjykimet të ndryshohen dhe të aprovohet kërkesëpadia e paditësit [punëmarrësit] apo të prishen dhe çështja t’i kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë”.
21. Më 2 maj 2013, Gjykata Supreme e Kosovës (Rev. Nr. 368/2011) e pranoi si të bazuar revizionin e punëmarrësit dhe i ndryshoi aktgjykimet e shkallës së parë dhe të dytë. Gjykata Supreme arsyetoi si në vijim:

“Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas dispozitës së nenit 215 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se: Revizioni është i themeltë”.

...

“Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e vërtetuar faktike e çështjes, ka gjetur se një qëndrim i tillë juridik i gjykatave të instancës më të ulët nuk mund të pranohet si i drejtë dhe i ligjshëm nga se sipas vlerësimit të kësaj gjykate mbi gjendje e tillë të vërtetuar faktike gabimisht është zbatuar e drejta materiale, kur të dy gjykatat kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit [i punësuar] është e pa bazuar dhe si të tillë e kanë refuzuar, për të cilën arsye u deshtë që të pranohet revizioni i paditësit [i punësuar] si i bazuar, siç është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi”.

“Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët gabimisht kanë aplikuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se vendimi i të paditurës [parashtruesi] për shkëputjen e kontratës së punës është i ligjshëm, nga se nga provat që gjenden në shkresa të lëndës dhe atë Njoftimi mbi shkëputjen e kontratës së punës, Vendimi nr. 417 datë 29.11.2010 nuk rezulton se e paditura [i punësuar] para marrjes së vendimeve të kundërshtuara ka vepruar në kuptim të nenit 8.4 (a), (b) të Rregullores nr. 3 Për operacionet e distriktit të KEK-ut, sipas të cilës dispozitë është paraparë se: Menaxheri i Distriktit do të aranzhoj një takim me punonjësin

në fjalë me qëllim të paraqitjes me shkrim të njoftimit për largimi nga puna të punonjësit dhe të jap shpjegim verbal për arsyet e largimit. Nëse punonjësi është njoftuar rreth takimit dhe nuk merr pjesë, Menaxheri i Distriktit mund të vendos njoftimi në tabelën e njoftimeve publike të zyrës së distriktit, kurse veprimi i tillë do të konsiderohet si njoftim me qëllim të shkëputjes së kontratës së punës, sipas pikës (b) të njëjtit nen është paraparë se nëse punonjësi është anëtar i Sindikatës, ai ka të drejtë të ketë një përfaqësues të sindikatës prezent në takim. Po ashtu e paditura [parashtruesi] me rastin e marrjes së njoftimit mbi shkëputjen e marrëdhënies së punës, nuk ka vepruar në kuptim të nenit 11.5(b) të Rregullores 2001/27 Për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë.

“Gjykatat e instancës më të ulët gabimisht kanë aplikuar të drejtën materiale kur aktgjykimet e tyre i mbështesin në faktin e vërtetuar përmes procesverbalit mbi takimin e menaxherit të distriktit me punëmarrësin nr. 532 më 25 mars 2010, sepse nga ky procesverbal rezulton se ky takim ka të bëjë me dorëzimin e vërejtjes së fundit me shkrim të datës 25.03.2010, në kuptim të nenit 8.3 dhe nuk ka të bëjë me obligimet e të paditurës [parashtruesit] të parapara me nenin 8.4(a) dhe (b) të Rregullores së lartë cituar të paditurës [parashtruesi]. Pasi që në rastin konkret paditësit [parashtruesit] i është shkëputur kontrata e punës për shkak të rezultateve të pakënaqshme në punë për muajin tetor 2010 është dashur ta respektoj nenin 8.4(a) dhe (b) të Rregullores se lartcekur.

“Gjykata Supreme e Kosovës, vlerësoi si të bazuara pretendimet e paditësit [të punësuarit] të parashtruara me revizion se gjykatat e instancës më të ulët gabimisht kanë aplikuar të drejtën materiale për shkëputjen e kontratës së punës, nga se për këto shkelje e paditura [parashtruesi] nuk ka udhëhequr procedurë disiplinore, sepse në bazë të dispozitave të nenit 112 të Ligjit mbi Marrëdhënien e Punës të Kosovës nr. 12/1989, i cili Ligj ka qenë në aplikim në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24, deri me hyrjen në fuqi të Ligjit të Punës të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-212 në muajin dhjetor të vitit 2010, i cili ligj me dispozitën e nenit 99.1 shfuqizon Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/27 për Ligjin themelor të punës në Kosovë, Ligjin për Marrëdhëniet e Punës të KSAK të Kosovës, të vitit 1989 dhe Ligjin e punës të vitit 1977 me amendamentet përkatëse, është paraparë se organet e autorizuar kanë për detyrë të paraqesin kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore, brenda tetë ditësh pasi të

marrin vesh për shkeljen e detyrave të punës, ose për ndonjë shkelje tjetër të disiplinës së punës dhe për kryesin, ndërsa sipas dispozitës së nenit 113 paragrafi 2 është paraparë se para se të i shqiptoj masën disiplinore largim nga puna organi punë drejtues respektivisht punëtori i caktuar me autorizime dhe përgjegjësi të veçanta, ka për detyrë të marr në pyetje punëtorin.

“Nga neni 11 i Kontratës së punës e lidhur mes paditësit [punësuarit] si punëmarrës dhe të paditurit [parashtruesi] si punëdhënës është përcaktuar se kontrata e punës ndërpritet sipas neneve 67, 68, 69 dhe 70 të Ligjit të Punës në Kosovë, Marrëveshjes Kolektive dhe Rregullores së punës së KEK-ut”.

“Sipas nenit 24 të kontratës së përgjithshme kolektive është paraparë se komisionin disiplinor e emëron punëdhënësi, gjegjësisht organi kompetent me aktin e përgjithshëm të punëdhënësit, ndërsa e paditura [parashtruesi] me Rregulloren mbi përgjegjësinë disiplinore dhe materiale të nxjerrë më dt. 10.10.2006, me pjesën II të kësaj rregullore detajisht janë përcaktuar dispozitat për zbatimin e procedurës disiplinore, e cila Rregullore nuk është lënë jashtë fuqie me Rregulloren nr. 3 të datës 30.11.2009. Po ashtu me asnjë dispozitë të Rregullores nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, nuk është lënë jashtë fuqie Ligji Mbi Marrëdhëniet e Punës nr. 12/1989 i KSAK”.

“Gjykata Supreme e Kosovës, nga arsyet e cekura si dhe të dhënat të cilat gjenden në shkresa të lëndës gjeti së kërkesëpadia e paditësit (të punësuarit) është në tërësi e bazuar edhe për shkak se gjykatat e instancës më të ulët gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale, u deshtë që të dy aktgjykimet e atyre gjykatave të ndryshohen dhe kërkesëpadia e paditësit si e tillë të aprovohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi”.

Pretendimet e parashtruesit

22. Parashtruesi pretendon se “[Gj]ykata ka gjykuar në bazë të ligjeve që nuk kanë qenë në fuqi, andaj aktgjykimi i saj është i pa ligjshëm dhe i padrejtë dhe si i tillë të priset. KEK Sh.a është në dijeni që Gjykata Kushtetuese e Kosovës nuk vepron si shkallë e IV-të, por ka juridiksion kushtetues që ta prish-anuloj çdo akt juridik të cilitdo organ në qoftë se gjen se ka shkelje të dispozitave ligjore dhe atyre kushtetuese, e që për rastin konkret nuk është

fare kontestuese se janë shkelë dispozitat ligjore duke aplikuar ligjet dhe aktet tjera që nuk kanë qenë në fuqi”.

23. Në këtë mënyrë, parashtruesi pretendon se vendimi i kontestuar ia shkel të drejtat kushtetuese, të garantuara me nenin 31 dhe 102.3 të Kushtetutës, si pasojë e shkeljes së nenit 214.2 të Ligjit për procedurën kontestimore.
24. Për më tepër, parashtruesi pretendon se *“bazuar në dispozitat e nenit 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ka të drejtë ligjore që të kërkojë të shqyrtohet ligjshmëria e një vendimi të autoriteteve publike, pasi janë shterrë të gjitha mjetet juridike, andaj kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës që pas shqyrtimit të kërkesës, të njëjtën ta aprovoj si të bazuar, duke e anuluar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 368/2011 të dt. 02.5.2013”.*
25. Për më tepër, në bazë të dokumenteve shtesë të 13 dhjetorit 2012, parashtruesi pretendon se, *“Nuk mund të quhet një vendim gjyqësor i ligjshëm, i pa anshëm dhe i drejtë kur zbatohen dispozita të ligjit i cili nuk ka qenë në fuqi. Sikur të ishte kushtetues parmi i gjyqimit në bazë të ligjeve ma të favorshme për palën pa respektuar aspektin kohë, atëherë ne sistemin juridik dhe kushtetues të vendit do të krijohej konfuzion dhe pa siguri juridike”.*
26. Kështu, parashtruesi pretendon se, *“Aplikimi i gabuar i të drejtës materiale nga ana e gjykatës, rezulton me shkelje të drejtave të punëdhënësit të garantuara me Kushtetutë që të jetë i barabartë para ligjit, parim ky i garantuar me dispozitat e nenit 24 të Kushtetutës, si dhe shkelje të Drejtave dhe Lirive Themelore të sanksionuara me dispozitat e nenit 21.4 të Kushtetutës duke ia imponuar me Aktgjykim punëdhënësit me ke do të qëndroj në marrëdhënie kontraktuale në ekonominë e lirë të tregut e sanksionuar me dispozitat e nenit 101 të Kushtetutës”.*
27. Për më tepër, parashtruesi pretendon se, *“Gjykata Supreme e Kosovës për çështje identike që kanë të bëjnë me shkëputje të kontratës së punës ka qëndrime diametralisht të kundërta ku herë i zbaton dispozitat e nenit 112 të Ligjit mbi marrëdhënie pune të Kosovës GZ. E KSA Kosovës nr. 12/89 e herë të Ligjit Themelor të punës në Kosovë, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001127”.*
28. Për ta mbështetur padinë e tij, parashtruesi i referohet Aktgjyqimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 379/11 të 2 majit 2013, në të cilin

Gjykata Supreme i ka zbatuar dispozitat e nenit 112 dhe 113.2 të Ligjit për marrëdhëniet e punës të Kosovës (Krahina Socialiste Autonome e Kosovës, nr. 12/89), përderisa në një rast tjetër, Aktgjykimi Rev. nr. 310/12 të 22 prillit 2013, Gjykata Supreme konstatoi se janë zbatuar drejt dispozitat e nenit 11.1 dhe 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut.

29. Parashtruesi më tej thekson se, *“Se cilat dispozita aplikohen pas hyrjes në fuqi të Ligjit të Punës në Kosovë, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27 sa i përket marrëdhënies së punës me qëndrimin e vet juridik e ka qartësuar të gjitha gjykatat e qarkut, edhe ajo në Pejë me të gjitha Aktgjykimet që i përkasin kësaj lëmie, por edhe me Aktgjykimin Ac. Nr. 176/09, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Rev. nr. 106/2010, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës me Aktgjykimin ASC-09-00 14 dt. 26 maj 2011 [...]”*.
30. Prandaj, parashtruesi përfundon duke pyetur:
 - a. *“Pse Gjykata Supreme e Kosovës për 12 vite me radhë i ka zbatuar dispozitat e Ligjit Themelor të Punës në Kosovë, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, kurse në vitin 2013 ka ndërruar qëndrim dhe ka vendos që të zbatohen dispozitat ligjore të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Punës të KSA Kosovës, Gazeta Zyrtare nr. 12/89, [...]”*
 - b. *“[...] a nuk janë shkel të drejtat kushtetuese të gjithë atyre palëve deri në vitin 2013 që rastet e tyre janë vendos sipas dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27?”*;
 - c. *“A nuk krijohet një pasiguri juridike me vendime kontradiktore të gjykatës për çështje identike?”*;
 - d. *A nuk krijohet një pasiguri juridike?”*;
 - e. *A nuk krijohet pa barazi para ligjit, a nuk janë shkel parimet kushtetuese, Barazia para ligjit i paraparë me dispozitat e nenit 24 të Kushtetutës së republikës së Kosovës, pasi me aktgjykimet e gjykatës supreme për çështje identike (materia e njëjtë) për dike vendoset pozitivisht e për dike negativisht”*.

Pranueshmëria e kërkesës

31. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i ka plotësuar të gjitha kriteret e pranueshmërisë, siç janë përcaktuar me Kushtetutë dhe më tutje specifikuar me Ligj dhe me Rregullore të punës.
32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 dhe 21 të Kushtetutës.

Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Neni 21 [Parimet e Përgjithshme]

(...)

4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.

33. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

34. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) c) dhe rregullin 36 (2) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

*“36 (1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:
c) kërkesa është qartazi e bazuar.*

36 (2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie;

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;

c) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë; ose

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

35. Gjykata vëren se parashtruesi kryesisht pretendon: (a) shkelje të parimit të sigurisë juridike, (b) shkelje të neneve 31 dhe 102.3 të Kushtetutës, dhe (c) shkelje të dispozitave ligjore.
36. Para se të lëshohet në pretendimin e parashtruesit, Gjykata ripërsërit se ajo ka vendosur në disa raste lidhur me kontestin e punës, përkatësisht në rastet KI26/09, KI39/09, KI70/10 dhe KI25/10.
37. Në rastin KI26/09 (Shih rastin KI26/09, parashtrues Ekrem Gashi, Aktvendim për papranueshmëri i 14 dhjetorit 2010), parashtruesi pretendoi se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, i 24 janarit 2006, i kishte shkelur të drejtat e tij kushtetuese, sepse Gjykata e lejoi kërkesën e punëdhënësit dhe i ndryshoi vendimet e Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, në masën ku kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës ishte refuzuar si e pabazuar. Arsyetimi juridik i Gjykatës Supreme ishte bazuar në faktin se njoftimi, i cili deklaronte arsyet për përfundim të marrëdhënies së punës së punëmarrësit ka qenë i mjaftueshëm dhe në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut (2001/27), e cila e zëvendëson tërë legjislacionin që nuk ishte në pajtim me të. Gjykata Kushtetuese konstatoi se kërkesa e parashtruesit ishte e papranueshme, sepse nuk ishte *ratione temporis* në pajtim me Kushtetutën.
38. Në rastin KI39/09 (Shih rastin KI39/09, parashtrues Avni Kumnova, Aktgjykim i 3 nëntorit 2011) parashtruesi pretendoi se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, i 27 majit 2009, kishte shkelur të drejtat e tij kushtetuese sepse Gjykata Supreme gjeti se gjykatat e instancave të ulëta kishin zbatuar gabimisht të drejtën materiale, pasi që, në rast të zbatimit të nenit 11.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/27, punëdhënësi duhet vetëm të njoftojë me shkrim se e ka ndërmend të ndërpresë kontratën e punës dhe se një njoftim i tillë duhet të përfshijë arsyet e ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Gjykata Supreme konsideroi se *"në bazë të dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë"*, ishte paraparë që ndërprerja e kontratës së punës mund të bëhet pa obligimin për të iniciuar procedura disiplinore, dhe se punëdhënësi ishte obliguar vetëm për të njoftuar të

punësuarin rreth qëllimit të tij për të ndërprerë kontratën e punës në rastet e rënda të sjelljes së keqe, ose të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave nga i punësuar, dhe se një njoftim i tillë duhej të përfshinte arsyet për një largim të tillë, ashtu siç ka vepruar Ibër-Lepenci. Gjykata Kushtetuese gjeti se nuk ishin shkelur të drejtat kushtetuese të parashtruesit të kërkesës.

39. Në rastin KI70/10 (Shih rastin KI70/10, parashtrues Fatime Kabashi, Aktvendim për Papranueshmëri i 3 nëntorit 2011), parashtruesja e kërkesës pretendoi se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të 27 majit 2009, Gjykata Supreme anuloi aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut dhe asaj Komunale dhe hodhi poshtë ankesën e parashtrueses së kërkesës si të pabazë, duke deklaruar se gjykatat e instancës më të ulët kishin gjykuar gabimisht situatën faktike si dhe kishin zbatuar gabimisht të drejtën materiale (Rev. I. nr. 28/2010). Sipas mendimit të Gjykatës Supreme, parashtruesja e kërkesës ka munguar nga puna pa autorizim, edhe pse ishte informuar një ditë para se të refuzohej kërkesa e saj për pushim pa pagesë. Gjykata Supreme rithekson se Rregullorja e UNMIK-ut 2001/36 dhe Udhëzimi Administrativ 44/2004 ishin në fuqi në vend të Rregullores së UNMIK-ut 2001/27. Gjykata Kushtetuese e shpalli kërkesën të papranueshme sepse parashtruesja e kërkesës as nuk e ka arsyetuar ankesën e saj lidhur me shkeljet e pretenduara dhe as nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.
40. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me shkeljen e parimit të sigurisë juridike, se Gjykata Supreme për çështje identike për dikë vendos pozitivisht dhe për dikë tjetër negativisht, Gjykata rithekson se në rastin KI25/10 (Shih rastin KI25/10, parashtrues Agjencia Kosovare e Privatizimit, Aktgjykim i 31 marsit 2011), Gjykata gjeti se:

“57. Për më tepër, Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, dispozitat e të cilit do të kenë përparësi ndaj të gjitha dispozitave ligjore në Kosovë, në Aneksin IV [Sistemi i Drejtësisë], neni 1.1, "Gjykata Supreme do të sigurojë zbatim të njëtrajtshëm të ligjit duke vendosur mbi ankesat në përputhshmëri me ligjin". Dhoma e Posaçme, si pjesë e Gjykatës Supreme është e obliguar ta respektojë këtë dispozitë.
58. Përfundimisht, neni 145 [Vazhdimësia e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe e Legjislacionit të Aplikueshëm] përcakton se "Legjislacioni i aplikueshëm në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute vazhdon të zbatohet për aq sa të jetë në pajtueshmëri me këtë Kushtetutë, derisa të mos shfuqizohet, zëvendësohet ose amendamentohet në pajtueshmëri me këtë

Kushtetutë". Si interpretues përfundimtar i Kushtetutës, Gjykata konsideron se legjislacioni i zbatueshëm në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute përfshinë rregulloret e UNMIK-ut dhe vendimet administrative të nxjerra nga PSSP-ja para 15 qershorit 2008. Në pajtim me nenin 145, rregulloret dhe udhëzimet administrative të tilla, si dhe legjislacioni tjetër do të vazhdojnë të zbatohen vetëm për aq sa janë në pajtim me Kushtetutën derisa të shfuqizohen, zëvendësohen apo ndryshohen në pajtim me Kushtetutën".

41. Sidoqoftë, Gjykata vëren se, në pajtim me parimin e subsidiaritetit, parashtruesi i kërkesës duhet të ngre shkeljen e pretenduar kushtetuese në gjykatat e rregullta që në radhë të parë të sigurojnë respektimin e të drejtave themelore të mishëruara në Kushtetutë.
42. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Supreme nuk e ka ngre shkeljen e pretenduar kushtetuese të qëndrimeve jo të harmonizuara parimore për çështjet e njëjta dhe zbatimit të Gjykatës Supreme lidhur me çështjet identike, kur për dikë vendos pozitivisht dhe për dikë negativisht, që sipas parashtruesit të kërkesës do të krijonte pasiguri juridike.
43. Gjykata më tej vëren se, më 28 gusht 2013, parashtruesi i ka dërguar një letër Kryetarit të Gjykatës Supreme, duke kërkuar harmonizimin e qëndrimeve parimore për çështje identike. Parashtruesi i kërkesës, kërkoi nga Kryetari i Gjykatës Supreme *"të na sugjeroni se cilat veprime duhet t'i ndërmerret KEK-u për t'i riparuar pasojat e shkaktuara me aktgjykimin e lartpërmendur"*. Megjithatë, kjo kërkesë është dashur të ngrihej nga parashtruesi gjatë procedurës për shqyrtimin e rastit, dhe jo pasi që ishte nxjerrë Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, d.m.th. 2 maj 2013.
44. Në lidhje me pretendimet e parashtruesit për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka sqaruar si dhe pse vendimi i kontestuar *"me zbatimin e akteve tjera, të cilat nuk ishin në fuqi"* kishte shkelur këtë të drejtë të veçantë kushtetuese.
45. Gjykata rikujton se e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm përfshin një numër të elementeve dhe përbën komponentët kyç në mbrojtjen e të drejtave themelore individuale nga shkeljet e mundshme të kryera nga gjykatat ose autoritetet publike me vendimet e tyre.

46. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, i cili parasheh:

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike”.

47. Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (KEDNJ) gjithashtu parasheh se:

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile (...), çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme”.

48. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se parashtruesi nuk shpjegon në mënyrë të saktë si dhe pse pretendimi “i zbatimit të akteve tjera që nuk ishin në fuqi” e mbështet shkeljen kushtetuese të të drejtave të tij themelore për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Në të vërtetë, parashtruesi vetëm konkludon se “për rastin konkret nuk është fare kontestuese se janë shkel dispozitat ligjore duke aplikuar ligjet dhe aktet tjera që nuk kanë qenë në fuqi”.
49. Për më tepër, citati i lartcekur i vendimit të Gjykatës Supreme tregon se vendimi i kontestuar ofroi arsyetim të gjerë dhe gjithëpërfshirës të fakteve të rastit dhe të gjetjeve të tij.
50. Për më tepër, pakënaqësia me vendimin apo thjesht përmendja e neneve ose dispozitave të Kushtetutës nuk është e mjaftueshme për parashtruesin të ndërtojë një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkeljet e Kushtetutës, parashtruesi duhet të sigurojë një argument bindës dhe të arsyetuar mirë, në mënyrë që kërkesa të jetë e bazuar.
51. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk e mbështet dhe nuk dëshmon se Gjykata Supreme duke gjykuar “në bazë të ligjeve që nuk ishin në fuqi”, pretendohet t’i ketë shkelur të drejtat e tij kushtetuese.
52. Parashtruesi gjithashtu pretendon shkeljen e nenit 102.3 të Kushtetutës, i cili parasheh se “gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit”. Gjykata konsideron se parashtruesi nuk ka ofruar asnjë argument apo nuk ka paraqitur asnjë dëshmi se Gjykata Supreme nuk e kishte respektuar dispozitën në fjalë. Prandaj, Gjykata gjen se parashtruesi prapë edhe njëherë nuk e ka

argumentuar shkeljen e të drejtave të tilla, siç parashihen me Kushtetutë, në nenin e lartpërmendur 102.3 të Kushtetutës.

53. Përveç kësaj, parashtruesi pretendon “*shkelje të dispozitave ligjore*”, Gjykata menjëherë konsideron se ato pretendime janë të natyrës ligjore. Kështu, Gjykata gjen ato nuk paraqesin asnjë bazë kushtetuese për shkelje të të drejtave themelore të njeriut, të garantuara me Kushtetutë.
54. Në të vërtetë, Gjykata as nuk i shqyrton vendimet e gjykatave të rregullta për çështje të ligjshmërisë, dhe as nuk e shqyrton saktësinë e fakteve, përveç nëse ka dëshmi të qarta dhe bindëse se ato vendime janë marrë në mënyrë qartazi të padrejtë apo arbitrare.
55. Për më tepër, nuk është detyrë e Gjykatës të vendosë nëse Gjykata Supreme i ka shqyrtuar argumentet e parashtruesve në mënyrë të duhur me rastin e zgjidhjes së çështjeve ligjore. Kjo mbetet ekskluzivisht juridiksion i gjykatave të rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
56. Është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë nëse, gjatë procedurave të gjykatave të rregullta, gjykatat kanë shkelur ndonjë të drejtë themelore të garantuar me Kushtetutë.
57. Si përmbledhje, Gjykata nuk vëren argumente dhe dëshmi se Vendimi i kontestuar Rev. nr. 368/2011 i Gjykatës Supreme të Kosovës, të 2 majit 2013, ishte marrë në mënyrë qartazi të padrejtë dhe arbitrare.
58. Si rezultat i kësaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk i plotëson kushtet e pranueshmërisë, pasi që parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të mbështesë pretendimin e tij dhe të paraqesë dëshmi mbështetëse për shkeljen e pretenduar kushtetuese me vendimin e kontestuar.
59. Prandaj, sipas rregullit 36 (2) b) të Rregullores së punës, kërkesa e parashtruesit duhet të hidhet poshtë si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) b) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 18 shkurt 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KIO6/14, Olga Petrović, Svetolik Patrnogić, Vesna Dejanović dhe Miroslava Ivanović, Vendim për Masë të Përkohëshme i datës 10 shkurt 2014 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Pc. Nr. 559/10 të 18 shtatorit 2013

Rasti KIO6/14, vendimi i 10 shkurtit 2014

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, palë e paautorizuar, mosshterje e mjeteve juridike

Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se aktgjykimi i kontestuar është nxjerrë me shkelje të të drejtave të tyre të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në veçanti neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe neni 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë se janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës kërkuan nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës që të shqiptoj, masë të përkohshme.

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) a) dhe 36 (3) c) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 4 korrik 2014, njëzëri deklarojë kërkesën e tre parashtruesve të parë të papranueshme për shkak të mos shterimit të të gjitha mjeteve juridike të parapara me ligj si dhe kërkesën e parashtrueses së katërt të papranueshme për shkak se ishte dorëzuar nga një palë e paautorizuar.

VENDIM PËR MASË TË PËRKOHSHME
në
Rastin Nr. KIo6/14
Parashtruesi
Olga Petrović, Svetolik Patrnogić, Vesna Dejanović dhe
Miroslava Ivanović
Vlerësimi i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Pc. Nr.
559/10
të 18 shtatorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë: Olga Petrović, Svetolik Patrnogić, Vesna Dejanović, me vendbanim në Kragujevc, Republika e Serbisë, dhe Miroslava Ivanović me vendbanim në Roscoe, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Vendimi kontestuar

2. Parashtruesit e kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, Pc. Nr. 559/10, e 18 shtatorit 2013, i cili pretendohet t'i jetë dorëzuar përfaqësuesit të përkohshëm të parashtruesve, i emëruar sipas detyrës zyrtare nga Gjykata Themelore në Ferizaj në një datë të pacaktuar.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, Pc. Nr. 559/10 të 18 shtatorit 2013, të cilin ata nuk ia kanë bashkëngjitur kërkesës.

4. Parashtruesit pretendojnë se aktgjykimi i kontestuar ishte nxjerrë me shkelje të të drejtave të tyre të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në veçanti nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrotjtja e Pronës] së Kushtetutës. Parashtruesit gjithashtu pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
5. Përveç kësaj, parashtruesit kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) që të vendosë masë të përkohshme *“duke urdhëruar Zyrën Komunale Kadastrale në Ferizaj që t’ia shlyejë të drejtën e pronësisë I. B. mbi ngastrën kadastrale numër P-72217092-02323-0, KK Ferizaj, në sipërfaqe të përgjithshme 1917 m² dhe ta vendosë gjendjen paraprake, përkatësisht ta bëjë regjistrimin e së drejtës pronësore të Julijana Patrnogić”*.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 22 dhe 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 dhe rregullave 54, 55 dhe 56 (3) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 20 janar 2014, parashtruesit dorëzuan kërkesën në Gjykatë.
8. Më 31 janar 2014, Kryetari i Gjykatës, në bazë të Vendimit GJR. KIO6/14 caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues.
9. Më 31 janar 2014, Kryetari i Gjykatës, në bazë të Vendimit KSH. KIO6/14 caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.
10. Më 10 shkurt 2014, Gjykata Kushtetuese njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën shkresë, ishte kërkuar nga parashtruesit që të dorëzojnë në Gjykatë formularin e plotësuar të kërkesës dhe aktgjykimin e kontestuar. Për më tepër, Gjykata kërkoi nga parashtruesja e parë znj. Olga Petrović, që të dorëzojë një autorizim për parashtruesen e katërt, znj. Miroslava Ivanić.

11. Të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi edhe Gjykatën Komunale në Ferizaj lidhur me kërkesën.
12. Më 10 shkurt 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë që ta refuzojë kërkesën për masa të përkohshme në pritje të rezultatit përfundimtar të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 26 prill 2011, Gjykata Themelore në Kragujevc, Serbi, mori Aktvendimin nr. 0-517/10 dhe 0-518/10 dhe vërtetoi, ndër të tjera, se trashëgimia e të ndjerës Patrnogić Julijana konsiston në të drejtën e pronësisë mbi paluajtshmërinë në Ferizaj në sipërfaqe të përgjithshme prej 1,46.71 ha. Me të njëjtin Aktvendim, 22 familjarë, duke përfshirë katër parashtruesit, u shpallën trashëgimtarë të së ndjerës Patrnogić Julijana.
14. Sipas parashtruesve të kërkesës, më 18 shtator 2013, Gjykata Themelore në Ferizaj mori aktgjykimin e kontestuar Pc. 559/10. Parashtruesit pretendojnë se në procedurën në Gjykatën Themelore në Ferizaj ata ishin përfaqësuar nga përfaqësuesi i përkohshëm z. Hilmi Piraj, avokat nga Ferizaj. Ata gjithashtu pretendojnë se ata nuk mundën ta kontaktojnë përfaqësuesin e përkohshëm, i cili nuk u kishte siguruar atyre një kopje të aktgjykimit të kontestuar.
15. Më 27 nëntor 2013, noteri Nexhat Sh. Qorrolli e informoi avokatin Miloš Petković nga Shtërpca, si përfaqësues i autorizuar i trashëgimtarëve ligjorë të së ndjerës Julijana Patronogić, si në vijim: *“udhëzimi në procedurën kontestimore është i domosdoshëm, duke pasur parasysh se noteri ka konstatuar se lidhur me pronën e paluajtshme, që është lëndë e trashëgimisë, është duke u zhvilluar procedura kontestimore dhe gjykata ka marrë aktgjykim me të cilin ia ka njohur të drejtën e pronësisë B. I. nga fshati Greme, mbi ngastrën kadastrale numër P-72217092-02323-0, në sipërfaqe të përgjithshme prej 1917m². Sipas aktgjykimit të gjykatës janë bërë edhe ndryshimet në operatin kadastral në Komunën e Ferizajt”*.

Vlerësimi i kërkesës për masë të përkohshme

16. Në mënyrë që Gjykata të lejojë masë të përkohshme në pajtim me rregullin 55 (4) të Rregullores së punës, duhet të konstatojë se:

“(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për papranueshmërinë e saj, rastin prima facie për papranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masë e përkohshme.

(..)

Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës”.

17. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesit nuk kanë paraqitur ndonjë argument dhe as nuk kanë paraqitur ndonjë dëshmi, pse dhe si masa e përkohshme është e nevojshme për të evituar rrezikun ose dëmin e pariparueshëm, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik, ashtu siç kërkohet me nenin 27 të Ligjit. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa për masë të përkohshme duhet të refuzohet si e pabazuar.
18. Ky konstatim nuk pengon Gjykatën Kushtetuese për të vlerësuar pranueshmërinë e kërkesës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 27 të Ligjit, dhe në pajtim me rregullat 55 (4) dhe 56 (3) të Rregullores së punës, më 10 shkurt 2014, njëzëri,

VENDOS

- I. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. TË SHPALLË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Dr. Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI14/14, Abdyl Islami, Aktvendim i datës 26 shkurt 2014 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 225/2013, të 18 dhjetorit 2013

Rasti KI14/14, vendimi i 26 shkurtit 2014

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kërkesë për masë të përkohshme, qartazi i pabazuar.

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme (Pml. nr. 225/2013, i 18 dhjetorit 2013), ka të bëjë me refuzimin e kërkesës së parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar, ndërkohë që parashtruesi përmes aktgjykimeve të instancave më të ulëta ishte shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale: vepër e rëndë kundër sigurisë së komunikacionit dhe për të njëjtën ishte gjykuar me dënim me burgim.

Parashtruesi pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme dhe aktgjykimet e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Komunale në Prishtinë, i kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Përveç kësaj, parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në .tekstin e mëtejme: Gjykata) vendosjen e masës së përkohshme deri në nxjerrjen e një vendimi nga Gjykata, gjegjësisht pezullimin e ekzekutimit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës (PAL nr. 1081/2012, të 12 shtatorit 2013), e cila gjykoi parashtruesin me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.

Gjykata Kushtetuese deklaroi kërkesën të papranueshme si qartazi e pabazuar, sepse faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtave kushtetuese dhe parashtruesi nuk e ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme si dhe pse aktgjykimet e lartcekura i kishin shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë. Përveç kësaj, Gjykata Kushtetuese vendosi ta refuzojë kërkesën për Masë të përkohshme si qartazi të pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI14/14
Parashtrues
Abdyl Islami
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme,
Pml. nr. 225/2013, të 18 dhjetorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan,
gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova,
gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Abdyl Islami (në tekstin e mëtejme: parashtruesi), me banim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 225/2013, të 18 dhjetorit 2013, të cilin parashtruesi e ka pranuar më 10 janar 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 225/2013, të 18 dhjetorit 2013, si dhe aktgjykimeve të Gjykatës Komunale në Prishtinë (P. nr. 1823/2012, i 16 korrikut 2012) dhe Gjykatës së Apelit (PA1. Nr. 1081/2012, i 12 shtatorit 2013). Aktgjykimi i lartcekur i Gjykatës Supreme ka të bëjë me refuzimin e kërkesës së parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar, ndërkohë që parashtruesi përmes aktgjykimeve të

instancave më të ulëta ishte shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale: vepër e rëndë kundër sigurisë së komunikacionit dhe për të njëjtën ishte gjykuar me dënim me burgim.

4. Përveç kësaj, parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) vendosjen e masës së përkohshme deri në nxjerrjen e një vendimi nga Gjykata, gjegjësisht pezullimin e ekzekutimit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës (PA1. Nr. 1081/2012, të 12 shtatorit 2013), e cila gjykoj parashtruesin me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 27 dhe 47 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullat 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 28 janar 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 31 janar 2014, Kryetari i Gjykatës, në bazë të Vendimit GJR. KI14/14, e caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, në bazë të Vendimit KSH. KI14/14, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
8. Më 31 janar 2014, Gjykata Kushtetuese njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi gjithashtu edhe Gjykatën Supreme në lidhje me kërkesën.
9. Më 7 shkurt, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese, dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë të deklarojë kërkesën e papranueshme dhe të refuzojë kërkesën për masë të përkohshme.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 24 janar 2003, parashtruesi gjatë drejtimit të veturës në komunikacion, kishte goditur një këmbësor, me ç'rast i njëjti

këmbësor si rezultat i lëndimeve të pësuar nga goditja me veturë kishte vdekur një orë me vonë në spital.

11. Parashtruesi nga 24 janari 2003, deri më 6 shkurt 2003, kishte qëndruar në paraburgim.
12. Më 25 mars 2003, Prokuroria Publike Komunale në Prishtinë, kishte ushtruar aktakuzë ndaj parashtruesit për shkak të veprës penale: vepër e rëndë kundër sigurisë së komunikacionit sipas nenit 171, paragrafi 5 në lidhje me nenin 165, paragrafi 3 në lidhje me paragrafin 1 të Ligjit Penal të Kosovës.
13. Më 14 shkurt 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë, (Aktgjykimi P. Nr. 497/2003) parashtruesin e kishte shpallur fajtor dhe e kishte gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve.
14. Si rezultat i ankesës së parashtruesit, më 21 qershor 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktvendimi AP. Nr. 78/2011) kishte miratuar si të bazuar ankesën e parashtruesit, duke anuluar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale (Aktgjykimi P. Nr. 497/2003 i 14 shkurtit 2011) dhe kishte kthyer çështjen për rigjykim.
15. Parashtruesi nuk ka dorëzuar në Gjykatë, aktgjykimet e lartcekura të Gjykatës Komunale në Prishtinë (P. Nr. 497/2003, i 14 shkurtit 2011) dhe Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë (AP. Nr. 78/2011, të 21 qershorit 2011).
16. Pas kthimit të çështjes në rigjykim, Gjykata Komunale në Prishtinë, kishte kërkuar një super ekspertizë.
17. Më 16 korrik 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë, pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësore, dëgjimit të palëve, dhe pas vlerësimit të ekspertëve, përmes Aktgjykimit, P. Nr. 1823/2012, parashtruesin e kishte shpallur fajtor për kryerje të veprës penale: vepër e rëndë kundër sigurisë së komunikacionit sipas nenit 171, paragrafi 5 në lidhje me nenin 165, paragrafi 3 në lidhje me paragrafin 1 të Ligjit Penal të Kosovës, dhe e kishte gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, duke i llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim.
18. Gjykata Komunale në Prishtinë, kishte ardhur në përfundim se:

[...]

“Me rastin e percaktimit të denimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe masën e denimit kështu që të pandehurit Avdyl Islami gjykata ia mori parasysh rrethanat lehtësuese, se është njeri fanlijar, baba i një femiu, se me parë nuk ka qenë i gjykuar, se kundra tij nuk zhvillohet procedura tjetër penale, ndërsa si rrethana renduese gjykatat ia mori parasysh motivin dhe venin e kryerjes së veprës penale, dhe të nejtë për veprën penale si në aktakuzë e gjykoi me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve me bindje se me një dënim të tillë do të arrihet efekti i denimit.

“Nga faktet e vertetuara me lartë gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit Avdyl Islami ekzistojnë të gjitha elementet qensore të veprës penale Veprës së rëndë kundër sigurisë së komunikacionit nga neni 175 al. 5 lidhur me nenin 165 al. 3 me al. 1 të LPK për të cilën veprën penale gjykata edhe e shpall fajtor të pandehurin, pasi me parë gjeti se penalisht është përgjegjës”.

19. Parashtruesi, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komonale në Prishtinë, kishte parashtruar ankesë me pretendimin se Aktgjykimi i lartcekur përmbante shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke pohuar se dispozitivi i Aktgjykimit ishte i paqartë dhe i pakuptueshëm dhe nuk ofronte arsytim lidhur me faktet relevante. Parashtruesi po ashtu ishte ankuar për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
20. Më 12 shtator 2013, Gjykata e Apelit e Kosovës, përmes Aktgjykimit PA1. nr. 1081/2012, vendosi që pjesërisht të miratojë ankesën e parashtruesit dhe të ndryshojë Aktgjykimin e Gjykatës Komonale në Prishtinë, (P. nr. 1823/2011 i 18 korrikut 2012) sa i përket pjesës së vendimit për dënim me burgim, duke i shqiptuar parashtruesit dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.
21. Duke iu referuar pretendimeve të ngritura nga parashtruesi, Gjykata e Apelit e Kosovës konstatoi se:

[...]

“Kolegji Penal i Gjykatës së Apelit, duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar në pajtim me nenin 394 par. 1 pika 1.1 të KPPK, sipas detyrës zyrtare ka shikuar dhe ka ardhur në përfundim që aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 pika 1.12 të KPPK, sepse dispozitivi i aktgjykimit të sulmuar, është i

qartë, i kuptueshëm dhe si i tillë në harmoni me vetveten dhe me arsyet e paraqitura. Në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, në përshkrimin faktik, përnahen të gjitha arsyenat lidhur me faktet vendimtare dhe rrethanat që i përbëjnë elementet qenësore të veprës penale, vepër e rëndë kundër sigurisë së komunikacionit nga neni 171 1l. 5 lidhur me nenin 165 al. 3 lidhur me al.1 të LPK, të aplikuar sipas Rregullores së UNMIK-ut 24/1999, të cilat elemente janë vërtetuar gjatë mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, dhe pas përfundimit të të njëjtit i akuzuari është shpallur fajtor. “

[...]

“aktgjykimi i ankimuar nuk i përmban shkeljet për të cilat pretendon mbrojtësi i të akuzuarit, sepse nga ana e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të drejtë janë vlerësuar të gjitha provat të cilat janë proceduar gjatë mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, sikurse janë deklaratat e të akuzuarit, deklaratat e dëshimtarëve, janë vlerësuar provat materiale nga shkresat e lëndës, andaj është ardhur në përfundim që nga ana e gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar se i akuzuari ditën kritike ka kryer veprën penale vepër e rëndë kundër sigurisë së komunikacionit nga neni 171 al. 5 lidhur me nenin 165 al. 3 lidhur me al. i të LPK”.

[...]

22. Duke marrë parasysh këtë më sipër, Gjykata e Apelit erdhi në përfundimin si në vijim:

[...]

“Meqë me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, aktgjykimi ankimohet sa i përket vendimit mbi dënimin, duke pretenduar se nga ana e gjykatës së shkallës së parë janë mbivlerësuar rrethanat renduese, pa i vlerësuar ato lehtësuese, sikurse janë koha relativisht e gjatë prej kryerjes së veprës penale e gjer me tani, se i akuzuari është familjar, kolegji i Gjyaktës së Apelit, me aprovimin e pjesërishëm të ankesës së mbrojtësit të akuzuarit të ndryshohet vendimi mbi dënimin ashtu që të akuzuarit iu është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, duke qenë i bindur që me dënimin e shqiptuar do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 (i vjetri 34) të KPK”.

23. Më 5 dhjetor 2013, parashtruesi, duke pretenduar aplikimin e gabuar të së drejtës materiale në Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë (P. nr. 1823/11, i 18 korrikut 2012), të ndryshuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme.
24. Parashtruesi në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë kishte pretenduar [...], *“se vetëm tejkalimi i shpejtësisë pa patur veprime të tjera të kundërligjshme dhe të rrezikshme për pjesëmarrësit në komunikacion, në asnjë rast nuk nenkupton se personi ka kryer veprën penale nga neni 171 lidhur me nenin 165 të LPK-së. Në rastin konkret levizja e shpejtësisë pertej 40 km/h, mund të cilësohet vetëm si një kundërvajtje e trafikut, dhe jo veper penale”*. Parashtruesi e përfundon kërkesën e tij si në vijim: *“Veprimet e të dënuarit në rastin konkret, nuk përbejnë elemente të veprës penale, dhe për këto arsye aktgjykimet e kundërshtuara duhet të ndryshohen apo anulohen si është propozuar me lartë, pasi merren me shkelje të ligjit penal në dëm të dënuarit, duke aplikuar ligjin penal pa mundur me vërtetuar se janë shkelur dispozitat e nenit 171 dhe 165 të LPK-së”*.
25. Më 18 dhjetor 2013, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit (Pml. nr. 225/2013) e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.
26. Gjykata Supreme, në Aktgjykimin e saj, konstatoi dhe përfundoi si në vijim:

[...]

“Nga shkresat e çështjes dhe përshkrimi faktik i veprës penale rezulton se në veprimet e gjykuarit përmbushen elementet e përcaktuara nga dispozitat e nenit 165 par. 1 të LPK, ndërsa meqë si pasojë e këtij veprimi ka rezultuar vdekja e një personi vepra është cilësuar në pajtim me dispozitat e nenit 171 par. 5 të LPK, prandaj cilësimi i veprës penale me asgjë nuk mund të vihet në dyshim.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata Supreme, nuk aprovoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë se në këtë rast kemi të bëjmë vetëm me një kundërvajtje sepse sic edhe u cek më lartë si rezultat mospërfilljes së dispozitave që rregullojnë trafikun rrugor – tejkalimi i shpejtësisë është shkaktuar edhe vdekja e këmbësorit [...], prandaj asesi nuk kemi të bëjmë me kundërvajtje por vepër penale siç drejtë kanë

konkluduar gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë, të cilin qëndrim e aprovon edhe kjo Gjykatë”.

Pretendimet e parashtruesit

27. Parashtruesi pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, përfshirë dhe aktgjykimet e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Komunale në Prishtinë, i kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
28. Në lidhje me këtë, parashtruesi pohon si në vijim:

[...]

“Aktgjykimi i Gjykatës komunale në Prishtinë, p.nr. 1823/2012, aktgjykimi i gjykatës së Apelit në Prishtinë, PA1.nr. 1081/2012, dhe aktgjykimi i gjykatës supreme të Kosovës, Pml. nr. 225/2013, në asnjë moment asnjë nuk marrin parasysh asnjë nga kërkesat e mbrojtjes për sigurimin e gjyqimit të drejtë dhe për barazim e paleve në procedurë. Në fakt të gjitha keto aktgjykime duke u përqendruar vetëm në kinse vertetimin e gjeëndjes faktike dhe zbatimin e ligjit penal, fare as që leshohen në dhenjen e vlerësimeve për propozimet e kërkesat e mbrojtjes së tani kerkuesit – të denuarit”.

[...]

“Gjykata në asnjë moment nuk bëri përpjekje për tu siguruar një ekspertisë komplete e cila duhej të bazohej në të gjitha rrethanat lidhur me shkaktimin e aksidentit, si nga vendi i ngjarjes dhe rrethanat në terren si dhe kushtet teknike të automjetit”.

29. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën:

“- që kërkesa të shpallet e pranueshme

- të konstatohet se ka patur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës së Kosovës (E drejta gjykim të drejtë dhe të paanshëm) dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut (e drejta për proces të rregullt),

- te shpallen te pavlefshem aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. Nr. 225/2013 date 18 dhjetor 2013, aktgjykimin e gjykatës së Apelit në Prishtinë, PA1, nr. 1081/2012, dhe aktgjykimin e Gjyktaes Komunale në Prishtinë, P.nr. 1823/2012,
- te kthej në rivendosje qështjen prej fillimi”.

Pranueshmëria e kërkesës

30. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregullore të punës të Gjykatës.

31. Në këtë drejtim, neni 113, paragrafi 7, i Kushtetutës parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

32. Përveç kësaj, neni 49 i Ligjit parasheh që *“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”.*

33. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit. Gjykata gjithashtu vëren se atij i është dorëzuar Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 225/2013, më 10 janar 2014, dhe ai e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 28 janar 2014.

34. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi është palë e autorizuar dhe se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit të zbatueshëm, dhe se kërkesa është dorëzuar brenda afatit kohor prej katër(4) muajsh.

35. Sidoqoftë, Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:(c) kërkesa është qartazi e bazuar”.

(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:”

[...], ose

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese; [...], ose

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

36. Parashtruesi pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Pml. nr. 225/2013, përfshirë dhe aktgjykimet e instancave më të ulëta i kanë shkelur të drejtat e tij, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të KEDNJ-së.

37. Parashtruesi, lidhur me procedurat në gjykatat e rregullta pohon që: *“Gjykata në asnjë moment nuk bëri përpjekje për tu siguruar një ekspertisë komplete e cila duhej të bazohej ne te gjitha rrethanat lidhur me shkaktimin e akcidentit, si nga vendi i ngjarjes dhe rrethanat ne teren si dhe kushtet teknike te automjetit”.*

38. Lidhur me pretendimet e ngritura nga parashtruesi pranë gjykatave të rregullta, Gjykata vëren se Gjykata Komunale pas kthimit të çështjes për rishqyrtim nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktvendimi AP. Nr. 78/2011, i 21 qershorit 2011), kishte kërkuar një super ekspertizë. Si rezultat i kësaj dhe pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësore, dëgjimit të palëve dhe pas vlerësimit të ekspertëve kjo Gjykatë përmes Aktgjykimit (P. nr. 1823/2012, të 16 korrikut 2012), parashtruesin e kishte shpallur fajtor për kryerje të veprës penale.

39. Në Aktgjykimin e saj, Gjykata Komunale kishte ardhur në përfundim se:

“Nga faktet e vertetuara me larte gjykata gjeti se ne veprimet e te pandehurit Avdyl Islami ekzistojne te gjitha elementet qensore te vepres penale Vepres se rende kunder sigurise se komunikacionit nga neni 175 al. 5 lidhur me nenin 165 al. 3 me al. 1 të LPK per te cilen veper penale gjykata edhe e shpall fajtor te pandehurin, pasi me pare gjeti se penalisht eshte pergjegjes”.

40. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese ripërsërit se sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë

rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11, parashtrues Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

41. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë, (Shih, ndër autoritete të tjera, rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i miratuar më 10 korrik 1991).
42. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme është i qartë dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu gjeti që procedurat në gjykatat e rregullta nuk ishin të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Nr. 17064/06, Vendimi i GJEDNJ-së, i 30 qershorit 2009).
43. Për më tepër, Gjykata Supreme, në aktgjykimin e saj, gjeti se [...]” *Nga shkresat e çështjes dhe përshkrimi faktik i veprës penale rezulton se në veprimet e gjykuarit përmbushen elementet e përcaktuara nga dispozitat e nenit 165 par. 1 të LPK, ndërsa meqë si pasojë e këtij veprimi ka rezultuar vdekja e një personi vepra është cilësuar në pajtim me dispozitat e nenit 171 par. 5 të LPK, prandaj cilësimi i veprës penale me asgjë nuk mund të vihet në dyshim”.*
44. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtave kushtetuese dhe parashtruesi nuk e ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme si dhe pse aktgjykimet e lartcekura i kishin shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë.

Kërkesa për masë të përkohshme

45. Parashtruesi kërkon nga Gjykata “*qe te merr vendim LEJOHET masa e përkohshme deri në kohën e rivendosjes, ashtu qe kerkuesi nuk do te thirret ne fillimin e mbajtjes se denimit”.*
46. Lidhur me kërkesën për masë të përkohshme, parashtruesi pohon se: [...] “*Kerkesa per lejimin e masës së përkohshme është e arsyeshme dhe e bazuar në faktin se tanimë, pas përfundimit të të gjitha procedurave para gjykatave të rregullta, pritet qe shume shpejt qe kerkuesi te filloj mbajtjen e denimit”.*

47. Në mënyrë që Gjykata të lejojë masë të përkohshme në pajtim me rregullin 55 (4) të Rregullores së punës, duhet të konstatojë se:

“(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masë e përkohshme.
(..)

Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës”.

48. Siç u konstatua më lart, kërkesa është e papranueshme dhe prandaj nuk ka rast *prima facie* për qëllim të vendosjes së masës së përkohshme, dhe për këtë arsye kërkesa për masë të përkohshme është qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 27 të Ligjit dhe rregullat 36 (2), b) dhe d) dhe 55 (4), të Rregullores së punës, më 26 shkurt 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën si të papranueshme;

- II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. T'UA KOMUNIKOJË vendimin palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;
- V. TË SHPALLË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Arta Rama-Hajrizi

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI23/14, Qendra Shoqërore, Sportive dhe Ekonomike, Aktvendim i datës 10 shkurt 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjytimeve të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, ASC-09-0101 dhe ASC-09-0084, të 13 shtatorit 2012

Rasti KI23/14, vendimi i 10 shkurtit 2014

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, cenim i të drejtave dhe lirive kushtetuese nenet 24, 31, 32 dhe 41, kërkesë për masë të përkohshme, kërkesa e papranueshme.

Parashtruesi ka paraqitur kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat dhe liritë e tyre kushtetuese janë cenuar me aktgjykimet e gjykatave të rregullta të të gjitha shkallëve. Parashtruesi pohon se gjykatat e rregullta të të gjitha shkallëve kanë cenuar të drejtat dhe liritë e tyre të garantuar me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridik dhe me nenin 41 [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike]. Parashtruesi konkretisht kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjytimeve të DHPGJS, ASC-09-0101 dhe ASC-09-0084, të 13 shtatorit 2012. Me aktgjykimet e lartpërmendura të DHPGJS-se urdhërohej.

Parashtruesi që t'ua kompensojë gjashtëmbëdhjetë (16) paditësve dëmin material, të shkaktuar nga zjarri në ndërtesën e parashtruesit në Prishtinë. Përveç kësaj, Parashtruesi nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës kërkon të caktojë masën e përkohshme që të pezullojë përmbarimin e aktgjytimeve të DHPGJS-se derisa të merret vendimi nga Gjykata.

Gjykata konkludon se kërkesa është e paafatshme dhe rikujton se qëllimi i afatit ligjor katër(4) mujor, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri ligjore, duke siguruar se rastet që kanë të bëjnë me çështje të Kushtetutës të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe se vendimet e mëparshme nuk janë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar.

Gjykata sa i përket kërkesës për masë të përkohshme konstatoi se është e papranueshme duke e arsyetuar që nuk ka rast *prima facie* për shqiptimin e masës së përkohshme, prandaj kërkesa refuzohet. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesit si të pa pranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI23/14
Parashtrues
Qendra Shoqërore, Sportive dhe Ekonomike
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të Dhomës së
Posaçme të Gjykatës Supreme, ASC-09-0101 dhe ASC-09-
0084, të 13 shtatorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Qendra Shoqërore, Sportive dhe Ekonomike në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Parashtruesi), e përfaqësuar nga ushtruesi i detyrës së drejtorit, z. Bajram Uka.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston aktgjykimet e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme: DHPGJS), ASC-09-0101 dhe ASC-09-0084, të 13 shtatorit 2012, të cilat i ishin dorëzuar parashtruesit më 28 shtator 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të DHPGJS, ASC-09-0101 dhe ASC-09-0084, të 13 shtatorit 2012. Me aktgjykimet e lartpërmendura të DHPGJS-së urdhërohej Parashtruesi që t'ua kompensojë gjashtëmbëdhjetë (16) paditësve dëmin material, të shkaktuar nga zjarri në ndërtesën e parashtruesit në Prishtinë.
4. Përveç kësaj, Parashtruesi nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) të caktojë masën e

përkohshme që të pezullojë përmbarimin e aktgjykimeve të DHPGJS-së derisa të merret vendimi nga Gjykata.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenet 27 dhe 47 të Ligjit dhe në rregullat 54, 55, dhe 56 të Rregullores.

Procedura në Gjykatë

6. Më 7 shkurt 2014, Parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 7 shkurt 2014, Kryetari, me Vendimin GJR. KI23/14, e caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI23/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
8. Më 7 shkurt 2014, Gjykata Kushtetuese e njoftoi Parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 10 shkurt 2014, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 25 shkurt 2000, shpërtheu një zjarr në depot e Parashtruesit (Qendrës Shoqërore, Sportive, Kulturore dhe Ekonomike) në Prishtinë.
11. Ndërmjet vitit 2004 dhe 2005, gjashtëmbëdhjetë (16) paditës paraqitën paditë e tyre në DHPGJS, duke kërkuar kompensimin e dëmeve nga Parashtruesi, për mallrat që ishin brenda depove të marra me qira, të cilat ishin shkatërruar nga zjarri.
12. Më 13 shtator 2012, sipas aktgjykimeve të Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së (ASC-09-0101 dhe ASC-09-0084) *“më 18 gusht 2006, DHPGJS (Numrat e aktgjykimeve të panjohur), nxori aktgjykime individuale në këto raste, duke e shpallur të pandehurin e parë përgjegjës në parim për dëmet që i pësuan paditësit dhe më tej vendosi që do të caktohet një komision i likuidimit nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, i cili do të përcaktojë shumën përfundimtare të dëmeve të pësuar nga paditësit”*.

13. Për më tepër, Kolegji i Ankesave gjeti se: *“Më 7 shtator 2007, DHPGJS ishte njoftuar se komisioni nuk ishte formuar kurrë dhe sipas kërkesës së paditësve, ishte vendosur që të caktohej një ekspert për të vlerësuar lartësinë e dëmeve, pasuar nga aktgjykimet plotësuese për secilin rast”*.
14. Më 18 shkurt 2009, Agjencia e Privatizimit shprehu interesimin që t'i bashkëngjitet padisë në anën e Parashtruesit në DHPGJS.
15. Më 15 tetor 2009, Trupi gjykues i DHPGJS-së në rastet e përbashkëta të pesë (5) paditësve (SCC-05-0080, SCC-06-0029, SCC-06-0470, SCC-06-0482 dhe SCC- 06-0524), e urdhëroi Parashtruesin që të paguajë kompensimin për dëmin material.
16. Më 29 tetor 2009, Trupi gjykues i DHPGJS-së në rastet e përbashkëta të njëmbëdhjetë (11) paditësve, (SCC-04-0011, SCC-04-0012, SCC-04-0098, SCC-04-0116, SCC-04-0121, SCC-04-0199, SCC-04-0028, SCC-05-0067, SCC-05-0072 dhe SCC-05-0073) e urdhëroi Parashtruesin që të paguajë kompensimin për dëmet materiale.
17. Trupi gjykues i DHPGJS-së në aktgjykimet e tij vendosi që *“të trajtojë padinë e AKP-së si kundërpadi. Më tej e refuzoi padinë si të pabazuar”*.
18. Parashtruesi ushtroi ankesë kundër aktgjykimeve të Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme, duke pretenduar se aktgjykimet e lartpërmendura ishin nxjerrë me shkelje thelbësore të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Parashtruesi gjithashtu ankohej për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
19. Më 18 shtator 2012, Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së (aktgjykimet ASC-09-0101 dhe ASC-09-0084) e aprovoi pjesërisht ankesën e paraqitur nga Parashtruesi dhe aktgjykimet e Trupit gjykues të 15 tetorit dhe 29 tetorit 2012, janë ndryshuar në atë mënyrë që shuma, të cilën Parashtruesi ishte urdhëruar që ta paguante, ishte zvogëluar.
20. DHPGJS gjeti se:

[...]

“Në kohën kur ka shpërthyer zjarri nuk ka pasur kompani të specializuara për të ofruar sigurimin e mallrave në Kosovë dhe

kompanitë e tilla u krijuan vetëm pas 5 tetorit 2001, kur ishte nxjerrë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/25. Përgjegjësia e Qendrës Shoqërore, Sportive, Kulturore dhe Ekonomike në Prishtinë për këtë arsye është e paprekur edhe pse paditësit nuk i kishin siguruar mallrat në përputhje me kontratën”.

“Në pajtim me paragrafin e parë të nenit 376.2 të Ligjit për Marrëdhënien e Detyrimeve, kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin. Pasi që në kohën kur shpërtheu zjarri ishte e paqartë kush ishte kryesi, është e arsyeshme që në vend të kësaj të përdoret afati i përgjithshëm prej pesë vitesh, siç parashikohet në paragrafin e dytë”.

21. Më 18 tetor 2012, Parashtruesi paraqiti kërkesë për revizion në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, me pretendim për zbatimin e gabueshëm të së drejtës materiale në aktgjykimet e Kolegjit të Ankesave (ASC-09-0101 dhe ASC-09). Sidoqoftë, sipas Parashtruesit, kërkesa ende nuk i është përcjellë Gjykatës Supreme për shqyrtim.

Pretendimet e parashtruesit

22. Parashtruesi pretendon se aktgjykimet e DHPGJS i kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht me nenin 24 [Barazia para Ligjit] lidhur me nenin 7 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ), nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] lidhur me nenin 6 dhe 13 të KEDNJ-së, nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] lidhur me nenin 8 të KEDNJ-së dhe me nenin 41 [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike].

23. Në këtë drejtim, Parashtruesi pretendon si në vijim:

[...]

“ju ka mohuar e drejta e qasjes në dokumente publike, pasi të njëjtit asnjëherë, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, nuk ia lejuar që të paraqitet para Gjykatës Raporti i Policisë, i cili raport tregon saktë se zjarri ka qenë aksidental dhe se shkaku i zjarrit është akoma i papërcaktuar”.

[...]

“se Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme duke mos e dërguar kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme është duke e penguar Parashtruesin që t’i shterojë të gjitha mjetet juridike dhe kështu e ka shkelur Ligjin për Procedurën Kontestimore, Ligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme dhe Ligjin për Marrëdhëniet Detyrimore dhe nenet 21 dhe 22 të Ligjit për Gjykata për shkak se Gjykata Supreme ka kompetencë ekskluzive për të shqyrtuar dhe vendosur për mjetet e jashtëzakonshme juridike të paraqitura kundër vendimeve të gjykatave të rregullta”.

Pranueshmëria e kërkesës

24. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e Parashtruesit, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

25. Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor (...)”.

26. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

...

b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi...”.

27. Në këto rrethana, Gjykata vëren se aktgjykimet që kontestohen nga Parashtruesi janë të 13 shtatorit 2012, të cilat i janë dorëzuar Parashtruesit më 28 shtator 2012, kurse kërkesa ishte dorëzuar më 7 shkurt 2014, përderisa është dashur të dorëzohej jo më larg se 28 janari 2013.

28. Prandaj, Gjykata konsideron se kërkesa e Parashtruesit nuk është në përputhje me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të

Rregullores, pasi që ajo ishte dorëzuar pas më shumë se 1 viti e gjysmë nga dita e dorëzimit të vendimeve të kontestuar.

29. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa është e paafatshme.
30. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor katër(4) mujor, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri ligjore, duke siguruar se rastet që kanë të bëjnë me çështje të Kushtetutës të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe se vendimet e mëparshme nuk janë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar (Shih rastin O'Loughlin dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr. 23274/04, GJEDNJ, Aktvendimi i 25 gushtit 2005).
31. Sa i përket pretendimit të bërë nga Parashtruesi lidhur me përpjekjen për "shterimin e të gjitha mjeteve juridike" dhe se kërkesa e tij për revizion është duke u mbajtur nga DHPGJS-ja, Gjykata vëren se neni 10 paragrafi 14 i Ligjit për Dhomen e Posaçme të Gjykatës Supreme parasheh se, *"Të gjitha aktgjykimet dhe aktvendimet e kolegjit të apelit janë të prera dhe nuk i nënshtrohen asnjë apeli tjetër"*. Kështu, Parashtruesi mund ta kishte dorëzuar kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese brenda katër muajsh nga data në të cilën i ishin dorëzuar aktgjykimet e Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së.

Kërkesa për masë të përkohshme

32. Parashtruesi kërkon nga Gjykata *"të merr vendim për lejimin e masës së përkohshme deri në Vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Aktgjykimeve ASC-09-0101 dhe ASC-09-0084 të 13 shtatorit 2012 nga Gjykata Kushtetuese, në mënyrë që të shmangë pagesën e kompensimit nga ana e Parashtruesit në shumë prej 2.770.000 plus kamata e caktuar, pasi që është shumë e madhe dhe e papërbalueshme, duke marrë parasysh se Gjykata Themelore në Prishtinë ka lëshuar Urdhrin E. nr. 341/2013 të 31 janarit 2014 për përmbarimin e Aktgjykimeve të DHPGJS-së"*.
33. Për më tepër, Parashtruesi pretendon se *"përmbarimi i aktgjykimeve të lartcekura do t'i shkaktojë Parashtruesit të kërkesës vështirësi financiare dhe mund të vijë edhe deri te privatizimi i ndërmarrjes, nëse nuk lejohet masa e përkohshme"*.
34. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 55 (4) të Rregullores së punës, i cili parasheh se:

“(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme.

(...)

Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës”.

35. Siç u cek më lart, kërkesa është e papranueshme. Rrjedhimisht, nuk ka rast *prima facie* për shqiptimin e masës së përkohshme. Prandaj, kërkesa për masë të përkohshme refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) dhe 55 (5) të Rregullores, më 10 shkurt 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. Ky vendim do t'u kumtohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, ne pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. dr. Enver Hasani

KI158/13, Prend Prenkpalaj, Aktvendim i datës 23 janar 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërise së Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prizren, P. nr. 13/09, të 16 prillit 2010

Rasti KI158/13, vendim i 23 janarit 2014

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, liritë dhe të drejtat individuale, kërkesë e paafatshme

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren P. nr. 13/09, i janë cenuar të drejtat e e tij te garantuara me Kushtetutë, pa specifikuar konkretisht se cila e drejtë i është shkelur.

Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vlerësoi se parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën e tij më 14 tetor 2013, përderisa vendimi i fundit, Ap. Nr. 102/2010, i Gjykatës së Qarkut në Prizren, i ishte dorëzuar atij më 6 nëntor 2010. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën e tij pas skadimit të afatit të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës. Si e tillë, Kërkesa u shpall e papranueshme nga Gjykata, për shkak të mos-respektimit të afateve kohore për sfidimin e vendimeve te autoriteteve publike.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI158/13
Parashtrues
Prend Prenkpalaj
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës
Komunale në Prizren, P. nr. 13/09, të 16 prillit 2010**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u dorëzua nga z. Prend Prenkpalaj (në tekstin e mëtejme: parashtruesi), me vendbanim në fshatin Zym, komuna e Prizrenit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktvendimin P. nr. 13/09, të Gjykatës Komunale në Prizren, të 16 prillit 2010, i cili iu dorëzua parashtruesit më 28 prill 2010.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit P. nr. 13/09, të Gjykatës Komunale në Prizren, i cili pretendohet t'i ketë shkelur të drejtat e tij të njeriut, të garantuara me Kushtetutë. Sidoqoftë, parashtruesi nuk kishte saktësuar se cila dispozitë kushtetuese pretendohet të jetë shkelur, por vetëm theksoi se *“Sepse është shkelur e drejta e palës për një marrje të vendimit në kohë të arsyeshme dhe i drejtë - sepse pala akuzuese në rastin konkret ka mbetur pa u ndëshkua - për shkak se çështja nuk është trajtuar me kohë nga institucioni.”*

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 14 tetor 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 4 nëntor 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.
7. Më 4 nëntor 2013, parashtruesi ishte njoftuar për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 14 nëntor 2013, parashtruesit i ishte kërkuar të dorëzojë dokumente shtesë në Gjykatë, të cilat ishin përmendur në kërkesë, po nuk ishin bashkëngjitur.
9. Më 21 nëntor 2013, Gjykata i pranoi nga parashtruesi i kërkesës dokumentet e kërkuara.
10. Më 23 janar 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi Raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 17 tetor 2008, gjyqtari V. D. nga Gjykata Komunale në Prizren mori Aktvendimin P. nr. 1096/02 për pezullimin e procedurës penale, të iniciuar nga parashtruesi kundër P. P., N. P. dhe Xh. P., të cilët ishin të pandehur të përbashkët, të akuzuar për veprën penale të lëndimit të rëndë, kundër parashtruesit.
12. Në vendimin e tij, gjyqtari V. D. nga Gjykata Komunale në Prizren, theksoi se *“Në pajtim me dispozitat e nenit 95 paragrafi 1.4 të*

Ligjit për Procedurën Penale, për këtë lloj të veprës penale parashihet parashkrimi relativ...”

13. Më 8 janar 2009, Kolegji shqyrtues, i përbërë nga tre gjyqtarë nga Gjykata Komunale në Prizren, vendosi për ankesën e parashtruesit si palë e dëmtuar, të ushtruar kundër Aktvendimit P. nr. 1096/02, dhe e nxori Aktvendimin Kp. Nr. 66/08, duke e aprovuar ankesën e parashtruesit si të bazuar dhe e ktheu rastin në rigjykim.
14. Më 25 gusht 2009, gjyqtari V. D. nga Gjykata Komunale në Prizren vendosi në lidhje me rastin dhe nxori Aktvendimin P. nr. 13/09, që është identik me Aktvendimin e mëparshëm, P. nr. 1096/02.
15. Në një datë të pacaktuar të vitit 2009, parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren, kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prizren, P. nr. 13/09, duke pretenduar *“shkelje të dispozitave të ligjit penal”*. Në të njëjtën mënyrë, prokurori publik komunal ushtroi ankesë kundër vendimit të njëjtë të Gjykatës Komunale, duke pretenduar *“konstatimin e gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljen e dispozitave të ligjit penal”*.
16. Më 15 tetor 2009, Gjykata e Qarkut në Prizren nxori Aktvendimin Ap. nr. 125/2009, me të cilin refuzohej ankesa e prokurorit publik komunal, si e pabazuar, dhe e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të palejueshme.
17. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, duke pretenduar *“shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.”*
18. Më 16 prill 2010, Gjykata Komunale në Prizren nxori Aktvendimin P. nr. 13/09, duke hedhur poshtë si të palejueshme kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë.
19. Në vendimin e saj, Gjykata Komunale shpjegoi se *“Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës e ka përcjellë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të paraqitur nga pala e dëmtuar Prend Prenkpalaj, në Gjykatën Komunale, për procedurë të mëtejme, bazuar në juridiksionin e saj.”* [...] *“Gjykata gjen se pala e dëmtuar, Prend Prenkpalaj nuk është palë e autorizuar për të iniciuar mbrojtje të ligjshmërisë. Sipas nenit 452 para. 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të parashtrohet nga Prokurori Publik i Kosovës, i pandehuri dhe përfaqësuesi i tij ...”*

20. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren, kundër Aktvendimit P. nr. 13/09, të Gjykatës Komunale në Prizren.
21. Më 22 tetor 2010, Gjykata e Qarkut nxori Aktvendimin Ap. Nr. 102/2010, duke e hedhur poshtë ankesën si të pabazuar.

Pretendimet e parashtruesit

22. Parashtruesi pretendon se *“Është shkelur e drejta e palës për një marrje të vendimit në kohë të arsyeshme dhe i drejtë, sepse pala akuzuese në rastin konkret ka mbetur pa u ndëshkuar, për shkak se çështja nuk është trajtuar me kohë nga institucioni.”*

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë së kërkesës

23. Gjykata vëren se në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

25. Gjykata më tej merr parasysh nenin 49 të Ligjit, i cili parasheh që:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor (...)”.

26. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, i cili parasheh që:

“1. Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

...

b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi...”.

27. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata gjen se parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën e tij më 14 tetor 2013, përderisa vendimi i fundit, Ap. Nr. 102/2010, i Gjykatës së Qarkut në Prizren, i ishte dorëzuar atij më 6 nëntor 2010. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën e tij pas skadimit të afatit të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.
28. Pavarësisht nga faktiseparashtruesi i kërkesësnëkërkesën e tijshprehimishtkonteston Vendimin, P.nr. 13/09, tëGjykatës Komunale nëPrizren, të datës 16 prill 2010,Gjykatavëren se parashtruesikishte kontestuar këtëvendimnë Gjykatën e Qarkutnë Prizren, nga kuai ka marrëvendiminAp. Nr. 102/2010. Gjykatae konsideron këtë të jetëvendimi i funditdhesi datëprej kurafatiprej 4muajshfillon të llogaritet.
29. Gjykata përkujton se qëllimi i afatit ligjor prej katër muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës, është të promovojë siguri ligjore, duke siguruar se rastet që kanë të bëjnë me çështje të Kushtetutës të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme si dhe vendimet e kaluara të mos jenë vazhdimisht të hapura për kontestim (Shih rastin O'LOUGHLIN dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr. 23274/04, GJEDNJ, Vendimi i 25 gushtit 2005).
30. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa është e pasafatshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, rregullin 36 (1) b) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 23 janar 2014, njëzëri:

VENDOSI

- I. TË SHPALLË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KOMUNIKOJË palëve këtë vendim;
- III. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe
- IV. TË SHPALLË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI65/12, Fuad Gjakova, Aktvendim i datës 2 dhjetor 2013 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac.nr. 246/2011, të 5 korrikut 2011

Rasti KI65/12, vendimi i 2 dhjetor 2013.

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, e paaftshme.

Parashtruesi pretendon se ai është larguar nga puna, “pa asnjë arsye” prandaj ai duhet të kthehet në vendin e tij të mëparshëm të punës. Përveç kësaj, parashtruesi kërkon kompensimin e pagës së tij prej kohës së largimit deri në kohën e kthimit.

Parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatë më 3 korrik 2012, që do të thotë se kërkesa është dorëzuar pas afatit prej katër (4) muajsh, të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës.

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, më 2 dhjetor 2013, njëzëri deklaroi kërkesën të papranueshme si të pa afatshme.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në**

Rastin Nr. KI65/12

Parashtrues

Fuad Gjakova

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së
Qarkut në Pejë, Ac.nr. 246/2011, të 5 korrikut 2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Fuad Gjakova (në tekstin e mëtejme: parashtruesi), me vendbanim në Pejë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin Ac. nr. 246/2011 të Gjykatës së Qarkut në Pejë, të 5 korrikut 2011, i cili i ishte dorëzuar atij më 28 korrik 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, i cili pretendohet të jetë “i gabueshëm dhe i padrejtë.”
4. Parashtruesi nuk e saktëson asnjë dispozitë kushtetuese.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit nr. 03/L-121, për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009, (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 56

(2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 6 korrik 2012, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 4 shtator 2012, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. KI65/12, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Në ditën e njëjtë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. KSH. KI65/12, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Ivan Čukalović (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 5 qershor 2013, Gjykata e Apelit u njoftua për kërkesën.
9. Më 2 dhjetor 2013, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i propozoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesi ishte në marrëdhënie pune me Korporatën Energjetike të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KEK) si kryepunëtor i Shkycjes në Njësinë e Rrjetit në Pejë.
11. Më 14 janar 2008, menaxheri i Njesisë së Rrjetit të KEK-ut në Pejë, (Vendimi nr. 33) e suspendoi përkohësisht parashtruesin e kërkesës, për shkak të refuzimit të kryerjes së detyrës që i ishte caktuar atij. Parashtruesi ushtroi ankesë në Komisionin disiplinor.
12. Më 28 janar 2008, Komisioni disiplinor i shkallës së dytë (Vendimi nr. 476) e hodhi poshtë ankesën e dorëzuar nga parashtruesi si të pabazuar. Përveç kësaj, ishte caktuar një shqyrtim gojor më 28 mars 2008.
13. Më 28 mars 2008, Komisioni disiplinor i Divizionit të Rrjetit, njësia në Pejë (Vendimi nr. 361) i shkëputi parashtruesit marrëdhënien e punës menjëherë pas plotfuqishmërisë së vendimit. Parashtruesi ushtroi ankesë kundër këtij vendimi në Komisionin disiplinor të shkallës së dytë.

14. Më 3 prill 2008, Komisioni disiplinor i shkallës së dytë (Vendimi nr. 1932) e hodhi poshtë ankesën e dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës si të pabazuar.
15. Më 23 prill 2008, pas vendimit të plotfuqishëm të Komisionit disiplinor të shkallës së dytë, parashtruesi u njoftua se ishte shkëputur marrëdhënia e tij e punës.
16. Më 8 prill 2008, parashtruesi paraqiti padi për të drejtën e tij në punë, në Gjykatën Komunale në Pejë.
17. Më 1 shtator 2009, Gjykata e Komunale në Pejë, (Aktgjykimi C. nr. 183/09) aprovoi ankesën si të bazuar dhe e obligoi KEK-un ta kthejë parashtruesin në vendin e tij të mëparshëm të punës. KEK-u ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë kundër vendimit të Gjykatës Komunale.
18. Më 9 shkurt 2010, Gjykata e Qarkut në Pejë, me Aktvendimin Ac. nr. 398/09, e aprovoi ankesën si të bazuar. Gjykata e Qarkut e anuloi vendimin e gjykatës së instancës më të ulët dhe e ktheu rastin prapa për rigjykim në gjykatën e instancës së parë.
19. Më 18 maj 2010, Gjykata Komunale në Pejë, me Aktgjykimin C. nr. 84/10, e refuzoi ankesën si të pabazuar. Parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë kundër vendimit të Gjykatës Komunale.
20. Më 28 maj 2010, Gjykata e Qarkut në Pejë, me Aktgjykimin Ac. nr. 270/2010, e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar. Parashtruesi paraqiti kërkesë për revizion ndaj këtij vendimi.

Pretendimet e parashtruesit

21. Parashtruesi pretendon se ai është larguar nga puna, “*pa asnjë arsye*” prandaj ai duhet të kthehet në vendin e tij të mëparshëm të punës. Përveç kësaj, parashtruesi kërkon kompensimin e pagës së tij prej kohës së largimit deri në kohën e kthimit.

Pranueshmëria e kërkesës

22. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet për pranueshmëri, të

përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.

23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh që *“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të llogaritet që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor[...]”*.
24. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës, që parasheh: *“Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi”*.
25. Në rastin konkret, Gjykata vëren se vendimi i fundit i gjykatës në lidhje me parashtruesin e kërkesës është Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 246/2011, i 6 korrikut 2011, i cili iu dorëzua atij më 28 korrik 2011. Parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatë më 3 korrik 2012, që do të thotë se kërkesa është dorëzuar pas afatit prej katër (4) muajsh, të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës. Nga kjo rrjedh se kërkesa është e paafatshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, më 2 dhjetor 2013, njëzëri:

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KOMUNIKOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në përputhje me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI88/12, Emrije Asllani, Aktvendim i datës 2 dhjetor 2013 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Prokurorit të Shtetit,

Rasti KI88/12, vendimi i 2 dhjetorit 2013.

Fjalër kyçe: Kërkesë individuale, rasti penal, mohim i të drejtës në gjykim të drejt, kërkesa e paafatëshme.

Kërkesa e parashtruesës është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës. Në kërkesë, parashtruesja e konteston në veqanti Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prizren, ku thekson që i është mohuar e drejta në gjykim të drejtë. Megjithatë vendimi përfundimtarë është Njoftimi i Prokurorit të Shtetit, Kzz. nr. 65/09, të 29 prillit 2009

Parashtruesja nuk ka përmendur apo saktësuar ndonjë dispozitë ligjore të cilën pretendon që i është shkelur.

Parashtruesja e kërkesës ishte palë e demtuar në procedure kunder A. L., ku ajo pretendonë se qdo gjë është bërë në dobi të palës kundërshtare dhe prandaj kërkon që rasti të kthehet prapa për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Kushtetuese vendosi sa i përket pranushmërisë së kërkesës e cila është parashtruar nga ana e parashtrueses, duke u bazuar në nenin 49 të ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36 pika 1 (b) të rregullorës së punës, ku konstatojë që, kërkesa duhet të hidhet poshtë si e paafatëshme, për arsye se parashtruesja nuk e kishte rrespektuar afatin kohor për parashtrimin e kërkesës në baz të neneve të cekura më lartë, që sipas këtyre neneve është 4 muaj. Duke u bazuar në atë që u theksua më lartë, Gjykata vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesit si të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI88/12
Parashtrues
Emrije Asllani
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Prokurorit të
Shtetit,
Kzz. nr. 65/09, të 29 prillit 2009

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga znj. Emrije Asllani (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës), me vendbanim në Reçan.

Vendimi i kontestuar

2. Në kërkesë, parashtruesja e konteston në veçanti Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prizren K. nr. 130/06 të 17 marsit 2008, C. nr. 215/06 mars 2008, dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren Kz. nr. 71/98 të 13 tetorit 2008, të cilat parashtruesja i pranoi në një datë të pacaktuar.
3. Sidoqoftë, vendimi përfundimtar në këtë rast është Njoftimi i Prokurorit të Shtetit, Kzz. nr. 65/09, i 29 prillit 2009.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet të ketë mohuar të drejtën e parashtrueses në gjykim të drejtë.

5. Parashtruesja e kërkesës nuk e saktëson asnjë dispozitë kushtetuese.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit, Nr. 03/L-121, për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009, (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 2 tetor 2012, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 2 nëntor 2012, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. KI88/12, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Në ditën e njëjtë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. KSH. KI88/12, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.
9. Më 2 dhjetor 2013, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesja e kërkesës ishte palë e dëmtuar në rastin kundër A. L.
11. Më 17 mars 2008, Gjykata Komunale në Prizren (Aktgjykimi P. nr. 130/2006) e shpalli A. L. fajtor për veprën penale të “shkaktimit të lëndimit të lehtë trupor” nga neni 153.2 i KPK.
12. Më 13 tetor 2008, Gjykata e Qarkut në Prizren (Aktgjykimi Kz. nr. 71/2008) e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të 17 marsit 2008, duke e refuzuar padinë kundër A. L. Parashtruesja e kërkesës si palë e dëmtuar paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.
13. Më 22 janar 2009, Gjykata Komunale në Prizren (Aktvendimi K. nr. 130/06) e refuzoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të paraqitur nga parashtruesja e kërkesës. Parashtruesja e kërkesës

ushtroi ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën e Qarkut në Prizren.

14. Më 25 mars 2009, Gjykata e Qarkut në Prizren, (Aktvendimi Kz. nr. 22/09) e aprovoi ankesën e parashtrueses së kërkesës dhe e prishi Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prizren, K. nr. 130/06 të 2009 *“duke e urdhëruar gjykatën e shkallës së parë t’i dërgojë shkresat e lëndës te Prokurori Publik i Kosovës në Prishtinë, si autoritet i autorizuar dhe kompetent për të vendosur për kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë”*.
15. Më 29 prill 2009, Prokurori i Shtetit e njoftoi parashtruesen (Kzz. nr. 65/09) se nuk do të paraqesë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë pasi që *“nuk ka bazë ligjore për paraqitjen e kërkesës së tillë”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesja e kërkesës ishte palë e dëmtuar në procedurën kundër A. L., ku ajo pretendon se *“çdo gjë është bërë në dobi të A. L. dhe prandaj kërkon që rasti të kthehet prapa për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë”*.
17. Parashtruesja e kërkesës nuk thirret në asnjë dispozitë kushtetuese në veçanti.

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata vëren se, për të qenë në gjendje të gjykojë për ankesën e parashtrueses, së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka plotësuar kushtet për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
19. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit i cili parasheh se *“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor[...]”*.
20. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës, që parasheh: *“Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesit”*.

21. Në rastin konkret, Gjykata vëren se vendimi i fundit në lidhje me parashtruesen e kërkesës është Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, Kz. nr. 22/09, i 25 marsit 2009, i cili është pasuar nga njoftimi i Prokurorit të Shtetit, i 20 prillit 2009. Parashtruesja e parashtroi kërkesën në Gjykatë më 2 tetor 2012, që do të thotë se kërkesa është dorëzuar pas afatit prej katër (4) muajsh, të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës. Nga kjo rezulton që kërkesa është e paafatshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 49 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, më 2 dhjetor 2013, njëzëri,

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u kumtohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI117/12/A, K119/12/A, KI121/12/A, KI138/12, Nexhmije Brezhnica, Fatmire Bardhi, Feriha Shala, Rifat Sadiku, Aktvendim i datës 19 nëntor 2013 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Ac. nr. 130/12, të 17 shtatorit 2012, Ac. nr. 1070/2012, të 2 majit 2013, Ac. nr. 138/12, të 9 korrikut 2012, Ac. nr. 1068/2012, të 2 majit 2013

Rastet KI117/12/A, K119/12/A, KI121/12/A, KI138/12, vendimi i 19 netorit 2013.

Fjalë kyçe: Kërkesa individuale, qartazi e pabazuar.

Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se ata kanë punuar në NSH “Qyqavica”, në Vushtrri deri më 1991, kur forcat serbe i dëbuan me forcë nga puna dhe i diskriminuan.

Parashtruesit pretendojnë se ishin shkelur të drejtat e tyre, të garantuara me Kushtetutë, sepse ata kanë të drejtë në një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së “Qyqavica” si formë e kompensimit për pagat e tyre prej vitit 1991 deri më 1999. Parashtruesit thirren në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

Gjykata vëren se parashtruesit nuk e kanë mbështetur pretendimin e tyre në baza kushtetuese dhe nuk kanë ofruar prova se të drejtat dhe liritë themelore u janë shkelur nga gjykatat e rregullta.

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, rregullin 36 (1) a) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 19 nëntor 2013, njëzëri deklaron kërkesën të papranueshme si qartazi të pa bazuar.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në**

Rastet Nr.

KI117/12/A, KI119/12/A, KI121/12/A, KI138/12

Parashtrues

**Nexhmije Brezhnica, Fatmire Bardhi, Feriha Shala, Rifat
Sadiku**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së
Qarkut në Mitrovicë, Ac. nr. 130/12, të 17 shtatorit 2012, Ac.
nr. 1070/2012, të 2 majit 2013, Ac. nr. 138/12, të 9 korrikut
2012, Ac. nr. 1068/2012, të 2 majit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar

Ivan Čukalović,

zëvendëskryetar

Robert Carolan,

gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova,

gjyqtare

Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe

Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi

1. Kërkesat u dorëzuan nga parashtruesit si në vijim:

KI117/12/A Nexhmije Salihu Brezhnica, me vendbanim në
Mitrovicë;

KI119/12/A Fatmire Bardhi, me vendbanim në Vushtrri;

KI121/12/A Feriha Shala, me vendbanim në Vushtrri,

KI138/12 Rifat Sadiku, me vendbanim në Vushtrri.

Vendimet e kontestuara

2. Parashtruesit e kontestojnë veçanërisht Aktgjykimin kolektiv të
Gjykatës Komunale në Vushtrri të Republikës së Kosovës, C. nr.
215/06 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Komunale në Vushtrri), të
3 korrikut 2006, i cili iu dorëzua parashtruesve në një datë të
pacaktuar.

3. Mirëpo, vendimet përfundimtare lidhur me këto raste janë vendimet vijuese të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë:
 - a. KI117/12/A, Nexhmije S. Brezhnica, Ac. nr. 130/12, të 17 shtatorit 2012, i cili u pranua nga parashtruesja e kërkesës në një datë të pacaktuar;
 - b. KI119/12/A, Fatmire Bardhi, Ac. nr. 1070/2012, të 2 majit 2013, i cili u pranua nga parashtruesja e kërkesës në një datë të pacaktuar;
 - c. KI121/12/A, Feriha Shala, Ac. nr. 138/12, të 9 korrikut 2012, i cili u pranua nga parashtruesja e kërkesës në një datë të pacaktuar;
 - d. KI138/12, Rifat Sadiku, Ac. nr. 1068/2012, të 2 majit 2013, i cili u pranua nga parashtruesi i kërkesës në një datë të pacaktuar.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të lartcekura të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë.
5. Pavarësisht nga kjo, parashtruesit në kërkesë kontestuan Aktgjykimin kolektiv të Gjykatës Komunale në Vushtrri, C. nr. 215/06, të 3 korrikut 2006, për shkak të mospërmbarimit të vendimit.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Parashtruesit dorëzuan kërkesat e tyre më 20 nëntor 2012, më 21 nëntor 2012, më 23 nëntor 2012 dhe më 31 dhjetor 2012.
8. Më 6 dhjetor 2012, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. KI117/12, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Në të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. KSH. KI117/12, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga

gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

9. Më 19 prill 2013, kërkesa iu komunikua Gjykatës Themelore në Vushtrri (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
10. Më 17 tetor 2013, Gjykata Themelore në Vushtrri i dorëzoi në Gjykatë vendimet e Gjykatës Komunale në Vushtrri dhe të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, të cilat nuk u dorëzuan fillimisht nga parashtruesit.
11. Më 31 tetor 2013, Gjykata informoi parashtruesit në lidhje me dokumentet e dorëzuara nga Gjykata Themelore në Vushtrri.
12. Të njëjtën ditë, në përputhje me nenin 37 të Rregullores së punës, Gjykata njoftoi parashtruesit për bashkimin e kërkesave.
13. Parashtruesit nuk paraqitën asnjë kundërshtim ndaj vendimit për bashkimin e kërkesave.
14. Më 18 nëntor 2013, Kolegji shqyrtues pasi shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Parashtruesit ishin punonjës në Ndërmarrjen Shoqërore “Qyqavica” deri më 1992.
16. Sipas dokumenteve të dorëzuara, bazuar në Aktgjykimin kolektiv të Gjykatës Komunale në Vushtrri, C. nr. 215/05, të 3 korrikut 2006, NSH “Qyqavica” në Vushtrri, ishte e detyruar t’i përmbushë obligimet e saj në lidhje me kompensimin e pagës ndaj të gjithë parashtruesve të kërkesës nga viti 1992 deri më 1999, me një kamatë prej 4.5% në vit që nga 29 qershori 2005, deri në pagesën përfundimtare.
17. Parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Komunale në Vushtrri për përbarimin e Aktgjykimit të mëparshëm të Gjykatës Komunale, C. nr. 215/05, të 3 korrikut 2006.
18. Më 29 shtator 2006, Gjykata Komunale në Vushtrri vendosi për përbarimin e Aktgjykimit C. nr. 215/05, të 3 korrikut 2006 (p. sh.: Vendimi E. nr. 206/08, të 12 shkurtit 2008, në rastin e parashtrueses së parë, Nexhmije SalihuBrezhnica). Llogaria e NSH

“Qyqavica” ishte bllokuar dhe “Banka e Re në Kosovë”, dega në Vushtrri, ishte urdhëruar t’ua paguajë parashtruesve shumën e caktuar së bashku me kamatën e caktuar.

19. Mirëpo, më 21 gusht 2008, Gjykata Komunale në Vushtrri mori vendim për secilin parashtrues për pezullimin e procedurës përmbarimore (p.sh.: Vendimi E. nr. 762/06, të 29 shtatorit 2006, në rastin e parashtrueses së parë, Nexhmije Salihu Brezhnica).
20. Në vendimin e saj, Gjykata Komunale në Vushtrri e arsyetoi Vendimin për pezullimin e ekzekutimit, duke iu referuar shkresës së 31 dhjetorit 2007 të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit duke kërkuar nga Gjykata Komunale që *“... lidhur me të gjitha rastet që kanë të bëjnë me NSH “Qyqavica”, ta pezullojë përmbarimin, pasi që Rregullorja e UNMIK-ut 2005/4 parasheh se me miratimin e rregulloreve të veçanta në lidhje me rregullimin e fushave të caktuara është përjashtuar LPP-ja [Ligji për procedurën përmbarimore] dhe se NSH-ja e përmendur nuk është në procedurë të likuidimit, por kreditori mund t’i realizojë të drejtat e tij në AKM [Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit] dhe se këto kërkesa do të konsiderohen si tituj ekzekutivë dhe në procedurën përmbarimore të ndërmarrjes, kërkesat do të përmbushen nga Komisioni i Likuidimit të NSH-së”*.
21. Kundër Vendimit të Gjykatës Komunale në Vushtrri (p.sh.: Vendimi E. nr.206/08, i 12 shkurtit 2008, në rastin e parashtrueses së parë, Nexhmije Salihu Brezhnica) parashtruesit ushtruan ankesë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë.
22. Gjykata e Qarkut në Mitrovicë e refuzoi ankesën e parashtruesve dhe i vërtetoi vendimet e Gjykatës Komunale (p.sh.: Vendimi Ac. nr. 130/12, i 17 shtatorit 2012, në rastin e parashtrueses së parë, Nexhmije Salihu Brezhnica). Gjykata e Qarkut konstatoi se *“NSH-ja është në kompetencën ekskluzive të Dhomës së Posaçme, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/13 për Themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit”*.

Pretendimet e parashtruesve

23. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se ata kanë punuar në NSH “Qyqavica”, në Vushtrri deri më 1991, kur forcat serbe i dëbuan me forcë nga puna dhe i diskriminuan.

24. Parashtruesit pretendojnë se ishin shkelur të drejtat e tyre, të garantuara me Kushtetutë, sepse ata kanë të drejtë në një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së “Qyqavica” si formë e kompensimit për pagat e tyre prej vitit 1991 deri më 1999. Parashtruesit thirren në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata vëren se që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesve, duhet së pari të vlerësojë nëse ata i kanë plotësuar kriteret për pranueshmëri të parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregullore të punës.
26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, i cili parasheh se *“Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: (...) kërkesa është qartazi e bazuar”*.
27. Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është detyrë e Gjykatës të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë), që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Prandaj, kjo Gjykatë nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t’i interpretojnë dhe t’i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM], Nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).
28. Si përmbledhje, Gjykata vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në atë mënyrë sa që procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesit e kësaj kërkesë të kenë pasur gjykim të drejtë (shih, ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropianpërtë Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, kërkesa nr. 13071/87, i miratuar më 10 korrik 1991).
29. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesit nuk e kanë mbështetur pretendimin e tyre në baza kushtetuese dhe nuk kanë ofruar prova se të drejtat dhe liritë themelore u janë shkelur nga gjykatat e rregullta.

30. Gjykata vëren se Gjykata e Qarkut në Mitrovicë e kishte arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme Vendimin e saj për ta refuzuar ankesën e parashtruesit duke iu referuar Rregullores së UNMIK-ut në lidhje me kompetencën e Dhomës së Posaçme për ndërmarrjet shoqërore, të administruara nga Agjencia e Privatizimit të Kosovës. Prandaj, Gjykata nuk mund të gjejë se procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmëri të kërkesës Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
31. Për më tepër, duke iu referuar rasteve të gjykuara nga Gjykata lidhur me pezullimin e procedurës përmbartimore, konkretisht lidhur me rastin Nr. KIO8/09, Sindikata e Pavarur e Punëtorëve të IMK - Fabrika e Çelikut në Ferizaj, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2010, Gjykata konsideron se duke u bazuar në dokumentet e dorëzuara dhe procedurat e përfunduara, kjo kërkesë dallon nga rasti i lartpërmendur për shkak të arsyes si në vijim: Gjykata Komunale me vendimet e saj vendosi ta pezullojë procedurën e përmbartimit, për shkak të faktit se NSH “Qyqavica” në Vushtrri është nën juridiksionin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Siç u tha më lart, NSH-të, në pajtim me legjislacionin e lartpërmendur, janë kompetencë ekskluzive e Dhomës së Posaçme.
32. Më tej, Gjykata përsërit se parashtruesit janë të obliguar që të njoftojnë Gjykatën për të gjitha rrethanat relevante në lidhje me kërkesën dhe të mos mbajnë ndonjë informatë që kanë në dijeni. Përndryshe, ruajtja apo vënia e Gjykatës në lajthitje, mund të ngrejë çështjen e keqpërdorimit të së drejtës për peticion.
33. Gjykata vëren se në rastin konkret, parashtruesit nuk e kanë njoftuar Gjykatën lidhur me Vendimin e Gjykatës Komunale në Vushtrri (E. nr. 273/08, të 21 shkurtit 2008) për të anuluar procedurën e përmbartimit dhe Vendimin e Gjykatës së Apelit (Ac. nr. 170/2012, të 24 shtatorit 2012) për të prishur vendimin e lartpërmendur të Gjykatës Komunale në Vushtrri. Një sjellje e tillë nuk është në pajtim me të drejtën e individit për peticion, sipas standardeve juridike evropiane (shih, *mutatis mutandis*, Vendimi i KEDNJ Hadrabova dhe të tjerët kundër Republikës Çeke, Vendimi i KEDNJ-së për papranueshmërinë e kërkesës nr. 42165/02 dhe 466/03, të 25 shtatorit 2007).
34. Si përmbledhje, parashtruesit nuk treguan pse dhe si u ishin shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë. Deklarata e thjeshtë se është shkelur Kushtetuta, nuk mund të konsiderohet ankesë kushtetuese. Prandaj, në pajtim me rregullin 36 (1) c) të

Rregullores së punës, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe prandaj e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, rregullin 36 (1) a) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 19 nëntor 2013, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI11/12, Zef Lekaj, Aktvendim i datës 3 dhjetor 2013 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 235/08, të 5 shtatorit 2011.

Rasti KI11/12, vendimi i 3 dhjetorit 2013.

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, qartazi e pabazuar.

Parashtruesi pohon se ka punuar në NSH “EEK” për 25 vite deri në vitin 1991, si dhe që “pretendimet për përdorimin e mjeteve të punës në kundërshtim me aktet normative, si dhe pengimin e punëtorëve të tjerë, janë fakt i qartë i diskriminimit kundër tij dhe gjithë punëtorëve shqiptarë në përgjithësi”.

Parashtruesi pretendon që “vendimet e Gjykatës Komunale në Prishtinë, të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, si dhe të Gjykatës Supreme të Kosovës, paraqesin dështim në sigurim të barazisë dhe të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm”. Parashtruesi thirret në nenin 24 [Barazia Para Ligjit] si dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

Gjykata vëren se parashtruesi nuk e ka mbështetur pretendimin e tij në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar prova që të drejtat dhe liritë themelore të tij janë cenuar nga gjykatat e rregullta.

Kështu, në bazë të rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, më 2 dhjetor 2013, Gjykata njëzëri deklaroi kërkesën si qartazi e pabazuar, si dhe rrjedhimisht, e papranueshme.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në**

Rastin Nr. KI11/12

Parashtrues

Zef Lekaj

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës
Supreme të Kosovës, Rev. nr. 235/08, të 5 shtatorit 2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović,
zëvendëskryetar
Robert Carolan,
gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova,
gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar,
dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Zef Lekaj (në tekstin e mëtejme: parashtruesi), me banim në Prishtinë, përfaqësuar nga z. Gani Tigani, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 235/2008, të 5 shtatorit 2011, i cili i është dorëzuar atij më 7 tetor 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, i cili pretendohet të jetë “dështim në barazi dhe në të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm”.

4. Në këtë drejtim, parashtruesi pretendon që janë shkelur neni 21 [Parimet e Përgjithshme], 24 [Barazia Para Ligjit] si dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

Baza juridike

5. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 6 shkurt 2012, parashtruesi ka parashtruar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 7 shkurt 2012, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin nr. GJR. KI11/12, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Më 10 tetor 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin nr. KSH. KI11/12, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani, pasi mandati i gjyqtarës Iliriana Islami, gjyqtare e Gjykatës, kishte përfunduar.
8. Më 5 qershor 2013, Gjykata Supreme ishte njoftuar lidhur me kërkesën.
9. Më 3 dhjetor 2013, Kolegji shqyrtues pasi shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesi ishte në marrëdhënie pune në NSH “Elektro-Ekonomia e Kosovës (në tekstin e mëtejme: EEK, tashmë e njohur si KEK), si stomatolog specialist në protetikë, deri në vitin 1991.
11. Më 20 nëntor 1991, EEK-u njoftoi parashtruesin që marrëdhënia e tij e punës ndërpritet që nga 21 nëntori 1991, për shkak të *“përdorimit të veglave në kundërshtim me aktin normativ, si dhe për pengim të punëtorëve të tjerë në kryerjen e detyrave të tyre”*.

12. Më 4 dhjetor 1991, parashtruesi dorëzoi ankesë kundër këtij vendimi tek Autoriteti i Përkohshëm i NSH “EEK”, megjithatë, parashtruesi nuk kishte marrë përgjigje në këtë ankesë, dhe prandaj parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë.
13. Më 22 nëntor 1994, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktvendimi C1. nr. 2734/92), aprovoi ankesën e parashtruesit, prishi, Aktvendimin nr. 5590, të 14 nëntorit 1991. NSH “EEK” parashtroi ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.
14. Më 29 shtator 1995, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktvendimi Ac nr. 394/95), hodhi poshtë ankesën si të pabazuar, si dhe konfirmoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale, C1. nr. 2734/92, të 22 nëntorit 1994. NSH “EEK” parashtroi revizion në Gjykatën Supreme, kundër vendimeve të Gjykatës Komunale dhe asaj të Qarkut në Prishtinë.
15. Më 3 qershor 1996, Gjykata Supreme e Serbisë (Aktvendimi Rv. 586/96), aprovoi revizionin si të bazuar. Gjykata Supreme anuloi vendimet e gjykatave të instancës më të ulët, si dhe urdhëroi rigjykimin e çështjes në shkallë të parë.
16. Më 4 shkurt 2005, Gjykata Komunale (Aktvendimi C1. nr. 46/03), hodhi poshtë ankesën si të pabazuar. Gjykata Komunale theksoi që *“marrëdhënia e punës është ndërprerë në pajtim me nenin 2, paragrafët 1 dhe 4 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për marrëdhënie të punës, në rrethanat e veçanta, të cilat vlenin në rastin konkret”*. Parashtruesi parashtroi ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.
17. Më 21 nëntor 2007, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Ac. nr. 359/05) hodhi poshtë ankesën si të pabazuar. Gjykata e Qarkut kishte theksuar që *“gjykata e shkallës së ulët me të drejtë kishte vlerësuar gjendjen faktike si dhe kishte aplikuar të drejtën materiale”*. Parashtruesi parashtroi revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës, kundër vendimeve të Gjykatës Komunale dhe asaj të Qarkut në Prishtinë.
18. Më 5 shtator 2011, Gjykata Supreme e Kosovës (Rev. nr. 235/2008) hodhi poshtë revizionin e parashtruesit si të pabazuar. Gjykata Supreme kishte theksuar që *“gjykatat e instancës më të ulët, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt i kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar. Andaj, gjykata e shkallës së parë, me të drejtë, nuk ka pranuar si të bazuar pretendimin e paditësit se është*

joligjore ndërprerja e marrëdhënies së punës pa pëlqimin e tij nga ana e së paditurës në bazë të dispozitës së nenit 2, par. 1 dhe 4 të Ligjit mbi ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për marrëdhëniet e punës në rrethana të posaçme, i cili atëherë ishte në fuqi”.

Pretendimet e parashtruesit

19. Parashtruesi pohon se ka punuar në NSH “EEK” për 25 vite deri në vitin 1991, si dhe që *“pretendimet për përdorimin e mjeteve të punës në kundërshtim me aktet normative, si dhe pengimin e punëtorëve të tjerë, janë fakt i qartë i diskriminimit kundër tij dhe gjithë punëtorëve shqiptarë në përgjithësi”.*
20. Parashtruesi pretendon që *“vendimet e Gjykatës Komunale në Prishtinë, të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, si dhe të Gjykatës Supreme të Kosovës, paraqesin dështim në sigurim të barazisë dhe të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm”.* Parashtruesi thirret në nenin 24 [Barazia Para Ligjit] si dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

Pranueshmëria e kërkesës

21. Gjykata thekson që për të gjykuar ankesën e parashtruesit, duhet që së pari të vlerësojë nëse i ka plotësuar kërkesat e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, dhe më tutje të specifikuar me Ligj dhe Rregullore të punës.
22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, i cili parasheh që *“Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse (...) kërkesa është qartazi e bazuar”.*
23. Gjykata thekson që nuk është detyrë e kësaj gjykate që të lëshohet në gabimet faktike apo juridike (ligjshmëri) që pretendohen të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç nëse, si dhe në masën që, ato mund të kenë cenuar të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Kështu, kjo gjykatë nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, kur shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të aplikojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe asaj materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [ECHR] 1999-I).

24. Në përmbledhje, Gjykata mund të shqyrtojë vetëm nëse provat janë prezantuar në atë mënyrë që procedurat në përgjithësi, të vështuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në atë mënyrë që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, mes dokumenteve të tjera, Raportin e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, App. Nr. 13071/87, miratuar më 10 korrik 1991).
25. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi nuk e ka mbështetur pretendimin e tij në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar prova që të drejtat dhe liritë themelore të tij janë cenuar nga gjykatat e rregullta.
26. Gjykata vëren se Gjykata Supreme e Kosovës i ka ofruar parashtruesit një aktgjykim mjaft të arsyetuar se pse revizioni është hedhur poshtë, që shpjegon pse ndërprerja e marrëdhënies së punës nuk ka qenë *“jologjore në bazë të nenit 2, par. 1 dhe 4 të Ligjit mbi ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për marrëdhëniet e punës në rrethana të posaçme, i cili atëherë ishte në fuqi”*.
27. Rrjedhimisht, Gjykata nuk mund të konkludojë që procedurat përkatëse kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmëri të aplikacionit nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).
28. Pra, parashtruesi nuk ka treguar se pse dhe si të drejtat e tij, të garantuara me Kushtetutë, janë shkelur. Deklarata e thjeshtë se Kushtetuta është cenuar, nuk mund të konsiderohet si ankesë kushtetuese. Kështu, në bazë të rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, kërkesa është qartazi e pabazuar, si dhe rrjedhimisht, e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113. 7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit, dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 3 dhjetor 2013, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u kumtohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Dr. Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI125/13, Mehmet Kahrmani, Aktvendim i datës 3 dhjetor 2013 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së vendimeve të publikuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit përkitazi me listat përfundimtare të punëtorëve me të drejtë të përfitimit të një pjese të të ardhurave nga privatizimi i NSH "Ramiz Sadiku" dhe NSH "Meto Bajraktari"

Rasti KI125/13, vendimi i 3 dhjetorit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, e drejta e pronës, mosshterimi i mjeteve juridike.

Parashtruesi e parashtroi kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës nr. 03/L-121 dhe rregullit 56 paragrafi 2 të Rregullores së punës.

Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata të ndryshojë vendimin e AKP-së në lidhje me listat e punëtorëve me të drejtë, si dhe të pranojë të drejtën e tij për një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH "Ramiz Sadiku". Parashtruesi nuk është thirrur në ndonjë dispozitë kushtetuese në veçanti.

Duke shqyrtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata konstatoi se në rastin në fjalë, parashtruesi nuk ka paraqitur vendimin përfundimtar të një autoriteti publik në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47 të Ligjit.

Nga kjo rezultoi se kërkesa duhet të hidhet poshtë si e papranueshme, për shkak të mosshterimit të të gjitha mjeteve juridike, ashtu siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në**

Rastin Nr. KI125/13

Parashtrues

Mehmet Kahrmani

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të publikuara nga
Agjencia Kosovare e Privatizimit përkitazi me listat
përfundimtare të punëtorëve me të drejtë të përfitimit të një
pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH “Ramiz Sadiku”
dhe NSH “Meto Bajraktari”**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan,
gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar,
dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është z. Mehmet Kahrmani (në tekstin e mëtejme: Parashtruesi), me banim në Mitrovicë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi kundërshton vendimet e publikuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP), përkitazi me listat përfundimtare të punëtorëve me të drejtë të përfitimit të një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së “Ramiz Sadiku” në Prishtinë, dhe i NSH-së “Meto Bajraktari” në Mitrovicë.
3. Lista përfundimtare e punëtorëve me të drejtë përfitimi të një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së “Meto Bajraktari”, sipas parashtruesit, është publikuar më 8 mars 2012. Data e publikimit të listës përfundimtare të punëtorëve me të drejtë përfitimi të një

pjese të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së “Ramiz Sadiku” nuk është theksuar.

Objekti i çështjes

4. Parashtruesi kërkon vlerësimin kushtetues të listave përfundimtare të punëtorëve me të drejtë përfitimi të një pjese të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së “Ramiz Sadiku” dhe NSH-së “Meto Bajraktari”, publikuar nga AKP-ja.
5. Në këtë drejtim, parashtruesi nuk përmend ndonjë dispozitë kushtetuese në veçanti.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), si dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 16 gusht 2013, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
8. Më 30 gusht 2013, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI125/13, emëroi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Në të njëjtën datë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI125/13, emëroi edhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.
9. Më 24 shtator 2013, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën datë, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Dhoma e Posaçme), u njoftua përkitazi me kërkesën.
10. Më 30 shtator 2013, Gjykata i kërkoi parashtruesit të dorëzojë vendimet e Dhomës së Posaçme, të cilat në bazë të dokumenteve të paraqitura duket të jenë regjistruar me nr. SCEL-09-001-C1270.

11. Më 2 dhjetor 2013, Kryetari i Gjykatës, në bazë të nenit 11 të Ligjit dhe rregullit 9 (1) të Rregullores së punës, me Vendimin nr. KSH. KI125/13, caktoi gjyqtarin Enver Hasani anëtar të Kolegjit shqyrtues, në vend të gjyqtarit Robert Carolan.
12. Më 3 dhjetor 2013, Kolegji shqyrtues pasi shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues i propozoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Në një moment të caktuar, parashtruesi pohon se ka qenë i punësuar si punëtor i NSH “Ramiz Sadiku” dhe i NSH “Meto Bajraktari”.
14. Më 3 korrik 2013, parashtruesi ka dorëzuar ankesën në Dhomën e Posaçme kundër vendimit të AKP-së, për listën përfundimtare të punëtorëve me të drejtë përfitimi të një pjese të të ardhurave nga privatizimi i NSH “Ramiz Sadiku”.
15. Më 15 korrik 2013, Dhoma e Posaçme e njoftoi AKP-në me ankesën e parashtruesit.
16. Më 26 korrik 2013, AKP-ja dorëzoi përgjigjen e saj në Dhomën e Posaçme, duke theksuar që në pajtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë, parashtruesi është dashur të ankohet në Dhomën e Posaçme brenda 20 ditësh nga publikimi i listës përfundimtare në media. AKP-ja më tutje theksonte që data përfundimtare për të parashtruar ankesë në Dhomën e Posaçme, kundër listës përfundimtare, kishte qenë 27 marsi 2009, ndërsa parashtruesi kishte parashtruar ankesën shumë kohë pas afatit, më 3 korrik 2013. AKP-ja i kishte propozuar Dhomës së Posaçme që ta hidhte poshtë ankesën e parashtruesit si të palejueshme.
17. Në lidhje me NSH “Meto Bajraktari”, parashtruesi thekson që më 8 mars 2012, një listë e punëtorëve me të drejtë përfitimi të një pjese të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së së përmendur është publikuar në gazetën ditore “Koha ditore”.
18. Parashtruesi, në lidhje me të dy NSH-të, “Ramiz Sadiku” dhe “Meto Bajraktari”, nuk ka ofruar ndonjë dokument të besueshëm për të dëshmuar që ai ka ndjekur çështjen më tutje me Dhomën e Posaçme. Kërkesa vetëm përmban një shkresë të pranimi të një

dokumenti me numrin e rastit, SCEL-09-0001-C1270, të 26 korrikut 2013.

Pretendimet e parashtruesit

19. Parashtruesi pretendon se ai i plotëson kriteret për t'u përfshirë në listat e punëtorëve me të drejtë për realizimin e një pjese të të ardhurave nga privatizimi, si dhe me mos përfshirjen e tij në ato lista, ka ndodhur *“aplikimi i gabueshëm i së drejtës materiale.”*
20. Për më tepër, parashtruesi kërkon nga Gjykata të ndryshojë vendimin e AKP-së në lidhje me listat e punëtorëve me të drejtë, si dhe të pranojë të drejtën e tij për një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH “Ramiz Sadiku”. Parashtruesi nuk është thirrur në ndonjë dispozitë kushtetuese në veçanti.

Vlerësimi i pranueshmërisë

21. Gjykata vëren se për të gjykuar ankesën e parashtruesve, është e nevojshme që së pari të vlerësojë nëse parashtruesit kanë plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të caktuara me Kushtetutë, dhe më tutje të detajuara në Ligj dhe në Rregulloren e punës.
22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton që:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

23. Gjykata i referohet më tutje nenit 47 të Ligjit, i cili parasheh që:

“Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

24. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës, i cili përcakton që:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

a) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar...”;

25. Parashtruesi kryesisht pretendon që ai i *“plotëson kushtet për të qenë në listat e punëtorëve me të drejtë, si dhe duke mos qenë i përfshirë në lista, ka pasur aplikim të gabueshëm të së drejtës materiale”*.
26. Gjykata vëren që parashtruesi është ankuar në Dhomën e Posaçme kundër vendimeve të AKP-së përkitazi me listën përfundimtare të punëtorëve me të drejtë përfitimi të një pjese të të ardhurave nga privatizimi i NSH “Ramiz Sadiku”, megjithatë, mbetet e panjohur nëse ai ka vazhduar përcjelljen e rastit të tij apo jo në Dhomën e Posaçme.
27. Nga dokumentet e parashtruara, Gjykata vëren që në lidhje me privatizimin e të dy NSH-ve, “Ramiz Sadiku” dhe “Meto Bajraktari”, parashtruesi nuk ka ofruar ndonjë vendim, kushtetutshmëria e të cilit mund të vendoset.
28. Për më tepër, Gjykata vëren që parashtruesit i është kërkuar dhe i është dhënë kohë e mjaftueshme për të ofruar dëshmi që ka shteruar të gjitha mjetet juridike, por ai nuk është përgjigjur.
29. Nga sa u tha më lart, Gjykata konstaton se në rastin në fjalë, parashtruesi nuk ka paraqitur vendimin përfundimtar të një autoriteti publik në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës, dhe nenin 47 të Ligjit.
30. Arsyeshmëria e rregullit të shterimit është që t’u ofrojë autoriteteve përkatëse, duke përfshirë edhe gjykatat, një mundësi për të parandaluar apo për të korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Rregulli është i bazuar te supozimi që rendi juridik i Kosovës duhet të ofrojë një mjet juridik efektiv për shkeljen e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (shih Rastin KI41/09, parashtruesi Universiteti AAB-RIINVEST SHPK Prishtinë, Vendimi për papranueshmëri i 21 janarit 2010, si dhe *mutatis mutandis*, shih rastin Selmouni kundër Francës, Nr. 25803/94, GJEDNJ, Aktvendimi i 28 korrikut 1999).

31. Rrjedh pra që kërkesa duhet hedhur poshtë si e papranueshme, për shkak të mosshterimit të të gjitha mjeteve juridike, ashtu siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit si dhe rregullit 36 (1) a) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit, dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 3 dhjetor 2013, njëzëri:

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KOMUNIKOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Dr. sc. Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani

KI149/13, Lukë Kuzhnini, Aktvendim i datës 5 dhjetor 2013 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR. nr. 1990/12, të 7 majit 2013.

Rasti KI149/13, vendimi i 5 dhjetorit 2013.

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, *prima facie*.

Parashtruesi pretendon që me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR nr. 1990/12, të 7 majit 2013, i janë shkelur të drejtat e mbrojtura me Kushtetutë, neni 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) Neni 21 (Parimet e Përgjithshme), Neni 23 (Dinjiteti i Njeriut), Neni 24 (Barazia para Ligjit), Neni 25 (E Drejta për Jetën) dhe Neni 29 (E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë) të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese rithekson që nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës, që të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i këtyre të fundit që të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale.

Gjykata konsideron se faktet e dorëzuara nga parashtruesi nuk kanë arsyetuar në asnjë mënyrë pretendimin e shkeljes së të drejtave kushtetuese dhe parashtruesi nuk i ka mbështetur sa duhet pretendimet e tij.

Për më tepër, parashtruesi nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi *prima facie* që do të vërtetonte shkeljen e të drejtave të tij sipas Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) b) dhe d) të Rregullores së punës, më 5 dhjetor 2013, njëzëri deklaroi se kërkesa është e papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI149/13
Parashtrues
Lukë Kuzhnini
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së
Apelit të Kosovës, PAKR. nr. 1990/12, të 7 majit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Lukë Kuzhnini nga fshati Smaq, komuna e Prizrenit, i cili gjendet në vuajtje të dënimit në burgun e Dubravës, të cilin me autorizim e përfaqëson znj. Myrvete Çollaku, avokate në Prizren.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR, nr. 1990/12, të 7 majit 2013, për të cilin parashtruesi pohon se e ka pranuar më 28 maj 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR nr. 1990/12, të 7 majit 2013, në lidhje me procedurën penale në të cilën parashtruesi i kërkesës ishte shpallur fajtor për veprën penale vrasje e rëndë nga neni 147, par. 11, në lidhje me paragrafin 4 të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPK), veprës penale të mbajtjes në pronësi, kontroll, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328, paragrafi 2, i KPK-së, dhe veprën penale të falsifikimit të dokumenteve nga neni 332, paragrafi 3, në lidhje me

paragrafin 1 të KPK-së, dhe ishte dënuar me burgim në kohëzgjatje prej katërmëdhjetë vjet e gjashtë muaj.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi më 17 shtator 2013, parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 24 shtator 2013, Kryetari, me Vendimin nr. GJR. KI149/13, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI149/13, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
7. Më 9 tetor 2013, Gjykata Kushtetuese informoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën e Apelit për regjistrimin e kërkesës, si dhe kërkoi nga përfaqësuesja e parashtruesit të kërkesës që në afat sa më të shkurtë të dorëzojë në Gjykatë autorizimin që tregon se e përfaqëson parashtruesin e kërkesës në Gjykatë.
8. Më 14 tetor 2013, përfaqësuesja e parashtruesit të kërkesës dorëzoi në Gjykatë autorizimin.
9. Më 5 dhjetor 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 23 korrik 2012, Gjykata e Qarkut në Prizren, duke vendosur si gjykatë e shkallës së parë lidhur me veprën penale të parashtruesit të kërkesës, për shkak të kryerjes së veprave penale, vrasje e rëndë nga neni 147, par. 11, e lidhur me paragrafin 4 të KPK-së, veprës penale të mbajtjes në pronësi, kontroll, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328, par. 2, i KPK-së, dhe veprën penale të falsifikimit të dokumenteve nga neni 332, par. 3, në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorit

të Qarkut në Prizren, shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës dhe e dënoi me burgim në kohëzgjatje prej 14 vjet e gjashtë muaj.

11. Më 7 maj 2013, Gjykata e Apelit të Kosovës duke vendosur sipas ankesave të Prokurorit Publik të Qarkut në Prizren, dhe mbrojtësve të parashtruesit të kërkesës i refuzoi këto ankesa si të pabazuara. Ankesat e Prokurorit Publik të Qarkut në Prizren ishin për shkak të dënimit të ulët, me propozim që Gjykata e Apelit, Aktgjykimin ta ndryshojë dhe të shqiptojë dënim me burgim afatgjatë. Mbrojtësit e parashtruesit u ankuan për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
12. Gjykata e Apelit më tej në arsyetimin e saj theksoi:

“Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit jo vetëm që drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka konstatuar të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e sanksionit por të njëjtat edhe drejtë i ka vlerësuar, prandaj duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e lartcekura si dhe rrethanat e rastit konkret, mënyrën dhe rrethanat nën të cilat janë kryer veprat penale atëherë del se dënimi i shqiptuar të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm...”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

13. Parashtruesi pretendon që me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR nr. 1990/12, të 7 majit 2013, i janë shkelur të drejtat e mbrojtura me Kushtetutë, neni 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) Neni 21 (Parimet e Përgjithshme), Neni 23 (Dinjiteti i Njeriut), Neni 24 (Barazia para Ligjit), Neni 25 (E Drejta për Jetën) dhe Neni 29 (E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë) të Kushtetutës.
14. Parashtruesi i kërkesës pretendon se:

“Gjykimi kundër Lukë (Gjergj) Kuzhninit nuk ishte i drejtë sepse nuk ishte objektiv, faktet e lëndës nuk janë vlerësuar drejt, kështu është vendosur sipas paragjykimit të krijuar që në procedim të çështjes në polici...”

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

15. Fillimisht, për të gjykuar kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i ka plotësuar të gjitha kërkesat e pranueshmërisë, të cilat përcaktohen me Kushtetutë, të qartësohen më tutje me Ligj dhe Rregullore të Punës.

16. Gjykata i referohet nenit 113. 7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Në lidhje me këto kërkesa, Gjykata vëren që parashtruesi është person fizik, si dhe është palë e autorizuar në pajtim me nenin 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës.

17. Gjykata gjithashtu duhet të përcaktojë nëse parashtruesi, në pajtim me kërkesat e nenit 113 (7) të Kushtetutës, si dhe nenit 47 (2) të Ligjit, ka shteruar të gjitha mjetet juridike. Në rastin aktual, parashtruesi ka paraqitur fakte që i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjeve në fuqi.
18. Parashtruesi gjithashtu duhet të vërtetojë që ka përmbushur kërkesat e nenit 49 të Ligjit, në lidhje me dorëzimin e kërkesës brenda afatit të caktuar. Mund të shihet nga shkresat e rastit, si dhe nuk ka asnjë dëshmi që do të kundërshtojë pretendimin e parashtruesit që Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR, i 7 majit 2013, i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 28 maj 2013, andaj, kërkesa është dorëzuar brenda afatit 4 (katër) mujor, siç përcaktohet me Ligj dhe me Rregullore të punës.
19. Në lidhje me kërkesën, Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36.2 të Rregullores së punës, i cili përcakton që:

“(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...], ose

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

[...], ose

(d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

20. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese rithekson që nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës, që të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i këtyre të fundit që të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, para. 28, shih edhe rastin Nr. KI70/11, parashtruesit Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima, Aktvendim për pranueshmëri i 16 dhjetorit 2011).
21. Gjykata Kushtetuese mundet vetëm të trajtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre janë kryer në mënyrë të tillë sa që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, *inter alia*, Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr. 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, kërkesa e 10 korrikut 1991).
22. Në bazë të shkresave të rastit, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në aktgjykimin e nxjerrë nga Gjykata e Qarkut në Prizren është i qartë, si dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu ka gjetur që procedurat në Gjykatën e Apelit në Prishtinë nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009). Për më tepër, Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR nr. 1990/12, i 7 majit 2013, është i qartë dhe i arsyetuar mirë. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës ka dështuar të prezantojë argumente bindëse që do të mbështesnin shkeljet e pretenduara.
23. Për më tepër, parashtruesi nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi *prima facie* që do të vërtetonte shkeljen e të drejtave të tij sipas Kushtetutës (Shih Vanek kundër Republikës Sllovaqe, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, të 31 majit 2005).
24. Për të gjitha arsyet e lartpërmendura, Gjykata është e bindur që faktet e dorëzuara nga parashtruesi nuk kanë arsyetuar në asnjë mënyrë pretendimin e shkeljes së të drejtave kushtetuese dhe parashtruesi nuk i ka mbështetur sa duhet pretendimet e tij.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) b) dhe d) të Rregullores së punës, më 5 dhjetor 2013, njëzëri:

VENDOS

- I. TA DEKLAROJ kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KOMUNIKOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në përputhje me nenin 20 (4) të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI154/13, Beqir Halili, Aktvendim i datës 20 nëntor 2013 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Vendimit të Trupit Gjykses të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, nr. 1204, të 8 prillit 2010

Rasti KI154-13, vendimi i 20 nëntorit 2013.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, e drejta e pronës, e jashtafatshme.

Parashtruesi e parashtroi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 dhe rregullin 56 paragrafi 2 të Rregullores së punës.

Parashtruesi nuk kishte saktësuar në kërkesë se cilin vendim të Trupit Gjykses të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit e konteston, por vetëm e ka përmendur Vendimin nr. 1204, i cili paraqet një pjesë të vendimit kolektiv të Trupit Gjykses të Dhomës së Posaçme, të 8 prillit 2010, i cili shprehimisht i referohet atij.

Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesë që Gjykata t’ia pranoj të drejtën në 20% e cila i takon, sepse ka punuar në ndërmarrjen “Ramiz Sadiku” më tepër se 4 (katër) vjet. Pas luftës nuk më kanë ftuar, edhe pse disa herë jam lajmëruar në punë.

Në bazë të shqyrtimit të shkresave të lëndës, Gjykata konstatoi se parashtruesi e paraqiti kërkesën në Gjykatë më 29 shtator 2013, përderisa vendimi i fundit i Trupit Gjykses të Dhomës së Posaçme atij iu dorëzua më 13 korrik 2010, domethënë pas skadimit të afatit të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36. (1) b) të Rregullores së punës. Nga kjo rrjedh se kërkesa e parashtruesit është e jashtafatshme.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në**

Rastin nr. KI154/13

Parashtrues

Beqir Halili

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Trupit gjykues të
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për
çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, nr.
1204, të 8 prillit 2010**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Beqir Halili nga fshati Peran, komuna e Podujevës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk kishte saktësuar në kërkesë, se cilin vendim të Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme) e konteston, por vetëm e ka përmendur Vendimin nr. 1204, i cili paraqet një pjesë të vendimit kolektiv të Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme, të 8 prillit 2010, i cili shprehimisht i referohet atij.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet t'i ketë shkelur parashtruesit të

kërkesës të drejtat nga marrëdhënia e punës, të garantuara me Kushtetutë.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 4 tetor 2013, parashtruesi i kërkesës e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata)
6. Më 9 tetor 2013, Kryetari, me vendimin Nr. GJR. KI154/13 caktoi gjyqtaren Arta Rama Hajrizi gjyqtare raportuese. Po të njëjtën ditë, Kryetari me vendimin Nr. KSH. KI154/13 caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
7. Më 21 tetor 2013, Gjykata e informoi parashtruesin e kërkesës dhe Dhomën e Posaçme për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 20 nëntor 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi i kërkesës kishte themeluar marrëdhënie pune me Ndërmarrjen shoqërore, “Ramiz Sadiku” (në tekstin e mëtejme: NSH “Ramiz Sadiku”) duke filluar prej 1 qershorit 1986, deri më 28 shkurt 1990.
10. Më 27 qershor 2006, NSH “Ramiz Sadiku” e kishte përfunduar procesin e privatizimit.
11. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme kundër listës përfundimtare të punëtorëve, të cilën e kishte përpiluar Agjencia për Privatizim, pasi që ai, si punëtor i mëparshëm, nuk gjendej në listë.

12. Në ankesën drejtuar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, parashtruesi i kërkesës theksoi se ai nuk kishte paraqitur ankesë brenda afatit të paraparë ligjor kundër listës përfundimtare të punëtorëve, të cilët e kishin fituar të drejtën në një pjesë të 20 % nga privatizimi i NSH “Ramiz Sadiku”, pasi gjatë asaj periudhe ai kishte qenë në spital për shërim.
13. Më 8 prill 2010, Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme kishte nxjerrë vendimin kolektiv, ku me nr. 1204, gjendet një pjesë e vendimit, e cila shprehimisht ka të bëjë me parashtruesin, në të cilin thuhet se ankesa e parashtruesit të kërkesës refuzohet si e pabazuar.
14. Në arsyetimin e vendimit të tij, Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme kishte theksuar:

„Duke marrë parasysh se ankesa e parashtruesit të kërkesës ishte ngritur tre (3) muaj pas skadimit të afatit për paraqitje të ankesës (afati kohor për paraqitje të ankesës kishte skaduar më 27 mars 2009), nuk ekziston mundësia e kthimit në gjendje të mëparshme, përkatësisht që ankesa të shqyrtohet si të ishte dorëzuar brenda afatit. Duke pasur parasysh këtë, ankesa e parashtruesit të kërkesës hidhet poshtë si e papranueshme.“

Pretendimet e parashtruesit

15. Parashtruesi i kërkesës nuk ka saktësuar se cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë i janë shkelur me vendimin e kontestuar, por vetëm pretendon se me këtë vendim i shkelen të drejtat nga marrëdhënia e punës, të garantuara me Kushtetutë.
16. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën vijuese:

„Unë dëshiroj që ta realizoj të drejtën time në 20%, pasi që më takon, sepse kam punuar në ndërmarrjen “Ramiz Sadiku” më tepër se 4 (katër) vjet. Pas luftës nuk më kanë ftuar, edhe pse disa herë jam lajmëruar në punë.“

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

17. Në mënyrë që Gjykata të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, duhet që së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

18. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se neni 113.7 i Kushtetutës parasheh:

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

19. Gjykata po ashtu thirret në nenin 49 të Ligjit, i cili thotë:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.

20. Gjykata po ashtu merr parasysh edhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së Punës

“(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

...

b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi”.

21. Në bazë të dokumenteve të bashkëngjitura, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës i paraqiti kërkesën Gjykatës më 29 shtator 2013, përderisa vendimi i fundit i Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme atij iu dorëzua më 13 korrik 2010, domethënë pas skadimit të afatit të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së Punës.
22. Nga kjo rrjedh, se kërkesa e parashtruesit është e jashtafatshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, më 20 nëntor 2013, njëzëri

VENDOS

- I. TË SHPALLË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Arta Rama-Hajrizi

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI131/13, Luan Spahiu, Aktvendim i datës 19 nëntor 2013 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 313/2012, të 17 prillit 2013

Rasti KI131/13, vendimi i 19 nëntorit 2013.

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, qartazi të pabazuar.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se ishte shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Parashtruesi pretendon se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata vëren se, parashtruesi nuk e ka ndërtuar rastin në shkelje të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë, dhe as nuk e ka ofruar ndonjë provë *prima facie* për një shkelje të tillë.

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, më 19 nëntor 2013, njëzëri hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme, si qartazi të pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI131/13
Parashtrues
Luan Spahiu
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme të Kosovës, Rev. nr. 313/2012, të 17 prillit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan,
gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar,
dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Luan Spahiu nga Prizreni.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 313/2012, të 17 prillit 2013, i cili iu dorëzua atij në një datë të pasaktësuar.
3. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu e konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. Nr. 200/2011, të 18 qershorit 2012, dhe atë të Gjykatës Komunale në Prizren C. Nr. 780/09, të 12 qershorit 2010.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës së dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar i cili pretendohet të jetë nxjerrë në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës; nenin 47 të Ligjit, dhe rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 23 gusht 2013, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Në kërkesën e tij, parashtruesi gjithashtu paraqiti një petition për përjashtimin e gjyqtarëve Kadri Kryeziu dhe Altay Suroy, si pason:

“Po ashtu kërkoj nga Gjykata që gjatë marrjes së vendimit lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë të akteve gjyqësore të përjashtohen gjyqtarët: Kadri Kryeziu dhe Altay (Suroy) Rexhepoglu që të dy gjyqtarë nga Prizreni me arsyetim se Y. H. si Kryetar i gjykatës themelore në Prizren i cili ka pas ndikim në marrjen e vendimeve të gjykatave, i njëjti mund të ndikojë tek gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese Kadri Kryeziu për arsye se janë shokë në mes veti. Ndërsa gjyqtari Altay Suroy Rexhepoglu i njëjti mund të jetë në ndikimin e gjyqtarit F. S. i cili tani është gjyqtar në Dhomën e posaçme pranë Gjykatës Supreme të Kosovës dhe i njëjti ka pas ndikim absolut në marrjen e vendimeve gjyqësore pranë gjykatave pasi që paditësin - kundërpaditurin Abdylkader Rototo e ka familjar”.

8. Më 30 gusht 2013, Kryetari, me Vendimin nr. GJR. KI131/13, e caktoi zëvendëskryetarin Ivan Čukalović si Gjyqtar raportues, si dhe po të njëjtën ditë, me Vendimin nr. KSH. KI131/13, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Enver Hasani dhe Arta Rama-Hajrizi.
9. Më 23 shtator 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës në Gjykatë.
10. Më 23 shtator 2013, Gjykata gjithashtu njoftoi Gjykatën Supreme në lidhje me kërkesën.
11. Më 2 tetor 2013, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për urgjencë të procedurës në Gjykatë. Parashtruesi kërkon nga Gjykata, *“që të merr lëndën e ekzekutimit E. nr. 1476/12 të Gjykatës Themelore në Prizren dhe të bëjë vlerësimin e*

kushtetutshmërisë së vendimit të marrë nga kjo gjykatë dhe të ndalojë ndërmarrjen e veprimeve të mëtejshme nga ana e gjyqtarit të procedurës përmbartuese A. H., deri sa Gjykata Kushtetuese të vlerësojë kushtetutshmërinë e vendimeve të marra, sepse gjykata ka marrë vendim me të cilin ka caktuar shitjen e paluajtshmërisë së debitorit Luan Spahiut më 30.10.2013”. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës dorëzoi një numër të dokumenteve në lidhje me ekzekutimin e rastit përmbartimor E. Nr. 1476/12.

12. Më 19 nëntor 2013, u morën deklaratat e gjyqtarëve Kadri Kryeziu dhe Altay Suroy, dhe në pajtim me rregullin 7 të Rregullores së Punës Gjykata refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për përjashtim të dy gjyqtarëve të lartpërmendur.
13. Më 19 nëntor 2013, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i propozoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 12 qershor 2010, Gjykata Komunale në Prizren mori Aktgjykimin C. Nr. 780/09, dhe e aprovoi si të bazuar padinë e A. R. kundër parashtruesit të kërkesës, duke e urdhëruar parashtruesin që t'i paguajë paditësit A. R. borxhin në shumë prej 34,000 euro me interes ligjor. Në të njëjtën kohë, Gjykata Komunale e refuzoi si të pabazuar kundërpadinë e parashtruesit të kërkesës, me të cilën kishte kërkuar që paditësi/kundër i padituri A. R. të paguajë shumën prej 16,000 euro të borxhit.
15. Në arsyetim, Gjykata Komunale deklaroi, *inter alia*, se “është vërtetuar se i padituri Luan Spahiu pranoi borxhin në shumë prej 34.000 €. Ai është i detyruar që ta kthejë këtë borxh, sepse këtë borxh e ka pranuar para dëshmitarëve të cilët janë marrë nee pyetje në këtë procedurë e për këtë është hartuar dhe procesverbali më 22 maj 2008, sipas të cilit i padituri ka marrë detyrimin që ta kthejë në këste borxhin e vet ndaj paditësit”.
16. Gjykata Komunale në arsyetim përkujton se: “sipas nenit 295. par. 1 i Ligjit mbi marrëdhëniet detyrimore,..., dhe është rregull i përgjithshëm që detyrimi pushon kur ai përmbushet, si dhe me ligjin tjetër qiramarrësi është i detyruar të paguajë qiranë në afate të caktuara me kontratë ose ligj. Sipas nenit nr. 324, para. 1 të ligjit të njëjtë, debitori është në vonesë kur nuk e përmbush detyrimin në afat të caktuar për përmbushje...”

17. Më 2 qershor 2011, parashtruesi ushtroi ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren, të 12 qershorit 2010. Në ankesën e tij, parashtruesi i kërkesës pretendonte se aktgjykimi i kontestuar ishte nxjerrë me shkelje të procedurës kontestimore. Parashtruesi gjithashtu pretendonte se Gjykata Komunale në Prizren kishte përcaktuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë situatën faktike dhe kishte zbatuar gabimisht të drejtën materiale.
18. Më 18 qershor 2012, Gjykata e Qarkut në Prizren mori Aktgjykimin Ac. Nr. 300/2011, dhe e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.
19. Në arsyetimin e saj Gjykata e Qarkut në Prizren theksoi, *inter alia*, se “*Gjykata e Qarkut në tërësi e pranon konstatimin faktik dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, pasi që nga provat e lartcekura e të administruara rezulton se i padituri/kundërpaditësi i ka borxh paditësit/kundërtëpaditurit shumë prej 34.000 eurosh, ndërsa i padituri/kundërpaditësi, edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate, nuk ka mundur të provojë se paditësi/kundëripadituri ia ka borxh atij 16.000 euro*”.
20. Pas 16 korrikut 2012, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut. Në kërkesën e tij, parashtruesi pretendon shkelje thelbësore të procedurës kontestimore dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.
21. Më 17 prill 2013, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin Rev. Nr. 313/2012, dhe e refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. Nr. 300/2011, të 18 qershorit 2012.
22. Gjykata Supreme në arsyetimin e aktgjykimit të saj theksoi, ndër të tjera, se “*Nga shkresat e lëndës del se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se palët ndërgjyqëse kanë pretenduar se kanë borxhe ndaj njëri-tjetrit. Më 22 maj 2008, është formuar një grup njerëzish...të pranishmit, pra edhe i padituri/kundërpaditësi Luan Spahiu, dhe në këtë takim janë pajtuar se ky i ka borxh paditësit/kundërtëpaditurit A. R. shumë prej 34.000 €, të cilin edhe duhet t’ia kthejë dhe që kthimi duhet të bëhet me këste, ashtu që pagesat t’i bëjë: në shtator të vitit 2009 shumë prej 10.000 €, në shtator të vitit 2010 shumë prej 10.000 €, në shtator të vitit 2011, shumë prej 10.000 € dhe në shtator të vitit 2012, shumë prej 4.000 €, por Luan Spahiu ka pranuar që të paguajë tërë shumë edhe më herët, atëherë kur do t’i marree paratë nga shitja*

e shtëpisë së vet, e cila është paraqitur për shitje. Lidhur me këtë, është përpiluar procesverbali të cilin e kanë nënshkruar të gjithë të pranishmit (me përjashtim të A. R.), ndërsa gjykata i ka vërtetuar këto fakte edhe në bazë të dëshmive të dëshmitarëve”.

23. Sipas gjetjeve të Gjykatës Supreme, aktgjykimi i shkallës së dytë nuk përmban asnjë shkelje të procedurës kontestimore, për të cilat Gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare. Po ashtu, nuk është i bazuar pretendimi për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, siç pretendohet në revizion, përkatësisht që aktgjykimi nuk përmban arsye për faktet vendimtare, relevante për të nxjerrë një vendim të ligjshëm. Gjykata Supreme theksoi në arsyetimin e saj si në vijim: *”... jo vetëm se në procesverbalin e 22 majit 2008 është cekur se i padituri/kundërpaditësi Luan Spahiu i ka borxh paditësit/kundërtëpaditurit A. R..., por vete i padituri/kundërpaditësi Luan Spahiu ka deklaruar se këtë borxh do ta paguajë edhe më parë, kur ta shesë shtëpinë dhe këtë e ka deklaruar me vullnetin e vet, në praninë e dëshmitarëve. Andaj, përmbajtja e procesverbalit është vlerësuar drejt dhe i njëjti me të drejtë është marrë si provë në këtë procedurë”.*
24. Sipas dokumentacionit që parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë më 2 tetor 2013, duket se në një datë të pacaktuar, parashtruesi paraqiti kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit A. H. nga procedura përmbarimore, e cila ishte iniciuar në Gjykatën Themelore në Prizren. Ajo procedurë kishte të bënte me ekzekutimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale të 12 qershorit 2010. Në kërkesën e njëjtë, parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkoi përjashtimin e Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren.
25. Më 5 shtator 2013, Gjykata Themelore në Prizren nxori vendimin dhe e refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit A. H. nga procedura dhe vendosja në lëndën përmbarimore E. Nr. 1476/12, në pritje në Gjykatën Themelore në Prizren.
26. Më 16 shtator 2013, parashtruesi ushtroi ankesë kundër Vendimit të 5 shtatorit 2013.
27. Më pastaj, më 23 shtator 2013, Kryetari i Gjykatës së Apelit nxori aktvendimin dhe e refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për përjashtim të Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren dhe gjyqtarit A. H. nga Gjykata Themelore në Prizren. Ishte përmendur, ndër të tjera, se *“në kërkesën për përjashtim nuk janë të theksuara shprehimisht dhe taksativisht shkaqet konkrete në*

bazë të cilave kërkohet përjashtimi, siç parashikohen në bazë të nenit 69.2 të Ligjit për procedurën kontestimore. Nga shkresat e lëndës rrjedh se debitori i ka keqpërdorur të drejtat e tij procedurale...”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ishte shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Parashtruesi pretendon se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
29. Parashtruesi pretendon se: *“I tërë ky proces më është montuar nga ish-Kryetari i Gjykatës së Qarkut në Prizren, tani Kryetar i Gjykatës Themelore në Prizren... dhe ai ka pasur ndikim prej Gjykatës Komunale deri në Gjykatën Supreme dhe gjatë procedurës së ankesës në Gjykatën e Qarkut në Prizren”.* Parashtruesi më tej pretendon se *“Është për të habitur fakti se si është e mundshme që në shkallën e parë dhe në shkallën e dytë, gjyqtarët dhe vetë paditësi të jenë me kombësi boshnjake, është e pamundur të mos dyshohet duke marrë parasysh përqindjen e gjyqtarëve boshnjakë në gjykata...”.*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

30. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe me Rregulloren e punës.
31. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës ankohet se e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 paragrafi 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Konventa) është shkelur.
32. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese vëren se parashtruesi i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas Ligjit të procedurës kontestimore dhe se Gjykata Supreme në Prishtinë, e ka marrë parasysh dhe iu është përgjigjur ankesave të tij në çështjet e ligjit.
33. Gjykata gjithashtu vëren se edhe Gjykata Themelore në Prizren, edhe Kryetari i Gjykatës së Apelit trajtuan ankesat e parashtruesit

në lidhje me shkeljen e pretenduar të së drejtës së tij në gjykatë të pavarur dhe të paanshme gjatë procedurës përmbartimore.

34. Gjykata Kushtetuese rikujton se nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale, (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM], Nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ] 1999-1; shih gjithashtu Aktvendimin për papranueshmëri në rastin KI70/11, parashtruesit Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima, Vlerësimi i kushtetushtmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. Nr. 983/08, të 7 shkurtit 2011).
35. Gjykata vëren se, me deklaratën e thjeshtë se: *“Është për t'u habitur se si edhe në shkallën e parë, edhe në të dytën, gjyqtarët dhe paditësi janë boshnjakë ,”* parashtruesi as nuk e ka ndërtuar rastin në shkelje të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë, dhe as nuk e ka ofruar ndonjë provë *prima facie* për një shkelje të tillë (shih Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ-se për papranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, të 31 majit 2005).
36. Rrjedh se kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës që parasheh se: *“Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: (c) kërkesa është qartazi e bazuar”*.
37. Prandaj, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, njëzëri:

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KOMUNIKOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në përputhje me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. TË SHPALLË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI192/13, Hatixhe Avdyli, Aktvendim i datës 24 shkurt 2014 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. Nr. 11/2013, i dates 23 korik 2013

Rasti KI 192/13, vendimi i 24 shkurtit 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, e drejta për mjete juridike, mbrojtja e pronës, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, qartazi e pabazuar.

Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, me të cilin ajo ndryshoi aktgjykimet e Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, duke hedhur poshtë kështu kërkesëpadinë e parashtrueses si të pabazuar. Parashtruesja kishte parashtruar një kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Prishtinë, ku kishte kërkuar të anulohet kontrata e shitblerjes për blerjen e banesës, të vërtetohet se parashtruesja është bartëse e së drejtës së shfrytëzimit të banesës, dhe të obligohet e paditura që parashtrueses t'ia dorëzojë në posedim të lire banesën si dhe t'i bartë shpenzimet procedural.

Parashtruesja pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, duke ndryshuar aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta, i ka shkelur të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Gjykata Kushtetuese deklaroikërkesën të papranueshme, si qartazi të pabazuar sepse faktete paraqituranga parashtruesja në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtave të saj kushtetuese dhe parashtruesja nuk e ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e saj. kanë treguar se të drejtate tij kushtetueseishin dëmtuarngaKolegji i Ankesave tëDhomës së Posaçme tëGjykatës Supreme të Kosovës.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI192/13
Parashtrues
Hatixhe Avdyli
Vlerësimi i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. Nr. 11/2013,
të 23 korrikut 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović,
zëvendëskryetar
Robert Carolan,
gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruese është znj. Hatixhe Avdyli (në tekstin e mëtejme: parashtruesja), me banim në Prishtinë, e përfaqësuar nga z. Skënder Musa, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 11/2013, të 23 korrikut 2013, të cilin parashtruesja e ka pranuar më 17 tetor 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 11/2013, të 23 korrikut 2013. Në aktgjykimin e saj, Gjykata Supreme miratoi kërkesën për revizion të paditëses V. A. dhe ndryshoi aktgjykimet e Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, duke hedhur poshtë kështu kërkesëpadinë e parashtrueses si të pabazuar. Parashtruesja kishte

parashtruar një kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Prishtinë, ku kishte kërkuar të anulohet kontrata e shitblerjes për blerjen e banesës, të vërtetohet se parashtruesja është bartëse e së drejtës së shfrytëzimit të banesës, dhe të obligohet e paditura që parashtrueses t'ia dorëzojë në posedim të lirë banesën si dhe t'i bartë shpenzimet procedurale.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 11 nëntor 2013, parashtruesja dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 29 nëntor 2013, Kryetari i Gjykatës, në bazë të Vendimit GJR. KI192/13, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese.
7. Më 3 dhjetor 2013, Kryetari i Gjykatës, në bazë të Vendimit KSH. KI192/13, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 4 dhjetor 2013, Gjykata Kushtetuese njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën datë, Gjykata njoftoi gjithashtu edhe Gjykatën Supreme në lidhje me kërkesën.
9. Më 5 dhjetor 2013, Gjykata vendosi që ta refuzojë kërkesën për masë të përkohshme si të pabazuar në pritje të rezultatit përfundimtar të kërkesës (Shih Vendimin për masë të përkohshme, të datës 9 dhjetor 2013).
10. Më 7 shkurt 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Faktet e rastit

11. Gjatë periudhës 1988-1989, parashtrueses, si e punësuar në Ndërmarrjen Shoqërore “Amortizatorët” (në tekstin e mëtejme: NSH), i ishte ndarë një banesë në Prishtinë. Vendimet për ndarjen e banesës ishin anuluar nga Gjykata e Punës së Bashkuar në Prishtinë dhe ky anulim ishte vërtetuar nga Gjykata e Punës së Bashkuar të Kosovës.
12. Më 26 korrik 1990, kontrata e punës së parashtrueses ishte ndërprerë nga ana e organeve të përkohshme të NSH-së.
13. Më 8 tetor 1992, organet e përkohshme të NSH-së vendosën që t’ia ndajnë banesën të punësuarës V. A. dhe, si rezultat, ishte lidhur një kontratë për shfrytëzimin e banesës. Në bazë të kontratës së shitblerjes, të vërtetuar nga Gjykata Komunale në Prishtinë, më 28 dhjetor 1995, V. A. fitoi të drejtën e pronësisë mbi banesën.
14. Pas luftës në Kosovë, V. A. u largua nga banesa, e cila më vonë u uzurpua nga parashtruesja.
15. Më 9 dhjetor 2004, Drejtoria për Çështje Pronësore Banesore lëshoi një urdhër (HPPC/REC/41/2004) lidhur me dëbimin e parashtrueses nga banesa.
16. Rrjedhimisht, në një datë të pacaktuar, parashtruesja ushtroi padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë, duke kërkuar anulimin e kontratës së shitblerjes së lartpërmendur dhe për të konfirmuar se parashtruesja ka të drejtë për shfrytëzimin e banesës, si dhe të obligohet e paditura e parë që parashtrueses t’ia dorëzojë në posedim të lirë banesën.
17. Më 10 nëntor 2006, Gjykata Komunale në Prishtinë, në Aktgjykimin e saj, C. Nr. 1502/2005, vendosi të aprovojë padinë e parashtrueses.
18. Më 31 tetor 2008, pas një ankese të ushtruar nga V. A., Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin Ac. nr. 367/2007, prishi vendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe e ktheu rastin për rigjykim.
19. Më 12 maj 2009, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktgjykimin e saj, C. nr. 2038/2008, e aprovoi padinë e parashtrueses si të bazuar, anuloi dhe prishi kontratën e shitblerjes dhe konfirmoi më

tej se parashtruesja është bartëse e së drejtës për shfrytëzim të banesës.

20. Gjykata Komunale në Prishtinë e arsyetoi aktgjykimin e saj si në vijim:

“Fakti që nuk ka qenë palë në lidhjen e kontratës VR nr.7903/95 nuk e përjashton legjitimitetin e saj, ngase në kuptim të nenit 109 të LMD-së, secili që ka interes mund të kërkojë vlerësimin e vlefshmërisë së kontratës për arsyet e cekura në nenin 103 të LMD-së. Mbi bazën e kërkesëpadisë së paditëses, e në kuptim të nenit 109 të LMD-së, gjykata vlerësoi edhe kryesisht përmbajtjen e kontratës lëndore dhe gjeti se e njëjta ka kontradiktoritet dhe mospërputhje mes dispozitave të saj edhe lidhur me çmimin e kontraktuar të shitblerjes dhe pagesës së kryer sipas vërtetimit nr. 2010/1. Edhe këto mospërputhje në aspektin e lëndës së kontratës e bëjnë të njëjtën të pavlefshme dhe si të tillë gjykata e anuloi”.

21. Më 18 qershor 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, (Ac. nr. 1087/2009) e refuzoi ankesën e V. A. dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 2038/2008, të 12 majit 2009.

22. Gjykata e Qarkut në Prishtinë gjeti se:

[...]

“kjo gjykatë vlerëson se mbi bazën e konstatimit të drejtë të gjendjes faktike gjykata e shkallës së parë e ka zbatuar drejtë të drejtën materiale kur kërkesëpadinë e paditëses e ka miratuar si të bazuar dhe ka gjykuar si në dispozitiv të aktgjykimit ankimor”.

23. Më 23 korrik 2013, pas kërkesës për revizion të ushtruar nga paditësja V. A., Gjykata Supreme, në Aktgjykimin e saj, Rev. nr. 11/2013, vendosi të aprovojë revizionin e paditëses dhe e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 2038/2008, të 12 majit 2009 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 1087/2009, të 18 qershorit 2012, duke refuzuar kështu si të pabazuar padinë e parashtrueses të parashtruar në Gjykatën Komunale.

24. Në aktgjykimin e saj, Gjykata Supreme konstatoi se:

“Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët duke e vërtetuar gjendjen faktike drejt dhe në mënyrë të plotë, në bazë të gjendjes së tillë gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë aprovuar kërkesëpadinë e paditëses dhe duke anuluar kontratën e shitjes së banesës kontestuese lidhur në mes të paditurës së parë-si blerëse dhe paditurës së dytë -si shitëse.

Zbatimi i gabuar i së drejtës materiale konsiston në faktin se neni 103 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve përcakton se kontrata që është në kundërshtim me parimet e përcaktuara me Kushtetutë të rregullimit shoqëror me dispozitat e detyrueshme apo me moralin e shoqërisë është nule, në qoftë se qëllimi i rregullës është shkelur nuk sjell ndonjë sanksion tjetër apo nëse ligji në rastin e caktuar nuk parashikon diçka tjetër. Kontrata në fjalë e shitjes nuk përmban ndonjë nga shkaqet që do të sjellte nulitetin absolut dhe do të jepte mundësi që personi i tretë të kërkon anulimin e kontratës mbi shitjen e banesës kontestuese. Paditësja nuk ka fituar të drejtën e shfrytëzimit të banesës në fjalë ngase vendimet mbi ndarjen e banesës kontestuese paditëses janë anuluar nga Gjykata Themelore e Punës së Bashkuar në atë kohë. Megjithatë kontrata e lidhur në mes të paditëses së parë dhe të dytë nuk ka elemente të kontratës absolutisht nule, edhe atëherë paditësja nuk ka legjitimitet aktiv”.

Pretendimet e parashtruesit

25. Parashtruesja pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, duke ndryshuar aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta, i ka shkelur të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta).
26. Parashtruesja konkludon duke kërkuar nga Gjykata: “[...] që në bazë të provave dhe dëshmive që po i paraqesim të anulojë vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës si të pabazë dhe absolutikisht nule, ndërsa të VËRTETOHEN Vendimet e Gjykatës Komonale dhe Gjykatës së Qarkut në Prishtinë me të cilat APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e Hatixhe Avdyllit me të cilën i njihet e drejta e Shfrytëzimit të banesës ndërsa ANULOHET kontrata e shitblerjes-privatizimit të banesës kontestuese e lidhur

në mes të [...] dhe NSH "Amortizatorët" si kontratë absolutikisht e pabazë”.

Pranueshmëria e kërkesës

27. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtrueses, Gjykata së pari duhet të vlerësojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje me Ligj dhe Rregullore të punës së Gjykatës.

28. Në këtë drejtim, neni 113, paragrafi 7 i Kushtetutës parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkëljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

29. Përveç kësaj, neni 49 i Ligjit parasheh që *“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”.*

30. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesja i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit. Gjykata gjithashtu vëren se asaj i është dorëzuar Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 11/2013, më 17 tetor 2013 dhe ajo e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 11 nëntor 2013.

31. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesja është palë e autorizuar dhe se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit të zbatueshëm, dhe se kërkesa është dorëzuar brenda afatit kohor prej katër (4) muajsh.

32. Sidoqoftë, Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: (c) kërkesa është qartazi e bazuar”.

(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se”:

[...], ose

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkëljen e një të drejte kushtetuese; [...], ose

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

33. Parashtruesja pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 11/2013, i shkel të drejtat e saj, të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 46 [Mbrotjtja e Pronës] dhe me nenin 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
34. Megjithatë, parashtruesja nuk shpjegon si dhe pse aktgjykimi i Gjykatës Supreme i kishte shkelur të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutë.
35. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese ripërsërit se sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih, gjithashtu rastin KI70/11, parashtrues Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima, Aktvendimi për Papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
36. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesja të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih ndër autoritete të tjera, rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i miratuar më 10 korrik 1991).
37. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në aktgjykimin e fundit të Gjykatës Supreme është i qartë dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu gjeti që procedurat në Gjykatën Supreme nuk ishin të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Nr. 17064/06, Vendimi i GJEDNJ-së, i 30 qershorit 2009).
38. Për më tepër, Gjykata Supreme, në aktgjykimin e saj, arsyetoi se [...]”Zbatimi i gabuar i së drejtës materiale konsiston në faktin se neni 103 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve përcakton se kontrata që është në kundërshtim me parimet e përcaktuara me Kushtetutë të rregullimit shoqëror me dispozitat e detyrueshme apo me moralin e shoqërisë është nule, në qoftë se qëllimi i rregullës është shkelur nuk sjell ndonjë sanksion tjetër apo nëse ligji në rastin e caktuar nuk parashikon diçka tjetër. Kontrata në fjalë e shitjes nuk përmban ndonjë nga shkaqet që do të sjellte nulitetin absolut dhe do të jepte mundësi që personi i tretë të kërkon anulimin e kontratës mbi shitjen e banesës kontestuese.” [...]

39. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesja në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e drejtave të saj kushtetuese dhe parashtruesja nuk e ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e saj.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me Rregullin 36 (2), b) dhe d) të Rregullores së punës, më 24 shkurt 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;
- IV. TË SHPALLË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI72/13, Isa Halimi, Aktvendim i datës 3 dhjetor 2013 - Kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 241/2010, të 10 janarit 2013

Rasti KI72/13, vendimi i 3 dhjetorit 2013.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar.

Parashtruesi I kërkesës ka pretenduar se Gjykata Komunale në Ferizaj, ka nxjerrë një Aktvendim pa asnjë mbështetje ligjore dhe se me këtë Aktvendim atij I është shkelur e drejta e njeriut, e garantuar me Kushtetutë–E Drejta e Punës.

Parashtruesi më tej ka theksuar se Aktvendimi i Gjykatës Supreme është kontradiktor dhe jo idrejtë, sepse në mes të tjerash, në kolegji ka marrë pjesë edhe gjyqtarja qëka vendosur padinë [nëGjykatënKomunalenëFerizaj].

Gjykata konstaton se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin përshkeljen e një të drejte kushtetuese dhe nuk mund të konstatohet se kërkesa ishte e bazuar.

Gjykata Kushtetuese, në përputhshmëri me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 36 paragrafi 2 pika b të Rregullores së punës, më 3 dhjetor 2013, një zëri deklaroi kërkesën të papranueshme.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në**

Rastin Nr. KI72/13

Parashtruesi

Isa Halimi

**Kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të
Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 241/2010, të 10 janarit
2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar

Ivan Čukalović,

zëvendëskryetar

Robert Carolan,

gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova,

gjyqtare

Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe

Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Isa Halimi (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës) nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 241/2010, i 10 janarit 2013, e ka pranuar më 13 shkurt 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) më 15 maj 2013, është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 241/2010, me anë të cilit parashtruesit të kërkesës i është refuzuar si i pabazuar revizioni dhe Aktvendim mi i Gjykatës së Qarkut Ac. nr. 112/2008, më 4 gusht 2010 ishte vërtetuar.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 15 maj 2013, parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 27 maj 2013, me Vendimin GJR. KI72/13, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
7. Më 13 qershor 2013, Gjykata Kushtetuese kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 9 shtator 2013, Gjykata Kushtetuese kishte kërkuar sqarim nga Gjykata Supreme lidhur me çështjen e pjesëmarrjes së gjyqtarës N. I. në dy instanca vendimmarrëse për të njëjtën çështje juridike, fakt ky që konstatohet nga kopjet e aktvendimeve të gjykatave të rregullta të bashkëngjitura me kërkesën nga parashtruesi i saj.
9. Më 12 shtator 2013, Gjykata Kushtetuese ka pranuar nga Gjykata Supreme përgjigje lidhur me sqarimin e kërkuar.
10. Më 17 tetor 2013, Gjykata ka njoftuar parashtruesin e kërkesës lidhur me përgjigjen e Gjykatës Supreme.
11. Më 5 nëntor 2013, Gjykata ka pranuar komentet me shkrim nga parashtruesi i kërkesës përkitazi me përgjigjen e Gjykatës Supreme.
12. Më 3 dhjetor 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 11 shtator 2001, Komuna e Ferizajt - Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport (në tekstin e mëtejshëm: DKRS), ka shpallur konkurs për

plotësimin e 7 (shtatë) pozitive të lira të punës në bibliotekën e qytetit, në mesin e të cilave edhe pozitën “përgjegjës (e) të bibliotekës” të radhitur në pikën 1 (një) të konkursit.

14. Për këtë pozitë, sipas procesverbalit të DKRS-së, të 29 shtatorit 2001, kanë konkurruar: M. P., E. Zh., E .S., H. Sh. dhe parashtruesi i kërkesës Isa Halimi.
15. Pas intervistimit, komisioni rekrutues kishte përpiluar renditjen përfundimtare dhe kishte propozuar që komuna të lidhë kontratë pune me kandidatin E. Zh., të cilin e kishte vlerësuar si më të mirin me 115 poena, ndërsa parashtruesin e kërkesës e kishte vlerësuar me 65 poena, dhe e kishte renditur si të tretin në listë. Ky propozim ishte aprovuar dhe E.Zh. kishte lidhur marrëdhënie pune me Komunën e Ferizajt për pozitën përgjegjës në bibliotekën e qytetit.
16. Këtë Vendim të Komunës, në Gjykatën Komunale në Ferizaj e kishte kontestuar me padi parashtruesi i kërkesës duke kërkuar anulimin e përzgjedhjes së kandidatit sipas këtij konkursi, duke paraqitur edhe argumentet për mospërmbylljen e kushteve të kërkuara në konkurs nga ana e kandidatit të zgjedhur.
17. Më 28 mars 2002, Gjykata Komunale në Ferizaj ka nxjerrë Aktgjykimin C. nr. 318/2001, në dispozitivin e të cilit përcaktohet se: *“APROVOHET kërkespadija e paditësit dhe anulohet Aktvendimi i Bordit të Drejtoreve të Komunës së Ferizajt, nr. 1485, i 1 tetorit 2001 mbi zgjedhjen e kandidatit përgjegjës të Bibliotekës së qytetit "Anton Çetta" në Ferizaj, dhe obligohet e paditura që në afat prej 15 ditësh të bëjë rizgjedhjen në mesin e kandidatëve pjesëmarrës në konkurs për vendin e punës përgjegjës i bibliotekës të qytetit në Ferizaj (nën kërcënimin për ekzekutim të dhunshëm)”*.
18. Më 9 korrik 2004, Gjykata Komunale në Ferizaj, në procedurën përmbartimore kishte aprovuar propozimin për ekzekutim të Aktgjykimit C. nr. 318/2001, dhe me Aktvendimin ekzekutiv 851/04, kishte caktuar ekzekutimin e këtij Aktgjykimi.
19. Më 17 maj 2005, duke u bazuar në propozimin e avokatit komunal të Komunës si dhe duke marrë parasysh Aktvendimin E 851/04, të 9 korrikut 2004, të Gjykatës Komunale të Ferizajt për lejimin e ekzekutimit të Aktgjykimit C. nr. 318/2001 të po kësaj gjykate, Komuna e Ferizajt - Bordi i Drejtoreve, nxori Vendimin 02. nr. 1111, me të cilin ANULOI Vendimin e vet paraprak, nr. 1485 të 2 tetorit 2001, për zgjedhjen e kandidatit E. ZH. në pozitën e përgjegjësit të bibliotekës së qytetit, duke ia anuluar njëkohësisht edhe kontratën

e punës të 17 majit 2005, dhe gjithashtu vendosi që në afat ligjor të bëjë përzgjedhjen e sërishme për këtë pozitë nga pjesëmarrësit në konkursin e shpallur.

20. Më 24 maj 2005, Komuna e Ferizajt - Bordi i Drejtorëve, nxori Vendimin 02 nr. 1172, me të cilin kandidatin E. ZH. e zgjodhi përgjegjës për bibliotekën e qytetit nga 24 maji 2005, pra në procedurë të ripërsëritur zgjodhi kandidatin e njëjtë.
21. Më 21 nëntor 2007, Gjykata Komunale në Ferizaj nxori Aktvendimin C. nr. 453/05, me anë të të cilit padia e paditësit-parashtruesit të kërkesës, e ushtruar kundër të paditurës Komuna e Ferizajt - DKRS, - hidhet si e parakohshme. Në arsyetimin e Aktvendimit, Gjykata Komunale kishte theksuar se: *”paditësi nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike që i ka pasur në dispozicion në procedurë administrative se para të ushtrojë padinë, paditësi ka pasur të drejtë që me ankesë t’i drejtohet Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, si organi më i lartë kompetent për të vendosur për ankesa në procedurën e rekrutimit të shërbyesve civilë dhe se vetëm vendimi i Këshillit është vendim definitiv në procedurë administrative”*.
22. Edhe pse parashtruesi i kërkesës nuk e kishte bashkëngjitur me kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, Gjykata nga Aktvendimi i Gjykatës Supreme, e cila ka vendosur për revizionin, konstaton se Gjykata e Qarkut në Prishtinë kishte nxjerrë Aktvendimin Ac. nr. 112/2008, më 4 gusht 2010, me të cilin *‘e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit dhe është vërtetuar Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Ferizaj, C. nr. 453/2005, i 21 nëntorit 2008, me të cilin padia e paditësit është hedhur si e parakohshme”*.
23. Kundër këtij Aktvendimi, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.
24. Më 10 janar 2013, Gjykata Supreme e Kosovës ka nxjerrë Aktvendimin Rev. nr. 241/2010, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar revizionin e paditësit paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 112/2008, më 4 gusht 2010. Gjykata Supreme *“duke refuzuar ankesën e paditësit në tërësi, ka pranuar konstatimet dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë”*.

Pretendimet e parashtruesit për shkelje kushtetuese

25. Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se "pas revizionit, Gjykata Supreme në përbërje të E. B., kryetar, SH. S. dhe N. I., anëtarë, përndryshe ish-gjyqtare e Gjykatës Komunale në Ferizaj, kanë nxjerrë një Aktvendim pa asnjë mbështetje ligjore dhe se me këtë Aktvendim atij i është shkelur e drejta e njeriut, e garantuar me Kushtetutë – E Drejta e Punës.
26. Parashtruesi më tej ka potencuar se ai ishte konsultuar me përgjegjës të KPMK-së dhe se i është thënë, se KPMK-ja nuk vendos për lëndët që kanë ndodhur para se Këshilli të jetë konstituuar dhe mu për këtë i është drejtuar drejtpërsëdrejti Gjykatës Komunale. Parashtruesi më tej ka theksuar se Aktvendimi i Gjykatës Supreme është kontradiktor dhe jo i drejtë, sepse në mes të tjerash, në kolegji ka marrë pjesë edhe gjyqtarja që ka vendosur padinë [në Gjykatën Komunale në Ferizaj].

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

27. Për të qenë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse pala i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara me Kushtetutë, Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës të Gjykatës.
28. Lidhur me këtë, i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, ku përcaktohet:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

29. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se kërkesa e regjistruar me Nr. KI72/13 është dorëzuar në Gjykatë nga një individ, ishte dorëzuar në Gjykatë brenda afatit 4-mujor të paraparë me nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, dhe se parashtruesi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion dhe rrjedhimisht i ka përmbushur kriteret formale në mënyrë që kërkesa e tij të jetë e përshtatshme për t'u shqyrtuar në Gjykatën Kushtetuese.

Vlerësimi i meritave të kërkesës

30. Pasi parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret procedurale për pranueshmëri, Gjykata duhet t'i shqyrtojë meritat e ankesës së parashtruesit.

31. Gjykata vëren se parashtruesi e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 241/2010, të 10 janarit 2013, me të cilin iu refuzua si e pabazuar kërkesa për revizion, e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 112/2008, i 4 gushtit 2010.
32. Për sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës së tij me Aktvendimin e Gjykatës Supreme t'i jetë shkelur E Drejta për Punë (neni 49 i Kushtetutës) për shkak se ajo Gjykatë e ka refuzuar revizionin duke vërtetuar aktvendimet e gjykatave të instancave më të ulëta, të cilat kishin konstatuar se parashtruesi ka dështuar t'i shterë mjetet juridike që i kishte në dispozicion, andaj padia ishte e parakohshme, Gjykata Kushtetuese thekson se kjo çështje është çështje e zbatimit të ligjshmërisë dhe veçanërisht në rastin konkret të Rregullores 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës, që ishte në fuqi në atë kohë, dhe u takon gjykatave të rregullta të çmojnë gjendjen faktike të përdorimit të mjetit juridik për ankim në KPMK.
33. Gjykata Kushtetuese ka rol subsidiar krahasuar me sistemet vendore të rregullta gjyqësore apo edhe administrative, dhe është e dëshirueshme që gjykatat kombëtare ose organet kompetente administrative me kompetenca të vendimmarrjes efektive të kenë fillimisht mundësinë që të vendosin për çështje të pajtueshmërisë të së drejtës së brendshme me Kushtetutën (shih Vendimin e GJNDJ-së - A, B dhe C kundër Irlandës [DHM], § 142).
34. Andaj, ajo nuk gjykon si gjykatë e shkallës së katërt, nuk është gjykatë e faktit dhe roli i saj është vetëm që ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe në asnjë rast nuk merr rolin e "gjykatës së shkallës së katërt" (shih, *mutatis mutandis*, i.a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65), andaj në këto rrethana nuk mund të konstatojë shkelje të nenit 49 të Kushtetutës.
35. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij, sikur është theksuar në paragrafin 21 të këtij raporti, ka potencuar përbërjen e Kolegjit gjyqësor të Gjykatës Supreme, por pa ngritur në mënyrë specifike nëse përbërja e këtij kolegji mund të përbënte eventalisht shkelje të ndonjë të drejte të njeriut të garantuar me Kushtetutë.
36. Edhe pse në fakt nga kopjet e Aktvendimit të Gjykatës Komunale, C. nr. 453/05, të 21 nëntorit 2007, dhe të Aktvendimit të Gjykatës Supreme për Revizionin, Rev. nr. 241/2010, të 10 janarit 2013, të

cilat i janë bashkëngjitur kërkesës nga parashtruesi i saj, mund të konstatohet se emri i gjyqtarës N. I. figuron në të dyja aktvendimet si pjesëmarrëse në kolegjet gjyqësore që kanë vendosur në çështjen juridike të ngritur nga parashtruesi i kërkesës.

37. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese ka pranuar shkresën sqaruese, nr. 357/13, të 12 shtatorit 2013, nga Gjykata Supreme, pjesë e së cilës janë deklarata e gjyqtarës N. I., e cila me përgjegjësi morale e penale potencon se nuk ka qenë pjesë e kolegjit në Gjykatën Supreme, kur është vendosur për çështjen e revizionit dhe gjithashtu, Gjykata Supreme ka dërguar edhe Aktvendimin për përmirësimin e Aktvendimit, Rev. nr. 241/2010, të 10 janarit 2013.
38. Ky aktvendim është nxjerrë më 9 shtator 2013 dhe në dispozitivin e tij theksohet:

“PËRMIRËSOHET Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 241/2010, të 10 janarit 2013, në pjesën hyrëse, ashtu që në vend të emrit të gjyqtarës Nazmije Ibrahimit si anëtare e dytë kolegjit duhet të jetë emri i gjyqtarës Gyltene Sylejmani”.

39. Gjykata merr për bazë kompetencat e gjykatave të rregullta, sipas Ligjit për procedurën kontestimore (Ligji Nr. 03/L-006, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës: Viti III / Nr. 38/ 20 shtator 2008) të cilat përcaktohen me nenin 165 (korrigjimi i Aktgjykimit), e ku shprehimisht theksohet se *“1- Gabimet në emra dhe numra, si dhe gabimet e tjera në shkrim dhe llogaritje, mungesat në aspektin e formës së aktgjykimit dhe mospajtimi i kopjes me origjinalin e aktgjykimit, i korrigjon gjykata në çdo kohë”.*
40. Në pikën dy të po këtij neni përcaktohet se korrigjimi bëhet me Aktvendim, sikurse edhe është vepruar në rastin konkret nga Gjykata Supreme, duke respektuar procedurën e bazuar në ligj, lidhur me përmirësimin e revizionit të nxjerrë sipas kërkesës së parashtruesit, andaj Gjykata nuk gjen fakte dhe asnjë lloj forme të arbitraritetit në këto veprime juridike të Gjykatës, dhe shkeljes të së Drejtës për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm (neni 31) i Kushtetutës.
41. Parashtruesi i kërkesës as në përgjigjen e tij shtesë lidhur me këto akte juridike të Gjykatës Supreme nuk ka potencuar shkelje eksplicite të të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë përpos që ka shprehur habinë *“se nuk është e mundur që në Gjykatën Supreme të gabohet në atë nivel”.*

42. Në këto rrethana Gjykata konstaton se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese; nuk mund të konstatohet se kërkesa ishte e bazuar, andaj

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhshmëri me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 36 paragrafi 2 pika b të Rregullores së punës, më 3 dhjetor 2013, njëzëri

VENDOS

- I. TA SHPALLË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në përputhje me nenin 20 (4) të Ligjit;
- IV. TË SHPALLË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI140/13, Ramadan Cakiqi, Aktvendim i datës 2 dhjetor 2013 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, SCEL-09-0001, të 10qershorit 2011.

Rasti KI140/13, vendim i 2 dhjetorit 2013.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, e drejta e pronës, e paafatshme.

Parashtruesi dorëzoi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 dhe rregullin 56, paragrafi 2 të Rregullores së Punës.

Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit SCEL-09-0001, i cili pretendohet të ketë mohuar të drejtën e parashtruesit të kërkesës në një pjesë të ardhurave të fituara nga privatizimi i Ndërmarrjes Shoqërore “Ramiz Sadiku” në Prishtinë. Parashtruesi i kërkesës nuk thirret në ndonjë dispozitë kushtetuese në veçanti.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e njeriut sepse “nuk më janë njohur të drejtat nga marrëdhënia e punës, të cilat i kam pasur gjatë 4 viteve në punë në NSH “Ramiz Sadiku.”

Gjykata vëren se vendimi i cili kontestohet nga parashtruesi i kërkesës është i 10 qershorit 2011, ndërsa kërkesa është dorëzuar më 4 shtator 2013. Kërkesa e parashtruesit nuk është në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores, pasi që ishte dorëzuar në Gjykatë më shumë se dy (2) vite pas ditës së vendimit të fundit.

Prandaj, kërkesa e parashtruesit është refuzuar si e paafatshme.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI140/13
Parashtrues
Ramadan Cakiqi
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit, SCEL-09-0001,
të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 10
qershorit 2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Ramadan Cakiqi (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi) me vendbanim në Podujevë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin, SCEL-09-0001, të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 10 qershorit 2011. Data e dorëzimit të Aktgjykimit është e panjohur.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, SCEL-09-0001, i cili pretendohet të ketë mohuar të drejtën e parashtruesit të kërkesës në një pjesë të ardhurave të fituara nga privatizimi i Ndërmarrjes Shoqërore “Ramiz Sadiku” në Prishtinë, (në tekstin e mëtejshëm: NSH “Ramiz Sadiku”).
4. Në këtë drejtim, parashtruesi nuk thirret në asnjë dispozitë kushtetuese në veçanti.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës

së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 4 shtator 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
7. Më 24 shtator 2013, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI140/13, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Në datën e njëjtë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI140/13, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
8. Më 9 tetor 2013, Gjykata e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Dhoma e Posaçme) u informua lidhur me kërkesën.
9. Më 2 dhjetor 2013, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues ia rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesi ishte si punonjës i NSH “Ramiz Sadiku”, ndërmjet viteve 1986 dhe 1990.
11. Më 27 qershor 2006, NSH “Ramiz Sadiku” u privatizua.
12. Në mars 2009, AKP-ja publikoi listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar për të marrë 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH “Ramiz Sadiku”. Afati i fundit për të ushtruar ankesë në Dhomën e Posaçme ishte 27 marsi 2009.

13. Më 13 mars 2009, parashtruesi ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër AKP, me të cilën kërkoi që të përfshihet në listën e punëtorëve të kualifikuar për të marrë 20% të të ardhurave nga privatizimi.
14. Më 10 qershor 2011, Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme (Aktgjykimi SCEL-09-0001) refuzoi ankesën e parashtruesit, duke konstatuar se parashtruesi nuk i kishte plotësuar kërkesat e nenit 10.4 të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut 2003/13, pasi që ai e kishte arritur moshën e pensionimit para privatizimit të NSH “Ramiz Sadiku”.
15. Më 4 shtator 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të lartpërmendur.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi pretendon se ai kishte punuar në NSH “Ramiz Sadiku”, *“prej 1986 deri më 28.02.1990, kur ne u dëbuam nga forcat serbe. Pas luftës, ne u kthym të punojmë në ndërmarrjen Ramiz Sadiku, dhe ata atje nuk na pranuan, duke na thënë se do të na thërrasin, por ata kurrë nuk e bënë këtë”*.
17. Parashtruesi pretendon se i janë shkelur të drejtat e njeriut sepse *“nuk më janë njohur të drejtat nga marrëdhënia e punës, të cilat i kam pasur gjatë 4 viteve në punë në NSH “Ramiz Sadiku”*.
18. Parashtruesi i kërkesës nuk thirret në asnjë dispozitë kushtetuese në veçanti.

Pranueshmëria e kërkesës

19. Gjykata vëren se, për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit duhet së pari të vlerësojë nëse ai i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri të parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.
20. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
21. Për më tepër, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër njëligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.

22. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

...

(b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi”.

23. Në këto rrethana, Gjykata vëren se vendimi i cili kontestohet nga parashtruesi i kërkesës është i 10 qershorit 2011, ndërsa kërkesa është dorëzuar më 4 shtator 2013. Kërkesa e parashtruesit nuk është në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b), pasi që ishte dorëzuar në Gjykatë më shumë se dy (2) vite pas ditës së vendimit të fundit.
24. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor katër (4) mujor, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri ligjore, duke siguruar se rastet që kanë të bëjnë me çështje të Kushtetutës të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe se vendimet e mëparshme nuk janë vazhdimisht të hapura për t’u kontestuar (Shih rastin O’Loughlin dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr. 23274/04, GJEDNJ, Aktvendimi i 25 gushtit 2005).
25. Gjykata përsërit se neni 49 i Ligjit dhe rregulli 36 (1) b) i Rregullores, kërkon që parashtruesit pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike, t’i dorëzojnë kërkesat e tyre brenda periudhës prej katër (4) muajve të afatit ligjor, nga dita kur është pranuar vendimi përfundimtar i gjykatës.
26. Nga kjo del se kërkesa është e paafatshme.
27. Rrjedh se kërkesa duhet të hedhet poshtë si e papranueshme, për shkak të mospajtimit me kriteret e parapara me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 56 (2) të Rregullores, më 2 dhjetor 2013, njëzëri:

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe
- IV. TË DEKLAROJË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Arta Rama-Hajrizi

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. dr. Enver Hasani

KI42/12, Rizah Ismajli, Aktvendim i datës 9 shtator 2013 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së kërkesës për dhënien e mendimit

Rasti KI42/12, vendimi i 9 shtatorit 2013.

Fjalët kyçe: Kërkesa individuale, palë e paautorizuar, mos-shterimi

Parashtruesi i kërkesës nuk konteston asnjë vendim të autoritetit publik; ai thjesht ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese që të nxjerrë një opinion në lidhje me gjashtë (6) pyetjet që ishin parashtruar në kërkesë. Këto pyetje i përkisnin të drejtës të pretenduar të punonjësve të NTSH "Gërmia" për të përdorur objektet e kompanisë.

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se përfaqësuesit e NTSH "Gërmia" kanë të drejtë të përdorin objektet e tilla derisa e njëjta të privatizohet. Në këtë drejtim, ata pretenduan se është shkelur e drejta e tyre e garantuar me nenin 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Gjykata Kushtetuese deklaroi kërkesën të papranueshme sepse pala nuk ka paraqitur një autorizim të duhur për të përfaqësuar anëtarët e Sindikatës "Gërmia". Megjithatë, Gjykata Kushtetuese vlerësoi se edhe duke supozuar se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, a inuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion pasi që ai parashtroi kërkesë drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese, pa iniciuar ndonjë procedure në gjykatat rregullta. Së fundi, Gjykata Kushtetuese konstatoi se, në bazë të nenit 113.1, Gjykata Kushtetuese nuk është kompetente për të dhënë mendim mbi pyetjet që janë parashtruar nga parashtruesi i kërkesës. Rrjedhimisht, kërkesa ishte deklaruar e papranueshme.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në**

Rastin Nr. KI42/12

Parashtrues

Rizah Ismajli

Kërkesë për dhënien e mendimit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar

Ivan Čukalović, zëvendëskryetar

Robert Carolan,

gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova,

gjyqtare

Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe

Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Riza Ismajli nga fshati Zhiti, komuna e Podujevës, punëtor i NTSH “Gërmia” në Prishtinë. Pretendohet se ai është duke vepruar me autorizim të lëshuar nga Kryesia e Sindikatës së NTSH “Gërmia”, në përfaqësim të 473 punëtorëve të saj në procedurën pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, në mënyrë që të marrin “kompensimin e të ardhurave personale”.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk konteston ndonjë aktgjykim të Gjykatës apo vendim administrativ.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës parashtron se punëtorët e NTSH “Gërmia” kërkojnë nga Gjykata të japë një mendim lidhje me çështjen, nëse ata kanë të drejtë të kërkojnë nga shfrytëzuesit aktualë pagesën e qirasë për shfrytëzimin e lokaleve afariste në sipërfaqe prej 11.500 m², të Shtëpisë së Re të Mallrave “Gërmia” në Prishtinë.

Baza juridike

4. Me sa duket, kërkesa nuk bazohet në nenet 113.7 dhe 21. 4 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, Nr. 03/L-121, për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) ose rregullin 56 (3) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 18 prill 2012, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë. Sidoqoftë, autorizimi i 20 gushtit 2009, të cilin ai e dorëzoi në Gjykatë së bashku me kërkesën, duket se ka të bëjë me autorizimin për t'i përfaqësuar punëtorët e NTSH "Gërmia" në procedurën pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme lidhur me kompensimin e të ardhurave personale.
6. Më 23 maj 2012, me Vendimin KSH. KI42/12, Kryetari e caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Ivan Čukalović (gjyqtar kryesues), Gjyljeta Mushkolaj dhe Iliriana Islami. Kur mandati i tyre si anëtarë të Gjykatës Kushtetuese kishte skaduar në qershor 2012, gjyqtaret Gjyljeta Mushkolaj dhe Iliriana Islami u zëvendësuan nga gjyqtarët Enver Hasani dhe Robert Carolan, me Vendimin e Kryetarit, Nr. KSH. KI42/212.

Përmbledhja e fakteve

7. Me letrën e 26 janarit 2009, të adresuar Ministrisë së Shërbimeve Publike, Sindikata e Pavarur e punëtorëve të NTSH "Gërmia" e informoi Ministrinë se punëtorët kishin dokumentacion të vlefshëm, se ata kishin më tepër se 62 shitore në tërë Kosovën, për të cilat ata nuk merrnin asnjë qira, dhe se Ministria e Shërbimeve Publike e mori pronën e tyre më të vlefshme. Ata ushtruan ankesë në të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, në Qeveri dhe në të gjitha ministritë, që t'i ndërmarrin masat e nevojshme për t'i ndaluar njëherë e përgjithmonë njerëzit e korruptuar dhe t'i ndjekin penalisht. Nëse qiraja do të paguhej, thuhej më tej në letër, ata do të arrinin të siguronin jetesë për vete dhe për familjet e tyre.
8. Më 4 nëntor 2009, Sindikata ishte regjistruar në Ministrinë e Punës dhe të Mirëqenies Sociale.

9. Një tjetër letër iu dërgua Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), më 24 mars 2010, duke kërkuar nga ai që t'i nxisë institucionet, organet publike dhe personat privatë që i kanë uzurpuar lokalet e “Gërmisë”, ta paguajnë qiranë pasi që ata ishin vendosur aty. Në letër thuhej më tutje se nga qiraja, e cila do të mund të mblidhej nga këto institucione, do të mund të paguheshin pagat e rreth 400 punëtorëve të NTSH “Gërmia”, të cilët janë pa mjete financiare.
10. Më 22 mars 2011, kryetari dhe zëvendëskryetari i Sindikatës i dërguan edhe një letër Ministrisë së Administratës Publike, me qëllim të inicimit të procedurës administrative në Ministri. Ata e informuan Ministrinë se punëtorët e NTSH “Gërmia” kërkojnë nga ajo që t'i shfrytëzojë kompetencat e saj për pagesën e qirasë për Shtëpinë e Mallrave “Gërmia”, ku ishin vendosur 5 ministri që nga viti 2000, dhe të cilat nuk kishin paguar qira për 12 vjet. Në letër thuhej më tej se AKP-ja i menaxhonte ndërmarrjet shoqërore dhe publike për punëtorët, të cilët i kishin ndërtuar objektet në vitin 1970, siç dëshmohet me dokumente të vlefshme.
11. Fakte të tjera nuk janë dorëzuar.

Pretendimet dhe pohimet e parashtresit

12. Parashtresi pretendon se përfaqësuesit e NTSH “Gërmia”, janë të bindur se objekti i Shtëpisë së Mallrave është pronë e tyre dhe se ata mund ta përdorin atë në mënyrë ligjore derisa ajo të privatizohet, sipas nenit 46 [Mbrotja e Pronës] së Kushtetutës, i cili parasheh se *“Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona”*.
13. Punëtorët e NTSH “Gërmia”, të organizuar në sindikata, përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar, kërkojnë nga Gjykata të japë mendimin e saj në lidhje me çështjet vijuese:
 - 1) A kanë të drejtë punëtorët e NTSH “Gërmia” që t'i përdorin lokalet etyre;
 - 2) Nëse po, a kanë të drejtë ta kërkojnë pagesën e qirasë nga shfrytëzuesit e tanishëm;
 - 3) A do ta njohë Gjykata cilësinë e tyre ligjore si palë sipas nenit 73 të Ligjit për procedurën kontestimore;

- 4) A e ka përfaqësuesi i Këshillit të Sindikatës, sipas autorizimit, cilësinë procedurale;
- 5) Nëse jo, kush mund t'i përfaqësojë ata për t'i realizuar të drejtat e tyre;
- 6) A kanë të drejtë të kërkojnë nga institucionet që shfrytëzuesit etanishëm t'i lirojnë ato, të cilët pa asnjë titull ligjor i shfrytëzojnë këtolokale afariste?

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

14. Në mënyrë që Gjykata të jetë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të parapara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës.
15. Gjykata së pari duhet të përcaktojë nëse parashtruesi është palë e autorizuar, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, që parasheh se *“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi t'i kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”*. Në lidhje me këtë, kërkesa në Gjykatë është dorëzuar nga z. Riza Ismajli, punëtor i NTSH “Gërmia” dhe kryetar i sindikatës së saj, duke vepruar sipas autorizimit të Kryesisë së Sindikatës *“që t'i përfaqësojë punëtorët e NTSH “Gërmia” në Prishtinë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, lidhur me kompensimin e të ardhurave personale”*.
16. Sa i përket autorizimit të cituar më lart, Gjykata vëren se, me sa duket, ai nuk e përfshin procedurën në këtë gjykatë, por vetëm procedurat në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës. Nga kjo rrjedh se parashtruesi nuk mund të konsiderohet palë e autorizuar sipas nenit 113.7 të Kushtetutës.
17. Megjithatë, edhe duke supozuar se Kryesia e Sindikatës ka pasur qëllimin ta autorizojë z. Riza Ismajli që t'i përfaqësojë punëtorët e NTSH “Gërmia” në procedurën pranë Gjykatës Kushtetuese, kërkesa duhet të shpallet e papranueshme për arsytet vijuese:

18. Siç u përmend më lart, parashtruesi është i obliguar që, në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit, t'i shterojë të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në Kosovë.
19. Gjykata thekson se arsyetimi për rregullin e shterimit, siç interpretohet nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) është që t'ua ofrojë autoriteteve publike, duke përfshirë edhe gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e pretenduar të të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutë dhe/ose instrumente ndërkombëtare, drejtpërdrejt të aplikueshme në Kosovë. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi ligjor i Kosovës do të sigurojë mjete efikase për trajtimin e shkeljes së pretenduar të të drejtave të tilla themelore. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të procedurës në Gjykatën Kushtetuese (Shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës nr. 25803/94, Vendim i 28 korrikut 1999).
20. Megjithatë, rregulli i shterimit, jo vetëm që kërkon nga parashtruesi t'i shterojë të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit të Kosovës para dorëzimit të kërkesës në Gjykatë, duke përfshirë gjykatën e instancës më të lartë, por gjithashtu kërkon që i njëjti ta ketë ngritur shkeljen e pretenduar të së drejtës themelore në procedurat në këto gjykata.
21. Në rastin konkret, Gjykata vëren se është e qartë nga dokumentacioni i dorëzuar nga parashtruesi se pretendimet, që tani i paraqet para Gjykatës, ai nuk i ka paraqitur pranë gjykatave kompetente në Kosovë. Prandaj, parashtruesi nuk ka dëshmuar se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në Kosovë, siç ka qenë i obliguar të veprojë sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit.
22. Për më tepër, Gjykata nuk është kompetente, në bazë të nenit 113.1 të Kushtetutës, të japë mendim në lidhje me çështjet e lartcekura nga parashtruesi.
23. Prandaj, Gjykata konsideron se kërkesa duhet të hidhet poshtë si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47.2 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1) c) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 9 shtator 2013, njëzëri:

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u kumtohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI144/13, Ramë Hoxha, Aktvendim i datës 3 dhjetor 2013 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev. nr. 300/2011, të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 3 majit 2013

Rasti KI144/13, vendimi i 3 dhjetorit 2013.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, e drejta e punës, qartazi e pabazuar

Parashtruesi e parashtroi kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 dhe rregullin 56 paragrafi 2 të Rregullores së punës.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se janë shkelur neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 49 [E drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit], 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës, si dhe neni 6 [E Drejta për Proces të Rregullt] i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: Konventa).

Përfundimisht, parashtruesi kërkon nga Gjykata ta shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 300/2011, të 3 majit 2013 dhe Aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 346/2010, të 19 korrikut 2011.

Parashtruesi në kërkesë pretendon se Aktgjykimi i kontestuar [Rev. nr. 63/2014] i Gjykatës Supreme i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, dhe atë: nenin 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës i cili përcakton se Republika e Kosovës është shoqëri multietnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.

Duke shqyrtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev. nr. 300/2011, të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 3 majit 2013, Gjykata Kushtetuese konstatoi se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtave kushtetuese dhe se parashtruesi i kërkesës nuk i ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij dhe, rrjedhimisht, kërkesa e tij është qartazi e pabazuar.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në**

Rastin nr. KI144/13

Parashtruesi

Ramë Hoxha

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev. nr.
300/2011, të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 3 majit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Ramë Hoxha (në tekstin e mëtejme: parashtruesi), me vendbanim në Pejë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin Rev. nr. 300/2011, të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 3 majit 2013, i cili iu dorëzua atij më 28 maj 2013; dhe Aktgjykimin Ac. nr. 346/2010, të Gjykatës së Qarkut në Pejë, të 19 korrikut 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara të gjykatave të rregullta, të cilat pretendohet se vërtetuan *“vendimin e gabueshëm dhe të padrejtë të punëdhënësit të parashtruesit të kërkesës për ta larguar atë nga puna”*.
4. Në këtë drejtim, parashtruesi pretendon se janë shkelur neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesioneve], 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës si dhe neni 6 [E Drejta për Proces të Rregullt] i Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejme: Konventa).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 10 shtator 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 24 shtator 2013, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI144/13 e caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova si Gjyqtare raportuese. Në të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI144/13, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.
8. Më 21 tetor 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata Supreme e Kosovës u informua në lidhje me kërkesën.
9. Më 2 dhjetor 2013, kryetari i Gjykatës, në pajtim me nenin 11 të Ligjit dhe rregullin 9 (1) të Rregullores, me Vendimin Nr. KSH. KI144/13, caktoi gjyqtarin Altay Suroy si anëtar të Kolegjit shqyrtues, në vend të gjyqtarit Robert Carolan.
10. Më 3 dhjetor 2013, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 1999, parashtruesi ishte punësuar si punonjës i kompanisë “KOSOVA PETROLL” (në tekstin e mëtejme: punëdhënësi) për kohë të pacaktuar.
12. Më 14 tetor 1999, punëdhënësi, me Vendimin nr. 05-114, e ndaloj parashtruesin të punojë në stacionin e benzinës nr. 1 në Pejë, i cili

pretendohet të jetë uzurpuar nga personat e tretë dhe ishte jashtë autoritetit faktik të punëdhënësit. Në vendim, ndër të tjera, thuhej:

“Të gjithë punëtorëve të ndërmarrjes shtetërore për qarkullimin e derivateve të naftës “Kosova Petrol” u ndalohet rreptësisht puna në stacionet e benzinës, që janë pronë e ndërmarrjes e që përkohësisht shfrytëzohen nga uzurpuesit jolegjitim”.

13. Më 27 mars 2003, punëdhënësi, me Vendimin nr. 05-312, theksoi si në vijim:

“Të gjitha kontratat e punës të punëtorëve të Ndërmarrjes për qarkullimin e derivateve të naftës “Kosova Petrol” të lidhura para 1 janarit 2003, të cilat nuk janë përtërirë gjatë vitit 2003, shpëputen në mënyrë të njëanshme nga 1 marsi 2003.

Nga 1 marsi 2003 do të lidhen kontrata të reja të punës për të gjithë punëtorët që për momentin janë të nevojshëm për ndërmarrjen, ndërsa punëtorët të cilëve nuk do t’iu përtërihen kontratat e punës, do të kalojnë në asistencë sociale”.

14. Pas kësaj, parashtruesi paraqiti padi kundër punëdhënësit, për kompensimin e të ardhurave personale të papaguara.
15. Më 9 tetor 2003, punëdhënësi, me Vendimin nr. 05-671, e dërgoi parashtruesin e kërkesës në pushim pa pagesë, për tre (3) muaj, duke filluar nga 8 tetori 2003 deri më 8 janar 2004, që pretendohet të jetë bërë pa kërkesën e tij dhe kundër vullnetit të tij.
16. Më 23 dhjetor 2003, Gjykata Komunale në Pejë, me Aktgjykimin C. nr. 15/03, e obligoi punëdhënësin t’i paguajë parashtruesit në emër të të ardhurave personale shumë prej 3.520.00 euro, për periudhën prej 1 marsit 2001 deri më 31 qershor 2003.
17. Më 6 mars 2006, Gjykata Komunale në Pejë, me Aktgjykimin C. nr. 1152/05, e anuloi vendimin e punëdhënësit për ta dërguar parashtruesin në pushim pa pagesë, si të paligjshëm, dhe e obligoi punëdhënësin që t’i paguajë shpenzimet procedurale, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.
18. Më 26 tetor 2007, Gjykata Komunale në Pejë, me Aktgjykimin C. nr. 422/06, e obligoi punëdhënësin t’i paguajë parashtruesit të kërkesës në emër të të ardhurave personale shumë prej 15.340.80

euro, për periudhën prej 1 tetorit 2003 deri më 30 shtator 2007, duke përfshirë kamatën vjetore.

19. Në Aktgjykimin e lartpërmendur, C. nr. 422/06, Gjykata Komunale në Pejë, argumentoi më tej:

“...Pas vlerësimit të fakteve relevante, bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar, të cilat gjykata i vërtetoi në seancën e shqyrtimit kryesor, rrjedh se kërkesëpadia e paditësit ka bazë juridike dhe si të tillë gjykata e aprovoi si të bazuar.

Gjykata e mbështet një konstatim të tillë në faktin se e paditura (punëdhënësi) e ka dërguar paditësin (parashtruesin) në pushim pa pagesë, me Vendimin nr. 05-671, të 9 tetorit 2003, për 3 muaj, duke filluar më 8 tetor 2003 deri më 8 janar 2004. Vendimi i tillë është në kundërshtim me dispozitat ligjore të cilat tani janë në fuqi në Kosovë. Me Ligjin për marrëdhëniet e punës të Kosovës, i cili, sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/1 dhe 1999/20 është në fuqi, nuk është e rregulluar çështja e dërgimit të punëtorëve në pushim pa pagesë, mirëpo kjo çështje është rregulluar me Ligjin themelor të punës në Kosovë, i cili ligj, sipas Rregullores, nr. 2001/27, të 8 tetorit 2001, është ende në fuqi dhe i aplikueshëm.

Kjo çështje është e rregulluar me nenin 21 të Ligjit themelor të punës të Kosovës (Rreg. e UNMIK-ut. nr. 2001/27). Me këtë dispozitë thuhet se "punëdhënësi, me kërkesë të punonjësit, mund t'i lejojë punonjësit pushim pa pagesë", pra sipas kësaj dispozite pushimi pa pagesë i lejohet punëtorit nga punëdhënësi nëse punëtori ka bërë kërkesë.

Në rastin konkret, paditësi nuk ka bërë kurrfarë kërkesë tek e paditura që t'i lejohet pushimi pa pagesë. Duke pasur parasysh këtë, rrjedh se vendimi kontestues me të cilin vendim e paditura e ka dërguar paditësin në pushim pa pagesë, është marrë në kundërshtim me dispozitën ligjore, andaj si të tillë, Gjykata e anuloi si të paligjshëm”.

20. Më 16 tetor 2008, Gjykata e Qarkut në Pejë, me Aktvendimin Ac. nr. 125/08, e prishi Aktgjykimin C. nr. 422/06, të Gjykatës Komunale në Pejë, dhe e ktheu rastin për rigjykim.
21. Më 19 qershor 2010, Gjykata Komunale në Pejë, me Aktgjykimin C. nr. 771/08, obligoi punëdhënësin që t'i paguajë parashtruesit, në emër të kompensimit të të ardhurave personale, shumën prej

15.340.80 euro, për periudhën prej 1 tetorit 2003 deri më 30 shtator 2007, duke përfshirë kamatën vjetore.

22. Më 19 korrik 2011, Gjykata e Qarkut në Pejë, me Aktgjykimin Ac. nr. 346/2010, ndryshoi Aktgjykimin C. nr. 771/08, të Gjykatës Komunale në Pejë, dhe e refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit si të pabazuar.
23. Në Aktgjykimin e lartpërmendur, Ac. nr. 346/2010, Gjykata e Qarkut në Pejë, argumentoi më tej:

“... E paditura (punëdhënësi) asnjëherë nuk e ka shfrytëzuar Stacionin e Benzinës Peja-1, edhe pse ka pasur të drejtën ligjore e edhe pse ia ka kompensuar të ardhurat personale paditësit (parashtruesit) deri në periudhën kontestuese, sikurse punëtorëve të tjerë, të cilët kanë qenë të sistemuar në objektet të cilat i ka pasur në menaxhim e paditura. Lidhur me këto objekte, përkatësisht dorëzimin e tyre, në mes të paditurit dhe personave që gjenden në shfrytëzim të përkohshëm të tyre, udhëhiqet kontesti i posaçëm për dorëzimin e objekteve pranë Gjykatës Komunale në Pejë.

... Për këtë arsye është paraqitur tepriçë teknologjike e punëtorëve dhe shumë vende të punës janë mbyllur. E paditura, duke u mbështetur në dispozitën e nenit 12 të Ligjit themelor të punës në Kosovë, Rregullorja nr. 2001/27, si dhe duke u mbështetur në Vendimin nr. 05-312 të 27 marsit 2003, nuk ka bërë ripërtëritjen e kontratave të punës me shumë punëtorë, po ashtu edhe me paditësin, për arsye se nuk ka pasur vende se ku do t'i përcaktojë punëtorët pasi që shumica e këtyre objekteve janë në shfrytëzim nga persona të tjerë. Nga këto arsye, për të ekzistuar përgjegjësia për kompensimin e të ardhurave personale, duhet të jenë të plotësuara kushtet që kanë të bëjnë me veprimin kundërligjor të të paditurës, dëmin e shkaktuar në formë të fitimit të humbur dhe lidhjes shkakore në mes të veprimit dëmtues dhe dëmit të shkaktuar. Për faktin se paditësi nuk ka qenë i angazhuar në punë për periudhën kontestuese as që është përtërirë kontrata e punës me të për shkaqe objektive, kjo gjykatë vlerëson se nuk kemi të bëjmë me vendim kundërligjor të të paditurës, se nuk ekziston përgjegjësia objektive e së paditurës e as faji, prandaj meqë paditësi nuk ka punuar në atë kohë për shkaqe objektive dhe nuk ka kontribuar në krijimin e të ardhurave, nuk mund të pranohet kërkesëpadia e paditësit dhe e njëjta është e pabazuar.

Nga ana tjetër, meqenëse e paditura nuk është në shfrytëzim të pompave të benzinës ku ka punuar më parë paditësi, por në shfrytëzim të tyre janë persona të tjerë, kjo gjykatë konkludon se e paditura nuk është pjesëmarrëse e raportit detyrimor juridik të paraqitur në këtë çështje juridike, nuk është objekt në raportin materialo-juridik nga i cili paditësi e nxjerr të drejtën e tij pa marrë parasysh se paditësi ka poseduar vendimin formal për caktimin në punë dhe detyra të punës, si kryepunëtor në SB “Peja-1” duke filluar nga 17 dhjetori 1999...”.

24. Më 3 maj 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Rev. nr. 300/2011, e refuzoi revizionin e paraqitur kundër Aktgjykimit Ac. nr. 346/2010, të Gjykatës së Qarkut në Pejë, si të pabazuar.
25. Në Aktgjykimin e lartpërmendur, Rev. nr. 300/2011, Gjykata Supreme e Kosovës argumentoi më tej:

“... Nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së dytë, në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, drejt dhe në mënyrë të plotë, i ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit (parashtruesit) është e pabazuar. Kjo nga fakti se e paditura (punëdhënësi) në kohën kontestuese nuk ishte në shfrytëzim të pompave të karburanteve, por edhe të asaj nr. 1. në Pejë, ku kishte punuar paditësi. Për këtë arsye është paraqitur tepriçë teknologjike e punëtorëve kur shumë vende të punës janë shuar. E paditura në pajtim me dispozitën e nenit 12 të Ligjit themelor të punës në Kosovë, Rregullorja nr. 2001/27, dhe duke u mbështetur në Vendimin nr. 05-312 të 27 marsit 2003, nuk ka bërë ripërtëritjen e kontratave të punës me shumë punëtorë të tjerë, po ashtu edhe me paditësin. Në kontekst të këtyre rrethanave, kjo gjykatë vlerëson se këtu nuk ka ekzistuar detyrimi i së paditurës për kompensimin e të ardhurave personale, meqë nuk janë plotësuar kushtet që kanë të bëjnë me vendim të kundërligjshëm të së paditurës, madje nuk ekziston lidhja shkakore midis këtij vendimi së paditurës dhe dëmit të shkaktuar në formë të fitimit të humbur, prandaj nuk ka ekzistuar përgjegjësia objektive e së paditurës siç drejt konkludon gjykata e shkallës së dytë, e të cilin e pranon edhe kjo gjykatë.

Thëniet në revizionin e paditësit se ai nuk e ka pranuar asnjë vendim apo njoftim më 27 mars 2003, i cili, sipas pretendimeve të paditësit, nuk ekzistonte dhe se këtë e ka bërë e

paditura për të manipuluar, kjo gjykatë i vlerëson si të pabazuara për faktin se këto pretendime, duke i përfshirë edhe të tjerat, i referohen gjendjes faktike, prandaj kjo gjykatë në kuptim të nenit 214 të LPK-së,, të njëjtat nuk i vlerësoi meqë revizioni për këtë bazë nuk mund të paraqitet”.

Pretendimet e parashtruesit

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *“gjykatat e rregullta e kanë shkelur parimin e ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, sepse arsyetimet e dhëna kanë dështuar të përmbajnë faktet e vërtetuara në dosje të lëndës dhe kanë dështuar të aplikojnë dispozitat ligjore si dhe marrëdhënien logjike ndërmjet tyre”.*
27. Parashtruesi pretendon se *“Gjykata Kushtetuese, në rastin KI-120/10, të parashtrueses Zyma Berisha, për arsye dhe shkaqe të njëjta, e kishte vlerësuar kërkesën si të pranueshme, andaj parashtruesi mendon se edhe kjo kërkesë do të duhej vlerësuar si e pranueshme”.*
28. Parashtruesi pretendon se *“e paditura (punëdhënësi) asnjëherë nuk ia ka dorëzuar zyrtarisht vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës”.*
29. Për më tepër, parashtruesi pretendon se *“arsyetimet e gjykatave të rregullta se e paditura nuk ka pasur obligim ligjor për kompensimin e të ardhurave personale, nga që objekti ku ishte caktuar të punojë paditësi ishte i uzurpuar dhe si rrjedhojë nuk ekziston faji, sipas parashtruesit, ky vlerësim nuk mund të qëndrojë për shkak të faktit se e paditura (punëdhënësi) me Vendimin nr. 05-114, të 14 tetorit 1999, e kishte larguar paditësin nga vendi i tij i punës, ku veç kishte punuar, provë kjo e cila në mënyrë të drejtpërdrejtë e bën përgjegjëse dhe fajtores të paditurën. Edhe kjo provë nuk ishte shtjelluar dhe vlerësuar fare nga gjykatat”.*
30. Parashtruesi pretendon shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit], dhe neni 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës si dhe nenin 6 [E Drejta për Proces të Rregullt] të Konventës.
31. Përfundimisht, parashtruesi kërkon nga Gjykata ta shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr.

300/2011, të 3 majit 2013, dhe Aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 346/2010, të 19 korrikut 2011.

Pranueshmëria e kërkesës

32. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregullore të punës.

33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

34. Për më tepër, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, që parasheh:

“(1) “Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

...

(c) kërkesa është qartazi e bazuar”.

35. Në rastin konkret, Gjykata vëren se janë plotësuar garancitë procedurale të së drejtës për një gjykim të drejtë, siç është përcaktuar me Kushtetutë dhe Konventë; nuk ka asnjë gjurmë të arbitraritetit nga ana e gjykatave të rregullta. Kërkesa e parashtruesit, përgjithësisht ngre pyetje të së drejtës materiale, dhe në këtë drejtim, Gjykata konsideron që çështjet e fakteve dhe të ligjit të jenë brenda domenit të gjykatave të rregullta. Gjykata nuk mund të zëvendësojë gjetjet e veta me ato të gjykatave të rregullta për shkak se ajo nuk është as gjykatë e apelit dhe as gjykatë e shkallës së katërt.

36. Në lidhje me pretendimin e parashtruesit se rasti i tij duhet të konsiderohet i pranueshëm, sepse ai ngre të njëjtat argumente që janë ngritur në rastin KI120/10, parashtruesja Zyma Berisha, Gjykata vëren se ky rast është i ndryshëm dhe i pangjashëm me rastin KI120/10, në disa aspekte, por një aspekt kyç është se në rastin KI120/10 Gjykata konstatoi se, Gjykata Supreme ka vepruar në një "mënyrë të dukshme arbitrare", për shkak se ajo kishte

vendosur në dëm të parashtruesit të kërkesës (Zyma Berisha), në krahasim me aktvendimet e favorshme për kolegët e parashtruesit, në të njëjtat rrethana dhe fakte. Në këtë mënyrë kjo paraqiste, "një mospërputhje të thellë" në marrjen e vendimeve të Gjykatës Supreme, në rastin konkret. Gjykata konsideron se rasti në fjalë është i ndryshëm dhe i pangjashëm me rastin KI120/10, sepse ai nuk i mbështet argumentet e tilla ose të ngjashme.

37. Në rastin e lartcekur KI120/10, parashtruese Zyma Berisha, Gjykata arsyetoi: *"...pikëpamja e Gjykatës Supreme, përkundër parashtrësve të parashtrueses, si objekt të çështjes në rastin e saj ka konsideruar vazhdimin e kontratës me kohë të caktuar dhe aspak nuk ka marrë parasysh argumentet dhe provat e parashtrueses sa i përket pretendimeve të saj se ka të drejtë për status të përhershëm të punësimit dhe për kthim në vendin e saj të punës"*.
38. Për më tepër, në rastin KI120/10, parashtruese Zyma Berisha, Gjykata arsyetoi: *"se aktgjykimi i Gjykatës Supreme, duke neglizhuar vlerësimin e duhur të argumenteve të parashtrueses përkritazi me statusin e përhershëm të punësimit, edhe pse ato ishin specifike, relevante dhe të rëndësishme, nuk i plotësoi detyrimet e Gjykatës Supreme sipas nenit 6.1 të KEDNJ-së për të plotësuar detyrimet e cekjes se arsyeve"*.
39. Sa i përket arsyetimit të gjykatave të rregullta, Gjykata konsideron se në këtë rast gjykatat e rregullta e kishin përmbushur obligimin për t'i arsyetuar vendimet e tyre; në të vërtetë Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta kanë dhënë arsyetim të mjaftueshëm, logjik dhe të qartë, i cili shpjegon marrëdhëniet në mes parashtruesit si punonjës dhe punëdhënësit të tij si dhe marrëdhëniet e këtij të fundit me palët e treta, të cilat kanë uzurpuar objektet e tij.
40. Gjykata Kushtetuese vëren se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve, dhe me këtë rast, Gjykata dëshiron të theksojë se konstatimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta dhe se roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore, prandaj edhe nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (Shih rastin Akdivar kundër Turqisë, nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykim i 16 shtatorit 1996, para. 65, gjithashtu *mutatis mutandis* shih rastin KI86/11, parashtruesi i kërkesës Milaim Berisha, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

41. Për më tepër, kërkesa nuk tregon se gjykatat e rregullta kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të zëvendësojë vlerësimin e saj të fakteve me atë të gjykatave të rregullta, dhe si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave të vlerësojnë dëshmitë para vetes. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është që të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë marrë ato dëshmi (Shih rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, i 10 korrikut 1991).
42. Fakti se parashtruesi nuk pajtohet me rezultatin e rastit, nuk mundet vetvetiu të paraqesë pretendim të argumentueshëm për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe të nenit 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit], të Kushtetutës (Shih rastin Mezotur Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Appl. nr. 5503/02, Aktgjykim i GJEDNJ-së, i 26 korrikut 2005).
43. Në këto rrethana, parashtruesi nuk e ka mbështetur pretendimin e tij për shkelje të nenit 31 [E Drejta Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe të nenit 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës, sepse faktet e paraqitura nga ai në asnjë mënyrë nuk tregojnë se gjykatat e rregullta ia kanë mohuar atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë.
44. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të hidhet poshtë si e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullit 56 (2) të Rregullores, më 3 dhjetor 2013, njëzëri:

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe
- IV. TË SHPALLË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI161/13, KI162/13, KI164/13, KI165/13, KI166/13, KI167/13, KI168/13, KI169/13, KI170/13, KI171/13, KI172/13, KI173/13, KI174/13, KI175/13, KI176/13, KI177/13, KI178/13 dhe KI179/13, Ramiz Isufi dhe 17 individë të tjerë, Aktvendim i datës 7 shkurt 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së 18 aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, të 14 qershorit 2013

Raste të bashkuara, vendimi i 7 shkurtit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, qartazi i pabazuar, mbrojtja e pronës, kompensimi.

Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së tetëmbëdhjetë aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, të 14 qershorit 2013, në të cilat raste Gjykata Supreme vendosi të aprovojë pjesërisht revizionin e ushtruar nga Komuna e Glogocit, dhe t'i ndryshojë aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, dhe aktgjykimet e Gjykatës Komunale në Glogoc, me të cilat shumat e kompensimit për objektet e rrënuara afariste ishin zvogëluar dhe padite për kompensim të dëmit jomaterial, të parashtruara nga parashtruesit, ishin refuzuar si të pabazuara.

Në kërkesat e tyre, parashtruesit pretendojnë se Gjykata Supreme nuk ka përcaktuar një kompensim adekuat dhe proporcional për rrënimin e objekteve dhe për këtë arsye është shkelur e drejta për mbrojtjen e pronës. Për më tepër, ata gjithashtu pretendojnë shkeljen e neneve 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese konsideroi se Gjykata Supreme gjerësisht arsyetoi pse e kishte ndryshuar aktgjykimin e gjykatave më të ulëta, me të cilin e zvogëloi shumën e kompensimit për dëmin e shkaktuar dhe refuzoi padinë për kompensim jomaterial. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese deklaroi kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar, sepse faktet e paraqitura nga parashtruesit në asnjë mënyrë nuk i arsyetojnë pretendimet për shkelje të të drejtave kushtetuese dhe parashtruesit nuk i kanë dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tyre.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastet Nr.
KI161/13, KI162/13, KI164/13, KI16S/13, KI166/13, KI167/13,
KI168/13,
KI169/13, KI170/13, KI171/13, KI172/13, KI173/13, KI174/13,
KI17S/13,
KI176/13, KI177/13, KI178/13 dhe KI179/13
Parashtrues
Ramiz Isufi dhe 17 individë të tjerë
Vlerësimi i kushtetutshmërisë
së 18 aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, të 14 qershorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përberë nga:

Enver Hasani, kryetar
 Ivan Cukalovic, zëvendëskryetar
 Robert Carolan, gjyqtar
 Altay Suroy, gjyqtar
 Almiro Rodrigues, gjyqtar
 Snezhana Botusharova, gjyqtare
 Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
 Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtrues të kërkesës

1. Kërkesat në vijim janë dorëzuar nga këta parashtrues:

- | | |
|-------------------------------|--------------------------------|
| 1. Ramiz Isufi (Kh61/13) | 10. Qama Ramaj (KI171/13) |
| 2. Zenullah Pirraku (Kh62/13) | 11. Murtez Xhehaj (KI172/13) |
| 3. Fehmi Gecaj (Kh64/13) | 12. Ferat Gjoka (KI173/13) |
| 4. Qazim Zogaj (Kh65/13) | 13. Ilir Haziri (KI174/13) |
| 5. Lulzim Qorolli (Kh66/13) | 14. Mehdi Gjoka (KI175/13) |
| 6. Sami Qorri (Kh67/13) | 15. Azemine Hasi (KI176/13) |
| 7. Rusha Uljeviq (Kh68/13) | 16. Imer Zeneli (KI177/13) |
| 8. Fevzije Seferaj (Kh69/13) | 17. Mevlude Zymberi (KI178/13) |
| 9. Qamil Dragaj (KI170/13) | 18. Asllan Seferaj (KI179/13) |

(në tekstin e mëtejme: parashtruesit) me vendbanim në Glllogoc.

2. Ramiz Isufi përfaqësohet nga z. Zenullah Pirraku (KI162/13), gjithashtu parashtrues në Gjykatë.

3. Të 16 parashtruesit e tjerë përfaqësohen nga z. Feriz Gërvalla, avokat nga Prishtina.

Vendimet e kontestuarra

4. Parashtruesit i kontestojnë aktgjykimet vijuese të Gjykatës Supreme, të 14 qershorit 2013:
 - (1) Ramiz Isufi (KI161/13), Rev. 99/2013, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 27 shtator 2013.
 - (2) Zenullah Pirraku (KI162/13), Rev. 109/2013, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 27 shtator 2013.
 - (3) Fehmi Gecaj (KI164/13), Rev. 96/2013, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 30 shtator 2013.
 - (4) Qazim Zogaj (KI165/13), Rev. 100/2013, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 30 shtator 2013.
 - (5) Lulzim Qorolli (KI166/13), Rev. 110/2013, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 30 shtator 2013•
 - (6) Sami Qorri (KI167/13), Rev. 98/2013, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 30 shtator 2013•
 - (7) Rusha Uljeviq (KI168/13), Rev. 106/2013, i cili i është dorëzuar parashtrueses më 30 shtator 2013.
 - (8) Fevzije Seferaj (KI169/13), Rev. 103/2013, i cili i është dorëzuar parashtrueses më 30 shtator 2013•
 - (9) Qamil Dragaj (KII70/13), Rev. 111/2013, i cili është dorëzuar parashtruesit më 30 shtator 2013.
 - (10) Qama Ramaj (KII71/13), Rev. 97/2013, i cili i është dorëzuar parashtrueses më 30 shtator 2013.
 - (11) Murtez Xhehaj (KII72/13), Rev. 104/2013, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 30 shtator 2013.
 - (12) Ferat Gjoka (KII73/13), Rev. 113/2013, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 30 shtator 2013.

- (13) Ilir Haziri (KII74/13), Rev. 108/2013, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 30 shtator 2013.
- (14) Mehdi Gjoka (KI175/13), Rev. 105/2013, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 30 shtator 2013.
- (15) Azemine Hasi (KII76/13), Rev. 101/2013, i cili i është dorëzuar parashtrueses më 30 shtator 2013.
- (16) Imer Zeneli (KI177/13), Rev. 107/2013, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 30 shtator 2013.
- (17) Mevlude Zymberi (KII78/13), Rev. 102/2013, i cili i është dorëzuar parashtrueses më 30 shtator 2013.
- (18) Asllan Seferaj (KII79/13), Rev. 112/2013, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 30 shtator 2013.

Objekti i çështjes

- 5. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë se tetëmbëdhjetë aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, të 14 qershorit 2013, në të cilat raste Gjykata Supreme vendosi të aprovojë pjesërisht revizionin e ushtruar nga Komuna e Glllogocit, dhe t'i ndryshojë aktgjykimet e Gjykatës se Qarkut në Prishtinë, dhe aktgjykimet e Gjykatës Komunale në Glllogoc, me të cilat shumat e kompensimit për objektet e rrënuara afariste ishin zvogëluar dhe paditë për kompensim të dëmit jomaterial, të parashtruara nga parashtruesit, ishin refuzuar si të pabazuara.

Baza juridike

- 6. Kërkesat bazohen në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullat 37 dhe 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

- 7. Më 17 tetor 2013, parashtruesit Ramiz Isufi (K1161/13) dhe Zenullah Pirraku (K1162/13) i dorëzuan kërkesat e tyre në Gjykatë.
- 8. Më 22 tetor 2013, parashtruesit Fehmi Gecaj (K1164/13), Qazim Zogaj (K116S/13), Lulzim Qorolli (K1166/13), Sami Qorri

(KI167/13), Rusha Uljeviq (KI168/13), Fevzije Seferaj (KI169/13), Qamil Dragaj (KI170/13), Qama Ramaj (KI171/13), Murtez Xhehaj (KI172/13), Ferat Gjoka (KI173/13), Ilir Haziri (KI174/13), Mehdi Gjoka (KI17S/13), Azemine Hasi (KI176/13), Imer Zeneli (KI177/13), Mevlude Zymberi (KI178/13) dhe Asllan Seferaj (KI179/13) i dorëzuan kërkesat e tyre në Gjykatë.

9. Më 8 nëntor 2013, Kryetari, me Vendimin GJR. KI161/13, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Te njëjtën ditë, me Vendimin KSH. KI161/13 të Kryetarit, u caktua Kolegji shqyrtues, i përberë nga gjyqtaret: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
10. Më 11 nëntor 2013, në pajtim me rregullin 37.1 të Rregullores së punës, Kryetari urdhëroi bashkimin e kërkesës KI161/13 me kërkesat: KI162/13, KI164/13, KI16S/13, KI166/13, KI167/13, KI168/13, KI169/13, KI170/13, KI171/13, KI172/13, KI173/13, KI174/13, KI17S/13, KI176/13, KI177/13, KI178/13 dhe KI179/13. Me këtë urdhër, ishte vendosur që Gjyqtari raportues dhe përbërja e Kolegjit shqyrtues të jenë të njëjtë, siç; është vendosur nga Kryetari me vendimin për caktimin e Gjyqtarit raportues dhe Kolegjit shqyrtues, të 8 nëntorit 2013.
11. Më 13 nëntor 2013, Gjykata i njoftoi parashtruesit dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesave dhe bashkimin e tyre.
12. Më 7 shkurt 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Bazuar në shkresat e lëndës, prej vitit 1992 deri me 1996, Komuna e Glogocit ua kishte ndarë 60 ngastra individëve të ndryshëm për ndërtimin e lokaleve afariste me karakter të përhershëm dhe të përkohshëm.
14. Në shtator të vitit 1999, Komuna e Glogocit, në kontekst të planifikimit hapësinor, vendosi t'i lirojë ngastrat dhe e urdhëroi rrënimin e lokaleve afariste.
15. Procedurat administrative në lidhje me këto vendime zgjaten deri me 2005.

16. Më 21 mars 2005, Gjykata Supreme vendosi t'i anuloi vendimet administrative dhe t'i kthejë rastet në procedure administrative, në mënyrë që të merren vendime të tjera.
17. Pavarësisht nga ankesa administrative në pritje dhe para nxjerrjes së vendimit nga Gjykata Supreme, të 21 marsit 2005, në fillim të marsit 2005, Komuna e Glllogocit i kishte rrënuar të gjitha lokalet afariste ekzistuese dhe i kishte liruar parcelat.
18. Menjëherë pas rrënimit të lokaleve afariste, u paraqiten shumë padi për kompensim në Gjykatën Komunale në Glllogoc, kundër Komunes se Glllogocit.
19. Më 8 dhjetor 2009 dhe 25 qershor 2010, sipas kërkesës se 18 paditësve, gjyqtarët e EULEX-it vendosen që t'i marrin përsipër rastet.
20. Në padite e tyre, paditësit kërkonin kompensim për rrënimin e hapësirës afariste, kompensim për shkatërrimin e pjesshëm të hapësirës afariste, kompensim për fitimin e humbur, kompensim për dëmin jomaterial, për caktimin e një parcele tjetër për lokal afarist dhe kamatën për kompensimin monetar.
21. Ndërmjet 27 shtatorit 2011 dhe 21 tetorit 2011, Gjykata Komunale në Glllogoc i aprovoi pjesërisht padite. Gjykata vendosi të aprovoje vetëm kompensimin për rrënim të lokaleve me kamatën e caktuar, duke filluar nga data kur është paraqitur padia, ndërsa ajo vendosi më tej që të aprovoje kompensimin për dëm jomaterial dhe të refuzojë paditë për kompensim të fitimit të humbur dhe për caktimin e një ngastre tjetër për lokal afarist.
22. Kundër aktgjykimeve të Gjykatës Komunale në Glllogoc, Komuna e Glllogocit ushtroi ankesa në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.
23. Ndërmjet 23 tetorit 2012 dhe 23 nëntorit 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë nxori aktgjykimet, me të cilat i refuzoi ankesat dhe i vërtetoi aktgjykimet e Gjykatës Komunale në Glllogoc.
24. Kundër aktgjykimeve të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Komuna e Glllogocit ushtroi revizione në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe të zbatimit të gabuar të ligjit material.
25. Më 14 qershor 2013, Gjykata Supreme nxori 18 aktgjykime dhe vendosi ta aprovojë revizionin e ushtruar nga Komuna e Glllogocit,

dhe t'i ndryshojë aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë dhe aktgjykimet e Gjykatës Komunale në Glllogoc, me të cilat shumat e kompensimit për objektet e rrënuara afariste ishin zvogëluar dhe paditë për kompensim të dëmit jomaterial ishin refuzuar si të pabazuara.

26. Në tetëmbëdhjetë aktgjykimet, Gjykata Supreme gjeti si në vijim:

"Sa i përket dëmeve të shkaktuara nga shkatërrimi i ndërtesës, gjykata e shkallës së dytë ka vlerësim të drejtë se dëmet e shkaktuara janë vetëm në formë të dëmit të zakonshëm-pakësimit të pronës së paditësit. Megjithatë, nuk është zbatuar drejt ligji në këtë aspekt. Dëmi në këtë rast nuk është vlera e ndërtesës kur është ngritur në vitin 1997 (vlera e barabarte me materialin dhe fuqinë punëtore për ndërtimin e saj), nuk është vlera e kohës së shkatërrimit me 2005 minus zhvlerësimi i ndërtesës për 8 vjet përdorimi, por është vetëm vlera e materialit të cilin paditësja do të mundte ta merrte nëse konstruksioni/ndërtesa nuk do të shkatërrohej por do të dekonstruktohej (de-konstruktimi është çmontimi selektiv i pjesëve të ndërtesës për ri-shfrytëzim). Konstruksioni/ndërtesa ishte e karakterit të përkohshëm, s'kishte mundësi të shitej, as në vlerën e tregut në kohën e shkatërrimit e as në vlerën e konstruksionit (koha e ndërtimit ose koha e shkatërrimit minus zhvlerësimi). Prandaj dëmi është vetëm vlera e materialit të përdorshëm që do të mund të nxirrej, në rast të dekonstruktimit të duhur".

27. Në këtë drejtim, Gjykata Supreme vendosi t'i ndryshojë aktgjykimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta dhe ta zvogëlojë shumën e kompensimit, të përcaktuar nga gjykatat e lartpërmendura.
28. Në lidhje me kompensimin për inventarin e humbur, Gjykata Supreme erdhi në përfundim se aktgjykimet ishin të drejta dhe kërkesa për revizion duhet të refuzohet.
29. Sa i përket dëmit jomaterial, Gjykata Supreme gjeti se [...] "revizioni është i bazuar pasi që nuk është vuajtur asnjë dëm i shpërblyeshëm jo-material. Nuk ekzistojnë të dhëna se paditësi ka vuajtur dhimbje fizike apo psikologjike të cilat duhet të kompensohen. Paditësi dhe Komuna kanë kundërshtuar të drejtën e paditëses që ta ketë këtë ndërtesë në tokën e komunës për shumë vite deri në kohën e shkatërrimit të saj. Është e arsyeshme që paditësi ka përjetuar zhgënjim dhe zemërim kur është shkatërruar ndërtesa, por nuk duhet të kompensohen në të holla të gjitha llojet

e dhimbjes psikologjike, në përputhje me nenin 200 të LMD-se. Dhimbjet psikologjike nuk mund të kompensohen në të holla nëse nuk dëshmohet se ato ishin aq intensive dhe të gjata saqë kishin prekur gjendjen mendore të paditëses. Përkitazi me këtë nuk ekziston asnjë provë. Prandaj edhe në këtë pjesë vendimi duhet të ndryshohet dhe padia për kompensim moral të refuzohet (neni 224 (1) i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore)".

Pretendimet e parashtruesve

30. Në kërkesat e tyre të ndara, parashtruesit Ramiz Isufi (KI161/13) dhe Zenuliah Pirraku (Kh62/13) pretendojnë si në vijim: [...] "*Neni 46.3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës pasi është cenuar mbrojtja e pronës dhe kompensimi. Është shkel neni 24.1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës pasi është cenuar Barazia para Ligjit dhe është shkel neni 23 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës pasi është cenuar Dinjiteti i Njeriut. Është mohuar e drejta e pronësisë edhe dhe pse ishte ndarë në baza ligjore, ishte ndërtuar në bazë të Vendimeve Valide [...]*".
31. Të njëjtit parashtrues, më tej, kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese: [...] "*Kërkojmë që të aprovohet Kërkesa pranë Gjykatës Kushtetues të Kosovës, të anulohet Aktgjykimi [...] i dt. 14. qershor 2013. Kërkojmë Sugjerimin nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës për kompensimin e dëmit material, psiqik dhe moral*".
32. Në kërkesat e tyre, 16 parashtruesit e tjerë pretendojnë që: [...] "*Prandaj, paditësit duke mos iu pranuar kompensimi adekuat dhe proporcional për rrënimin padrejtësisht të lokalit të tij afarist, i është cenuar e drejta e mbrojtjes së pronës në kuptim të nenit 46 par. 1 e 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe dispozitave të Konventës Evropiane për te drejtat e njeriut, mbi bazë të gjykimit të padrejtë sipas nenit 31 të Kushtetutës së Kosovës. Se kemi të bëjmë me gjykim të padrejtë flet qarte edhe konfuziteti i aktgjykimit. Ai aktgjykim është kundërthënës dhe përmban arsye kontradiktore për faktet vendimtare. Përderisa me dispozitivin e tij ndryshohen aktgjykimet e gjykatave më të ulëta dhe gjykohet shumë minimale e kompensimit të dëmit për lokalin e shkatërruar, refuzohet kërkesa për kompensimin e dëmit jomaterial, me paragrafin 2 të dispozitivit vendoset: se pjesa e mbetur e kërkesës refuzohet e pabazuar dhe secila palë i bartë shpenzimet e veta [...]*".
33. Këta parashtrues pretendojnë shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejte dhe të Paanshëm], nenit 46, para. 1 dhe 2

[Mbrojtja e Pronës] dhe te nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës dhe nenit 1 te Protokollit Nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut.

Pranueshmëria e kërkesës

34. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykoje kërkesën e parashtruesve, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesit i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.

35. Gjykata i referohet nenit 113, paragrafi 7 te Kushtetutës, i cili parasheh:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

36. Përveç; kësaj, neni 49 i Ligjit përcakton se *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ece që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor"*.

37. Në rastet e tanishme, Gjykata konsideron se parashtruesit janë pale të autorizuar, se i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipasligjit të zbatueshëm dhe se kërkesat janë dorëzuar brenda afatit kohor prej katër muajsh.

38. Sidoqoftë, Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (2) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...],ose

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një te drejte kushtetuese, ose

[...],ose

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

39. Në kërkesat e tyre, parashtruesit pretendojnë se Gjykata Supreme nuk ka përcaktuar një kompensim adekuat dhe proporcional për rrënimin e objekteve dhe për këtë arsye është shkelur e drejta për mbrojtjen e pronës. Për më tepër, ata gjithashtu pretendojnë shkeljen e neneve 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejte dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
40. Megjithatë, parashtruesit nuk shpjegojnë si dhe pse aktgjykimet e Gjykatës Supreme i kanë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë.
41. Lidhur me këtë, Gjykata Kushtetuese përsërit që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykate e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21janarit, para. 28, shih, gjithashtu rastin Nr. KI70/11, parashtruesit Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
42. Gjykata Kushtetuese mundet vetëm të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në atë mënyrë dhe procedurat në përgjithësi, shikuar në tërësinë e tyre, ishin kryer në atë mënyrë që parashtruesit e kërkesave të kenë pasur një gjykim të drejtë (shih, ndër të tjera, Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).
43. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në aktgjykimet e fundit, të nxjerra nga Gjykata Supreme, është i qartë dhe i arsyetuar dhe pas shqyrtimit të procedurave në tërësi, Gjykata gjithashtu gjeti se procedurat në Gjykatën Supreme nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (Shih, mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).
44. Në këtë drejtim, Gjykata Supreme gjerësisht arsyetoi pse e kishte ndryshuar aktgjykimin e gjykatave më të ulëta, me të cilin e zvogëloi shumën e kompensimit për dëmin e shkaktuar dhe refuzoi padinë për kompensim jomaterial.
45. Sa i përket dëmit material, Gjykata Supreme konsideron që gjykatat e shkallëve më të ulëta kishin zbatuar gabimisht të drejtën materiale, kur e përcaktuan shumën e kompensimit, duke i arsyetuar si në vijim: [...] "*Dëmi në këtë rast nuk është vlera e*

ndërtesës kur është ngritur në vitin 1997 (vlera e barabartë me materialin dhe fuqinë punëtore për ndërtimin e saj), nuk është vlera e kohës së shkatërrimit me 2005 minus zhvlerësimi i ndërtesës për 8 vjet përdorimi, por është vetëm vlera e materialit të cilin paditësja do të mundte ta merrte nëse konstruksioni/ndërtesa nuk do të shkatërrohej por do të dekonstruktohej (dekonstruktimi është çmontimi selektiv i pjesëve të ndërtesës për ri-shfrytëzim). Konstruksioni/ndërtesa ishte e karakterit të përkohshëm, s'kishte mundesi të shitej, as në vlerën e tregut në kohën e shkatërrimit e as në vlerën e konstruksionit (koha e ndërtimit ose koha e shkatërrimit minus zhvlerësimi). Prandaj, dëmi është vetëm vlera e materialit të përdorshëm që do të mund të nxirrej, në rast të de-konstruktimit të duhur". Ndërsa, sa i përket dëmit jomaterial, Gjykata Supreme vendosi se nuk kishte dëshmi se parashtruesit kishin pësuar dëm moral.

46. Për të gjitha arsyet e lartcekura, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesit në asnjë mënyre nuk i arsyetojnë pretendimet për shkelje të të drejtave kushtetuese dhe parashtruesit nuk i kane dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tyre.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me rregullin 36 (2) b) dhe d) të Rregullores së punës, më 7 shkurt 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesës si të papranueshme;

- II. T'UA KUMTOJË këtë vendimin palëve;
- III. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;
- IV. TE DEKLAROJË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Arta Rama-Hajrizi

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI147/13, Ilir Bunjaku, Aktvendim i datës 5 dhjetor 2013 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Udhëzimit Administrativ Nr. 20/2012 të Ministrit të Arsimit, të Shkencës dhe Teknologjisë për krahasueshmërinë dhe barasvlerën e diplomave dhe programeve studimore para sistemit të Bolonjës dhe sistemit të Bolonjës

Rasti KI147/13, vendimi i 5 dhjetorit 2013.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, palë e paautorizuar

Objekti çështje sështë vlerësimi i kushtetutshmërisë i Udhëzimit Administrativ Nr.20/2012 të MASHT-it,i cili sipas parashtruesit të kërkesës,i vë në pozitë të barabartë një grup inxhinierësh të diplomuar në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (në tekstin e mëtejme FIEK),që para diplomimit i kanë kryer ligjëratat në studimet pesëvjeçare me ata që i kanë kryer studimet katërvjeçare dhe titullin akademik që ata marrin pas diplomimit.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Udhëzimin Administrativ ata janë vënë në pozitë të pabarabartë me studentët e tjerë që kanë kryer sistemin 5-vjeçar të studimeve, sepse atyre tani nuk u njihen 300 ECTS si të tjerëve që kanë diplomuar në atë sistem para Bolonjës.

Parashtruesi i kërkesës nuk ka potencuar shkeljen e ndonjë të drejte te garantuar me Kushtetutë, por ka kërkuar vlerësimin e ligjshmërisë së këtij Udhëzimi Administrativ.

Gjykata konkludonse individët nuk janë palë e autorizuar në kuptim të nenit 113 të Kushtetutës për të ngritur në Gjykatën Kushtetueseçështjen e përputhshmërisë së rregulloreve të Qeverisë me Kushtetutën, por këtë mund ta bëjnë vetëm subjektet e parapara me nenin 113.2 të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 36 par. 3 pika C të Rregullores së punës, më 5 dhjetor 2013, njëzëri deklaroi kërkesën të papranueshme.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në**

Rastin Nr. KI147/13

Parashtruesi

Ilir Bunjaku

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Udhëzimit
Administrativ Nr. 20/2012 të Ministrisë së Arsimit, të
Shkencës dhe Teknologjisë për krahasueshmërinë dhe
barasvlerën e diplomave dhe programeve studimore para
sistemit të Bolonjës dhe sistemit të Bolonjës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar

Ivan Čukalović,

zëvendëskryetar

Robert Carolan,

gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe

Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Ilir Bunjaku (në tekstin e mëtejme: parashtruesi), nga fshati Samadrexhë, komuna e Vushtrrisë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Udhëzimi Administrativ Nr. 20/2012 i Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe Teknologjisë (në tekstin e mëtejme UA MASHT) për krahasueshmërinë dhe barasvlerën e diplomave dhe programeve studimore para sistemit të Bolonjës dhe sistemit të Bolonjës, i nënshkruar nga ministri më 22 tetor 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Udhëzimit Administrativ Nr. 20/2012 të MASHT-it, i cili sipas parashtruesit të kërkesës, i vë në pozitë të barabartë një grup inxhinierësh të diplomuar në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike

(në tekstin e mëtejme FIEK), që para diplomimit i kanë kryer ligjëratat në studimet pesëvjeçare me ata që i kanë kryer studimet katërvjeçare dhe titullin akademik që ata marrin pas diplomimit.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës (në tekstin e mëtejme Kushtetuta), neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 13 shtator 2013, parashtruesi i kërkesës e parashtroi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 24 shtator 2013, me Vendimin GJR. KI147/13, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues) dhe Snezhana Botusharova e Kadri Kryeziu.
7. Më 7 tetor 2013, Gjykata Kushtetuese kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës dhe MASHT-in për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 5 dhjetor 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës

Përmbledhja e fakteve

9. Më 22 tetor 2010, MASHT-i kishte nxjerrë Udhëzimin Administrativ Nr. 20/12 – për krahasueshmërinë dhe barasvlerën e diplomave dhe programeve studimore para sistemit të Bolonjës. Udhëzimi Administrativ ishte nënshkruar nga ministri i MASHT-it.
10. Në nenin 4.1 të kësaj UA-je, parashihet që *“diplomat e studimeve universitare 4 (katër) vjeçare të sistemit të para Bolonjës barasvlerësohen me 240 ECTS”*. Në paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se *“Për të fituar gradën master, këta të diplomuar duhet të akumulojnë së paku edhe 60 ECTS në ndonjë nga këto programe”*.
11. Në nenin 5 të kësaj UA-je është përcaktuar se, *“Diplomat e studimeve universitare 5 (pesë) vjeçare që kanë mbarur me*

mbrojtje publike të temës së diplomës në fushat teknike të sistemit të para Bolonjës barasvlerësohen me 300 ECTS”.

12. Sipas parashtruesit të kërkesës, ai dhe një grup studentësh të FIEK-ut i kanë mbaruar të gjitha ligjëratat në sistemin pesëvjeçar të studimeve dhe i kanë dhënë gati të gjitha provimet, por pa u diplomuar dhe se në ndërkohë ka ndryshuar programi i studimeve në këtë fakultet, ku provimet e vitit të pestë janë bartur në vitin e katërt të studimeve.

Pretendimet e parashtruesit për shkeljet kushtetuese

13. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Udhëzimin Administrativ ata janë vënë në pozitë të pabarabartë me studentët e tjerë që kanë kryer sistemin 5-vjeçar të studimeve, sepse atyre tani nuk u njihen 300 ECTS si të tjerëve që kanë diplomuar në atë sistem para Bolonjës.
14. Parashtruesi i kërkesës nuk ka potencuar shkeljen e ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë, por ka kërkuar vlerësimin e ligjshmërisë së këtij Udhëzimi Administrativ.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

15. Për të qenë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse pala i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara me Kushtetutë, me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe me Rregulloren e punës të Gjykatës.
16. Lidhur me këtë i referohet nenit 113 (1) të Kushtetutës, ku përcaktohet:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.

dhe nenit 113.7, ku përcaktohet:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

17. Duke iu referuar kërkesës së parashtruesit dhe shkeljeve të pretenduara, Gjykata konstaton se kërkesa është e dorëzuar nga një individ, se parashtruesi nuk ka dëshmuar se ka shterur ndonjë mjet

juridik para se kërkesën ta dërgojë në Gjykatën Kushtetuese, dhe akti juridik i cili kontestohet është bërë publik më 20 tetor 2012, që do të thotë 10 muaj e gjysmë para se kërkesa e parashtruesit të dorëzohej në Gjykatë.

18. Për sa i përket kriterit të pranueshmërisë së palës së autorizuar, Gjykata konstaton si në vijim:
19. Parashtruesi i kërkesës konteston UA të MASHT-it, Nr. 20/12, të nënshkruar nga ministri i MASHT-it më 22 tetor 2012.
20. Neni 92 [Parimet e Përgjithshme] i Kushtetutës ka paraparë se:

“1. Qeverinë e Kosovës e përbëjnë Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat”.

21. Duke marrë parasysh normën kushtetuese si më sipër dhe faktin se UA-ja që kontestohet, është nënshkruar nga një ministër i Qeverisë dhe i përket një dege të ekzekutivit, përkatësisht i MASHT-it, është e qartë se UA-ja është akt nënligjor i Qeverisë së Kosovës.
22. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i Kushtetutës kur përcakton palët e autorizuar për të ngritur çështje kushtetuese, në pikën dy ka saktësuar se:

“Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:

(1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën”.

23. Bazuar në, si më sipër Gjykata konkludon se individët nuk janë palë e autorizuar në kuptim të nenit 113 të Kushtetutës për të ngritur në Gjykatën Kushtetuese çështjen e përputhshmërisë së rregulloreve të Qeverisë me Kushtetutën, por këtë mund ta bëjnë vetëm subjektet e parapara me nenin 113.2 të Kushtetutës.
24. Në rrethana të ngjashme, Gjykata ka trajtuar çështjen e palës së autorizuar kur ka vendosur për rastin KI44/10 të parashtruesit Gafurr Podvorica, kur lidhur me kërkesën për “vlerësim të kushtetutshmërisë të vendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenës Sociale (MPMS) nr. 89 të 23 prillit 2010, për shpërbërjen e Institutit të Politikës Sociale në MPMS”, ka nxjerrë

Aktvendimin për papranueshmëri (shih Aktvendimin për rastin KI44/10, të 18 marsit 2011, dhe gjithashtu edhe Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut kur ka shqyrtuar aplikacionin nr. 45129/98, shih edhe Convention Municipal Section of Antilly v. France (dhjetor) nr. 45129/98, ECHR 1999-VIII).

25. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka specifikuar asnjë të drejtë të njeriut të garantuar me Kushtetutë, e cila eventalisht mund të jetë shkelur me aktin juridik që ai konteston, e nga përmbajtja e kërkesës as Gjykata nuk ka mundur të konstatojë se cilat të drejta do të mund të ishin objekt i çështjes së parashtruar për shqyrtim para saj.
26. Në këto rrethana, parashtruesi i ankesës nuk ka dëshmuar se ai është palë e autorizuar për të ngritur rastin në Gjykatë në formën dhe përmbajtjen se si e ka ndërtuar rastin, andaj

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 36 par. 3 pika c të Rregullores së punës, më 5 dhjetor 2013, njëzëri:

VENDOS

- I. TA SHPALLË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KOMUNIKOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në përputhje me nenin 20 (4) të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Arta Rama-Hajrizi

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasan

KI59/13, Ibrahim Rizvanolli, Aktvendim i datës 18 nëntor 2013-Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 105/2010, të 29 nëntorit 2012

Rasti KI59/13, vendimi i 18 nëntorit 2013.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, qartazi e pabazuar, mosshërim

Parashtruesi i Kërkesës e ka paraqitur kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, ku konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 105/2010, të 15 shkurtit 2013, i cili pretendohet të ketë shkelur nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

Në lidhje me çështjen e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata vlerësoi se kërkesa ishte e papranueshme, sepse parashtruesi i kërkesës nuk e ka ofruar prova se procedurat përkatëse kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta ose arbitrare. Nga kjo rrjedh se Gjykata vlerësoi se kërkesa është qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullat 36 (1) c) dhe 36 (2) d) të Rregullores së punës. Më tutje, Gjykata gjithashtu vlerësoi se në lidhje me shkeljen e pretenduar të parimit që rasti duhet të vendoset brenda një afati kohor të arsyeshëm, shpallet e papranueshme për mosshërim të mjeteve, sepse parashtruesi i kërkesës nuk e ka paraqitur ankesë para gjykatave të rregullta në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI59/13
Parashtrues
Ibrahim Rizvanolli
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme të Kosovës, Rev. nr. 105/2010, të 29 nëntorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan,
gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Ibrahim Rizvanolli, me vendbanim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin Rev. nr. 105/2010 të Gjykatës Supreme, të 15 shkurtit 2013, i cili i është dorëzuar atij më 23 mars 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet të ketë shkelur nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 22 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës

(në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 18 prill 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 29 prill 2013, Kryetari e caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 18 nëntor 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Në mars të vitit 1989, parashtruesi i kërkesës e bleu një dyqan dhe ai duhej t’ia paguante shitësit çmimin e blerjes në këste. Më 1 janar 1999, parashtruesi i kishte ende borxh blerësit një shumë të caktuar të parave. Shitësi e inicioi procedurën civile në Gjykatën Komunale në Pejë, pasi që parashtruesi i kërkesës i kishte injoruar disa kërkesa nga ana e shitësit për t’ia paguar borxhin e mbetur.
9. Më 28 tetor 2007, Gjykata Komunale e hodhi poshtë padinë si të paafatshme.
10. Shitësi ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë kundër vendimit të Gjykatës Komunale.
11. Më 5 shkurt 2010, Gjykata e Qarkut e ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale dhe e urdhëroi parashtruesin e kërkesës që paditësit t’ia paguajë shumën e mbetur me kamatë si dhe shpenzimet e procedurës.
12. Pas kësaj, parashtruesi paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme “*për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale*”. Ai kërkoi nga Gjykata Supreme ta prishë aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, në mënyrë që aktgjykimi i Gjykatës Komunale të mbetet në fuqi.
13. Më 15 shkurt 2012, Gjykata Supreme vendosi që Gjykata e Qarkut kishte të drejtë kur gjeti se Gjykata Komunale e kishte vlerësuar

gjendjen faktike në mënyrë të drejtë, por e kishte zbatuar në mënyrë të gabuar të drejtën materiale, duke mos marrë parasysh ndryshimin e nenit 371 të Ligjit për marrëdhëniet detyrimore, të 25 qershorit 1993, sipas të cilit periudha për parashtrimin e kërkesave ishte zgjatur prej pesë në dhjetë vite.

14. Gjykata Supreme konstatoi se afati prej dhjetë vitesh ende nuk kishte kaluar dhe se Gjykata e Qarkut e kishte aprovuar me të drejtë ankesën e shitësit si të bazuar. Prandaj, Gjykata Supreme e konfirmoi vendimin e Gjykatës së Qarkut për ndryshimin e aktgjykimit të Gjykatës Komunale.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi pretendon para Gjykatës Kushtetuese se edhe Gjykata e Apelit, edhe ajo e Revizionit e kanë zbatuar në mënyrë të gabuar nenin 371 të Ligjit për marrëdhëniet detyrimore.
16. Parashtruesi i kërkesës përfundon se vendimet e kontestuara e shkelin nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës dhe kërkon nga Gjykata që të anulojë vendimet e kontestuara.

Pranueshmëria e kërkesës

17. Gjykata para së gjithash vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore.
18. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113. 7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

19. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47 dhe 48 të Ligjit.

Neni 47.2 i Ligjit për Gjykatën parasheh:

“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48 i Ligjit për Gjykatën, gjithashtu parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

20. Përveç kësaj, rregulli 36 (1) a), b), dhe c), dhe (2) a) dhe d) i Rregullores parasheh:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

*a)janështerurtëgjithamjetetjuridikeefektivetëpërcaktuaram
eligjkundërvendimitose aktgjykimittëkundërshtuar,ose*

*b)kërkesaparashtrohetbrendakatërmuajshngaditaedorëzi
mittëvendimittëmjetittë
funditjuridikefektivteparashtruesi,ose*

c) kërkesa është qartazi e bazuar.

(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose

[...]

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

21. Gjykata konsideron se parashtruesi ka vepruar në përputhje me afatin e paraparë prej katër (4) muajsh të llogaritur nga dita e dorëzimit të aktgjykimit të Gjykatës Supreme; ka arsyetuar kërkesën me fakte relevante dhe me referencë të qartë për shkeljet e pretenduara; shprehimisht konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme si akti konkret i autoritetit publik që është objekt shqyrtimi; në mënyrë të qartë thekson ndihmën e kërkuar; duke bashkëngjitur vendime të ndryshme dhe dokumente dhe informata tjera mbështetëse.

22. Në fakt parashtruesi ka parashtruar kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme *“për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale”.*

23. Gjykata Supreme përfundimisht gjeti se afati kohor prej dhjetë(10) vitesh nuk kishte kaluar dhe konfirmoi vendimin e Gjykatës së Qarkut.
24. Siç u tha më lart, parashtruesi pohon se “*edhe gjykata e apelit edhe gjykata e revizionit kanë zbatuar në mënyrë të gabueshme nenin 371 të Ligjit për Procedurën Kontestimore*”, dhe pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme ka shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenin 31 [e Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm].
25. Gjykata Kushtetuese vëren se baza e ankesës në Gjykatën Supreme konsiston me pretendimin përkitazi me “*shkeljet substanciale të dispozitave të procedurës kontestimore*”, dhe “*zbatimin e gabuar të së drejtës materiale*”.
26. Gjykata Kushtetuese konsideron se ato pretendime i përkasin domenit të ligjshmërisë; dhe më tutje vëren se asnjë pretendim i qartë nuk ishte bërë në bazë të kushtetutshmërisë para Gjykatës Supreme.
27. Në përputhje me parimin e subsidiaritetit, parashtruesi është i obliguar që të shterojë të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj, siç parashihet me nenin 113 (7) dhe dispozitat tjera ligjore, siç ceket më lart.
28. Në fakt, qëllimi i shterimit është që, në këtë rast t’i ofrohet Gjykatës Supreme mundësia e rregullimit të shkeljeve të pretenduara të Kushtetutës. Rregulli i shterimit në mënyrë operative është i gërshetuar me karakterin subsidiar të kornizës procedurale të drejtësisë kushtetuese. (shih, *mutatis mutandis*, Selmouni kundër Francës [GC], § 74; Kudla kundër Polonisë [GC], § 152; Andrášik dhe të tjerët kundër Sllovakisë (vendim).
29. Kështu pra parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi të shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo, nëse ka, të rregullohet shkelja e tillë e të drejtave themelore. Përndryshe, parashtruesi është përgjegjës kur rasti i tij shpallet i papranueshëm nga Gjykata Kushtetuese, kur dështon të shfrytëzojë procedurat e rregullta apo kur dështon të raportojë shkeljet e Kushtetutës në procedurë të rregullt. Ai dështim do të kuptohet si heqje dorë nga e drejta për të kundërshtuar më tej shkeljen dhe për t’u ankuar. (shih, Aktvendimin në Rastinnr. KIO7/09, Demë Kurbogaj dhe

Besnik Kurbogaj, Vlerësimi i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pkl. Nr. 61/07 të 24 nëntorit 2008, paragrafi 18).

30. Kurdoherë që një vendim gjyqësor kontestohet në bazë të një qëndrimi juridik që është i papranueshëm nga pikëpamja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, gjykatave të rregullta që sollën vendimin duhet t'u ofrohet mundësia për të rishqyrtuar vendimin e kontestuar. Kjo do të thotë se, çdoherë, kur pretendohet shkelja e të drejtave të njeriut, nuk është e thënë që ky pretendim të arrijë në Gjykatën Kushtetuese para se të shqyrtohet paraprakisht nga gjykatat e rregullta.
31. Në rastin konkret, parashtruesi do të duhej të ishte ankuar në mënyrë të qartë në Gjykatën Supreme kundër shkeljes së pretenduar të së drejtës së tij për gjykim të drejtë, pasi që Gjykata Supreme gjithashtu “duhet të gjykojë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit” (neni 102 (3) i Kushtetutës).
32. Në praktikë, asgjë nuk e ndaloi parashtruesin që të ankohej para Gjykatës Supreme përkitazi me shkeljen e pretenduar të së drejtës së tij për gjykim të drejtë. Nëse Gjykata Supreme do të shqyrtonte shkeljen dhe do ta rregullonte atë, kjo do përfundonte; nëse Gjykata Supreme as nuk do ta rregullonte shkeljen, apo nuk do ta shqyrtonte atë, parashtruesi do të kishte përmbushur kërkesën për shterimin e të gjitha mjeteve, në kuptimin që Gjykatës Supreme do t'i ofrohej mundësia e rregullimit të shkeljes së pretenduar.
33. Gjykata Kushtetuese tashmë ka konsideruar se “*mos shterimi i mjeteve juridike mund të nënkuptojë situatë të ndryshme: kërkesa është e parakohshme, sepse vendimi për të njëjtën çështje është ende në pritje; kërkesa ishte parashtruar në mungesë të disa ankesave; ose ankesa parashtrohet në instancën e fundit, pa iu dhënë mundësia asaj gjykate të instancës së fundit që të korrigjojë shkeljen e pretenduar*” (shih, Aktvendimipër papranueshmëri i 4 dhjetorit 2012, në rastin nr. KI120-11, Parashtrues Ministria e Shëndetësisë, Vlerësim kushtetues i Vendimit të Gjykatës Supreme A. Nr. 551, i 20 qershorit 2011).
34. Në fakt, kjo analizë është në përputhshmëri me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të DREJTAT E NJERIUT (në tekstin e mëtejshëm Gjykata Evropiane), e cila parasheh që parashtruesit vetëm duhet shteruar mjetet vendore që i kanë në dispozicion në teori dhe në praktikë në kohën përkatëse, që do të thotë se janë të arritshme, në gjendje të sigurojnë dëmshpërblim lidhur me ankesat e tyre dhe për të ofruar mundësi të arsyeshme për sukses

(Sejdović kundër Italisë [GCI, nr. 56581/00, GJEDNJ 2006-IJ §46). Duhet vlerësuar, në të gjitha rrethanat e rastit, nëse parashtruesi i kërkesës ka bërë gjithçka që me arsye pritet prej tij ose prej saj për të shteruar mjetet vendore (D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke [GCI §§1162).

35. Gjykata Kushtetuese gjithashtu ka aplikuar të njëjtin justifikim me rastin e nxjerrjes së Aktvendimit për papranueshmëri mbi bazën e mos-shterimit të mjeteve, më 4 dhjetor 2012, në rastin nr. KI120/11, Ministria e Shëndetësisë, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme A. nr. 551 të 27 janarit 2010, në rastin nr. KI41/09, Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C. Prishtinë, kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës; dhe më 23 mars 2010, në Vendimin e saj në rastin nr. KI73/09, Mimoza Kusari Lila kundër Komisionit Qendror Zgjedhor.
36. Në parim dhe faktikisht, parashtruesi nuk mund të ankohet drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese për shkelje të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut. Parashtruesi është dashur së pari të ankohej në Gjykatën Supreme kundër shkeljes kushtetuese. Mungesa e ankesës në Gjykatën Supreme kundër shkeljes së pretenduar të të drejtave të tij për një gjykim të drejtë, tregon se nuk janë shteruar të gjitha mjetet e ofruara nga sistemi i rregullt ligjor.
37. Sidoqoftë, Gjykata Kushtetuese konsideron se faktet e rastit nuk lejojnë një përfundim bindës se bazat e ankesës “*shkelje substanciale e dispozitave të procedurës kontestimore*” dhe “*zbatimi i gabuar i të drejtës materiale*” të pretenduar në Gjykatën Supreme, përmbushin testin e Gjykatës Evropiane.
38. Në cilëndo mënyrë, edhe nëse parashtruesi do të kishte ngritur në mënyrë të qartë pretendimet kushtetuese para Gjykatës Supreme, Gjykata Kushtetuese edhe më tej konsideron se parashtruesi nuk e ka arsyetuar dhe mbështetur me prova shkeljen e të drejtave të tij nga ana e Gjykatës Supreme.
39. Në fakt, pretendimet e parashtruesit për shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese nuk paraqesin ndonjë bazë të mjaftueshme *prima facie* për të parashtruar rastin në Gjykatë; pakënaqësia e parashtruesit me vendimin e Gjykatës Supreme nuk mund të jetë bazë kushtetuese për t’u ankuar në Gjykatën Kushtetuese.
40. Gjykata përkujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i kontestuar shkelë të drejtat e tij për gjykim të drejtë dhe të

paanshëm dhe për mbrojtje të pronës, siç garantohen me nenin 31 dhe 46 të Kushtetutës.

41. Sidoqoftë, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk i ka qartësuar saktësisht pse dhe si të drejtat e tij kushtetuese janë shkelur me vendimet e kontestuara, kur ka konstatuar se nuk ka kaluar afati prej dhjetë vitesh. Duket se parashtruesi thjesht nuk pajtohet me rezultatin e vendimeve të kontestuara.
42. Në të vërtetë, nga parashtruesi i kërkesës nuk është bërë asnjë pretendim mbi bazën e kushtetutshmërisë, qoftë në mënyrë implicite, qoftë në substancë, që do të mbështeste shkeljen e pretenduar të të drejtave të tij në gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe në mbrojtje të pronës.
43. Për më tepër, Gjykata përsëri vëren se parashtruesi i kërkesës ankohet në bazë “*të aplikimit të gabuar të nenit 371 të Ligjit për marrëdhënie detyrimore*” dhe më tutje konstaton se vendimet e kontestuara i shkelin të drejtat e tij kushtetuese.
44. Gjykata konsideron se ankesa e parashtruesit të kërkesës i takon fushës së ligjshmërisë, e cila, si rregull, është juridiksioni i gjykatave të rregullta. Referenca e thjeshtë për një shkelje të të drejtave të tij për gjykim të drejtë dhe mbrojtje të pronës së tij nuk përbën në vetvete një bazë kushtetuese për ankesën e tij.
45. Për më tepër, parashtruesi nuk e mbështet pretendimin *prima facie* mbi baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar prova që tregojnë se të drejtat dhe liritë e tij, të garantuara me nenin 31 dhe 46 të Kushtetutës, janë shkelur me vendimet e Gjykatës së Qarkut dhe të Gjykatës Supreme.
46. Përveç kësaj, Gjykata Kushtetuese përkujton se, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Supreme, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria).
47. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga këto gjykata. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM], Nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).

48. Përveç kësaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të konsiderojë se procedurat përkatëse në Gjykatën e Qarkut dhe në Gjykatën Supreme ishin në ndonjë mënyrë të padrejta ose arbitrare (shih *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendim i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).
49. Përkundrazi, Gjykata konsideron se procedurat, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në mënyrë të tillë sa që parashtruesi ka pasur gjykim të drejtë (shih, *mutatis mutandis*, Raport i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut në rastin Edwards kundër MB, Nr. 13071/87, 10 korrik 1991).
50. Për më tepër, Gjykata konsideron se të dy vendimet, ai i Gjykatës së Qarkut dhe ai i Gjykatës Supreme janë të arsyetuara mirë dhe të justifikuara në pajtim me juridiksionin e tyre.
51. Si përmbledhje, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit, në pajtim me dispozitat e kombinuara të nenit 113 (7) të Kushtetutës, nenit 48 të Ligjit dhe të rregullit³⁶ (1), a), b) dhe c) dhe (2) a) dhe d) të Rregullores, është qartazi e pabazuar.
52. Prandaj, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 dhe 48 të Ligjit, dhe me rregullin 36 (1) c) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 18 nëntor 2013, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI150/13, Halit Lahu, Aktvendim i datës 20 nëntor 2013 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit SCEL-09-0001 të Trupit Gjykses të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 15 marsit 2011.

Rasti KI150/13, vendimi i 20 nëntorit 2013.

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, kërkesa e paafatshme.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i kontestuar ia cenon të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Kosovës.

Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese të shpallë që “pjesa e 20 % përqindëshit nga privatizimi i takon edhe atij pasi që, si ish punëtor i NSH Ramiz Sadiku, ai ka të drejtë në të”.

Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 19 shtator 2013, ndërsa vendimi i fundit i Trupit gjykses të Dhomës së Posaçme i ishte dorëzuar parashtruesit më 17 prill 2011.

Prandaj, Gjykata konsideron se kërkesa është e paafatshme, sepse është dorëzuar 2 vjet dhe 31 ditë pas skadimit të afatit ligjor, të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores.

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës, më 20 nëntor 2013, njëzëri deklaroi kërkesën e papranueshme si të paafatshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI150/13

Parashtrues

Halit Lahu

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit SCEL-09-0001 të
Trupit Gjykses të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të
Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të
Privatizimit,
të 15 marsit 2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Halit Lahu nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin SCEL-09-0001 të Trupit gjykses të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Trupi Gjykses i Dhomës së Posaçme), të 15 marsit 2011, që i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 17 prill 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës, mes tjerash, i është cenuar e drejta për gjykim të drejtë.

Baza juridike

4. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenet 20 dhe 22.7 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009, (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 19 shtator 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 24 shtator 2013, Kryetari me vendimin nr. GJR. KI150/13 caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues. Në të njëjtën ditë, me vendimin e Kryetarit nr. KSH. KI150/13 është caktuar Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 10 tetor 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 20 nëntor 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues, dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 27 qershor 2006, NSH "Ramiz Sadiku" e përmbylli procesin e privatizimit.
10. Më 31 mars 2009, parashtruesi i kërkesës inicioi procedurë gjyqësore në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, duke u ankuar, për të realizuar të drejtën e tij të pretenduar për një pjesë të 20%, nga privatizimi i NSH "Ramiz Sadiku".
11. Përfundimisht, më 15 mars 2011, Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme (Vendimi SCEL-09-0001) e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të papranueshme.
12. Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme dha këtë arsyetim:

“Gjatë seancës dëgjimore dhe pas administrimit të provave ka konstatuar se parashtruesi nuk ka paraqitur prova për të arsyetuar se përse e ka humbur afatin ligjor për të ushtruar ankesë ndaj Agjencisë”. Në këshillën për mjetin juridik, Trupi Gjykues theksoi se „pala e pakënaqur me vendimin e Trupit Gjykues ka të drejtën e ankesës brenda afatit ligjor”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

13. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i kontestuar ia cenon të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Kosovës.
14. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese të shpallë që *“pjesa e 20 % përqindëshit nga privatizimi i takon edhe atij pasi që, si ish punëtor i NSH Ramiz Sadiku, ai ka të drejtë në të”*.

Pranueshmëria e kërkesës

15. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
16. Lidhur më këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës që përcakton:

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

17. Gjykata po ashtu i referohet nenit 49 të Ligjit që thotë:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”.

18. Gjykata gjithashtu merr parasysh edhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores, i cili parashikon:

“(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

...

b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi”.

19. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 19 shtator 2013, ndërsa vendimi i fundit i Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme i ishte dorëzuar parashtruesit më 17 prill 2011.
20. Prandaj, Gjykata konsideron se kërkesa është e paafatshme, sepse është dorëzuar 2 vjet dhe 31 ditë pas skadimit të afatit ligjor, të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores.
21. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa duhet të hidhet poshtë si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës, më 20 nëntor 2013, njëzëri

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe
- IV. TË SHPALLË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI197/13, NTP “Beni Dona”, Aktvendim i datës 21 janar 2014 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. Mlc. nr. 141/2012, të 18 shtatorit 2013

Rasti KI197/13, vendimi i 21 janarit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, qartazi e pabazuar

Parashtruesi i kërkesës, N.T.P. Beni Dona, parashtroi kërkesë në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke kontestuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, i cili pretendohet të ketë shkelur nenet 3.2 [Barazia para Ligjit], 7.1 [Vlerat], 16.3 [Epërsia e Kushtetutës], 21.4 [Parimet e Përgjithshme] dhe 22.2 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Parashtruesi i kërkesës konsideron se Gjykata Supreme kishte zbatuar gabimisht të drejtën materiale, sepse sipas parashtruesit, ekziston vazhdimësia ligjore në mes të ish-Komunës së Podujevës dhe asaj të themeluar pas konfliktit të armatosur në Kosovë.

Lidhur me çështjen e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata konstatoi se kërkesa ishte e papranueshme, sepse parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar dëshmi se procedurat përkatëse kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare. Prandaj, Gjykata konstatoi se kërkesa ishte qartazi e pabazuar në pajtim me rregullat 36 (1) c) dhe 36 (2) d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI197/13
Parashtrues
N.T.P. “Beni Dona”
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme, Rev. Mlc. nr. 141/2012, të 18 shtatorit 2013
GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi

1. Parashtrues i kërkesës është Ndërmarrja “Beni Dona”, e përfaqësuar nga z. Muhamet Shala, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. Mlc. nr. 141/2012, të 18 shtatorit 2013, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit më 5 nëntor 2013.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, i cili pretendohet t’i ketë shkelur nenet 3.2 [Barazia para Ligjit], 7.1 [Vlerat], 16.3 [Epërsia e Kushtetutës], 21.4 [Parimet e Përgjithshme] dhe 22.2 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 të

Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 12 nëntor 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 3 dhjetor 2013, Kryetari me Vendimin Nr. GJR. KI197/13, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI197/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 9 dhjetor 2013, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme, Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit në Prishtinë dhe Komunën e Podujevës në lidhje me kërkesën.
8. Më 21 janar 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 16 shtator 1996, Ndërmarrja "Beni Dona", pronë e parashtruesit, lidhi kontratë me Komunën e Podujevës për ta marrë me qira objektin e ish-hotelit "Llap" në Podujevë për një periudhë 10-vjeçare, me kusht që Ndërmarrja "Beni Dona" ta rehabilitonte atë me shpenzime të veta. Pas skadimit të kontratës së qirasë, Komuna e Podujevës do të vendoste për vazhdimin ose ndërprerjen e kontratës së qirasë, pra nëse Komuna do të vendoste ta ndërpriste kontratën e qirasë, ajo do të duhej t'ia kthente Ndërmarrjes "Beni Dona" shumën e shpenzuar për rehabilitimin e hotelit.
10. Prej vitit 2002 deri në vitin 2005, sipas kërkesës së Komunës së Podujevës, përveç shpenzimeve për rehabilitim, Ndërmarrja "Beni Dona" e pagoi edhe tatimin në pronë për pronën e marrë me qira.
11. Pasi që Komuna e Podujevës nuk i kishte plotësuar obligimet e saj kontraktuale, më 6 qershor 2007, parashtruesi paraqiti padi kundër Komunës në Gjykatën Komunale në Podujevë, duke kërkuar që gjykata të vendoste që Komuna t'ia kthente investimin

ose ndërmarrja të vazhdonte ta shfrytëzonte objektin e marrë me qira për dhjetë (10) vjet.

12. Më 9 nëntor 2007, Gjykata Komunale në Podujevë, (Aktgjykimi C. nr. 155/2007), e miratoi padinë e parashtruesit dhe e urdhëroi Komunën e Podujevës ose t'ia kthente ndërmarrjes fondet e investuara, ose ta vazhdonte kontratën e qirasë edhe për dhjetë (10) vjet.
13. Më 9 nëntor 2007, Komuna ushtroi ankesë kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.
14. Më 28 maj 2008, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktgjykimi Ac. nr. 28/2008) e refuzoi si të pabazuar ankesën e Komunës, duke pohuar që dispozitivi i aktgjykimit të Gjykatës Komunale ishte i kuptueshëm dhe i përshtatshëm për përmbarrim dhe në arsyetimin e vet, gjykata kishte ofruar arsye të plota dhe të kuptueshme për të gjitha faktet e rëndësisë vendimtare dhe prandaj, arsyetimi i ofruar ishte plotësisht në përputhje me përmbajtjen e provave të administruara.
15. Brenda afatit ligjor, Komuna e Podujevës paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale dhe aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut. Në të njëjtën kohë, prokurori publik paraqiti kërkesë në të njëjtën gjykatë, për mbrojtje të ligjshmërisë, duke propozuar prishjen e aktgjykimeve të gjykatave të shkallëve më të ulëta për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabueshëm të së drejtës materiale, dhe që rasti të rihapej në gjykatën e shkallës së parë.
16. Më 3 shtator 2010, Gjykata Supreme e miratoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të paraqitur nga prokurori publik, si dhe revizionin e paraqitur nga Komuna e Podujevës, duke vendosur që Komuna e Podujevës tani nuk ishte ligjërisht përgjegjëse për kontratën e qirasë ndërmjet parashtruesit dhe ish-Kuvendit Komunal të Podujevës, të nënshkruar në vitin 1996. Gjykata Supreme gjeti se gjykatat e shkallëve më të ulëta kishin zbatuar gabimisht të drejtën materiale.
17. Më 12 tetor 2010, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë, duke u ankuar në aktgjykimin e Gjykatës Supreme. Më 12 prill 2012, Gjykata Kushtetuese e deklaroi të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev nr. 406/2008 të 3 shtatorit 2010, sepse Aktgjykimi i Gjykatës Supreme kishte shkelur të

drejtat procedurale të parashtruesit sipas nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6.1 (E drejta për gjykim të drejtë) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kështu, Gjykata Kushtetuese e ktheu rastin në Gjykatën Supreme për rishqyrtim në pajtim me aktgjykimin e kësaj Gjykate.

18. Më 18 shtator 2013, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Mlc. nr. 141/2012), në përputhje me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, e rihapi procedurën lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të dorëzuar nga prokurori publik si dhe revizionin e dorëzuar nga Komuna e Podujevës. Gjykata Supreme vendosi që Komuna e Podujevës nuk ishte ligjërisht përgjegjëse për kontratën e qirasë, në mes të parashtruesit dhe të ish-Kuvendit Komunal të Podujevës, të nënshkruar më 1996. Megjithatë, Gjykata Supreme e Kosovës, sipas rekomandimeve të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, të specifikuara në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese Nr. KI103/2010 të 12 prillit 2012, gjithashtu njoftoi palët ndërgjyqëse, Prokurorin e Shtetit të Kosovës, paditësin Shaban Mustafa – pronarin e “Beni-Dona”, përfaqësuesin e autorizuar avokatin Muhamet Shala, dhe përfaqësuesin e të paditurës, avokatin publik Faik Rama.

Pretendimet e parashtruesit

19. Parashtruesi pretendon që arsyetimi i Gjykatës Supreme është i gabuar për shkak se ajo konkludoi që ndërmarrja kishte lidhur kontratë me ish-Komunën e Podujevës në vitin 1996, dhe pas luftës, Komuna e tashme e Podujevës nuk është pasardhëse e saj, dhe, për këtë arsye, komuna e tanishme nuk obligohej t'i merrte përsipër obligimet e kontratës së vitit 1996. Parashtruesi pretendon se Komuna e Podujevës vërtet e ka humbur kontinuitetin politik të ish-Komunës, por gëzonte kontinuitetin juridik të bartjes së të drejtave dhe detyrimeve, pasi që ishte vendosur në të njëjtat lokale dhe administronte pasurinë e njëjtë të patundshme si edhe më parë, dhe pasi që kishte pranuar se ishte pronare e objektit të lëshuar me qira, ajo duhej t'i pranonte edhe detyrimet lidhur me këtë objekt.

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata së pari vëren se, në mënyrë që kërkesa të jetë e pranueshme, parashtruesi duhet të tregojë që i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës.

21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, i cili parasheh: *“Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar”*.
22. Lidhur me rastin e tanishëm, parashtruesi pretendon se Gjykata Supreme me Aktgjykimin e saj të 18 shtatorit 2013, kishte zbatuar gabimisht të drejtën materiale, sepse sipas parashtruesit, ekziston vazhdimësia ligjore në mes të ish-Komunës së Podujevës dhe asaj të themeluar pas konfliktit të armatosur në Kosovë.
23. Në këtë drejtim, Gjykata thekson që nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe deri në masën që mund të kenë cenuar të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Kështu, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, kur shqyrton vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih rastin KI14/13, parashtrues Komuna e Podujevës, Aktvendimi për papranueshmëri i 12 marsit 2013).
24. Gjykata vëren se kërkesa e parashtruesit ka të bëjë me çështje të ligjshmërisë dhe jo me çështje të kushtetutshmërisë, sepse pretendimi i parashtruesit është lidhur me atë se a kishte të drejtë Gjykata Supreme të konstatojë se nuk ka vazhdimësi ligjore në mes të komunës së mëparshme të Podujevës dhe asaj të themeluar pas konfliktit të armatosur në Kosovë.
25. Lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, parashtruesi nuk e ka mbështetur pretendimin e tij në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar dëshmi se të drejtat dhe liritë e tij janë cenuar nga ai autoritet publik. Prandaj, Gjykata nuk mund të konstatojë se procedurat përkatëse në Gjykatën Supreme kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare. (shih rastin KI14/13, parashtrues Komuna e Podujevës, Aktvendim për papranueshmëri i 12 marsit 2013).
26. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk ka treguar pse dhe si përfundimi i Gjykatës Supreme se nuk ekziston vazhdimësia ligjore në mes të komunës së mëparshme të Podujevës dhe asaj të themeluar pas konfliktit të armatosur në Kosovë, i ka shkelur të drejtat dhe liritë e tij, të mbrojtura me Kushtetutë.

27. Në këto rrethana, Gjykata konkludon se kërkesa, në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, është e papranueshme, sepse është qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me rregullin 36 (1) c) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 21 janar 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI188/13, Fetije Bajrami-Shala, Aktvendim i datës 24 janar 2014 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev. nr. 181/2013, të 9 korrikut 2013, dhe të Aktgjykimit Rev. nr. 48/2003, të 11 shtatorit 2003, të Gjykatës Supreme

Rasti KI188/13, vendimi i 24 janarit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kontest civil, e drejta për gjykim të drejte, interpretimi i dispozitave për të drejtat e njeriut, kërkesë qartazi e pabazuar.

Në këtë rast, parashtruesja e kërkesës pretendonte se me vendimet e kontestuara i ishin shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara me nenin 31 dhe 53 të Kushtetutës, për faktin se, Gjykata Supreme ia kishte refuzuar asaj, kërkesën përkitazi me kompensimin e të hollave për punët e kryera në Komisionin për krime lufte dhe persona të humbur.

Gjykata, në tërësi i shqyrtoi shkresat e bashkëngjitura në kërkesë, dhe vëren se, parashtruesja e kërkesës nuk ka ofruar prova të mjaftueshme mbi bazën e argumentimit kushtetues, përkitazi me pretendimin se aktgjykimet, Rev. nr. 181/2013 të 9 korrikut 2013 dhe Rev. nr. 48/2003 të 11 shtatorit 2003 të Gjykatës Supreme, shkelin të drejtat e parashtrueses, të garantuara me nenin 31 dhe 53 të Kushtetutës.

Në rastin konkret, parashtruesja nuk kishte paraqitur asnjë provë që do tregonte se shkeljet e pretenduara, të përmendura në kërkesë, përbënin elemente të shkeljes së të drejtave të garantuara me Kushtetutë. Në këtë kontekst Gjykata iu referua gjetjeve të GJEDNJ-së, në rastin Vanek kundër Republikës Sllovake, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, i 31 majit 2005.

Gjykata konsideroi se procedurat përkatëse të zhvilluara në Gjykatën Supreme nuk ishin kanë të padrejta apo arbitrare dhe përkitazi me këtë i referua mutatis mutandis rastit Shub vs. Lithuania, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009.

Si përfundim, Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtrueses nuk i përmbushte kërkesat e kërkuara me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI188/13

Parashtrues

Fetije Bajrami-Shala

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev. nr.

181/2013,

të 9 korrikut 2013, dhe të Aktgjykimit Rev. nr. 48/2003, të 11

shtatorit 2003, të Gjykatës Supreme

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar

Ivan Čukalović, zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe

Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është znj. Fetije Bajrami-Shala (në tekstin e mëtejme: parashtruesja), me vendbanim në fshatin Oshlan, komuna e Vushtrrisë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktgjykimin Rev. nr. 181/2013, të 9 korrikut 2013, dhe Aktgjykimin Rev. nr. 48/2003, të 11 shtatorit 2003, të Gjykatës Supreme. Parashtruesja nuk e ka specifikuar datën e pranimi të vendimit të fundit.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev. nr. 181/2013 të 9 korrikut 2013, dhe Aktgjykimit Rev. nr. 48/2003 të 11 shtatorit 2003, të Gjykatës Supreme, me të cilat parashtruesja pretendon shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të

Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 4 nëntor 2013, parashtruesja dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 2 dhjetor 2013, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI188/13, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përbërë nga: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodriguez dhe Ivan Čukalović.
7. Më 13 dhjetor 2013, Gjykata Kushtetuese njoftoi parashtruesen e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 20 janar 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Nga viti 1999 gjer në vitin 2000, parashtruesja pohon se ka punuar në Komunën e Vushtrrisë, respektivisht për Komisionin për hetimin e krimeve të luftës dhe personave të humbur. Ky Komision, sipas parashtrueses, ishte formuar nga Qeveria e Përkohshme e Kosovës, me vendimin e 5 korrikut 1999. Në bazë të këtij vendimi, kryetari i Këshillit Komunal të Vushtrrisë kishte autorizuar parashtruesen e kërkesës që të punojë në Komisionin përkatës.
10. Meqë, Komuna e Vushtrrisë nuk i është përgjigjur kërkesave të parashtrueses për kompensimin me të holla për punët e kryera në Komision, ajo, së bashku me disa persona të tjerë, ushtruan padi në Gjykatën Komunale në Vushtri.

11. Më 5 korrik 2002, Gjkata Komunale në Vushtrri, me Aktgjykimin C. nr. 13/2001, aprovoi kërkesëpadinë e parashtrueses dhe paditësve të tjerë. Me këtë vendim është obliguar Komuna e Vushtrrisë (e paditura) që në emër të borxhit t'ua paguajë nga 1.794 euro secilit paditës, duke përfshirë dhe parashtruesen e kërkesës.
12. Komuna e Vushtrrisë, kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale të Vushtrrisë, ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës.
13. Më 11 dhjetor 2002, Gjkata e Qarkut në Mitrovicë, me Aktgjykimin Ac. nr. 93/2002, e refuzoi si të pabazuar ankesën e ushtruar nga Komuna e Vushtrrisë dhe vërtetoi, si të drejtë, aktgjykimin gjykatës së instancës së parë.
14. Më 5 shkurt 2003, Komuna e Vushtrrisë, kundër Aktgjykimit Ac. nr. 93/2002, të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës, ushtroi revizion në Gjykatën Supreme, për shkak të shkeljeve procedurale, të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe të aplikimit të gabuar të ligjit material.
15. Pasi Gjkata e Qarkut të Mitrovicës kishte vërtetuar, si të drejtë, aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Vushtrrisë, parashtruesja i është drejtuar kësaj të fundit me propozim për përmbarimin e Aktgjykimit C. nr. 13/2001, të 5 korrikut 2002.
16. Më 5 mars 2003, Gjkata Komunale në Vushtrri, me Vendimin E. nr. 59/2003, lejoi propozimin për përmbarim, me të cilin ishte aprovuar kërkesëpadia e parashtrueses për kompensimin e borxhit në shumën prej 1.794 eurosh nga ana e Komunës së Vushtrrisë.
17. Më 11 shtator 2003, Gjkata Supreme, me Aktgjykimin Rev. nr. 48/2003, aprovoi si të bazuar revizionin e ushtruar nga Komuna e Vushtrrisë, duke vendosur kështu për ndryshimin e Aktgjykimit C. nr. 13/2001, të 5 korrikut 2002, të Gjykatës Komunale të Vushtrrisë dhe Aktgjykimin Ac. nr. 93/2002, të 11 dhjetorit 2002, të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë. Kjo gjykatë e arsyeton aktgjykimin e saj si më poshtë:

“Gjkata Supreme e Kosovës nuk mund të pranojë një qëndrim të tillë të gjykatave të instancës me të ulet, nga se sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, aktgjykimet e goditura janë marr me zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Në bazë të Rezolutës së Kombeve të Bashkuara 1244 dhe Rregullores së

UNMIK-ut 1999/01 dhe 1999/24, pas luftës është krijuar një realitet i ri në Kosovë. Ndërkaq, me dispozitën e nenit 1 të kësaj Rregulloreje është parapare se, i gjithë pushteti legjislativ dhe ekzekutiv ushtrohet nga UNMIK-u dhe përfaqësuesi special i KB, kurse si ligje në fuqi në Kosovë, përveç tjerash, në rend të parë janë rregulloret e shpallura nga PSSP dhe instrumentet ndihmese të nxjerra në përputhje me to. Me rregulloret e UNMIK-ut janë themeluar të gjitha institucionet legjislative, ekzekutive dhe të administratës si në nivelit qendror, ashtu edhe në vetëqeverisjen e komunave të Kosovës. Sipas Rregullores se UNMIK-ut nr.1999/45 neni 48. 12, administratori miraton çdo emërim apo largim të nëpunësve të lartë nga puna dhe mbikëqyr të gjitha emërimet tjera me qëllim që të sigurojë përfaqësim të nevojshëm të komuniteteve në ato emërimet. Emërimet dhe shkarkimet e tilla nuk mund të hyjnë në fuqi pa bashkënenshkrimin e administratorit komunal. Sipas nenit 2.4 të së njëjtës rregullore, çdo komunë duhet ta ketë statutin e vet juridik, të drejtë për të poseduar dhe administruar pronën, mundësinë për të ushtruar padi dhe për të qene e paditur në gjykatë, të drejtën për të lidhur kontrata dhe të drejtën për të marrë punëtor në punë.

Me këtë Rregullore janë përcaktuar organet e vetëqeverisjes së komunave dhe shërbimi civil komunal. Për faktin se paditësit nuk posedojnë kontrata për krijimin e detyrimeve, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, në rastin konkret gabimisht është zbatuar e drejta materiale, prandaj aktgjykimet e të dy gjykatave u ndryshuan, ashtu që kërkesëpadia e paditësve u refuzuar si e pabazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së revizionit, mungesa e legjitimitetit real pasiv të komunës së paditur, del nga gjendja e cila ekziston në shkresat e lendes dhe gjykata, sipas detyrës zyrtare, porsa ta vërtetojë mungesën e legjitimitetit aktiv ose pasiv të palës ndërgjyqëse, do ta refuzojë me aktgjykim si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve”.

18. Pas kësaj, Komuna e Vushtrrisë ushtroi padi në Gjykatën Komunale në Vushtrri, me kërkesë për kthimin e mjeteve financiare të paguara parashtrueses, nga xhirollogaria e saj, sipas Vendimit E. nr. 59/2003, të 5 marsit 2003, të Gjykatës Komunale të Vushtrrisë.
19. Më 26 tetor 2005, Gjykata Komunale në Vushtrri, me Aktgjykimin C. nr. 20/2004, aprovoi kërkesëpadinë e Komunës së Vushtrrisë,

tani paditëses, duke obliguar parashtruesen që në emër të pasurimit të pabazë, t'ia paguajë Komunës së Vushtrrisë shumën prej 2.485,75 eurosh, në xhirollogarinë zyrtare të saj, me kamatë vjetore 3%, duke filluar nga 10 shkurti 2004, deri në pagesën definitive. Gjykata në fjalë, pas vlerësimit të çështjes, kishte konstatuar se:

“Nga provat e zhvilluara, gjykata konstatoi se kemi të bëjmë me rastin e pasurimit të pabazë. Pagesa sipas bazës ka dështuar me vone, nga se paditësja në çastin e pagimit ka ekzistuar baza, ka paguar shumën e të hollave të paditurës, në bazë të aktgjyqimit të plotfuqishëm të Gjykatës Komunale në Vushtrri të cekur me lartë. Mirëpo kjo bazë me vone ka dështuar nga se me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të cekur me lartë është ndryshuar aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Vushtrri i cekur me lartë, si dhe ai i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë dhe kërkesëpadia e tani paditurës është refuzuar si e pabazuar.”

20. Më 18 mars 2013, Gjykata e Apelit në Prishtinë, me Aktgjykimin Ac. nr. 373/2012, refuzoi ankesën e ushtruar nga parashtruesja dhe vërtetoi, si të drejtë, Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Vushtrri, C. nr. 20/2004, të 26 tetorit 2005. Kjo gjykatë kishte konstatuar si të drejtë dhe të ligjshëm vendimin e gjykatës së instancës së parë, për faktin se nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 354.2 i LPK-së, të cilat kjo gjykatë i vlerëson, sipas detyrës zyrtare, bazuar në nenin 365.2 të LPK-së.
21. Më 9 korrik 2013, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin Rev. nr. 181/2013, refuzoi revizionin e parashtrueses, si palë paditëse në këtë rast, të ushtruar kundër aktgjyqimit. Gjykata arsyeton:

“Nisur nga kjo gjendje çështjes Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykatat e instancës me të ulet, në baze të gjendjes faktike të vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë drejtë kane zbatuar të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditëses për kthimin e të hollave, në shumën e gjykuar është e bazuar. Gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar dispozitën e nenit 210 të LMD pasi që me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 48/2003 dt. 11.09.2003, në atë konteste është refuzuar kërkesëpadia tani e te paditurës për pagesën e borxhit të gjykuar me aktgjykimin e Gjykatës Komunale Vushtrri, C. nr. 13/2001 dt. 05.07.2002. Këtë shume gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar në bazë të aktvendimit për

lejimin e përmbarimit të Gjykatës Komunale në Vushtrri E. nr. 59/2003 të dt. 05.03.2003, ku të paditurës në emër të borxhit kryesor në shuma prej 1.794,00 € dhe kamatës i është paguar shuma prej 691,75 €, ose shuma e tërësishme prej 2.485, 75 €.

Thëniet në revizion lidhur me lartësinë e normës së kamatës prej 3%, në shumën e gjykuar kjo Gjykatë e vlerësoj dhe si të pa bazuar pasi që kamata e gjykuar është kamate vjetore që pranohet në bankë në mjetet e afatizuara mbi një vit pa destinim të caktuar. Thëniet e revizionit lidhur me punët dhe detyrat që ka kryer e paditura dhe drejta e saj në kompensim kjo gjykate nuk i vlerësoj pasi që me aktgjykimin Rev. nr. 48/2003 dt.11.09.2003 është vendosur lidhur me këtë çështje”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesja e kërkesës pretendon se me vendimet e kontestuarra i janë shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara me nenin 31 dhe 53 të Kushtetutës, për faktin se, Gjykata Supreme ia kishte refuzuar asaj, kërkesën përkitazi me kompensimin e të hollave, për punët e kryera në Komisionin për krime lufte dhe persona të humbur.
23. Parashtruesja mëton se “Qëndrimi i Gjykatës Supreme të Kosovës në aktgjykimin Rev. nr 48/2003, se gjykatat kane zbatuar gabimisht të drejtën materiale nuk është i sakte. Gjykata thekson se me rregulloren 1999/1, 1999/24, 1999/45 janë themeluar te gjitha institucionet legjislative, ekzekutive dhe administrative, si ne nivelin qendror ashtu edhe atë komunal. Mirëpo me rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/01 datë 14 janar 2000, mbi strukturën e përbashkët, të përkohshme administrative të Kosovës theksohet e kundërta e asaj që theksohet në arsyetim të këtij aktgjykimi. *Legis specialis derogat legis generalis*. Me këtë rregullore krijohet baza e strukturës së re administrative në Kosovë, përkatësisht të gjitha organet e pushtetit të themeluara nga ana e Qeverisë së Përkohshme në Kosovë, sipas kësaj rregullore janë konsideruar se kane ekzistuar dhe kanë vepruar legalisht në Kosovë gjer në nxjerrjen e kësaj rregulloreje”.

Pranueshmëria e kërkesës

24. Në mënyrë që Gjykata të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtrueses, duhet që fillimisht të vlerësojë nëse parashtruesja i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

25. Përkitazi me kërkesën e parashtrueses, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

26. Gjykata, po ashtu, i referohet nenit 49 të Ligjit, që përcakton se:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të llogaritet që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të llogaritet në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht....”.

27. Gjykata, gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit, që përcakton se: *“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar, ...”.*

28. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesja është palë e autorizuar, i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj, në pajtim me kërkesat e nenit 113.7 të Kushtetutës, dhe se kërkesa është dorëzuar brenda afatit ligjor prej katër (4) muajsh, siç parashihet nën 49 i Ligjit.

29. Sa i përket pretendimit të parashtrueses për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) c) dhe 36 (2) b) të Rregullores së punës, që përcakton se:

*“(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:
[...]*

c) Kërkesa është qartazi e bazuar.

*“(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
[...]*

b) Faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”.

30. Gjykata, në tërësi i shqyrtoi shkresat e bashkëngjitura në kërkesë, dhe vëren se, parashtruesja e kërkesës nuk ka ofruar prova të mjaftueshme mbi bazën e argumentimit kushtetues, përkitazi me pretendimin se aktgjykimet, Rev. nr. 181/2013 të 9 korrikut 2013 dhe Rev. nr. 48/2003 të 11 shtatorit 2003 të Gjykatës Supreme,

shkelin të drejtat e parashtrueses, të garantuara me nenin 31 dhe 53 të Kushtetutës.

31. Gjykata vëren se, vendimet e kontestuar janë arsyetuar mjaftueshëm, dhe nga to vërehet se Gjykata Supreme, në të dyja rastet, i ka vlerësuar në tërësi rrethanat e rastit, në bazë të të cilave ka bazuar verdiktin e saj, gjë që është juridiksion i plotë i gjykatës në fjalë që të vlerësojë ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjykatat e instancave më të ulëta.
32. Gjatë rrjedhës së procedurës së rregullt, vërehet qartë se, parashtrueses së kërkesës i janë ofruar të gjitha mundësitë e paraqitjes së argumenteve, fakteve dhe provave, para atyre gjykatave, përkitazi me shkeljen e të drejtave kushtetuese të pretenduara. Nuk është detyrë e Gjykatës të shqyrtojë vendimet e gjykatave të rregullta thjesht sepse parashtruesja e kërkesës nuk është ndarë e kënaqur me rezultatin e vendimeve të gjykatave të rregullta.
33. Gjykata duhet t'ia përkujtojë parashtrueses, se Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e shkallës së katërt që të vlerësojë ligjshmërinë dhe saktësinë e vendimeve të dhëna nga gjykatat e rregullta, përveç nëse ka prova bindëse se vendimet e tilla janë dhënë në një mënyrë dukshëm të padrejtë dhe të paqartë. Është detyrë e gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (shih, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM], Nr. 30544/96, 28, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ] 1999-I.).
34. Në rastin konkret, parashtruesja nuk ka paraqitur asnjë provë që tregon se shkeljet e pretenduara, të përmendura në kërkesë, përbëjnë elemente të shkeljes së të drejtave të garantuara me Kushtetutë (shih, Vanek kundër Republikës Sllovaqe, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, i 31 majit 2005).
35. Prandaj, Gjykata nuk mund të konsiderojë se procedurat përkatëse të zhvilluara në Gjykatën Supreme kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, *Shub vs. Lithuania*, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
36. Nga arsyet e shtjelluara më lart, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtrueses nuk i përmbush kërkesat e kërkuara me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me rregullin 36 (1) c), rregullin 36 (2) b) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 24 janar 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Dr. Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI134/12, N.P.N.T. “ÇLIRIMI”, Aktvendim i datës 13 maj 2013 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. E. nr. 5/2010, të 8 nëntorit 2012

Rasti KI134/12, vendimi i 13 majit 2013.

Fjalët kyçe: Kërkesa individuale, mosshterimi

Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. E. nr.5/2010, të 8 nëntorit 2012. Parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë të urdhërojë Komunën e Glogocit që t'i paguajë atij disa fatura të papaguara. Fillimisht, Gjykata e Qarkut në Prishtinë miratoi kërkesën e parashtruesit. Megjithatë, pasankesës së parashtruar nga Komuna e Glogocit, padia e parashtruesit të kërkesës ishte refuzuar si e pabazuar pasi që gjykata vlerësoi se ka qenë e obligueshme që kontratat e ndërtimit për të cilat ai ishte duke kërkuar pagesën e faturave të papaguara, duhej të ishin në formë të shkruar. Pas ankesës së paraqitur nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata Supreme vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.

Parashtruesi parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese. Në kërkesën e tij, parashtruesi pretendoi se aktgjykimi i kontestuar kishte shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Parashtruesi gjithashtu pretendoi shkeljen e së drejtës së tij të garantuar me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut dhe nenin 10 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut. Në substancë, parashtruesi i kërkesës pretendoi se e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm ishte shkelur për shkak se palët në procedure nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë dhe se argumentet e tij nuk ishin shqyrtuar siç duhet.

Gjykata Kushtetuese e refuzoi kërkesën si të papranueshme sepse parashtruesi nuk i kishte shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion të parashikuara me ligj. Në arsyetimin e saj, Gjykata Kushtetuese theksoi se rregulli i shterimit jo vetëm që kërkon nga parashtruesi i kërkesës që t'i shterë të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në Kosovë, por nga ai po ashtu kërkon që të ketë ngritur shkeljet e pretenduara të të drejtave themelore gjatë procedurës pranë instancave të rregullta gjyqësore. Në këtë rast konkret, Gjykata Kushtetuese konstatoi se parashtruesi nuk kishte dorëzuar asnjë prove që do të tregonte se ai është thirrur në të njëjtat shkelje në Gjykatë në Qarkut dhe në Gjykatën Supreme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI134/12
Parashtrues
N.P.N.T. “ÇLIRIMI”
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të
Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. E. nr. 5/2010, të 8 nëntorit
2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga kompania N.P.N.T. “ÇLIRIMI” (në tekstin e mëtejme: parashtruesi), e përfaqësuar nga z. Sahit Bibaj, avokat në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. E. nr. 5/2010, të 8 nëntorit 2012.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet t’ia ketë shkelur atij të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të

Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 28 dhjetor 2012, parashtruesi parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.
6. Më 10 janar 2013, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Enver Hasani dhe Kadri Kryeziu.

Përmbledhja e fakteve

7. Më 4 tetor 2005, parashtruesi i kërkesës ia paraqiti Komunës së Gllogocit një numër faturash për kryerjen e disa punëve shtesë në rrugë. Sidoqoftë, Komuna refuzoi të paguajë këto fatura për arsye se nuk ekzistonte ndonjë kontratë me shkrim në mes të palëve. Pas kësaj, parashtruesi i kërkesës u ankua te Kryeshefi ekzekutiv i Komunës.
8. Më 20 dhjetor 2005, Kryeshefi ekzekutiv i Kuvendit Komunal të Gllogocit e miratoi pagesën e vetëm njërës nga faturat e paraqitura, dhe e urdhëroi Drejtorinë Komunale të Financave që ta përmbaronte aktvendimin.
9. Më 15 janar 2006, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë për pagesën e faturave të papaguara nga Komuna e Gllogocit.
10. Më 16 shkurt 2006, Gjykata e Qarkut (Aktvendimi E. nr. 30/2006) e miratoi përmbarimin e kërkesëpadisë së parashtruesit. Ndërkohë, Komuna paraqiti ankesë kundër këtij aktvendimi në Gjykatën e Qarkut.
11. Më 25 korrik 2006, Gjykata e Qarkut mbajti një shqyrtim dhe vendosi të caktojë dy ekspertë për rastin për përgatitjen e një ekspertize. Të gjeturat e ekspertëve siç duket e mbështetnin kërkesën e parashtruesit.
12. Më 17 korrik 2007, Gjykata e Qarkut mbajti edhe një shqyrtim dhe po të njëjtën ditë e shfuqizoi (Aktgjykimi nr. II. C. nr. 49/2006) vendimin e saj të mëhershëm (E. nr. 30/2006) duke refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesit si të pabazuar, pasi që ka qenë e obligueshme që kontratat e tilla të ndërtimit të jenë në formë të

shkruar e jo në formë të marrëveshjes gojore me Kryeshefin ekzekutiv të Kuvendit Komunal të Glllogocit siç ka bërë parashtruesi i kërkesës.

13. Më 2 nëntor 2007, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër Aktgjykimit Nr. II. C. nr. 49/2006 pranë Gjykatës Supreme duke pretenduar shkelje të rëndë të dispozitave të procedurës civile, konstatim jo të plotë dhe të gabueshëm të gjendjes faktike dhe zbatim të gabueshëm të së drejtës materiale. Parashtruesi i kërkesës më tej argumentoi se punët shtesë ishin miratuar nga Komiteti Komunal për Politikë dhe Financa më 11 dhjetor 2003 dhe se, në bazë të nenit 73 të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore, në rastet kur kontrata nuk është me shkrim por është përmbartuar në tërësi apo në pjesën më të madhe, kontrata është e vlefshme.
14. Më 23 qershor 2010, Gjykata Supreme (Aktgjykimi A. e. nr. 135/2007) e refuzoi ankesën si të pabazuar dhe e vërtetoi aktgjykimin e kontestuar me arsyetimin se Gjykata e Qarkut e kishte vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike dhe e kishte zbatuar të drejtën materiale kur kishte vendosur se kërkesëpadia e parashtruesit ishte e pabazuar. Gjykata më tej theksoi se, në bazë të nenit 633 të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore, kontratat e ndërtimit duhet të përpilohen me shkrim dhe për çdo shmangie nga projekti i ndërtimit respektivisht nga punimet e kontraktuara, kryerësi duhet të ketë pëlqimin me shkrim të porositesit dhe se ai nuk mund të kërkojë ngritje të çmimit të kontraktuar për punimet që i ka kryer pa pëlqimin e këtillë.
15. Më 8 korrik 2010, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme, me kërkesë që të shfuqizojë aktgjykimet e kontestuar dhe të miratojë kërkesëpadinë e tij duke argumentuar se Gjykata Supreme nuk kishte arsyetuar në mënyrën e duhur refuzimin e këtyre kërkesëpadive.
16. Më 8 nëntor 2012, Gjykata Supreme [Aktgjykimi Rev. E. nr. 5/2010] e refuzoi revizionin e parashtruesit si të pabazuar dhe e vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të 17 korrikut 2007, duke theksuar se Gjykata e Qarkut kishte hedhur poshtë kërkesëpadinë e parashtruesit pasi që i njëjti nuk ka qenë i autorizuar që ta ndryshojë projektin pa pëlqimin me shkrim për punët shtesë nga ana e porositesit/investitorit dhe se, rrjedhimisht, obligimi i të paditurës për t'ia paguar parashtruesit shumën kontestuese nuk mund të qëndronte. Gjykata më tej theksoi se aktgjykimi i ankimuar nuk përmbante ndonjë shkelje të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, në kundërshtim me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, i janë shkelur të drejtat për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, pasi që palët në këtë procedurë nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë dhe se gjykatat nuk i kanë shqyrtuar provat dhe faktet e ofruara nga parashtruesi i kërkesës. Parashtruesi më tej argumenton se Gjykata e Qarkut si dhe Gjykata Supreme nuk kanë dhënë arsye bindëse për refuzimin e rastit të tij si dhe kanë zbatuar gabueshëm të drejtën materiale.
18. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se ka shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së dhe nenit 10 të Deklaratës Universale.

Pranueshmëria e kërkesës

19. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, në revizionin e paraqitur në Gjykatën Supreme, pretendon se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe përshkruan në hollësi se si është dashur që gjykatat të zbatojnë nenet përkatëse të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore dhe të Ligjit për Prokurimin Publik.
20. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

21. I njëjti parim është përcaktuar në nenin 47.2 të Ligjit.
22. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 21.4 të Kushtetutës, i cili parasheh:

“Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”.

Rrjedhimisht, kompania N.P.N.T. “ÇLIRIMI” ka të drejtë të parashtojë ankesë kushtetuese në këtë Gjykatë duke u thirrur në shkelje të të drejtave dhe lirive kushtetuese, në të njëjtën mënyrë, megjithëse “për aq sa janë të zbatueshme” si individë. Kjo do të

thotë se parashtruesi i kërkesës po ashtu e ka për obligim që të shterë të gjitha mjetet juridike ashtu siç kërkohet edhe nga individët që të bëjnë një gjë të tillë, siç përcaktohet me nenin e lartcekur 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47.2 të Ligjit.

23. Gjykata thekson më tej se me rregullin e shterimit jo vetëm që kërkohet nga parashtruesi i kërkesës që, para se të parashtrojë kërkesë në Gjykatë, të shterë të gjitha mjetet juridike që i ka në dispozicion në bazë të ligjit në Kosovë, përfshirë edhe gjykatën e instancës më të lartë, por nga ai po ashtu kërkohet që të ketë ngritur shkeljet e pretenduara të të drejtave themelore gjatë procedurës pranë këtyre instancave.
24. Arsyeja për rregullin e shterimit sipas interpretimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (shih, nenin 53 të Kushtetutës), është që t'u ofrohet mundësia autoriteteve përkatëse, përfshirë gjykatat, që të parandalojnë ose korrigjojnë shkeljen e pretenduar të Kushtetutës kundër tyre para se këto pretendime të ngritën në Gjykatën Kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, Selmouni kundër Francës, GJEDNJ, nr. 25803/94, Aktgjykimi i 28 korrikut 1999).
25. Rrjedhimisht, autoritetet në fjalë, duke përfshirë gjykatatpërkatëse, lirohen ngapërgjegjësiapara GjykatësKushtetuese për veprimet e tyre, para se të kenë pasurnjëmundësi për të korrigjuar gjëratpërmesprocedurave të veta.Ky rregull bazohetnë supoziminse rendi juridiki Kosovësdo tësigurojë njëmjete efektivnë lidhje meshkeljen/shkeljet e pretenduaratë të drejtave kushtetuese. Në këtë mënyrë, kyështënjë aspekt i rëndësishëmi parimitqëmekanizmi mbrojtës iGjykatës Kushtetuese,i përcaktuar me Kushtetutëështë subsidiar në raport mesistemetgjyqësore që mbrojnë të drejtat e njeriut.
26. Kështu, ankesa të cilën parashtruesi e ka dorëzuar në Gjykatë, është dashur fillimisht të dorëzohej-së paku në esencë-tek autoriteti/autoritetet përkatëse, përfshirë gjykatat kompetente, dhe në pajtim me kriteret procedurale, duke i respektuar afatet, të përcaktuara me ligjet e Kosovës (shih, *mutatis mutandis*, Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 7 dhjetorit 1976, Seria A nr. 24, f. 22, para 48 dhe Cardot kundër Francës, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 19 marsit 1991, Seria A nr. 200, f. 18, para. 34 si dhe rasti nr. KI41/09, Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, Aktvendim i Gjykatës Kushtetuese së 27 janarit 2010).

27. Në pajtim me praktikën gjyqësore të lartcekur të GJEDNJ-së, të cilën Gjykata duhet ta zbatojë vazhdimisht gjatë interpretimit të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kushtetutë, siç parashihet me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, nuk është e domosdoshme që një parashtrues të ketë përmendur nenet e sakta të Kushtetutës apo të instrumenteve të zbatueshme ndërkombëtare në procedurën tek autoritetet përkatëse, duke përfshirë gjykatat. Përderisa shkelja e të drejtave themelore, të cilën parashtruesi i kërkesës e ngrit pranë kësaj Gjykate, të jetë ngritur në mënyrë implicite apo në esencë në procedurën përkatëse, është respektuar rregulli i shterimit (shih, *mutatis mutandis*, GJENDJ, Azianas kundër Qipros, nr. 56679/00, aktgjykimi i 28 prillit 2004).
28. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se nga parashtruesit kërkohet që të shterin vetëm mjetet që janë në dispozicion dhe që janë efektive (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Cinar kundër Turqisë, nr. 28602/95, aktgjykimi i 13 nëntorit 2003).
29. Sa i përket ankesave të ngritura në Gjykatën Kushtetuese, duhet të konstatohet se parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar asnjë provë, me të cilën do të tregonte se, gjatë procedurës në Gjykatën e Qarkut dhe në Gjykatën Supreme në instancën e fundit, ai është thirrur në shkeljen e nenit 21.4 dhe 31 të Kushtetutës si dhe të nenit 6 të KEDNJ-së dhe nenit 10 të Deklaratës Universale, madje as në mënyrë implicite e as në esencë.
30. Prandaj Gjykata konsideron se në kundërshtim me kërkesat e nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit, parashtruesi nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj.
31. Nga kjo rrjedh se kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) c) dhe 56 (2) Rregullores, në seancën e mbajtur më 13 maj 2013, **njezëri**

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI157/13, Emin Maxhuni, Aktvendim i datës 20 janar 2014 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, nr. GSK-KPA-A-27/12, të 30 tetorit 2012

Rasti KI157/13, vendimi i 20 janarit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kontest civil, e drejta për gjykim të drejtë, qartazi e pabazuar.

Në këtë rast, parashtuesi pretendonte se vendimi i kontestuar ishte nxjerr me shkelje flagrante të dispozitave kushtetuese, për faktin se Kolegji i Apelit i AKP-së i DHPGJS-së vendosi në mënyrë arbitrare dhe jotransparente përkritazi me zgjidhjen e kontestit pronësor. Parashtuesi pretendonte se vendimi i kontestuar shkeli të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së.

Megjithatë, Gjykata konsideroi se parashtuesi nuk kishte saktësuar si dhe pse Kolegji i Apelit i AKP-së, ia kishte shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij, përkatësisht të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me Kushtetutë dhe KEDNJ, kur ka konkluduar se ai “nuk e ka dëshmuar të drejtën e tij pronësore (...) ndaj banesave kontestuese”. Prandaj, Gjykata konsideroi se parashtuesi nuk dëshmoi dhe provoi në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

Për më tepër, Gjykata ritheksoi se nuk mund të vepronte si gjykatë e shkallës së katërt, përkritazi me vendimet e nxjerra nga Kolegji i Apelit të AKP-së, sepse është domen i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale, Në këtë kontekst iu referua mutatis mutandis rastit Garcia Ruiz kundër Spanjës, nr. 30544/96, § 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1.

Si përmbledhje, Gjykata, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) c) dhe 36 (2) d) të Rregullores së punës, konkludoi se kërkesa ishte qartazi e pabazuar dhe rrjedhimisht e papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI157/13
Parashtrues
Emin Maxhuni
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të
Apelit
të AKP-së të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës,
nr. GSK-KPA-A-27/12, të 30 tetorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Emin Maxhuni, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, nr. GSK-KPA-A-27/12, të 30 tetorit 2012 (në tekstin e mëtejme: Vendimi i kontestuar), të cilin parashtruesi pohon se e ka pranuar më 16 shtator 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet të ketë shkelur paragrafin 1 dhe 2 të nenit 3 [Barazia para Ligjit] lidhur me nenin 24 [Barazia para Ligjit]; paragrafi 1 dhe 2 të nenit 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; paragrafi 1, 2 dhe 3 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës]; nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]; paragrafi 2, 3 dhe 5 të nenit 102 [Parimet e

Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të gjithë të Kushtetutës dhe nenit 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt Gjyqësor] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit nr. 03/L-121, për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 28 tetor 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën e tij.
6. Më 28 tetor 2013, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 12 nëntor 2013, Gjykata e informoi parashtruesin e kërkesës, Kolegjin e Apelit të AKP-së së Gjykatës Supreme, Agjencinë Kosovare për Pronë (në tekstin e mëtejme: AKP) dhe palët e përfshira në procedurë, për regjistrimin e kësaj kërkesë.
8. Më 20 janar 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Në vitin 1991, parashtruesi e kishte themeluar ndërmarrjen private “Marigona Commerce”.
10. Më 27 nëntor 1996, ndërmarrja lidhi kontratë (kontrata nr. 02-2853/1) me BVI-në (Bashkësia Vetëqeverisëse e Interesit), tani Ndërmarrja Publike Banësore në Prishtinë për investime të përbashkëta përkritazi me ndërtimin e dy banesave në Prishtinë.
11. Ndërmarrja “Marigona Commerce” ka punuar deri në vitin 1999, kur e gjithë pasuria e saj ishte shkatërruar, me përjashtim të dy banesave kontestuese. Si pasojë e kësaj, parashtruesi e kishte ndërprerë biznesin e tij. Më pas, Administrata e UNMIK-ut, me

Rregulloren 2000/8, kishte urdhëruar regjistrimin e bizneseve. Sidoqoftë, parashtruesi nuk e kishte regjistruar biznesin e tij.

12. Parashtruesi nuk i mori në pronësi banesat, sepse ndërtimi i objektit ku gjendeshin dy banesat kontestuese nuk kishte përfunduar. Prandaj, parashtruesi pohon se palët kundërshtarë i morën dy banesat ilegalisht në posedim.
13. Më 5 shkurt 2008, parashtruesi kërkoi nga AKP-ja kthimin dy banesave kontestuese në pronësi të tij.
14. Më 26 tetor 2011, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) ia pranoi (KPCC/D/R/130/2011) parashtruesit të kërkesës të drejtën e pronësisë dhe të posedimit për dy banesat kontestuese.
15. Më 25 maj 2012, ai vendim iu dorëzua palëve përgjegjëse.
16. Më 26 maj 2012, palët përgjegjëse, ushtruan ankesë te Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme, duke pretenduar që vendimi i KKPK-së ishte bazuar në dokumentacion të falsifikuar.
17. Më 30 tetor 2012, Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme (GJK-KPA-A-27/12) e aprovoi si të bazuar ankesën e palëve përgjegjëse dhe ndryshoi Vendimin e KKPK-së, nr. KPCC/D/R/130/2011, të 26 shkurtit 2011. Kolegji i Apelit kishte konstatuar se parashtruesi *“nuk e ka dëshmuar të drejtën e tij pronësore ose ndonjë të drejtë tjetër pronësore ndaj banesave kontestuese”* dhe pastaj ai *“nuk ka të drejtë në të drejtën që rrjedh nga kontrata për investimin e përbashkët në ndërtimin banesor”*.
18. Kolegji i Apelit të AKP-së më tutje arsyeton se, *“Kontrata lidhur me financimin e ndërtimit të dy banesave kontestuese nuk është lidhur me Ndërmarrjes Publike Banesore dhe palës përgjegjëse në ankesësi person fizik, por ndërmjet Ndërmarrjes Publike Banesore dhe kompanisë “Marigona Comerc”. Kjo kompani dhe pasuria e saj duhet të dallohet nga pala përgjegjëse në ankesë dhe pasuria e tij si palë fizike”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi pretendon se vendimi i kontestuar është marrë me shkelje flagrante të dispozitave kushtetuese, për faktin se Kolegji i Apelit i AKP-së i DHPGJS-së vendosi në mënyrë arbitrare dhe jotransparente përkritazi me zgjidhjen e kontestit pronësor.

20. Parashtruesi pretendon se vendimi i kontestuar kryesisht e shkel të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së.

Pranueshmëria e kërkesës

21. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tutje në Ligj dhe Rregullore të punës të Gjykatës.

22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës, që parasheh:

1. “Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

23. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh se:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

24. Përveç kësaj, rregulli 36 (1) c) dhe 36 (2) d) i Rregullores së punës, parasheh se:

(1) “Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

[...]

c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

Parashtruesi pretendon se Kolegji i Apelit i AKP-së të Gjykatës Supreme ka vendosur në mënyrë arbitrare dhe jotransparente me rastin e zgjidhjes së këtij kontesti pronësor. Megjithatë, parashtruesi nuk ndërton një argument dhe nuk paraqet dëshmi për shkeljen e pretenduar.

25. Gjykata Kushtetuese konsideron se parashtruesi nuk ka saktësuar si dhe pse Kolegji i Apelit i AKP-së, i ka shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij, përkatësisht të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me Kushtetutë dhe KEDNJ, kur ka konkluduar se ai *“nuk e ka dëshmuar të drejtën e tij pronësore (...) ndaj banesave kontestuese”*.
26. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk ka dëshmuar dhe provuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.
27. Përveç kësaj, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit i AKP-së theksoi se, *“kontrata në lidhje me financimin e ndërtimit të dy banesave kontestuese ishte (...) lidhur ndërmjet (...) Ndërmarrjes Publike Banesore dhe ndërmarrjes Marigona-Comerce. Kjo kompani dhe pasuria e saj duhet të dallohet nga pala përgjegjëse në ankesë [parashtruesi] dhe pasuria e tij si palë fizike”*.
28. Prandaj, Gjykata nuk mund të konkludojë se parashtruesi ishte privuar në mënyrë arbitrare nga të drejtat e tij si palë në këtë kontest pronësor dhe se vendimi i kontestuar ishte marrë me shkelje të Kushtetutës.
29. Në të vërtetë, Kolegji i Apelit i AKP-së kishte konstatuar se parashtruesi, në cilësinë e personit fizik, nuk gëzon të drejtën e pronësisë mbi banesat kontestuese, pasi që pasuria e ndërmarrjes “Marigona Commerce” nuk mund të konsiderohet të jetë pronë e parashtruesit. Si përmbledhje, pasi që parashtruesi nuk ka dëshmuar se e drejta e pronësisë dhe e posedimit të banesave kontestuese i takonte atij personalisht, nuk mund të konsiderohet se ka pasur shkelje të të drejtave të tij personale.
30. Për më tepër, Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga Kolegji i Apelit të AKP-së. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, § 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).

31. Në të kundërtën, Gjykata konsideron se parashtuesi nuk ka paraqitur asnjë provë që tregon se shkelja e pretenduar përbën elemente të pakontestuarra të shkeljes së të drejtave kushtetuese (shih, *Vanek kundër Republikës Sllovaqe*, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, i 31 majit 2005).
32. Përveç kësaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të konsiderojë si të bazuar pretendimin se, procedurat në Kolegjin e Apelit të AKP-së kanë qenë jotransparente ose në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, *Shub vs. Lithuania*, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
33. Prandaj, Gjykata gjen se parashtuesi as nuk e ka mbështetur dhe as nuk e ka dëshmuar pretendimin e tij për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.
34. Rrjedhimisht, nuk ka nevojë logjike dhe praktike për shqyrtim të mëtejme të shkeljeve tjera të pretenduara (të së drejtës për Barazi para Ligjit, Mbrojtjes së Pronës, Mbrojtjes Gjyqësore të së Drejtave dhe Parimeve të Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor), siç janë të përmbledhura dhe të përfshira në pretendimin për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.
35. Si përmbledhje, Gjykata konkludon se kërkesa, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) c) dhe 36 (2) d) të Rregullores së punës, është qartazi e pabazuar dhe rrjedhimisht e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 113. 7 të Kushtetutës, nenit 48 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) c), 36 (2) d) dhe rregullit 56 (2) të Rregullores së punës, me 20 janar 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. TË DEKLAROJË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI112/13, Bajram Sfishta, Aktvendim i datës 2 dhjetor 2013 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Vendimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC-11-0035, të 23 nëntorit 2012

Rasti KI112/13, vendimi i 2 dhjetorit 2013.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, e drejta e pronës, jashtë afatit kohor

Parashtruesi e parashtroi kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 dhe rregullit 56 paragrafi 2 i Rregullores së punës.

Parashtruesi i është drejtuar Gjykatës sepse vendimi i kontestuar ASC-11-0035, siç pretendohet, ia kishte mohuar “të drejtën në një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i Ndërmarrjes shoqërore "Ramiz Sadiku" nga Prishtina.

Në këtë drejtim, parashtruesi nuk thirret në asnjë shkelje të ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti.

Nga dokumentet e dorëzuara, Gjykata konstatoi se parashtruesi i kërkesës e ka dorëzuar kërkesën e tij më 25 korrik 2013, përderisa vendimi i fundit i Dhomës së Posaçme i është dorëzuar atij më 15 janar 2013. Parashtruesi kishte dorëzuar kërkesën e tij në Gjykatë dyzet (40) ditë më vonë se afati ligjor i paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.

Në bazë të kësaj, Gjykata e hodhi poshtë kërkesën sepse është e paafatshme.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në**

Rastin Nr. KI112/13

Parashtrues

Bajram Sfishta

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Kolegjit të
Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të
Kosovës, ASC-11-0035,
të 23 nëntorit 2012**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Bajram Sfishta (në tekstin e mëtejme: parashtruesi), me vendbanim në Podujevë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Vendimin e Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC-11-0035, të 23 nëntorit 2012, i cili i është dorëzuar atij më 15 janar 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet ta ketë ka mohuar *“të drejtën e parashtruesit të kërkesës në një pjesë të të ardhurave, të fituara nga privatizimi i Ndërmarrjes shoqërore “Ramiz Sadiku” në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: NSH “Ramiz Sadiku”)”*.
4. Në këtë drejtim, parashtruesi nuk thirret në asnjë shkelje të ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-121(në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 56të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 25 korrik 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 5 gusht 2013, Kryetari me Vendimin Nr. GJR. KI112/13, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Në të njëjtën ditë, Kryetari me Vendimin Nr. KSH. KI112/13, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
8. Më 26 gusht 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Agjencia Kosovare e Privatizimit(në tekstin e mëtejme: AKP-ja) u njoftua lidhur me kërkesën.
9. Më 24 shtator 2013, Gjykata kërkoi nga parashtruesi të dorëzojë dokumente shitesë. Të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Dhomen e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me kërkesën (në tekstin e mëtejme: Dhoma e Posaçme).
10. Më 2 dhjetor 2013, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues ia rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Në një periudhë kohore, parashtruesi ishte i punësuar si punonjës i NSH “Ramiz Sadiku”.
12. NSH “Ramiz Sadiku”u privatizua më 27 qershor 2006.
13. Më 4, 5 dhe 7 mars 2009, AKP-ja publikoi listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar për një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH “Ramiz Sadiku” së bashku me afatin e fundit

ligjor për të ushtruar ankesë kundër kësaj liste, që ishte 27 marsi 2009.

14. Më 30 qershor 2009, parashtruesi ushtroi ankesë në Trupin gjykues të Dhomës së Posaçme kundër listës përfundimtare të punëtorëve.
15. Më 24 shkurt 2011, Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme me Vendimin SCEL-09-0001 vendosi se ankesa e parashtruesit të kërkesës kundër listës përfundimtare të punëtorëve ishte paraqitur pas afatit ligjor. Trupi gjykues e hodhi poshtë ankesën si të papranueshme.
16. Parashtruesi ushtroi ankesë në Kolegjin për Ankesa të Dhomës së Posaçme kundër Vendimit të Trupit gjykues, SCEL-09-0001, të 24 shkurtit 2011.
17. Më 23 nëntor 2012, Kolegji për Ankesa i Dhomës së Posaçme, me Vendimin ASC-11-0035, e vërtetoi Vendimin e Trupit gjykues, SCEL-09-0001, të 24 shkurtit 2011.
18. Kolegji për Ankesa i Dhomës së Posaçme me Vendimin ASC-11-0035, të 23 nëntorit 2012, arsyetoi ndër të tjera se: “...Trupi gjykues e vlerësoi drejt ankesën kundër listës përfundimtare, të cilën ai (parashtruesi) e kishte paraqitur më 27 mars 2009, si të paafatshme. Pasi që ankuesi (parashtruesi) nuk kishte paraqitur një kërkesë për rikthim pranë Trupit gjykues, nuk është relevante nëse atij i ka ikur afati për fajin e tij apo jo”.

Pretendimet e parashtruesit

19. Parashtruesi pretendon se “ai kishte punuar në NSH ‘Ramiz Sadiku’ në Prishtinë për shumë vite deri më 28 shkurt 1990, kur forcat serbe e dëbuan me dhunë nga puna dhe e diskriminuan atë”.
20. Parashtruesi pretendon se në kohën kur ishin publikuar emrat në gazetat ditore të Kosovës, ai kishte qenë i sëmure dhe nuk i kishte parë emrat. Për më tepër, ai pretendon se sapo u informua për privatizimin përmes shokëve të tij, ai paraqiti padi në AKP, por kërkesa e tij u refuzua si e paafatshme.
21. Parashtruesi pretendon se ishin shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë në dëm të tij nga AKP-ja dhe Dhoma e Posaçme, sepse ai kishte kontribuar në NSH “Ramiz Sadiku” për

shumë vite dhe prandaj ai pretendon se ka të drejtë në një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së në fjalë.

22. Parashtruesi nuk ishte thirrur në asnjë dispozitë kushtetuese në veçanti.

Pranueshmëria e kërkesës

23. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, duhet së pari të vlerësojë nëse ai i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri të parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.

24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

25. Gjykata vëren se parashtruesi kishte ushtruar ankesë në AKP dhe më pas në Trupin gjykues dhe Kolegjin për Ankesa të Dhomës së Posaçme. Parashtruesi i ka shterur të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohen me nenin 113.7 të Kushtetutës.

26. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të llogaritet që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor(...)”.

27. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36(1)b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

...

b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi...”.

28. Nga dokumentet e dorëzuara, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e ka dorëzuar kërkesën e tij më 25 korrik 2013, përderisa

vendimi i fundit i Dhomës së Posaçme i është dorëzuar atij më 15 janar 2013. Parashtruesi kishte dorëzuar kërkesën e tij në Gjykatë dyzet (40) ditë më vonë se afati ligjor i paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.

29. Nga kjo rrjedh sekërkesa është e paafatshme.
30. Prandaj, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 56 (2) Rregullores së punës, më 2 dhjetor 2013, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Arta Rama-Hajrizi

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI195/13, Asllan Krasniqi, Aktvendim i datës 21 janar 2014 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev. nr. 126/2012, të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 2 gushtit 2013

Rasti KI195/13, vendimi i 21 janarit 2014.

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, qartazi e pabazuar.

Parashtruesi pretendon se atij i janë shkelur të drejtat kushtetuese pronësore dhe e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjakovë, C. nr. 11/2008, të 21 prillit 2011 dhe me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 470/2011, të 19 marsit 2012. Ai më tej pretendon se Gjykata Supreme e Kosovës nuk e ka korrigjuar shkeljen e të drejtave të tij të njeriut, të garantuara me Kushtetutë.

Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës as nuk i ka përshkruar faktet e rastit dhe as nuk i ka dëshmuar ankesat e tij. Në vend të kësaj, ai vetëm ka argumentuar se parashtresat e tij nuk janë marrë parasysh dhe prandaj pretendon se i janë shkelur të drejtat e njeriut, veçanërisht ato pronësore dhe e drejta për gjykim të drejtë.

Si përmbledhje, parashtruesi as nuk e ka ndërtuar rastin mbi shkeljen e ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë dhe as që ka ofruar ndonjë provë *prima facie* për atë shkelje.

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, më 21 janar 2014, njëzëri deklaroi kërkesën si qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI195/13
Parashtrues
Asllan Krasniqi
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev. nr.
126/2012, të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 2 gushtit
2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u dorëzua nga z. Asllan Krasniqi (në tekstin e mëtejme: parashtruesi) me vendbanim në Gjakovë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 126/2012, të 2 gushtit 2013, i cili iu dorëzua atij më 10 tetor 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 126/12, të 2 gushtit 2013. Me këtë aktgjykim, revizioni i parashtruesit të kërkesës, i paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 470/2011, të 19 marsit 2012, lidhur me njohjen e të drejtave të tij të bashkëpronësisë në paluajtshmëri, ishte refuzuar si i pabazuar.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 12 nëntor 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 2 dhjetor 2013, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI195/13, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI195/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.
7. Më 11 dhjetor 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të dorëzojë Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 470/2011, të 19 marsit 2012 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjakovë, C. nr. 11/2008, të 21 prillit 2011.
8. Më 11 dhjetor 2013, Gjykata gjithashtu njoftoi Gjykatën Supreme të Kosovës për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 20 dhjetor 2013, parashtruesi dorëzoi në Gjykatë kopjet e aktgjykimeve të kërkuara.
10. Më 21 janar 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandim për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesi i kërkesës nuk i ka përshkruar faktet e rastit. Në vend të kësaj, ai kërkoi nga Gjykata t'i shqyrtojë të gjitha parashtruesat që ai i kishte ofruar në procedura para gjykatave të rregullta. Në këtë drejtim, ai i kishte bashkëngjitur kopjet e aktgjykimeve përkatëse.
12. Nga këto aktgjykime mund të vërtetohet si në vijim:

13. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës, së bashku me katër vëllezërit e tij, kishte iniciuar procedurën civile kundër I. K. për vërtetimin e së drejtës së bashkëpronësisë në paluajtshmërinë në sipërfaqe prej 215.5 m², të regjistruar në ngastrën kadastrale nr. 189/2 ZK Rogovë. Parashtruesi dhe vëllezërit e tij gjithashtu kërkuan dorëzimin e posedimit të paluajtshmërisë kontestuese.
14. Më 21 prill 2011, Gjykata Komunale në Gjakovë nxori aktgjykimin, me të cilin ishte refuzuar kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës si e pazbatueshme.
15. Gjykata Komunale e refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit, sepse gjeti se marrëveshja për ndarjen fizike të pronës ishte e nënshkruar në mes të babait të ndjerë të parashtruesit të kërkesës dhe babait të ndjerë të I. K. (të cilët ishin vëllezër), dhe e vërtetuar nga Gjykata Komunale në Prizren, më 30 dhjetor 1963, duke paraqitur bazë të vlefshme juridike për fitimin e së drejtës pronësore, në pajtim me nenin 20 të Ligjit për marrëdhënie pronësore juridike.
16. Parashtruesi dhe vëllezërit e tij ushtruan ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë.
17. Më 19 mars 2012, Gjykata e Qarkut në Pejë, me Aktgjykimin Ac. nr. 470/2011, e refuzoi ankesën e lartpërmendur. Në arsyetim, Gjykata e Qarkut theksoi ndër të tjera se, *“qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj e aprovon edhe Gjykata e shkallës së dytë për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 i LPK, të cilat Gjykata e shkallës së dytë i vështtron sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK. Gjendja faktike të cilën e ka vërtetuar Gjykata e shkallës së parë nuk vihet në pyetje në procedurën ankimore. Me ankesë përsëriten dhe parashtrohen çështjet të cilat janë vlerësuar nga Gjykata e shkallës së parë gjatë shqyrtimit të raportit juridiko-kontestues dhe për të cilat Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftuara juridike dhe faktike dhe të bazuara në Ligj”*.
18. Pas kësaj, parashtruesi dhe vëllezërit e tij ushtruan revizion në Gjykatën Supreme. Ata pretendonin se Gjykata e Qarkut i kishte shkelur dispozitat e Ligjit për procedurën kontestimore (LPK), në veçanti nenin 188 të LPK-së, dhe se Gjykata e Qarkut në Pejë ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale.
19. Më 2 gusht 2013, Gjykata Supreme e Kosovës nxori Aktgjykimin Rev. 126/2012 dhe e refuzoi revizionin e lartcekur.

20. Gjykata Supreme, në arsyetim, ritheksoi se, *“Faktin se patundshmëria e të paditurit ka sipërfaqe më të madhe, gjykata e shkallës së parë e ka pasur parasysh, por duke marrë për bazë se ndarja është bërë në bazë të bonitetit dhe pozitës së parcelave, me të cilën ndarje janë pajtuar paraardhësit e palëve ndërgjyqëse, të cilët kanë hyrë në posedim pa ndonjë vërejtje nga pala tjetër, dhe pasardhësit -këtu palët ndërgjyqëse, kanë vazhduar shfrytëzimin dhe posedimin nga viti 1963 e tutje ndërsa paditësit nuk i kanë kundërshtuar deri në vitin 2008 kur kanë paraqitur padinë, ...”*.
21. Gjykata Supreme theksoi në vijim: *“Në revizionin e paditësve vetëm në mënyrë të përgjithësuar thuhet se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët përmbajnë shkelje esenciale të dispozitës ligjore nga neni 182 par. 2 pika (n) të LPK, pa u sqaruar konkretisht se cilat janë ato shkelje, ..., kjo Gjykatë vlerëson se janë të pabazuara thëniet e revizionit përkitazi me shkeljet thelbësore të dispozitës ligjore të cekur më lart. Në revizion është cekur se aktgjykimi i kundërshtuar është marrë në bazë të shkeljes së dispozitës ligjore nga neni 188 i LPK, Gjykata Supreme e shqyrtoi këtë pretendim, por e njëjta dispozitë ka të bëjë me përgjigjen në ankesë dhe nuk ka të bëjë me shqyrtimin sipas revizionit”*.

Pretendimet e parashtruesit

22. Parashtruesi pretendon se atij i janë shkelur të drejtat kushtetuese pronësore dhe e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjakovë, C. nr. 11/2008, të 21 prillit 2011 dhe me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 470/2011, të 19 marsit 2012. Ai më tej pretendon se Gjykata Supreme e Kosovës nuk e ka korrigjuar shkeljen e të drejtave të tij të njeriut, të garantuara me Kushtetutë.
23. Parashtruesi më tej deklaroi si në vijim: *“Janë shkelur të drejtat e mija të përcaktuara me nenet 21, 22, 31, 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 5 dhe 6 të KEDNJ”*.

Pranueshmëria e kërkesës

24. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet që së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

25. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës as nuk i ka përshkruar faktet e rastit dhe as nuk i ka dëshmuar ankesat e tij. Në vend të kësaj, ai vetëm ka argumentuar se parashtresat e tij nuk janë marrë parasysh dhe prandaj pretendon se i janë shkelur të drejtat e njeriut, veçanërisht ato pronësore dhe e drejta për gjykim të drejtë.
26. Në këtë drejtim, Gjykata merr parasysh rregullin 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:(c) kërkesa është qartazi e bazuar”.

27. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë), që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata Supreme, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).
28. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese ripërsërit se nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t’i interpretojnë dhe t’i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ] 1999-1, shih gjithashtu Aktvendimin për papranueshmëri në rastin KI70/11, parashtrues Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. Nr. 983/08, të 7 shkurtit 2011).
29. Gjykata Kushtetuese vëren se parashtruesi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me Ligjin për procedurën kontestimore, duke ushtruar revizion kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe se Gjykata Supreme mori parasysh këtë dhe vërtet iu përgjigj ankesave të tij në çështjet e ligjit.
30. Prandaj, Gjykata konsideron se nuk ka asgjë në kërkesë që tregon se rastit i mungonte paanshmëria ose që procedurat ishin në ndonjë mënyrë të padrejta (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
31. Si përmbledhje, parashtruesi as nuk e ka ndërtuar rastin mbi shkeljen e ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë dhe as që ka ofruar ndonjë provë *prima facie* për atë shkelje (shih, Vanek

- kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ-së sa i përket pranueshmërisë së kërkesës, Nr. 53363/99, i 31 majit 2005).
32. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se kërkesa është qartazi e pabazuar, në pajtueshmëri me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, më 21 janar 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI139/13, Zorica Đokić, Aktvendim i datës 20 janar 2014 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Njoftimit të Prokurorit të Shtetit, KMLP. I. Nr. 8/13, të 3 majit 2013

Rasti KI139/13, vendimi i 20 janarit 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, qartazi e pabazuar.

Parashtruesja e kërkesës, Zorica Đokić, ka paraqitur kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, ku konteston Njoftimin e Prokurorit të Shtetit, KMLP. I. Nr. 8/13, të 3 majit 2013, me të cilin janë shkelur: neni 3 [Barazia para Ligjit]; neni 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare]; neni 24 [Barazia para Ligjit]; neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike]; neni 46 [Mbrojtja e Pronës]; neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]; neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]; neni 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme]; nenin 156 [Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur Brenda Vendit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; si dhe me nenet përkatëse të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, konkretisht, neni 6 paragrafi 1 [E drejta për një proces të rregullt]; neni 13 [E drejta për zgjidhje efektive]; neni 8 [E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare]; neni 14 [Ndalimi i diskriminimit]; neni 1 i Protokollit 1 të KEDNJ-së [Mbrojtja e pronës] dhe Protokollit 12 [Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit].

Në lidhje me çështjen e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata vlerësoi se kërkesa ishte e papranueshme, sepse parashtruesja e kërkesës nuk e ka ofruar prova se procedurat përkatëse kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta ose arbitrare. Prandaj, Gjykata konsideron se Kërkesa është qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 36 (1) c) dhe 36 (2) d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI139/13
Parashtrues
Zorica Đokić
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Prokurorit të
Shtetit,
KMLP. I. nr. 8/13, të 3 majit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga znj. Zorica Đokić (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës) nga Zajëçari, Serbi.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Njoftimin e Prokurorit të Shtetit KMLP. I. nr. 8/13 të 3 majit 2013, dhe Aktgjykimin e Gjykatës së qarkut në Gjilan, Kž. nr. 251/2012, të 19 nëntorit 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesja pretendon se i janë shkelur të drejtat e saja kushtetuese të garantuara me: nenin 3 [Barazia para Ligjit]; nenin 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare]; nenin 24 [Barazia para Ligjit]; nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike]; nenin 46 [Mbrojtja e Pronës]; nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]; nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]; nenin 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme]; nenin 156 [Refugjatët dhe Personat e

Zhvendosur Brenda Vendit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta); si dhe me nenet përkatëse të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (më tekstin e mëtejme: KEDNJ), konkretisht, neni 6 paragrafi 1 [E drejta për një proces të rregullt]; neni 13 [E drejta për zgjidhje efektive]; neni 8 [E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare]; neni 14 [Ndalimi i diskriminimit]; neni 1 i Protokollit 1 të KEDNJ [Mbrojtja e pronës] dhe Protokollin 12 [Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit].

Baza juridike

4. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56.2 të Rregullores së punës të Gjykatës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 3 shtator 2013, parashtruesja e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 24 shtator 2013, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI139/13, e caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Në të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendim Nr. GJR. KI139/13, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.
7. Më 10 tetor 2013, Gjykata kërkoi nga parashtruesja e kërkesës dokumente shtesë dhe sqarime.
8. Në të njëjtën ditë, Gjykata Supreme u njoftua për kërkesën e parashtruar.
9. Më 18 tetor 2013, parashtruesja i ktheu përgjigje Gjykatës.
10. Më 20 janar 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandim për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Në vitin 2005, parashtruesja paraqiti kërkesë në Komisionin për kërkesa pronësore dhe banesore pranë Drejtoratit për Çështje

Pronësore dhe Banesore (në tekstin e mëtejshëm: DÇPB) për largimin e F. I. nga një banesë në Banjën e Klllokotit, e cila sipas parashtrueses i takonte asaj në pronësi.

12. Më 24 shkurt 2005, DÇPB, nxori Vendimin nr. HPCC/D/170/2005/C duke kërkuar që prona në fjalë të lirohej nga *“çdo person tjetër që banon në pronë...në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e këtij urdhri”*, në të kundërtën, sipas këtij vendimi, personat e tillë do të largoheshin me dhunë. F. I. paraqiti kërkesë kundër këtij vendimi.
13. Më 18 shkurt 2006, DÇPB me Vendimin HPCC/REC/58/2006 e refuzoi si të pabazuar kërkesën e F. I. për rishqyrtim të vendimit.
14. Më 15 shtator 2006, DÇPB ia dorëzoi parashtrueses çelësat e pronës.
15. Më 6 tetor 2006, Prokuroria publike komunale në Gjilan (në tekstin e mëtejshëm: PPK) ngriti aktakuzë me nr. Kt. nr. 1475/2006 në Gjykatën Komunale në Viti (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Komunale) kundër F. I. për cenim të paprekshmërisë së banesave dhe për heqje apo dëmtim të vulave zyrtareose të shenjave, të parapara me nenin 166, përkatësisht 322 të Kodit penal të Kosovës.
16. Më 27 prill 2008, parashtruesja paraqiti fletëparaqitje në Stacionin Policor në Viti, me kërkesë që F. I. *“të shpërngulet nga banesa ime dhe të përgjigjet penalisht e materialisht”*.
17. Më 29 korrik 2009, PPK në Gjilan kishte ngritur një tjetër aktakuzë me nr. Kt. nr. 1235/2009 në Gjykatën Komunale kundër F. I. për cenim të paprekshmërisë së banesave; pushtim të paligjshëm të pronës së paluajtshme; dhe heqje ose dëmtim të vulave zyrtare ose të shenjave, të parapara me nenet 166, 259, përkatësisht 322 të Kodit penal të Kosovës. Përfaqësuesja e parashtrueses në seancë, J. Z., i mbështeti pohimet e PPK-së dhe ndjekjen penale për realizimin e të drejtës së saj pronësore-juridike.
18. Më 4 korrik 2012, Gjykata Komunale, me Aktgjykimin nr. K. nr. 320/2006, e shpalli fajtor F. I. për veprat penale cenim i paprekshmërisë së banesave dhe dëmtim të vulave zyrtare ose të shenjave. Përkitazi me veprën penale për pushtim të paligjshëm të pronës së paluajtshme, Gjykata Komunale nuk e shpalli fajtor F. I. për shkak se kjo vepër *“është parashkruar plotësisht...”, pasi që vepra “është kryer në muajin qershor të viti 1999 dhe ka kaluar afati i ndjekjes penale”*.

19. Kundër këtij Aktgjykimi, F. I. paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut në Gjilan (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Qarkut), me kërkesë për anulimin e Aktgjykimit të Gjykatës komunale (K. nr. 320/2006) dhe që lënda të kthehet në rigjykim ose të ndryshohet duke liruar atë nga fajësia.
20. Më 19 nëntor 2012, Gjykata e qarkut, me Aktgjykimin Kž. nr. 251/12, e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës komunale (K. nr. 320/2006) dhe e liroi F. I. nga të gjitha akuzat për shkak të parashkrimit absolut të veprave penale. Sipas Gjykatës së qarkut *“nga shkresa e lëndës shihet se nga kryerja e veprës penale deri më tash kanë kaluar më shumë se 6 vjet, ndërsa për veprën penale për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor parashkrimi relativ vjen kur kalojnë tri vjet nga kryerja e veprës penale, sipas neni 91, paragrafi 1 dhe 6 i të njëjtit ligj [Ligji penal i Kosovës]. Në rastin konkret nga kryerja e veprës penale deri më sot kanë kaluar 6 vjet, që do të thotë se është arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale”*.
21. Më 17 korrik 2013, parashtruesja paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës për shkak të shkeljes së Kodit penal të Kosovës dhe të Kodit të procedurës penale të Kosovës.
22. Më 3 maj 2013, Prokurori i Shtetit, me Njoftim KMLP. I. nr. 8/13, e njoftoi parashtruesen se nuk ka bazë për iniciimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë. Sipas tij *“Gjykata e Qarkut në Gjilan, me aktgjykim Ap. 251/2012 të datës 19.11.2012, drejt ka konstatuar se në rastin konkret është parashkruar ndjekja penale, për arsye se veprat penale për të cilat i pandehuri është shpallur fajtor me aktgjykim të shkallë së parë P. nr. 320/2006, të datës 04.07.2006, është parashikuar dënimi nga tri vjet burgim, ndërsa në rastin konkret kanë kaluar më shumë se 6 vjet nga koha e kryerjes së veprës penale.”*... ndërsa *“Pohimi i paraqitësit të kërkesës në bazë të shkeljes së dispozitave të procedurës penale që pohon se nuk i është dërguar asnjë ankesë e të pandehurit kundër aktgjykimit të shkallës së parë dhe në atë mënyrë ajo nuk ka mundur t'i përgjigjet ankesës, është pa efekt”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesja e kërkesës pretendon se gjatë procedurës në gjykatat e rregullta i janë shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara me

nenet: 3, 24, 31, 32, 46, 54, 56, 156, 19 dhe 53 të Kushtetutës; të neneve 6, 13, 8, 14 të KEDNJ-së si dhe neni 1 i Protokollin 1 të KEDNJ-së dhe të drejtat e garantuara me Protokollin 12.

24.

25. Parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata që *“të shpallë këtë kërkesë time të pranueshme dhe që aktgjykimet e lartpërmendura të gjykatave të Kosovës ti shpallë jokushtetuese”*.

Pranueshmëria e kërkesës

26. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri të parapara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

27. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

28. Për më tepër, rregulli 36 (1) dhe (2) i Rregullores së punës parasheh:

(1) *“Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse*

...

c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar

(2) *Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

...

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

29. Në rastin konkret, Gjykata vëren se lidhur me të njëjtën pasuri të paluajtshme është duke u zhvilluar edhe kontesti civil në gjykatat e rregullta përkatëse ku si palë është e përfshirë edhe personi juridik “Banja e Kllkotit” si pretenduese e kësaj prone. Megjithatë, në bazë të përgjigjes së parashtrueses drejtuar Gjykatës më 18 tetor 2013, parashtruesja e kërkesës ankohet lidhur me procedurat penale. Përkitazi me procedurat penale parashtruesja e kërkesës

ankohet ndaj konkludimit të Prokurorit të Shtetit se “[...] kanë kaluar më shumë se 6 vjet nga koha e kryerjes së veprës penale [...] dhe pretendon se vendimi i Prokurorit të Shtetit ia cenon të drejtat, pa shpjeguar se përse dhe si ia cenon të drejtat e saj vendimi i kontestuar.

30. Gjykata e thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërinë), që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç nëse dhe për aq sa ato të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Kësisoj, Gjykata nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, kur shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, rastin KI14/13, parashtues i kërkesës Komuna e Podujevës, Aktvendim për Papranueshmëri i 12 marsit 2013).
31. Sa i përket procedurave penale, parashtuesja i kërkesës nuk e ka mbështetur pretendimin në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar prova se i janë cenuar të drejtat dhe liritë nga gjykatat rregullta. Prandaj, Gjykata nuk mund të konkludojë se procedurat përkatëse pranë gjykatave të rregullta kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta ose arbitrare (Shih rastin KI14/13, parashtues i kërkesës Komuna e Podujevës, Aktvendim për Papranueshmëri i 12 marsit 2013).
32. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtuesja e kërkesës nuk ka treguar se përse dhe si konkludimi në njoftimin e Prokurorit të Shtetit ose procedurat pranë Gjykatës së Qarkut ia kanë cenuar të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë.
33. Rezulton që kërkesa është e papranueshme sepse është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (1) c) dhe 36 (2) d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 48 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) c), 36 (2) d) dhe 56. 2 të Rregullores së punës, më 20 janar 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Dr. sc. Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI90/13, Lumni Limaj, Aktvendim i datës 20 janar 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Panelit për Lirim me Kusht në Ministrinë e Drejtësisë, MD/PLK. Nr. 457/12, të 28 dhjetorit 2012.

Rasti KI90/13, vendimi i 20 janarit 2014.

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, *prima facie*, qartazi e pabazuar.

Parashtruesi i kërkesës nuk ka saktësuar shkeljen e pretenduar të ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti.

Parashtruesi nuk ka saktësuar se cilin vendim të gjykatave e konteston dhe cilat të drejta dhe liri të garantuara me Kushtetutë pretendon se i janë shkelur ashtu siç parashihet në nenin 113.7 të Kushtetutës, dhe nenin 48 të Ligjit. Duke marrë parasysh se barra e të provuarit të shkeljeve kushtetuese bie mbi parashtruesin e kërkesës, Gjykata do të shqyrtojë vetëm dokumentacionin e bashkëngjitur me kërkesën. Në rastin konkret parashtruesi nuk ka arritur të paraqes prova nga të cilat Gjykatën do ta dërgonin në përfundim të shkeljes eventuale të ndonjë dispozite kushtetuese.

Parashtruesi i kërkesës po ashtu nuk paraqiti ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) a) dhe d) të Rregullores së punës, më 20 janar 2014, njëzëri deklaroi kërkesën e papranueshme si qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI90/13
Parashtrues
Lumni Limaj
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Panelit për
Lirim me Kusht në Ministrinë e Drejtësisë, MD/PLK. Nr.
457/12,
të 28 dhjetorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović,
zëvendëskryetar
Robert Carolan,
gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Lumni Limaj nga Prizreni (në tekstin e mëtejme: parashtruesi), i cili gjendet në vuajtje të dënimit në burgun e Dubravës.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi i Panelit për Lirim me Kusht i Ministrisë së Drejtësisë, MD/PLK. Nr. 457/12, i 28 dhjetorit 2012, të cilin parashtruesi e ka pranuar më 29 janar 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit i Panelit për Lirim me Kusht i Ministrisë së Drejtësisë, MD/PLK. Nr. 457/12, i 28 dhjetorit 2012, që ka të bëjë me procedurën penale, në të cilin rast parashtruesi i kërkesës ishte shpallur fajtor për veprën penale vjedhje grabitçare dhe i dënuar me burgim prej dhjetë (10) vitesh.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 56, paragrafi 2, të Rregullores së punës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 5 maj 2013, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi një shkresë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 24 maj 2013, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që ta plotësojë formularin zyrtar të Gjykatës për regjistrim të kërkesës.
7. Më 24 qershor 2013, parashtruesi e dorëzoi në Gjykatë formularin zyrtar të Gjykatës për regjistrim të kërkesës.
8. Më 28 qershor 2013, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI90/13, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI90/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.
9. Më 3 korrik 2013, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që sërish të plotësojë formularin zyrtar të Gjykatës për regjistrim të kërkesës dhe të njëjtin ta nënshkruajë pasi që formulari i 24 qershorit 2013 nuk është i nënshkruar, dhe të saktësojë se cilin vendim e konteston.
10. Më 20 janar 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 21 mars 2007, Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur në bazë të ankesës së mbrojtësit të parashtruesit të kërkesës dhe mbrojtësve të dënuarve të tjerë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Ap. nr. 186/2006, të 14 shtatorit 2006, nxori Aktgjykimin API. nr. 9/2006, përmes të cilit refuzon ankesën si të pabazuar, vërteton pjesën gjykuese të Aktgjykimit të Gjykatës

Supreme, Ap. nr. 186/2006, të 14 shtatorit 2006, dhe për pjesët e tjera të aktgjykimit ankesën e parashtruesit e hedh si të palejuar.

12. Gjykata Supreme më tej në arsyetimin e saj thekson:

“Duke vlerësuar Aktgjykimin e kundërshtuar përkitazi me shkeljet qenësore të dispozitave të procedurës penale, konform dispozitës së nenit 415 të KPPPK, Gjykata Supreme vlerëson se ky aktgjykim nuk përmban shkelje qenësore të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të ligjit penal, shkelje këto të cilat Gjykata i vëren detyrimit të cilat do të kushtëzonin anulimin e Aktgjykimit”.

13. Më 20 dhjetor 2010, Gjykata Supreme e Kosovës, duke vepruar në bazë të kërkesës së parashtruesit të kërkesës për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, nxori Aktvendimin Pzd. Nr. 128/2010, duke e refuzuar si të pabazuar kërkesën e parashtruesit. Gjykata Supreme më tej në aktvendim thekson:

“Rrethanat e lartë cekura lehtësuese të theksuara në kërkesën për zbutje të jashtëzakonshmet dënimit nuk janë të asaj natyre që konform dispozitës së nenit 448 të KPPK, të merën si bazë për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, e sidomos duke i pasur parasysh rrethanat dhe mënyrën e kryerjes së veprave penale...”.

14. Më 28 dhjetor 2012, Ministria e Drejtësisë, përkatësisht Paneli për Lirim me Kusht, duke vepruar në bazë të kërkesës për lirim me kusht, nxori Aktvendimin MD/PLK. Nr 457/12, me të cilin refuzoi kërkesën për lirim me kusht me arsyetimin:

“Nuk është arritur risocializimi, duke marrë për bazë mendimin përmbledhës të qendrës korrektuese mbi shkallën e risocializimit. Paneli vlerëson se nuk është arritur qëllimi i dënimit konform nenit 34 KPK-së kështu që kërkesa e tij refuzohet me mundësi rishqyrtimit në 1 vjet”.

Pretendimet e parashtruesit

15. Parashtruesi i kërkesës nuk ka saktësuar shkeljen e pretenduar të ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti.

Pranueshmëria e kërkesës

16. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata Kushtetuese para së gjithash duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

17. Në këtë drejtim, neni 113, paragrafi 7, i Kushtetutës parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

18. Përveç kësaj, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, që parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

19. Lidhur me kërkesën, parashtruesi nuk ka saktësuar se cilin vendim të gjykatave e konteston dhe cilat të drejta dhe liri të garantuara me Kushtetutë pretendon se i janë shkelur ashtu siç parashihehet në nenin 113.7 të Kushtetutës, dhe nenin 48 të Ligjit. Duke marrë parasysh se barra e të provuarit të shkeljeve kushtetuese bie mbi parashtruesin e kërkesës, Gjykata do të shqyrtojë vetëm dokumentacionin e bashkëngjitur me kërkesën. Në rastin konkret parashtruesi nuk ka arritur të paraqes prova nga të cilat Gjykatën do ta dërgonin në përfundim të shkeljes eventuale të ndonjë dispozite kushtetuese.

20. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese nuk mund të zëvendësojë rolin e gjykatave të rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

21. Parashtruesi i kërkesës po ashtu nuk paraqiti ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ-së lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, i 31 majit 2005).

22. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (2) a) dhe d) të Rregullores së punës që parasheh: *“Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse: a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie dhe d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”*.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) a) dhe d) të Rregullores së punës, më 20 janar 2014, njëzëri:

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Dr. Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI209/13, Mustafë Musa, Aktvendim i datës 21 janar 2014 - Kërkesë për "[...] interpretim të një pjese të Aktgjykimit" në rastin KO108/13, të 9 shtatorit 2013

Rasti KI209/13, vendimi i 21 janarit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, palë a paautorizuar.

Parashtruesi i kërkesës, Mustafë Musa, parashtroi kërkesë në pajtim nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke kërkuar interpretimin në lidhje me një pjesë të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në Rastin KO108/13, të 9 shtatorit 2013 dhe me Ligjin për Amnisti, sepse nuk është e qartë nëse Ligji për Amnisti zbatohet në tërë territorin e Kosovës, apo vetëm në Mitrovicën Veriore.

Lidhur me çështjen e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata konstatoi se kërkesa ishte e papranueshme, sepse parashtruesi i kërkesës për interpretim dhe sqarim nuk është e bazuar në baza kushtetuese ose ligjore. Për më tepër, parashtruesi nuk tregon si dhe pse ai mund të jetë viktimë e Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO108/13, të 9 shtatorit 2013, apo se ndonjë nga të drejtat e tij kushtetuese mund të preket nga ky Aktgjykim, sepse nga parashtruesi pretendohet se Aktgjykimi është i paqartë. Prandaj,

Gjykata konstatoi se kërkesa ishte e papranueshme, sepse parashtruesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar në pajtim me nenin 113.1 të Kushtetutës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI209/13
Parashtrues
Mustafë Musa
Kërkesë për “[...] interpretim të një pjese të Aktgjykimit” në
rastin KO108/13, të 9 shtatorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Mustafë Musa, avokat nga Gjilani.

Objekti i çështjes

2. Objekt i çështjes së kërkesës është kërkesa për interpretim të një pjese të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) në rastin KO108/13, të 9 shtatorit 2013, dhe të Ligjit për Amnisti.

Baza juridike

3. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-131 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

4. Më 19 nëntor 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

5. Më 3 dhjetor 2013, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI209/13, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI209/13, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.
6. Më 9 dhjetor 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.
7. Më 20 janar 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit

8. Parashtruesi “[...] kërkon interpretimin - shpjegimin e Aktgjykimit Nr. KO108/2013 të 9 shtatorit 2013, lidhur me Ligjin për Amnistinë”. Ai kërkoj për sqarim nëse “Ligji për Amnisti zbatohet në tërë territorin e Kosovës apo vetëm pjesërisht – në Mitrovicën Veriore”.
9. Parashtruesi i kërkesës pretendon se “Në praktikë lidhur me zbatimin e Ligjit për Amnistinë, nr. 04/L-209, për të cilin ekziston edhe aktgjykimi i gjykatës së juaj nr. KO108/2013 i datës 9 shtator 2013 ka dilema të mëdha lidhur me interpretimin e dispozitës së nenit 3.1.1.13, përkatësisht 3.1.2.8 dhe 3.1.3.4 të ligjit të përmendur, për veprën penale Thirrja në Rezistencë (neni 411) i Kodit Penal të Republikës së Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 19/13, korrik 2012), (neni 319) i Kodit Penal të Kosovës ("Rregullore e UNMIK-ut, nr. 2003/25", të datës 6 korrik 2003 "Gazeta Zyrtare e Kosovës", nr. 2003/25 dhe "Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/19 mbi ndryshimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, dhe (nenit 186) të Ligjit Penal të KSAK ("Gazeta Zyrtare", nr. 20/77 lidhur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24 dhe 2000/59, për ligjin në fuqi në Kosovë)”.
10. Parashtruesi më tej pretendon se “Dispozitat e përmendura ‘Thirrja në Rezistencë’ përkatësisht ‘Nxitja në Rezistencë’ dhe veprat e numëruara në këta paragrafë, në praktikë nga gjyqtarët dhe prokurorët ka dilema se nga Ligji për Amnistinë a përfitojnë vetëm personat që shprehimisht kanë bërë thirrje për rezistencë apo të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, meqë të gjithë të cilët nuk kanë vepruar sipas dispozitave në fuqi, në një mënyrë apo tjetrën u kanë bërë rezistencë organeve të pushtetit dhe se

Ligji për Amnistinë a zbatohet njësojë në tërë territorin e Republikës së Kosovës apo vetëm parciaisht, në pjesën e Mitrovicës Veriore”.

Pranueshmëria e kërkesës

11. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, ajo së pari duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës së Gjykatës.
12. Në këtë drejtim, Gjykata duhet të vlerësojë nëse parashtruesi është palë e autorizuar për ta dorëzuar kërkesën përkatëse.
13. Në rastin në fjalë, parashtruesi kërkon interpretimin e një pjese të Aktgjykimit në rastin KO108/13, të 9 shtatorit 2013 dhe të Ligjit për Amnisti, përkatësisht nëse Ligji për Amnisti zbatohet në tërë territorin e Kosovës apo pjesërisht, sepse nuk është e qartë nëse Ligji për Amnisti zbatohet në tërë territorin e Kosovës ose vetëm në Mitrovicën Veriore.
14. Parashtruesi më tej kërkon sqarim lidhur me zbatueshmërinë e Ligjit për Amnisti dhe interpretimin e dispozitave të caktuara të Ligjit në fjalë, siç theksohet në paragrafin 9.
15. Në këtë drejtim, parashtruesi konsideron se ekzistojnë dilema në mesin e gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me zbatimin e Ligjit për Amnisti, siç theksohet në paragrafin 10.
16. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.1 të Kushtetutës, i cili parasheh se: *“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.*
17. Gjykata vëren se parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën e tij sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh: *“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*
18. Gjykata vëren se kërkesa e parashtruesit për interpretim dhe sqarim nuk është e bazuar në baza kushtetuese ose ligjore. Për më tepër, parashtruesi nuk tregon si dhe pse ai mund të jetë viktimë e

Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO108/13, të 9 shtatorit 2013, apo se ndonjë nga të drejtat e tij kushtetuese mund të preket nga ky Aktgjykim, sepse nga parashtruesi pretendohet se Aktgjykimi është i paqartë.

19. Siç kuptohet nga Gjykata, kurka të bëjë mekërkesë përinterpretim në lidhje me zbatimin territorial të Ligjit për Amnisti, nuk ka të drejtë kushtetuese që fuqizon individët për të sjellë një kërkesë të tillë në Gjykatë.
20. Gjykata përsërit se sipas nenit 113.8 të Kushtetutës, gjykatat e rregullta janë të autorizuar *“[...] t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkritazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë”*.
21. Për më tepër, sipas nenit 113.5 të Kushtetutës, parashihet se *“Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur”*.
22. Përveç kësaj, sipas nenit 113.2 (1) të Kushtetutës *“Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim (1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën”*.
23. Duke pasur parasysh dispozitatë cituaratë Kushtetutës, Gjykata arrin në përfundim se parashtruesinuk është palë e autorizuar për të parashtruar një kërkesë të tillë.
24. Sa i përket vërtetimit të pretenduar të parashtruesit se ekziston një dilemë në mesin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, lidhur me zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të caktuara të Ligjit për Amnisti, Gjykata vëren se nuk ka bazë kushtetuese për një kërkesë të tillë.
25. Prandaj, duke marrë parasysh dispozitat e lart cekura kushtetuese, Gjykata konkludon se parashtruesi nuk është palë e autorizuar.

26. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit është e papranueshme në pajtim me nenin 113.1 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 të Kushtetutës dhe me rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 21 janar 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Dr. sc. Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI215/13, Selim Emërllahu, Aktvendim i datës 11 shkurt 2014 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së mos zbatimit të Ligjit për amnisti.

Rasti KI215/13, vendimi i 11 shkurtit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, vepra penale, mosshterimi i mjeteve juridike.

Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke mos e kontestuar asnjë vendim të autoriteteve publike, por duke kërkuar vlerësimin e moszbatimit të Ligjit për amnisti.

Me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, Ap. nr. 23/2012, të datës 12.03.2012, parashtruesi i kërkesës është dënuar me burg, në kohëzgjatje prej tre (3) muajsh për shkak të kryerjes në bashkëveprim të veprës penale mashtrim në votim, nga neni 180, lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Parashtruesi i kërkesës pretendoi se: *“Ne kemi njohuri se Ligji për Amnisti ka përfshirë edhe këtë lloj të veprave penale, për çka Gjykata Themelore në Gjilan – dega në Viti, ka lëshuar urdhër në polici për vuajtjen e dënimit, mirëpo, nuk është zbatuar Ligji për Amnistinë, i cili amnistion këtë vepër penale, nga fakti që vepra, siç pretendohet, është kryer më 2007”.*

Duke vendosur në lidhje me kërkesën e parashtruesit Selim Emërllahu, Gjykata Kushtetuese konstatoi se parashtruesi i kërkesës nuk e ka shteruar mundësinë e ushtrimit të ankesës kundër vendimit për amnisti, në të cilin parashtruesi i kërkesës ka të drejtë, në pajtim me nenin 10 para. 1 të Ligjit për amnisti, nr. 2013/04-L-209.

Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t’u ofrojë autoriteteve përkatëse, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i vendit siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Prandaj, Gjykata Kushtetuese konstatoi se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me Ligjin, që të jetë në gjendje të parashtrojë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, kështu që kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me nenin 47.2 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) a) të Rregullores.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI215/13
Parashtrues
Selim Emërllahu
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së “moszbatimit të Ligjit për
amnisti”

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u dorëzua nga z. Selim Emërllahu (në tekstin e mëtejme: parashtruesi), fshati Ramjan, komuna e Vitisë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk e konteston asnjë vendim të autoriteteve publike.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është “moszbatimi i Ligjit për amnisti”.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 20 nëntor 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 3 dhjetor 2013, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI215/13, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI215/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy(kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 11 shkurt 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues Ivan Čukalović, Kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botushareva dhe Arta Rama-Hajrizi, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plot papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Me Aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës së Qarkut në Gjiilan, Ap. nr. 23/2012, të 12 marsit 2012, parashtruesi i kërkesës është dënuar me burg, në kohëzgjatje prej tre (3) muajsh për shkak të kryerjes në bashkëveprim të veprës penale mashtrim në votim, nga neni 180, lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Pretendimet e parashtruesit

9. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *“Ne kemi njohuri se Ligji për Amnisti ka përfshirë edhe këtë lloj të veprave penale, për çka Gjykata Themelore në Gjiilan-dega në Viti, ka lëshuar urdhër në polici për vuajtjen e dënimit, mirëpo, nuk është zbatuar Ligji për Amnistinë, i cili amnistion këtë vepër penale, nga fakti që vepra, siç pretendohet, është kryer më 2007”*.
10. Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese: *“Kërkojmë nga ju që si titull i lartshënuar dhe si Kryetar i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të na njoftoni me shkrim për këtë çështje, si dhe të njoftoni Gjykatën kompetente dhe Policinë e Kosovës dhe eventualisht Shërbimin Sprovues”*.

Pranueshmëria e kërkesës

11. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
12. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
13. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47 të Ligjit, i cili parasheh:

“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
14. Për më tepër, Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës, i cili parasheh që:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:
...
a) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjyqimit të kundërshtuar...”.
15. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t’u ofrojë autoriteteve përkatëse, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i vendit siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. (shih, *mutatis mutandis* GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25803/94, vendimi i 28 korrikut 1999).
16. Kjo Gjykatë e ka zbatuar arsyetimin e njëjtë kur e mori vendimin më 27 janar 2010, për papranueshmëri në bazë të mosshterimit të të gjitha mjeteve juridike në rastin Universitetit AAB-RIINVEST SHPK, Prishtinë, kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, rasti nr. KI41/09 dhe vendimin e 23 marsit 2010, në rastin e Mimoza Kusarit-Lilës kundër Komisionit Qendror Zgjedhor, rasti nr. KI73/09.

17. Duke marrë parasysh këtë, në bazë të dokumenteve të dorëzuara në Gjykatën Kushtetuese nga ana e parashtruesit të kërkesës, me të cilat ai i drejtohet drejtpërdrejt Gjykatës Kushtetuese, ndërsa ai nuk e ka parashtruar “...kërkesën e personit të dënuar, kryesit të veprës penale” në pajtim me nenin 7 para. 1.2 i Ligjit për amnisti nr. 2013/04-L-209, në mënyrë që gjykata kompetente të mund të vendoste me aktvendim.
18. Parashtruesi gjithashtu nuk e ka shteruar mundësinë e ushtrimit të ankesës kundër vendimit për amnisti, në të cilin parashtruesi i kërkesës ka të drejtë, në pajtim me nenin 10 para. 1 të Ligjit për amnisti, nr. 2013/04-L-209, i cili parasheh:

“1. Kundër vendimeve për amnisti, mund të paraqitet ankesë Gjykatës së Apelit në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimi të vendimit. Gjykata e Apelit nxjerr vendim sipas ankesës në afat prej tre (3) ditësh nga dita e pranimi të shkresave”.
19. Prandaj, parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me Ligjin për amnisti, nr. 2013/04-L-209, që të jetë në gjendje të parashtojë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, kështu që kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me nenin 47.2 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) a) të Rregullores.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 par. 7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 11 shkurt 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI76/13, Durije Kurshumlja, Shpresa Kurshumlja dhe Orhan Kurshumlja, Aktvendim i datës 16 tetor 2013 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 218/2010, të 7 shkurtit 2013

Rasti KI76/13, vendimi i 16 tetorit 2013.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, qartazi e pabazuar.

Parashtruesit e kërkesës e kanë paraqitur kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, ku kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 218/2010, të datës 7 shkurt 2013, Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 424/2008, të 23 qershorit 2010, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale, C. nr. 180/2002, të 14 shtatorit 2007, të cilët pretendohet të kenë shkelur: nenin 7 [Vlerat]; nenin 21 [Parimet e përgjithshme]; nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]; nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; nenin 46 [Mbrojtja e Pronës]; nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]; dhe nenin 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut [E Drejta për një Proces të Rregullt]; dhe nenin 1 i Protokollit shtesë të KEDNJ-së [Mbrojtja e Pronës].

Në lidhje me çështjen e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata vlerësoi se kërkesa ishte e papranueshme, sepse parashtruesit e kërkesës nuk kanë ofruar prova se procedurat përkatëse kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta ose arbitrare. Nga kjo rrjedh se Gjykata vlerësoi se kërkesa është qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullat 36 (1) c) dhe 36 (2) a) dhe d) të Rregullores së punës. Më tutje, Gjykata gjithashtu vlerësoi se në lidhje me shkeljen e pretenduar të parimit që rasti duhet të vendoset brenda një afati kohor të arsyeshëm, shpallet e papranueshme për mosshterim të mjeteve, sepse parashtruesit e kërkesës nuk kanë paraqitur ankesë para gjykatave të rregullta në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI76/13
Parashtrues
Durije Kurshumlija,
Shpresa Kurshumlija dhe
Orhan Kurshumlija
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 218/2010, të 7
shkurtit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesit e kërkesës janë: znj. Durije Kurshumlija, znj. Shpresa Kurshumlija dhe z. Orhan Kurshumlija. Ata janë të përfaqësuar nga z. Teki Bokshi, avokat nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 218/2010, të 7 shkurtit 2013, Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, Ac. nr. 424/2008, të 23 qershorit 2010, dhe Aktgjykimi Gjykatës Komunale C. nr. 180/2002, të 14 shtatorit 2007.
3. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës iu dorëzua parashtruesve të kërkesës më 6 prill 2013.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara gjyqësore, të cilat pretendohet të kenë shkelur nenin

7 [Vlerat]; neni 21 [Parimet e përgjithshme]; neni 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]; neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; neni 46 [Mbrojtja e Pronës]; neni 53 [Interpretimi i të Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]; dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ) [E Drejta për një Proces të Rregullt]; dhe neni 1 i Protokollit shtesë i KEDNJ [Mbrojtja e Pronës].

Baza juridike

5. Neni 113. 7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 29 maj 2013, parashtruesit parashtruan kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
7. Të njëjtën ditë, Kryetari caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.
8. Më 10 qershor 2013, Gjykata i njoftoi parashtruesit dhe Gjykatën Supreme në lidhje me regjistrimin e kërkesës.
9. Gjithashtu, më 10 qershor 2013, Gjykata kërkoi nga avokati i parashtruesve që t'i dorëzojë të gjitha dokumentet e përmendura në kërkesë.
10. Më 18 qershor 2013, parashtruesit i dorëzuan disa nga dokumentet e kërkuara nga Gjykata.
11. Më 16 tetor 2013, Kolegji shqyrtues pasi shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 5 nëntor 1985, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin C. nr. 526/84, vërtetoi se babai i parashtruesve kishte të drejtën e shfrytëzimit të përhershëm të paluajtshmërisë, e cila figuron si

parcelë kadastrale nr. 6177 në sipërfaqe prej 1.67,53 hektarësh në vendin e quajtur “Vreshtat”, sipas fletëposedimit nr. 1941 KK Prishtinë, dhe të lejojë regjistrimin në emrin e tij në afat prej 15 ditësh nga dita e nxjerrjes së Aktgjykimit.

13. Pas kësaj i padituri u ankua në Gjykatën Supreme, duke u ankuar se Gjykata e Qarkut ka shkelur dispozitat esenciale të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejshëm: LPK), ka vërtetuar në mënyrë të gabuar situatën faktike dhe në mënyrë të gabuar ka zbatuar të drejtën materiale.
14. Më 17 korrik 1986, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Ac. nr. 125/86, prishi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, duke deklaruar se pretendimet nga ankuesi (paditësi para Gjykatës së Qarkut) ishin të arsyetuara, dhe urdhëroi që rasti të dorëzohet për shqyrtim në Gjykatën Komunale në Prishtinë si gjykatë kompetente për të vendosur për këtë rast. Gjykata Supreme më tej gjykoi se në procedurën e përsëritur, të gjitha rrethanat duhet të qartësohen, inter alia, duke kërkuar një raport të detajuar nga Departamenti i Gjeodezisë për kontestin pronësor.
15. Kur vdiq parashtruesi, në vitin 1987, i biri i tij fitoi të gjitha të drejtat e tij dhe trashëgoi pronën në fjalë.
16. Më 25 prill 1994, një ekspertizë u përgatit nga eksperti P. G. duke ofruar tërë historinë e pronës së kontestuar, ashtu siç vërtetohej nga një ekspert tjetër Q. H.
17. Në një datë të pacaktuar, parashtruesit, pas vdekjes së babait të tyre, iniciuan procedurën e përsëritur në Gjykatën Komunale në Prishtinë ashtu siç urdhërohej me Aktgjykimin Ac. nr. 125/86 të Gjykatës Supreme, të 17 korrikut 1986.
18. Më 14 shtator 2007, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktgjykimin C. nr. 180/2002, refuzoi padinë e parashtruesve si të pabazuar, duke e konsideruar të paditurin si pronar të ngastrës zyrtarisht të regjistruar në emrin e tij në Zyrën Kadastrale në Prishtinë.
19. Më 6 nëntor 2007, parashtruesit ushtruan ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, duke pretenduar se gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar sipas udhëzimeve të përcaktuara në Aktgjykimin Ac. nr. 125/86 të Gjykatës Supreme, të datës 17 korrik 1986 dhe ka shkelur nenin 354. 1 në lidhje me nenin 377 dhe 354. 2 të LPK, dhe se Aktgjykimi

i saj ishte rezultat i përcaktimit të gabuar dhe jo të plotë të situatës faktike të së drejtës materiale.

20. Më 24 qershor 2010, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin Ac. nr. 424/2008, vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale dhe refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesve. Gjykata theksoi se, Gjykata Komunale në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka përcaktuar të gjitha faktet që ishin me rëndësi vendimtare për të përcaktuar faktin se babai i ndjerë i parashtruesve nga Prishtina nuk ka gëzuar të drejtën e pronësisë së pasurisë së paluajtshme të kontestuar. Gjykata e Qarkut konkludoi se Aktgjykimi i Gjykatës Komunale përmbante një dispozitiv të kuptueshëm dhe se, në arsyetimin e aktgjyimit, ishin paraqitur arsyet e plota dhe të kuptueshme përkitazi me të gjitha faktet të cilat ishin relevante për gjykimin e drejtë të çështjes së kontestuar.
21. Më 5 gusht 2010, parashtruesit paraqitën revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të LPK dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Gjykatës Supreme që vendimet e gjykatave të instancës më të ultë të ndryshohen ashtu që kërkesa e parashtruesve të pranohet si e bazuar, ose që këto aktgjykime të anulohen dhe që çështja të kthehet në rigjykim.
22. Më 7 shkurt 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Rev. nr. 218/2013, refuzoi revizionin si të pabazuar dhe pranoi të gjitha të gjeturat faktike dhe ligjore të nxjerra nga gjykatat e instancës më të ulët, duke theksuar se aktgjykimet e kontestuar ishin të qarta dhe nuk përmbanin kundërthënie në përmbajtjen ose arsyetimin e tyre.

Pretendimet e parashtruesit

23. Parashtruesit pretendojnë se Gjykata Komunale dhe e Qarkut nuk kanë bërë analiza reale dhe kuptimplotë si të dëshmive të dëshmitarëve për parashtruesit, ashtu edhe të dëshmive të dëshmitarëve për të paditurin si dhe të vetë paditurit. Në veçanti, këto gjykata nuk kanë siguruar baza të përshtatshme për refuzimin e provave të paraqitura nga parashtruesit. Për më tepër, sipas mendimit të tyre, Gjykata Supreme nuk ka marrë parasysh deklaratat e dëshmitarëve që ata i kishin realizuar.
24. Parashtruesit kërkojnë nga Gjykata që të gjejë se Gjykata Supreme, Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Komunale kishin shkelur të drejtat e tyre themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë, në veçanti

nenin 7 [Vlerat], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [e Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës si dhe nenin 6 [e Drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ dhe neni 1 [Mbrojtja e Pronës] të Protokollit shtesë të KEDNJ.

25. Ata gjithashtu pohojnë se, kur llogaritet afati kohor prej datës kur janë iniciuar procedurat gjyqësore deri kur është nxjerrë Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, kërkesa që rasti duhet të vendoset brenda afatit të arsyeshëm kohor siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk ishte respektuar.
26. Parashtruesit i propozojnë Gjykatës që t'i anulojë të gjitha aktgjykimet e nxjerra në këtë rast si dhe rasti të kthehet në rigjykim.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

27. Në mënyrë që Gjykata të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesve, duhet që së pari të vlerësojë nëse parashtruesit e kërkesës i kanë plotësuar kriteret për pranueshmëri të parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe në Rregullore.
28. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

29. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor (...)”.

30. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesit kanë kërkuar mbështetje për të mbrojtur të drejtat e tyre në Gjykatën Komunale dhe të Qarkut dhe, përfundimisht, në Gjykatën Supreme të Kosovës. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesve u është

dorëzuar Aktgjykimi i Gjykatës Supreme më 6 prill 2013, dhe kanë parashtruar kërkesën në Gjykatë më 29 maj 2013.

31. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesit janë palë të autorizuar dhe i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit të zbatueshëm dhe i kanë dorëzuar kërkesat brenda afatit katër (4) mujor.

32. Gjykata më tej i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

33. Përveç kësaj, rregulli 36 (1) c) dhe rregulli 36 (2) a) dhe d) i Rregullores së punës, parashohin:

(1) *“Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*

[...]

c) kërkesa nuk është qartazi e bazuar.

(2) *Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose:

[...]

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

34. Në rastin konkret, parashtruesit pohojnë se nuk pajtohen me vendimet e Gjykatës Komunale dhe të Qarkut në procedurë të përsëritur të urdhëruar me Aktgjykimin Ac. nr. 125/86 të Gjykatës Supreme të 17 korrikut 1986, sepse të dy gjykatat kanë injoruar plotësisht rekomandimet e përfshira në atë Aktgjykim. Për më tepër, sipas opinionit të tyre, gjithashtu Aktgjykimi Rev. nr. 218/2010 i Gjykatës Supreme të 7 shkurtit 2013 ka shkelur të drejtën e qasjes në drejtësi, me atë se nuk e kanë konsideruar çështjen në tërësi.

35. Parashtruesit më tutje pohojnë se këto gjykata nuk kanë bërë analiza reale dhe kuptimplota të dëshmitarëve të parashtruesve, dhe se nuk është dhënë asnjë sqarim i duhur për secilën pjesë të provave që u është paraqitur.
36. Ata pretendojnë se tërë çështja ishte vendosur nga gjykatat në shkelje të nenit 7 [Vlerat], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [e Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrotjtja e Pronës] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës si dhe nenin 6 [e Drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ dhe neni 1 [Mbrotjtja e Pronës] e Protokollit nr. 1 të KEDNJ.
37. Përkitazi me ankesat e parashtruesve, Gjykata vëren se sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërinë) që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta dhe Gjykata Supreme, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Prandaj, Gjykata nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I). Pakënaqësia e thjeshtë me vendimet e kontestuar gjyqësore nuk mund të jetë bazë kushtetuese për të parashtruar një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.
38. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse procedurat, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në atë mënyrë që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, *mutatis mutandis*, Raport i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër MB, Kërkesa nr. 13071/87, e 10 korrikut 1991).
39. Përkitazi me rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesit thjesht ankohen se Gjykata Supreme, në Aktgjykimin e vet Rev. nr. 218/2010 të 7 shkurtit 2013, refuzoi revizionin e tyre kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë si të pabazuar për arsye se plotësisht ka pranuar gjetjet faktike dhe juridike të nxjerra nga Gjykata Komunale dhe e Qarkut dhe se këto të gjetura ishin të qarta dhe nuk përmbanin ndonjë kundërthënie sa i përket përmbajtjes dhe arsyetimit.

40. Në këtë drejtim, pas shqyrtimit të ankesës së parashtruesve, Gjykata gjen se procedurat përkatëse nuk ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare. (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06 të 31 majit 2009).
41. Për më tepër, Gjykata konsideron se, parashtruesit as nuk e kanë ndërtuar rastin mbi shkeljen e ndonjë të drejte në të cilat ata thirren, dhe as që kanë ofruar ndonjë provë *prima facie* për ato shkelje (shih, Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendim i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, i 31 majit 2005 dhe Rasti KI70/11, Faik Hima, Magbule Hima, Bestar Hima, Vlerësimi kushtetues i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme nr. 983/08, të 7 shkurtit 2011, Aktvendim për Papranueshmëri i 13 dhjetorit 2011).
42. Nga kjo rrjedh se kërkesa është qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullat 36 (1) c) dhe 36 (2) a) dhe d) të Rregullores së punës.
43. Parashtruesit më tutje ankohen se, kur llogaritet afati kohor prej datës kur janë iniciuar procedurat gjyqësore deri kur është nxjerrë aktgjykimi i Gjykatës Supreme, kërkesa që rasti duhet të vendoset brenda afatit të arsyeshëm kohor siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk ishte respektuar.
44. Megjithatë, Gjykata vëren se nga dokumentet e paraqitura del që parashtruesit nuk kanë ngritur një ankesë në Gjykatën Komunale dhe të Qarkut, ose në instancë më të lartë në Gjykatën Supreme.
45. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, para se të parashtrohet kërkesa në Gjykatë, rregulli i shterimit jo vetëm që kërkon nga parashtruesi që të shterojë të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në Kosovë, duke përfshirë gjykatën e instancës më të lartë, por gjithashtu edhe të ngrejë shkeljen e pretenduar të të drejtave themelore në procedurat e këtyre instancave.
46. Gjykata thekson se arsyetimi për rregullin e shterimit, siç interpretohet nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), është që t'u ofrojë autoriteteve publike përkatëse, duke përfshirë edhe gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të të drejtave themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe/apo me instrumentet ndërkombëtare, drejtpërdrejtë të zbatuara në Kosovë. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës

do të sigurojë mjete efektive kundër shkeljes së pretenduar të të drejtave të tilla themelore. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të procedurave në Gjykatën Kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, Selmouni kundër Francës, GJEDNJ, nr. 25 803/94, Aktgjykimi i 28 korrikut 1999).

47. Kështu, në rastin konkret, parashtruesit nuk kanë treguar se, përkitazi me ankesën e tyre që rasti i tyre nuk ishte vendosur brenda afatit të arsyeshëm kohor në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ, ata kanë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në Kosovë ashtu siç ishte kërkuar nga ata, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës dhe nenin 47. 2 të Ligjit.
48. Nga kjo rrjedh se kjo pjesë e kërkesës duhet të refuzohet për shkak se parashtruesit nuk kanë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në Kosovë.
49. Në këto rrethana, Gjykata konkludon se kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 dhe nenit 48 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) c) dhe rregullit 56 (2) të Rregullores së punës, më 16 tetor 2013, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI32/14, Arben Krasniqi, Aktvendim i datës 12 mars 2014 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Vendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKRNR 47/13, PPS Nr. 107/2012, të 20 janarit 2014

Rasti KI32/14, vendimi i 12 marsit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kërkesë për masë të përkohshme, nuk është arsyetuar prima facie, qartazi e pabazuar

Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake të Gjykatës Themelore në Prishtinë. Në vendimin e tij, gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës Themelore në Prishtinë, e refuzoi kërkesën e parashtruesit për qasje të plotë në shkresat e lëndës.

Parashtruesi i kërkesës është në paraburgim dhe ai hetohej për vepra penale, përderisa aktakuza nuk është ngritur ende.

Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës të vendosë masën e përkohshme, përkatësisht ta detyrojë gjyqtarin e procedurës paraprake ta urdhërojë prokurorinë që t'i lejojë parashtruesit qasje të plotë në pjesët e shkresave të lëndës, që pretendohet të jenë baza për të urdhëruar paraburgimin e parashtruesit të kërkesës.

Parashtruesi pretendon se vendimi i gjyqtarit të procedurës paraprake i 20 janarit 2014, e ka shkelur parimin e barazisë së armeve që, sipas parashtruesit të kërkesës, garantohet me nenin 5 [E Drejta për Liri dhe Siguri] dhe nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Gjykata Kushtetuese, duke marrë parasysh fazën e procedurës, konsideroi se nuk mund të ndjekë argumentin e parashtruesit të kërkesës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe konsideron se neni 6 i KEDNJ-së nuk është i aplikueshëm siç pretendohet nga parashtruesi i kërkesës. Për më tepër, në bazë të shkresave të lëndës, Gjykata vërejti se parashtruesi nuk kishte parashtruar kërkesë te gjyqtari i procedurës paraprake për të përcaktuar ligjshmërinë e paraburgimit, dhe as nuk kërkon në mënyrë specifik neni 5 i KEDNJ-së nuk ishte i zbatueshëm sa i përket çështjes së paraburgimit, e cila nuk ishte kontestuar nga parashtruesi i kërkesës.

Gjykata Kushtetuese, bazuar në arsyetimin e lartcekur dhe duke iu referuar fazës së tanishme të procedurës, deklaroi kërkesën e parashtruesit të papranueshme, sepse nuk është arsyetuar *prima facie*.

Përveç kësaj, Gjykata Kushtetuese refuzoi kërkesën e parashtruesit për masë të përkohshme si qartazi të pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI32/14
Parashtrues
Arben Krasniqi
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të gjyqtarit të
procedurës paraprake të Gjykatës Themelore në Prishtinë,
PKRNR 47/13,
PPS Nr. 107/2012, të 20 janarit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është z. Arben Krasniqi (në tekstin e mëtejme: parashtruesi), me vendbanim në Prishtinë, i përfaqësuar nga Dr. Donat Ebert, avokat i regjistruar në Odën e Avokatëve të Gjermanisë dhe të Hungarisë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Vendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKRNR 47/13, PPS Nr. 107/2012, të 20 janarit 2014, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit në një datë të pacaktuar.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKRNR 47/13, PPS Nr. 107/2012, të 20 janarit 2014. Në vendimin e tij, gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës

Themelore në Prishtinë, e refuzoi kërkesën e parashtruesit për qasje të plotë në shkresat e lëndës.

4. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) të vendosë masën e përkohshme, përkatësisht ta detyrojë gjyqtarin e procedurës paraprake ta urdhërojë prokurorinë që t'i lejojë parashtruesit qasje të plotë në pjesët e shkresave të lëndës, që pretendohet të jenë baza për të urdhëruar paraburgimin e parashtruesit të kërkesës.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullat 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 19 shkurt 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.
7. Më 25 shkurt 2014, Kryetari me Vendimin Nr. GJR. KI32/14, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI32/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
8. Më 25 shkurt 2014, Gjykata e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi dokumentet shtesë si në vijim: 1. Vendimin për paraburgim; 2. Vendimin/Vendimet për masa mbrojtëse, të cilat janë të përmendura në shkresat e lëndës; dhe 3. Kërkesën për qasje në shkresat e lëndës, të dorëzuar në Zyrën e Prokurorisë Speciale të Kosovës.
9. Të njëjtën ditë, Gjykata gjithashtu e njoftoi gjyqtarin e procedurës paraprake të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Zyrën e Prokurorisë Speciale të Kosovës për kërkesën.
10. Më 6 mars 2014, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.

11. Më 12 mars 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë ta deklarojë kërkesën të papranueshme dhe ta refuzojë kërkesën për masë të përkohshme.

Përmbledhja e fakteve

12. Në pajtim me vendimin për fillimin e hetimeve të 6 marsit 2013, parashtruesi hetohet për veprat penale si në vijim: pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar në shkelje të nenit 283, paragrafi 2, të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshme: KPK), në lidhje me veprën penale të zhvatjes, në shkelje të nenit 340, paragrafi 2, të KPK-së, vepra të dënueshme me gjobë deri në pesëqind mijë (500,000) euro dhe me burgim me së paku dhjetë (10) vjet.
13. Pas një bastisjeje të kryer më 28 tetor 2013, në vendbanimin e parashtruesit në Prishtinë, parashtruesi i kërkesës hetohet edhe për pronësi, kontroll dhe posedim të armëve, në kundërshtim me nenin 374, paragrafi 1, të KPK-së, vepër e dënueshme me një gjobë deri në (7.500) euro dhe me burgim deri në pesë (5) vjet.
14. Parashtruesi është në paraburgim që nga 28 tetori 2013.
15. Më 20 nëntor 2013, parashtruesi kishte parashtruar një kërkesë në Zyrën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, për qasje në shkresa të lëndës.
16. Më 28 nëntor 2013, Zyra e Prokurorisë Speciale, në vendimin e saj, vendosi si në vijim:
 - “1. Avokati mbrojtës i të pandehurit Arben Krasniqi do të ketë qasje në shkresat e rastit deri në masën që lejohet nga neni 213, paragrafi 3.*
 - 2. Avokati mbrojtës i të pandehurit Arben Krasniqi nuk do të ketë qasje në materiale të tjera të shkresave të rastit.*
 - 3. Avokati mbrojtës do të njoftohet dhe do të ftohet të marrë pjesë në të gjitha veprimet hetimore për të cilat prokurori i shtetit është i obliguar të japë një njoftim apo ftesë të tillë”.*
17. Përkitazi me një pjesë të vendimit për moslejimin e qasjes në materiale të tjera në shkresat e lëndës, Zyra e Prokurorisë Speciale arsyetoi si në vijim:

[...]

“Derisa në bazë të nenit 213, par. 2 KPPK [Kodi i Procedurës Penale të Kosovës], ekziston obligimi pozitiv i prokurorit që t’i mundësojë të pandehurit apo avokatit të tij mbrojtës qasje në shkresat e lëndës (qasje e përgjithshme), ai obligim u nënshtrohet përjashtimeve që përcaktohen me nenin 213. Në bazë të këtyre përjashtimeve dhe dispozitave në lidhje me masat mbrojtëse për dëshmitarë, kjo «qasje e përgjithshme» në shkresat e rastit refuzohet”.

[...]

“Ky është hetim i vazhdueshëm ndaj një grupi kriminal të organizuar, potencialisht të madh. Lejimi i qasjes së përgjithshme për avokatin mbrojtës në shkresat e rastit ka mundësi që seriozisht të rrezikojë qëllimin e hetimit, përkatësisht të zbulojë të gjitha aktivitetet e paligjshme të grupit të organizuar kriminal dhe pjesëtarëve të tij. Përveç këtyre, ekziston një numër dëshmitarësh për të cilët është dhënë masa mbrojtëse nga Gjykata dhe, në këtë rast, qasja në shkresat e rastit do të mund të çonte në zbulimin e dëshmitarëve aktualë dhe të ardhshëm, të cilët nuk kanë gëzuar apo nuk gëzojnë të njëjtat masa. Duke marrë parasysh mënyrën e veprimit të grupeve të organizuara kriminale – që është përdorimi i kërcënimeve serioze dhe dhunës për qëllime të përfitimit material – nuk është e paarsyeshme të pritet që nëse pjesëtarët e grupit të organizuar kriminal zbulojnë identitetin e dëshmitarëve (aktualë apo të mundshëm) do të ndërmerrnin hapa – duke përfshirë këtu edhe përdorimin e dhunës – që t’i pengonin në bashkëpunimin e tyre në hetimin penal, si dhe procedurat e mëtutjeshme gjyqësore”.

[...]

“Përveç bazimit të përjashtimit të përcaktuar me nenin 213, paragrafi 6, prokurori i poshtënjshkruar bazohet tek neni 222, par.2 i KPPK-së, i cili shprehimisht përcakton që, në rastet kur dispozitat e tjera të KPPK-së janë në konflikt me masat mbrojtëse që i jepen një dëshmitari, dispozitat e tjera të KPPK-së nuk vlejnë”.

18. Më 21 nëntor 2013, Zyra e Prokurorisë Speciale mori vendim për zgjerimin e hetimeve.

19. Më 7 janar 2014, parashtruesi parashtroi kërkesë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, duke kërkuar nga gjyqtari i procedurës paraprake që të obligojë Prokurorin e Shtetit:

1. *“T’i lejojë mbrojtjes qasje të plotë në dosjen e plotë të shkresave të lëndës në posedim të Prokurorisë, në lidhje me hetimin ndaj Arben Krasniqit,*
2. *Në rast se ka arsyetim të thellë për t’i mohuar qasjen e plotë në shkresat e lëndës, të ofrojë të gjitha dokumentet që nuk përmbajnë informata të privilegjuara,*
3. *Përndryshe, t’i ofrojë mbrojtjes versionin e redaktuar të dosjes së plotë të shkresave të lëndës ose të pjesëve të saj që nuk janë të privilegjuara”.*

20. Parashtruesi përmbylli kërkesën e tij, dorëzuar gjyqtarit të procedurës paraprake, duke argumentuar:

“Këtu është me rëndësi të shihet që objektet e krimeve të pohuara dhe dëshmitarët e pohuar duken të jenë identikë. Kjo e bën të lehtë për Prokurorinë të theksojë që kur identiteti i tyre të zbulohet, ekziston rrezik i lartë i prekjës së dëshmive, duke kërcënuar dëshmitarët në njërën anë, derisa në anën tjetër ka dyshim të thellë ndaj të pandehurve, pa i dhënë mbrojtjes mundësinë më të vogël që ta kontestojë këtë, si dhe të vlerësojë vlefshmërinë e këtyre pretendimeve.

[...]

Për ta përmbledhur, mund të thuhet që refuzimi për të ofruar qasje në shkresat e rastit nuk është në përputhje as me KEDNJ-në, as me KPP-në e Republikës së Kosovës dhe kjo duhet korrigjuar me anë të një urdhri të gjyqtarit të procedurës paraprake”.

21. Më 20 janar 2014, gjyqtari i procedurës paraprake të Gjykatës Themelore në Prishtinë, me vendimet PKRNR 47/13, PPS Nr. 107/2012, hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit të kërkesës për qasje në shkresa të lëndës.

22. Në vendimin e lartpërmendur, gjyqtari i procedurës paraprake konstatoi si në vijim:

[...]

“Gjyqtarja e procedurës paraprake konsideron që të drejtat e të pandehurve nuk janë shkelur për shkak të mohimit të qasjes në deklaratat e dëshmitarëve dhe vendimin për fillimin e hetimeve, sepse këto të drejta janë objekt i masave mbrojtëse. Kjo përcaktohet shprehimisht me paragrafin 8 të nenit 213 të KPPK-së. Për më tepër, neni 222, paragrafi 2 i KPPK-së përcakton që dispozitat e tjera të KPPK-së nuk zbatohen kur janë në konflikt me masat mbrojtëse. Gjykata përfundon që lejimi i qasjes së tillë do të ishte në konflikt me masat mbrojtëse të urdhëruara nga kjo Gjykatë”.

23. Gjyqtari i procedurës paraprake konkludoi se: *“Në baraspeshimin mes të drejtës së të pandehurve dhe avokatëve mbrojtës për të pasur qasje në disa prej shkresave të lëndës dhe rrezikut potencial të jetës apo shëndetit të njerëzve nën masën mbrojtëse, Gjykata konsideron që e fundit duhet të ketë peshë më të madhe. Gjykata është e obliguar me parimin e pafajësisë, por në këtë fazë, duhet marrë parasysh faktin që të gjithë dëshmitarët kanë ngurruar të dëshmojnë, deri kur janë miratuar masat mbrojtëse për ta”.*
24. Vendimi i lartpërmendur i gjyqtarit të procedurës paraprake përmban udhëzimin juridik vijues: *“Ky aktvendim është përfundimtar, si dhe nuk lejohet ankesa kundër tij (neni 213, paragrafi 6 i KPPK-së)”.*
25. Duke u bazuar në shkresat e lëndës, në këtë fazë, ende nuk është ngritur një aktakuzë.

Pretendimet e parashtruesit

26. Parashtruesi pretendon se vendimi i gjyqtarit të procedurës paraprake i 20 janarit 2014, e ka shkelur parimin e barazisë së armëve që, sipas parashtruesit të kërkesës, garantohet me nenin 5 [E Drejta për Liri dhe Siguri] dhe nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).
27. Parashtruesi pretendon se: *“[...] prokuroria është e obliguar të ofrojë qasje të plotë në të gjitha shkresat e rastit, për aq sa ato merren si baza për vendosjen e paraburgimit. Përndryshe, as i pandehuri e as mbrojtësi i tij nuk mund të vështrojnë nëse paraburgimi është i ligjshëm apo jo”.*

28. Parashtruesi pretendon se:

“Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës i lë hapësirë prokurorisë të redaktojë dosjen, si dhe, për shembull, t’i fshehë e t’i bëjë identitetet e viktimave të panjohura.

Argumentimi i gjyqtarit të procedurës paraprake që vetë rrethanat e dëshmime të dëshmitarëve do t’i bënin identitetet e tyre të njohura nuk janë bindëse. Është në natyrën e tij që përshkrimi i një veprë apo krimi të pohuar është aq specifik që ta bëjë autorin e dëshmisë të identifikueshëm. Kjo praktikisht gjithmonë ndodh, përveç nëse dëshmia nuk ka lidhshmëri me rrethanat reale faktike.

Pa informata mbi dëshmitë e dëshmitarëve, është e pamundur të verifikohet vërtetësia dhe besueshmëria e deklaratave të tyre”.

29. Parashtruesi përfundon duke kërkuar nga Gjykata:

“- Ta obligojë gjyqtarin e procedurës paraprake që t’i urdhërojë Prokurorisë që t’i lejojë të poshtënë shkruarit qasje të plotë në shkresat e lëndës që, në thelb, përbëjnë bazat për caktimin e paraburgimit.

- Të vendosë masë të përkohshme, duke obliguar Gjykatën që të bëjë një gjë të tillë sa më shpejt që është e mundur”.

Dispozitat relevante të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës Nr. 04/ L-123

1. Neni 213 [Qasja e të dyshuarit dhe të pandehurit në shkresat e lëndës]

“1. Gjatë hapave fillestarë të policisë, i dyshuari duhet të ketë qasje në dëshmitë që janë duke u mbledhur me kërkesë të tij, përveç rasteve ku paragrafi 6. ose 7. i këtij neni mund të aplikohet mutatis mutandis.

2. Me fillimin e hetimit, prokurori i shtetit është i detyruar që t’i sigurojë cilitdo të pandehur apo mbrojtësve të tyre qasje në shkresat e lëndës, përveç përjashtimeve të parapara me këtë nen.

3. Në asnjë fazë të hetimit mbrojtjes nuk mund t'i mohohet shikimi i shkresave lidhur me procesin e marrjes në pyetje të të pandehurit, shikimi i materialit të marrë nga i pandehuri apo materialit që i përket atij, shikimi i materialit lidhur me veprimet hetimore në të cilat është lejuar ose është dashur të lejohet pjesëmarrja e mbrojtësit ose shikimi i ekspertizave.

4. Pas përfundimit të hetimit, mbrojtja ka të drejtë të shikojë, të kopjojë ose t'i fotografojë të gjitha shkresat dhe provat materiale me të cilat disponon gjykata.

5. Pas ngritjes së aktakuzës, të pandehurit ose të pandehurve të cekur në aktakuzë mund t'u sigurohet kopja ose kopjet e shkresave të lëndëve.

6. Përveç të drejtave që i gëzon mbrojtja nga paragrafët 2., 3. dhe 4. të këtij neni, mbrojtjes i lejohet nga prokurori i shtetit që të shikojë, të kopjojë ose të fotografojë shkresa, libra, dokumente, fotografi dhe objekte të tjera materiale në posedim, ruajtje ose kontroll të prokurorit të shtetit, materiale të cilat shërbejnë për përgatitjen e mbrojtjes ose të cilat kanë për qëllim që të shfrytëzohen nga prokurori i shtetit si prova gjatë shqyrtimit gjyqësor, ose që janë marrë nga i pandehuri apo kanë qenë pronë e tij, varësisht nga rasti. Prokurori i shtetit mund t'i refuzojë mbrojtjes shikimin, kopjimin ose fotografimin e shkresave të caktuara, të librave, dokumenteve, fotografive dhe objekteve të tjera materiale në posedim, ruajtje ose nën kontroll të tij, nëse ka gjasa reale se shikimi, kopjimi ose fotografimi mund të rrezikojë qëllimin e hetimit, jetën ose shëndetin e njerëzve. Në rast të tillë, mbrojtja mund të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues që të lejojë shikimin, kopjimin ose fotokopjimin. Vendimi i gjyqtarit është përfundimtar.

7. Informacionet mund të redaktohet ose të shënjoen nga prokurori i shtetit me vijë të trashë të zezë për të fshehur të dhëna të caktuara në kopjet e shkresave të cilat përmbajnë të dhëna të ndjeshme. I pandehuri mund të kundërshtojë redaktimin te gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues brenda tre (3) ditëve nga pranimi i kopjes së redaktuar. Prokurorit të shtetit i jepet mundësia që të shpjegojë bazën ligjore të redaktimit pa zbuluar informacionin e ndjeshëm. Gjyqtari shqyrton informacionin e ndjeshëm dhe merr vendim brenda tre (3) ditëve nëse redaktimi është ligjërisht i arsyetuar.

8. Dispozitat e këtij neni varen nga masat për mbrojtjen e të dëmtuarve, dëshmitarëve dhe privatësisë së tyre si dhe për mbrojtjen e informacioneve konfidenciale, siç parashihet me ligj”.

2. Neni 222. 1 dhe 2 [Urdhri për Masa Mbrojtëse]

“1. Gjyqtari kompetent mund të jep urdhër për masa të tilla mbrojtëse kur e sheh të nevojshme, duke përfshirë por pa u kufizuar në:

- 1.1. lënien bosh ose shlyerjen e emrave, adresave, vendit të punës, profesionit ose ndonjë të dhëne apo informate tjetër që mund të përdoret për të identifikuar të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues ose dëshmitarin;
- 1.2. moszbulimin e ndonjë shkrese që identifikon të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues ose dëshmitarin;
- 1.3. përpjekjen për të fshehur veçoritë ose përshkrimin fizik të të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues apo dëshmitarit që jep dëshminë, duke përfshirë dhënien e dëshmisë prapa një mburoje jo të tejdukshme apo përmes pajisjeve për ndryshimin e fotografisë ose të zërit, ose marrjen në pyetje të njëkohshme nga një vend tjetër që komunikon me gjykatoren me anën e qarkut të mbyllur televiziv, ose videoregjistrimin para seancës dëgjimore në praninë e mbrojtësit;
- 1.4. caktimin e pseudonimit;
- 1.5. seancën e mbyllur për publikun;
- 1.6. urdhrat ndaj mbrojtësit për të mos zbuluar identitetin e të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues apo dëshmitarit, ose për të mos zbuluar ndonjë material apo informacion që mund të shpie në zbulimin e identitetit;
- 1.7. largimin e përkohshëm të të pandehurit nga gjykatorja nëse dëshmitari bashkëpunues ose

dëshmitari refuzon të dëshmojë në prani të të pandehurit apo nëse rrethanat ia bëjnë të ditur gjykatës se dëshmitari nuk do ta flasë të vërtetën në prani të të pandehurit; ose

- 1.8. *cilido kombinim i metodave të përmendura më lart për të parandaluar zbulimin e identitetit të të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues ose dëshmitarit.*

2. Dispozitat tjera të këtij Kodi nuk vlejnë atëherë kur janë në kundërshtim me masat mbrojtëse nga paragrafi 1. i këtij neni”.

Pranueshmëria e kërkesës

30. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

31. Në këtë drejtim, neni 113, paragrafi 7, i Kushtetutës parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

32. Përveç kësaj, neni 49 i Ligjit parasheh se “Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”.

33. Në rastin konkret, Gjykata vëren se vendimi i gjyqtarit të procedurës paraprake që të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesit për qasje të plotë në shkresat e lëndës është përfundimtar dhe, në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, nuk lejohet ankesë kundër tij. Gjykata gjithashtu vëren se vendimi i kontestuar është nxjerrë më 20 janar 2014 dhe parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesën e tij në Gjykatë më 19 shkurt 2014.

34. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh se:

(1) “Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: (c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar.”

(2) “Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

a) kërkesa nuk arsyetohet *prima facie*”.

35. Në kërkesën e tij, parashtruesi pretendon se gjyqtari i procedurës paraprake dhe prokuroria kanë shkelur obligimet e tyre që dalin nga neni 5 [E Drejta për Liri dhe Siguri] dhe nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të KEDNJ-së. Në këtë drejtim, parashtruesi pretendon shkelje të parimit të barazisë së armëve, sepse atij nuk i është dhënë qasje e plotë në shkresat e lëndës së prokurorisë.
36. Gjykata vëren se prokuroria dhe gjyqtari i procedurës paraprake në lidhje me procedurat për qasje në dosjen e lëndës, i kanë arsyetuar vendimet e tyre duke iu referuar dispozitave të ligjit në fuqi. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se ajo që parashtruesi ngre është një çështje e ligjshmërisë, e jo e kushtetutshmërisë.
37. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë (kushtetutshmërinë).
38. Gjykata Kushtetuese nuk mund ta zëvendësojë rolin e gjykatave të rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse si të së drejtës procedurale, ashtu edhe të asaj materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11 të parashtruesve Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
39. Për më tepër, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në vendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake për ta hedhur poshtë kërkesën e parashtruesit për qasje në të gjitha shkresat e lëndës, është i qartë dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata kishte gjetur gjithashtu se procedurat te gjyqtari i procedurës paraprake nuk ishin të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituaniës, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
40. Lidhur me këtë, Gjykata dëshiron t’i referohet kuptimit të akuzës penale, të zhvilluar nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, sipas të cilit “është njoftimi zyrtar që i jepet një individ nga autoriteti

kompetent me një pretendim se ai ka kryer një vepër penale ose ndonjë veprim tjetër i cili bart implikimin e një pretendimi të tillë dhe i cili gjithashtu ndikon në thelb në situatën e të dyshuarit." (Shih Corgliano kundër Italisë, App. nr 8309/78, GJEDNJ, Aktgjykimi i 10 dhjetorit 1982, par. 34).

41. Gjykata vëren se procedura hetimore është në zhvillim e sipër dhe aktakuza nuk është ngritur ende.
42. Në këtë kontekst, Gjykata nuk mund të pajtohet me argumentin e parashtruesit në lidhje me nenin 6 dhe për këtë arsye Gjykata konsideron se bazuar në rrethanat e kërkesës dhe fazën e procedurës, neni 6 i KEDNJ-së nuk është i aplikueshëm siç pretendohet nga parashtruesi i kërkesës.
43. Për më tepër, bazuar në shkresat e lëndës, duket se parashtruesi nuk kishte parashtruar kërkesë te gjyqtari i procedurës paraprake për të përcaktuar ligjshmërinë e paraburgimit, dhe as nuk kërkon në mënyrë specifike nga Gjykata Kushtetuese të kontestojë paraburgimin. Prandaj, neni 5 i KEDNJ-së nuk është i zbatueshëm sa i përket çështjes së paraburgimit, e cila nuk ishte kontestuar nga parashtruesi i kërkesës.
44. Kështu, Gjykata konsideron se procedurat, me të cilat kërkohet qasje në dosjen e prokurorisë, të kontestuar nga parashtruesi, nuk janë në fushën e nenit 5, e as të nenit 6 të KEDNJ-së dhe për këtë arsye kërkesa është e pabazuar.
45. Bazuar në arsyetimin e lartcekur dhe duke iu referuar fazës së tanishme të procedurës, ku procedura e hetimit është ende në zhvillim e sipër dhe aktakuza ende nuk është paraqitur, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit nuk është arsyetuar *prima facie*.
46. Kështu, Gjykata përfundon se kërkesa është e papranueshme.

Kërkesa për masë të përkohshme

47. Parashtruesi gjithashtu kërkon nga Gjykata të shqiptojë një masë të përkohshme, përkatësisht ta detyrojë gjyqtarin e procedurës paraprake që ta urdhërojë prokurorinë për t'i dhënë parashtruesit qasje të plotë në pjesët e shkresave të lëndës.
48. Në këtë drejtim, parashtruesi konstaton se: *"Kjo është e domosdoshme dhe e përshtatshme, sepse refuzimi i tillë i qasjes–*

siç është aktualisht – mbrojtja nuk është në gjendje të vështrojë nëse kushtet për urdhërimin e paraburgimit janë përmbushur, si dhe nëse paraburgimi i tillë është i ligjshëm“.

49. Në mënyrë që Gjykata të lejojë një masë të përkohshme, në pajtim me rregullin 55 (4) të Rregullores së punës, ajo duhet të përcaktojë se:

“(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme; dhe

(...)

Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do ta rekomandojë refuzimin e kërkesës”.

50. Siç u konstatua më lart, kërkesa është e papranueshme dhe, për këtë arsye, nuk ka rast *prima facie* për shqiptimin e masës së përkohshme. Për këto arsye, kërkesa për masë të përkohshme është qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 27 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) a) dhe 55 (4) të Rregullores së punës, më 12 mars 2014, njëzëri:

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për Masë të Përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI156/13, Reshat Sahitaj, Aktvendim i datës 21 janar 2014 - Vlerësim Kushtetutshmërisë së Njoftimit të Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit - Prishtinë

Rasti KI156/13, vendimi i 21 janarit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, e drejta e pronës, mos-shterimi,

Parashtruesi i kërkesës, Reshat Sahitaj, parashtroi kërkesës në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke kontestuar Njoftimin e Drejtorisë së Urbanizmit, të Ndërtimit dhe të Mbrojtjes së Mjedisit, – Prishtinë sepse *"çdo kund nëbotën e civilizuar, prona private konsiderohet të jetë e shenjtë"*. Parashtruesi i kërkesës nuk ka specifikuar asnjë dispozitë kushtetuese.

Lidhur me çështjen e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata konstatoi se kërkesa ishte e papranueshme, sepse parashtruesi i kërkesës nuk ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në fuqi, siç kërkohet në mënyrë që të jetë në gjendje të parashtojë kërkesë në Gjykatë. Prandaj, Gjykata konstatoi se kërkesa ishte e papranueshme në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47.2 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) a) të Rregullores së Punës.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në**

Rastin Nr. KI156/13

Parashtrues

Reshat Sahitaj

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Drejtorisë së
Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit - Prishtinë**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Reshat Sahitaj (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi), me vendbanim në Fushë-Kosovë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Njoftimin e Drejtorisë së Urbanizmit, të Ndërtimit dhe të Mbrojtjes së Mjedisit, të 12 prillit 2013, i cili iu dorëzua parashtruesit në një datë të pacaktuar.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Drejtorisë së Urbanizmit, të Ndërtimit dhe të Mbrojtjes së Mjedisit, duke pretenduar se *“çdo kund në botën e civilizuar, prona private konsiderohet të jetë e shenjtë”*.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për

Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 4 tetor 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 28 tetor 2013, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI156/13, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI156/13, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
7. Më 12 nëntor 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoj që parashtruesi të dorëzojë ndonjë vendim të gjykatës në lidhje me çështjen, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, të cilat parashtruesi nuk i ka dorëzuar deri më tani. Të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Drejtorinë e Urbanizmit, të Ndërtimit dhe të Mbrojtjes së Mjedisit – Prishtinë për kërkesën e parashtruesit në Gjykatë.
8. Më 21 janar 2014, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Në një kohë të caktuar të vitit 2003, parashtruesi filloi ndërtimin e shtëpisë së tij.
10. Më 6 mars 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Komunën e Prishtinës për lejen e ndërtimit, nr. 05-350-25236. Parashtruesi pretendon se ai kurrë nuk kishte pranuar një përgjigje nga *“autoritetet urbane kompetente”*. Si rezultat, parashtruesi vazhdoi me ndërtimin e shtëpisë së tij.
11. Më 12 prill 2013, parashtruesi ishte njoftuar nga Komuna e Prishtinës se *“Planifikimi urban i lagjes [së tij] do të përfundonte më 12 maj 2013 dhe se [ai] do të njoftohej në detaje me planin më*

të ri urban”, por nuk kishte specifikuar se parashtruesi do të duhej të ndërpriste ndërtimin e shtëpisë.

12. Më 14 prill 2013, parashtruesi ushtroi ankesë në Ministrinë e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor. Sidoqoftë, sipas parashtruesit, ai nuk e ka pranuar vendimin përfundimtar për këtë çështje.

Pretendimet e parashtruesit

13. Parashtruesi pretendon se *“e drejta e pronës si dhe çdo rregullore profesionale janë shkelur, sepse nuk ka asnjë arkitekt normal që do të planifikonte një rrugë të tillë”*.
14. Parashtruesi gjithashtu pretendon se *“kudo në botën e civilizuar prona private konsiderohet e shenjtë. Duke u nisur nga fakti se Komuna nuk është përgjigjur me kohë kërkesës sime; Duke u nisur nga fakti se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nuk i është përgjigjur asnjëherë ankesës sime; Duke u nisur nga fakti se toka në ngastrën kadastrale 461/3, është prona e ime. Unë e kam filluar ndërtimin e shtëpisë sime sipas planit të arkitektit tim dhe me të gjitha normat dhe preventivat e nevojshme për ndërtim të një shtëpie banimi 4-katëshe*.
15. Prandaj, parashtruesi kërkon *“anulimin e vendimit absurd për të ndërtuar rrugë lokale që do të shkaktojë shkatërrimin e disa shtëpive të reja. Nëse nuk do të kishte alternativë tjetër, ne do të pajtoheshim me këtë, por rruga ekziston”*.

Pranueshmëria e kërkesës

16. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë ankesën e parashtruesit, është e nevojshme që së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të parapara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës.
17. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të

garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

18. Gjkata gjithashtu i referohet nenit 47.2 të Ligjit, i cili parasheh:

“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

19. Përfundimisht, Gjkata i referohet rregullit 36 (1) a) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjkata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

a) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar”.

20. Gjkata dëshiron të theksojë se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t’u ofrojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë edhe gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive për shkeljen e të drejtave kushtetuese. (shih, Rasti KI65/11, parashtrues Holding Corporation “Emin Duraku”, Aktvendimi për papranueshmëri, i 21 janarit 2013).
21. Duke pasur këtë parasysh, nga dokumentacioni i dorëzuar nga parashtruesi mund të shihet qartë se parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas ligjit. Parashtruesi nuk e ka pranuar vendimin përfundimtar nga Drejtoria e Urbanizmit, e Ndërtimit dhe e Mbrojtjes së Mjedisit – Prishtinë dhe se ka pranuar vetëm një njoftim, me të cilin informohej parashtruesi se Drejtoria do ta njoftojë atë në një datë të pacaktuar me vendimin e tyre në lidhje me këtë çështje. Për më tepër, parashtruesi nuk ka dëshmuar se ka ushtruar ankesë në gjykatat e rregullta.
22. Në këtë aspekt, Gjkata vëren se ankesa e parashtruesit të kërkesës është në procedurë e sipër para autoriteteve publike. Andaj, kërkesa e parashtruesit është e parakohshme për shkak se nuk ka vendim përfundimtar për t’u kontestuar në këtë Gjykatë. Megjithatë, Gjkata vëren se parashtruesit të kërkesës nuk i mohohet e drejta për të paraqitur përsëri kërkesë në këtë Gjykatë duke pretenduar shkelje të të drejtave të tij kushtetuese, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion.

23. Nga kjo rrjedh se parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas ligjit të zbatueshëm, siç kërkohet nga ai, në mënyrë që të mund të paraqesë kërkesë në Gjykatë. Gjykata thekson më tej se nuk ka vendim përfundimtar, për t'u kontestuar në këtë Gjykatë.
24. Prandaj, kërkesa duhet të konsiderohet e papranueshme, për shkak të mosshterimit, në përputhshmëri me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 47.2 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykatës Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 47.2 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) a) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 21 janar 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI123/13, Afrim Karaxha, Aktvendim i datës 20 janar 2014 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. Mlc. nr. 93/2011, të 1 shkurtit 2013

Rasti KI123/13, vendimi i 20 janarit 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, ndarja e pasurisë, zvarritja e procedurës, *ratione temporis*, qartazi e pabazuar

Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. Mlc. nr. 93/2011, të 1 shkurtit 2013. Në aktgjykimin e saj, në rastin lidhur me ndarjen e pronës, të fituar gjatë bashkësisë martesore, Gjykata Supreme aprovoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të parashtruar nga Prokurori i Shtetit dhe kërkesën për revizion, të ushtruar nga ish-bashkëshortja e parashtruesit, me te cilin e ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë dhe e vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë.

Parashtruesi i kërkesës pretendon zvarritjen e procedurës në Gjykatën Komunale në Prishtinë dhe pretendimeve të mëtejshme se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme ishte nxjerrë në shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut.

Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën Komunale në mes të vitit 2001 dhe 2005, Gjykata Kushtetuese vlerësoi se pretendimet e parashtruesit nuk janë *ratione temporis* në pajtim me Kushtetutën.

Në lidhje me pretendimet e parashtruesit lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Gjykata Kushtetuese konstatoi se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk i arsyetojnë pretendimet për shkeljen e të drejtave kushtetuese. Gjykata Kushtetuese deklaroi kërkesën të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI123/13
Parashtrues
Afrim Karaxha
Vlerësimi i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. Mlc. Nr. 93/2011,
të 1 shkurtit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan,
gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova,
gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Afrim Karaxha (në tekstin e mëtejme: parashtruesi), i cili përfaqësohet nga z. Mahmut Halimi dhe z. Betim Shala, avokatë nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. Mlc. Nr. 93/2011, i 1 shkurtit 2013, i cili iu dorëzua parashtruesit më 25 prill 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. Mlc. nr. 93/2011, të 1 shkurtit 2013. Në aktgjykimin e saj, në rastin lidhur me ndarjen e pronës, të fituar gjatë bashkësisë martesore, Gjykata Supreme aprovoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të parashtruar nga Prokurori i Shtetit dhe kërkesën për revizion, të ushtruar nga ish-bashkëshortja e parashtruesit, me të cilin e ndryshoi aktgjykimin e

Gjykatës së Qarkut në Prishtinë dhe e vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-131 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 14 gusht 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 30 gusht 2013, bazuar në Vendimin GJR. KI123/13 të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejshëm: Kryetari), gjyqtarja Snezhana Botusharova u caktua gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, bazuar në Vendimin KSH. KI123/13 të Kryetarit u caktua Kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.
7. Më 23 shtator 2013, Gjykata e informoi parashtruesin dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe kërkoi dorëzimin e fletëkthesës, e cila tregon datën se kur i ishte dorëzuar parashtruesit Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. Mlc. nr. 93/2011, i 1 shkurtit 2013.
8. Më 2 tetor 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë e dorëzoi në Gjykatë kopjen e fletë-kthesës, e cila tregon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. Mlc. nr. 93/2011, i 1 shkurtit 2013, i ishte dorëzuar parashtruesit më 25 prill 2013.
9. Më 20 janar 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesi ishte i martuar me ish-bashkëshorten e tij prej vitit 1978 deri më 2000.

11. Më 5 nëntor 1980, parashtruesi i kërkesës dhe ish-bashkëshortja e tij kishin lidhur një kontratë për blerjen e një banese në Prishtinë. Bazuar në shkresat e lëndës, babai i parashtruesit kishte kontribuar me një shumë të caktuar për blerjen e asaj banese.
12. Më 12 gusht 1982, parashtruesi, babai i tij dhe ish-bashkëshortja e tij kishin arritur një marrëveshje, duke përcaktuar se, në rast të ndonjë kontesti në mes të palëve, palët pajtohen se pronësia e banesës do të ndahet në bazë të investimeve të secilës nga palët. Kjo marrëveshje ishte vërtetuar nga Gjykata Komunale në Prishtinë (Vendimi Nr. 2709/12).
13. Pas shkurorëzimit, më 11 maj 2000, ish-bashkëshortja e parashtruesit dhe tre fëmijët e tyre mbetën në banesën e tyre të përbashkët.
14. Më 10 korrik 2000, parashtruesi paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë, duke kërkuar ndarjen e pronës së fituar gjatë bashkësisë martesore dhe gjithashtu kërkoj pronësinë mbi banesën, në pjesën për të cilën ai dhe i ati i tij kontribuan për blerjen e saj.
15. Më 12 korrik 2005, Gjykata Komunale në Prishtinë mori Aktgjykimin C. nr. 330/2000, me të cilin e refuzoi pjesërisht padinë e parashtruesit dhe e aprovoi në tërësi kundërpadinë e ish-bashkëshortes së tij, duke vërtetuar se parashtruesi i kërkesës dhe ish-bashkëshortja janë bashkëpronarë, secili me nga 1/2 të pjesës ideale të banesës.
16. Në aktgjykimin e lartcekur, Gjykata Komunale në Prishtinë pretendoi:

[...]

“Kështu, pretendimet e paditësit-kundër të paditurit se kontributi i tij është me i lartë vlerësohet pa ndikim në bindjen e gjykatës. Këtë nga shkaku se si rezulton nga vet deklaratat e ndërgjyqsve të dëgjuar si palë në këtë çështje fare kuartë përfundohet se që të dy bashkëshortët janë angazhuar në kuadër të rrethanave konkrete të rastit, se të ardhurat nga puna i kanë pasur përafërsisht të njëjta, se dallimi në të ardhura dhe fitime nuk ishte i një vëllimi i cili do të përfaqësonte shfrytëzim të njenit bashkëshort nga ana e tjetrit, se e paditura përveç punës në ndërmarrje është kujdesur edhe për paditësit dhe për tre fëmijët të përbashkët dhe për të gjitha

punët e amvisërisë, gjë e cila përfaqëson angazhim të shtuar dhe e cila në kuptim të nenit 314 të Ligjit mbi martesën dhe marrëdhëniet familjare është me ndikim me rastin e gjyqimit për vëllimin e kontributit të secilit bashkëshort në fitimin e pasurisë gjatë martesës”.

[...]

Kështu, në praninë e faktit se kontraktues në kontratën mblerjen e banesës ishin paditësi Afrim dhe e paditura [...], se banesa në kadastrë është regjistruar vetëm në emër të tyre si dhe rrethanave se ndaj tyre asnjëherë nuk kishte kërkesë të personave të tretë, gjykata vlerëson se çështja duhet gjykuar vetëm si bashkëpronësi martesore. Pretendimet e paditësit se kishte ndihmë nga babai dhe vëllai në rastin konkret vlerësohen pa ndikim derisa diç e tillë nuk është bërë me përcaktim vetëm për njërin bashkëshort. Kështu, në pajtim me rregullat juridike ndihma e dhanë një bashkësie martesore konsiderohet se u është bërë të dy bashkëshortëve nëse shprehimisht nuk përcaktohet ndryshe”.

[...]

17. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Njësinë e Inspektimit Gjyqësor të Departamentit të Drejtësisë (UNMIK) duke pretenduar sjelljen e pahijshme të gjyqtarës së Gjykatës Komunale të caktuar në lëndë dhe të zvarritjes së panevojshme të procedurës.
18. Rrjedhimisht, më 5 dhjetor 2005, drejtori i Departamentit të Drejtësisë, iu përgjigj ankesës së parashtruesit të kërkesës, duke deklaruar se në bazë të hetimeve të kryera nga Njësia e Inspektimit Gjyqësor, Njësia nuk mundi të gjejë prova bindëse, të cilat do t'i mbështesnin pretendimet e parashtruesit. Duke iu referuar kohëzgjatjes së procedurës, është konstatuar që Gjykata mbajti 15 seanca nga 10 prilli 2001, data kur gjyqtarja është caktuar në lëndë, deri më 12 korrik 2005, data kur Gjykata Komunale në Prishtinë nxori aktgjykimin e saj. Sipas kësaj Njësie, vonesat e procedurës ishin për shkak se rasti ishte i ndërlikuar.
19. Kundër Aktgjyqimit të Gjykatës Komunale, C. nr. 330/2000, të 12 korrikut 2005, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.
20. Më 12 dhjetor 2007, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktvendimin Ac. nr. 953/2005, ka prishur Aktgjykimin e Gjykatës

Komunale në Prishtinë, C. nr. 330/2000, të 12 korrikut 2005, dhe e kishte kthyer çështjen për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

21. Më 10 qershor 2008, Gjykata Komunale, me Aktgjykimin C. nr. 302/2007, e aprovoi kërkesën e ish-bashkëshortes së parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi që parashtruesi dhe ish-bashkëshortja janë bashkëpronarë, secili 1/2 të pjesës ideale të banesës.
22. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale (C. nr. 302/2007, të 10 qershorit 2008).
23. Më 24 shkurt 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin Ac. nr. 1546/2008, e aprovoi ankesën e parashtruesit dhe ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale, C. nr. 302/2007, të 10 qershorit 2008, me të cilin e aprovoi padinë e parashtruesit dhe vërtetoi se parashtruesi është pronar i pjesës së banesës për 85.48% dhe ish-bashkëshortja e tij, pronare e pjesës së banesës për 14.52%.
24. Në aktgjykimin e lartcekur, Gjykata e Qarkut gjeti se:

[...]

“Me qenë se pranë gjykatës së shkallës së parë plotësisht është vërtetuar gjendja faktike mirëpo gabimisht është aplikuar e drejta materiale kur gjykata e shkallës së parë bëri ndarjen e fitimit të bashkëshortëve sipas kontributit të bashkëshortëve martesorë, ndërsa jo sipas marrëveshjes së tyre me shkrim, atëherë aktgjykimin e shkallës së parë është dashtë me e ndryshuar dhe pronësinë e banesës lëndore me vërtetuar në bazë të kontratës Vr.nr.2709/82 të 12.08.1982 dhe konstatimit të ekspertit me të cilin është vërtetuar përqindja e pronësisë sipas kontributit të bashkëshortëve”.

25. Më 19 prill 2011, parashtruesi i kërkesës paraqiti propozim për ekzekutimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 1546/08, të 24 shkurtit 2011, në Gjykatën Komunale në Prishtinë, gjegjësisht, për të detyruar ish-bashkëshorten e tij t'ia dorëzojë parashtruesit posedimin e banesës.
26. Më 6 qershor 2012, Gjykata Komunale e refuzoi përmbarimin e propozuar. Kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

27. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktvendimin Ac. nr. 574/2012, të 6 nëntorit 2012, ka aprovuar ankesën e parashtruesit si të bazuar dhe e ka kthyer rastin për rigjykim në Gjykatën Komunale në Prishtinë.
28. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 1546/08, të 24 shkurtit 2011, Prokurori i Shtetit paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe ish-bashkëshortja e parashtruesit si e paditur-kundër-paditëse paraqiti revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar aplikimin e gabueshëm të së drejtës materiale dhe shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore.
29. Më 1 shkurt 2013, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin Rev. Mlc. Nr. 93/2011, i aprovoi si të bazuara kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe revizionin e së paditurës–kundër-paditëses, me të cilin e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, (Ac. nr. 1546/2008, të 24 shkurtit 2011) ashtu që Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 302/2007, i 10 qershorit 2008, mbeti në fuqi.
30. Në aktgjykimin e lartcekur, Gjykata Supreme konstatoi:

[...]

“se gjykata e shkallës së parë ka zbatuar drejt të drejtën materiale, kur ka vërtetuar se ndërgjyqësit janë pronarë të ½ të pjesës ideale të banesës kontestuese, përcaktuar si në dispozitiv të aktgjykimit”.

31. Gjykata Supreme, në Aktgjykimin e saj, argumentoi më tej:

[...]

“Kontrata për blerjen e banesës (e vërtetuar në Gjykatën komunale në Prishtinë, dat 12.08.1982), lidhur në mes të Afrim Karaxhës dhe [bashkëshortes], dhe të atit të Afrim Karaxhës dhe [...] si dhe të atit të Afrim Karaxhës, nuk mund të trajtohet si marrëveshje për pjesëtimin e pasurisë së përbashkët të ndërgjyqësve, ashtu si gabimisht vlerëson gjykata e shkallës së dytë. Mënyra e blerjes dhe fitimit të pronësisë në banesën kontestuese është përcaktuar me kontratën mbi blerjen dhe fitimin e së drejtës së pronësisë së banesave dt. 05.11.1980 dhe kjo është pasuria e bashkëshortëve, e krijuar gjatë bashkësisë martesore. Andaj, kontrata e lidhur më vonë, më 12.08.1982 në të cilën gjykata e shkallës së dytë e mbështetë aktgjykimin

është lidhur dy vite më vonë, qëllimi i ndërgjyqësve nuk ka qenë ndarja e pasurisë së tyre me marrëveshje, pasi që banesa është blerë qysh në vitin 1980. Kjo pasuri është qeverisur me marrëveshje nga të dy bashkëshortët dhe është regjistruar në librat publikë në emër të dy bashkëshortëve, në pajtim të nenit 310, po të njëjtit ligj, ku parashihet se të drejtat e bashkëshortëve për sendet e paluajtshme që janë pasuri e tyre e përbashkët regjistrohen në regjistra publikë për evidencën e pasurisë së paluajtshme në emër të dy bashkëshortëve si pasuri e tyre e përbashkët në pjesë të papërcaktuara.

Aplikimi i gabuar i së drejtës materiale rezulton në faktin se gjykata e shkallës së dytë qëndrimin e vet nuk e ka mbështetur në dispozitat tjera të cilat rregullojnë bashkëpronësinë e bashkëshortëve. Dispozita e nenit 312, al. 2 të LMF, përjashtohet shprehimisht mundësinë e kontraktimit në dëm të pasurisë së përbashkët të fituar gjatë martesës”.

[...]

“Kontributi i bashkëshortëve nuk mund të matet ashtu si është bërë me ekspertizë pasi që eksperti kontributin e ka llogaritur në bazë të kredisë së marrë nga ana e bashkëshortëve dhe për këtë arsye nuk mund të vlerësohet nga aplikimi i drejtë i ligjit. Andaj, me të drejtë theksohet në revizion dhe në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me aplikimin e gabuar të së drejtës materiale për cilën arsye kjo gjykatë aktgjykimin e goditur e ndryshoi dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ka mbetur në fuqi”.

[...]

Pretendimet e parashtruesit

32. Në lidhje me pretendimet e parashtruesit dhe kërkesën drejtuar Gjykatës, pretendimet e parashtruesit ndahen si në vijim:
 - A. Pretendimi lidhur me procedurën në Gjykatën Komunale në Prishtinë; dhe
 - B. Pretendimi lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme.
33. Lidhur me procedurën në Gjykatën Komunale në Prishtinë, parashtruesi argumenton: [...] *“Gjykata Komunale me veprimet e saja dhe në disa raste me mosveprim ka shkelur të drejtat e*

garantuara me ligjet vendore, me Kushtetutën e Kosovës, dhe aktet ndërkombëtare. Gjykata Komunale ka zvarritur procedurën e cila është procedure e ndjeshme dhe lidhet me raportet familjare, janë mbajtur diku 15-16 seanca gjyqësore prej 10 prillit 2001 deri me 12 korrik 2005. Gjyqtarja gjykuese nuk ka poseduar mirësjellje dhe trajtim të barabarte të palëve në procedurë. E njëjta ka neglizhuar pretendimet permanente të parashtruesit për vlerësimin e pasurisë së veçantë në pasurinë e bashkësisë martesore, ka refuzuar pa arsye ligjore pretendimet e parashtruesit për Caktimin e Masës së Përkohshme të pasurisë së përbashkët, ka tejzgjatur procedurën e ekzekutimit të Aktgjykimit të shkallës së dytë, deri më tani nuk ka lejuar që parashtruesi të shfrytëzojë dhe disponojë me “pjesën” e pasurisë së tij. Procedura e përmbarimit-ekzekutimit nga Gjykata Komunale ka filluar me Propozimin e parashtruesit C.nr. 572/11 më 19.04.2011 kurse ende nuk ka përfunduar. Parashtruesi i kërkesës për 13 vite me veprimet e Gjykatës është privuar arbitrarisht nga pjesa e pronës së tij”.

34. Në këtë drejtim, ai pretendon shkelje të nenit 31.1 dhe 2 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës dhe të nenit 6, par. 1 [E Drejta për një Proces të Rregullt], dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
35. Lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. Mlc. 93/2011, të 1 shkurtit 2013, parashtruesi pretendon se: [...] ” Gjykata Supreme ka vendosur njëjtë si Gjykata Komunale, nuk ka administruar si provë relevante, pasurinë e veçantë të parashtruesit gjatë kohës së bashkësisë martesore, të cilat pretendime tërë kohën i ka paraqitur parashtruesi, në mënyrë që të vërtetojë ndikimin apo mosndikimin e kësaj prove në ndarjen e pasurisë. Në arsyetimin e Aktgjykimit i cili ka qenë rast i fundit për parashtruesin dhe në të cilin ka shpresuar për triumfin e drejtësisë parashtruesi. Gjykata nuk ka dhënë arsye të qarta juridiko-kushtetuese në aspektin e të gjitha fakteve-provave të cilat janë relevante për dhënien e një Vendimi të ligjshëm, por menjëherë ka vlerësuar si të pabazuara pretendimet e parashtruesit. Fare nuk ka përmendur nenin 5 të Kontratës – që ku specifikuar qartë se në rast kontesti në marrëdhëniet bashkëshortore-prindërore, palët janë marrë vesh se banesën do ta ndajnë në bazë të investimit të secilit”.
36. Parashtruesi më tej pretendon që [...] “për shkak të marrjes së një Aktgjykimi jo të drejtë nga Gjykata Supreme, cenimin e të

drejtave të parashtrimin të provave relevante, ndershmërisë së procedurës, se ndërhyrja e kësaj natyre nuk është proporcionale dhe e mjaftueshme që të sigurojë individin për garancitë procedurale që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike dhe veçmas në një shoqëri e cila po ecë në drejtim të përfundimit të parimeve dhe standardeve për gjykim të drejtë dhe respektimit të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, të garantuara me Kushtetutë dhe aktet ndërkombëtare”.

37. Lidhur me këtë, parashtruesi pretendon shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, nenit 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt], dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, neni 7, neni 10 dhe neni 17 i Deklaratës Universale për të Drejta të Njeriut.

38. Parashtruesi konkludon, duke kërkuar nga Gjykata që:

“Kërkesën e parashtruesit të kërkesës ta shpallë të pranueshme.

- Në përputhje me Rregullin 39 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të urdhëroj mbajtjen e seancës dëgjimore;*

- Të konstatojë cenimin e të drejtave individuale të parashtruesit të kërkesës Afrim Karaxhës, të garantuara me nenet 31, 46 dhe 54 të Kushtetutës së*

Republikës së Kosovës, nenet 7, 10 dhe 17 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, nenin 6 dhe nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në procedurat gjyqësore të Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe marrjes së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës; dhe të

- Përcaktojë çfarëdo të drejte ose përgjegjësie për palët në kërkesë që kjo Gjykatë e nderuar i vlerëson si të bazuara juridikisht dhe të arsyeshme”.*

Pranueshmëria e kërkesës

39. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, duhet së pari të shqyrtojë nëse ai i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës.

40. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113, paragrafi 7, i Kushtetutës, i cili parasheh që:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

41. Përveç kësaj, neni 49 i Ligjit parasheh që *“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”.*
42. Në rastin konkret, Gjykata vëren se janë shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesit i është dorëzuar aktgjykimi i Gjykatës Supreme më 25 prill 2013, dhe ai e parashtroi kërkesën e tij në Gjykatë, më 14 gusht 2013.
43. Kështu, Gjykata konsideron se parashtruesi është palë e autorizuar dhe i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion me ligjin e zbatueshëm dhe kërkesa është paraqitur brenda afatit katër (4) muajor.
44. Megjithatë, Gjykata gjithashtu duhet të marrë parasysh rregullin 36 të Rregullores, i cili parasheh:

(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: (c) kërkesa është qartazi e bazuar..”.

“(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

[...], ose

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

Pretendimi në lidhje me procedurën në Gjykatën Komunale në Prishtinë

45. Në këtë drejtim, parashtruesi pretendon që: [...] *“Gjykata Komunale ka zvarritur procedurën e cila është nj; procedurë e*

ndjeshme dhe lidhet me raportet familjare, janë mbajtur diku 15-16 seanca gjyqësore prej 10 prillit 2001 deri më 12 korrik 2005. Gjyqtarja gjykuese nuk ka poseduar mirësjellje dhe trajtim të barabarte të palëve në procedurë. E njëjta ka neglizhuar pretendimet permanente të parashtruesit për vlerësimin e pasurisë së veçantë në pasurinë e bashkësisë martesore, ka refuzuar pa arsye ligjore pretendimet e kërkuësit për Caktimin e Masës së Përkohshme të pasurisë së përbashkët, ka tejzgjatur procedurën e ekzekutimit të Aktgjykimit të shkallës së dytë, deri më tani nuk ka lejuar që parashtruesi të shfrytëzojë dhe disponoj me “pjesën” e pasurisë së tij. Procedura e përmbarimit-ekzekutimit nga Gjykata Komunale ka filluar me Propozimin e parashtruesit C. nr. 572/11 më 19.04.2011 kurse ende nuk ka përfunduar. Parashtruesi i kërkesës për 13 vite me veprimet e Gjykatës është privuar arbitrarisht nga pjesa e pronës së tij”.

46. Parashtruesi i kërkesës pretendon zvarritjen e procedurës nga ana e Gjykatës Komunale në Prishtinë, gjatë periudhës ndërmjet vitit 2001 dhe 2005 dhe periudhës pasi ai e ka paraqitur një propozim për ekzekutimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 1546/08, të 24 shkurtit 2011.
47. Në lidhje me pretendimin e parë të lartcekur, gjegjësisht për periudhën 2001-2005, për ta përcaktuar juridiksionin kohor të Gjykatës, është me rëndësi të identifikohet, në secilin rast konkret, koha e saktë e shkeljes së pretenduar. Me këtë rast, Gjykata duhet të marrë parasysh faktet për të cilat parashtruesi ankohet dhe fushëveprimin e së drejtës kushtetuese që pretendohet të jetë shkelur (shih, *mutatis mutandis*, Bleëia kundër Kroacisë, kërkesa Nr. 59532/0, GJEDNJ, Aktgjykimi i 8 marsit 2006).
48. Në këtë drejtim, Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 (3) h), i cili përcakton:

[...]

“(3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:

h) kërkesa nuk është ratione temporis në pajtim me Kushtetutën”.

49. Gjykata vëren se pretendimi i parashtruesit në lidhje me procedurën gjyqësore në Gjykatën Komunale në mes të vitit 2001 dhe 2005 i referohet një periudhe kohore para 15 qershorit 2008,

datë kur Kushtetuta ka hyrë në fuqi, dhe para se Gjykata të kishte juridiksion kohor. Prandaj pretendimet e lartpërmendura të parashtruesit të kërkesës konsiderohen si të papajftueshme *ratione temporis* me Kushtetutën (shih, KI25/09, parashtrues Shefqet Haxhiu, Aktvendimi për papranueshmëri, i 25 qershorit 2010).

50. Në lidhje me procedurën për përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 1546/08, të 24 shkurtit 2011, Gjykata vëren se Gjykata Komunale në Prishtinë, në Aktvendimin e saj të 6 qershorit 2012, e refuzoi si të pabazuar propozimin e parashtruesit për ekzekutimin e aktgjykimit të lartpërmendur.
51. Gjykata Komunale në Prishtinë e arsyetoi vendimin e saj, duke konstatuar se Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut, i 24 shkurtit 2011, për të cilin parashtruesi propozoj përmbarimin, nuk përmban elemente të përmbarimit, siç parashihet me nenin 26 të Ligjit për procedurën përmbarimore.
52. Kundër Aktvendimit të lartpërmendur, parashtruesi i kërkesës ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, e cila vendosi (Aktvendimi i 6 nëntorit 2012) për ta kthyer çështjen për rigjykim në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Në ndërkohë, përkatësisht më 1 shkurt 2013, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin e saj, vendosi të ndryshojë Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 1546/08, të 24 shkurtit 2011, për të cilin parashtruesi propozoi përmbarimin dhe vendosi të vërtetojë Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë.
53. Në këtë drejtim, parashtruesi nuk i ka mbështetur pretendimet e tij, duke treguar se si dhe zvarritja e përmbarimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 1546/08, të 24 shkurtit 2011, nga Gjykata Komunale në Prishtinë, i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë.
54. Bazuar në shkresat e lëndës, parashtruesi nuk e ka ngritur këtë zvarritje të procedurës përmbarimore në gjykatat e rregullta, dhe as nuk ka dëshmuar se ai është përpjekur ta përshpejtojë procedurën.
55. Prandaj, ky pretendimi parashtruesit është qartazi i pabazuar.

Pretendimi lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme

56. Lidhur me aktgjykimin e Gjykatës Supreme, parashtruesi pretendon se: [...]”*Gjykata Supreme ka vendosur njëjtë si Gjykata*

Komunale, nuk ka administruar si prov relevante, pasurinë e veçantë të parashtruesit gjatë kohës së bashkësisë martesore, të cilat pretendime tërë kohën i ka paraqitur parashtruesi, në mënyrë që të vërtetojë ndikimin apo mosndikimin e kësaj prove në ndarjen e pasurisë. Në arsyetimin e Aktgjykimit i cili ka qenë rast i fundit për parashtruesin dhe në të cilin ka shpresuar për triumfin e drejtësisë parashtruesi. Gjykata nuk ka dhënë arsye të qarta juridiko-kushtetuese në aspekt të gjitha fakteve-provave të cilat janë relevante për dhënien e një Vendimi të ligjshëm, por menjëherë ka vlerësuar si të pabazuara pretendimet e parashtruesit. Fare nuk ka përmendur nenin 5 të Kontratës – që ku specifikuar qartë se në rast kontesti në marrëdhëniet bashkëshortore-prindërore, palët janë marrë vesh se banesën do ta ndajnë në bazë të investimit të secilit”.

57. Në rastin e parashtruesit, Gjykata Supreme e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr.1546/08, të 24 shkurtit 2011, ku arriti në përfundim se Gjykata e Qarkut në Prishtinë gabimisht e kishte zbatuar të drejtën materiale.
58. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabimet e fakteve ose ligjit, që pretendohet të jenë kryer nga Gjykata Supreme, përveç dhe për aq sa ajo mund të ketë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë.
59. Gjykata më tej ripërsëritë se sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës, Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 28; shih, gjithashtu, Rastin KI70/11 të parashtruesve Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
60. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, *inter alia*, Eduards kundër Mbretërisë së Bashkuar, kërkesa Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).

61. Gjykata Supreme, në Aktgjykimin e saj, qartë arsyetoi se; [...]”Kontrata për blerjen e banesës (vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë), më 12.08.1982), lidhur në mes Afrim Karaxhës dhe [bashkëshortes] dhe të atit të Afrim Karaxhës, nuk mundet të trajtohet si marrëveshje për pjesëtimin e pasurisë së përbashkët të ndërgjyqësve, ashtu si gabimisht vlerëson gjykata e shkallës së dytë. Mënyra e blerjes dhe fitimit të pronësisë në banesën kontestuese është përcaktuar me kontratën mbi blerjen dhe fitimin e të drejtës së pronësisë së banesave, të 05.11.1980. dhe kjo është pasuria e bashkëshortëve e krijuar gjatë bashkësisë martesore” dhe vërtetoi se “Gjykata e shkallës së parë drejt ka zbatuar të drejtën materiale kur ka vërtetuar se ndërgjyqësit janë pronarë të ½ pjesës ideale të banesës kontestuese” [...] ”që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me aplikimin e gabuar të së drejtës materiale për cilën arsye kjo gjykatë aktgjykimin e goditur e ndryshoi dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ka mbetur në fuqi”.
62. Prandaj, Gjykata vëren se arsyetimi në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme është i qartë dhe, pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu ka gjetur se procedurat në gjykatat e rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituaniës, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).
63. Për arsyet e mësipërme, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk i arsyetojnë pretendimet për shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese.
64. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me rregullin 36 (1) c), 36 (2) b) dhe 36 (3) h) të Rregullores së punës, më 20 janar 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KO44/14, Aktgjykim i datës 31 mars 2014 - Vlerësimi i amendamenteve të Kushtetutës të propozuara nga Qeveria, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 11 mars 2014, me shkresën Nr. 04-DO-2186

Rasti KO44/14, vendimi i 31 marsit 2014.

Fjalët kyçe: Amendamentet e propozuara të Kushtetutës, kërkesa e Kryetarit të Kuvendit, Kapitulli II i Kushtetutës, kërkesë e pranueshme, Forcat e Armatosura të Kosovës.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, në përputhje me nenin 114.3 të Kushtetutës, ia paraqiti Gjykatës Kushtetuese Propozimin e Qeverisë për gjashtëmbëdhjetë (16) amendamente të Kushtetutës, për të vlerësuar paraprakisht nëse amendamentet e propozuara nuk pakësojnë ndonjë të drejtë dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese njëzëri vendosi se kërkesa është e pranueshme dhe se amendamentet e propozuara të Kushtetutës nuk i zvogëlojnë të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

AKTGJYKIM
në
Rastin Nr. KO44/14
Vlerësimi i amendamenteve të Kushtetutës të propozuara nga
Qeveria, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së
Kosovës më 11 mars 2014, me shkresën Nr. 04-DO-2186

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Me Vendimin nr. 1/174, të 6 marsit 2014, Qeveria e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Qeveria), duke u mbështetur në nenin 144.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), propozoi një numër amendamentesh në Kushtetutë.
2. Më 11 mars 2014, Kryetari i Kuvendit të Kosovës, në përputhje me nenin 114.3 të Kushtetutës, ia paraqiti Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) Propozimin e Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës, për të vlerësuar paraprakisht nëse amendamentet e propozuara nuk pakësojnë ndonjë të drejtë dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës.
3. Prandaj, Kryetari i Kuvendit është parashtrues i kërkesës në procedurën në Gjykatë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës janë 16 (gjashtëmbëdhjetë) amendamente të Kushtetutës, që u miratuan më 6 mars 2014 me Vendimin e Qeverisë, Nr. 01/174.

Baza juridike

5. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.9 dhe në nenin 144.3 të Kushtetutës; në nenin 20 dhe në nenin 54 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji); dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 11 mars 2014, parashtruesi i kërkesës, me shkresën nr. 04-DO-2186, ia paraqiti Gjykatës amendamentet e propozuara nga Qeveria, duke kërkuar që Gjykata të vlerësojë paraprakisht nëse këto amendamente nuk pakësojnë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Këto amendamente paraqiten në Aneksin e bashkëngjitur më poshtë.
7. Më 11 mars 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KO44/14, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KO44/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 14 mars 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga parashtruesi të dorëzojë informacione dhe dokumente mbështetëse përkitazi me procedurat e ndërmarra në bazë të nenit 144 të Kushtetutës jo më vonë se deri më 20 mars 2014. Për më tepër, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që t'ia ofrojë një kopje të këtij njoftimi secilit deputet të Kuvendit, ashtu që atyre t'u mundësohet t'ia paraqesin Gjykatës komentet e tyre për kërkesën e lartpërmendur, posaçërisht në dritën e interpretimit të nenit 144.3 të Kushtetutës nga ana e kësaj gjykate në raste të ngjashme, por jo më vonë se 22 marsi 2014.
9. Më 14 mars 2014, Gjykata, po ashtu, e njoftoi Kryeministrin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi që i njëjti të dorëzojë informacione dhe dokumente mbështetëse për procedurat e ndërmarra, në bazë të nenit 144 të Kushtetutës, por jo më vonë se deri më 22 mars 2014.
10. Më 14 mars 2014, një kopje e kërkesës iu komunikua Presidentes së Republikës së Kosovës dhe Avokatit të Popullit.

11. Deri më sot, Gjykata nuk ka pranuar informacionet dhe dokumentet e kërkuara mbështetëse, as nga parashtruesi i kërkesës e as nga Kryeministri.
12. Më 31 mars 2014, Gjykata u këshillua për kërkesën dhe njëzëri vendosi që kërkesa është e pranueshme dhe që amendamentet e propozuara në Kushtetutë nuk pakësojnë të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Përmbledhja e fakteve

13. Kuvendi e miratoi tekstin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe ajo hyri në fuqi më 15 qershor 2008. Në Kapitullin XIII [Dispozitat Përfundimtare], neni 144 [Amendamentimi] i Kushtetutës autorizohet Qeveria, Presidenti, apo një e katërta e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, të propozojnë ndryshime dhe amendamente të kësaj Kushtetute.
14. Më 6 mars 2014, Qeveria, në bazë të nenit 93.9 të Kushtetutës, miratoi Vendimin Nr. 01/174, duke propozuar 16 (gjashtëmbëdhjetë) amendamente në Kushtetutë.
15. Më 10 mars 2014, Kryeministri, me shkresën nr. 57/2014, ia përcolli parashtruesit të kërkesës Propozimin e Qeverisë për Amendamentet.
16. Më 11 mars 2014, parashtruesi i kërkesës, me shkresën Nr. 04-DO-2186, dhe në përputhje me nenin 114.3 të Kushtetutës, ia paraqiti Gjykatës Propozimin e Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës, duke kërkuar që Gjykata të vlerësojë nëse amendamentet e propozuara nuk pakësojnë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

17. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse janë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
18. Në këtë drejtim, Gjykata duhet së pari të përcaktojë nëse ka juridiksion për të dhënë vlerësim për amendamentet e propozuara në Kushtetutë nga ana e Qeverisë.
19. Gjykata rikujton që, sipas nenit 113.9 të Kushtetutës:

“Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara para miratimit në Kuvend, me qëllim që të konstatohet nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin II të Kushtetutës”.

20. Rrjedhimisht, Gjykata ka juridiksion për të vlerësuar nëse amendamentet e propozuara nuk pakësojnë ndonjë të drejtë dhe liritë e garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës.
21. Përveç kësaj, pyetja në të cilën duhet dhënë përgjigje është se kush mund të konsiderohet palë e autorizuar për të referuar kërkesë në Gjykatë, në bazë të nenit 113.9 të Kushtetutës. Gjykata rithekson se, në bazë të këtij neni, *“Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara”*. Në rastin e tanishëm, Kryetari i Kuvendit, me shkresën e 11 marsit 2014, e dorëzoi në këtë Gjykatë kërkesën për vlerësim paraprak të amendamenteve të propozuara në Kushtetutë. Rezulton që, në bazë të nenit 113.9 të Kushtetutës, parashtruesi është palë e autorizuar dhe ka të drejtë ta referojë këtë rast në Gjykatë.
22. Prandaj, pasi që Gjykata ka juridiksion ta trajtojë këtë çështje dhe pasi që parashtruesi është palë e autorizuar sipas nenit 113.9 të Kushtetutës, kërkesa është e pranueshme.

Fushëveprimi i vlerësimit kushtetues

23. Siç u tha më lart, në pjesën “Procedura në Gjykatë”, parashtruesi i kërkesës i dorëzoi Gjykatës 16 (gjashtëmbëdhjetë) amendamente të propozuara në Kushtetutë nga ana e Qeverisë.
24. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se, Kushtetuta, si akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës, duhet të respektohet zyrtarisht dhe solemnisht me rastin e propozimit të amendamenteve për të. Prandaj, Gjykata, duke qenë e kujdesshme për nevojën e sigurisë juridike në lidhje me këtë çështje, i referohet nenit 112 [Parimet e Përgjithshme] të Kapitullit VIII [Gjykata Kushtetuese] të Kushtetutës, ku parashihet që Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe të përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.
25. Për më tepër, Gjykata konfirmon se vlerësimi i kushtetutshmërisë, sipas nenit 144.3 të çdo amendamenti të propozuar në Kushtetutë, duhet të trajtohet në dritën e Kapitullit II [Të Drejtat dhe Liritë

Themelore], duke përfshirë rendin juridik të Republikës së Kosovës, bazë e të cilit – sipas nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kapitullit II të Kushtetutës – janë të drejtat dhe liritë e njeriut të përmendura në atë Kapitull (Shih Rastin Nr. KO29/12 dhe KO48/12, Parashtrues: Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Aktgjykim i 20 korrikut 2012; shih, po ashtu, Rastin Nr. KO61/12, Parashtrues: Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Aktgjykim i 31 tetorit 2012, paragrafi 18).

26. Gjykata, gjithashtu, është e mendimit se Kapitulli III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] dhe të drejta të tjera mund të jenë të zbatueshme në këtë proces, pasi të drejtat specifike të përcaktuara aty janë zgjerim i të drejtave dhe i lirive të njeriut të parapara në Kapitullin II të Kushtetutës, në veçanti i atyre të drejtave të parapara në nenin 24 [Barazia para Ligjit]. Kjo është posaçërisht kështu edhe në dritën e dispozitave të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] paragrafi 2, i cili përcakton se Kosova do t'i mbrojë dhe do t'i garantojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, siç parashihet me Kushtetutë, por jo domosdo vetëm ato të përfshira në Kapitullin II (Shih Rastin Nr. KO29/12 dhe Nr. KO48/12, Parashtrues: Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Aktgjykim i 20 korrikut 2012).
27. Gjykata, po ashtu, konsideron se neni 21 i Kushtetutës duhet lexuar në lidhje me nenin 7.1 të Kushtetutës, që definon vlerat e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës e që është i bazuar *“në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes së mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut”*.
28. Prandaj, me rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së amendamenteve të propozuara, kjo Gjykatë nuk do t'i marrë parasysh vetëm të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të përfshira në Kapitullin II, por tërë shkronjën dhe frymën e Kushtetutës (Shih Rastin Nr. KO29/12 dhe KO48/12, Parashtrues: Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Aktgjykim i 20 korrikut 2012).
29. Gjykata tani do ta shqyrtojë me radhë secilin prej amendamenteve të propozuara.

Vlerësim i kushtetutshmërisë së amendamenteve të propozuara

I. Amendamenti i propozuar nr. 24: Neni 2, paragrafi 2

30. Amendamenti nr. 24 propozon zëvendësimin e fjalës “mjetet” në nenin 2, paragrafi 2, të Kushtetutës me fjalën “mekanizmat”.
31. Sipas nenit të tanishëm 2 [Sovraniteti], paragrafi 2: *“Sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm dhe mbrohet me të gjitha mjetet e përcaktuara me këtë Kushtetutë dhe me ligj”*.
32. Në nenin e ndryshuar 2, paragrafi 2, do të thuhet si vijon: *“Sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm dhe mbrohet me të gjithë **mekanizmat** e përcaktuar me këtë Kushtetutë dhe me ligj”*.

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së amendamentit të propozuar nr. 24

33. Gjykata konsideron se formulimi i amendamentit të propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.
34. Prandaj, Gjykata konfirmon se amendamenti i propozuar nr. 24 është në pajtueshmëri me Kapitullin II të Kushtetutës.

II. Amendamenti i propozuar nr. 25: Neni 73, paragrafi 1, pika 2

35. Amendamenti nr. 25 propozon që neni 73, paragrafi 1, pika 2, i Kushtetutës, të fshihet dhe të riformulohet si vijon:

“(2)pjesëtarët e Forcave të Armatosura të Kosovës”.

36. Sipas nenit të tanishëm 73 [Pamundësia e Kandidimit], paragrafi 1, pika 2:

“Nuk mund të kandidohen dhe as të zgjidhen deputetë të Kuvendit, pa hequr dorë paraprakisht nga detyra e tyre:

[...]

(2) pjesëtarët e Forcës së Sigurisë të Kosovës;

[...]”.

37. Në nenin e ndryshuar 73, paragrafi 1, pika 2, do të thuhet si vijon:

“1. Nuk mund të kandidohen dhe as të zgjidhen deputetë të Kuvendit, pa hequr dorë paraprakisht nga detyra e tyre:

[...]

(2) pjesëtarët e Forcave të Armatosura të Kosovës;

[...]”.

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së amendamentit të propozuar nr. 25

38. Gjykata konsideron se formulimi i amendamentit të propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.
39. Prandaj, Gjykata konfirmon se amendamenti i propozuar nr. 25 është në pajtueshmëri me Kapitullin II të Kushtetutës.

III. Amendamenti i propozuar nr. 26: Neni 84, paragrafi 12

40. Amendamenti nr. 26 propozon të fshihet paragrafi 12, i nenit 84, të Kushtetutës dhe të riformulohet si vijon:

“(12) është Komandant Suprem i Forcave të Armatosura të Kosovës”.

41. Sipas nenit të tanishëm 84 [Kompetencat e Presidentit], paragrafi 12:

“Presidenti i Republikës së Kosovës:

[...]

është Komandant Suprem i Forcave të Sigurisë të Kosovës;

[...]”.

42. Në nenin e ndryshuar 84, paragrafi 12, do të thuhet si vijon:

“Presidenti i Republikës së Kosovës:

[...]

(12) është Komandant Suprem i Forcave të Armatosura të Kosovës;

[...]”.

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së amendamentit të propozuar nr. 26

43. Gjykata konsideron se formulimi i amendamentit të propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.
44. Prandaj, Gjykata konfirmon se amendamenti i propozuar nr. 26 është në pajtueshmëri me Kapitullin II të Kushtetutës.

IV. Amendamenti i propozuar nr. 27: Neni 84, paragrafi 20

45. Amendamenti nr. 27 propozon të fshihet paragrafi 20, i nenit 84, të Kushtetutës dhe të riformulohet si vijon:

“(20) emëron dhe shkarkon Shefin e Mbrojtjes, pas rekomandimit të Kryeministrit”.

46. Sipas nenit të tanishëm 84 [Kompetencat e Presidentit], paragrafi 20:

“Presidenti i Republikës së Kosovës:

[...]

(20) emëron Komandantin e Forcave të Sigurisë të Kosovës, pas rekomandimit të Kryeministrit; [N.B.: Gjykata vëren se në versionin anglisht të këtij neni, në vend të fjalës “të Kryeministrit” përdoret fjala “të Qeverisë”]

[...]”.

47. Në nenin e ndryshuar 84, paragrafi 20, të Kushtetutës do të thuhej si vijon:

“Presidenti i Republikës së Kosovës:

[...]

emëron **dhe shkarkon Shefin e Mbrojtjes**, pas rekomandimit të Kryeministrit.

[...]”.

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së amendamentit të propozuar nr. 27

48. Gjykata vëren se një kompetencë shtesë i është veshur Presidentit, si Komandant Suprem i Forcave të Armatosura të Kosovës, konkretisht kompetenca për të shkarkuar Shefin e Mbrojtjes.
49. Gjykata konsideron se formulimi i amendamentit të propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.
50. Prandaj, Gjykata konfirmon se amendamenti i propozuar nr. 27 është në pajtueshmëri me Kapitullin II të Kushtetutës.

V. Amendamenti i propozuar nr. 28: Neni 94, paragrafi 7

51. Amendamenti nr. 28 propozon të shtohet fjala “*dhe politikat e mbrojtjes*” pas fjalës “*Inteligjencës*”, në paragrafin 7 të nenit 94 të Kushtetutës.
52. Sipas nenit të tanishëm 94 [Kompetencat e Kryeministrit], paragrafi 7:

“Kryeministri ka këto kompetenca:

[...]

(7) këshillohet me Presidentin e Republikës së Kosovës mbi çështjet e Inteligjencës”.

53. Në nenin e ndryshuar 94, paragrafi 7, do të thuhej si vijon:

“Kryeministri ka këto kompetenca:

[...]

(7) këshillohet me Presidentin e Republikës së Kosovës mbi çështjet e Inteligjencës dhe politikat e mbrojtjes”.

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së amendamentit të propozuar nr. 28

54. Gjykata konsideron se formulimi i amendamentit të propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.
55. Prandaj, Gjykata konfirmon se amendamenti i propozuar nr. 28 është në pajtueshmëri me Kapitullin II të Kushtetutës.

VI. Amendamenti i propozuar nr. 29: Titulli i Kapitullit XI

56. Amendamenti nr. 29 propozon të fshihet titulli i Kapitullit XI të Kushtetutës dhe të riformulohet si vijon:

“Kapitulli XI - Sektori i Mbrojtjes dhe i Sigurisë”

57. Titulli i tanishëm i Kapitullit XI është *“Kapitulli XI - Sektori i Sigurisë”*.

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së amendamentit të propozuar nr. 29

58. Gjykata konsideron se titulli i ri i Kapitullit XI nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.
59. Prandaj, Gjykata konfirmon se amendamenti i propozuar nr. 29 është në pajtueshmëri me Kapitullin II të Kushtetutës.

VII. Amendamenti i propozuar nr. 30: Neni 125, paragrafi 1

60. Amendamenti nr. 30 propozon të shtohet fjala *“mbrojtjen”* pas fjalës *“zbatimin e ligjit”*, në paragrafin 1 të nenit 125 [Parimet e Përgjithshme] të Kapitullit XI të Kushtetutës.
61. Sipas nenit të tanishëm 125, paragrafi 1:

“1. Republika e Kosovës ka pushtet mbi zbatimin e ligjit, sigurinë, drejtësinë, sigurinë publike, inteligjencën, organet civile emergjente dhe mbi kontrollin e kufijve në territorin e vet.

[...]”.

62. Në nenin e ndryshuar 125, paragrafi 1, do të thuhej si vijon:

*“1. Republika e Kosovës ka pushtet mbi zbatimin e ligjit, **mbrojtjen**, sigurinë, drejtësinë, sigurinë publike, inteligjencën, organet civile emergjente dhe mbi kontrollin e kufijve në territorin e vet.*

[...]”.

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së amendamentit të propozuar nr. 30

63. Gjykata konsideron se formulimi i amendamentit të propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.
64. Prandaj, Gjykata konfirmon se amendamenti i propozuar nr. 30 është në pajtueshmëri me Kapitullin II të Kushtetutës.

VIII. Amendamenti i propozuar nr. 31: Neni 125, paragrafi 2

65. Amendamenti nr. 31 propozon të fshihet paragrafi 2, i nenit 125, të Kushtetutës dhe të riformulohet si në vijim:

*“Institucionet **e mbrojtjes** dhe sigurisë në Republikën e Kosovës mbrojnë **dhe sigurojnë pavarësinë e vendit**, sigurinë publike dhe të drejtat e të gjithëve në Republikën e Kosovës. Institucionet veprojnë me transparencë të plotë dhe në pajtim me standardet demokratike e me të drejtat e njeriut të njohura ndërkombëtarisht. Institucionet **e Mbrojtjes dhe të Sigurisë** duhet të pasqyrojnë shumëllojshmërinë etnike të popullit të Republikës së Kosovës”.*

66. Sipas nenit të tanishëm 125 [Parimet e Përgjithshme], paragrafi 2:

“2. Institucionet e sigurisë në Republikën e Kosovës mbrojnë sigurinë publike dhe të drejtat e të gjithëve në Republikën e Kosovës. Institucionet veprojnë me transparencë të plotë dhe në pajtim me standardet demokratike e me të drejtat e njeriut të njohura ndërkombëtarisht. Institucionet e Sigurisë duhet të pasqyrojnë shumëllojshmërinë etnike të popullit të Republikës së Kosovës”.

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së amendamentit të propozuar nr. 31

67. Gjykata konsideron se formulimi i amendamentit të propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.
68. Prandaj, Gjykata konfirmon se amendamenti i propozuar nr. 31 është në pajtueshmëri me Kapitullin II të Kushtetutës.

IX. Amendamenti i propozuar nr. 32: Neni 125, paragrafi 3

69. Amendamenti nr. 32 propozon të shtohen fjalët “*të mbrojtjes*”, pas fjalëve “*organet ndërkombëtare*” në paragrafin 3, të nenit 125, të Kushtetutës.

70. Sipas nenit të tanishëm 125 [Parimet e Përgjithshme], paragrafi 3:

“3. Republika e Kosovës respekton plotësisht të gjitha marrëveshjet e aplikueshme ndërkombëtare dhe ligjin përkatës ndërkombëtar dhe bashkëpunon me organet ndërkombëtare të sigurisë e me homologët rajonalë”.

71. Në nenin e ndryshuar 125, paragrafi 3, do të thuhej si vijon:

“3. Republika e Kosovës respekton plotësisht të gjitha marrëveshjet e aplikueshme ndërkombëtare dhe ligjin përkatës ndërkombëtar dhe bashkëpunon me organet ndërkombëtare [të sigurisë] të mbrojtjes e me homologët rajonalë”.

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së amendamentit të propozuar nr. 32

72. Gjykata konsideron se formulimi i amendamentit të propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.
73. Prandaj, Gjykata konfirmon se amendamenti i propozuar nr. 32 është në pajtueshmëri me Kapitullin II të Kushtetutës.

X. Amendamenti i propozuar nr. 33 – Neni 125, paragrafi 4

74. Amendamenti nr. 33 propozon që të shtohet fjala “*e mbrojtjes dhe*”, pas fjalës “*mbi institucionet*” në paragrafin 4, të nenit 125, të Kapitullit XI të Kushtetutës.
75. Sipas nenit të tanishëm 125 [Parimet e Përgjithshme], paragrafi 4:

“4. Kontrolli civil dhe demokratik mbi institucionet e sigurisë garantohet”.

76. Në nenin e ndryshuar 125, paragrafi 4, do të thuhej si vijon:

“4. Kontrolli civil dhe demokratik mbi institucionet e mbrojtjes dhe të sigurisë garantohet”.

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së amendamentit të propozuar nr. 33

77. Gjykata konsideron se formulimi i amendamentit të propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

78. Prandaj, Gjykata konfirmon se amendamenti i propozuar nr. 33 është në pajtueshmëri me Kapitullin II të Kushtetutës.

XI. Amendamenti i propozuar nr. 34 - Neni 125, paragrafi 5

79. Amendamenti nr. 34 propozon që të shtohet fjala “mbrojtjes dhe”, pas fjalës “institucioneve të”, në paragrafin 5, të nenit 125, të Kapitullit XI të Kushtetutës.

80. Sipas nenit të tanishëm 125 [Parimet e Përgjithshme], paragrafi 5:

“5. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbikëqyr buxhetin dhe politikat e institucioneve të sigurisë, sikur rregullohet me ligj”.

81. Në nenin e ndryshuar 125, paragrafi 5, do të thuhej si vijon:

“5. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbikëqyr buxhetin dhe politikat e institucioneve të mbrojtjes dhe të sigurisë, sikur rregullohet me ligj”.

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së amendamentit të propozuar nr. 34

82. Gjykata konsideron se formulimi i amendamentit të propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

83. Prandaj, Gjykata konfirmon se amendamenti i propozuar nr. 34 është në pajtueshmëri me Kapitullin II të Kushtetutës.

XII. Amendamenti i propozuar nr. 35: Neni 126

84. Amendamenti nr. 35 propozon që të fshihet neni 126 i Kushtetutës dhe të riformulohet si vijon:

“Neni 126 [Forcat e Armatosura të Kosovës]

1. Forcat e Armatosura të Kosovës janë forca kombëtare ushtarake të Republikës së Kosovës, dhe mund të dërgojnë pjesëtarët e tyre jashtë vendit, në përputhje të plotë me përgjegjësitë e tyre ndërkombëtare.

2. Forcat e Armatosura të Kosovës mbrojnë sovranitetin, integritetin territorial, qytetarët, pronën dhe interesat e Republikës së Kosovës, si dhe kontribuojnë në ndërtimin dhe ruajtjen e paqes dhe stabilitetit rajonal dhe global.

3. Presidenti i Republikës së Kosovës është Komandant Suprem i Forcave të Armatosura të Kosovës, të cilat gjithmonë i nënshtrohen kontrollit të autoriteteve civile të zgjedhura në mënyrë demokratike.

4. Forcat e Armatosura të Kosovës janë forcë profesionale, pasqyrojnë shumëllojshmërinë etnike të popullit të Republikës së Kosovës dhe rekrutohen nga shtetasit e Republikës së Kosovës.

5. Shefi i Mbrojtjes është njëkohësisht edhe Komandant i Forcave të Armatosura të Kosovës, i cili emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, në bazë të rekomandimit të Kryeministrit.

6. Organizimi i brendshëm i Forcave të Armatosura të Kosovës rregullohet me ligj të veçantë”.

85. Sipas nenit të tanishëm 126 [Forca e Sigurisë e Kosovës]:

“1. Forca e Sigurisë e Kosovës është forcë kombëtare e sigurisë për Republikën e Kosovës, dhe mund të dërgojë pjesëtarët e saj jashtë vendit në përputhje të plotë me përgjegjësitë e saj ndërkombëtare.

2. Forca e Sigurisë e Kosovës mbrohet qytetarët dhe komunitetet e Republikës së Kosovës në bazë të kompetencave të përcaktuara me ligj.

3. *Presidenti i Republikës së Kosovës është Komandant i Përgjithshëm i Forcës së Sigurisë të Kosovës, e cila gjithmonë i nënshtrohet kontrollit të autoriteteve civile të zgjedhura në mënyrë demokratike.*

4. *Forca e Sigurisë e Kosovës është profesioniste, pasqyron shumëllojshmërinë etnike të popullit të Republikës së Kosovës dhe rekrutohet nga shtetasit e Republikës së Kosovës.*

5. *Komandantin e Forcës së Sigurisë të Kosovës e emëron Presidenti i Republikës së Kosovës, në bazë të rekomandimit të Qeverisë. Organizimi i brendshëm i Forcës së Sigurisë të Kosovës rregullohet me ligj”.*

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së amendamentit të propozuar nr. 35

86. Gjykata konsideron se formulimi i amendamentit të propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.
87. Prandaj, Gjykata konfirmon se amendamenti i propozuar nr. 35 është në pajtueshmëri me Kapitullin II të Kushtetutës.

XIII. Amendamenti i propozuar nr. 36: Neni 127, paragrafi 1

88. Amendamenti nr. 36 propozon që të fshihet neni 127, paragrafi 1, i Kushtetutës, dhe të riformulohet si vijon:

*“Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Presidentin e Republikës së Kosovës dhe Qeverinë, përgatit strategjinë e **mbrojtjes dhe** të sigurisë për Republikën e Kosovës. Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës ka edhe rol këshillues në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me **mbrojtjen dhe** me sigurinë në Republikën e Kosovës”.*

89. Sipas nenit të tanishëm 127 [Këshilli i Sigurisë i Kosovës], paragrafi 1: *“Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Presidentin e Republikës së Kosovës dhe Qeverinë, përgatit strategjinë e sigurisë për Republikën e Kosovës. Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës ka edhe rol këshillues në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë në Republikën e Kosovës”.*

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së amendamentit të propozuar nr. 36

90. Gjykata konsideron se formulimi i amendamentit të propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.
91. Prandaj, Gjykata konfirmon se amendamenti i propozuar nr. 36 është në pajtueshmëri me Kapitullin II të Kushtetutës.

XIV. Amendamenti i propozuar nr. 37: Neni 129, paragrafi 1

92. Amendamenti nr. 37 propozon që të zëvendësohet fjala “*në Republikën e Kosovës*” në paragrafin 1, të nenit 129, të Kushtetutës me fjalën “*së Republikës së Kosovës*”.
93. Sipas nenit të tanishëm 129 [Agjencia e Kosovës për Inteligjencë], paragrafi 1:

“1. Agjencia e Kosovës për Inteligjencë zbulon, heton dhe mbikëqyr kërcënimet ndaj sigurisë në Republikën e Kosovës”.

94. Në nenin e ndryshuar 129, paragrafi 1, do të thuhej si vijon:

*“1. Agjencia e Kosovës për Inteligjencë zbulon, heton dhe mbikëqyr kërcënimet ndaj sigurisë **së Republikës së Kosovës**”.*

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së amendamentit të propozuar nr. 37

95. Gjykata konsideron se formulimi i amendamentit të propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.
96. Prandaj, Gjykata konfirmon se amendamenti i propozuar nr. 37 është në pajtueshmëri me Kapitullin II të Kushtetutës.

XV. Amendamenti i propozuar nr. 38: Neni 131, paragrafi 7

97. Amendamenti nr. 38 propozon që të zëvendësohet fjala “*Forcës së Sigurisë së Kosovës*” në paragrafin 7, të nenit 131, të Kushtetutës, me fjalën “*Forcave të Armatosura të Kosovës*”.

98. Sipas nenit të tanishëm 131 [Gjendja e Jashtëzakonshme], paragrafi 7:

“7. Presidenti i Republikës së Kosovës, pas konsultimit me Qeverinë dhe Kuvendin, mund të urdhërojë mobilizimin e Forcës së Sigurisë të Kosovës, për të ndihmuar në Gjendjen e Jashtëzakonshme”.

99. Në nenin e ndryshuar 131, paragrafi 7, do të thuhej si vijon:

*“7. Presidenti i Republikës së Kosovës, pas konsultimit me Qeverinë dhe Kuvendin, mund të urdhërojë mobilizimin e **Forcave të Armatosura të Kosovës**, për të ndihmuar në Gjendjen e Jashtëzakonshme”.*

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së amendamentit të propozuar nr. 38

100. Gjykata konsideron se formulimi i amendamentit të propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.
101. Prandaj, Gjykata konfirmon se amendamenti i propozuar nr. 38 është në pajtueshmëri me Kapitullin II të Kushtetutës.

XVI. Amendamenti i propozuar nr. 39

102. Amendamenti nr. 39 propozon që të shtohet një nen i ri pas nenit 128 [Policia e Kosovës]. Amendamenti i propozuar thotë si në vijim:

“Neni 128A

[Komisionari Parlamentar për Forcat e Armatosura dhe Policinë e Kosovës]

- 1. Komisionari Parlamentar për Forcat e Armatosura dhe Policinë e Kosovës, është institucion i pavarur i cili i përgjigjet Kuvendit të Kosovës.*
- 2. Roli, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionarit Parlamentar do të përcaktohen me ligj të veçantë”.*

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së amendamentit të propozuar nr. 39

103. Gjykata vëren se ky amendament i propozuar themelon një institucion të ri të pavarur publik, roli, detyrat dhe përgjegjësitë e të cilit do të përcaktohen me ligj të veçantë.
104. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se një institucion i ngjashëm ekziston në një numër vendesh evropiane, siç janë: Austria, Gjermania, Holanda, Norvegjia, Suedia dhe të tjera. Për shembull, Ligji Themelor i Gjermanisë, i ndryshuar, parasheh të ketë një Komisionar Parlamentar për Forcat e Armatosura, i cili është veshur me kompetenca *“për të mbrojtur të drejtat themelore dhe për të ndihmuar Bundestagun në ushtrimin e mbikëqyrjes parlamentare mbi Forcat e Armatosura”*, ku gjithashtu shtohet se *“Detajet rregullohen me ligj federal”*. (Shih, Ligji Federal Gjerman mbi Komisionarin Parlamentar për Forcat e Armatosura, i 16 qershorit 1982, BGBl. IS. 677 dhe i ndryshuar më 5 shkurt 2009, BGBl. IS. 160). Një institucion i tillë funksionon edhe në rajon (p.sh., në Bosnjë dhe Hercegovinë).
105. Gjykata konsideron se neni i ri i propozuar 128 A i Kushtetutës nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.
106. Prandaj, Gjykata konfirmon se amendamenti i propozuar nr. 39 është në pajtueshmëri me Kapitullin II të Kushtetutës.

XVII.

107. Sa i përket pikës XVII të Projektamendamenteve të propozuara nga Qeveria (Shih Aneksin), Gjykata vëren se hyrja në fuqi e amendamenteve në Kushtetutë është e rregulluar me nenin 144, paragrafi 4, të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.9 dhe të nenit 144.3 të Kushtetutës, në mbështetje të nenit 20 të Ligjit dhe në mbështetje të rregullit 56 (1) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 31 mars 2014,

NJËZËRI, VENDOS SI NË VIJIM:

- I. Kërkesa që përmban Propozimin e Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës, e parashtruar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 11 mars 2014, është e pranueshme.
- II. Gjykata konfirmon se asnjë nga 16 (gjashtëmbëdhjetë) amendamentet që përmban Propozimi i Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit më 11 mars 2014, nuk i pakëson të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës;
- III. Ky vendim do t'u kumtohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Kushtetutës; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI120/13, Ismete Veseli, Aktvendim i datës 20 janar 2014 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 60/2012, të 4 qershorit 2013

Rasti KI120/13, vendimi i 20 janarit 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, qartazi e pabazuar.

Parashtruesja kërkesës ka pretenduar se me aktgjykimin e Gjykatës Supreme dhe të gjykatave të instancës më të ulët “është shkelur dispozita e nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës për mbrojtjen e pronësisë”.

Parashtruesja e kërkesës më tej theksoi se gjykatat e rregullta nuk kishin zbatuar ligjin e duhur me rastin e marrjes së vendimeve lidhur me kontestin.

Gjykata vëren se parashtruesja në mënyrë të gabuar kishte theksuar shkeljen e nenit 22 të Kushtetutës duke i dhënë atij përmbajtjen e së drejtës të garantuar në pronë, sepse neni 22 i Kushtetutës në fakt i referohet zbatimit të drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare, ndërsa e drejta e pronës garantohet me nenin 46 të Kushtetutës.

Gjykata konstaton se faktet e paraqitura nga parashtruesja në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit dhe me rregullin 36 të Rregullores së punës, më 20 janar 2014, njëzëri deklaroi kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI120/13
Parashtrues
Ismete Veseli
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme të Kosovës, Rev. nr. 60/2012, të 4 qershorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është znj. Ismete Veseli (në tekstin e mëtejme: parashtruesja) nga fshati Rogoqicë, komuna e Kamenicës, e përfaqësuar nga avokati z. Mustafë Musa.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 60/2012, i 4 qershorit 2013, të cilin parashtruesja e kërkesës e ka pranuar më 27 qershor 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 60/2012, për të cilën pretendohet se i ka shkelur të drejtat e parashtrueses të garantuara me Kushtetutë duke e privuar në mënyrë të jashtëligjshme nga e drejta e pronësisë mbi paluajtshmërinë e fituar në bazë të kontratës mbi mbajtjen e përjetshme.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja)

Procedura në Gjykatë

5. Më 5 gusht 2013, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.
6. Më 30 gusht 2013, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova, kryesuese, dhe Kadri Kryeziu e Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 4 tetor 2013, Gjykata Kushtetuese kishte njoftuar parashtruesen e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 14 tetor 2013, Gjykata kërkoi nga parashtruesja e kërkesës dokumentacionin shtesë të nevojshëm për shqyrtimin e kërkesës.
9. Më 5 nëntor 2013, Gjykata pranoi nga parashtruesja dokumentacionin e kërkuar shtesë.
10. Më 20 janar 2014, Kolegji shqyrtues pasi shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Nga dokumentacioni i bashkëngjitur me kërkesën, Gjykata konstaton se në Gjykatën Komunale në Gjilan, më 7 prill 2008, ishte vërtetuar kontrata për mbajtje të përhjetshme me numër veprues, Vr. nr. 1504/08, në mes të tani të ndjerit A. V. nga Gjilani dhe parashtrueses së kërkesës, I. V., po ashtu nga Gjilani, të cilët në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate ishin bashkëshortë në mes vete dhe në bazë të së cilës e drejta e pronësisë së paluajtshme e A. V. pas vdekjes do t'i kalonte parashtrueses së kërkesës si kompensim për mbajtje të përhjetshme.
12. Më 10 shkurt 2009, Gjykata Komunale në Gjilan ka nxjerrë Aktgjykimin C. nr. 306/08, me anë të të cilit në pikën I (një) të dispozitivit ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses

Sh. L. nga Prishtina (vajza natyrore e të ndjerit A. V.), me të cilën ajo kishte kërkuar prishjen e kontratës për mbajtje të përhjetshme në mes të tani të ndjerit A. V. nga Gjilani dhe parashtrueses së kërkesës.

13. Në pikën II (dy) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata Komunale në Gjilan kishte aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses sa i përket kërkesës së dytë të saj, dhe ka anuluar kontratën mbi shitblerjen e paluajtshmërisë të lidhur në mes të parashtrueses së kërkesës në cilësinë e shitësit, dhe F. D. si blerës, e cila ishte vërtetuar në Gjykatën Komunale në Gjilan, me numër veprues, Vr. nr. 4611/08, më 26 gusht 2008, dhe atë për shkak të pavlefshmërisë absolute, sepse objekti i kontratës ka qenë jashtë qarkullimit juridik, ngase Gjykata Komunale kishte nxjerrë më herët aktvendim për aplikimin e masës së përkohshme të ndalimit të tjetërsimit të kësaj paluajtshmërie deri në përfundimin e kontestit me vendim të plotfuqishëm.
14. Më 28 shtator 2009, duke vepruar sipas ankesave të autorizuarve të të dyja palëve në kontest, Gjykata e Qarkut në Gjilan nxori Aktgjykimin Ac. nr. 162/09, me të cilin kishte prishur Aktgjykimin C. nr. 306/08 të Gjykatës Komunale në Gjilan, në alinenë 1 të dispozitivit duke e kthyer çështjen në rivendosje në Gjykatën Komunale, ndërsa alinenë 2 të këtij aktgjykimi e kishte lënë në fuqi duke refuzuar kështu ankesat e përfaqësuesve, edhe të paditësit, edhe të paditurës sa i përket kësaj pjese të aktgjykit.
15. Në arsyetimin e vet, Gjykata e Qarkut kishte theksuar se dispozitivi dhe *“arsyetimi i aktgjykit të Gjykatës Komunale janë kontradiktorë”* dhe *“kontrata për mbajtje të përhjetshme është dokument publik, andaj si i tillë është dashur të përpilohet në mënyrë formale dhe të vërtetohet te gjyqtari”*.
16. Më 21 dhjetor 2010, Gjykata Komunale në Gjilan, në procedurën e përsëritur në përputhje me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Gjilanit nxori Aktgjykimin C. nr. 733/2009 dhe aprovoi padinë e paditëses Sh. L. nga Prishtina dhe njëkohësisht anuloi kontratën mbi mbajtje të përhjetshme, Vr. nr. 1504/2008, të vërtetuar me 7 prill 2008.
17. Më 26 janar 2012, Gjykata e Qarkut në Gjilan nxori Aktgjykimin Ac. nr. 60/2011, me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e përfaqësuesit të parashtrueses së kërkesës.

18. Më 4 qershor 2013, Gjykata Supreme e Kosovës nxori Aktgjykimin Rev. nr. 60/2012, me të cilin refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtrueses së kërkesës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjiilan, Ac. nr. 60/2011, të 26 janarit 2012.
19. Në arsyetimin e aktgjykimit sipas revizionit, Gjykata Supreme në mes të tjerash ka konstatuar se *“gjykatat e instancës më të ulët, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, kanë zbatuar drejt të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar”*.

Pretendimet e parashtruesit

20. Parashtruesja e kërkesës ka pretenduar se me aktgjykimin e Gjykatës Supreme dhe të gjykatave të instancës më të ulët *“është shkelur dispozita e nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës për mbrojtjen e pronësisë”*.
21. Parashtruesja e kërkesës më tej theksoi se gjykatat e rregullta nuk kishin zbatuar ligjin e duhur me rastin e marrjes së vendimeve lidhur me kontestin.

Pranueshmëria e kërkesës

22. Për të qenë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtrueses, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse parashtruesja i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara me Kushtetutë, Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës të Gjykatës.
23. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

24. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtrueses është dorëzuar në Gjykatë nga një individ, brenda afatit katër (4) mujor të paraparë me ligj dhe pas shterimit të mjeteve juridike, andaj është e përshtatshme për t'u shqyrtuar në Gjykatën Kushtetuese.

Vlerësimi i aspekteve përmbajtjesore të kërkesës

25. Duke bërë vlerësimin e aspekteve përmbajtjesore të kërkesës, Gjykata vëren se parashtruesja e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 60/2012, të 4 qershorit 2013, me pretendimin se me këtë aktgjykim, por edhe me aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë.
26. Gjykata vëren se parashtruesja në mënyrë të gabuar kishte theksuar shkeljen e nenit 22 të Kushtetutës duke i dhënë atij përmbajtjen e së drejtës të garantuar në pronë, sepse neni 22 i Kushtetutës në fakt i referohet zbatimit të drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare, ndërsa e drejta e pronës garantohet me nenin 46 të Kushtetutës.
27. Pavarësisht nga kualifikimi juridik i dispozitës kushtetuese nga ana e parashtrueses për të cilën pretendon se është shkelur, Gjykata konstaton se parashtruesja në fakt nuk pajtohet me aktgjykimin përfundimtar të Gjykatës Supreme në rastin e saj para kësaj Gjykate.
28. Gjykata rikujton se, fakti i thjeshtë se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t'u shërbejë atyre si e drejtë të ngrenë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të dispozitave të Kushtetutës (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, kërkesa Nr. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, ose aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese, rasti KI128/12, i 12 korrikut 2013, të parashtruesit Shaban Hoxha, në kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 316/2011).
29. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës në asnjë mënyrë nuk ka prezantuar fakte se si ka ndodhur shkelja e pretenduar e dispozitës kushtetuese, në cilën fazë të procedurave gjyqësore, cilat janë elementet eventuale arbitrare në vendimet që i konteston, por se thjeshtë ka potencuar se është aplikuar gabimisht ligji për trashëgiminë në vend të ligjit për familjen dhe se për pasojë, parashtruesja ka humbur të drejtën në pronë të fituar sipas kontratës për mbajtje të përhershme.
30. Në referim të këtij pretendimi, Gjykata potencon faktin se Gjykata Supreme në arsyetimin e Aktgjykimit Rev. nr. 60/2012, të 4 qershorit 2013, ka theksuar se *“gjykatat e instancës më të ulët....(.....)...., kanë zbatuar drejt të drejtën materiale”*, andaj gjykatanë këtorrethana nuk mund të konstatojë seka pasur shkelje të të drejtave të njeriut në dëm të parashtrueses.

31. Lidhur me si më sipër, duhet kujtuar se njëri nga parimet themelore të vlerësimit kushtetues, është parimi i subsidiaritetit. Në kontekstin e veçantë të Gjykatës Kushtetuese, do të thotë që detyra për të siguruar respektimin e të drejtave të parashikuara nga Kushtetuta, u takon në radhë të parë autoriteteve vendore gjyqësore, dhe jo drejtpërsëdrejti apo menjëherë Gjykatës Kushtetuese (shih, Scordino kundër Italisë, nr. 1, [DHM], § 140), andaj në këtë drejtim, Gjykata vëren se edhe çështjes së adresuar nga parashtruesja e kërkesës, përgjigje efektive i ka dhënë edhe Gjykata Supreme duke e arsyetuar me argumente vendimin e nxjerrë.
32. Gjykata nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe konstatimi i gjendjes së drejtë e të plotë faktike është në juridiksionin e gjykatave të rregullta, në rastin konkret i Gjykatës Supreme dhe i gjykatave të instancës më të ulët dhe roli i saj është vetëm që ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore, prandaj nuk mund të veprojë si “*gjykatë e shkallës së katërt*” (shih, *mutatis mutandis*, i. a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R. J. D, 1996-IV, para. 65).
33. Për më tepër, për t’u shpallë vendimi i një autoriteti publik si jokushtetues, parashtruesi i kërkesës do të duhej *prima facie* të dëshmojë para Gjykatës Kushtetuese se “*vendimi i autoritetit publik, si i tillë, do të jetë treguesi një shkeljeje të kërkesës përgjykim të drejtë, dhe nëse, paarsyeshmëria e atij vendimi është aq dukshme që vendim mund të konsiderohet si vendim tej mase arbitrar*” (shih, GJEDNJ, Khamidov kundër Rusisë, Aktgjykimi i 15 nëntorit 2007, § 175).
34. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se faktet e paraqitura nga parashtruesja në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese; andaj nuk mund të konstatohet se kërkesa ishte e bazuar dhe në përputhje me rregullin 36 paragrafi 2 pika b, prandaj Gjykata gjen se kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit dhe me rregullin 36 të Rregullores së punës, më 20 janar 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u kumtohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI148/13, Sylejmon Pllana, Aktvendim i datës 20 janar 2014 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 30/2013, të 12 korrikut 2013

Rasti KI148/13, vendimi i 20 janarit 2014.

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, qartazi të pabazuar.

Në parashtresën e tij me shkrim, të 25 nëntorit 2013, parashtruesi i sqaroi pretendimet e tij, duke theksuar se me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 2287/07, të 27 shkurtit 2009, ai ishte liruar nga aktakuza. Ai pretendon se ky aktgjykim duhet të ekzekutohet në këtë kontest pune, e jo vendimet e KEK-ut që ishin miratuar në procedurën kontestimore.

Parashtruesi më tej pretendon se, si qytetar i Kosovës, ai e ka të drejtën kushtetuese të punës, siç parashihet me nenin 49 të Kushtetutës. Ai gjithashtu pretendon se është shkelur e drejta e tij e pronës, e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës, sepse ai nuk i kishte fituar të ardhurat e tij. Përfundimisht, parashtruesi argumenton se është shkelur edhe e drejta e tij për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të tij, e paraparë me nenin 54 të Kushtetutës.

Gjykata më tej vëren se fakti i thjeshtë se parashtruesi është i pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës. Përveç kësaj, fakti i thjeshtë që një parashtrues nuk pajtohet me konkluzionet ligjore që një Gjykatë i ka sjellë në rastin e tij/saj, nuk do të thotë që ai vendim paraqet mohim të së drejtës për mjet juridik efektiv, siç përcaktohet me nenin 54 të Kushtetutës. Për më tepër, fakti i thjeshtë që një personi i është ndërprerë marrëdhënia e punës për veprën penale të vjedhjes, nuk do të thotë se atij i është mohuar e drejta për të punuar në një vend tjetër të punës, në qoftë se ai vend është në dispozicion dhe nëse është i kualifikuar për të kryer atë punë, siç garantohet me nenin 49 të Kushtetutës, dhe as që e drejta e pronës, e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës, nuk i është mohuar në mënyrë arbitrare.

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 20 janar 2014, njëzëri deklarojë se kërkesa është qartazi e bazuar.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI148/13
Parashtrues
Sylejmon Pllana
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 30/2013, të 12
korrikut 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u dorëzua nga z. Sylejmon Pllana (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Fushë-Kosovë, i cili përfaqësohet nga z. Hamdi Podvorica, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin, e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 30/2013, të 12 korrikut 2013, i cili iu dorëzua atij më 27 gusht 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, i cili pretendohet të jetë nxjerrë në kundërshtim me nenin 7 [Vlerat], me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], me nenin 46 [Mbrotjtja e Pronës] dhe me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 46 të Ligjit

për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-131 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 13 shtator 2013, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 24 shtator 2013, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI148/13, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 9 tetor 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata gjithashtu e njoftoi Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK) lidhur me kërkesën.
8. Më 18 tetor 2013, KEK-u e dorëzoi parashtresën me shkrim, duke e kontestuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës si të papranueshme.
9. Më 25 nëntor 2013, Gjykata e pranoi parashtresën me shkrim të përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës, i cili i kontestoi pretendimet e KEK-ut, duke pretenduar se parashtruesi i kërkesës është viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut.
10. Më 27 nëntor 2013, Gjykata e pranoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale, P. nr. 2287/2007, të 27 shkurtit 2009.
11. Më 20 janar 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 1 janar 2007, parashtruesi kishte hyrë në marrëdhënie të përhershme të punës me KEK-un.
13. Më 16 maj 2007, me Vendimin Nr. 06/178, parashtruesi ishte suspenduar nga puna.

14. Pas procedurës disiplinore kundër parashtruesit, Komisioni Disiplinor i KEK-ut, më 27 korrik 2007, nxori Vendimin Nr. 06/273 dhe e ndërpreu marrëdhënien e punës së parashtruesit. Parashtruesi u shpall përgjegjës për vjedhjen e pronës së KEK-ut. Ky veprim u përcaktua si shkelje e rëndë e detyrave të punës nga ana e parashtruesit.
15. Parashtruesi e kontestoi Vendimin e Komisionit Disiplinor, të 27 korrikut 2007. Me Vendimin Nr. 4559, të 6 gushtit 2007, KEK-u e refuzoi ankesën e parashtruesit dhe e vërtetoi Vendimin e 27 korrikut 2007.
16. Më 27 shkurt 2009, Gjykata Komunale në Prishtinë, në procedurën penale kundër parashtruesit të kërkesës dhe një personi tjetër (A. B.), në lidhje me veprën e njëjtë, nxori Aktgjykimin P. nr. 2287/ duke e hedhur poshtë aktakuzën penale kundër parashtruesit të kërkesës.
17. Ishte vërtetuar se gjatë procedurës penale kundër parashtruesit, ndër të tjera, ai mori 120 metra tel të llojit F-120 mm dhe e ngarkoi atë në veturën në pronësi të A. B. Gjithashtu ishte vërtetuar se këto veprime përbënin elemente të veprës penale të vjedhjes sipas nenit 252.1 në lidhje me nenin 23 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës. Pa marrë parasysh këto konkluzione ligjore, Gjykata Komunale gjeti se veprimet e parashtruesit të kërkesës dhe të A. B. nuk përbënin vepër penale, sepse vepra ka qenë e rëndësishë së vogël dhe nuk kishte pasoja të dëmshme dhe të rëndësishme.
18. Më 19 tetor 2009, Gjykata Komunale në Prishtinë, në kontestin e punës, të iniciuar nga parashtruesi i kërkesës, nxori Aktgjykimin C1. nr. 322/2007, dhe e aprovoi si të bazuar petitionin e parashtruesit. Me aktgjykimin e njëjtë, vendimet e KEK-ut, të 27 korrikut 2007 dhe të 6 gushtit 2007, në lidhje me përfundimin e marrëdhënies së punës së parashtruesit ishin anuluar dhe KEK-u ishte i detyruar ta kthente parashtruesin në vendin e tij të mëparshëm të punës.
19. Gjykata Komunale në Prishtinë e ka bazuar arsyetimin e aktgjykimit, të nxjerrë në procedurën penale kundër parashtruesit (P. nr. 2287/07, më 27 shkurt 2009), me të cilin parashtruesi ishte liruar nga aktakuza. Gjykata Komunale gjeti se aktgjykimi penal i 27 shkurtit 2009, kishte hedhur poshtë aktakuzën kundër parashtruesit të kërkesës, sepse përcaktoi se veprimet e vjedhjes së parashtruesit kundër KEK-ut, punëdhënësit të tij, ishin të

parëndësishme, për të pasur ndikim në ligjshmërinë e vendimeve të KEK-ut, të nxjerra në procedurën disiplinore.

20. Në një datë të pacaktuar, KEK-u ushtroi ankesë kundër aktgjykimit të lartpërmendur.
21. Më 28 shtator 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë nxori Aktgjykimin Ac. nr. 133/2010, me të cilin refuzoi ankesën e KEK-ut dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të 19 tetorit 2009.
22. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, KEK-u ushtroi revizion, duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.
23. Më 12 korrik 2013, Gjykata Supreme e Kosovës mori Aktgjykimin e kontestuar, Rev. nr. 30/2013 dhe e pranoi si të bazuar revizionin e KEK-ut. Ajo gjithashtu i ndryshoi aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut, të 28 shtatorit 2012 dhe të Gjykatës Komunale të 19 tetorit 2009, dhe i vërtetoi përsëri vendimet e KEK-ut të marra në procedurën disiplinore kundër parashtresit të kërkesës.
24. Në arsyetim, Gjykata Supreme theksoi si në vijim: *“Në rastin konkret, fakt relevant dhe i pakontestueshëm është se paditësit i ka pushuar marrëdhënia e punës për shkak të shkeljes së kontratës si pasojë e shkeljes së rëndë të detyrave të punës - vjedhje e pasurisë së KEK-ut, të parashikuar nga dispozita e nenit 6 par. 1 pika 4 të Rregullores mbi përgjegjësinë disiplinore dhe materiale. Mirëpo, nga shkresat e lëndës del se e paditura vendimin e saj e ka marrë pasi paraprakisht ka zbatuar procedurën disiplinore për të vërtetuar përgjegjësinë e paditësit dhe pasi që është vërtetuar përgjegjësia e tij është marrë vendimi mbi shkeljet e marrëdhënies së punës. Pra, në rastin konkret është ndjekur e tërë procedura ligjore për marrjen e një vendimi të tillë siç është paraparë sipas Ligjit mbi Marrëdhëniet e Punës, respektivisht dispozitës së nenit 112, i cili ligj ishte në fuqi në kohën e paraqitjes së padisë ndërsa është shfuqizuar me dispozitën e nenit 99 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 të datës 1 nëntor 2010.”*

Pretendimet e parashtresit

25. Në parashtresën e tij me shkrim, të 25 nëntorit 2013, parashtresi i sqaroi pretendimet e tij, duke theksuar se me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 2287/07, të 27 shkurtit 2009, ai ishte liruar nga aktakuza. Ai pretendon se ky aktgjykim

duhet të ekzekutohet në këtë kontest pune, e jo vendimet e KEK-ut që ishin miratuar në procedurën kontestimore.

26. Parashtruesi më tej pretendon se, si qytetar i Kosovës, ai e ka të drejtën kushtetuese të punës, siç parashihet me nenin 49 të Kushtetutës. Ai gjithashtu pretendon se është shkelur e drejta e tij e pronës, e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës, sepse ai nuk i kishte fituar të ardhurat e tij. Përfundimisht, parashtruesi argumenton se është shkelur edhe e drejta e tij për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të tij, e paraparë me nenin 54 të Kushtetutës.

Pranueshmëria e kërkesës

27. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet që së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
28. Gjykata vëren se substanca e argumentit të parashtruesit në Gjykatë është se Aktgjykimi P. nr. 2287/07, i 27 shkurtit 2009, i nxjerrë në procedurën penale kundër tij, duhet të ketë përparësi mbi vendimet e KEK-ut të nxjerra në procedurën disiplinore kundër tij.
29. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion të parapara me Ligjin për procedurën kontestimore dhe se Gjykata Supreme në Prishtinë i ka marrë parasysh dhe iu është përgjigjur ankesave të tij në çështjet e ligjit.
30. Gjykata rikujton se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, kur shqyrton vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I, shih, gjithashtu edhe Aktvendimin për papranueshmëri në rastin nr. KI70/11, parashtrues Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. nr 983/08, të 7 shkurtit 2011).
31. Gjykata më tej vëren se fakti i thjeshtë se parashtruesi është i pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (shih,

mutatis mutandis, GJEDNJ, kërkesa nr. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, e 26 korrikut 2005). Përveç kësaj, fakti i thjeshtë që një parashtrues nuk pajtohet me konkluzionet ligjore që një Gjykatë i ka sjellë në rastin e tij/saj, nuk do të thotë që ai vendim paraqet mohim të së drejtës për mjet juridik efektiv, siç përcaktohet me nenin 54 të Kushtetutës. Për më tepër, fakti i thjeshtë që një personi i është ndërprerë marrëdhënia e punës për veprën penale të vjedhjes, nuk do të thotë se atij i është mohuar e drejta për të punuar në një vend tjetër të punës, në qoftë se ai vend është në dispozicion dhe nëse është i kualifikuar për të kryer atë punë, siç garantohet me nenin 49 të Kushtetutës, dhe as që e drejta e pronës, e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës, nuk i është mohuar në mënyrë arbitrare.

32. Prandaj, kjo kërkesë është qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 36 (1) të Rregullores së punës, e cila përcakton se *"Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa është qartazi e bazuar"*.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 20 janar 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

**KI189/13, Avdullah Rrustemi, Aktvendim i datës 24 janar 2014
- Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev. I. nr. 121/2012, të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 29 korrikut 2013**

Rasti KI189/13, vendimi i 24 janarit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, e drejta e punës, qartazi e pabazuar.

Parashtruesi e parashtroi kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 dhe rregullit 56 paragrafi 2 të Rregullores së punës.

Objekt i çështjes është vlerësimi kushtetues i vendimeve të kontestuara që “supozohet se janë të padrejta, kundërligjshme dhe kundër kushtetuese sepse parashtruesit i kanë mohuar të drejtën në gjykim të drejtë dhe të paanshëm si dhe të drejtën në punë”.

Në këtë drejtim, parashtruesi nuk kishte cek shprehimisht shkelje të ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti, porse përmbajtja e kërkesës së tij në mënyrë të nënkuptuar ngre pretendime për shkelje të Nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], Nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Parashtruesi pretendon se gjykatat e rregullta kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale si dhe nuk kanë zbatuar nenin 182.1 të Ligjit të procedurës kontestimore dhe nenin 14 të Ligjit për marrëdhëniet e punës.

Duke shqyrtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit, Rev. I. nr. 121/2012, të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 29 korrikut 2013, Gjykata Kushtetuese konstatoi se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtave kushtetuese dhe se parashtruesi i kërkesës nuk i ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij dhe, rrjedhimisht, kërkesa e tij është qartazi e pabazuar.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI189/13
Parashtrues
Avdullah Rustemi
Vlerësim kushtetues i Aktgjykimit, Rev. I. nr. 121/2012, të
Gjykatës Supreme të Kosovës, i 29 korrikut 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Avdullah Rustemi (në tekstin e mëtejme: parashtruesi), me vendbanim në Poklek të Ri, komuna e Gllgovcit.

Vendimet e kontestuara

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin, Rev. I. nr. 121/2012, të Gjykatës Supreme të Kosovës, i 29 korrikut 2013. Parashtruesi gjithashtu konteston Aktgjykimin, Ac. nr. 489/2010, të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, i 15 shkurtit 2012, dhe Aktgjykimin C. 37/09, të Gjykatës Komunale në Gllgovc, i 19 marsit 2010.

Objekti i çështjes

3. Objekt çështjeje është vlerësimi kushtetues i vendimeve të kontestuara që *“supozohet se janë të padrejta, kundërligjshme dhe kundër kushtetuese sepse parashtruesit i kanë mohuar të drejtën në gjykim të drejtë dhe të paanshëm si dhe të drejtën në punë”*.
4. Në këtë drejtim, parashtruesi nuk çekë shprehimisht shkelje të ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti, porse përmbajtja e kërkesës së tij në mënyrë të nënkuptuar ngre pretendime për

shkelje të Nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], Nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme, Kushtetuta), Nenin 47 të Ligjit, Nr. 03/121, për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme, Ligji), dhe Rregullin 56 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme, Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 5 nëntor 2013, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme, Gjykata).
7. Më 2 dhjetor 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. KI189/13, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën datë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. KSH. KI189/13, caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
8. Më 18 dhjetor 2013, parashtruesi u njoftua për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën datë, kompania Newco Ferronikeli Complex l.l.c si dhe Gjykata Supreme e Kosovës u njoftuan për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 24 janar 2014, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtare raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

10. Më 24 shtator 2007, menaxheri i Newco Ferronikeli Complex l.l.c (në tekstin e mëtejme, Punëdhënësi) përkitazi me përgjegjësinë disiplinore dhe materiale në punë, parashtruesit i shqiptoi vërejtje me shkrim duke i përkujtuar atij se në rast të përsëritjes së shkeljeve të detyrave të punës do të pasojë ndërprerja e parakohshme e kontratës së punës.

11. Më 26 dhjetor 2008, Punëdhënësi njoftoi parashtruesin se nga 1 janari 2009 atij do t'i ndërpritet marrëdhënia e punës për shkak të skadimit të kontratës paraprake të punës të lidhur ndërmjet tyre.
12. Më 28 janar 2009, Inspektori i Punës dhe i Mbrojtjes në Punë, me Vendimin Nr. 164-21, urdhëroi Punëdhënësin që të rishqyrtoj vendimin për ndërprerje të marrëdhënies të punës me punonjësin e tyre, përkatësisht parashtruesin e kërkesës.
13. Më 18 shkurt 2009, Punëdhënësi iu përgjigj Inspektorit të Punës dhe Mbrojtjes në Punë, *“se e rishqyrtoi me vëmendje rastin në fjalë dhe mbetet në vendimin e mëparshëm se kontrata e punës nuk mund të vazhdohet”*.
14. Më 19 mars 2010, Gjykata Komunale në Glllogovc, me Aktgjykimin C. nr. 37/09, përcaktoi:

“REFUZOHET e pabazuar kërkesëpadia e paditësit (parashtruesit) Avdullah Rustemi nga Korrotica e Ultë, kundër të paditurës NEWCO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C (punëdhënësi) në Glllogovc, me të cilën kërkohet se paditësi Avdullah Rustemi ka krijuar marrëdhënie pune pranë të paditurës me kohë të pacaktuar, të anulohet Aktvendimi i datës 3.02.2009, me të cilin nuk i është vazhduar marrëdhënia e punës, prej datës 1.01.2009, e në vendin e Punës Përcjellës i Trenave në Departamentin e logjistikës pranë të paditurës, si dhe paditësin ta kthej në detyrat e punës me të gjitha të drejtat dhe obligimet nga vendi i punës”.

15. Në aktgjykimin e sipërpërmendur, Gjykata Komunale në Glllogovc, më tutje arsyetoi:

“... mbështetur në njoftimin e datës 26.12.2008 të lëshuar nga e paditura me të cilin është njoftuar paditësi Avdullah Rustemi se e paditura nuk e vazhdon kontratën e punës me paditësin, kontrata e datës 25.07.2007, gjykata vlerëson se paditësi Avdullah Rustemi gjithnjë ka krijuar marrëdhënie pune me kohë të caktuar...pra, çështja e vazhdimit të kontratës së punës me punëmarrësin është ekskluzivisht çështje e punëdhënësit se don të vazhdoi kontratën me punëmarrësin apo jo, kjo varësisht nga ajo se punëdhënësi ka interes apo jo për një çështje të tillë... për kohën sa paditësi ka punuar tek e paditura, ka realizuar pagat për çdo muaj dhe e paditura ka përmbushur obligimet ndaj paditësit...”

“... Pretendimet e paditësit se duhet t’i njihet e drejta e punës tek e paditura dhe atë në vendin e punës përcjellës i trenave në departamentin e logjistikës me të gjitha të drejtat dhe obligimet në vendin e punës ku ka punuar më parë, nuk janë të bazuara në ligjin themelor të punës në Kosovë...”

16. Më 15 shkurt 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin Ac. nr. 489/2010, refuzoi të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Glllogovc.
17. Më 29 korrik 2013, Gjykata Supreme me Aktgjykimin Rev. I. nr. 121 /20 12, refuzoi të pabazuar revizionin e parashtruesit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.
18. Në aktgjykimin e sipërpërmendur, Gjykata Supreme arsyetoi:

“... Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, gjykatat e instancës më të ultë drejtë e kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, sepse themelimi i marrëdhënies së punës bëhet në bazë të konkursit me plotësimin e kushteve për marrëdhëniet punës, respektivisht marrëdhënia e punës themelohet në bazë të konkursit, intervistave dhe në bazë të rregullores për Ligjin Themelor të Punës nr .2001/27 dt. 8 tetor 2001. Në rastin konkret në mes të ndërgjyqësve është lidhur kontratë pune në kohë të caktuar, në kohëzgjatje prej 25.07.2007 deri 31.12.2008, prandaj dalja në punë e paditësit pas skadimit të kontratës nuk do të thatë se paditësi ka themeluar marrëdhënie pune ngase edhe me dispozitat e nenit 10 të rregullores së lartpërmendur, është paraparë mënyra e themelimit të marrëdhënies së punës e në rastin konkret, marrëdhënia e punës e paditësit të e paditura është themeluar në kohë të caktuar...”

Kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, ngase gjykata e shkallës së dytë i ka shqyrtuar thëniet ankimore përkitazi me faktet vendimtare dhe në arsyetimin e aktgjykimit ka dhënë arsye të mjaftueshme të cilat i pranon edhe kjo gjykatë”.

19. Parashtruesi po ashtu ka dorëzuar në Gjykatë, aktgjykimin (P. nr. 180/2009, i 19 shtatorit 2011) të Gjykatës Komunale në Glllogovc që ka të bëjë me padi penale të paraqitur nga ai kundër stafit menaxherial të Punëdhënësit, me ç’rast parashtruesi pohon: “A. B

nuk ka autorizim për marrje të vendimeve të tilla (d.m.th shkëputje të kontratës së punës), këtë vet e ka deklaruar në Gjykatën Komunale në Gllogoc, me rastin e zhvillimit të procedurës penale ndaj tij dhe disa punëtorëve të tjerë. Si provë, për vërtetim të një fakti të tillë do t'i bashkëngjitem kësaj kërkesë aktgjykimin P. nr. 180/2009 të Gjykatës Komunale në Gllogoc, në kuptim të dispozitës së nenit 216 të LPK-së”.

Pretendimet e parashtruesit

20. Parashtruesi pretendon se gjykatat e rregullta kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale si dhe nuk kanë zbatuar nenin 182.1 të Ligjit të procedurës kontestimore dhe nenin 14 të Ligjit për marrëdhëniet e punës (Gazeta Zyrtare KSAK nr. 12/89).
21. Parashtruesi pretendon se vendimet e gjykatave të rregullta janë karakterizuar nga ndikimet dhe lidhjet jo ligjore sepse sipas tij gjykatat e instancave më të larta vetëm kanë miratuar vendimin e gjykatës së instancës më të ulët pa i përfillur provat në shkresat e lëndës.
22. Parashtruesi po ashtu pretendon se persona të paautorizuar dhe jo kompetentë e lajmëruan atë për mos vazhdim të kontratës së punës pa kurrfarë paralajmërimi, mase disiplinore e shumë mangësi tjera.
23. Parashtruesi nuk çekë shprehimisht shkelje të ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti porse përmbajtja e kërkesës së tij në mënyrë të nënkuptuar ngre pretendime për shkelje të Nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe Nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve], të Kushtetutës.

Dispozitat relevante ligjore

RREGULLORE NR. 2001/27 PËR LIGJIN THEMELOR TË
PUNËS NË KOSOVË

Neni 10

Kontrata e punës

10.1 Kontrata e punës mund të lidhet:

(a) për një kohë të pacaktuar ose

(b) për një kohë të caktuar.

[...]

*Neni 11**Shkëputja e kontratës së punës**11.1 Kontrata e punës shkëputet:**[...]**(c) në rastet e rënda të sjelljes së keqe nga punonjësit;**(ç) për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës nga ana e punonjësit;**(d) me skadimin e kohëzgjatjes së punësimit dhe**(dh) sipas fuqisë ligjore.***Vlerësim i pranueshmërisë**

24. Gjykata vëren se, për të qenë në gjendje për të gjykuar kërkesën e parashtruesit, së pari është e nevojshme të shqyrtojë nëse janë përmbushur të gjitha kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

25. Përkitazi me kërkesën e parashtruesit, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

26. Gjykata po ashtu i referohet nenit 49 të Ligjit, që përcakton:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të llogaritet që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të llogaritet në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të llogaritet që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.

27. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi është palë e autorizuar, ka shteruar të gjitha mjetet juridike në pajtim me Nenin 113.7 të Kushtetutës, dhe se kërkesa është dorëzuar brenda afatit ligjor prej katër muajsh të përcaktuar me Nenin 49 të Ligjit.
28. Përkitazi me pretendimet e ngritura në kërkesë, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, që përcakton:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

[...]

c) kërkesa është qartazi e bazuar”.

29. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi pretendon se vendimet e gjykatave të rregullta janë karakterizuar nga zbatimi i gabuar i të drejtës materiale, vërtetimi jo i plotë i fakteve, lidhjet dhe ndikimet e supozuara jo ligjore ndaj gjykatave të rregullta gjatë kryerjes së detyrave të tyre e shumë mangësi tjera të supozuara.
30. Gjykata Kushtetuese rithekson se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se vërtetimi i drejtë dhe i plotë gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, ndërsa roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore. Prandaj Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (shih rastin Akdivar kundër Turqisë, Nr. 2189/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65 dhe po ashtu shih rastin KI-86/11, parashtrues i kërkesës Milaim Berisha, Aktvendimi për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).
31. Përveç kësaj, kërkesa nuk arrin të dëshmojë që gjykatat e rregullta kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese ta zëvendësojë vlerësimin e vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta dhe, si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave që t’i vlerësojnë provat e vëna në dispozicion të tyre. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta ishin të drejta në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave (Shih rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).
32. Në rastin konkret, Gjykata konsideron se vendimet e gjykatave të rregullta kanë bazë ligjore, janë të arsyetuara mirë dhe në

përgjithësi janë të logjikshme e koherente dhe po ashtu në mënyrë të qartë shpjegojnë raportin ndërmjet parashtruesit si punonjës dhe punëdhënësit të tij, natyrën e kontratës të punës të lidhur ndërmjet tyre si dhe mënyrat e kushtet që lejohen me ligj përkitazi me themelimin dhe shuarjen e kontratës së punës.

33. Gjykata vëren se parashtruesit i janë dhënë mjaft mundësi që të ngrejë argumente përkitazi me rastin e tij para gjykatave të rregullta. Gjykata po ashtu vë në pah se e drejta për proces të rregullt dhe korrekt gjyqësor siç garantohet me Kushtetutë dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk nënkupton korrektësi ‘materiale’ por korrektësi ‘procedurale’. Kjo korrektësi në praktikë nënkupton procedurën ndërgjyqësore ku ankesat e palëve janë dëgjuar dhe pastaj ato janë vënë në pozitë të barabartë në gjykatat e rregullta (shih rastin Star Cate Epiletka dhe të tjerët kundër Greqisë, Nr. 5411/07, GJEDNJ, Vendim i 6 korrikut 2010).
34. Përkitazi me padinë penale që parashtruesi ka paraqitur kundër stafit menaxherial të punëdhënësit (aktgjykimi P. nr. 180/2009, i Gjykatës Komunale në Glogovc i 19 shtatorit 2011), Gjykata konsideron se aktgjykimi në fjalë nuk mund të përdoret për të inkriminuar individë të caktuar dhe se nuk ka e nuk mund të ketë kurrfarë ndikimi në përfundimin e këtij rasti.
35. Fakti që parashtruesi nuk pajtohet me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], të Kushtetutës (Shih rastin Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).
36. Në këto rrethana, parashtruesi nuk e ka mbështetur me prova pretendimin e tij për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës, sepse faktet e paraqitura nga ai nuk tregojnë në asnjë mënyrë që gjykatat e rregullta i kanë mohuar atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë.
37. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në përputhje me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, Nenin 47 të Ligjit dhe Rregullat 36 (1) c) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 24 janar 2014, njëzëri

VENDOSI

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Gjyqtarja raportuese
Arta Rama-Hajrizi

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI181/13, NTSH “WITT`PEN”, Suharekë, Aktvendim i datës 21 janar 2014 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 34/2013, të 11 korrikut 2013

Rasti KI181/13, vendimi i 21 janarit 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, qartazi e pabazuar.

Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme i është shkelur e drejta në punë e garantuar me nenin 49 të Kushtetutës.

Gjykata konstaton se përkundër pohimit të parashtruesit të kërkesës së atij, me këtë aktgjykim, i është shkelur e drejta e garantuar në punë sipas nenit 49 të Kushtetutës, ai nuk ka paraqitur fakte që do ta çonin Gjykatën në përfundim se shkelja e pretenduar vërtet ka ndodhur. Parashtruesi nuk ka ofruar argumente mbi natyrën e shkeljes. Nuk ka sqaruar rrethanat në të cilat ajo eventualisht ka ndodhur, nuk ka specifikuar përmasat e shkeljes apo pasojat kushtetuese dhe, në fakt, ai vetëm ka bashkëngjitur me kërkesë vendimet gjyqësore lidhur me rastin dhe ka potencuar se me konfiskimin e barnave nga barnatorja e tij dhe me moskompensimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e marrjes së tyre, atij i është pamundësuar puna e mëtutjeshme.

Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës nuk e arsyetojnë në asnjë mënyrë pretendimin për shkelje të të drejtave kushtetuese, se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur mjaftueshëm pretendimin e tij dhe se deklarata e thjeshtë se është shkelur Kushtetuta, nuk mund të konsiderohet ankesë kushtetuese.

Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës; të nenit 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe të rregullit 56 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese, më 21 janar 2014, njëzëri deklaroi kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI181/13
Parashtrues
NTSH “WITT`PEN”, Suharekë
Kërkesë për vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të
Gjykatës Supreme Rev. nr. 34/2013, të 11 korrikut 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Ndërmarrja Shëndetësore - barnatore “Witt`pen” (në tekstin e mëtejshëm: NSH “Witt`pen”), me seli në Suharekë, me pronar z. Gani Guraziu, të cilën e përfaqëson avokati z. Ramiz Suka nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Rev. nr. 34/2013, i 11 korrikut 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme, me të cilin u refuzua si i pabazuar revizioni i parashtruesit të kërkesës dhe me të cilin aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, të cilat kishin refuzuar padinë e parashtruesit për kompensim të dëmit, çmohen si të bazuara në ligj dhe si të tilla mbeshin në fuqi.

Baza juridike

4. Neni 113.7 lidhur me nenin 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 23 tetor 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.
6. Më 31 tetor 2013, me vendimin nr. GJR. KI181/13, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.
7. Më 11 nëntor 2013, Gjykata Kushtetuese kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 21 janar 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 24 shtator 2004, me Aktgjykimin C. nr. 228, Gjykata Komunale në Suharekë ka aprovuar padinë e parashtruesit të kërkesës për kompensim të dëmit dhe i kishte akorduar një shumë të caktuar të hollave për dëmin e shkaktuar si pasojë e marrjes së një sasie të konsiderueshme barnash nga barnatorja e tij në muajin prill dhe maj 1999 nga policia financiare e Republikës së Serbisë dhe dërgimit të këtyre barnave në Shtëpinë e Shëndetit në Suharekë.
10. Sipas këtij aktgjykimi, dëmi i shkaktuar në mënyrë solidare do të duhej të kompensohej në mënyrë solidare nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Suharekë dhe nga Ministria e Shëndetësisë (MSH).
11. Më 23 janar 2006, me Aktvendimin Ac. nr. 368/2004, Gjykata e Qarkut në Prizren kishte aprovuar ankesat e të autorizuarve të të paditurave MSH dhe QKMF - Suharekë, duke prishur Aktgjykimin

e Gjykatës Komunale në Prizren dhe duke e kthyer lëndën në rivendosje.

12. Më 14 shtator 2006, Gjykata Komunale në Suharekë me Aktgjykimin C. nr. 25/06 përsëri ka aprovuar padinë e parashtruesit dhe ka nxjerrë aktgjykim identik me aktgjykimin e parë C. nr. 228, të 14 shtatorit 2006.
13. Më 3 shtator 2007, me Aktvendimin Ac. nr. 436 /2006 Gjykata e Qarkut në Prizren kishte aprovuar ankesat e të autorizuarve të të paditurave MSH dhe QKMF - Suharekë dhe përsëri e ka kthyer lëndën në rivendosje.
14. Më 27 janar 2010, Gjykata Komunale në Prizren përfundimisht ka nxjerrë Aktgjykimin C. nr. 206/07, me të cilin ka refuzuar si të pabazë padinë e parashtruesit të kërkesës, duke konstatuar se të paditurat nuk janë përgjegjëse për dëmin e shkaktuar ndaj parashtruesit të kërkesës.
15. Më 24 tetor 2012, Gjykata e Qarkut në Prizren ka nxjerrë Aktgjykimin Ac. nr. 89/2010, me të cilin e ka refuzuar si të pabazë ankesën e parashtruesit të kërkesës. Gjykata e Qarkut ka konstatuar se *“pasi që gjykata e shkallës së parë drejt dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar se ka vërtetuar gjendjen faktike, nuk ka bërë shkelje të procedurës kontestimore, prandaj edhe drejt ka zbatuar të drejtën materiale”*.
16. Më 1 korrik 2013, Gjykata Supreme e Kosovës ka nxjerrë Aktgjykimin Rev. nr. 34/2013, me të cilin ka refuzuar si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 69/2010.
17. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi, Gjykata Supreme ndër të tjera ka theksuar:

“Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se gjykatat e instancës me të ulet, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar për faktin se të paditurave iu mungon legjitimiteti pasiv, duke pasur parasysh faktin se paditësit dem i është shkaktuar në muajin prill dhe maj të vitit 1999 nga pushteti i ish Republikës së Serbisë, ndërsa padia është paraqitur me 23.11.2000”.

Pretendimet e parashtruesit për shkeljet kushtetuese

18. Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme i është shkelur e drejta në punë e garantuar me nenin 49 të Kushtetutës.

Pranueshmëria e kërkesës

19. Për të qenë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse pala i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore.
20. Lidhur me këtë i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, ku përcaktohet:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

21. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se kërkesa KI181/13 është dorëzuar në Gjykatë nga një individ, është parashtruar brenda afatit katër (4) mujor të paraparë me nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, si dhe pas shterjes së mjeteve juridike në dispozicion, andaj i plotëson kushtet formale për t’u shqyrtuar në Gjykatën Kushtetuese.
22. Duke bërë vlerësimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren që parashtruesi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 34/2013, me të cilin iu refuzua revizioni si i pabazuar për shkak se, sipas arsytimit të gjykatës, palëve të paditura u mungonte legjitimiteti pasiv për të qenë palë në këtë procedurë gjyqësore, andaj ato nuk mund të jenë përgjegjëse për dëmin e shkaktuar ndaj parashtruesit të kërkesës.
23. Parashtruesi i kërkesës në veçanti pretendon se i janë shkelur të drejtat nga neni 49 i Kushtetutës. Dhe, në këtë drejtim, Gjykata thekson se kjo dispozitë kushtetuese shprehimisht parashikon:

“1. E drejta e punës garantohet.

2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës”.

24. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se përkundër pohimit të parashtruesit të kërkesës së tij, me këtë aktgjykim, i është shkelur e drejta e garantuar në punë sipas nenit 49 të Kushtetutës, ai nuk ka paraqitur fakte që do ta çonin Gjykatën në përfundim se shkelja e pretenduar vërtet ka ndodhur. Parashtruesi nuk ka ofruar argumente mbi natyrën e shkeljes. Nuk ka sqaruar rrethanat në të cilat ajo eventualisht ka ndodhur, nuk ka specifikuar përmasat e shkeljes apo pasojat kushtetuese dhe, në fakt, ai vetëm ka bashkëngjitur me kërkesë vendimet gjyqësore lidhur me rastin dhe ka potencuar se me konfiskimin e barnave nga barnatorja e tij dhe me moskompensimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e marrjes së tyre, atij i është pamundësuar puna e mëtutjeshme.
25. Gjykata më tej konstaton se parashtruesit të kërkesës me asnjë vendim të asnjë autoriteti publik nuk i ishte ndaluar puna dhe nuk i është shqiptuar ndonjë masë parandaluese që do t'ia mohonte të drejtën e punës dhe ushtrimit të profesionit (neni 49 i Kushtetutës), por ai kishte një çështje juridike civile në gjykatat e rregullta që kishte të bënte me kompensim dëmi dhe kjo çështje ishte vendosur nga gjykatat e rregullta në një proces gjyqësor, andaj në këto rrethana Gjykata nuk gjen se aktgjykimi i Gjykatës Supreme është pasuar me shkelje të nenit 49 të Kushtetutës sikur ka pretenduar parashtruesi.
26. Lidhur me si më sipër, Gjykata konkludon se, në fakt, parashtruesi i kërkesës është i pakënaqur me rezultatin përfundimtar të procesit gjyqësor, sepse ai me asnjë fakt nuk ka argumentuar arbitraritetin e Aktgjykimit mbi revizion të Gjykatës Supreme dhe as argumente për shkeljet e të drejtave të njeriut, por çështja që ai ka ngritur ka të bëjë me konstatimin e gjendjes faktike dhe aplikimin e ligjit që janë qartazi çështje të ligjshmërisë dhe jo çështje kushtetuese.
27. Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e faktit dhe, me këtë rast, rithekson se konstatimi i gjendjes faktike, të drejtë dhe të plotë, është juridiksion i plotë i gjykatave të rregulltadhe se roli i saj është vetëm që ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë, prandaj nuk mund të veprojë si “*gjykatë e shkalës së katërt*” (shih, *mutatis mutandis*, i. a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R. J. D., 1996-IV, para. 65).
28. Nga arsyet e lartpërmendura, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës nuk e arsyetojnë në asnjë mënyrë pretendimin për shkelje të të drejtave kushtetuese dhe se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur mjaftueshëm

pretendimin e tij. Dhe, se deklarata e thjeshtë se është shkelur Kushtetuta, nuk mund të konsiderohet ankesë kushtetuese.

29. Në rrethana të ngjashme, Gjykata kishte shpallur të papranueshme edhe kërkesën e parashtruesit në rastin KI21/13 (shih Aktvendimin për papranueshmëri KI21/13, të 13 dhjetorit 2013).
30. Në këto rrethana, parashtruesi i ankesës nuk ka *“argumentuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e saj për shkelje të Kushtetutës me aktin e autoritetit publik”*. Andaj, Gjykata, në përputhje me rregullin 36, paragrafi 2, pika d, gjen se kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet të papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës; të nenit 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe të rregullit 56 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese, më 21 janar 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. Ky vendim do t’u kumtohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI133/13, Shefqet Hasimi, Aktvendim i datës 24 janar 2014 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 90/2013, te 23 korrikut 2013

Rasti KI133/13, vendimi i 24 janarit 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, palë e autorizuar, dështimi për të specifikuar të drejtën kushtetuese, nuk është arsyetuar *prima facie*, qartazi e pabazuar.

Parashtruesi i kërkesës, në cilësi të Zyrtarit të Lartë në Departamentin për Përfaqësim (Departamenti për Çështje Ligjore) në Ministrinë e Drejtësisë), i cili në procedurë pranë gjykatave të rregullta ishte i autorizuar për ta përfaqësuar Ministrinë e Punëve të Brendshme. Megjithatë, kërkesa e parashtruar në Gjykatën Kushtetuese ishte dorëzuar si kërkesë individuale në emër të tij.

Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, me të cilin ishte vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë. Vendimet e gjykatave të shkalleve të ulëta kishin të bënin me anulimin e Vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, lidhur me masën disiplinore të shqiptuar ndaj një zyrtari policor.

Parashtruesi i kërkesës pa specifikuar shkeljen e supozuar të ndonjë dispozite kushtetuese pretendoi se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme është marrë në kundërshtim me Kushtetutën.

Gjykata vëren se parashtruesi në kërkesën e tij nuk thekson se cila e drejtë është shkelur dhe cili nen i Kushtetutës mbështet kërkesën e tij.

Gjykata Kushtetuese deklaroi kërkesën e parashtruesit të papranueshme si qartazi të pabazuar sepse nuk ishte arsyetuar *prima facie* dhe parashtruesi nuk e ka mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI133/13
Parashtrues
Shefqet Hasimi
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme,
Rev. nr. 90/2013, të 23 korrikut 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović,
zëvendëskryetar
Robert Carolan,
gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova,
gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Shefqet Hasimi, zyrtar i lartë ligjor (Departamenti për Çështje Ligjore) në Ministrinë e Drejtësisë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi), i cili në procedurë pranë gjykatave të rregullta kishte përfaqësuar Ministrinë e Punëve të Brendshme. Parashtruesi e ka parashtruar kërkesën në emër të tij.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 90/2013, i 23 korrikut 2013, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 15 gusht 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 90/2013, të 23 korrikut 2013, përmes të cilit është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.

4. Nëpërmjet aktgjytimeve të instancave më të ulëta, ishte miratuar kërkesëpadia e paditësit Q. R. dhe ishte anuluar si joligjor vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, P. nr. 88/VDP/2011, i 4 shkurtit 2011, me të cilin paditësit i ishte shqiptuar masa disiplinore ndalesë prej 30% prej pagës mujore bruto për dy muaj.
5. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e zyrtarit të lartë në Divizionin për Përfaqësime (Departamenti për Çështje Ligjore) në Ministrinë e Drejtësisë ishte i autorizuar që të përfaqësojë Ministrinë e Punëve të Brendshme në procedurat para gjykatave të rregullta. Megjithatë, kërkesa e dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), ishte paraqitur si kërkesë individuale në emër të tij.

Baza juridike

6. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 30 gusht 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.
8. Më 4 shtator 2013, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI133/13, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI133/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
9. Më 16 shtator 2013, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës si dhe kërkoi nga parashtruesi të qartësojë nëse kërkesa ishte dorëzuar si kërkesë individuale në emër të tij. Të njëjtën ditë, kërkesa iu komunikua Gjykatës Supreme të Kosovës.
10. Më 23 tetor 2013, Gjykata pranoi shkresën e parashtruesit, me të cilën parashtruesi konfirmoi pretendimet për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, por nuk saktësoi nëse kërkesa ishte dorëzuar në mënyrë individuale.

11. Më 25 tetor 2013, Ministria e Drejtësisë, përkatësisht drejtori i Departamentit Ligjor, pjesë e të cilit është parashtruesi, ia dorëzoi Gjykatës autorizimin për përfaqësim.
12. Më 6 nëntor 2013, Gjykata njoftoi Ministrinë e Punëve të Brendshme për regjistrimin e kërkesës, duke ia bashkëngjitur shkresën e dërguar nga parashtruesi i kërkesës dhe autorizimin për përfaqësim të lëshuar nga Ministria e Drejtësisë.
13. Më 24 janar 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë, pranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 28 shtator 2010, Komisioni për Emërime të Larta dhe Disiplinë në Polici (në tekstin e mëtejme: KELD) ka rekomanduar që Q. R. për shkak të sjelljes së pahijshme, gjegjësisht ndërhyrjes në procesin e hetimit të prokurorit publik të Qarkut në Prishtinë, t'i shqiptohet masa disiplinore, ndalesë në pagën mujore bruto prej 30 % për dy muaj.
15. Më 4 shkurt 2011, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, nxori vendimin me të cilin Q. R. iu shqiptua masa disiplinore e propozuar nga KELD-i.
16. Kundër këtij vendimi, Q. R. ushtroi ankesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme.
17. Më 22 mars 2011, ministri i Punëve të Brendshme, përmes vendimit të tij hodhi poshtë si të pabazuar ankesën e ushtruar nga Q. R.
18. Më 8 prill 2011, Q. R. ushtroi padi në Gjykatën Komunale në Ferizaj.
19. Më 8 dhjetor 2011, Gjykata Komunale në Ferizaj, me Aktgjykimin C. nr. 229/11, aprovoi padinë e paditësit Q. R. si të bazuar dhe anuloi në tërësi vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës.
20. Gjykata Komunale në Ferizaj, në aktgjykimin e saj, arsyetoi [...] *“me rastin e nxjerrjes së vendimit nga ana e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë është marrë pa kurrfarë baze juridike duke u thirrur në Urdhëresën Administrative të UNMIK 2006/9*

në të cilin Urdhëresë është thirrur e paditura kinse për sjellje të pahijshme të paditësit duke mos marrë për bazë se kjo Rregullore është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Ligjit mbi Policinë, ku në nenin 46 të Ligjit në fjalë kjo shkelje disiplinore nuk figuron. Ligji i Policisë qartë i përmende të gjitha shkeljet disiplinore por masë e tillë shkelje e pahijshme nuk ekziston andaj për këto arsye këto vendime, vendimi i shkallës së parë dhe vendimi i shkallës së dytë të marra nga e paditura nuk kanë kurrfarë baze juridike as ligjore”.

21. Lidhur me kërkesën e së paditurës që padia dhe shkresat e lëndës t’i dërgohen sipas kompetencës Gjykatës Supreme, Gjykata Komunale në Ferizaj vlerësoi se [...]”një pretendim i tillë sipas mendimit të Gjykatës nuk është i bazuar meqenëse bëhet fjalë për kontest nga marrëdhënia e punës për vendosjen e të cilit në përputhje me nenin 26 par. 1 pika 7 të Ligjit për Gjykatat e rregullta Gazeta Zyrtare nr. 21/78 kompetente është Gjykata Komunale”.
22. Kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj, Ministria e Punëve të Brendshme, e përfaqësuar nga parashtruesi i kërkesës, ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.
23. Më 24 tetor 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin e saj, Ac. nr. 320/2012, e refuzoi si të pabazuar ankesën.
24. Bazuar në shkresat e lëndës, më 27 nëntor 2012, Prokurori i Shtetit njoftoi parashtruesin e kërkesës lidhur me propozimin e tij për kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktgjykimeve të Gjykatës Komunale në Ferizaj dhe Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, pas shqyrtimit të aktgjykimeve të kundërshtuara si dhe shkresave të tjera të lëndës, nuk ka gjetur bazë ligjore për të ngritur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.
25. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Nr. 320/2012, të 24 tetorit 2012, me pohimin për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, Ministria e Punëve të Brendshme, e përfaqësuar nga parashtruesi i kërkesës, ushtroi revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.
26. Më 23 korrik 2013, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin e saj, Rev. Nr. 90/2013, refuzoi si të pabazuar revizionin.

27. Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj vlerësoi se [...]”në rastin konkret nuk janë aplikuar dispozitat për mbajtjen e dëgjimit disiplinor para KELD [Komisioni për Emërime të Larta dhe Disiplinë] siç me të drejtë ceket edhe në aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët [...]”. Gjykata Supreme më tej arsyetoi se [...] “me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e masës disiplinore të ndaljes së pagave mujore, Drejtori i Përgjithshëm është thirrë edhe në Urdhëresën administrative nr. 2006/9 të datës 06.06.2006 që është Urdhëresë administrative për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/54 mbi kornizën dhe parimet udhëzuese të shërbimit policor të Kosovës, e cila Rregullore ka hyrë në fuqi me datën 20.12.2005 dhe është shfuqizuar me datën 20.02.2008 kur është nxjerrë Ligji i policisë. Në këtë mënyrë janë aplikuar dispozitat e një ligji i cili në kohën kritike nuk kanë qenë në fuqi”.

Pretendimet e parashtruesit

28. Parashtruesi pretendon se [...] “të gjitha Aktgjykimet e sipër theksuar janë nxjerrë në shkelje të Kushtetutës duke refuzuar vendimet e organit të punësimit”.
29. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën që të konstatojë se: [...]” Aktgjykimet e atakuara a ka shkelje të ligjeve të aplikueshme të Kosovës, a ka veprua në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, që paditësi ka ndërhyrë pa autorizim në Prokurorin e Qarkut në Prishtinë dhe të vlerëson se organi i punësimit ka vepruar konform Kushtetutës së vendit [...]”, duke mos saktësuar shkeljen e pretenduar të ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti.

Pranueshmëria e kërkesës

30. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata Kushtetuese para së gjithash duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës.
31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113, paragrafi 7 të Kushtetutës që parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

32. Prandaj, Gjykata konsideron se së pari duhet të përcaktohet nëse parashtruesi është palë e autorizuar në kuptimin e dispozitave të sipërpërmendura.
33. Gjykata vëren se nga dokumentet e dorëzuara është e qartë se në procedurat para gjykatave të rregullta, parashtruesi, në funksionin e zyrtarit të lartë në Divizionin për Përfaqësim (Departamenti për Çështje Ligjore) në Ministrinë e Drejtësisë, ka përfaqësuar Ministrinë e Punëve të Brendshme, në cilësinë e palës së paditur. Pra, ai vetë nuk ishte palë në procedurë.
34. Në këtë rast, në vijim të kërkesës së Gjykatës për të qartësuar nëse kërkesa është parashtruar në emër individual të parashtruesit, parashtruesi në shkresën e tij, më 23 tetor 2013, konfirmoi pretendimet për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë duke mos saktësuar nëse kërkesa ishte parashtruar në emër të tij individual. Në shkresën e tij, parashtruesi *inter alia* theksoi:

“Megenëse unë Shefqet Hasimi, Zyrtar i Lartë në Ministrinë e Drejtësisë, Divizioni për Përfaqësim Gjyqësorë që sipas Autorizimit kam përfaqësuar këtë lëndë, me përfaqësim, shkresa, parashtrës, përgjigje në padi, Gjykatës Kushtetuese të Kosovës i PROPOZOJ që të merr në shqyrtim edhe këtë kërkesë për shqyrtimin e Kushtetutshmërisë në aktgjykimet e theksuara si në kërkesë, megenëse është prekë interesi i Ministrisë së Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës, Përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë nga Policia e Kosovës.

Në këtë drejtim konsideroj se ka shkelje të Kushtetutës dhe Ligjeve të Kosovës, në ndërhyrjen në Prokurorin e Qarkut në Prishtinë, andaj konsideroj se AKTGJYKIMI përmban Shkelje të Kushtetutës.

Andaj, për këto shkaqe kemi kërkuar që Gjykata Kushtetuese e Kosove të jep mendim lidhur me aktgjykimet e Gjykatës Supreme të Kosove si instancë e fundit”.

35. Më tej, Gjykata, pas pranimit të shkresës së parashtruesit të kërkesës të 23 tetorit 2013, më 25 tetor 2013 ka pranuar autorizimin e dërguar nga Ministria e Drejtësisë, me të cilin: “[...] Autorizohet z. Shefqet Hasimi, Zyrtar i Lartë Ligjor në Divizionin për Përfaqësim Gjyqësor në Departamentin për Çështje Ligjore të Ministrisë së Drejtësisë [...] që të përfaqësojë Qeverinë e Republikës së Kosovës pran Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për

parashtrimin e kërkesës të datës 30.08.2013 e njëjta është regjistruar pranë Gjykatës Kushtetuese me KI 133/2013, në bazë të nenit 113.7, si dhe në bazë të neneve 46,47,48,49 dhe 50, të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i autorizuar obligohet që të përfaqësoj dhe mbroj interesat e Qeverisë në pajtim me legjislacionin në fuqi. Ky autorizim vlen derisa të mos tërhiqet dhe nuk mund të përdoret për qëllime tjera”.

36. Përfaqësimi i autoriteteve publike nga Ministria e Drejtësisë në procedurat gjyqësore dhe të arbitrazhit është përcaktuar me legjislacionin përkatës.
37. Në këtë rast, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L - 048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe Rregullorja e Qeverisë 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive që përcaktojnë:

Neni 24 i Ligjit:

[...]

“Ministria e Drejtësisë ka të drejtën dhe autorizimin, por jo detyrimin, që të marrë përsipër përfaqësimin e autoritetit publik nëse (i) kjo kërkohet nga autoriteti publik; ose (ii) nëse Ministria e Drejtësisë përcakton, se autoriteti përkatës publik nuk është duke u përfaqësuar në mënyrë të rregullt ose kompetente. Ministria e Drejtësisë ka të drejtë të sigurojë këshilla të pavarura juridike, me kusht që këto nuk janë në konflikt me detyrimin e saj për përfaqësimin e cilësdo pale ose interesi në një procedurë.”[...]

Shtojca I e Rregullores:

“Ministria e Drejtësisë:

[...]

IX. Përfaqëson autoritetet publike në procedurat gjyqësore dhe të arbitrazhit, në pajtim me ligjin në fuqi;”

[...]

38. *Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi është palë e autorizuar dhe i ka shteruar të gjitha mjetet juridike, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës.*
39. Përveç kësaj, neni 49 i Ligjit parasheh se *“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të llogaritet që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”*. Në këtë rast, Gjykata vëren se parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar aktgjykimi i Gjykatës Supreme më 15 gusht 2013 dhe ai e ka dorëzuar kërkesën në Gjykatë më 30 gusht 2013.
40. Sidoqoftë, Gjykata gjithashtu duhet të marrë parasysh nenin 48 të Ligjit që parasheh:
- „Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*
41. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën, që të konstatojë se *[...]” Aktgjykimet e atakuara a ka shkelje të ligjeve të aplikueshme të Kosovës, a ka veprua në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, që paditësi ka ndërhyrë pa autorizim ne Prokurorin e Qarkut në Prishtinë dhe të vlerëson se organi i punësimit ka vepruar konform Kushtetutës së vendit [...]”*.
42. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi në kërkesën e tij nuk thekson se cila e drejtë është shkelur dhe cili nen i Kushtetutës mbështet kërkesën e tij.
43. Gjykata Kushtetuese, po ashtu, ripërsëritë se sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11 të parashtruesve Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
44. Në bazë të shkresave të rastit, Gjykata vëren që arsyetimi i dhënë me aktgjykimin e Gjykatës Supreme është i qartë, si dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu ka gjetur që procedurat në gjykatat e rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo

arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

45. Për më tepër, parashtuesi nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi *prima facie* që do të vërtetonte shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë (shih, Vanek kundër Republikës Sllovaqe, GJEDNJ, Nr. 53363/99 Vendimi i 31 majit 2005). Parashtuesi nuk saktësoi se cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë mbështesin pretendimin e tij, ashtu siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.
46. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (2) a) dhe d) të Rregullores së punës që parasheh *“Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse: a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie; dhe d) kur parashtuesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”*.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) a) dhe d) të Rregullores së punës, më 24 janar 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Arta Rama-Hajrizi

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI214/13, Kadrush Beqa, Aktvendim i datës 23 janar 2014 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit, Rev. nr. 75/2013, të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 16 shtatorit 2013

Rasti KI214/13, vendimi i 23 janarit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, e drejta e pronës, qartazi e pabazuar.

Parashtruesi e parashtroi kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 dhe rregullit 56 paragrafi 2 të Rregullores së punës.

Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të cilat pretendohet të kenë vërtetuar “eksproprijimin e gabuar dhe të padrejtë të pronës së parashtruesit”.

Në këtë drejtim, parashtruesi pretendon se është shkelur neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës karakterizohet me shkelje të së drejtës materiale dhe procedurale.

Duke shqyrtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit, Rev. nr. 75/2013, të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 16 shtatorit 2013, Gjykata Kushtetuese konstatoi se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtave kushtetuese dhe se parashtruesi i kërkesës nuk i ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij dhe, rrjedhimisht, kërkesa e tij është qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI214/13
Parashtrues
Kadrush Beqa
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit Rev. nr.
75/2013, të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 16 shtatorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga z. Kadrush Beqa (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Gjakovë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin Rev. nr. 75/2013, të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 16 shtatorit 2013 në lidhje me Aktgjykimin Ac. nr. 566/2012, të Gjykatës së Qarkut në Pejë, të 3 dhjetorit 2013, dhe Aktvendimin Ndr. nr. 45/2008, të Gjykatës Komunale në Gjakovë, të 23 dhjetorit 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara të gjykatave të rregullta, të cilat pretendohet të kenë vërtetuar *“eksproprijimin e gabuar dhe të padrejtë të pronës së parashtruesit”*.
4. Në këtë drejtim, parashtruesi pretendon se është shkelur neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-131 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 20 nëntor 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 3 dhjetor 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin nr. GJR. KI214/13, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin nr. KSH. KI214/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.
8. Më 19 dhjetor 2013, Gjykata e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai të dorëzojë dokumente shtesë. Të njëjtën ditë, Gjykata Supreme e Kosovës u njoftua për kërkesën.
9. Më 26 dhjetor 2013, parashtruesi i kërkesës i dorëzoi Gjykatës dokumente shtesë.
10. Më 23 janar 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 29 dhjetor 1960, Këshilli Popullor i Komunës së Gjakovës, respektivisht Komisioni për caktimin e paluajtshmërisë për eksproprijim, me Aktvendimin nr. 03-3475/60, e eksproprijoi një pronë të paluajtshme që ishte në pronësi të D. B., paraardhës juridik i parashtruesit të kërkesës.

12. Më 16 maj 2008, parashtruesi parashtroi kërkesë në Gjykatën Komunale në Gjakovë, duke kërkuar kompensim për pronën e eksproprijuar të paraardhësit të tij.
13. Më 23 dhjetor 2011, Gjykata Komunale në Gjakovë, me Aktvendimin Ndr. nr. 45/2008, e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për të detyruar palën e paditur (Komunën e Gjakovës), që në emër të pronës së eksproprijuar, përkatësisht të ngastrës kadastrale nr. 2120 ZK Gjakovë-qytet, t'ia paguajë atij shumën e përgjithshme prej 200.000,00 eurosh, me kamatën ligjore, e cila fillon të llogaritet nga dita kur pala e paditur hyri në posedim të pronës në fjalë, në vitin 1960, ose në mënyrë alternative, të kompensojë parashtruesin me një ngastër ndërtimore urbane me sipërfaqe të njëjtë me ngastrën e eksproprijuar.
14. Më 3 dhjetor 2012, Gjykata e Qarkut në Pejë, me Aktvendimin Ac. nr. 566/2012, e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe e vërtetoi aktvendimin e Gjykatës Komunale në Gjakovë.
15. Më 16 shtator 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin Rev. nr. 75/2013, e refuzoi si të pabazuar kërkesën për revizion të parashtruesit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë.
16. Në aktvendimin e lartpërmendur, Gjykata Supreme e Kosovës arsyetoi:

“... nga shkresat e lëndës del se propozuesit (parashtruesi) kërkojnë që të detyrohet kundër-propozuesja që atyre t’ua kompensojë sipërfaqen prej 0.05.38 ha, të depozeduar të ngastrës kadastrale nr. 2120 ZK Gjakovë-Qytet në lartësi prej 200.000,00 €, ose kërkesë tjetër alternative, dhënien e një toke tjetër ndërtimore në sipërfaqe të njëjtë. Me Aktvendimin nr. 03-3475/60 të 29.12.1960, Këshilli Popullor i Komunës së Gjakovës–Komisioni për caktimin e paluajtshmërisë së eksproprijuar, paraardhësit juridik të propozuesve D. B i është eksproprijuar paluajtshmëria– shtëpia me sipërfaqe prej 228 m², e cila ka qenë e ndërtuar në ngastrën kadastrale nr. 2120 ZK Gjakovë-Qytet, 1 një stalle të adaptuar për banim, 5 trungje të kumbullës, 2 trungje të ftonit, 1 hardhi të derës hyrëse (dyerve të oborrit) hambarit dhe pemishtes dhe në emër të kompensimit të pronës së eksproprijuar i është caktuar kundërvlera e përgjithshme prej 1.775.320 din.

[...]

Gjykata e shkallës së parë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes ka gjetur se kërkesa e propozuesve për caktimin e lartësisë së kompensimit të pronës së ekspropriuar është parashkruar dhe si e tillë është e pabazuar, andaj, me zbatimin e nenit 360 e lidhur me nenin 371 të LMD, vendosi si në dispozitiv të Aktvendimit.

Gjykata e shkallës së dytë drejt ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjetur se propozimi i propozuesve për kompensimin e pronës së depozeduar është parashkruar, kjo nga fakti se, paraardhësit juridik të propozuesve janë depozeduar nga patundshmëria kontestuese në vitin 1960, ndërsa propozuesit kanë ushtruar propozim më 16 maj 2008, pas plot 45 viteve dhe sipas vlerësimit të drejtë të gjykatës së shkallës së parë, me parashkrim pushon e drejta e propozuesve për të kërkuar përmbushjen e detyrimit edhe në supozimin se propozuesit kanë të drejtë”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi pretendon se vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës karakterizohet me shkelje të së drejtës materiale dhe procedurale.
18. Parashtruesi gjithashtu pretendon se është shkelur neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

Pranueshmëria e kërkesës

19. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, duhet së pari të shqyrtojë nëse ai i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
20. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113. 7 të Kushtetutës, i cili parasheh që:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

21. Për më tepër, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.

22. Në rastin konkret, Gjykata konsideron se parashtruesi është palë e autorizuar, i ka shteruar të gjitha mjetet juridike, siç parashihen me nenin 113.7 të Kushtetutës, dhe se kërkesa është dorëzuar brenda afatit ligjor prej katër (4) muajve në pajtim me nenin 49 të Ligjit.

23. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse

...

(c) kërkesa është qartazi e bazuar”.

24. Sa i përket pretendimit të parashtruesit se Gjykata Supreme e Kosovës e ka shkelur të drejtën materiale dhe procedurale, Gjykata konsideron se çështjet e faktit dhe të ligjit janë në kuadër të fushëveprimit të gjykatave të rregullta, në këtë rast të Gjykatës Supreme të Kosovës. Gjykata nuk mund të zëvendësojë gjetjet e veta me ato të gjykatave të rregullta për shkak se ajo nuk është as gjykatë e apelit, e as gjykatë e shkallës së katërt.

25. Në rastin konkret, Gjykata vëren se janë përmbushur garancitë procedurale të së drejtës për një gjykim të drejtë siç parashihen me Kushtetutë dhe Konventë; nuk ka asnjë gjurmë të arbitraritetit nga ana e Gjykatës Supreme. Për më tepër, Gjykata konsideron se vendimi i Gjykatës Supreme ka mbështetje ligjore, është i arsyetuar mirë dhe koherent për shkak se ai i shpjegon parashtruesit se të drejtat e tij të pretenduara ndaj pronës së shpronësuar janë parashkruar.

26. Gjykata Kushtetuese vëren se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve. Gjykata Kushtetuese thekson se konstatimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është në juridiksion të plotë të gjykatave të

rregullta dhe se roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë pajtueshmëri me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe me instrumente të tjera ligjore, prandaj nuk mund të veprojë si “*gjykatë e shkallës së katërt*” (shih, Akdivar kundër Turqisë, Nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, gjithashtu *mutatis mutandis* shih, rastin KI86/11, parashtues i kërkesës Milaim Berisha, Aktvendimi për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

27. Për më tepër, kërkesa nuk tregon se gjykatat e rregullta kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo në mënyrë të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të zëvendësojë vlerësimin e saj të fakteve me ato të gjykatave të rregullta, dhe si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave të vlerësojnë provat para vetes. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë marrë ato prova (shih rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, i 10 korrikut 1991).
28. Fakti se parashtuesi nuk pajtohet me rezultatin e rastit nuk mund t'i shërbejë që të ngrejë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës (shih rastin Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, nr. 5503/02, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 26 korrikut 2005).
29. Në këto rrethana, parashtuesi nuk e ka mbështetur me prova pretendimin e tij për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, sepse faktet e paraqitura nga ai nuk tregojnë në asnjë mënyrë se gjykatat e rregullta ia kanë mohuar atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë.
30. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet si e papranueshme, në mbështetje të rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) c) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 23 janar 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI141/13, Bajram Aliu, Aktvendim i datës 20 janar 2014 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Vendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, në rastin nr. SCEL-09-0001-C1131

Rasti KI141/13, vendimi i 20 janarit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, mosshterimi i mjeteve juridike.

Parashtruesi e parashtroi kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 dhe rregullit 56 paragrafi 2 të Rregullores së punës.

Parashtruesi nuk thirret në asnjë dispozitë kushtetuese në veçanti.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se “ai nuk ishte informuar në kohën e duhur për të ushtruar ankesë”, sepse “gruaja e tij është e palëvizshme dhe ka nevojë për përkujdesje të përhershme”.

Parashtruesi pretendon më tej se "Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme i ka shkelur të drejtat dhe liritë (e tij) në këtë rast, pasi që e hodhi poshtë ankesën (e tij) si të paafatshme pa bazë të mirëfilltë ligjore. Prandaj, të drejtat (e tij) të garantuara me Kushtetutën e Kosovës ishin shkelur". Parashtruesi nuk thirret në asnjë dispozitë kushtetuese në veçanti.

Nga dokumentet e përfshira në kërkesë, duket se parashtruesi kishte ushtruar ankesë në Trupin gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme; megjithatë, ai nuk ka dëshmuar se ai është ankuar gjithashtu edhe në Kolegjin për Ankesa të Gjykatës Supreme para se ta parashtrojë kërkesën në Gjykatë. Nga kjo rezultoi se kërkesa është e paafatshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI141/13

Parashtrues

Bajram Aliu

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Dhomës së
Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, në rastin nr. SCEL-
09-0001-C11311131**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar,
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Bajram Aliu (në tekstin e mëtejme: parashtruesi), me vendbanim në Podujevë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Vendimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, në rastin nr. SCEL-09-0001-C11311131 (parashtruesi ka dorëzuar vetëm një pjesë të shkëputur të vendimit), të nxjerrë në një datë të pacaktuar dhe i është dorëzuar atij në një datë të pacaktuar.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili pretendohet “t’i ketë shkelur të drejtat dhe liritë (e tij) në këtë rast, pasi që e hodhi poshtë ankesën [e tij] si të paafatshme, pa bazë të mirëfilltë ligjore dhe ia mohoi atij të drejtën në një pjesë të të ardhurave të fituara nga privatizimi i Ndërmarrjes shoqërore ‘Ramiz Sadiku’ në Prishtinë”.

4. Në këtë drejtim, parashtruesi nuk thirret në asnjë dispozitë kushtetuese në veçanti.

Baza juridike

5. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 4 shtator 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 24 shtator 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. KI141/13, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI141/13, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 10 tetor 2013, Gjykata e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të saktësojë se cilin vendim të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme e konteston. Të njëjtën ditë, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Dhoma e Posaçme) u njoftua në lidhje me kërkesën.
9. Parashtruesi nuk e dorëzoi informatën e kërkuar brenda afatit të caktuar kohor.
10. Më 20 janar 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Në një periudhë kohore, parashtruesi ishte i punësuar si punonjës i NSH “Ramiz Sadiku”.
12. Më 27 qershor 2006, u privatizua NSH “Ramiz Sadiku”.

13. Më 4, 5 dhe 7 mars 2009, AKP-ja publikoi listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar për një pjesë të fitimit nga fondi i 20% i të ardhurave nga privatizimi. Afati i fundit ligjor për të ushtruar ankesë kundër kësaj liste ishte 27 marsi 2009.
14. Më 5 qershor 2009, parashtruesi ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme, për t'u përfshirë në listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar.
15. Më 22 mars 2010, Dhoma e Posaçme (URDHRI SCEL-09-001) *“e lëshoi një urdhër duke kërkuar nga ankuesi (parashtruesi) të theksojë qartë se pse kishte ushtruar ankesë në Dhomën e Posaçme pas skadimit të afatit kohor të përcaktuar me nenin 10.6 (a) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/45 dhe kur arsyeja pushoi së ekzistuari”*.
16. Më 13 prill 2010, parashtruesi iu përgjigj urdhrit të Dhomës së Posaçme, duke theksuar se bashkëshortja e tij kishte qenë e sëmure dhe për shkak të sëmundjes së saj, ai nuk ishte në gjendje të ushtrojë ankesë brenda periudhës së obligueshme kohore.
17. Në një datë të pacaktuar, Dhoma e Posaçme me Vendimin në rastin nr. SCEL-09-0001-C11311131 (siç referohet nga parashtruesi), vërejti më tej se parashtruesi nuk kishte ofruar një arsyetim të vlefshëm që të dëshmojë se ai ishte penguar të ushtrojë ankesë me kohë, prandaj ankesa e tij ishte hedhur poshtë si e papranueshme.
18. Më 4 shtator 2013, parashtruesi parashtrroi kërkesë në Gjykatë.

Pretendimet e parashtruesit

19. Parashtruesi pretendon se *“ai nuk ishte informuar në kohën e duhur për të ushtruar ankesë”* sepse *“gruaja e tij është e palëvizshme dhe ka nevojë për përkujdesje të përhershme”*.
20. Parashtruesi pretendon më tej se *“Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme i ka shkelur të drejtat dhe liritë (e tij) në këtë rast, pasi që e hodhi poshtë ankesën [e tij] si të paqafatshme pa bazë të mirëfilltë ligjore. Prandaj, të drejtat (e tij) të garantuara me Kushtetutën e Kosovës ishin shkelur”*. Parashtruesi nuk thirret në asnjë dispozitë kushtetuese në veçanti.

Ligji

RREGULLORJA NR. 2003/13 MBI TRANSFORMIMIN E SË DREJTËS PËR PËRDORIMIN E PRONËS SË PATUNDSHME NË PRONËSI SHOQËRORE

“10.6 Pas paraqitjes së kërkesës nga individë apo individët me të drejtë të cenuar, ankesa lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime, e përcaktuar nga Agjencia dhe shpërndarja e fondeve nga llogaria e garancimbajtjes e paraparë në paragrafin 10.5, i nënshtrohet shqyrtimit nga Dhoma e Posaçme, në pajtim me nenin 4.1 (g) të Rregullores 2002/13.

(a) Ankesa duhet të dorëzohet në Dhomën e Posaçme brenda 20 ditëve pas shpalljes përfundimtare në media nga Agjencia, në bazë të paragrafit 10.3, të listës së të punësuarve me të drejta legjitime. Dhoma e Posaçme shqyrton çfarëdo ankese në (a) bazë të përparësisë dhe merr vendim për këto ankese brenda 40 ditësh pas dorëzimit të tyre;

Pranueshmëria e kërkesës

21. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 (7) të Kushtetutës, i cili parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

23. Gjykata i referohet nenit 47 (2) të Ligjit, i cili parasheh:

“Individi mund ta ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

24. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës, e cila parasheh:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

(a) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar; ose

25. Për më tepër, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

26. Gjykata vëren se parashtruesi përgjithësisht ankohet se *“Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme i ka shkelur të drejtat dhe liritë (e tij) në këtë rast, pasi që e hodhi poshtë ankesën [e tij] si të paqafatshme pa bazë të mirëfilltë ligjore”*, pa saktësuar si dhe pse kishin ndodhur shkeljet e pretenduara dhe gjithashtu pa saktësuar qartë se cili është akti konkret i autoritetit publik, të cilin ai dëshiron ta kontestojë.
27. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtruesit i është dhënë shumë kohë dhe mundësi për ta qartësuar kërkesën e tij, gjegjësisht të saktësojë se cilin vendim të Gjykatës Supreme e konteston dhe gjithashtu ta informojë Gjykatën nëse ai i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës. Parashtruesi nuk u përgjigj.
28. Nga dokumentet e përfshira në kërkesë, duket se parashtruesi kishte ushtruar ankesë në Trupin gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme; megjithatë, ai nuk ka dëshmuar se ai është ankuar gjithashtu edhe në Kolegjin për Ankesa të Gjykatës Supreme para se ta parashtrojë kërkesën në Gjykatë.
29. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për rregullin e shterimit është që t’u ofrojë autoriteteve përkatëse, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese (shih Rastin KI34/11, parashtrues Sami Bunjaku, Aktvendimi për papranueshmëri i 8 dhjetorit 2011).

30. Si përmbledhje, parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit të zbatueshëm.
31. Nga kjo rrjedh se kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme për shkak të mosshterimit të të gjitha mjeteve juridike siç parashihen me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 (2) të Ligjit, dhe rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) a) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 20 janar 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI155/13, Xhemajl Sylejmani, Aktvendim i datës 24 janar 2014 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 302/2012, të 3 qershorit 2013.

Rasti KI155/13, vendimi i 24 janarit 2014.

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, E Drejta për Mjete Juridike, E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit, **qartazi e pabazuar.**

Parashtruesi pretendon që me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 302/2012, të 3 qershorit 2013, i janë shkelur të drejtat e mbrojtura me Kushtetutë, nga neni 21 [Parimet e Përgjithshme], neni 24 [Barazia para Ligjit], neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe neni 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës.

Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë me aktgjykimin e fundit nga Gjykata Supreme është i qartë, si dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu ka gjetur që procedurat në gjykatat e rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare.

Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës nuk e arsyetojnë në asnjë mënyrë pretendimin për shkelje të të drejtave kushtetuese dhe se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur mjaftueshëm pretendimin e tij.

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe rregullit 36 (2) b) dhe d) të Rregullores së punës, më 24 janar 2014, njëzëri deklaroi kërkesën të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI155/13
Parashtrues
Xhemajl Sylejmani
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 302/2012, të 3 qershorit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Xhemajl Sylejmani nga fshati Gërmovë, komuna e Vitisë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 302/2012, të 3 qershorit 2013, të cilin parashtruesi i kërkesës e ka pranuar më 17 qershor 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 302/2012, të 3 qershorit 2013. Parashtruesi i kërkesës kërkon kthimin në vendin e punës si dhe kompensimin e të ardhurave për kohën gjatë së cilës parashtruesi nuk ka punuar.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121

(në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatë

5. Më 2 tetor 2013, parashtruesi parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata)
6. Më 10 tetor 2013, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi në Gjykatë një dokument shtesë.
7. Më 28 tetor 2013, Kryetari, me Vendimin GJR. nr. KI155/13, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. 99/13, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 11 nëntor 2013, Gjykata informoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e lëndës.
9. Më 24 janar 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 25 shtator 2009, Kuvendi Komunal i Vitisë, përmes Komisionit për ankesa, nxori Vendimin nr. 03-113/4782, me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës, me të cilën e kontestoi vendimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës me komunën. Më tej, në vendim thuhet:

“Sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës Komisioni për ankesa konstaton se këtu nuk kemi të bëjmë me ndërprerje të kontratës por me skadim të saj. dhe atë se me vetë dëshirë i njëjti nuk e ka nënshkruar kontratën edhe pse me njoftimin me nr 03.07.4178 të dt 13.08.2009 i ishte tërheqë vërejtja për pasojat e mos nënshkrimit të kontratës”.

11. Më 26 shkurt 2010, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPMK), duke vepruar në bazë të ankesës së parashtruesit të kërkesës, nxori Vendimin nr. 02 (213) 2009, me ç'rast e refuzoi ankesën si të pabazuar dhe vërtetoi Vendimin nr.

03-113/4782, të 25 shtatorit 2009, të Komisionit për Ankesa dhe Vendimin nr.03-118-4424, të 26 gushtit 2009, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së parashtruesit të kërkesës.

12. Më 2 maj 2012, Gjykata Komunale në Viti, duke vepruar në bazë të kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës, nxori Aktgjykimin C. nr. 214/2011, duke refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e tij. Gjykata Komunale në arsyetimin e saj më tej theksoi:

“Gjykata konkludon se kërkesëpadia e paditësit për kthimin në vend të punës njëkohësisht edhe kompensimin e të ardhurave personale është e pabazuar...”.

Vendimi i gjykatës është i bazuar në dispozita ligjore lidhur me procedurat në kontestet nga marrëdhënia e punës nga neni 475 lidhur me nenin 477 të LPK.

13. Më 10 korrik 2012, Gjykata e Qarkut në Gjilan, duke vepruar në bazë të ankesës së parashtruesit të kërkesës, nxori Aktgjykimin Ac. nr. 207/12, me ç’rast e refuzoi ankesën si të pabazuar dhe e vërtetoi Aktgjykimin C. nr. 214/2011 të shkallës së parë. Gjykata e Qarkut më tej dha këtë arsyetim:

“Kjo gjykatë konsideron se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së këtij aktgjykimi nuk ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kujdeset kryesisht se gjendjen faktike e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë e po ashtu drejt e ka zbatuar edhe të drejtën materiale...”.

14. Më 3 qershor 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, duke vepruar në bazë të kërkesës për revizion të parashtruesit të kërkesës, nxori Aktgjykimin Rev. nr. 302/2012, duke e refuzuar si të pabazuar revizionin kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, Ac. nr. 207/12, të 10 korrikut 2012. Gjykata Supreme, më tej, arsyetoi:

“Gjykatat e instancës më të ulët duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia është e pabazuar”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi pretendon që me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 302/2012, të 3 qershorit 2013, i janë shkelur të drejtat e mbrojtura me Kushtetutë, nga neni 21 [Parimet e

Përgjithshme], neni 24 [Barazia para Ligjit], neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe neni 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës.

16. Parashtruesi përfundon duke kërkuar nga Gjykata Kushtetuese:

“Dëshiroj të kthehem në vendin e punës ku isha, kompensim për kohën që s’kam punuar...”.

Pranueshmëria e kërkesës

17. Për të qenë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata para së gjithash duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës të Gjykatës.

18. Në këtë drejtim, neni 113 paragrafi 7 i Kushtetutës parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

19. Përveç kësaj, neni 49 i Ligjit parasheh:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të llogaritet që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”.

20. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës për të mbrojtur të drejtat e tij i është drejtuar KPMK-së, Gjykatës Komunale në Viti, Gjykatës së Qarkut në Gjiilan, dhe në fund Gjykatës Supreme të Kosovës. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesit të kërkesës aktgjykimi i Gjykatës Supreme i 3 qershorit i është dorëzuar më 17 qershor 2013 dhe ai e ka dorëzuar kërkesën në Gjykatë më 2 tetor 2013.

21. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi është palë e autorizuar dhe i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit të zbatueshëm dhe se kërkesa është dorëzuar brenda afatit prej katër (4) muajve.

22. Sidoqoftë, Gjykata gjithashtu duhet të marrë parasysh rregullin 36 të Rregullores së punës, që parasheh:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: (c) kërkesa është qartazi e bazuar”.

“(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...], ose

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese; ose

[...], ose

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi Rev. nr. 302/2012, i 3 qershorit 2013, me të cilin janë vërtetuar aktgjykimet e Gjykatës Komunale në Viti (Aktgjykimi C. nr. 214/2011, i 2 majit 2012) dhe të Gjykatës së Qarkut në Gjilan (Aktgjykimi Ac. nr. 207/12, i 10 korrikut 2012) shkel të drejtat e tij, të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], si dhe Nenin 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesioneve] të Kushtetutës.
24. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese e ripërsëritë se sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t’i interpretojnë dhe t’i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11 të parashtruesve Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
25. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, *inter alia*, rasti Eduards kundër Mbretërisë së Bashkuar, kërkesa nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).

26. Në bazë të shkresave të rastit, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë me aktgjykimin e fundit nga Gjykata Supreme është i qartë, si dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu ka gjetur që procedurat në gjykatat e rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).
27. Për më tepër, Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj konfirmoi se *“gjykatat e instancës më të ulët duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia është e pabazuar [...]”*.
28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat nga neni 49 i Kushtetutës. Neni 49 i Kushtetutës parashikon:
 - “1. E drejta e punës garantohej.*
 - 2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës”.*
29. Në këtë drejtim, *“e drejta e punës garantohej”* për aq sa individi i respekton kushtet e ligjshme nga kontrata e tij e punës dhe ligjet e aplikueshme mbi punësimin. Në këtë kërkesë, nuk ka prova se parashtruesi i kërkesës ka nënshkruar ndonjëherë kontratën e punës apo se i ka respektuar ligjet e aplikueshme mbi punësimin në Kosovë. Në të vërtetë, gjykatat në mënyrë të përsëritur kanë gjetur se i njëjti nuk i ka respektuar ligjet e aplikueshme mbi punësimin. Rrjedhimisht, nuk ka prova se parashtruesit të kërkesës i është mohuar e drejta e punës së ligjshme.
30. Nga arsyet e lartpërmendura, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës nuk e arsyetojnë në asnjë mënyrë pretendimin për shkelje të të drejtave kushtetuese dhe se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur mjaftueshëm pretendimin e tij.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, neni 20 të Ligjit dhe rregullit 36 (2) b) dhe d) të Rregullores së punës, më 24 janar 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe,
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI194/13, KI202/13, KI203/13 dhe KI204/13, Rrahman Rashiti, Ali Dragusha, Isak Dragusha, Nazim Dragusha, Aktvendim i datës 21 janar 2014 - Vlerësim i Kushtetushmërisë së Vendimit të Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, SCEL-09-0001, të 4 shkurtit 2010

Rastet KI194/13, KI202/13, KI203/13 dhe KI204/13, vendim i 21 janarit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesa individuale, afati i fundit, privatizimi, 20%

Parashtreusi i kërkesës parashtroi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke e kontestuar Vendimin e Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme), SCEL-09-0001, i 4 shkurtit 2010, i cili pretendohet se ua pamundëson parashtruesve që t'i realizojnë të drejtat në një pjesë të 20% nga privatizimi i Ndërmarrjes shoqërore “Ramiz Sadiku” (në tekstin e mëtejme: NSH “Ramiz Sadiku”), në Prishtinë. Parashtruesit e kërkesës në një periudhë kohore ishin punëtorë të NSH “Ramiz Sadiku”.

Më 27 qershor 2006, NSH “Ramiz Sadiku” e përfundoi procesin e privatizimit. Parashtruesit e pakënaqur me vendimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Agjencia), ku ata nuk ishin përfshirë në listën e punëtorëve, të cilët e kishin realizuar të drejtën në një pjesë të 20% nga privatizimi i NSH “Ramiz Sadiku”, ushtruan ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

Më 4 shkurt 2010, Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme nxori Vendimin SCEL-09-0001, me të cilin refuzohen ankesat e parashtruesve si të pabazuara. Në arsyetim të vendimit të tij, Trupi gjykues theksoi: *“se në bazë të dokumenteve të dorëzuara në shkresat e lëndës dhe në bazë të dëgjimit është vërtetuar se parashtruesit në momentin e privatizimit të NSH 'Ramiz Sadiku', ishin mbi 65 vjet, dhe për këtë arsye ata nuk i kishin plotësuar kërkesat e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13”.*

Duke shqyrtuar kërkesën e parashtruesit lidhur vlerësimin e kushtetushmërisë së Vendimit të Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit SCEL- 09-0001, të 4 shkurtit 2010,

Gjykata konstaton se parashtruesit i kishin dorëzuar kërkesat e tyre më 11 dhe 14 nëntor 2013. Në bazë të shkresave të lëndës në dispozicion, Gjykata gjithashtu vërtetoi që vendimi i fundit i Trupit gjyqësor të Dhomës së Posaçme SCEL-09-0001 u është dorëzuar parashtruesve të kërkesës në datat si në vijim: parashtruesit të kërkesës në rastin KI194/13, vendimi i është dorëzuar më 10 mars 2010, parashtruesit në rastin KI202/13 vendimi i është dorëzuar më 24 shkurt 2011, ndërsa parashtruesve në rastet KI203/13 dhe KI204/13, vendimet u janë dorëzuar më 13 korrik 2011, rrjedhimisht parashtruesit i kanë dorëzuar kërkesat e tyre në Gjykatë pas skadimit të afatit të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në**

Rastet nr.

KI194/13, KI202/13, KI203/13, KI204/13

Parashtrues

**Rrahman Rashiti, Ali Dragusha, Isak Dragusha, Nazim
Dragusha**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit SCEL-09-0001, të
Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të
Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të
Privatizimit, të 4 shkurtit 2010**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesat KI194/13, KI202/13, KI203/13, KI204/13, i kanë dorëzuar: z. Rrahman Rashiti nga fshati Obrancë, komuna e Podujevës, z. Ali Dragusha, z. Isak Dragusha, dhe z. Nazim Dragusha, të gjithë nga fshati Prugovc, komuna e Prishtinës (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kontestojnë Vendimin SCEL-09-0001, të Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme), i 4 shkurtit 2010, i cili u është dorëzuar parashtruesve në data të ndryshme. Parashtruesit të kërkesës të rastit KI194/13, sipas pohimit të tij, vendimi i është dorëzuar më 10 mars 2010, parashtruesit në rastin KI202/13 vendimi i është dorëzuar më 24 shkurt 2011, ndërsa parashtruesve në rastet KI203/13 dhe KI204/13, vendimet u janë dorëzuar më 13 korrik 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit, i cili pretendohet se ua pamundëson parashtruesve që t'i realizojnë të drejtat në një pjesë të 20% nga privatizimi i Ndërmarrjes shoqërore “Ramiz Sadiku” (në tekstin e mëtejme: NSH “Ramiz Sadiku”), në Prishtinë.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullat 29 dhe 37 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 11 dhe 14 nëntor 2013, parashtruesit dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 2 dhjetor 2013, Kryetari, me Vendimin nr. GJR. KI194/13, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI194/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 10 dhjetor 2013, Kryetari mori vendimin për bashkimin e rasteve KI202/13, KI203/13 dhe KI204/13 në rastin KI194/13.
8. Më 17 dhjetor 2013, në pajtim me rregullin 37 të Rregullores së punës, Gjykata i njoftoi parashtruesit për regjistrimin dhe bashkimin e kërkesave dhe gjithashtu kërkoi nga parashtruesit që të paraqesin dëshmi se kur u janë dorëzuar atyre vendimet e kontestuar.
9. Gjykata e njoftoi të njëjtën ditë, Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.
10. Parashtruesit nuk kanë paraqitur asnjë kundërshtim në Gjykatë ndaj vendimit për bashkimin e kërkesave dhe gjithashtu nuk kanë dorëzuar informatën e kërkuar.

11. Më 21 janar 2013, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Parashtruesit e kërkesës në një periudhë kohore ishin punëtorë të NSH "Ramiz Sadiku".
13. Më 27 qershor 2006, NSH „Ramiz Sadiku“ e përfundoi procesin e privatizimit.
14. Parashtruesit e pakënaqur me vendimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Agjencia), ku ata nuk ishin përfshirë në listën e punëtorëve, të cilët e kishin realizuar të drejtën në një pjesë të 20% nga privatizimi i NSH „Ramiz Sadiku“, ushtruan ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.
15. Në ankesën e ushtruar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, parashtruesit pretendojnë se ata janë viktimë të diskriminimit, se ata kishin punuar në NSH „Ramiz Sadiku“ derisa ata janë larguar me forcë nga vendet e tyre të punës, se pas luftës më 1999, disa herë kanë provuar të kthehen që të punojnë përsëri. Së bashku me ankesat në Dhomën e Posaçme, parashtruesit kishin bashkëngjitur edhe kopjet e dokumenteve të tyre personale, me datat e lindjes: parashtruesi i rastit KI194/13, më 1 dhjetor 1937, parashtruesi i rastit KI202/13, më 14 shkurt 1938, parashtruesi i rastit KI203/13, më 23 maj 1939, dhe parashtruesi i rastit KI204/13, më 23 prill 1939.
16. Agjencia u ishte përgjigjur ankesave të parashtruesve, përmes një shkrese dërguar Dhomës së Posaçme, duke pretenduar se parashtruesit nuk i plotësojnë kushtet që të jenë në listën e punëtorëve të cilët kanë të drejtë në pjesën e 20% nga privatizimi i NSH "Ramiz Sadiku", sepse në kohën e privatizimit ata i kishin mbushur nga 65 vjet.
17. Në një datë të pacaktuar, në procedurën e dëgjimit para Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme, parashtruesit deklaruan se librezat e tyre të punës ishin shkatërruar gjatë luftës së vitit 1999, dhe se në Agjenci ata kishin dorëzuar dokumentacionin që në mënyrë indirekte ofron dëshmi të statusit të tyre të punës në NSH "Ramiz Sadiku", se pas vitit 1999, ata u përpoqën të kthehen në vendet e tyre të punës që ata dikur i kishin pasur, por se kërkesat e tyre nuk

hasën në mirëkuptim nga autoritetet e ndërmarrjes. Të gjithë parashtruesit ia dorëzuan Trupit gjykues dokumentet e tyre personale.

18. Më 4 shkurt 2010, Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme nxori Vendimin SCEL-09-0001, me të cilin refuzohen ankesat e parashtruesve si të pabazuara. Në arsyetim të vendimit të tij, Trupi gjykues theksoi: „*se në bazë të dokumenteve të dorëzuara në shkresat e lëndës dhe në bazë të dëgjimit është vërtetuar se parashtruesit në momentin e privatizimit të NSH ‘Ramiz Sadiku’, ishin mbi 65 vjet, dhe për këtë arsye ata nuk i kishin plotësuar kërkesat e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13*”.

Ligji relevant

19. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/13, e 9 majit 2003, MBI TRANSFORMIMIN E SË DREJTËS PËR PËRDORIMIN E PRONËS SË PATUNDSHME NË PRONËSI SHOQËRORE

Neni 10.4 (Të drejtat e të punësuarve)

„Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri (3) vite. Kjo kërkesë nuk i ndalon punëtorët, të cilët pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar, nëse nuk do të kishin qenë diskriminuar, që të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6”.

Pretendimet e parashtruesit

20. Në kërkesat e tyre, parashtruesit pretendojnë se vendimi i kontestuar ua shkel atyre të drejtën e punës si dhe nenet 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe 24 [Barazia para Ligjit] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
21. Të gjithë parashtruesit i drejtohen Gjykatës me të njëjtën kërkesë:

„Që edhe ata dëshirojnë që atyre tu takojë e drejta në 20% si të punësuarve të tjerë të ndërmarrjes ‘Ramiz Sadiku’“.

Pranueshmëria e kërkesës

22. Gjykata thekson se në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë sipas ankesës së parashtruesve, para së gjithash Gjykata duhet të vlerësojë nëse parashtruesit e kërkesës i kanë plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës.

23. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkëljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

24. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor (...)".

25. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

...

b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi..."

26. Në bazë të të dhënave nga shkresat e lëndës, Gjykata konstaton se parashtruesit i kishin dorëzuar kërkesat e tyre më 11 dhe 14 nëntor 2013. Në bazë të shkresave të lëndës në dispozicion, Gjykata gjithashtu vërtetoi që vendimi i fundit SCEL-09-0001 i Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme u është dorëzuar parashtruesve të kërkesës në datat si në vijim: parashtruesit të kërkesës në rastin KI194/13, vendimi i është dorëzuar më 10 mars 2010, parashtruesit në rastin KI202/13 vendimi i është dorëzuar më 24 shkurt 2011, ndërsa parashtruesve në rastet KI203/13 dhe KI204/13, vendimet u janë dorëzuar më 13 korrik 2011, rrjedhimisht parashtruesit i kanë dorëzuar kërkesat e tyre në

Gjykatë pas skadimit të afatit të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.

27. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor katër (4) muaj, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri ligjore, duke siguruar se rastet që kanë të bëjnë me çështje të Kushtetutës të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe se vendimet e mëparshme nuk janë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar (shih, rastin O'Loughlin dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr. 23274/04, GJEDNJ, Aktvendimi i 25 gushtit 2005).
28. Nga kjo rrjedh se kërkesat janë të paafatshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, më 21 janar 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI94/13, Avni Doli, Mustafa Doli, Zija Doli dhe Xhemile Osmanaj Aktgjykim i datës 24 mars 2014 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 324/12, të 21 dhjetorit 2012

Rasti KI94/13, vendimi i 24 marsit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, situata e vazhdueshme, mospërmbarimi vendimit administrativ, res judicata, siguri juridike, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për mjete juridike, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, pritje legjitime, mbrojtje e pronës.

Parashtruesit e kërkesës kontestojnë mospërmbarimin e Aktvendimit të Drejtorisë për Çështje Pronësore, Kadastër, Gjeodezi dhe Komacson të tokës së Komunës së Gjakovës, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë, të 21 dhjetorit 2012, me të cilin u vërtetua Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Gjakovë, të 24 prillit 2012. Gjykata Komunale në Gjakovë me vendimin e saj të 24 prillit 2011 e kishte anuluar vendimin e vet për përmbarim të Vendimit të Drejtorisë së nxjerrë më 22 dhjetor 2011, i cili mori formën e prerë dhe detyrues.

Parashtruesit pretendojnë se vendimet e kontestuarat i kanë shkelur të drejtat e tyre për: Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës për Mbrojtje të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ); Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave siç garantohet me nenin 54 të Kushtetutës, dhe Mbrojtja e Pronës, siç garantohet me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Gjykata Kushtetuese deklaroi kërkesën të pranueshme duke konsideruar se parashtruesit e kërkesës ishin palë e autorizuar, kanë shteruar të gjitha mjetet juridike, kanë përmbushur kërkesën për afat si rezultat i situatës së vazhdueshme, dhe se ata e kanë sqaruar me saktësi shkeljen e pretenduar të të drejtave dhe lirive dhe u ishin referuar vendimeve që ata i kontestojnë.

Si rezultat, Gjykata e Qarkut, me rastin e vërtetimit të aktvendimit të dytë të Gjykatës Komunale, shkeli parimin e sigurisë juridike dhe, rrjedhimisht, shkeli të drejtën e parashtruesit për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së.

Gjykata Kushtetuese gjithashtu gjeti se pamundësia për të ndërmarrë veprime të mëtejshme ligjore për përmbarimin e Aktvendimit të Drejtorisë gjithashtu paraqet shkelje të neneve 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe të nenit 13 të KEDNJ-së.

Prandaj, Gjykata konsideron se Aktvendimi i Drejtorisë përbën pritje legjitime për parashtruesit, se ata do të gëzonin të drejtën e tyre pronësore

Si përfundim, Gjykata gjen se mospërmbarimi i Aktvendimit të Drejtorisë nga organet kompetente administrative dhe gjykatat e rregullta dhe dështimi që pasoi për të siguruar mekanizma efikas për përmbarimin e vendimeve përkatëse të autoriteteve përkatëse dhe vendimeve gjyqësore, përbën shkelje të neneve 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe të neneve 6 dhe 13 të KEDNJ-së.

Si rezultat i kësaj shkeljeje, parashtruesit e kërkesës janë privuar nga regjistrimi i pronës në emër të tyre. Kështu, është shkelur e drejta për mbrojtjen e pronës, e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së. Prandaj, Aktvendimi i Drejtorisë duhet të përmbarohet.

AKTGJYKIM
në
Rastin Nr. KI94/13
Parashtrues
Avni Doli, Mustafa Doli, Zija Doli dhe Xhemile Osmanaj
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së
Qarkut në Pejë, Ac. nr. 324/12, të 21 dhjetorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u dorëzua nga z. Avni Doli, z. Mustafa Doli, z. Zija Doli dhe znj. Xhemile Osmanaj nga Gjakova (në tekstin e mëtejme: parashtruesit).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kontestojnë mospërmbarimin e Aktvendimit të Drejtorisë për Çështje Pronësore, Kadastër, Gjeodezi dhe Komasaçion të tokës të Komunës së Gjakovës (në tekstin e mëtejme: Drejtoria), të 1 gushtit 2002, në lidhje me Aktgjykimin Ac. nr. 324/12, të Gjykatës së Qarkut në Pejë, të 21 dhjetorit 2012, me të cilin u vërtetua Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Gjakovë, E. nr. 1395/11, i 24 prillit 2012. Vendimi i Gjykatës së Qarkut u ishte dorëzuar parashtruesve më 18 janar 2013, dhe ishte objekt i kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, e cila u refuzua më 7 mars 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së mospërmbarimit të Aktvendimit të Drejtorisë lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë (Ac. nr. 324/12, të 21

dhjetorit 2012), me të cilin vërtetohet Aktvendimi (E. Nr. 1395/11, i 24 prillit 2012) i Gjykatës Komunale në Gjakovë, me të cilin anulohet procedura përmbartimore e vendimit të Drejtorisë.

4. Parashtruesit pretendojnë se vendimet e kontestuara i kanë shkelur të drejtat e tyre për: Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës për Mbrojtje të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ); Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave siç garantohet me nenin 54 të Kushtetutës, dhe Mbrojtja e Pronës, siç garantohet me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenet 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 3 korrik 2013, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 5 gusht 2013, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues, dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 27 gusht 2013, Gjykata i njoftoi parashtruesit dhe Gjykatën Themelore në Gjakovë për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 11 tetor 2013, Gjykata gjithashtu e njoftoi Drejtorinë për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi komente për kërkesën, nëse ka.
10. Më 21 tetor 2013, Drejtoria njoftoi se ajo e respekton tërësisht Aktvendimin e Drejtorisë (Nr. 11 465-8/93, të 1 gushtit 2002).
11. Më 25 tetor 2013, Gjykata kërkoi nga Drejtoria informata për regjistrimin e pronës në emër të parashtruesve, siç është përcaktuar në vendimin e 1 gushtit 2002.

12. Më 7 nëntor 2013, Gjykata e pranoi përgjigjen e dhënë nga Drejtoria.
13. Më 10 shkurt 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe ia rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 6 prill 1975, Sekretariati për Çështje Administrative dhe Juridike i Komunës së Gjakovës vendosi (Nr. 03-465-23/1972), për ekspropriimin e pronës së parashtruesve.
15. Më 1 gusht 2002, sipas kërkesës së parashtruesve, Drejtoria vendosi (Aktvendimi 11 Nr. 465-8/93) të ndryshojë vendimin e lartpërmendur dhe t'i kthejë pjesët e ngastrës kadastrale, Nr. 5531/1, KK Gjakovë, në sipërfaqe prej 0.33.01 ha, në posedim të parashtruesve.
16. Drejtoria, më tej, vendosi që Shërbimi për Kadastër dhe Gjeodezi i Drejtorisë për Punë Pasurore-Juridike, Kadastër, Gjeodezi dhe Komasacion të Komunës së Gjakovës ta bëjë çregjistrimin e paluajtshmërisë së lartpërmendur prej emrit të Komunës së Gjakovës dhe ta regjistrojë në emër parashtruesve.
17. Në vendim këshillohej se *“Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesa Kryeshefit të ekzekutivit të komunës së Gjakovës në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorzim te këtij aktvendimi”*.
18. Në vërtetimin e vendimit thuhej: *“Vendimi është përfundimtar. Gjakovë, 09.01.2003”*.
19. Drejtoria e përmbanoi Vendimin 11, Nr. 465-8/93, të 1 gushtit 2002, në raport me palën e tretë; por jo në raport me parashtruesit.
20. Më 4 qershor 2004 dhe më 17 shtator 2004, parashtruesit kërkuan nga Drejtoria përmbarimin e vendimit të saj në raport me ta.
21. Më 22 shtator 2011, Drejtoria i njoftoi parashtruesit se *“Lidhur me Aktvendimin për dëkpropriim 11 nr. 465-8/1993 dt.01.08.2002 i plotëfuqishem nga dt.09.01.2003, Ju informojme edhe një here se ky aktvendim si i tille nuk mund të jetësohet në aparatin kadastral sepse ka mangësi. [...] Andaj, kjo Drejtori është e*

mendimit qe ti drejtohi Gjykates komunale në Gjakove, lidhur me realizimin e te drejtave qe kërkoni., edhe pse kane kaluar shume vite”.

22. Më pas, më 13 dhjetor 2011, parashtruesit i propozuan Gjykatës Komunale në Gjakovë përmbarrimin e Vendimit 11 Nr. 465-8/93, të 1 gushtit 2002.
23. Më 22 dhjetor 2011, Gjykata Komunale (E. Nr. 1395/11) vendosi që *“Debitori ekzekutiv detyrohet që brenda afatit prej 7 ditësh / kurse në kontestet që lidhen me kambialin dhe çekun brenda afatit prej 3 ditësh/nga dita e dorëzimit të aktvendimit ta shlyej borxhin bashkë me shpenzimet procedurale të caktuara në të”.*
24. Në vendimin e Gjykatës Komunale këshillohej që *“Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 7 ditëve pas marrjes së tij nëpërmjet kësaj Gjykate”.*
25. Ndërkohë, më 24 prill 2012, Gjykata Komunale (E. Nr. 1395/11), vendosi të [...] *“SHFUQIZOHET Aktvendimi E nr. 1395/11 i dt. 22.12.2011 (...)dhe anulohen te gjitha veprimet e ndërmarra në këtë lëndë.”* Gjykata Komunale arsyetoi se [...] *“nga sa u tha në vështrim të nenit 24 pika b) dokumenti-Aktvendimi i cituar nuk paraqet Titull ekzekutiv pasi që në dispozitivin e Aktvendimit nuk parashihet kurrfarë detyrimi në të holla i debitorit ndaj kreditorëve, ndërsa zbatimi i këtij Aktvendimi në procedurën përmbarrimore me ligje tjera nuk është i paraparë”.*
26. Më 15 maj 2012, parashtruesit ushtruan ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë kundër vendimit të Gjykatës Komunale.
27. Parashtruesit pretendonin se Aktvendimi (E. Nr. 1395/11) i Gjykatës Komunale, i 22 dhjetorit 2011, kundër të cilit nuk është paraqitur ankesë nga Drejtoria, është bërë i formës së prerë dhe i përmbarrueshëm.
28. Parashtruesit më tej pretendonin se [...] *“Kreditorët nuk e kanë të kuartë faktin se si është e mundur që të shfuqizohet Aktvendimi për lejin e Propozimit të kreditorëve, i datës 22.11.2011, kur kundër këtij aktvendimi debitori nuk ka parashtruar kundërshtim brenda afatit ligjor për ndonjërin prej shkaqeve të përmendura në nenin 55 të LPP, bazuar në faktin se me dispozitat e nenit 13.1 të LPP, është përcaktuar se “Aktvendimi kundër të cilit nuk është paraqitur brenda afatit ligjor prapësimi, bëhet i formës së prerë*

dhe i përmbarueshëm", rrethanë kjo që e bënë të pabazuar dhe të kundërligjshëm aktvendimin e atakuar [...]".

29. Parashtruesit konstatuan se [...] *"Gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje të rënda të dispozitave ligjore, dhe se ka aplikuar gabimisht të drejtën materiale në dëm të kreditorëve [...]"*. Parashtruesit, më tej, kërkuar nga Gjykata e Qarkut që të aprovojë si të bazuar ankesën e tyre të përbashkët dhe të detyrohet Drejtoria ta regjistrojë paluajtshmërinë në emër të parashtruesve.
30. Më 21 dhjetor 2012, Gjykata e Qarkut (Aktgjykimi Ac. nr. 324/12) e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesve dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Gjakovë (E. Nr. 1395/11, të 24 prillit 2012).
31. Gjykata e Qarkut konstatoi se [...] *"gjykata e shkallës së parë në bazë të nenit 24. pika b) 4 lidhur me nenin 44. të Ligjit mbi procedurën e përmbarimit me aktvendimin e atakuar e ka shfuqizuar se aktvendimi i marr në procedurën administrative që nuk ka të bëjë me kërkesën në të holla nuk përfaqëson dokument të përshtatshëm përmbarimor"* dhe erdhi në përfundim se [...] *"aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182. 2 të LPK-së dhe se drejtë është aplikuar edhe e drejta materiale, të cilat i vëren gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194. të LPK-së, pa marur parasysh se a janë potencuar nga parashtruesi i ankesës apo jo"*.
32. Parashtruesit parashtruan kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurori i Shtetit të Kosovës.
33. Më 7 mars 2013, Prokurori i Shtetit i njoftoi parashtruesit se sipas mendimit të tij nuk kishte bazë ligjore për të vazhduar me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë. Më 3 korrik 2013, parashtruesit e parashtruan kërkesën e tyre në Gjykatë.
34. Më 11 tetor 2013, në njoftimin e Gjykatës drejtuar Drejtorisë për regjistrim të kërkesës, Gjykata e ftoi Drejtorinë që ta komentojë kërkesën.
35. Më 21 tetor 2013, Drejtoria komentoi se: [...] *"Lidhur me shkresën e Juaj Drejtoria për gjeodezi, kadastër e pronë e Komunës së Gjakovës, duke i analizuar të gjitha këto, për këtë qështje Ju njofton, respektivisht komenti i kësaj Drejtorie është me sa vijon: Mbetem respektivisht i përmbahem në tërësi Aktvendimit të*

plotëfuqishëm të Drejtorisë për punë pasurore-juridike, kadastër, gjeodezi dhe komasacion të Komunës së Gjakovës nr.II-465-8/93, të dt.01.08.2001,i cili është bërë i plotëfuqëshëm me dt.09.01.2013,me të cilën DEBITORI është detyruar që parashtruesve të kësaj kërkesë si dhe Rexhep Dolit nga Gjakova,t'ju kthehet në posed dhe shfrytëzim të përhershme 1/2 pjesë ideale respektivishtë nga 1/6 pjesë ideale të pjesës së ngastrës nr.5531/1, K.K.Gjakovë-j.qytet në sip prej 0.33.01 ha,ashtu siq theksohet në dispozitiv të ketij Aktevendimi, dhe për këtë nga Organi administrativ i është percjellë aktvendimi për të egzekutuar sipas dispozitivit të tij”.

36. Më 25 tetor 2013, përveç kësaj, Gjykata kërkoi nga Drejtoria që ta njoftojë për arsyet e regjistrimit të pronës në fjalë në emër të R. D., dhe pse ende nuk e kishte regjistruar pronën e njëjtë në emër të parashtruesve, siç përcaktohet me Vendimin e Drejtorisë (Nr. 11 465-8/93, të 1 gushtit 2002).
37. Më 7 nëntor 2013, Drejtoria njoftoi se “*Se Vendimi i Drejtorisë për punë pasurore juridike, kadastër, gjeodezi e komasacion e Komunës së Gjakovës, i cili aktvendim është bërë i plotëfuqishëm me dt.09.10.2003, i është percjellur shërbimit për kadastër e gjeodezi në Gjakovë, me dt.14.01.2003, me qka vërtetohet nga fletdorëzimi, kopja e të cilit i bashkangjitet kësaj informate, për regjistrim në libra kadastrale. Se në emër të cilit përfitues është regjistruar kjo paluajtshmëri, ose nuk është regjistruar, për përfituesit tjerë, për këtë qështje, Ju lutemi drejtohuni shërbimit për kadastër e gjeodezi, i cili ekziston në kuadër të Drejtorisë për gjeodezi, kadastër e pronë e Komunës së Gjakovës, dhe nga ky shërbim do të merrni informata të sakta dhe precize, se i është regjistruar paluajtshmëria e përfituar me Aktvendimin e theksuar më lartë”.*

Argumentet e parashtruesve

38. Siç u tha më lart, parashtruesit pretendojnë se Gjykata e Qarkut (Aktgjykimi Ac. nr. 324/12) e refuzoi ankesën e parashtruesve si të pabazuar dhe e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komonale në Gjakovë, E. Nr. 1395/11, të 24 prillit 2012.
39. Parashtruesit argumentojnë se [...] “*Komuna e Gjakovës nuk ka parashtruar fare kundërshtim për ndonjërin prej shkaqëve të përmendura në nenin 55 të LPP, kështu që aktvendimi i lejuar është bërë i plotëfuqishëm në përputhje me dispozitat e nenit 13.1 të LPP, me çka vërtetohet se parashtruesit e kësaj kërkesë janë*

diskriminuar dhe se u janë shkelur të drejtat dhe liritë e tyre, dhe këtë:

E drejta për mbrojtje gjyqësore, në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me kushtetutë, ..., "siq është p.sh. e drejta e pronës, e garantuar me dispozitat e nenit 54 të Kushtetutës, si dhe

Të drejtat që rrjedhin nga neni 7.1 i Kushtetutës së Kosovës, Konventat Europiane Nr. 6 dhe 13, Protokollit Nr. 14 i BE (Bashkësisë Europiane) dhe Konventa Europiane Protokollit Nr. 1. i Konventes të datës 20.03.1952, i cili ka hyrë në fuqi me 18.05.1954, me të cilin janë shtuar edhe 6 dispozita të reja për ruajtjen -mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore, në mesin e të cilave edhe e drejta për mbrojtje të pronës".

40. Parashtruesit përfundojnë duke kërkuar nga Gjykata Kushtetuese:

"Që të egzekutohet Aktvendimi i Drejtorisë për punë pasurore - juridike, Kadaster, Gjeodezi, dhe Komacson të Komunës së Gjakovës, 11 nr. 465 -8 /93 të datës 01.08.2002 dhe të DETYROHET Komuna e Gjakovës -Komuna e Gjakovës - Drejtoria për Kadaster, Gjeodezi dhe Pronë në Gjakovë, që brenda afatit prej 8 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, të regjistrojë në emër të parashtruesëve të kësaj kërkesë trojet nr. 80, 81, 82, 84, 86 dhe 88, të cilët shtrihen në pjesën e ngastres kadastrale nr. 5531/1, Komuna Kadastrale Gjakovë -Jasht Qytetit, në sipërfaqe të përgjithëshme prej 0.33.01 ha (ose 3301 m2), si dhe te iu kompenzojë shpenzimet procedurale".

Dispozitat përkatëseligjore lidhur me procedurat për përmbarimin evendimeve administrative dhe të gjykatave

Ligji për Procedurën Përmbarimore (Ligji nr. 03/L-008)

Neni 1 (Përmbajtja e ligjit)

"1.1 Me këtë ligj caktohen rregullat për procedurën e gjykatës sipas të cilës realizohen kërkesat në bazë të titujve ekzekutiv (procedura e përmbarimit), po qe se me ligj të posaçëm nuk është paraparë diçka tjetër.

1.2 Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për përmbarimin e vendimit të dhënë në procedure administrative dhe për kundërvajtje me të cilin është caktuar detyrimi në të holla,

përveçse kur për përmbarimin e tillë është paraparë me ligj kompetenca e organit tjetër”.

Neni 24.1 (Titulli ekzekutiv)

“Tituj ekzekutiv janë:

a) vendimi ekzekutiv i gjykatës dhe ujdia gjyqësore ekzekutive ;

b) vendimi ekzekutiv i dhënë në procedurë administrative dhe ujdia administrative, po qe se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po qe se me ligj nuk është paraparë diçka tjetër ;

c) dokumenti noterial ekzekutiv;

d) dokumenti tjetër që me ligj është quajtur dokument ekzekutiv”.

Neni 26.3 (Përmbarueshmëria e vendimit)

“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimorë, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”.

Ligji për Procedurën Përmbarimore (Ligji nr. 04/L-139)

Neni 22.1 [Dokumenti përmbarues] parasheh:

“1. Dokumente përmbaruese janë:

[...]

1.2. vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (në tekstin e mëtejme: ujdia);

Pranueshmëria e kërkesës

41. Para së gjithash, Gjykata shqyrton nëse parashtruesit i kanë plotësuar kriteret për pranueshmëri të kërkesës.

42. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës, i cili parasheh:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

43. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 dhe 49 të Ligjit, të cilët parashohin:

“48. Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

49. Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.

44. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

- a) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjyqimit të kundërshtuar, ose*
- b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi; ose*
- c) kërkesa është qartazi e bazuar.”*

45. Gjykatavëren separashtruesit mund të pretendojnë në mënyrë legjitime të jenë viktimë të mospërmbarimit të Aktvendimit të Drejtorisë, i cili ishte në favor të tyre dhe gjithashtu pamundësisë për të ndërmarrë veprimetë mëtejshme përmospërmbarimine vendimit të Drejtorisë përdisavite.

46. Gjykata, më tej, vëren që parashtruesit i kishin shterur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tyre në Gjykatën Komunale, Gjykatën e Qarkut dhe te Prokurori i Shtetit.
47. Gjykata gjithashtu vëren se kriteri për dorëzimin e kërkesës brenda afatit katër (4) mujor nuk vlen në rastin e mospërmbarimit të vendimit nga autoriteti publik (shih, *mutatis mutandis*, Iatridiskundër GreqisëNr. 59493/00, GJEDNJ, Aktgjykim i 19 tetorit 2000). GJEDNJ-ja thekson në mënyrë eksplicite, në një situatë të ngjashme që paraqitet në rastin Iatridis kundërGreqisë, se rregulli i afatit kohor nuk vlen në rastin kur ekziston refuzimi i ekzekutivit që të pajtohet me vendim konkret.
48. Gjykata më tejvëren se AktgjykimiAc. nr.324/12i Gjykatës së Qarkut, të 21 dhjetorit2012,i është dorëzuarparashtruesvëmë18 janar 2013dheparashtruesit e kërkesësparaqitënkërkesë përmbrojtjetëligjshmërisëteProkurori i Shtetit. Më 7 mars2013,Prokurori i Shtetit e refuzoikërkesën e tillë.
49. Në këtë drejtim, Gjykata vëren semospërmbarimi i Aktvendimit tëDrejtorisëvazhdonedhe sot. Kështu, kriteri përdorëzimin ekërkesësbrendakatër (4)muajvepasvendimit përfundimtar të gjykatës,nukështë i zbatueshëmnë këtë rast.
50. Në të vërtetë, një situatë e ngjashme e mospërmbarimit të dy vendimeve, të Gjykatës dhe të Komisionit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, ishte paraqitur në një numër të rasteve të tjera në Gjykatën Kushtetuese. Në këto raste, Gjykata konstatoi ekzistencën e situatës së vazhdueshme dhe moszbatimin e afatit të caktuar kohor prej katër (4) muajve, (shih Gjykata Kushtetuese rasti nr. Klo8/09, parashtrueseSindikatae Pavarur e Punonjësve të Fabrikës se Çelikut IMK Ferizaj, Aktgjykim i 17 dhjetorit 2010, dhe rasti K150/12, parashtrues Agush Lolluni, Aktgjykim i 16 korrikut 2012).
51. Prandaj, afati kohor prej katër (4) muajve është i parëndësishëm për shkak të situatës së vazhdueshme.
52. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesit e kërkesës kanë treguar se cilat të drejta kushtetuese pretendojnë t'u jenë shkelur dhe ata e kontestojnë Aktvendimin konkret të Drejtorisë (Nr. 11 465-8/93, të 1 gushtit 2002), Aktvendimin e Gjykatës Komunale (Nr. 1395/11) të 24 prillit 2012 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut (Ac. nr. 324/12) të 21 dhjetorit 2012.

53. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesit janë palë e autorizuar, i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike, e kanë përmbushur kërkesën e afatit si rezultat i situatës së vazhdueshme dhe se ata e kanë sqaruar me saktësi shkeljen e pretenduar të të drejtave dhe lirive, si dhe iu referohen vendimeve që ata i kontestojnë.
54. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa i plotëson të gjitha kriteret e pranueshmërisë.

Aspektet kryesore juridike të kërkesës

55. Parashtruesit kryesisht pretendojnë shkelje të të drejtave të tyre për:
 - a) Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ);
 - b) Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave, siç garantohet me nenin 54 të Kushtetutës, dhe
 - c) Mbrojtja e Pronës, siç garantohet me nenin 46 të Kushtetutës dhe me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së.
56. Gjykata shqyrton meritat e secilit prej pretendimeve të parashtruesve.
57. Siç u tha më lart, parashtruesit pretendojnë se vendimi i kontestuar e ka shkelur të drejtën e tyre për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së.
58. Parashtruesit pretendojnë se [...]“*Komuna e Gjakovës nuk ka parashtruar fare kundërshtim për ndonjërin prej shkaqëve të përmendura në nenin 55 të LPP, kështu që aktvendimi i lejuar është bërë i plotëfuqishëm në përputhje me dispozitat e nenit 13.1 të LPP, me çka vërtetohet se parashtruesit e kësaj kërkesë janë diskriminuar dhe se u janë shkelur të drejtat dhe liritë e tyre [...]*”.
59. Gjykata rikujton se Gjykata Komunale vendosi (E. Nr. 1395/11, të 22 dhjetorit 2011) për përmbarrimin e vendimit të Drejtorisë (në tekstin e mëtejme: Aktvendimi i parë).

60. Aktvendimi i lartcekur i Gjykatës Komunale këshillon: *“Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 7 ditëve pas marrjes së tij nëpërmjet kësaj Gjykate”*.
61. Drejtoria nuk ka ushtruar ankesë kundër atij Aktvendimi të Gjykatës Komunale.
62. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se, në mungesë të çdo ankese të paraqitur nga Drejtoria në cilësinë e debitorit, vendimi u bë i plotfuqishëm dhe i obligueshëm (*res judicata*) dhe si i tillë i përmbarueshëm.
63. Sidoqoftë, më 24 prill 2012, Gjykata Komunale vendosi të [...] *“SHFUQIZOHET Aktvendimi E nr.1395/11 i dt.22.12.2011 (...)dhe anulohen te gjitha veprimet e ndërmarra në këtë lëndë”* (në tekstin e mëtejme: Aktvendimi i dytë).
64. Gjykata vëren se Aktvendimi i 24 prillit 2012 është marrë pothuajse pesë muaj pasi që Gjykata Komunale e mori Aktvendimin E. Nr. 1395/11, të 22 dhjetorit 2011, për përmbarim dhe pa asnjë kërkesë të palëve të interesuara.
65. Në këtë drejtim, neni 31 i Kushtetutës përcakton:

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.
66. Përveç kësaj, neni 6.1 i KEDNJ-së përcakton:

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme”.
67. Gjykata i referohet nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, i cili parasheh:

“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

68. Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) mjaft shpesh e ka theksuar vendin e shquar të së drejtës për gjykim të drejtë në një shoqëri demokratike (shih, Perez kundër Francës, nr. 47281/99, GJEDNJ, Aktgjykimi i 12 shkurtit 2004).
69. Në rastin konkret, parashtruesit i propozuan Gjykatës Komunale përmbarimin e Aktvendimit të Drejtorisë. Gjykata Komunale, në vendimin e saj të parë, e aprovoi propozimin e parashtruesve për përmbarimin e vendimit të Drejtorisë. Ai vendim i Gjykatës Komunale mori formë të prerë dhe detyruese dhe kështu fitoi statusin *res judicata*. Megjithatë, e drejta e parashtruesve në gjykatë u bë iluzore, sepse e njëjta Gjykatë Komunale, me vendimin e saj të dytë, e anuloi këtë vendim të plotfuqishëm dhe detyrues.
70. Në anën tjetër, e drejta për gjykim të drejtë gjithashtu nënkupton se një vendim i formës së prerë dhe detyrues (*res judicata*) bëhet i pakthyesëm. Në të vërtetë, GJEDNJ-ja konstatoi se *“një nga aspektet themelore të shtetit ligjor është parimi i sigurisë juridike, i cili kërkon ndër të tjera se aty ku gjykatat kanë vendosur përfundimisht një çështje, vendimi i tyre nuk duhet të vihet në pikëpyetje”* (shih, *mutatis mutandis*, Brumarescu kundër Rumanisë, Nr. 28342/95, GJEDNJ, Aktgjykimi i 28 tetorit 1999, par. 61).
71. Rrjedhimisht, parimi i sigurisë juridike presupozon respektimin e *res judicata*, e cila është përfundimtarja e aktgjykimeve (Brumarescu kundër Rumanisë, Nr. 28342/95, GJEDNJ, Aktgjykimi i 28 tetorit 1999, paragrafi 62). *“Ky parim thekson se asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një vendimi të plotfuqishëm dhe detyrues gjyqësor thjesht për qëllimin e fitimit të rishqyrtimit dhe zgjidhjes të re të rastit. Rishikimi nuk duhet të trajtohet si një ankesë e fshehur dhe thjesht mundësia e ekzistimit të dy pikëpamjeve mbi këtë temë nuk është një bazë për rishqyrtim. Largimi nga ky parim justifikohet vetëm kur bëhet e nevojshme nga rrethanat me natyrë të rëndësishme dhe bindëse”* (shih, Ryabykh kundër Rusisë, nr. 52854/99, GJEDNJ, Aktgjykimi i 24 korrikut 2003, par. 52.; shih gjithashtu KI55 /11, parashtrues Fatmir Pirreci, Gjykata Kushtetuese, Aktgjykimi i 16 korrikut 2012, par. 42).

72. Gjykata vëren se Aktvendimi i dytë i Gjykatës Komunale, që shfuqizon Aktvendimin e parë ishte nxjerrë pa asnjë iniciativë ose ankesë, të dorëzuar nga palët.
73. Lidhur me këtë, neni 13.1 i Ligjit për Procedurën Përmbartimore parasheh se *"Aktvendimi kundër të cilit nuk është paraqitur brenda afatit ligjor prapësimi, bëhet i formës së prerë dhe i përmbartueshëm"*.
74. Gjykata, më tej, konsideron se, vendimi i dytë i Gjykatës Komunale rihapi një proces gjyqësor, i cili tashmë ishte përmblytur me një vendim gjyqësor të plotfuqishëm dhe të detyrueshëm dhe në këtë mënyrë ishte *res judicata* (shih, Rosca kundër Moldavisë, nr 6267/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 22 marsit 2005, par. 28).
75. Si rezultat, Gjykata e Qarkut, me rastin e vërtetimit të aktvendimit të dytë të Gjykatës Komunale, shkeli parimin e sigurisë juridike dhe, rrjedhimisht, shkeli të drejtën e parashtruesit për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së.
76. Përveç kësaj Gjykata vëren se Gjykata Komunale në Aktvendimin e saj të dytë, arsyetoi se [...] *"nga sa u tha në vështrim të nenit 24 pika b) dokumenti-Aktvendimi i cituar nuk paraqet Titull ekzekutiv pasi që në dispozitivin e Aktvendimit nuk parashihet kurrfarë detyrimi në të holla i debitorit ndaj kreditorëve, ndërsa zbatimi i këtij Aktvendimi në procedurën përmbartimore me ligje tjera nuk është i paraparë"*.
77. Më 21 dhjetor 2012, Gjykata e Qarkut (Aktgjykimi Ac. nr. 324/12) e refuzoi ankesën e parashtruesve si të pabazuar dhe e vërtetoi Aktvendimin e dytë të Gjykatës Komunale.
78. Gjykata e Qarkut konstatoi se [...] *"gjykata e shkallës së parë në bazë të nenit 24. pika b) 4 lidhur me nenin 44 të Ligjit mbi procedurën e përmbartimit me aktvendimin e atakuar e ka shfuqizuar se aktvendimi i marr në procedurën administrative që nuk ka të bëjë me kërkesën në të holla nuk përfaqëson dokument të përshtatshëm përmbartimor"* dhe konstatoi se [...] *"Aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182. 2 të LPK-se dhe se drejtë është aplikuar edhe e drejta materiale, të cilat i vëren gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së , pa marrur parasysh se a janë potencuar nga parashtruesi i ankesës apo JO"*.

79. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore (shih, ndër të tjera Gjykata Kushtetuese Rasti KIo4/12 parashtues Esat Kelmendi, Aktgjykim i 20 korrikut 2012, dhe Rasti KI112/12, parashtues Adem Meta, Aktgjykim i 5 korrikut 2013), ku është paraqitur një situatë e ngjashme me përmbarimin të vendimeve administrativë nga gjykatat, të cilat gjithashtu nuk kanë parashikuar në mënyrë ekskluzive një detyrim monetar. Në këto raste, Gjykata arriti në përfundim se një vendim nxjerrë nga një organ administrativ, i themeluar me ligj, prodhonte efekte juridike për palët dhe, për këtë arsye, një vendim i tillë është një vendim administrativ i formës së prerë dhe i përmbarueshëm.

80. Praktika gjyqësore e lartcekur e Gjykatës reflektohet në Ligjin e miratuar rishtazi Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, të 20 dhjetorit 2012. Në të vërtetë, nën 22 par. 1. 2 parasheh:

“1. Dokumente përmbaruese janë:

[...]

1.2. vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe akt pajtimi (më tej: ujdia)”.

81. Prandaj, Gjykata konkludon se vendimi i Drejtorisë ishte i formës së prerë dhe i përmbarueshëm.

82. Gjykata konsideron që përmbarimi i vendimit të prerë dhe të përmbarueshëm duhet të konsiderohet pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë, e drejtë kjo e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-se. Parimi i lartcekur është i një rëndësie edhe më të madhe në kuadër të procedurës administrative në lidhje me një kontest, rezultati i të cilit është i një rëndësie të posaçme për të drejtat civile të palës në kontest (shih, *mutatis mutandis*, Hornsby kundër Greqisë, nr. 18357/91, Aktgjykim i 19 marsit 1997, paragrafët 40-41).

83. Nga sa u tha më lart, rrjedh se Gjykata e Qarkut në Pejë, me rastin e vërtetimit të Aktvendimit të Gjykatës Komonale për mospërmbarimin e vendimit administrativ të formës së prerë dhe të përmbarueshëm, e kishte shkelur të drejtën e parashtuesve për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

84. Për më tepër, parashtruesit pretendojnë që [...] *“E drejta për mbrojtje gjyqësore, në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me kushtetutë,..., ”,siq është p.sh. e drejta e pronës, e garantuar me dispozitat e nenit 54 të Kushtetutës [...]”*.
85. Në këtë drejtim, Gjykata gjithashtu i referohet nenit 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ-së.
86. Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike] parasheh që:
“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”.
87. Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] përcakton se:
“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”.
88. Përveç kësaj, neni 13 i KEDNJ-së thekson:
“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”.
89. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesit kanë shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion, lidhur me përmbarimin e Aktvendimit të Drejtorisë. Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve të tyre, ai Aktvendim i Drejtorisë nuk është përmbaruar, as organet kompetente të Komunës së Gjakovës, dhe as nga gjykatat kompetente.
90. Gjykata rithekson se mosekzistimi i mjeteve juridike apo mekanizmave të tjerë efektivë, për përmbarimin e Aktvendimit të Drejtorisë, ndikon në të drejtën për mjete juridike efektive, të garantuara me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së. Në bazë të këtyre dispozitave, secili person ka të drejtë të shterojë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative, të cilat i cenojnë të drejtat ose interesat e tij në mënyrën e përcaktuar me ligj (shih, *mutatis mutandis*, Voytenko kundër Ukrainës, Nr. 18966/02, Aktgjykimi i 29 qershorit 2004, paragrafët 46-48).
91. Për më tepër, *“organet kompetente kanë për obligim që ta themelojnë një sistem për zbatimin e vendimeve, i cili është efektiv*

edhe në kuptimin ligjor edhe në atë praktik, dhe i cili siguron zbatimin e tyre pa vonesa të panevojshme (shih, Gjykata Kushtetuese, Rasti KI50/12, parashtres Agush Lolluni, Aktgjykim i 16 korrikut 2012, para. 41.; shih, gjithashtu, Pecevi kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 21839/03, 6 nëntor 2008)”.

92. Prandaj, Gjykata konkludon se pamundësia për të ndërmarrë veprime të mëtejshme ligjore për përmbarimin e Vendimit të Drejtorisë gjithashtu paraqet shkelje të neneve 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe të nenit 13 të KEDNJ-së.
93. Parashtresit gjithashtu pretendojnë shkeljen e nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
94. Neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës parasheh:

“1. E drejta e pronës është e garantuar.

2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.

3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.

4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.”

95. Neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së parasheh:

“Çdo person fizik apo juridik ka të drejtën të gëzojë në mënyrë paqësore zotërimet e tij. Askush nuk do të privohet nga zotërimet e veta përveçse në interes të publikut dhe kur është subjekt i kushteve të përcaktuara me ligj e sipas parimeve të përgjithshme të të drejtës ndërkombëtare. Dispozitat e mësipërme, sidoqoftë, nuk do të cënojnë në asnjë mënyrë të drejtën e një Shteti për të zbatuar ligjet, të cilat i vlerëson si të

nevojshme për kontrollin e përdorimit të pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm apo për të siguruar pagesën e taksave e kontributeve apo gjobave të tjera”.

96. Në këtë drejtim, Gjykata përkujton se Aktvendimi i Drejtorisë u bë i formës së prerë dhe detyrues më 9 janar 2003.
97. Prandaj, Gjykata konsideron se Aktvendimi i Drejtorisë përbën pritje legjitime për parashtruesit, se ata do të gëzonin të drejtën e tyre pronësore (shih, Gjykata Kushtetuese, Rasti KI40/09, Imer Ibrahimimi dhe 48 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës, Aktgjykimi i 23 qershorit 2010).
98. Pritja e tillë legjitime gjithashtu garantohet me nenin 1 të Protokollit nr. 1 Konventës (shih, *mutatis mutandis*, Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke, nr. 39794/98, GJEDNJ, Vendim i 10 korrikut 2002, para. 73).
99. Prandaj, Gjykata Kushtetuesekonsideron separashtruesitkanë një"pritje legjitime"të regjistrojnë pronënnë emrat e tyre, siçparashikohetmeAktvendimin eDrejtorisë, i cilimori formën e prerëme 9janar 2003(shih, *mutatismutandis*,PressosCompaniaNavieraSA e tjerëtkundër Belgjikës, GJEDNJ, Aktgjykimi i 20nëntorit 1995,SeriaA nr. 332, paragrafi 31).
100. Për arsyet e mësipërme, Gjykata arrin në përfundim semospërmbarimi iAktvendimit tëDrejtorisëpërbënshtet të nenit46 të Kushtetutësnelidhje me nenin1 tëProtokollit 1tëKEDNJ-së.

Përfundim

101. Si përfundim, Gjykata gjen se mospërmbarimi i Aktvendimit të Drejtorisë nga organet kompetente administrative dhe gjykatat e rregullta dhedështimiqë pasoi për të siguruarmekanizma efikas për përmbarimin e vendimeve përkatëse të autoriteteve përkatëse dhe vendimeve gjyqësore, përbën shkelje tëneneve 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe të neneve 6 dhe 13 të KEDNJ-së. Si rezultat i kësaj shkeljeje, parashtruesit janë privuar nga regjistrimi i pronës në emër të tyre. Kështu, është shkelur e drejta për mbrojtjen e pronës,e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së. Prandaj, Aktvendimi i Drejtorisë duhet të përmbarohet.

102. Në fillim, Gjykata sqaron se ky përfundim ka të bëjë vetëm me shkeljet e pretenduara kushtetuese. Në të vërtetë, përfundimi nuk ka të bëjë me atë nëse aktgjykimi i gjykatave të rregullta ose vendimi i mëhershëm administrative i Drejtorisë e interpreton drejt ligjin e aplikueshëm, për shkak se Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërtë lidhje me atë çka është interpretim i duhur të ligjit.
103. Si përmbledhje, në pajtim me rregullin 74 të Rregullores, Aktgjykimi Ac. nr. 324/12, i Gjykatës së Qarkut në Pejë, i 21 dhjetorit 2012, është i pavlefshëm, dhe në pajtim me nenin 39.2 të Ligjit për Gjykatat, lënda i kthehet Gjykatës së Apelit për rishqyrtim.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 20 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 56 (1) e me rregullin 74 (1) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 24 mars 2014, njëzëri:

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31, 32, 46 dhe 54 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 dhe 13 të KEDNJ-së dhe nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së;
- III. TA DEKLAROJË të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac. nr. 324/12 të 21 dhjetorit 2012, DHE T'IA KTHEJË rastin Gjykatës së Apelit për rishqyrtim në përputhje me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, gjegjësisht të merr parasysh se Aktvendimi i Drejtorisë duhet të përmbahet;
- IV. T'UA PËRKUJTOJË organeve kompetente obligimet e tyre, në pajtim me nenin 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës dhe rregullit 63 [Zbatimi i vendimeve] të Rregullores së punës së Gjykatës.
- V. TË URDHËROJË Gjykatën e Apelit që në pajtim me rregullin 63 (5) të Rregullores së punës të dorëzojë informacione në Gjykatën

Kushtetuese në lidhje me masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese;

VI. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

VII. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;

VIII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI187/13, N. Jovanović, Aktgjykim i datës 1 prill 2014 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë për mospërmbarimin e Vendimit të Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme GSK-KPA-A-001/12, të 8 majit 2012 dhe të Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/114/2011, të 22 qershorit 2011

Rasti KI187/13, vendimi i 1 prillit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, procedure përmbarimore, e drejta për gjykim të drejte, e drejta në pronë, kërkesë qartazi e bazuar, kërkesë e pranueshme.

Në këtë rast, parashtruesja pretendonte se me mospërmbarimin e vendimit të Kolegjit të Apelit dhe të vendimit të KKOK –asaj i janë shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara me nenet: 24, 31, 32, 46, 54; të neneve 6, 13, 14 të KEDNJ-së si dhe neni 1 i Protokolli 1 të KEDNJ-së. Më tutje, parashtruesja kërkon nga Gjykata që: 1) Të vendoset e drejta e kthimit të pronës, 2) të vendoset kompensimi për dëmin e shkaktuar për shkak të shkeljes së të drejtave njerëzore të apelueses, të garantuara me Kushtetutën e Kosovës, 3) të caktohet shuma prej 300.000,00 euro për dëmin material që i është bërë apelueses, përkatësisht 30.000,00 euro për dëmin jomaterial, i cili për nga natyra e vet është i pamatshëm, në bazë të shkeljes së të drejtave të njeriut, dhe 4) që shumat e përcaktuara të paguhen menjëherë pas shpalljes së vendimit, aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Përkritazi me këtë rast, Gjykata thirri një seance për dëgjim publike, për t'i dëgjuar argumentet e Agjencisë Kosovare të Pronës, lidhur me pretendimet e parashtrueses se kërkesës. Pas dëgjimit të argumenteve të palëve në procedure, me 1 prill 2014, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetute dhe me Konventën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Si përfundim, Gjykata konstatoi se mospërmbarimi i vendimit të KKPK-së nga AKP-ja dhe dështimi i autoriteteve kompetente të Republikës së Kosovës për të siguruar mekanizma efikas në kuptim të përmbarimit të vendimeve të formës së prerë është në kundërshtim me parimin e sundimit të ligjit dhe përbënte shkelje të të drejtave themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë. Në këto rrethana, Gjykata konkludoi se mospërmbarimi i Vendimit të formës së prerë, KPCC/D/A/114/2011, përbënte shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së dhe të nenit 54 të Kushtetutës.

Për më tepër, Gjykata konstatoi se parashtruesja e kërkesës, nga zvarritja dhe mospërmbarimi i Vendimit KPCC/D/A/114/2011 ishte privuar pa të drejtë nga prona e saj. Në këtë mënyrë, e drejta e parashtrueses për të gëzuar në mënyrë paqësore pronën e saj, e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës dhe me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së gjithashtu ishte shkelur.

**AKTGJYKIM
në
Rasti Nr. KI187/13
Parashtrues
N. Jovanović**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë për mospërmbarimin e
Vendimit të Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme GSK-KPA-
A-001/12, të 8 majit 2012 dhe të Vendimit të Komisionit për
Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/114/2011, të 22
qershorit 2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga znj. Jovanović (në tekstin e mëtejme: parashtruesja) me vendbanim në Beograd, Republika e Serbisë.
2. Parashtruesja kërkon që identiteti i saj të mos zbulohet.

Vendimi i kontestuar

3. Parashtruesja e konteston mospërmbarimin e Vendimit të Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme GSK-AKP-001/12, të 8 majit 2012 (më tutje: Kolegji i Apelit) dhe të Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/114/2011, të 22 qershorit 2011 (më tutje: Vendimi i KKPK-së).

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë, përkitazi me mospërmbarimin e Vendimit të Kolegjit të Apelit GSK-KPA-A-001/12, të 8 majit 2012 dhe të

Vendimit të KKPK-së nr. KPCC/D/A/114/2011 të 22 qershorit 2011, lidhur me kërkesën e parashtrueses nr. 16008, parashtruar në Agjencinë Kosovare të Pronës, më 23 gusht 2005.

5. Parashtruesja e kërkesës pretendon se, si pasojë e mospërmbarimit të vendimeve të lartcekura asaj i janë shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit]; nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike]; nenin 46 [Mbrojtja e Pronës]; nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]; nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]; si dhe me nenet përkatëse të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ) neni 6 paragrafi 1 [E Drejta për një Proces të Rregullt]; neni 13 [E Drejta për Mjete Efektive Juridike]; neni 14 [Ndalimi i Diskriminimit]; neni 1 i Protokollit 1 të KEDNJ [Mbrojtja e Pronës].
6. Ndër të tjera, parashtruesja kërkon nga Gjykata vënien e masës së përkohshme.

Baza juridike

7. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), neni 27 dhe 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji); rregulli 55, dhe 56 (1) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

8. Më 29 tetor 2013, parashtruesja parashtroi kërkesën në Gjykatë.
9. Më 4 nëntor 2013, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI187/13, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI187/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova (anëtare) dhe Arta Rama-Hajrizi (anëtare).
10. Më 20 nëntor 2013, për regjistrimin e kërkesës Gjykata njoftoi: parashtruesen e kërkesës; Zyrën për ndihmë juridike në Graqanicë, sipas rekomandimeve të parashtrueses; Agjencinë Kosovare të Pronës (me tutje: AKP); Kolegjin e Apelit dhe z. L. F. si palë e interesuar.

11. Më 22 nëntor 2013, Gjykata kërkoi nga AKP-ja sqarime shitesë në lidhje me rastin.
12. Më 20 janar 2014, Kolegji shqyrtues, pas raportimit të rastit nga gjyqtari raportues, erdhi në përfundim se nga AKP-ja duhet kërkuar sqarime shitesë.
13. Më 23 janar 2014, Kryetari i Gjykatës, i propozoi Gjykatës së plotë, mbajtjen e një seance publike dëgjimore, përkitazi me qartësimin e mëtutjeshëm të rastit. Propozimi i Kryetarit, njëzëri u mbështet nga të gjithë gjyqtarët prezentë në këtë seancë, dhe u vendos që seanca e dëgjimit publik të mbahet ditën e hënë, më 10 mars 2014.
14. Më 30 janar 2014, bazuar në kërkesën e Kolegjit shqyrtues, të 20 janarit 2014, Gjykata kërkoi nga AKP-ja që të deponojë përgjigjen e saj përkitazi me sqarimet shitesë.
15. Më 10 shkurt 2014, AKP-ja deponoi përgjigjen e saj në kërkesë.
16. Më 11 shkurt 2014, Gjykata ftoi Agjencinë Kosovare të Pronës, në cilësinë e palës kundërshtare, që të marrë pjesë në seancën e dëgjimit publik, më 10 mars 2014, duke filluar nga ora 10:00. Të njëjtën ditë, ftesa për të marrë pjesë në seancën e 10 marsit 2014, i është komunikuar parashtrueses së kërkesës të znj. Jovanović dhe Zyrës për ndihmë juridike në Graçanicë, sipas rekomandimit të saj.
17. Më 19 shkurt 2014, Gjykata ka pranuar një telefonatë nga AKP-ja, përkitazi me konfirmimin e pjesëmarrjes në seancën publike dëgjimore të 10 marsit 2014. AKP-në në këtë seancë e përfaqësojnë: znj. Mirvete Sopjani dhe znj. Florie Kika.
18. Më 10 mars 2014, Kryetari i Gjykatës konfirmoi pjesëmarrjen e përfaqësuesve të parashtrueses dhe të përfaqësuesve të AKP-së në këtë dëgjim publik. Parashtruesja u përfaqësua nga vajza e saj, Dragana Jovanović dhe nga Rastko Brajković, përfaqësues i saj. Ndërsa, AKP-ja u përfaqësua nga znj. Mirvete Sopjani dhe znj. Florie Kika. Seanca filloi në orën 10:00 dhe përfundoi në orën 12:35.
19. Më 1 prill 2013, Gjykata, votoi për pranueshmërinë dhe meritat e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

20. Më 23 gusht 2005, parashtruesja paraqet kërkesë në AKP kundër L. F. për vërtetimin e së drejtës së posedimit të pronës së paluajtshme në lagjen Sofali të Prishtinës, e regjistruar në fletën poseduese nr. 361 në Prishtinë.
21. Më 22 qershor 2011, KKPK me Vendimin nr. KPCC/D/A/114/2011, kërkesa nr. 16008, konstaton se parashtruesja është bartëse e së drejtës pronësore dhe urdhëron që cilido person që e shfrytëzon pronën ta lëshojë atë në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në të kundërtën do të shpërngulet me dhunë nga prona.
22. Për më tepër, vendimi i KKPK, respektivisht kërkesa nr. 16008, që i dedikohet parashtruesesciton:

“Kërkesa numër 16008,

Paraqitësja e kërkesës znj. N. Jovanović ka paraqitur kërkesë në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Paraqitësja e kërkesës deklaron se ajo është pronare e pronës në fjalë në bazë të fletës poseduese numër 361 dhe të kontratës për dhurim nga viti 1980, e cila është nga nëna e saj e ndjerë Leposava-Savka. Të dy dokumentet janë verifikuar pozitivisht nga ana e Sekretariatit Ekzekutiv. Paraqitësja e kërkesës thekson se prona i është uzurpuar pa pëlqimin e saj dhe se ndërtesa banesore është ndërtuar në pronë pa pëlqimin e saj. Në bazë të notifikimit të kësaj prone nga ana e Sekretariatit Ekzekutiv, ndërtesa e tillë ekziston. Banuesi momental i pronës, L. F (i padituri), thekson se diku në vitin 2000, është kontaktuar nga ana e personit të panjohur i cili është paraqitur si pronar i kësaj prone. Ai ka lidhur kontratë të shitblerjes me këtë person dhe thekson se ia ka paguar 2000 DM, si depozitë. Nuk ka pasur pagesa të tjera. I padituri thekson se më vonë ka marrë informata që personi nga i cili e ka blerë pronën në fjalë nuk është pronari i pronës dhe thekson se është në kontakt me paraqitësit e kërkesës nëpërmjet avokatit në mënyrë që të arrijë marrëveshje për blerje të pronës.

[...]

Komisioni konsideron se i padituri ka qenë i vetëdijshëm për faktin se e ka uzurpuar pronën në fjalë, se ajo pronë nuk i takon dhe se nuk ka leje për shfrytëzimin e saj. I padituri duhet ta kuptojë po ashtu se ndërtimi i objektit banesor në pronë është i paligjshëm dhe për këtë arsye ai nuk ka të drejtë mbi pronën e përmendur. Prandaj, kërkesa e paraqitëses së

kërkesës miratohet dhe jepet urdhëresa për shpërnguljen e të lartpërmendurit”.

23. Më 14 dhjetor 2011, z. L. F., kundër vendimit të KKPK-së, paraqet ankesë në Kolegjin e Apelit, duke theksuar se vendimi KKPK-së është i pavërtetë dhe jo i plotë.
24. Më 8 maj 2012, Kolegji i Apelit, me Aktgjykimin GSK-KPA-A-001/12, e refuzon ankesën e z. L. F. për shkak se ankesa ishte e paafatshme dhe se për vonesën e tij z. L. F. nuk ka dhënë ndonjë arsytim të pranueshëm. Në vijim, arsyetimi i aktgjykimit:

“Më 22 qershor 2011, me vendim të KPCC/D/A/114/2011 (lidhur me lëndën e regjistruar në AKP me numër AKP 16008). Komisioni ka vendosur se kërkesa e znj. N. S. Jovanović është e bazuar dhe se ajo është pronare e pronës së përmendur, prandaj e ka urdhëruar palën e paditur që ta lëshojë pronën”.

AKP-ja ka arsyetuar se paraqitësja e kërkesës me sukses ka vërtetuar të drejtën e pronës. AKP-ja konsideron “se pala e paditur ka qenë e vetëdijshme për faktin se e ka uzurpuar pronën e përmendur se ajo pronë nuk i takon dhe se nuk ka leje për shfrytëzimin e saj. I padituri duhet ta kuptojë po ashtu se ndërtimi i objektit banesor në pronë është i paligjshëm dhe për këtë arsye ai nuk ka të drejtë mbi pronën e përmendur”.

Pala e paditur (në tekstin vijues, ankuesi) e ka marrë vendimin e KPCC/D/A/114/2011 (lidhur me lëndën e regjistruar në AKP me numër AKP 16008), më 08 nëntor 2011. Më 14 dhjetor 2011, ai ka ushtruar ankesë, duke theksuar se vendimi është i pavërtetë dhe jo i plotë.

Ai nuk e konteston se paraqitësja e kërkesës është pronare e ngastrës kadastrale nr. 748/1, në sipërfaqe prej 18 ari e 41 metra katrorë, por ai thekson se ai e posedon këtë tokë nga viti 2000 dhe se i ka ndërtuar tri shtëpi dykatëshe familjare. Ai ka të bëjë me shkelje të ligjit për të drejtat themelore pronësore-juridike (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr. 6/80). Ankuesi pohon se “pasi që kanë kaluar 3 vjet nga ndërtimi i ndërtesave/shtëpive... ato (pronari i tokës) vetëm mund të pyesin për çmimin e tregut të tokës, të ngastrës së tyre por jo kthim të tokës”. Ai po ashtu thekson se rrënimi i ndërtesave nuk mund të arsyetohet me pikëpamje shoqërore prandaj pronari vetëm mund ta kërkojë pagesën. Ankuesi ka të bëjë me nenet 2 dhe 3 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Pronësore-

Juridike, por është e qartë se propozimet e tij janë të gabueshme, sepse dispozitat në të cilat ai thirret janë në nenin 25, paragrafi 2 dhe 5 të ligjit të përmendur.

[...]

Arsyetimi juridik:

Ankesa nuk është bërë me kohë (neni 186.2 i Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore). Neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i zëvendësuar me Ligjin 03/L-079 parasheh këtë: “Në afat prej tridhjetë (30) ditësh kur Agjencia Kosovare e Pronës e njofton palën për vendimin e Komisionit lidhur me kërkesën, pala nëpërmjet Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare të Pronës mund ti paraqes ankesë Gjykatës Supreme të Kosovës kundër atij vendimi.

Ankuesi e ka marrë vendimin, më 8 nëntor 2011. Prandaj, afati përfundimtarka qenë më 8 dhjetor 2011. Ndërkaq, ankuesi kaparashtruar ankesë, më 14 dhjetor 2011, që do të thotë pas kalimit të afatit. I njëjti nuk ka dhënë asnjëarsyetim, prandaj gjykata nuk sheh asnjë arsye të vonesës.

Prandaj, ankesa duhet të refuzohet pasi që e njëjta është e papranueshme në baza procedurale (neni 13.3 nënparagrafi (b) i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të zëvendësuar me ligjin nr. 03/L-079).

Në pajtim me këtë, nuk duhet të vendos se a janë dhe si janë të zbatueshme në këtë lëndë dispozitat e nenit 25, paragrafi 2 dhe 5 i Ligjit për Çështjet Themelore Pronësore Juridike (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr. 6/80)”.

25. Më 14 nëntor 2012, parashtruesja paraqet kërkesë në AKP për kthimin e pronës në posedim. Parashtruesja në kërkesën e saj thekson se e drejta e saj përkitazi me pronën është vërtetuar me Vendim të KKPK-së nr. KPCC/D/A/114/2011, kërkesa nr. 16008) dhe me Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit GSK-AKP-A-001/12.
26. Më 5 qershor 2013, AKP-ja, me shkresën Ref. nr. 00906/13/fk, i kthen përgjigje parashtrueses, në të cilën thekson situatën komplekse rreth pronës në fjalë për shkak të ndërtimit të objekteve duke pamundësuar momentalisht rrënimin e atyre objekteve. Ndër të tjera, AKP-ja i ofron parashtrueses mundësinë e ndërmjetësimit nga përfaqësuesit e saj të trajnuar: “agjencia mund të ndërmjetësojë në mes jush dhe shfrytëzuesit të pronës për ta gjetur

një zgjidhje paqësore lidhur me shfrytëzimin e pronës suaj. Agjencia ka ndërmjetësues të trajnuar”.

27. Më 11 korrik 2013, parashtruesja ia dorëzon një shkresë Këshillit Mbikëqyrës në AKP, me të cilën ajo ankohet për punën e Sekretariatit Ekzekutiv të AKP-së për mospërmbarimin e Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit, GSK-AKP-A-001/12, dhe Vendimit të KKKP-së nr. KPCC/D/A/114/2011, kërkesa nr. 16008, por nga shkresat e lëndës nuk shihet se ka marrë ndonjë përgjigje.
28. Më 19 gusht 2013, parashtruesja i ka dërguar një letër Zyrës së prokurorit disiplinor, ku ka paraqitur pakënaqësitë në lidhje me vonesën e përmbarimit të lëndës nga ana e Sekretariatit të AKP-së.
29. Më 3 tetor 2013, parashtruesja nga Zyra e prokurorit disiplinor ka pranuar një letër, nr. KDT/13/zp/892, me të cilën ajo njoftohet se Zyra e prokurorit disiplinor “nuk ka mandat ligjor (kompetencë) që të hetojë veprimin e mundshëm joprofesional (pakujdesinë) e të punësuarve në AKP”.

Përgjigjet e AKP-së

30. Më 22 nëntor 2013, Gjykata kërkoi nga AKP-ja sqarime shtesë në lidhje me rastin dhe përkitazi me këtë, më 26 nëntor 2013, mori këtë përgjigje:

“Bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079, gjegjësisht Kapitullin 5, nenit 15: “Mjetet juridike për ekzekutimin e vendimit mund të përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në dëbimin, vendosjen e pasurisë nën administrim, marrëveshjen për qiradhënie, konfiskim dhe shkatërrimin e strukturave të paligjshme dhe ankandin” Agjencia përveç dëbimit aplikon edhe mjetet tjera juridike për ekzekutimin e vendimeve të parapara në Procedurën Operative Standarde, siç janë: Dëbimi, vendosja e pronës nën administrim, marrëveshja për qiradhënie, konfiskimi dhe shkatërrimi i objekteve të paligjshme, konfiskimi dhe kompensimi, shpronësimi, vendosja e servitutit, ndërmjetësimi dhe ankandi.

Agjencia bazuar në legjislacionin në fuqi të cekur më lartë dhe po ashtu duke pasur parasysh natyrën komplekse të rasteve kur në pronën objekt i kërkesës janë ndërtuar struktura të reja/objekte dhe në mënyrë që të mënjanohej pasojat e dëmshme për palët ka filluar që për rastet e njëjta sikurse në

rastin e znj. N. Jovanović të aplikojë mjetin juridik të Ndërmjetësimit pa paragjykime.

Lidhur me kërkesën KPA 16008, znj. N. Jovanović është njoftuar sërish nga zyrtarët e Agjencisë më datën 3 shtator 2013 dhe asaj i është ofruar ndërmjetësimi si mjet për zgjidhjen e çështjes por ajo përsëri ka refuzuar.

Ju njoftojmë se ekzekutimi i vendimit përmes mjetit ligjor “shkatërrimit të strukturave të paligjshme” në këtë fazë është i pamundur nga Agjencia për shkak të mungesës së mjeteve financiare për angazhimin e ndonjë kompanie për rrënimin e objekteve. Agjencia në propozimin e buxhetit për vitin 2014 ka kërkuar fonde për këtë qëllim dhe nëse ato lejohen do të fillon me zbatimin e këtij mjeti juridik për zbatimin e vendimeve”.

31. Më 30 janar 2014, Gjykata kërkoi nga AKP-ja që të deponojë përgjigjen e saj, përkritazi me pyetjen e propozuar nga anëtarët e Kolegjit shqyrtues dhe nga Gjykata e plotë, në seancën shqyrtuese të 20 janarit 2014.

32. Më 10 shkurt 2014, AKP-ja dorëzoi në Gjykatë këtë përgjigje:

“Agjencia Kosovare e Pronës (Agjencia), dëshiron t’ju njoftoj se, kemi pranuar letrën tuaj, të datës 30 janar 2014, Nr. 160114/ZL, në të cilën kërkon informacione rreth zbatimit të kërkesës KPA 16008, të parashtruar pranë Agjencisë nga znj. N. Jovanović.

Bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 për themelimin e Agjencisë Kosovare të Pronës (Agjencia), e ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079 të aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Agjencia ka kompetenca që të pranojë dhe përmes Komisionit për Kërkesa Pronësore të zgjidhë kërkesat që janë të lidhura me konfliktin mbi pronësinë dhe kërkesat që përfshijnë të drejtat e shfrytëzimit të pronës, që përfshijnë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

Siç ju kemi njoftuar edhe me herët, Agjencia nuk ka kapacitete t’i shkatërrojnë objektet e ndërtuara në pronat e uzurpuara. Për këtë arsye janë kërkuar mjete financiare nga Buxheti i Kosovës për angazhimin kompanive për kryerjen e kësaj pune gjegjësisht për zbatimin e këtij mjeti juridik të zbatimit të

vendimeve por për fat të keq kërkesa e Agjencisë nuk është miratuar. Posa të sigurohen mjetet e nevojshme financiare Agjencia do të filloj me zbatimin e vendimit të Komisionit me prioritet, megjithatë nuk mund të ofrojmë ndonjë datë specifike në të cilën këto kërkesa do të zgjidhen përfundimisht. Agjencia është duke bërë përpjekje maksimale dhe do të vazhdojë edhe më tej që të gjej një mundësi të zbatimit të këtyre rasteve.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj dhe nëse keni nevojë për ndonjë informatë apo sqarim shtesë, ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

33. Parashtruesja pretendon se me mospërmbarimin e vendimit të Kolegjit të Apelit dhe të vendimit të KKOK –asaj i janë shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara me nenet: 24, 31, 32, 46, 54; të neneve 6, 13, 14 të KEDNJ-së si dhe neni 1 i Protokollit 1 të KEDNJ-së.
34. Më tutje, parashtruesja kërkon nga Gjykata që: 1) *Të vendoset e drejta e kthimit të pronës, 2) të vendoset kompensimi për dëmin e shkaktuar për shkak të shkeljes së të drejtave njerëzore të apelueses, të garantuara me Kushtetutën e Kosovës, 3) të caktohet shuma prej 300.000,00 euro për dëmin material që i është bërë apelueses, përkatësisht 30.000,00 euro për dëmin jomaterial, i cili për nga natyra e vet është i pamatshëm, në bazë të shkeljes së të drejtave të njeriut, dhe 4) që shumat e përcaktuara të paguhen menjëherë pas shpalljes së vendimit, aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.*

Pohimet e përfaqësuesve të parashtrueses në seancën e dëgjimit publik të mbajtur, më 10 mars 2014

35. Në këtë seancë të dëgjimit publik, parashtruesja u përfaqësua nga znj. Dragana Jovanović (vajza e parashtrueses) dhe z. Rastko Brajković (përfaqësuesi i autorizuar, zyra për ndihmë juridike në Graçanicë). Znj. D. Jovanović, në këtë seancë të dëgjimit publik, mes tjerash deklaroi: *në vitin 1999, ajo së bashku me të birin e saj dhe me nënën e saj (parashtruesen), ishin larguar nga Kosova, duke e lënë pronën e tyre. Më vonë kanë kuptuar se në pronën e tyre janë ndërtuar shtëpi. Pas katër (4) muajve kuptuam për emrin e personit i cili kishte ndërtuar shtëpitë në pronën tonë. Pas kësaj ngjarjeje, iu drejtuam AKP-së dhe kemi dorëzuar provat tona përkritazi me pronën (patundshmërinë) në sipërfaqe prej 0.18*

ha. AKP-ja, në bazë të dokumenteve të dorëzuara nga nëna ime (parashtruesja), vërtetoi se ajo është pronare legjitime e pronës në fjalë. Më pas, jemi njoftuar nga AKP-ja se pronësia mbi patundshmërinë është kontestuar nga personi që kishte ndërtuar shtëpitë në këtë patundshmëri. Me këtë rast, znj. D. Jovanović kërkon që çështja e patundshmërisë së saj të zgjidhet drejtësisht nga institucionet e Kosovës.

36. *Përfaqësuesi i parashtrueses, mes tjerash pohoi: parashtruesja e kërkesës, me gjithë provat e dorëzuara, për një periudhë të gjatë nuk ka mundur ta realizojë të drejtën e saj mbi pronën, që nga viti 1999, përkatësisht që nga viti 2007 kur i është drejtuar AKP-së për vërtetimin e pronësisë. Nëse shikohet dokumentacioni që i është paraqitur nga pikëpamja juridike, vërehet që rreth kësaj pronësie nuk ka elemente kontestuese. E tërë procedura ka zgjatur në mënyrë të paarsyeshme. Duke marrë parasysh që ekzekutimi i një vendimi gjyqësor, siç e definojnë praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, konkretisht i referohet rastit Hornsby kundër Greqisë, në të cilin thuhet se ekzekutimi i një vendimi është pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë, dhe se mjeti efektiv juridik nuk duhet të mbetet vetëm në letër, por edhe të realizohet në praktikë. Në këtë rast, ekzistojnë shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, duke marrë parasysh edhe natyrën e rastit dhe të gjitha provat, si dhe kohëzgjatjen e paarsyeshme të gjithë procedurës. Që nga marrja e vendimit e deri më sot, vendimi i AKP-së nuk është përmbaruar. Çdo gjë tjetër paraqet formulim të zbrazët që nuk shpie në gëzimin e të drejtës për t'iu drejtuar sistemit për mbrojtje gjyqësore, për të drejtat e fituara. Në fund, duke pasur parasysh përgjigjen e AKP-së se nuk posedojnë mjete buxhetore të mjaftueshme, mendoj se do të pritet një zvarritje shumëvjeçare, për fajin e këtij organi që është kompetent për t'iu ofruar mbrojtje këtyre personave, prandaj është e qartë se një rast i tillë nuk pritet që të zgjidhet për një kohë të shkurtër.*

Pohimet e përfaqësuesve të AKP-së në seancën e dëgjimit publik të mbajtur, më 10 mars 2014

37. *Në këtë seancë të dëgjimit publik, përfaqësuesja e AKP-së, mes tjerash pohoi: në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079 për AKP-në, AKP-ja është kompetente për zgjidhjen e rasteve të tilla. Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës (KKPK), në kuadër të AKP-së, zgjedh kërkesat e palëve që janë të lidhura me konfliktin e armatosur, nga shkurti i vitit 1998 gjer më 20 qershor 1999. Ndër këto raste,*

para AKP-së, objekt i shqyrtimit ka qenë edhe kërkesa e znj. N. Jovanović.

Me vendimin e KKPK-së (KPCC/D/A/114/2011, kërkesa nr. 16008) znj. N. Jovanović i është njohur e drejta e posedimit të pronës në fjalë. Me këtë vendim është urdhëruar z. L. F. dhe çdo person tjetër që kishte uzurpuar pronën, ta lirojë atë në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri. Për këtë vendim, palët janë njoftuar në kohë. Më pas, z. L. F. ka parashtruar ankesë kundër vendimit të KKPK-së pranë Kolegjit të Apelit të GJS-për çështjet e AKP-së. Kolegji i Apelit, më 8 maj 2012 nxori vendim duke e refuzuar ankesën e z. L. F., më ç'rast vendimi i KKPK-së u bë i plotfuqishëm. Sipas praktikës, AKP-ja, pas pranimit të vendimit nga Kolegji i Apelit, menjëherë i njofton palët në procedurë dhe ndërmerr veprime që vendimi të përmbarohet brenda 15 ditësh, pasi të jenë njoftuar palët. Mirëpo, për shkak të rrethanave të krijuara, AKP-ja nuk arriti të përmbaronte vendimin KKPK-së, për arsye të ndërtimit të strukturave të reja në atë pronë, fjala është për shtëpi të reja. Pengesat u paraqitën meqë për t'ia dorëzuar në posedim patundshmërinë pronares legjitime, AKP-së i duheshin mjete buxhetore shtesë për rrënimin e shtëpive të ndërtuara. Përveç rrënimin të strukturave, AKP-ja, sipas ligjit, ka mjete tjera juridike në dispozicion, siç është mjete i ndërmjetësimit. AKP-ja, në mungesë të mjeteve financiare, nuk arriti ta përmbarojë vendimin, sepse buxheti tashmë ishte aprovuar dhe për këtë arsye AKP-ja, më 21 tetor 2013, kërkoi nga Ministria e Financave të miratoj buxhet shtesë për vitin 2014, i cili do ta siguronte mbarëvajtjen e AKP-së dhe mandatin e saj, por, edhe pse kërkesat tona ishin të arsyetuara, Ministria e Financave nuk e miratoi kërkesën për buxhet shtesë. AKP-ja, me qëllim të përmbarimit të vendimit të KPCC, më 5 qershor 2013, e kontaktoi znj. N. Jovanović dhe e njoftoi atë për rrethanat e rastit dhe i kërkoi asaj që ta pranonte mjetin e ndërmjetësimit, në mënyrë që çështja e patundshmërisë të zgjidhej me marrëveshje dhe në mënyrë miqësore. Por, znj. N. Jovanović e refuzoi kërkesën tonë. Përpjekje tjetër është bërë edhe në shtator të 2013, por kemi marr përgjigje të njëjtë. Vlen të theksohet se AKP-ja, para saj, ka 42.600 mijë raste. Kërkesa të ngjashme sikurse të znj. N. Jovanović, AKP-ja posedon vetëm 21, ku 14 prej tyre kanë pranuar mjetin e ndërmjetësimit”.

Komentet e përfaqësuesve të parashtrueses ndaj përfaqësuesve të AKP-së

38. Përfaqësuesi i parashtrueses pohoi se: *AKP-ja ka pasur kohë të mjaftueshme për zgjidhjen e kësaj çështjeje juridike, mirëpo ka reaguar pasi që znj. N. Jovanović e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese. Parashtrueses i është thënë se AKP-ja nuk ka mjete të mjaftueshme financiare për përmbarrimin e vendimit të KKKP-së. Ky është edhe thelbi i kësaj ankese. Nuk është kontestues aspak mjeti i ndërmjetësimit, ndoshta edhe vetë parashtruesja do të ishte e interesuar për këtë mjet juridik. Sipas të drejtës anglosaksone, në këtë situatë, nuk kemi barazi të palëve, sepse njërës palë për pesëmbëdhjetë (15) vjet rresht i mohet e drejta e posedimit të pronës, ndërsa pala tjetër në mënyrë të paligjshme përfiton nga prona e parashtrueses. I referohemi rastit Dogan kundër Turqisë, ku ka pasur shkelje të të drejtave të palëve të zhvendosura edhe pse kanë ekzistuar procedurat për tejkalimin e kësaj.*

Përgjigjet e palëve në pyetjet e Gjykatës

39. Përfaqësuesi i parashtrueses pohoi se: *kërkesa e parashtrueses është bazuar në nenin 31, 32, 46, 53 dhe 54 të Kushtetutës. Këto dispozita mund të ndërlidhen me nenin 6, 8, 13 dhe nenin 1 të protokollit 1 të KEDNJ-së. Për më tepër ai shtoi se: nga deklaratat e përfaqësuesve të AKP-së, u konstatua se Agjencia është kompetente për përmbarrimin e vendimit në fjalë, por siç duket ajo nuk ka paraparë procedurat se si të arrihet kjo, sepse nuk ka caktuar afate kohore, për të parë se kur do të realizohet kjo e drejtë. Në ankesën tonë, kemi përmendur disa raste ku përmbarrimi i vendimit të gjykatës është element i të drejtës për gjykim të drejtë. Arsyeja pse është refuzuar ndërmjetësimi ka qenë stërzgjatja dhe përfitimi në kohë nga AKP-ja, prandaj dhe është refuzuar mjeti i ndërmjetësimit nga parashtruesja. AKP-ja, nuk ka pasur një platformë të qartë se çka do të ndodhte nëse ndërmjetësimi nuk do të kishte sukses, gjithashtu AKP-ja nuk ka paraparë mjete financiare për shkatërrimin e shtëpive të ndërtuara. Është dashur që kjo të rregullohej paraprakisht me procedura, më pas parashtrueses i është thënë se fatkeqësisht nuk ka mjete financiare për t'i shkatërruar ato shtëpi. Ky fakt ka bërë që ne t'i drejtohem Gjykatës Kushtetuese me ankesën tonë. Znj. D. Jovanović në këtë rast shtoi: ne nuk kemi qenë kundër ndërmjetësimit, nuk është se ne nuk e kemi dëshiruar këtë, por kjo ofertë nuk ka ekzistuar në fillim dhe nuk ka qenë bindëse.*
40. Znj. D. Jovanović, përveç tjerash theksoi: *ne nuk e dëshirojmë rrënimin e shtëpive, por ne duam një kompensim të arsyeshëm për atë parcelë, nuk jam absolutisht e pajtimtë që të shkatërrohen*

shtëpitë. Përfaqësuesi i parashtrueses, sqaron më tutje, duke thënë se: *përgjigja e parashtrueses është e qartë që do të thotë se ajo dëshiron një ndërmjetësim efektiv. Përfaqësuesit e AKP-së, përgjigjen duke theksuar se: prona është vizituar disa herë dhe përsëri është njoftuar z. L. F. për vendimin e Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme dhe është urdhëruar që ta lirojë pronën e znj. N. Jovanović por kjo nuk ka ndodhur. Më tutje, përfaqësuesit e AKP-së, pohojnë: në rastet kur dëbimi nuk është i mundur, AKP-ja shfrytëzon mjete të tjera në dispozicion, siç është ndërmjetësimi. Për situatën e krijuar, parashtruesja është njoftuar, më 5 qershor 2013 dhe i është kërkuar që ta pranojë mjetin e ndërmjetësimit. Parashtruesja, në korrik të vitit 2013, ka dorëzuar një shkresë me të cilën ka pohuar se nuk pajtohet me ndërmjetësim. Parashtruesja, më 3 shtator 2013, përsëri është kontaktuar nga AKP-ja dhe përsëri i është kërkuar që ta pranojë ndërmjetësimin.*

41. Përfaqësuesit e AKP-së, deklaruan se: *AKP-ja është i vetmi organ kompetent për përmbarimin e vendimit të Kolegjit të Apelit të GJS-së dhe të Komisionit për Kërkesa Pronësore në Kosovë (KKPK). Përkitazi me procedurat e ndërmjetësimit, përfaqësuesit e AKP-së pohuan: nëse palët pajtohen që çështja të zgjidhet me ndërmjetësim, atëherë AKP bie një vendim, i cili iu komunikohet më pas palëve. Procedurat parashohin që ndërmjetësimi të bëhet në disa faza, zakonisht tre deri në pesë seanca (takime). Nëse palët arrijnë një marrëveshje, në këtë rast, mandati i AKP-se përfundon. Nëse marrëveshja e arritur nuk respektohet, më pas palët mund të iniciojnë procedura të tjera gjyqësore. [...] kur marrëveshja dështon, atëherë AKP-ja procedon me mjete të tjera në dispozicion për shkatërrimin e strukturave të ndërtuara në atë pronë. Përfaqësuesit e AKP-së, në fund të seancës deklaruan: AKP-ja, është e gatshme, duke filluar që nga dita e nesërme, 11 mars 2011, që të procedojë me mjetin e ndërmjetësimit.*
42. Megjithatë, që nga 11 marsi 2014, gjer me datën e vendosjes së këtij rasti, Gjykata nuk posedon asnjë informacion nga AKP-ja për veprimet e ndërmarra.

Pranueshmëria e kërkesës

43. Në mënyrë që Gjykata të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtrueses, duhet që së pari të vlerësojë nëse parashtruesja i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

44. Përkitazi me kërkesën e parashtrueses, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton: *“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”*.
45. Në këtë kontekst, parashtruesja i ka shteruar të gjitha mjetet juridike, të parpara me ligj, dhe në mungesë të ndonjë mjeti tjetër efektiv në dispozicion, ajo i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për përmbarimin e Aktgjykimit GSK-KPA-A-001/12, të 8 majit 2012, të Kolegjit të Apelit, me të cilin është lënë në fuqi Vendimi nr. KPCC/D/A/114/2011, i 22 qershorit 2011, i KKPK-së.
46. Gjykata, po ashtu, i referohet nenit 49 të Ligjit, që përcakton se: *“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të llogaritet që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të llogaritet në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht....”*.
47. Gjykata, në këtë rast, dëshiron të theksojë se kriteri për dorëzimin e kërkesës brenda afatit prej katër (4) muajve nuk vlen në rastin e mospërmbarimit të vendimeve nga autoriteti publik (shih, *mutatis mutandis*, *Iatridis kundër Greqisë Nr. 59493/00, GJEDNJ, Aktgjykimi i 19 tetorit 2000*). GJEDNJ-ja thekson në mënyrë eksplicite se në një situatë të ngjashme që paraqitet në rastin Iatridis kundër Greqisë, rregulli i afatit kohor nuk vlen në rastin kur ekziston refuzimi i ekzekutivit që të pajtohet me vendimin konkret.
48. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 48 të Ligjit, që përcakton se: *“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij/saj të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar, dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”*.
49. Sa i përket përmbarimit të këtij kriteri, Gjykata vëren se, parashtruesja e kërkesës ka treguar saktësisht se cilat të drejta kushtetuese pretendon se i janë shkelur me mospërmbarimin e Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit dhe të vendimit të KKPK-së, duke iu referuar në këtë rast edhe praktikës së GJEDNJ-së për rastin e saj.
50. Gjykata vëren se parashtruesja mund të pretendojë në mënyrë legjitime të jetë viktimë e mospërmbarimit të vendimit të KKPK-së, i

cili është lënë në fuqi me Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit, GSK-KPA-A-001/12, të 8 majit 2012.

51. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesja është palë e autorizuar; i ka shteruar të gjitha mjetet juridike; e ka përmbushur kërkesën e afatit si rezultat i situatës së vazhdueshme dhe se i ka sqaruar me saktësi shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive, si dhe i është referuar praktikës së GJEDNJ-së për realizimin e së drejtës së saj për gëzimin dhe posedimin e pronës.
52. Pasi që parashtruesja i ka përmbushur kriteret procedurale të kërkuara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës, Gjykata konsideron se kërkesa është e pranueshme për shqyrtim meritior.

Meritat e kërkesës

53. Gjykata vëren se, parashtruesja pretendon në shkelje të të drejtave kushtetuese të garantuara me: nenin 3 [Barazia para Ligjit]; nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike]; nenin 46 [Mbrojtja e Pronës]; nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]; nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] si dhe me nenet përkatëse të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ) neni 6 paragrafi 1 [E Drejta për një Proces të Rregullt]; neni 13 [E Drejta për Mjete Efektive Juridike]; neni 14 [Ndalimi i Diskriminimit]; neni 1 i Protokollit 1 të KEDNJ-së [Mbrojtja e Pronës].
54. Gjykata në këtë rast do të shqyrtojë meritat e kërkesës, në bazë të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së, neni 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, si dhe të nenit 54 të Kushtetutës [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave].

Sa i përket shkeljes së pretenduar për gjykim të drejtë dhe të paanshëm

55. Gjykata vëren se, parashtruesja e kërkesës kryesisht pretendon se zvarritja dhe mospërmbarimi i Vendimit të Kolegjit të Apelit GSK-AKP-A-001/12 dhe i Vendimit të KKPK-së nr. KPCC/D/A/114/2011, shkel të drejtat e saj për gjykim të drejtë.
56. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 31 të Kushtetutës, i cili përcakton:

1. *“Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike”.*

2. *“Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.*

57. Përveç kësaj, neni 6.1 [E Drejta për një Proces të Rregullt] i KEDNJ-së përcakton:

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile..., çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme”.

58. Për më tepër, neni 54 i Kushtetutës, përcakton që:

“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”.

59. Në rastin konkret, sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079 të Republikës së Kosovës, Gjykata konstaton se AKP-ja është organi i vetëm përgjegjës dhe kompetent për përmbartimin e vendimeve të Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme për çështjet e Agjencisë Kosovare të Pronës dhe të vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës të AKP-së. Këtë fakt e konfirmuan edhe përfaqësuesit e AKP-së, në seancën e dëgjimit publik, të mbajtur më 10 mars 2014 në këtë Gjykatë.

60. Gjykata, vëren që, me Vendimin e KKPK-së KPCC/D/A/114/2011, parashtrueses i është njohur e drejta e pronësisë mbi pronën në fjalë. Kundër këtij vendimi z. L. F., kishte parashtruar ankesë pranë Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme. Ankesa e tij ishte hedhur poshtë si e paafatshme. Në këtë kontekst kuptojmë se vendimi i KKPK-së është bërë i formës së prerë dhe përbën çështje të gjykuar.

61. Në kuptim të përmbartimit të këtyre vendimeve, parashtruesja disa herë i është drejtuar AKP-së, me kërkesë për kthimin e pronës në

posedim. Më pas i është drejtuar edhe institucioneve tjera të Republikës së Kosovës. Parashtruesja është përpjekur vazhdimisht që të drejtën e saj ta realizojë në rrugë institucionale, gjithnjë në kërkim të realizimit të së drejtës së fituar, por kjo e drejtë e saj nuk është realizuar.

62. Në këtë kuptim, Gjkata thekson se është e drejtë e palës së pakënaqur që të iniciojë procedurë gjyqësore në rast të dështimit të realizimit të së drejtës së fituar që parashihet me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenin 6 në lidhje me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Do të ishte e pakuptimtë nëse sistemi ligjor i Republikës së Kosovës do të lejonte që një vendim gjyqësor përfundimtar i formës së prerë të mbetej i paefektshëm në dëm të një pale. Interpretimi i neneve të lartpërmendura në mënyrë ekskluzive ka të bëjë me qasjen ndaj Gjykatës. Prandaj, joefektshmëria e procedurave dhe moszbatimi i vendimeve prodhojnë efekte të cilat na sjellin para situatave që nuk janë në përputhje me parimin e sundimit të ligjit (neni 7 i Kushtetutës), parim të cilin autoritetet e Kosovës janë të obliguara ta respektojnë (shih, *Vendimin e GJEDNJ-së në rastin Romashov kundër Ukrainës, parashtrës nr. 67534/01, Aktgjykimi i 25 korrikut 2004*).
63. Gjykata është e mendimit se, përmbarimi i një vendimi të marrë nga një gjykatë duhet shikuar si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë, e drejtë kjo e garantuar me nenet e lartpërmendura (shih, *rastin Hornsby kundër Greqisë, Aktgjykimi i 19 marsit 1997, raportet 1997-II, f. 510, para. 40*). Në rastin konkret, parashtruesja nuk do të duhej privuar nga përfitimi i vendimit të fuqisë së prerë, që është në favorin e saj.
64. Asnjë autoritet nuk mund të arsyetojë mospërmbarimin e vendimeve për qëllim të fitimit të rishikimit dhe rishqyrtimit të freskët të rastit (shih, *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës, nr. 48553/99, § 72, ECHR 2002-VII, si dhe Ryabykh kundër Rusisë, nr. 52854/99, § 52, ECHR 2003-IX*).
65. Autoritetet kompetente e kanë për obligim që të organizojnë një sistem efikas për zbatimin e vendimeve, që janë efektive në kuptimin ligjor dhe atë praktik, si dhe duhet të sigurojnë zbatimin e tyre në kohë të arsyeshme, pa vonesa të panevojshme (shih, *Pecevi kundër Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 21839/03, 6 nëntor 2008; Martinovska kundër Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 22731/02, 25 shtator 2006*).

66. Gjykata thekson se, nuk është detyrë e saj të përcaktoj se cila do të ishte mënyra më e përshtatshme për AKP-në, në kuadër të kompetencave që ka, për gjetjen e mekanizmave efikase të natyrës ekzekutive, në kuptim të përmbushjes së plotë të detyrimeve që i përcaktohen me ligj dhe Kushtetutë. Megjithatë çdo individ gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj (shih, nenin 54 të Kushtetutës).
67. Prandaj, barra e përgjegjësisë për mospërmbarimin dhe mosgjetjen e mekanizmave adekuatë për përmbarimin e vendimit të fuqisë së prerë KKPK-së KPCC/D/A/114/2011, bie mbi vetë AKP-në. Mungesa e mekanizmave ekzekutivë të këtij institucioni, në asnjë mënyrë nuk duhet të jetë shkas i mohimit dhe i gëzimit të pronës së parashtrueses.

Sa i përket shkeljes së pretenduar të së drejtës për mbrojtje të pronës

68. Parashtruesja gjithashtu pretendon në shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës [Mbrojtja e Pronës] dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
69. Neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës parasheh:
1. *E drejta e pronës është e garantuar.*
 2. *Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
 3. *Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. (...)*

[...]

70. Neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së parasheh:

“Çdo person fizik apo juridik ka të drejtën të gëzojë në mënyrë paqësore zotërimet e tij. Askush nuk do të privohet nga zotërimet e veta përveçse në interes të publikut dhe kur është subjekt i kushteve të përcaktuara me ligj e sipas parimeve të përgjithshme të të drejtës ndërkombëtare.

Dispozitat e mësipërme, sidoqoftë, nuk do të cenojnë në asnjë mënyrë të drejtën e një Shteti për të zbatuar ligjet, të cilat i

ulerëson si të nevojshme për kontrollin e përdorimit të pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm apo për të siguruar pagesën e taksave e kontributeve apo gjobave të tjera”.

71. Sa i përket shkeljes së pretenduar, për mbrojtjen e pronës, Gjykata konstaton se vendimi i KKPK-së, përbënte pritje legjitime për parashtruesen, me të cilin është konstatuar se e njëjta është pronare legjitime e asaj prone. Prandaj, parashtruesja ka të drejtë ta gëzojë në mënyrë paqësore atë pronë, ashtu siç garantohet me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës. Në këto rrethana, asaj i është mohuar e drejta e gëzimit dhe posedimit të pronës (shih, *mutatis mutandis*, Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke (dec.), nr. 39794/98, para 73, GJEDNJ 2002-VII).

Sa i përket kërkesës për vendosjen e masës së përkohshme

72. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 116.2 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, i cili përcakton: *“Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktojë dëme të pariparueshme”.*

73. Gjykata, gjithashtu, merr në konsideratë nenin 27 të Ligjit, i cili parasheh:

“Gjykata Kushtetuese, sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës, mund të vendosë përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik”.

74. Përkitazi me këtë kërkesë, Gjykata vëren se, parashtruesja e kërkesës nuk ka argumentuar dhe provuar, si dhe pse, asaj edhe me tutje do ti shkaktoheshin dëme të pariparueshme me mospërmbarimin e vendimit të KKPK-së. Kërkesa për vendosjen e masës së përkohshme duhet argumentuar mbi baza reale të shkakimit të rrezikut a dëmit të pariparueshëm, vlera e të cilit është e pakompensueshme në kuptimin material dhe monetar.
75. Në këtë drejtim, Gjykata nuk gjeti bazë reale për miratimin e kërkesës për vendosjen e masës së përkohshme, ashtu siç kërkohet në nenin 27 të Ligjit.

76. Gjykata dëshiron të theksoj se, në seancën e dëgjimit publik, përfaqësuesit e AKP-së, u zotuan se AKP-ja, më 11 mars 2014 do të ndërmarrë veprime konkrete, brenda një periudhe të arsyeshme kohore dhe me procedurë të përshpejtuar nëpërmjet ndërmjetësimit, t'i organizojë dhe mbajë tre deri në pesë seanca, për arritjen e një marrëveshjeje të pranueshme për parashtruesen, që nënkupton kompensimin monetar të vlerës reale të pronës. Përfaqësuesit e AKP-së, gjithashtu u zotuan se në rast të dështimit të marrëveshjes, sipas ligjit në fuqi AKP-ja përfundimisht do të shfrytëzojë mjete tjera në dispozicion, siç është shkatërrimi i strukturave të ndërtuara nga shfrytëzuesi i paligjshëm dhe kthimin e pronës në posedim të pronares legjitime.
77. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 63 (4) të Rregullores së punës që përcakton: *“(4) Gjykata Kushtetuese mund të specifikojë, me vendimin e saj, mënyrën dhe afatin kohor për zbatimin e vendimit të Gjykatës”.*
78. Prandaj, në përputhje me rregullin e lartcekur, Gjykata e urdhëron AKP-në që në afat prej 3 (tre) muajsh, të përmbush zotimin e saj për përmbarimin e vendimit të KKPK-së dhe ta informojë Gjykatën Kushtetuese lidhur me masat e ndërmarra për të zbatuar këtë Aktgjykim të kësaj Gjykate.

PËRFUNDIM

79. Si përfundim, mospërmbarimi i vendimit të KKPK-së nga AKP-ja dhe dështimi i autoriteteve kompetente të Republikës së Kosovës për të siguruar mekanizma efikas në kuptim të përmbarimit të vendimeve të formës së prerë është në kundërshtim me parimin e sundimit të ligjit dhe përbën shkelje të të drejtave themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë.
80. Në këtorrethana, Gjykata konkludon se mospërmbarimi i Vendimit të formës së prerë, KPCC/D/A/114/2011, përbën shkeljetënenit31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin6.1 të KEDNJ-së dhe të nenit 54 të Kushtetutës.
81. Për më tepër, Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës, nga zvarritja dhe mospërmbarimi i Vendimit KPCC/D/A/114/2011 është privuar pa të drejtë nga prona e saj. Në këtë mënyrë, e drejta e parashtrueses për të gëzuar në mënyrë paqësore pronën e saj, e garantuar me nenin46 të Kushtetutës dhe me nenin1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së gjithashtu është shkelur.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56 (1) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 1 prill 2014, njëzëri:

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. KONSTATON se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së;
- III. KONSTATON se ka pasur shkelje të nenit 54 të Kushtetutës;
- IV. KONSTATON se ka pasur shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së;
- V. DEKLARON se Vendimi nr. KPCC/D/A/114/2011, i 22 qershorit 2011, duhet të përmbahet nga Agjencia Kosovare e Pronës;
- VI. URDHËRON Agjencinë Kosovare të Pronës, që në pajtim me rregullin 63 të Rregullores së punës të Gjykatës, në afat prej tre (3) muajsh, ta informojë Gjykatën Kushtetuese lidhur me masat e ndërmarra për të zbatuar këtë Aktgjykim të kësaj Gjykate.
- VII. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;
- VIII. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IX. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë

Gjyqtari raportues
Prof. Dr. Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI200/13, Belkize Kallaq, Aktgjykim i datës 24 mars 2014 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimeve Rev. Mlc. nr. 329/2012, të 24 qershorit 2013, dhe Rev. nr. 356/2009, të 20 janarit 2012, të Gjykatës Supreme të Kosovës, dhe të Aktgjykimit Ac. nr. 52/2012, të Gjykatës së Qarkut në Prizren, të 11 majit 2012

Rasti KI200/13, vendimi i 24 marsit 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesa individuale, shkelje e së drejtës pronësore, shkelje e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm

Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, Rev. Mlc. nr. 329/2012 dhe Rev. nr. 356/2009, të 24 qershorit 2013 dhe 20 janarit 2012, dhe Aktgjykimit Ac. nr. 52/2012 i Gjykatës së Qarkut në Prizren, të 11 majit 2012.

Parashtruesja e kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Komunale ku ajo kërkoi nga gjykata të përcaktojë se palët e paditura nga Peja kishin penguar e kishin poseduar atë në posedim të banesës së saj dydhomëshe në Pejë, duke u vendosur në mënyrë të paligjshme në banesën e saj. Gjykata Komunale konstatoi se ajo nuk mund t'i ofrojë mbrojtje gjyqësore parashtrueses së kërkesës, pasi që sipas Gjykatës Komunale të paditurit nuk kishin kryer veprën e pengimit të posedimit, por kjo është bërë nga persona të tjerë. Parashtruesja parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut dhe kjo e fundit e refuzoi ankesën e saj si të pabazuar.

Pas kësaj, parashtruesja e kërkesës iu drejtua Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore duke kërkuar urdhrin për regjistrimin e pronësisë së banesës. Kërkesa e saj u aprovua. Pas këtij vendimi të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore, pala e paditur kërkoi rishqyrtimin e kësaj kërkesë e cila u refuzua përfundimisht.

Pas marrjes së konfirmimit të pronësisë nga Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore, parashtruesja e kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Prizren duke kërkuar konfirmimin e pronësisë së saj. Gjykata Komunale në Prizren hodhi poshtë kërkesën e saj si të pabazuar. Ajo pastaj parashtroi ankesë me sukses në Gjykatën e Qarkut në Prizren, e cila anuloi vendimin e Gjykatës Komunale me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë ishte e obliguar t'i pranojë vendimet e Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore dhe se çështja nuk mund të jetë objekt i shqyrtimit në procedura të gjykatës. Pas kësaj, të paditurit paraqitën revizion në Gjykatën Supreme. Kjo e fundit e aprovoi

revizionin e parashtruar nga të paditurit, anuloi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren dhe ia ktheu lëndën gjykatës së shkallës së dytë për rigjykim.

Si rezultat, Gjykata e Qarkut në Prizren, gjatë gjykimit të së njëjtës çështje për herë të dytë, e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtrueses së kërkesës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, me të cilin kërkesëpadia e parashtrueses së kërkesës se ajo ishte pronare e banesës ishte refuzuar. Parashtruesja e kërkesës parashtroi revizion në Gjykatën Supreme kundër këtij aktgjykimi të Gjykatës së Qarkut, duke deklaruar se Gjykata e njëjtë e Qarkut së pari e kishte anuluar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale dhe tani kishte vërtetuar të njëjtin Aktgjykim duke përdorur një arsyetim krejtësisht të ndryshëm. Së fundi, Gjykata Supreme hodhi poshtë si të pabazuar revizionin e parashtrueses si dhe kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruar nga Prokurori i Shtetit, duke vërtetuar në këtë mënyrë Aktgjykimin e Gjykatës Komunale, që ia mohonte pronësinë e banesës parashtrueses së kërkesës.

Parashtruesja e kërkesës parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese. Në kërkesën e saj, parashtruesja pretendoi se Aktgjykimet e kontestuar kishin shkelur të drejtën e saj të garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] në lidhje me nenin 1 [E Drejta e Pronës] të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave të të Drejtave të Njeriut] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Gjykata Kushtetuese deklaroi kërkesën të pranueshme dhe konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ dhe se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Lidhur me të drejtën e parashtrueses në pronë, Gjykata konkludoi se vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore ishte bërë *res judicata* pasi ishte vërtetuar nga sekretari i KKPB-së më 24 korrik 2007 dhe që nga atëherë, parashtruesja kishte fituar të drejtën të gëzojë të drejtat e pronësisë dhe posedimit. Kështu, Gjykata Kushtetuese konstatoi se nuk ka pasur shkelje të të drejtave të parashtrueses të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së.

Lidhur me të drejtën e parashtrueses së kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata Kushtetuese konkludoi se duke neglizhuar vlerësimin e mirëfilltë të argumenteve të parashtrueses në lidhje me atë se ajo nuk ka marrë një kopje të revizionit të palës së paditur dhe se nuk ka qenë në gjendje të marrë pjesë në shqyrtimin pranë Gjykatës Supreme për ta bërë rastin e saj, Gjykata Supreme nuk i ka respektuar të drejtat e pretenduara nga parashtruesja e kërkesës. Prandaj, Gjykata Kushtetuese konstatoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

**AKTGJYKIM
në
Rastin nr. KI200/13
Parashtrues
Belkize Kallaq
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimeve Rev. Mlc. nr.
329/2012, të 24 qershorit 2013, dhe Rev. nr. 356/2009, të 20
janarit 2012, të Gjykatës Supreme të Kosovës, dhe të
Aktgjykimit Ac. nr. 52/2012, të Gjykatës së Qarkut në Prizren,
të 11 majit 2012**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është znj. Belkize Kallaq nga Peja, e përfaqësuar nga z. Adem Vokshi, avokat nga Mitrovica.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimet e kontestuarra janë: Aktgjykimi Ac. nr. 52/2012, i Gjykatës së Qarkut në Prizren, i 11 majit 2012, si dhe Aktgjykimet Rev. nr. 356/2009, i 20 janarit 2012, dhe Rev. Mlc. nr. 329/2012, i 24 qershorit 2013, të Gjykatës Supreme të Kosovës. Aktgjykimi Rev. Mlc. nr. 329/2012 i është dorëzuar parashtrueses më 12 gusht 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është ankesa e parashtrueses që vendimet e kontestuarra kanë cenuar të drejtat e saj sipas nenit 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 1 [E Drejta për Pronën] të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në

tekstin e mëtejme: KEDNJ), si dhe neneve 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave të të Drejtave të Njeriut] të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121, (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 13 nëntor 2013, parashtuesja e parashtroi kërkesën e saj në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Me Vendimin GJR. KI200/13, të 3 dhjetorit 2013, Kryetari emëroi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Në të njëjtën ditë, me Vendimin KSH. KI200/13, Kryetari emëroi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.
7. Me shkresën e 19 dhjetorit 2013, avokati i parashtreses është njoftuar për regjistrimin e kërkesës me nr. KI200/13, si dhe ka kërkuar nga ai të dorëzonte kopjet e Aktgjykimit Rev. Mlc. nr. 329/2012, të Gjykatës Supreme të 24 qershorit 2013; Aktgjykimit C. nr. 850/2005, të Gjykatës Komunale në Vushtrri, të 19 prillit 2007; Aktgjykimit Ac. nr. 199/2007, të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, të 18 shtatorit 2007; Aktgjykimit C. nr. 406/2006, të Gjykatës Komunale në Prizren, të 29 gushtit 2008; Aktgjykimit Ac. 23/2009, të Gjykatës së Qarkut në Prizren, të 16 marsit 2009; Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, tek e cila është kthyer rasti me Aktvendimin Rev. 356/2009, të Gjykatës Supreme, të 20 janarit 2012; Aktvendimin N. nr. 223/2008, të Gjykatës Komunale në Pejë, të 15 qershorit 2009; si dhe të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, tek e cila është bartur çështja me Aktvendimin C. nr. 14/2010, të Gjykatës Supreme, të 3 dhjetorit 2010.
8. Një kopje e kërkesës i është dërguar edhe Gjykatës Supreme të Kosovës për informim, më 19 shkurt 2014.
9. Më 24 mars 2014, Gjykata mbajti këshillime dhe votoi për rastin.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 4 qershor 2001, Gjykata Komunale në Pejë, me Aktvendimin C. nr. 121/01, hodhi poshtë kërkesëpadinë e parashtrueses, me të cilën kishte kërkuar nga gjykata të vërtetonte që palët e paditura nga Peja e kishin penguar atë në posedimin e banesës së saj dydhomëshe në Pejë, duke u vendosur në mënyrë të paligjshme në banesë, më 16 shkurt 2001, si dhe që të obligonte palët e paditura që t'ia kthenin banesën asaj brenda 48 orësh.
11. Gjykata Komunale theksoi që nuk mund t'i ofrojë mbrojtje gjyqësore parashtrueses, për shkak të faktit që është përcaktuar pa dyshim që palët e paditura nuk kishin kryer veprën e pengimit të posedimit, por që është bërë nga persona të tjerë. Gjykata gjithashtu kishte gjetur që dëshmitë e tjera, si kontratat e ndryshme të shitblerjes, nuk ishin relevante për të marrë vendim tjetër për këtë çështje, pasi që baza e kërkesëpadisë ishte pengimi i posedimit, e jo vërtetimi i pronësisë. Parashtruesja parashtroi ankesë brenda afatit ligjor.
12. Më 22 prill 2002, Gjykata e Qarkut në Prizren, me Aktvendimin Ac. nr. 234/2001, hodhi poshtë si të pabazuar ankesën e parashtrueses, me arsyetimin që vendimi i kontestuar ishte bazuar në vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, ku e drejta materiale ishte zbatuar në mënyrë të drejtë, dhe se arsyet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë nuk kanë sjellë në dyshim rregullsinë e vendimit.
13. Parashtruesja pastaj iu drejtua Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (në tekstin e mëtejshëm: KKPb), duke kërkuar urdhrin për regjistrimin e pronësisë së banesës. Kërkesa e saj u regjistrua me numrin DSo01477.
14. Më 15 korrik 2006, KKPb-ja, me Vendimin nr. HPCC/D/259/2006/B&C, vendosi që:

“[...]

(1) *Në lidhje me kërkesën e kategorisë B Nr. DSo01447 Komisioni urdhëron që:*

(a) *pronësia e paraqitësit mbi pronën përkatëse të regjistrohet në të dhënat përkatëse publike;*

- (b) *ti epet paraqitësit posedimi i pronës së kërkuar;*
 - (c) *Pala përgjegjëse dhe secili person tjetër që shfrytëzon pronën të lirojë atë pronë brenda 30 ditësh nga dorëzimi i këtij urdhri; si dhe*
 - (d) *Nëse pala përgjegjëse apo ndonjë person tjetër që aktualisht shfrytëzon pronën nuk respekton këtë urdhër që të lirojë pronën brenda afatit të dhënë, ata do të dëbohen nga prona.*
- (2) *Urdhri i sipërm nuk paragjykon juridiksionin e gjykatës kompetente lokale për të ndryshuar regjistrat përkatës publikë në rastin që ajo gjykatë anulon transaksionin mbi të cilin është bazuar urdhri i Komisionit në paragrafin 1.*

[...].”

15. KKPБ-ja arsyetoi se:

“A. Aprovohet kërkesa e kategorisë B

4. *Komisioni me kujdes ka shqyrtuar kërkesën e kategorisë B, nr. DSo01447, në frymën e kriterëve të përcaktuara me paragrafin I si më lart, si dhe udhëzimet e vendosura nga Komisioni në vendimet e tij të mëhershme. Parashtruesja e bazon pretendimin e saj mbi një kontratë të paverifikuar të blerjes, sipas saj të nënshkruar nga vetë ajo, si blerëse, si dhe nga X, si shitës, më 10 maj 1996 (“kontrata e Parashtrueses). Pronësia e X-së mbi pronën është bazuar në një kontratë të vërtetuar të shitblerjes, të nënshkruar më 22 dhjetor 1992, me organizatën "DP Kombinат Koze I Oбуce". Ajo është vërtetuar në gjykatë, si dhe është qartësisht e vlefshme.*
5. *Pala e paditur bazohet tek një kontratë shitblerjeje, e cila thuhet të jetë nënshkruar mes saj dhe ish-partnerit të Parashtrueses, Y, më 20 dhjetor 2000, regjistruar në gjykatën lokale, si dhe në një kontratë të pavërtetuar të shitblerjes, e cila raportohet të jetë nënshkruar më 20 mars 1996 mes Y-së dhe X-së (“Kontrata Y”). Parashtruesja thekson që Kontrata Kocan është nënshkruar në mënyrë mashtruese, nga ish-partneri i saj pas bombardimeve të NATO-s, por edhe është datuar në retroaktiv. Rrjedhimisht, thekson ajo, pala e paditur nuk do të kishte mundur të merrte titullin e vlefshëm nga ish-partneri i saj. Ajo*

gjithashtu thekson që si pronare, ka gëzuar posedimin e pronës nga koha e blerjes deri në kohën kur ka ikur në Suedi më 2000, për t'u bashkuar me burrin e saj të tashëm. Pala e paditur është njoftuar rregullisht për kërkesën. Ajo thekson që Kontrata Y, si dhe kontrata e regjistruar, me të cilën ajo pretendon ta ketë blerë banesën nga ai, janë të vlefshme.

6. *Komisioni, duke vepruar në kuptimin e nenit 19.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60, emëroi një prej anëtarëve të tij për të dëgjuar dëshmitë verbale në lidhje me kërkesën. Komisioneri intervistoi parashtruesen si dhe Z-së, të birin e X-së. Z është shënuar si dëshmitar në shitjen e Parashtrueses (bashkë me ish-partnerin e saj, dëshmitari i dytë). Nuk ka qenë e mundur të intervistohet X. Y është gjetur, si dhe është pajtuar të marrë pjesë në intervistën e Komisionit në atë ditë të caktuar. ai nuk ka arritur në ditën e caktuar, por ka kërkuar shtyrjen e intervistës. Prapë, nuk ka ardhur, si dhe e ka rishtyrë. Për herë të tretë, nuk ka arritur të marrë pjesë. Pas kësaj, thjesht nuk i është përgjigjur më thirrjeve nga shkresaria e Komisionit.*
7. *Komisioni ka gjetur që kontrata e Parashtrueses është nënshkruar vërtetë në datat e përmendura në kontratë, si dhe që Kontrata Y është e rrejshme. Në arritjen në këtë përfundim, Komisioni ka pasur parasysh vlerësimin e Komisionerit për besueshmërinë e dëshmitarëve, faktin që Z nuk konteston që kontrata e Parashtrueses është nënshkruar vërtetë dhe është dëshmuar nga ai (edhe pse ai thekson që kontrata Y është e vlefshme, pa qenë në gjendje të shpjegojë se pse do të nënshkruhej pastaj kontrata e Parashtrueses), faktin që parashtruesja ka vërtetuar që ka pasur posedim ekskluziv të banesës pas blerjes nga ajo (përmes komunalive dhe dëshmisë së Z-së), si dhe sjelljes bishtnuese të Y-së.*
8. *Rrjedhimisht, parashtruesja ka vërtetuar që ka hyrë në një transaksion të vullnetshëm për të blerë pronën banesore brenda periudhës 23 mars 1989 dhe 13 tetor 1999. Transaksioni ka qenë i paligjshëm sipas dispozitave të Ligjit për Kushtet e Veçanta që vlejnë për transaksionet me pronë të paluajtshme, sepse nuk ka pasur lejen e Ministrisë së Financave në bazë të atij ligji. Përndryshe, transaksioni do të ishte i ligjshëm. Vijimisht, kërkesa plotëson kërkesat e paragrafit I si më lart, si dhe duhet aprovuar. Vendimi i Komisionit nuk paragjykon të drejtën e palës së të drejtës për të kërkuar kthimin e çmimit të blerjes si dhe*

kompensimin e dëmit nga personi prej të cilit ajo thekson të ketë blerë pronën e pretenduar.

9. *Në lidhje me gjetjet e tij në lidhje me vlefshmërinë e kontratës së Parashtrueses, si dhe në bazë të nenit 22.7 (b) të Rregullores së UNMIK-it 2000/60, Parashtruesja gjithashtu ka të drejtë të kërkojë urdhrin për kthim të posedimit”.*
[...]
16. Më 21 korrik 2006, KKPБ-ja i lëshoi parashtruesit të kërkesës një “Vendim të certifikuar” në lidhje me Vendimin nr. HPCC/D/259/2006/B&C, me ç’rast pala përgjegjëse dorëzoi kërkesë për rishqyrtim në KKPБ.
17. Më 11 dhjetor 2006, KKPБ-ja, me Vendimin HPCC/REC/81/2006, urdhëroi, *inter alia*, që të hidhet poshtë kërkesa për rishqyrtim e paraqitur nga pala përgjegjëse.
18. Më 26 mars 2007, KKPБ-ja nxori “Vendim të certifikuar për kërkesën për rishqyrtim” në lidhje me vendimin HPCC/REC/81/2006, të 11 dhjetorit 2006, ndaj të cilit pala përgjegjëse parashtrroi një kërkesë për rishqyrtim të mëtutjeshëm në KKPБ.
19. Më 8 qershor 2007, KKPБ-ja, me Vendimin HPCC/REC/99/2007, urdhëroi, *inter alia*, që kërkesa për rishqyrtim të hidhet poshtë.
20. KKPБ-ja vendosi që:

“[...]

(A) *Nuk ka dëshmi të reja e as gabime materiale*

7. *Në kërkesën nr. DSO01447, të paraqitur në pjesën B të Shtojcës së bashkëngjitur, Pala kërkuese, e cila është palë përgjegjëse në kërkesën e kategorisë B, e cila është aprovuar me vendimin fillestar, pretendon që ka fituar pronësinë mbi pronën e pretenduar duke nënshkruar një kontratë të blerjes me pronarin e mëhershëm, A, më 20 dhjetor 2000. Kocan, siç pretendohet, kishte blerë më herët pronën nga një person i quajtur X. Pala përgjegjëse (pra parashtruesi i kërkesës së kategorisë B), e cila ishte më herët gruaja me të drejtë zakonore e A-së, pretendon që ajo, e jo A, kishte blerë pronën nga X. Pala përgjegjëse nuk është e lidhur më me A-në, është martuar sërish, si dhe është zhvendosur në Suedi. Pas ndarjes*

së tyre, A është raportuar të ketë nënshkruar një kontratë tjetër të blerjes me X-në, si dhe ka shitur tutje pronën tek pala kërkuuese. Pala kërkuuese insiston, që edhe pse blerja fillestare ishte bërë në emër të palës përgjegjëse, A ishte blerësi real, si dhe që mjetet ishin mbledhur nga A. Sipas palës kërkuuese, transaksioni është bërë në këtë mënyrë për shkak të “arsyeve familjare.”

8. *Komisioni vëren që pala përgjegjëse është poseduese e pronës së pretenduar për një periudhë të gjatë kohore, si dhe që gjithashtu pretendon që ka paguar pjesën më të madhe të çmimit të blerjes. Dëshmitë dokumentare mbështesin pretendimet e saj që ajo është pronarja e vërtetë, e jo vetëm nominale, e pronës. Komisioni gjithashtu vëren që pala kërkuuese nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi adekuate në të kundërtën e kësaj. Pra, Komisioni nuk mund t'i falë besimin kontratës së blerjes që theksohet të jetë nënshkruar nga A pasi që prona tashmë i ishte bartur palës përgjegjëse [parashtruesi]. Rrjedhimisht, kërkesa për rishqyrtim e Palës Kërkuuese duhet hedhur poshtë.*

[...].”

21. Më 24 korrik 2007, KKPБ-ja nxori një “Vendim të certifikuar për kërkesën për rishqyrtim” në lidhje me Vendimin nr. HPCC/REC/99/2007, të 8 qershorit 2007, për parashtruesen.
22. Më 5 dhjetor 2007, parashtruesja pranoi protokollin e KKPБ-së në fjalë, bashkë me çelësat e banesës nga KKPБ-ja.
23. Më 29 gusht 2008, Gjykata Komunale në Prizren, me Aktgjykimin C. nr. 406/06, hodhi poshtë si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtrueses, me të cilën kishte kërkuar nga Gjykata “të vërtetonte që është pronare e banesës [...] në fjalë, të obligonte të paditurit që ta pranojnë këtë dhe të përmbahen nga çdo lloj i interesimit”. Parashtruesja ishte ankuar kundër këtij vendimi në Gjykatën e Qarkut në Prizren.
24. Më 6 mars 2009, Gjykata e Qarkut në Prizren, me Aktgjykimin Ac. nr. 23/2009, anuloi vendimin e Gjykatës Komunale, të 29 gushtit 2008, në bazat që gjykata e shkallës së parë kishte kryer shkelje substanciale të ligjit, në kuptimin që në bazë të nenit 2.5 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 për Themelimin e Drejtorisë dhe Komisionit për Çështje Pronësore e Banesore, në lidhje me nenin 1.2(c) të Rregullores, si përjashtim i kompetencës së

gjykatave të rregullta, Komisioni ishte ekskluzivisht kompetent për kategoritë e rasteve të përmendura në nenin 1.2 të Rregullores 1999/23.

25. Gjykata e Qarkut, më tutje, arsyetonte që çështja e kontestit mes palëve ishte vendosur nga KKPБ-ja si dhe që gjykata e shkallës së parë ishte e obliguar, sipas nenit 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23, të pranonte vendimet e KKPБ-së si të prera dhe të plotfuqishme, si dhe që çështja nuk mund t'i nënshtrohet shqyrtimit në procedura gjyqësore. Kundër kësaj, e paditura parashtroi revizion në Gjykatën Supreme.
26. Më 20 janar 2012, Gjykata Supreme, me Aktvendimin Rev. nr. 356/2009, pranoi revizionin e parashtruar nga e paditura, duke anuluar Aktgjykimin Ac. nr. 23/2009, të Gjykatës së Qarkut në Prizren, si dhe e ktheu rastin në gjykatën e shkallës së dytë për rigjykim.
27. Gjykata Supreme konstatoi që:

“Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë, kjo çështje kontestuese në mes palëve është vendosur me vendimin e Komisionit për Çështje Pronësore dhe Banesore dhe se gjykata është obliguar që në kuptim të nenit 2.7 të Rregullores 1999/23, vendimet e këtij komisioni t'i merr si obliguese dhe detyruese dhe se e njëjta nuk mund t'i nënshtrohet rishqyrtimit në këtë kontest gjyqësor.

Sipas vlerësimit të gjykatës Supreme të Kosovës, aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të nenit 182 par. 1 lidhur me nenin 391 par. 1, nenit 18 par. 2 të LPK, dhe nenit 1 par. 2 nën (b) të Rregullores 1999/23 për Themelimin e Drejtorisë dhe Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave të Çështjeve Pronësore dhe Banesore si dhe Sqarimit të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/60 date 31.12.2000, mbi kërkesat pronësore dhe banesore dhe të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (Sqarimi) datë 12 prill 2001, e cila ka qenë me ndikim në marrjen e aktvendimit të ligjshëm dhe të drejtë.

Sipas nenit 1 par. 2 nën (b) të Rregullores 1999/23 si përjashtim nga juridiksioni i gjykatave lokale, Drejtoria merr dhe regjistron kërkesat e personave fizike që kanë bërë transaksione jozyrtare me prona të patundshme banesore në bazë të vullnetit të lirë të

palëve pas datës 23 mars 1989, ndërsa sipas pikës 5 nën (b) të Sqarimit, kërkesat e personave fizikë, të cilët kanë hyrë në transaksione jozyrtare për pronën banesore pas datës 23 mars 1989 deri me 13 tetor 1999, në baze të vullnetit të lirë të palëve, por të cilat kanë qenë të paligjshme sipas ligjit ekzistues (e ashtuquajtura "kategoria b" e kërkesave).

Duke marrë parasysh se i padituri kontratën për shitblerje të datës 20.3.1996 e ka legalizuar me 28.9.2000 në gjykatën kompetente, pas datës 13 tetor 1999, rrjedh se për zgjidhjen e kontestit konkret është kompetente gjykata e jo Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore, respektivisht Komisioni për Çështje Pronësore dhe Banesore.

Sipas vendimit të komisionit për shqyrtimin e kërkesave të çështjeve pronësore dhe banesore, kërkesa e paditëses nr. DS 001447, është e kategorisë (b) dhe sipas paragrafit 2 të këtij vendimit urdhri sipas pikës I të atij vendimi është pa prejjudikime të juridiksionit të gjykatës kompetente vendore që të ndryshojë shënimet publike relevante në rast se gjykatat e tilla anulojnë transaksionin në të cilin urdhri i komisionit është bazuar në paragrafin I.

Nga fakti se i padituri i parë legalizimin e kontratës e ka bërë pas datës 13 tetor 1999, e pastaj me të paditurën e dytë ka lidhur kontratën për shitblerjen e banesës kontestuese me datë 20.12.2000, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se kompetente e të gjitha kontesteve pronësore dhe banesore lidhur me transaksionet jozyrtare (si dhe atë zyrtare) pas datës 13 tetor 1999, janë gjykatat e rregullta dhe jo Komisioni për Çështje Pronësore dhe Banesore.

Për këto arsye sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, thëniet e revizionit të paditurve dhe ndërhyrësit, janë të bazuara, ashtu që aktgjykimi i gjykatës ankimore u desh të prishet dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së dytë në vendosje sipas ankesës, në mënyrë meritore, duke dhënë arsyetim të qartë për thëniet e ankesës dhe për çdo pjesë të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e shkallës së dytë është e detyruar që në rigjykim t'i mënjanojë të metat e lartpërmendura, duke pasur parasysh edhe thëniet tjera të revizionit, e pastaj të marrë një vendim të ligjshëm.

[...].”

28. Si rezultat, Gjykata e Qarkut në Prizren, me Aktgjykimin Ac. nr. 52/2012, të 11 majit 2012, hodhi poshtë si të pabazuar ankesën e parashtrueses të parashtruar kundër Aktgjykimit C. nr. 406/06, të Gjykatës Komunale në Prizren, të 29 gushtit 2008, me të cilin kërkesëpadia e parashtrueses, me të cilën ajo pretendonte që është pronare e banesës, ishte hedhur poshtë.
29. Më 21 qershor 2012, parashtruesja parashtroi revizion kundër Aktgjykimit Ac. nr. 52/2012, të Gjykatës së Qarkut në Prizren, në Gjykatën Supreme, duke theksuar që e njëjta Gjykatë e Qarkut, e cila, me Aktgjykimin Ac. nr. 23/2009, të 16 marsit 2009, së pari kishte anuluar Aktgjykimin C. nr. 406/2006, të Gjykatës Komunale në Prizren, të 29 gushtit 2008, tani kishte vërtetuar të njëjtin aktgjykim të Gjykatës Komunale, duke dhënë një arsyetim krejt ndryshe.
30. Parashtruesja, më tutje, theksonte që më 13 qershor 2012, ajo kishte pranuar Aktvendimin Rev. nr. 356/2009, të Gjykatës Supreme, të 20 janarit 2012, me të cilin revizioni i palëve të paditura ishte aprovuar, duke anuluar Aktvendimin Ac. nr. 23/2009, të Gjykatës së Qarkut në Prizren, të 16 marsit 2009 (N. B. e cila ishte në favor të parashtrueses) si dhe duke e kthyer çështjen për rigjykim në atë gjykatë. Sipas parashtrueses, as ajo, e as përfaqësuesi i saj ligjor nuk e kishin marrë kopjen e revizionit të parashtruar nga të paditurit kundër Aktvendimit Ac. nr. 23/2009, të Gjykatës Komunale në Prizren, të 16 marsit 2009, edhe pse një obligim i tillë ishte shprehimisht i përcaktuar me nenit 219(1) të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK), që përcakton që gjykata e shkallës së parë i dorëzon një kopje të revizionit palës së paditur brenda shtatë ditësh.
31. Parashtruesja gjithashtu ka theksuar se vetëm nga Vendimi i Gjykatës Supreme, Cn. nr. 14/2010, i 3 dhjetorit 2010, me propozimin e parashtrueses për ta caktuar Gjykatën e Qarkut në Prizren si gjykatë apeli në vend të Gjykatës Komunale në Pejë, në rastin N. nr. 223/2008, të 15 qershorit 2009, ajo kishte mësuar që e paditura kishte parashtruar revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktvendimit Ac. nr. 23/2009, të Gjykatës së Qarkut në Prizren, me të cilin ishte deklaruar se vendimi i KKPB-së për të drejtat e parashtrueses mbi banesën e kontestuar ishte obligues dhe i detyrueshëm, si dhe nuk mund t'i nënshtrohej shqyrtimit nga gjykatat e rregullta. Për këtë, ajo pretendon se i ka dërguar një letër Gjykatës Supreme, duke kërkuar një kopje të revizionit të së paditurës për vete, por Gjykata Supreme nuk i ishte përgjigjur

kësaj letre fare. Për mendimin e saj, mosveprimi i tillë nga Gjykata Supreme përbën shkelje të të drejtave e lirive të njeriut.

32. Më 17 korrik 2012, Prokurori i Shtetit dorëzoi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, në favor të parashtrueses, kundër Aktgjykimit Ac. nr. 52/2012, të nxjerrë nga Gjykata e Qarkut, më 11 maj 2012, duke pretenduar që Gjykata e Qarkut në Prizren gabimisht kishte aplikuar të drejtën materiale, si dhe i propozonte Gjykatës Supreme që të anulonte aktgjykimin e kontestuar dhe t'ia kthente rastin Gjykatës së Qarkut për rigjykim. Prokurori i Shtetit më tutje theksonte që KKPb-ja ishte kompetente për të vendosur për çështjen, siç përcaktohet me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/60, të 31 tetorit 2000, si dhe që në tri raste, KKPb-ja kishte vendosur në favor të parashtrueses.
33. Më 24 qershor 2013, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin Rev. Mlc. nr. 329/2012, e refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtrueses, si dhe kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të dorëzuar nga Prokurori i Shtetit, duke arsyetuar që:

“[...]

Nga shkresat e lëndës del se paditësja me padi kërkon vërtetimin e pronësisë në banesën e cila gjendet në Pejë në rrugën "Vlladosav Guriq" nr. 100/II, banesa nr. 3, në sipërfaqe prej 66,00 m2, në bazë të kontratës mbi shitblerjen të datës 10.05.1996 e nënshkruar nga paditësja Belkize Kallaç [parashtruesja e kërkesës], në cilësi të blerësit dhe nga X-ja, (pronar i banesës) në cilësi të shitësit, përndryshe ndërhyrës në anën e të paditurve. Kjo kontratë nuk është e legalizuar në gjykatë por është e nënshkruar nga i padituri i parë Y si dhe nga Z i biri i pronarit të banesës, X. Paditësja pas lidhjes së kontratës me datë 10.05.1996 ka hyrë në posedim të banesës të cilën e ka poseduar gjer më 16.02.2001

Në kohën e blerjes së banesës kontestuese paditësja Belkize Kallaç dhe i padituri i parë Y kanë pasur raporte jashtëmartesore. Me datën 16.02.2011, paditëses i është marrë nga posedimi banesa sepse i padituri i parë Y me datën 28.11.2000 me ish pronarin e kësaj banese, X, kishte lidhur kontratën tjetër me shkrim mbi shitblerjen e banesës e cila kontratë ishte vërtetuar në gjykatë nën shenjën Vr.nr. 1237/2000. Pasi që i padituri Z kishte vërtetuar këtë kontratë dhe banesën e kishte bartur në emër të vet, të njëjtën banesë ia ka shitur të paditurës së dytë, B, me të cilën ka përpiluar kontratën tjetër me shkrim mbi shitblerjen datë 20.12.2000, vërtetuar në gjykatë nën shenjën Vr.nr.2074/2000.

Paditësja më pas i është drejtuar Komisionit për kërkesa pronësore dhe banesore-Habitatit, me kërkesën nr.DS 0011447 dhe komisioni në fjalë me vendimin grupor HPCC/D/259/2006/BS datë 15.07.2006, me pikën I (b) paditëses i është dhënë e drejta e posedimit të pronës -banesës kontestuese, ndërsa me pikën II është paraparë që urdhri i mësipërm është pa prejjudikime të juridiksionit të gjykatës kompetente vendore që të ndryshojë shënimet publike relevante në rast se gjykatat e tilla anulojnë transaksionin në të cilën urdhri i komisionit është bazuar në par. 1. Pastaj, e njëjta çështje me kërkesën e Y-së kundër paditëses Belkize Kallaç, kërkesa DS.0011447 është rishqyrtuar në shkallë të dytë me datën 11.12.2006, dhe kërkesa për rishqyrtim e Y-së është refuzuar. E njëjta çështje me kërkesën e të paditurës B kundër-paditëses Belkize Kallaç është rishqyrtuar nga komisioni për rishqyrtime më datë 08.06.2007, dhe kërkesa e B-së për rishqyrtim është refuzuar.

Gjykata e shkallës së parë duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes ka gjetur se kontrata e lidhur ndërmjet të paditurit të parë Y dhe të paditurës së dytë B si blerës, e legalizuar në gjykatë nën shenjën Vr.nr.2074/2000 datë 20.12.2000, prodhon efekte juridike dhe e paditura e dytë B në bazë të kësaj kontrate ka fituar të drejtën e pronësisë në banesën kontestuese konform nenit 20 dhe 33 të LTHMJ. Sipas vlerësimit të asaj gjykate kontrata interne datës 10.05.1996 me të cilën bazë juridike bazohet kërkesëpadia e paditëses: nuk e plotëson formën e kërkuar ligjore për legalizimin e saj, andaj vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën e ankimit në tërësi ka pranuar konstatimin faktik dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditëses dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë.

Gjykata Supreme e Kosovës duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët në bazë të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur kanë refuzuar kërkesëpadinë e paditëses më afër të përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit.

[...]"

Pretendimet e parashtruesit

34. Parashtruesja pretendon që Aktvendimi Ac. nr. 23/2009, i Gjykatës së Qarkut në Prizren, i 16 marsit 2009, që ka anuluar Aktgjykimin C. nr. 406/06, të Gjykatës Komunale në Prizren, të 29 gushtit 2008, si dhe kishte hedhur poshtë pretendimin e palës së paditur si të palejueshëm, për arsyet që gjykata e shkallës së parë kishte kryer shkelje substanciale të ligjit, në kuptimin që në bazë të nenit 2.5 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 për Themelimin e Drejtorisë dhe Komisionit për Çështje Pronësore e Banësore, në lidhje me nenin 1.2(c) të Rregullores, si përjashtim nga kompetenca e gjykatave të rregullta, Komisioni kishte kompetencë ekskluzive për kategoritë e rasteve të përmendura në nenin 1.2 të Rregullores 1999/23.
35. Për mendimin e parashtrueses, në bazë të nenit 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/23, vendimi i nxjerrë nga KKPb-ja është i prerë dhe i plotfuqishëm, si dhe nuk mund të shqyrtohet nga asnjë organ gjyqësor apo administrativ tjetër në Kosovë. Për më tepër, pasi që vendimi i prerë i KKPb-së ka vërtetuar të drejtën pronësore të saj, ka urdhëruar regjistrimin e pronës në regjistrat përkatës publikë, si dhe i ka dhënë asaj posedimin ndaj pronës, secili vendim tjetër në lidhje me pronësinë përbën shkelje të të drejtave pronësore të parashtrueses.
36. Parashtruesja më tutje pretendon që pasi Gjykata e Qarkut në Prizren ka nxjerrë Aktgjykimin Ac. nr. 23/2009, më 16 mars 2009, ajo nuk e kishte marrë kopjen e revizionit të parashtruar nga pala e paditur, edhe pse obligimi i tillë është qartësisht i përcaktuar me nenin 219(1) të LPK-së, i cili përcakton që një kopje e revizionit, të parashtruar me kohë dhe nëse është i plotë dhe i lejueshëm, duhet të dorëzohet, nga gjykata e shkallës së parë, brenda 7 ditësh te pala e paditur. Për mendimin e saj, kjo përbën shkelje të të drejtave të saj, sipas nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], në lidhje me nenin 6 [E Drejta për Gjykim të Drejtë] të KEDNJ-së.
37. Për më tepër, parashtruesja thekson që Aktvendimi Rev. nr. 356/2009, i Gjykatës Supreme, i 20 janar 2012, si dhe Aktgjykimi Ac. nr. 52/2012, i Gjykatës së Qarkut, i 11 majit 2012, si dhe Aktgjykimi Rev. Mlc. nr. 329/2012, i Gjykatës Supreme, i 24 qershorit 2013, në procedurën e përsëritur, të obliguar me Aktvendimin Rev. nr. 356/2009, kanë shkelur të drejtat e saj sipas nenit 46 [Mbrotja e Pronës], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe

të Paanshëm] si dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejta të Njeriut] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6(1) të KEDNJ-së. Parashtruesja frikësohet që pas këtyre vendimeve gjyqësore, ajo do të dëbohet nga banesa, edhe pse vendimet e KKPb-së janë të prera dhe të plotfuqishme.

Ligji i zbatueshëm

38. Dispozitat e përmendura nga KKPb-ja, në vendimet e saj, janë përkufizuar në instrumentet vijuese ligjore:

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/23 për themelimin e Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore dhe Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore:

Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore

[...]

Neni 1.2: “Si përjashtim nga juridiksioni i gjykatave lokale, Drejtoria merr dhe regjistron kategoritë e mëposhtme të kërkesve që kanë të bëjnë me pronën banesore, duke përfshirë këtu edhe pronën e shoqëruar me të:

Kërkesat e personave fizikë, pronësia, posedimi ose e drejta e banimit në pronën e patundshme banesore të të cilëve u është revokuar pas datës 23 Mars 1989 në bazë të legjislacionit i cili është diskriminues si në zbatim ashtu edhe në qëllimet e tij;

Kërkesat e personave fizikë që kanë bërë transaksione jozyrtare me prona të patundshme banesore në bazë të vullnetit të lirë të palëve pas datës 23 mars 1989;

Kërkesat e personave fizikë të cilët kanë qenë pronarë, posedues ose që kanë pasur të drejtën e banimit në pronën banesore para datës 24 Mars 1999, e që tani nuk kanë atë pronë në posedim, dhe kur e drejta e pronësisë nuk është transferuar vullnetarisht.

Drejtoria ia paraqet këto kërkesa Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore për zgjidhje ose, nëse e sheh të përshtatshme, kërkon të ndërmjetësojë në këto mosmarrëveshje dhe kur nuk ka sukses, ia drejton ato për zgjidhje Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore. [...]”.

Neni 2:

Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore

Neni 2.1. *Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore ("Komisioni") është organ i pavarur i Drejtorisë, i cili i zgjidh mosmarrëveshjet private jotregtare që kanë të bëjnë me pronën banesore të cilat ia parashtrojnë Drejtoria, derisa Perfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të gjykojë se gjykatat lokale janë në gjendje të kryejnë funksionet që i janë besuar Komisionit. [...]*

Neni 2.7. *Vendimet përfundimtare të Komisionit janë të detyrueshme për tu zbatuar dhe nuk janë subjekt i rishqyrtimit nga asnjë organ tjetër gjyqësor apo administrativ në Kosovë."*

[...].

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/60, e 31 tetorit 2000

[...]

Neni 2.4: *"Çdo person që ka fituar të drejtën e pronësisë në një pronë nëpërmjet ndonjë transaksioni jozyrtar ndërmjet datës 23 mars 1989 dhe 13 tetor 1999, bazuar në vullnetin e lirë të palëve, ka të drejtë në urdhëresën e Drejtorisë ose të Komisionit për regjistrimin e pronësisë së vet në regjistrat përkatës publikë. Një urdhër i këtillë nuk e liron kërkuesin nga asnjë detyrim për të paguar çfarëdo takse apo tatimi lidhur me pronën ose qarkullimin e pronës."*

Neni 2.5: *"Çdo refugjat ose person i zhvendosur, me të drejtë mbi pronën, gëzon të drejtën e kthimit të pronës ose të disponojë me të në pajtim me ligjin dhe në përputhje me këtë rregullore."*

Neni 2.6: *"Çdo person me të drejtë në pronë më 24 mars 1999, i cili e ka humbur posedimin në atë pronë dhe nuk ka hequr dorë vullnetarisht nga e drejta në pronë, ka të drejtë të marrë vendim nga Komisioni për riposëdim të pronës. Komisioni nuk do të pranojë kërkesa për kompensimin e dëmtimeve apo të shkatërrimeve të pronës."*

[...].

Pranueshmëria e kërkesës

39. Për të vlerësuar kërkesën e parashtrueses, Gjykata duhet që së pari të vlerësojë nëse parashtruesja i ka përmbushur kërkesat e lejueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, si dhe të specifikuarat më tutje me Ligj dhe me Rregullore.
40. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton që:

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

41. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili përcakton që:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor(...)”.

42. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesja i ka kërkuar mjetet në Gjykatën Komunale dhe atë të Qarkut, si dhe përfundimisht, edhe në Gjykatën Supreme të Kosovës, për të mbrojtur të drejtat e saj që i janë dhënë me tri vendime të njëpasnjëshme të KKPb-së. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesja, më 12 gusht 2013, ka pranuar, Aktgjykimin Rev. Mlc. nr. 329/2012, të Gjykatës Supreme, të 24 qershorit 2013, si dhe ka parashtruar kërkesën e saj në Gjykatë, më 13 nëntor 2013.
43. Kështu, Gjykata konsideron se parashtruesja është palë e autorizuar, i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në zbatim, si dhe ka dorëzuar kërkesën e saj brenda afatit prej katërmuajsh.

Meritat e kërkesës

Sa i përket gjetjeve të KKPb-së

44. Sa i përket vlerësimit të meritave të kërkesës, Gjykata vëren se KKPb-ja, me Vendimin nr. HPCC/D/259/2006/B&C, të 15 korrikut 2006, ka vendosur, *inter alia*, që pronësia e parashtrueses në lidhje me pronën e kontestuar të regjistrohet në regjistrat përkatës publikë, si dhe që të marrë posedimin mbi atë pronë.
45. Gjykata gjithashtu gjen se kërkesat e përsëritura për rishqyrtim të atij vendimi, të parashtruara nga pala e paditur, janë hedhur

poshtë nga KKPБ-ja më 11 dhjetor 2006, respektivisht më 8 qershor 2007, duke mos gjetur dëshmi të reja apo gabime materiale. Te titulli: “Plotfuqishmëria e vendimit”, KKPБ-ja i referohet Rregullores së UNMIK-ut 1999/23, duke përcaktuar që: *“2.7 Vendimet e prera të Komisionit janë obligative dhe të ekzekutueshme, si dhe nuk i nënshtrohen shqyrtimit nga asnjë organ tjetër gjyqësor apo administrativ në Kosovë.”*

46. Për mendimin e Gjykatës, kjo mund të nënkuptojë vetëm që pasi vendimi i fundit i KKPБ-së, HPCC/REC/99/2007, i 8 qershorit 2007, në këtë çështje, është bërë *res judicata* pasi është vërtetuar nga sekretari i KKPБ-së, më 24 korrik 2007, parashtruesja ka fituar të drejtën të gëzojë pronësinë dhe posedimin, siç garantohet me nenin 46 të Kushtetutës, si dhe nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, si dhe që ndërhyrja në këto të drejta nga organet gjyqësore apo administrative do të duhej konsideruar si shkelje e këtyre të drejtave (shih edhe Rastin KI104/10, parashtrues: Arsić Draža, Aktgjykimi i 23 prillit 2012).
47. Në këtë kuptim, Gjykata vëren që deri më tani, përpjekjet e parashtrueses për të zbatuar Vendimin e KKPБ-së, nr. HPCC/D/259/2006/B&C, përmes regjistrimit në regjistrat përkatës publikë, kanë mbetur të pasuksesshme dhe kanë krijuar një gjendje të pasigurisë juridike për parashtruesen, edhe pse ajo është aktualisht duke e shfrytëzuar atë pronë.
48. Kështu, Gjykata gjeti që ka pasur shkelje të të drejtave të parashtrueses, të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së.

Sa i përket ankesës që parashtruesja nuk ka pranuar kopjen e revizionit të parashtruar nga pala e paditur

49. Në këtë drejtim, Gjykata vëren që parashtruesja ankohet që në kundërshtim me nenin 219(1) të LPK-së, ajo nuk e ka marrë asnjëherë kopjen e revizionit të parashtruar nga pala e paditur kundër Aktvendimit Ac. nr. 23/2009, të Gjykatës së Qarkut në Prizren, të 16 marsit 2009, si dhe që kur ka mësuar për procedurën e revizionit, kërkesa e saj e drejtuar Gjykatës Supreme për t'i siguruar asaj një kopje të revizionit ka mbetur pa përgjigje. Ajo ankohet që si pasojë, ajo nuk ka marrë pjesë në dëgjimin e Gjykatës Supreme, e cila, me Aktvendimin Rev. nr. 356/2009, të 20 janarit 2012, ka aprovuar revizionin e palës së paditur dhe ia ka kthyer rastin Gjykatës së Qarkut në Prizren, për rigjykim.

50. Më tutje, nga parashtrimet e parashtrueses del se Gjykata e Qarkut në Prizren, kur ka rigjykuar rastin, më 11 maj 2012, ka ndërruar mendimin e saj të mëparshëm duke iu përmbajtur vendimit të Gjykatës Supreme, si dhe duke vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Komunale, të 29 gushtit 2008, me të cilin kërkesëpadia e saj, me të cilën ka kërkuar vërtetimin e pronësisë mbi banesën e kontestuar, është hedhur poshtë.

51. Gjykata vëren që sipas kësaj, parashtruesja ka parashtruar revizion kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, të 11 majit 2012, në Gjykatën Supreme, duke kontestuar njëkohësisht Aktvendimin Rev. nr. 356/2009, të Gjykatës Supreme, të 20 janarit 2012, duke u thirrur shprehimisht të shkeljet e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së, me arsyetimin që *“procedura kontestimore nuk mund të iniciohet mes dy palëve, ku një prej tyre [Parashtruesja] nuk merr pjesë në dëgjim, respektivisht nuk njoftohet me pretendimet e palës së paditur.”*

52. Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës, përcakton, *inter alia*:

“Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...].”

53. Neni 6 [E Drejta për Gjykim të Drejtë] paragrafi 1 i KEDNJ-së, përcakton, *inter alia*:

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.

[...].”

54. Gjykata thekson që në bazë të nenit 53 të Kushtetutës, *“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë,*

interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".

55. Sa u përket ankesave të parashtrueses që nuk është njoftuar për procedurat e revizionit, të iniciuara nga pala e paditur në Gjykatën Supreme, si dhe që një kopje e revizionit, përkundër kërkesës së saj, nuk i është dorëzuar asaj, Gjykata i referohet qasjes së GJEDNJ-së në raste të ngjashme. Për shembull, në rastin Grozdanoski (shih Grozdanoski kundër Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 21510/03, të 31 majit 2007), GJEDNJ-ja pati gjetur që në procedurë civile, parimi i barazisë së armëve nënkupton që secila palë duhet të ketë mundësi të arsyeshme që të paraqesë argumentet e tij/saj – duke përfshirë dëshmitë – në kushte që nuk e vënë atë në pozitë substancialisht më të pafavorshme kundrejt palës kundërshtare. Sipas KEDNJ-së, koncepti i gjykimit të drejtë, një aspekt i të cilit është edhe barazia e armëve, nënkupton të drejtën e palëve për të pasur njohuri dhe për të dhënë përgjigje ndaj të gjitha dëshmimeve të parashtruara apo vërejtjeve të dhëna. GJEDNJ-ja gjithashtu ishte e mendimit që nenin 6 (1) i KEDNJ-së ka për synim, mbi të gjitha, që të sigurojë interesat e palëve dhe ato të ndarjes së mirëfilltë të drejtësisë, derisa respektimi i së drejtës për gjykim të drejtë, garantuar me nenin 6 (1) të KEDNJ-së, kërkon që parashtruesi të ketë mundësi të njoftohet dhe të japë përgjigjet e tij/saj me kërkesë të prokurorit publik. Rrjedhimisht, dështimi për njoftimin e parashtrueses përkritazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, parashtruar nga prokurori publik në Gjykatën Supreme të Maqedonisë, është gjetur nga GJEDNJ-ja të jetë në shkelje të nenit 6 (1) të KEDNJ-së.
56. Gjykata më tutje i referohet rastit Gusak (shih Gusak kundër Rusisë, 7 qershor 2011, kërkesa nr. 28956/05, para. 27), ku GJEDNJ-ja ka gjetur që “pala ndërgjyqëse duhet thirrur në shqyrtimin gjyqësor në atë mënyrë që jo vetëm të ketë njohuri për datën dhe vendin e shqyrtimit, por edhe të ketë kohë të mjaftueshme për të përgatitur argumentet dhe për të marrë pjesë në atë shqyrtim gjyqësor.”
57. Gjykata i referohet gjithashtu edhe praktikës së vet gjyqësore, në veçanti rastit KI108/10, Parashtrues Fadil Selmanaj – Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A. nr. 170/2009, të 25 shtatorit 2009, ku kishte theksuar që "Parashtruesi duhej të thirrej për procedurën gjyqësore në atë mënyrë që jo vetëm të ketë njohuri për ekzistimin e saj, por edhe për të paraqitur argumentet dhe dëshmitë gjatë procedurës."

58. Sa i përket këtij rasti konkret, Gjykata gjeti që parashtruesja nuk ka mundur të ushtrojë të drejtën e saj për gjykim të drejtë pa qenë e njoftuar për revizionin e palës së paditur, si dhe pa pasur mundësi të marrë pjesë në procedurën e Gjykatës Supreme, më 20 janar 2012, për të paraqitur rastin e saj.
59. Për më tepër, edhe pse parashtruesja e ka ngritur këtë çështje hollësisht në Gjykatën Supreme, në revizionin e saj të 21 qershorit 2012, Gjykata Supreme, në Aktgjykimin e saj, Rev. Mlc. nr. 329/2012, të 24 qershorit 2013, në asnjë mënyrë nuk i është referuar ankesës së parashtrueses dhe parashtrimeve të saj në këtë drejtim.
60. Në këto rrethana, Gjykata konkludon që duke neglizhuar vlerësimin e mirëfilltë të argumenteve të parashtrueses në lidhje me faktin që ajo nuk ka marrë një kopje të revizionit të palës së paditur, si dhe me faktin që nuk ka mundur të marrë pjesë në shqyrtimin pranë Gjykatës Supreme, më 20 janar 2012, për të paraqitur rastin e saj, Gjykata Supreme nuk i ka respektuar të drejtat e pretenduara nga parashtruesja. Pra, rrjedh që ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe rregullit 56 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 24 mars 2014,

VENDOS

- I. TA SHPALLË kërkesën të pranueshme, njëzëri;
- II. KONSTATON se ka pasur shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, njëzëri;
- III. KONSTATON se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, njëzëri;
- IV. SHPALL të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.Mlc.nr.329/2012, të 24 qershorit 2013, njëzëri;
- V. URDHËRON përmbarimin e Vendimit të KKPb-së nr. HPCC/D/259/2006/B&C përmes regjistrimit të së drejtës së

parashtrueses së kërkesës për pronën kontestuese në librat përkatës publik, me shumicë votash;

- VI. Në bazë të rregullit 63 (5) të Rregullores së punës, autoritetet publike përgjegjëse për përmbarimin e Vendimit të KKPb-së nr. HPCC/D/259/2006/B&C duhet të paraqesin informacione lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e vendimit të Gjykatës;
- VII. MBETETfuqimisht e angazhuar në këtë çështje në pritje të zbatimit të këtij Urdhri;
- VIII. URDHËRON që ky aktgjykim t'u kumtohet palëve dhe, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit, të publikohet në Gazetën Zyrtare;
- IX. Ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI61/11 dhe KI 55/13 Naxhije Hasani dhe Vjollca Shoshi, Aktvendim i datës 25 qeshor 2013 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së dy aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës: Rev. nr. 434/2008, të 23 shkurtit 2009, dhe Rev. nr. 164/2010, të 11 janarit 2013

Rasti KI61/11 dhe KI55/13, vendimi i 25 qershorit 2013.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale cenimi i të drejtave dhe lirive kushtetuese, nenet 46 dhe 31, kërkesë e papranushme

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushteutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat dhe liritë e tij kushtetuese janë cenuar me aktgjykimin e gjykatave të rregullta. kërkesa është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të kontestuara të Gjykatës Supreme, të cilat pretendohet të kenë shkelur të drejten në pronë dhe gjykim të drejtë të parashtruesëve të garantuara me nenin 46 dhe nenin 31 të Kushtetutës.

Rastet konkrete janë identike me rastin "Vahide Hasani dhe të tjeret" kundër aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës" (shih Aktvendimin për papranueshmeri të Gjykatës Kushtetuese të 22 janarit 2013).

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtrusit ishte e papranushme bazuar në Rregullin 36 (1) c), kërkesat janë qartazi të pabazuara dhe si të tilla të papranueshme. Si përmbledhje, parashtrueset nuk arriten të tregojnë se pse dhe si janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetute. Deklarimi i thjeshtë se ka pasur shkelje të Kushtetutës nuk mund të konsiderohet si shkelje kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutes, të veprojë si gjykate apeli, apo gjykatë e shkallës së katërt, për vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat perkatese të së drejtes procedurale dhe material. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata vendosi të hedhë poshtë kërkesën si të pa pranueshme.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI61/11 dhe KI55/13
Parashtrues
Naxhije Hasani dhe Vjollca Shoshi
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së dy aktgjykimeve të Gjykatës
Supreme të Republikës së Kosovës: Rev. nr. 434/2008, të 23
shkurtit 2009,
dhe Rev. nr. 164/2010, të 11 janarit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesat janë paraqitur nga znj. Naxhije Hasani dhe znj. Vjollca Shoshi (në tekstin e mëtejme: parashtrueset e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Vendimet e kontestuar janë aktgjykimet e Gjykatës Supreme: Rev. nr. 434/2008, i 23 shkurtit 2009, dhe Rev. nr. 164/2010, i 11 janarit 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së këtyre kërkesave është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të kontestuar të Gjykatës Supreme, të cilat pretendohet të kenë shkelur të drejtën në pronë dhe gjykim të drejtë të parashtrueseve të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) dhe nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ.

4. Rastet konkrete janë identike me rastin “Vahide Hasani dhe të tjerët” kundër aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës” (shih Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese të 22 janarit 2013).

Baza juridike

5. Kërkesat bazohen në nenin 113 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Përmbledhja e fakteve

6. Faktet e këtyre kërkesave janë identike me ato të rasteve të lartpërmendura në paragrafin 4.
7. Në fakt, gjatë vitit 2001 dhe 2002, parashtrueset nënshkruan Marrëveshje për Kompensim të Përkohshëm të Pagës për Shkëputje të Kontratës së Punës me punëdhënësin e tyre, Korporatën Energjetike të Kosovës.
8. Neni 1 i Marrëveshjes përcaktoi se, në përputhje me nenin 18 të Ligjit për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës Nr. 26/83, 26/86 dhe 11/88) dhe konstatimit të Komisionit Invalidor të KEK-ut, përfituesi (d.m.th., secili parashtrues) ka të drejtë për kompensim të përkohshëm për shkak të ndërprerjes së kontratës së punës, deri në themelimin dhe funksionimin e Fondit të Kosovës për Sigurim Pensional dhe Invalidor .
9. Më tej, neni 2 i kësaj marrëveshjeje precizoi se shuma mujore që do tëduhej t'i paguhej secilës parashtruese do të ishte 206 marka gjermane.
10. Për më tepër, neni 3 i Marrëveshjes specifikoi që *"pagesa do të përfundojë në ditën e funksionimit të Fondit të Kosovës për Sigurim Pensional dhe Invalidor. Prej asaj dite e tutje, shfrytëzuesi mund t'i realizojë të drejtat e veta në Fondin e Kosovës për Sigurim Pensional dhe Invalidor (Fondi Pensional Invalidor i Kosovës) dhe KEK-ut do t'i hiqen obligimet ndaj shfrytëzuesit sipas kësaj Marrëveshjeje"*.

11. Më 1 nëntor 2002, Bordi Ekzekutiv i KEK-ut miratoi një vendim për themelimin e Fondit Pensional, në përputhje me kriteret e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/30 për Pensionet në Kosovë. Neni 3 i këtij vendimi thotë: *“Fondi Pensional do të vazhdojë të ekzistojë për një periudhë të pacaktuar kohore, në pajtim me kriteret dhe përgjegjësitë e përcaktuara me ligjet për pensione, të miratuara nga Bordi i Fondit Pensional dhe KEK-u, në përputhje me këtë vendim, apo derisa kushtet ligjore për ekzistimin dhe funksionimin e Fondit të jenë në përputhje me rregulloret për pension ose rregullat për pension te miratuara nga ABPK-ja”*.
12. Më 25 korrik 2006, Bordi Ekzekutiv i KEK-ut e anuloi vendimin në fjalë për themelimin e Fondit Pensional Suplementar dhe ndërpreu financimin dhe punën e Fondit Pensional Suplementar, që nga 31 korriku 2006.
13. Sipas vendimit të 25 korrikut 2006, të gjithë përfituesve u garantohej pagesa e plotë në përputhje me Statutin e Fondit. Më tej në Vendim thuhet se punëtorët e KEK-ut, të cilët Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale i pranon si persona me aftësi të kufizuara për punë, do t'i gëzojnë të drejtat e parapara nga Ministria.
14. Më 14 nëntor 2006, KEK-u e informoi Autoritetin Qendror Bankar se *“vendimi për revokimin e Fondit Pensional të KEK-ut bazohet në vendimin e Bordit Ekzekutiv të KEK-ut dhe në vendimin e Bordit Menaxhues për Pensione ... për shkak të rrezikut financiar që kjo skemë paraqet për KEK-un në të ardhmen”*.
15. Në verë të 2006, KEK-u ndërpreu pa asnjë njoftim pagesën e paraparë me Marrëveshje.
16. Parashtrueset ngritën padi kundër KEK-ut në Gjykatën Komunale në Prishtinë, me të cilën kërkuan që Gjykata të urdhërojë KEK-un t'ua paguajë pagesat e papaguara dhe të vazhdojë t'ua paguajë nga 105 euro (që është e barabartë me 206 marka gjermane) deri në përmbushjen e kushteve për ndërprerjen e pagesës.
17. Gjykata Komunale në Prishtinë i miratoi paditë e parashtrueseve dhe urdhëroi kompensim monetar. Gjykata Komunale në Prishtinë konstatoi (p.sh., Aktgjykimi C. Nr. 646/2006, i 12 dhjetorit 2007, në rastin e parashtrueses së parë Naxhije Hasani) se kushtet e parapara në nenin 3 të Marrëveshjes nuk ishin përmbushur. Neni 3 i Marrëveshjes parashikon kompensimin e pagës deri në themelimin e Fondit Pensional Invalidor, *“që do të thotë se e drejta për skemën e pensioneve, nuk do të ishte e mundur për*

bashkëshortin e saj, edhe po të ishte ende gjallë meqë ai ende nuk do t'i mbushte 65 vjet dhe se parashtruesja i trashëgon të drejtat e bashkëshortit të saj për vazhdimin e pranimi të këtyre pagesave".

18. Kundër aktgjykimeve të Gjykatës Komunale KEK-u paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut, duke thënë, *inter alia*, se aktgjykimi i Gjykatës Komunale nuk ishte i drejtë, sepse Marrëveshjet ishin nënshkruar me parashtrueset për shkak të invaliditetit të tyre dhe se nuk mund të kërkojnë vazhdimin e marrëdhënies së punës për shkak të invaliditetit të tyre. KEK-u ritheksoi se Gjykata ka qenë e obliguar që të vendos duke u bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2003/40 për shpalljen e Ligjit për Pensionet Invalidore, sipas së cilës parashtrueset kishin të drejtë për pension invalidor.
19. Gjykata e Qarkut i hodhi poshtë ankesat e KEK-ut si të pabazuara.
20. KEK-u parashtroi revizion në Gjykatën Supreme duke pretenduar shkelje thelbësore të Ligjit për procedurën kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. KEK-u përsëriti se parashtrueset kishin të drejtë për pension sipas Ligjit 2003/40 dhe se, për shkak të arsyeve humanitare, KEK-u kishte vazhduar t'i paguante kompensimet mujore pas hyrjes në fuqi të Ligjit. KEK-u më tej kishte argumentuar se mosha e parashtrueseve nuk ishte relevante por ishte invaliditeti i tyre.
21. Gjykata Supreme i refuzoi si të pabazuara paditë e parashtrueseve dhe anuloi aktgjykimet e gjykatës Komunale dhe asaj të Qarkut. Gjykata Supreme konkludoi se ndërprerja e punësimit ishte e ligjshme, në përputhje me nenin 11. 1 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë.
22. Gjykata Supreme theksoi se mënyra e ndërprerjes së punësimit konsiderohej e ligjshme sipas nenit 11. 1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë.
23. Në Aktgjykimin në rastin e parashtrueses së parë, Naxhije Hasani Rev. Nr. 434/2008 të 23 shkurtit 2009, Gjykata Supreme theksoi: *"Duke marrë parasysh faktin e pakontestueshëm se pala e paditur e ka kryer obligimin ndaj paditësit, që është pagesa e kompensimit të pagës sipas periudhës së specifikuar, që është deri në themelimin dhe funksionimin e Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Kosovës, funksional që nga 1 janari 2004, Gjykata konstatoi se e paditura e kishte kryer obligimin sipas marrëveshjes. Prandaj, pretendimet e paditëses se pala e paditur ka obligim të paguajë kompensimin e pagës së përkohshme pas*

themelimin të Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Kosovës konsiderohen nga kjo gjykatë si të pabazuara, sepse palët kontraktuese deri me paraqitjen e kushtit të zgjidhjes – themelimit të fondit të lartpërmendur i kanë plotësuar obligimet kontraktuale ...”.

24. Më tej, Gjykata Supreme ritheksoi se *“e drejta për kompensim të përkohshëm nuk mund të transferohet tek personat tjerë, sepse kjo është një e drejtë subjektive e lidhur ngushtë ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit”* dhe se KEK-u i ka plotësuar detyrimet e veta, duke vazhduar t'ua paguajë parashtrueseve nga 105 euro për 60 muaj.
25. Më 15 maj 2009, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e Kosovës lëshoi këtë njoftim: *“Vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, në arsyetimin e vet të p.sh. Aktgjykimit Rev. Nr. 338/2008, që në Republikën e Kosovës ekziston Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor që është funksional që nga 1 janari 2004 nuk është i saktë dhe është i pabazuar. Në dhënien e kësaj deklarate, ne kemi parasysh faktin që Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/40 shpall Ligjin Nr. 2003/213 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë, i cili i rregullon rastet e personave me paafhtësi të përhershme, të cilët mund ta gëzojnë këtë skemë në pajtim me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë ligj. Prandaj, më lejoni të theksoj që dispozitat e këtij Ligji nuk parashikojnë themelimin e Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor të vendit. Themelimi i Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor në Republikën e Kosovës përcaktohet me Ligjin për Sigurim Pensional dhe Invalidor, i cili është në proces të hartimit dhe miratimit në Qeverinë e Kosovës”. Në të njëjtin njoftim shpjegohet që, në kohën e shkrimit të atij njoftimi, pensioni inter alia ekzistonte, “pensioni invalidor në shumë prej 45 eurove, siç rregullohet me Ligjin për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara (përfitues të tyre janë të gjithë personat me aftësi të kufizuara të përhershme dhe të plotë)”, si dhe “pensionet e kontribut-dhënësve prej 82 eurosh, të cilat rregullohen me vendim të Qeverisë (përfitues të të cilit janë të gjithë pensionistët që e kanë arritur moshën e pensionimit prej 65-vjetësh, si dhe të cilët kanë se paku 15 vjet përvojë pune)”.*
26. Parashtrueset pretendojnë se ndërprerja e pagesës ishte në kundërshtim me Marrëveshjen e nënshkruar.
27. Parashtrueset po ashtu pohojnë se është mirë e ditur që në Kosovë Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor ende nuk është

themeluar. Në anën tjetër, në rastin origjinal KI40/09, KEK-u konteston pretendimet e parashtrueseve, duke argumentuar se është mirë e ditur që Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor funksionon që nga 1 janari 2004.

28. Sipas KEK-ut, parashtrueset automatikisht mbuloheshin nga skema kombëtare invalidore, në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2003/40 për shpalljen e Ligjit për pensionet invalidore të Kosovës (Ligji Nr. 2003/23).
29. KEK-u më tej argumentoi se, më 31 gusht 2006, lëshoi një njoftim sipas të cilit përfituesit nga Fondi Suplementar i KEK-ut ishin njoftuar se Fondi ishte ndërprerë. I njëjti njoftim konfirmonte se të gjithë përfituesve u ishin garantuar pagesat e plota në pajtim me Statutin e FSP, gjegjësisht pagesa për 60 muaj ose derisa përfituesit të kenë arritur moshën 65 vjeçare, në përputhje me vendimin e Bordit Drejtues të Fondit Pensional të 29 gushtit 2006.
30. KEK-u më tej argumentoj se parashtrueset e kërkesave nuk kanë kontestuar udhëzimet për pension invalidor dhe nënshkrim për ndërprerje të parakohshme të punësimit në përputhje me konkluzionet e Komisionit Invalidor.
31. Si përmbledhje, parashtrueset pohojnë se të drejtat e tyre në pronë dhe gjykim të drejtë u janë shkelur me vendimin e KEK-ut duke anuluar në mënyrë të njëanshme marrëveshjet e tyre. Parashtrueset më tej pohojnë se nuk kanë pasur mundësi ta kundërshtojnë një shkelje të tillë në gjykatat e rregullta.

Procedura në Gjykatë

32. Ndërmjet vitit 2011 dhe qershorit 2013, parashtrueset individualisht i kanë dorëzuar kërkesat në Gjykatën Kushtetuese.
33. Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Enver Hasani dhe Ivan Čukalović.
34. Më 25 qershor 2013, Kolegji shqyrtues pasi shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesave.

Pranueshmëria e kërkesës

35. Për të gjykuar për kërkesat e parashtruesve, Gjykata Kushtetuese duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtrueset i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë.
36. Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë apeli, apo gjykatë e shkallës së katërt, për vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Sparifex [DHM], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).
37. Gjykata përkujton kriterin e pranueshmërisë, të paraparë me nenin 34 të Konventës, sipas së cilit çdo kërkesë duhet të dorëzohet nga një parashtrues, i cili mund të deklarojë se është një viktimë e shkeljes së Konventës. Një lidhje duhet të krijohet ndërmjet parashtruesit dhe dëmit, që ai/ajo kishte pësuar për shkak të shkeljes së pretenduar.
38. Në pjesën operative të vendimit, Gjykata Supreme theksoi se *"E drejta nuk mund t'i transferohet personave tjerë pasi që është një e drejtë subjektive, e lidhur ngushtë ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit dhe se kjo çështje ka të bëjë me kompensimin e përkohshëm për ndërprerjen e punësimit dhe jo me pensionin ligjor dhe prandaj fakti që Fondi i Pensionit Invalidor nuk është funksional nuk ndikon në rastin e parashtrueseve, pasi që Marrëveshja është nënshkruar me bashkëshortët e parashtrueseve (të ndjerë) prandaj sipas nenit 359 të Ligjit për Marrëdhënie Detyrimore, KEK-u nuk ka detyrime të mëtejme"*.
39. Për më tepër, neni 51 i Kushtetutës [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale], që i referohet disa nga parashtrueseve të lartpërmendura përkritazi me pensionet, thjesht thekson se *"Sigurimi social themelor, që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë, rregullohet me ligj"*. Kjo nuk do të thotë se një qytetar ka një pension apo të diktojë se si një person mund të kualifikohet për një pension.
40. Për sa i përket arsyetimit të Gjykatës Kushtetuese në aktgjykimin e saj të mëparshëm, që ka të bëjë me ish-punëtorët e KEK-ut, ky i fundit nuk mund të zbatohet te parashtrueset e tashme për shkak

se ato nuk ishin nënshkruese të Marrëveshjes me KEK-un dhe, si e tillë, është e natyrës së jotransferueshme.

41. Për më tepër, parashtrueset nuk precizojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë asnjë dispozitë kushtetuese, e cila mund të jetë shkelur me vendimin që ato e kontestojnë, pa qenë në gjendje të dëshmojnë “*statusin e viktimës sipas aktit të autoritetit publik*” siç është paraparë me nenin 34 të KEDNJ.
42. Duke shqyrtuar në tërësi të dy procedurat administrative, Gjykata Kushtetuese nuk gjen se procedurat relevante ishin në ndonjë mënyrë të padrejta ose arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub v. Lithuania, ECHR Vendimi sa i përket pranueshmërisë së Kërkesës nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
43. Si përmbledhje, parashtrueset nuk arritën të tregojnë se pse dhe si janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë. Deklarimi i thjeshtë se ka pasur shkelje të Kushtetutës nuk mund të konsiderohet si shkelje kushtetuese. Prandaj, në përputhje me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së Punës, kërkesat janë qartazi të papazuara dhe si të tilla të papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113. 7 të Kushtetutës, rregullin 36 (c) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 25 qershor 2013, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. Ky vendim do t’u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Dr. Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI83/13, Dragoljub Stankoviæ, Aktvendim i datës 20 janar 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Njoftimit Fi 21/90 lidhur me listën preliminare të punëtorëve të kualifikuar për të marrë kompensimin nga privatizimi i NSH-së „Stan/Banesa“ në Prizren, të publikuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit

Rasti KI83/13, vendimi i 20 janarit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, **mos shterje e mjeteve juridike.**

Parashtruesi i kërkesës e ka paraqitur kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 47 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Më 10 qershor 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, duke kërkuar nga Gjykata vlerësimin e kushtetutshmërisë së Njoftimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Parashtruesi në kërkesë nuk saktëson se cilat nene të Kushtetutës janë shkelur, dhe kërkon nga Gjykata realizimin e të drejtës në pjesën e të hyrave nga privatizimi i NSH „Stan/Banesa“ nga Prizreni.

Me Vendimin e Kryetarit nr. GJR. KI83/13, të 20 qershorit 2013, gjyqtari Kadri Kryeziu është caktuar si gjyqtar raportues, dhe të njëjtën ditë, me Vendimin e Kryetarit nr. KSH. KI83/13, është caktuar edhe Kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan(kryesuesi), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

Gjatë shqyrtimit të rastit, Gjykata konstatoi se kriteret për pranueshmëri nuk janë përmbushur në këtë kërkesë. Gjykata vëren se parashtruesit i kërkohej dhe i ofrohet mundësia për të dëshmuar se ai i ka shteruar të gjitha mjetet juridike, përderisa parashtruesi nuk e kishte informuar Gjykatën lidhur me procedurën sipas mjetit juridik. Arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'u ofrojë autoriteteve përkatëse, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është aspekt i rëndësishëm i natyrës subsidiare të Kushtetutës.

Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e kërkesës së parashtruar, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në seancën e 20 janarit 2014, vendosi që kërkesën ta deklarojë të papranueshme sepse nuk janë shteruar të gjitha mjetet juridike.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në**

Rastin Nr. KI83/13

Parashtrues

Dragoljub Stanković

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Njoftimit Fi 21/90 lidhur me listën preliminare të punëtorëve të kualifikuar për të marrë kompensimin nga privatizimi i NSH-së „Stan/Banesa“ në Prizren, të publikuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u dorëzua nga z. Dragoljub Stanković (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Shtërpc/Brezovicë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Njoftimin Fi 21/90 lidhur me listën preliminare të punëtorëve të kualifikuar për 20% nga të ardhurat e privatizimit të NSH „Stan/Banesa“ në Prizren, të publikuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP-ja).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Njoftimit Fi 21/90 lidhur me listën të punëtorëve, e cila, sipas parashtruesit, pretendohet t'i ketë shkelur të drejtat e tij themelore të njeriut, dhe të drejtën e punës dhe të fitimit, dhe me kërkesën e tij të dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata), kërkon

që të realizojë të drejtën në një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së „Stan/Banesa“ në Prizren.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-131 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 10 qershor 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.
6. Më 20 qershor 2013, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI83/13, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu si gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI83/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues (anëtar) dhe Ivan Čukalović (anëtar).
7. Më 2 korrik 2013, Gjykata kërkoi nga parashtruesi të plotësojë formularin zyrtar të kërkesës dhe të dorëzojë dokumente lidhur me veprimet e ndërmarra nga parashtruesi i kërkesës dhe institucionet përkatëse lidhur me listën preliminare të punëtorëve të kualifikuar për një pjesë të 20% nga të ardhurat e privatizimit të NSH „Stan/Banesa“ në Prizren, të publikuar nga AKP-ja.
8. Më 15 korrik 2013, parashtruesi dorëzoi në Gjykatë formularin e plotësuar të kërkesës, në të cilin ai e njofton Gjykatën se që nga 7 maji 2012, ai ka parashtruar kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë e Privatizimit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: DHPGJS), dhe deri më datën e dorëzimit të këtij formulari, ai nuk ka marrë asnjë përgjigje.
9. Më 27 gusht 2013, Gjykata e njoftoi DHPGJS-në për regjistrimin e kërkesës.
10. Më 29 gusht 2013, Gjykata e njoftoi AKP-në për regjistrimin e kërkesës.
11. Më 1 tetor 2013, DHPGJS-ja e dorëzoi një kopje të Aktvendimit nr. C-II-12-0016-001, të 6 gushtit 2013, kundër së cilës parashtruesi e kishte të drejtën e ankesës brenda afatit të caktuar ligjor.

12. Më 24 dhjetor 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës lidhur me përgjigjen e DHPGJS-së.
13. Më 20 janar 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Parashtruesi ishte punonjës i NSH „Stan/Banesa“ në Prizren, që nga viti 1987, i caktuar në vendin e punës si drejtor i ndërmarrjes dhe ka qëndruar në atë pozitë deri më 1999, kur për shkaqe të sigurisë u largua nga vendbanimi i tij (Prizren).
15. Më 24 korrik 2009, NSH „Stan/Banesa“ në Prizren u privatizua. AKP-ja e publikoi listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar për 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH „Stan/Banesa“ në Prizren, më 28 nëntor 2010. Afati përfundimtar për ushtrimin e ankesës në listën përfundimtare të punëtorëve DHPGJS ishte 27 nëntori 2010.
16. Më 7 maj 2012, parashtruesi ushtroi ankesë në DHPGJS kundër AKP-së, duke kërkuar që emri i tij të përfshihet në listën e punëtorëve të kualifikuar për një pjesë të 20% të të ardhurave nga privatizimi.
17. Më 16 prill 2013, DHPGJS-ja e njoftoi AKP-në për ankesën e parashtruesit.
18. Në përgjigjen ndaj DHPGJS-së, AKP-ja deklaroi se:

“Ankuesi nuk ka të drejtë për shkak të faktit se ankesa është ushtruar pas skadimit të afatit ligjor. Afati përfundimtar për dorëzimin e ankesës në DHPGJS ishte 27 nëntori 2010. Ankuesi e ka dorëzuar ankesën më 7 maj 2012. Në lidhje me këtë, Agjencia propozon që ankesa e tij të hedhet poshtë si e papranueshme”.

19. Më 6 gusht 2013, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme mori Vendimin nr. C-II-12-0016-001, kundër të cilit parashtruesi ka pasur të drejtë të ankohet brenda afatit të paraparë ligjor. Në vendimin e saj, DHPGJS-ja gjeti se:

“Ankesa në Dhomën e Posaçme ishte dorëzuar pas afatit përfundimtar të 27 nëntorit 2010. Nuk është dhënë asnjë shpjegim për atë vonesë në dorëzimin e ankesës. Gjykata gjen se provat e dorëzuara nga parashtruesi nuk i plotësojnë

kërkesat nga neni 10.6 (a), dhe prandaj, ankesa është e papranueshme, pasi që nuk është dorëzuar me kohë.

[...] MJETI JURIDIK

Në pajtim me nenin 10, paragrafi 6 i Ligjit për Dhomën e Posaçme, ankesa kundër këtij vendimi mund të dorëzohet brenda afati prej 21 (njëzet e një) ditësh. Afati ligjor fillon të llogaritet prej mesnatës së datës kur vendimi me shkrim i është dorëzuar palëve. Brenda afatit të njëjtë, Ankuesi duhet t'ua dorëzojë ankesën palëve tjera”.

Pretendimet e parashtruesit

20. Parashtruesi i kërkesës nuk saktëson se cili nen i Kushtetutës së Kosovës është shkelur me vendimin e Gjykatës Supreme, por vetëm pretendon si në vijim:

“Agjencioni Kosovar i Privatizimit me shpalljen e regjistrit të përkohshëm të punëtorëve që kanë të drejtë në pjesën e të hyrave të realizuara nga privatizimi i ndërmarrjes “Stan”-“Banesa” në Prizren e në të cilin regjistër unë nuk kam qenë, e as pjesëtarët e nacionalitetit tim, më janë janë shkelur të drejtat e mija themelore të njeriut, si e drejta e punës dhe e fitimit”.

21. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën vijuese:

“Me këtë kërkesë dëshiroj ta realizojë të drejtën në pjesën e të hyrave nga privatizimi i NSH “Stan”-“Banesa” në Prizren që më takon, duke pasur parasysh se në këtë ndërmarrje kam punuar nga viti 1987 deri në vitin 1999”.

Pranueshmëria e kërkesës

22. Në mënyrë që Gjykata të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

24. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës, i cili parasheh që:

“1. Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

a) “janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar”

25. Gjykata vëren se parashtuesi i kërkesës ishte ankuar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme kundër listës përfundimtare të AKP-së të punëtorëve të kualifikuar në një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH “Stan/Banesa”, por mbetet e panjohur nëse ai e ka dorëzuar rastin në Kolegjin për Ankesa të Dhomës së Posaçme.
26. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtuesit i kërkohet dhe i ofrohet mundësia për të dëshmuar se ai i ka shteruar të gjitha mjetet juridike, përderisa parashtuesi nuk e kishte informuar Gjykatën lidhur me procedurën sipas mjetit juridik të aktvendimit të DHPGJS-së, të paraparë me paragrafin 19 të këtij raporti.
27. Arsytimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'u ofrojë autoriteteve përkatëse, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i vendit siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është aspekt i rëndësishëm i natyrës subsidiare të Kushtetutës (shih, rastin KI41/09, parashtues AAB-RIINVEST Universiteti SHPK, Prishtinë, Aktvendimi për papranueshmëri, i 21 janarit 2010, dhe *mutatis mutandis*, shih, rastin Selmouni kundër Francës, nr. 25803/94, GJEDNJ, vendimi i 28 korrikut 1999).
28. Nga kjo rrjedh se kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme, pasi që nuk janë shteruar të gjitha mjetet juridike.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 20 janar 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe ta publikojë vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Dr. sc. Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani

KI34/14, Durrës Shahini, Aktvendim i dates 24 mars 2014 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 26/2014, të 31 janarit 2014, dhe kërkesa për vendosjen e masës së përkohshme

Rasti KI34/14, vendimi i 24 marsit 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesa individuale, kërkesë për masë të përkohshme, nuk arsyetohet *prima facie*

Objekt i çështjes së kërkesës është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 105/2010, të 29 nëntorit 2012. Në kohën kur kërkesa ishte parashtruar, parashtruesi ka qenë në paraburgim. Fillimisht, gjyqtari i procedurës paraprake urdhëroi që prania e parashtruesit të kërkesës të sigurohet përmes masës së arrestit shtëpiak. Pas ankesës së Prokurorisë Themelore, Gjykata Themelore në Prishtinë zëvendësoi masën e arrestit shtëpiak me paraburgim. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë në Gjykatën e Apelit dhe vendimin e fundit në Gjykatën Supreme. Të dy instancat, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme vërtetuan vendimin e Gjykatës Themelore, gjegjësisht vërtetuan masën e sigurimit të pranisë së parashtruesit të kërkesës përmes paraburgimit.

Parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese ku ai gjithashtu kërkoi vendosjen e masës së përkohshme. Në kërkesën e tij, parashtruesi pretendoi se aktgjykimi i kontestuar kishte shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) si dhe nenin 5 [E Drejta për Liri dhe Siguri] dhe neni 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

Gjykata Kushtetuese e refuzoi kërkesën si të papranueshme sepse ajo nuk arsyetohej *prima facie* dhe nuk kishte asnjë rast *prima facie* për shqiptimin e masës së përkohshme. Në arsyetimin e saj, Gjykata Kushtetuese konsideron se nuk aplikohen neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së siç pretendohet nga parashtruesi i kërkesës pasi që procedura ishte ende në fazën e hetimit dhe nuk ishte ngritur asnjë aktakuzë. Në lidhje me argumentet e tjera të ngritura nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata Kushtetuese iu referua "*doktrinës së shkallës të katërt*" për të përkujtuar parashtruesin e kërkesës se argumentet e ngritura prej

tij kanë të bëjnë me "ligjshmëri" e jo "kushtetutshmëri" dhe si të tilla nuk janë trajtuar nga Gjykata Kushtetuese.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI34/14
Parashtrues
Durrës Shahini
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme,
Pml. nr. 26/2014, të 31 janarit 2014, dhe kërkesa për
vendosjen e masës së përkohshme

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është z. Durrës Shahini (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me banim në Fushë-Kosovë, i përfaqësuar nga z. Artan Qerkini, avokat në Shoqërinë e Avokatëve “Sejdiu & Qerkini” në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 26/2014, të 31 janarit 2014, të cilin parashtruesi e ka pranuar të njëjtën ditë.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 26/2014, të 31 janarit 2014. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes aktgjykimit të lartpërmendur i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] dhe me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme:

Kushtetuta), si dhe me nenin 5 [E Drejta për Liri dhe Siguri] dhe me nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

4. Përveç kësaj, parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata) që të vendosë masë të përkohshme, përkatësisht të pezullojë përmbartimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme (Pml. nr. 26/2014, të 31 janarit 2014).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 22 dhe 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregullat 54, 55 dhe 56 (3) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 21 shkurt 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.
7. Më 27 shkurt 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI34/14, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin KSH. KI34/14, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.
8. Më 27 shkurt 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës si dhe kërkoi nga ai që të dorëzojë në Gjykatë: Aktvendimin e parë për caktimin e masës së paraburgimit dhe të gjitha aktvendimet e tjera pasuese. Të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi edhe Gjykatën Supreme për parashtrimin e kërkesës.
9. Më 6 mars 2014, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë të gjitha dokumentet e kërkuara.
10. Më 24 mars 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë ta deklarojë kërkesën të papranueshme dhe ta refuzojë kërkesën për masë të përkohshme.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 4 qershor 2013, gjyqtari i procedurës paraprake lëshoi Urdhëresën (PNKR. 207/2013) sipas së cilës urdhëroi Policinë e Kosovës që të kontrollojë shtëpitë dhe lokalet përcjellëse dhe të arrestojë parashtruesin dhe të dyshuarit e tjerë, për shkak të dyshimit se ka kryer veprat penale: pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar sipas nenit 283, paragrafi 1, të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPK); Lëshimi i çeqeve pa mbulesë ose të rreme dhe keqpërdorimi i kartelave të bankës apo të kreditit sipas nenit 307, paragrafi 1 të KPK-së; si dhe prodhimi, posedimi dhe tentativa e paautorizuar sipas nenit 13, paragrafi 2 dhe 3, të Ligjit Nr. 03/L-166 për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetikë.
12. Më 11 qershor 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin, PPRKR. nr. 127/13, vendosi t'ia caktojë parashtruesit të kërkesës masën e arrestit shtëpiak.
13. Më 19 qershor 2013, Gjykata e Apelit me Aktvendimin PN1. nr. 870/13 vendosi të aprovojë ankesën e Prokurorisë Themelore (PP. nr. 462/2013, të 11 qershorit 2013), dhe ndryshoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore (PPRKR. nr. 127/13, të 11 qershorit 2013), duke e zëvendësuar kështu masën e arrestit shtëpiak me masën e paraburgimit.
14. Parashtruesi është në paraburgim që nga 19 qershori 2013.
15. Më 9 janar 2014, gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës Themelore në Prishtinë me Aktvendimin, PPRKR. nr. 127/13 vendosi për vazhdimin e paraburgimit të parashtruesit të kërkesës edhe për dy (2) muaj. Sipas këtij Aktvendimi, paraburgimi i parashtruesit llogaritet prej 9 janarit 2014 e deri më 9 mars 2014.
16. Në Aktvendimin e saj, Gjykata Themelore në Prishtinë, *inter alia*, konstatoi se:

“[...]

... propozimi i Prokurorisë Themelore në Prishtinë [...] për vazhdimin e masës së paraburgimit për të pandehurin [...] është i bazuar sepse ende: ekzistojnë rrethana që tregojnë rrezikun se po të lirohet i pandehuri mund të ikë, të fshihet, të arratiset me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale dhe me këtë do të ndikonte në zvarritjen e procedurës penale, meqenëse ekziston baza e dyshimit se i pandehuri ka kryer veprat penale për të cilat parashihet dënim i rëndë që e bën

edhe më të arsyeshme vazhdimin e paraburgimit. Këto rrethana paraqesin shkaqe ligjore të parapara nga neni 187 par. 1. nën par. 1.1, 1.2.1. të KPPK-së [Kodi i Procedurës Penale të Kosovës] për vazhdimin e paraburgimit”.

17. Më 14 janar 2014, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit duke kërkuar anulimin e Aktvendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake (Aktvendimi PPRKR. nr. 127/13, i 9 janarit 2014) në mënyrë që parashtruesi të mbrohet në liri apo që Gjykata e Apelit të caktojë ndonjë masë më të butë e cila do të siguronte prezencën e parashtruesit në procedurë.
18. Më 17 janar 2014, Gjykata e Apelit në Prishtinë me Aktvendimin, PN1. nr. 89/14, e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar, dhe e vërtetoi Aktvendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake të Gjykatës Themelore (Aktvendimi PPRKR. nr. 127/13, i 9 janarit 2014).
19. Gjykata e Apelit të Kosovës konstatoi se:

“[...]

... pretendimet e bëra në ankesë nuk qëndrojnë, ngase nga shkresat e lëndës, [...] respektivisht nga provat e mbledhura deri më tani ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri është involvuar në kryerjen e veprave penale për të cilat dyshohet, e me këtë është përmbush kushti esencial për vazhdim të paraburgimit [...].

[...]

Po ashtu sipas vlerësimit të kësaj Gjykate ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit [...] sepse procedura është në fazën e hetimeve, andaj me gjetjen e tij në liri, ekziston frika e bazuar se do të mund ta pengonte rrjedhën normale të procedurës penale duke ndikuar në bashkëkryerësit e tjerë [...].

[...]

Gjykata po ashtu gjen se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit [...] ngase mënyra dhe rrethanat në të cilat dyshohet se janë kryer veprat penale, pastaj pesha e veprës penale [...] janë vepra penale për të cilat parashihet dënim kumulativë me gjobë deri

250 mijë € dhe me burgim së paku 7 vjet, e që hyn në grupin e veprave penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore [...].

[...]

Duke pasur parasysh rrethanat e lartpërmendura, kjo gjykatë konsideron se masat tjera të parapara me nenin 173 të KPPK-së janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës së pandehurit dhe parandalimit të përsëritjes së veprës penale me qëllim të zbatimit me sukses të procedurës penale, prandaj ankesa e mbrojtësit të të pandehurit u refuzua si e pabazuar [...].”

20. Më 28 janar 2014, parashtruesi parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme duke kërkuar anulimin e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit (Aktvendimi PN1. nr. 89/14, i 17 janarit 2014).
21. Më 31 janar 2014, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit, Pml. nr. 26/2014, e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.
22. Gjykata Supreme, në Aktgjykimin e saj, përfundoi si në vijim:

“[...]

Duhet theksuar se zvarritja e procedurës nga prokuroria e shtetit për të cilën pretendon mbrojtësi, nuk mund të kontestohet me këtë mjet të jashtë zakonshëm juridik. Meqë në rastin konkret çështja penale është ende në fazën e hetimeve, ndërsa pritet që gjatë fazave të ardhshme të procedurës penale të qartësohen të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me rastin konkret dhe me të pandehurin konkret. Edhe sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, qëndron baza ligjore për vazhdimin e paraburgimit siç me të drejtë kanë vlerësuar gjykata e shkallës së dytë, si dhe kanë dhënë arsyje të mjaftueshme mbi bazën ligjore për të cilën ia kanë vazhduar paraburgimit të pandehurit [...].”

Për shkak të rrethanave të lartcekura, dalin të pabazuara edhe pretendimet e mbrojtësit të të pandehurit edhe në lidhje me ndërprerjen e paraburgimit apo caktimit të ndonjë mase alternative [...], është e pamjaftueshme zhvillimin dhe për rrjedhën normale dhe të papenguar të procedurës penale për fazën në të cilën ndodhet procedura penale”.

23. Duke u bazuar në shkresat e lëndës, në këtë fazë, ende nuk është ngritur një aktakuzë.

Pretendimet e parashtruesit

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi, Pml. nr. 26/2014, i Gjykatës Supreme i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht me nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 5 [E Drejta për Liri dhe Siguri] dhe nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të KEDNJ-së.
25. Sa i përket shkeljes së pretenduar të nenit 29 të Kushtetutës dhe nenit 5 të KEDNJ-së, parashtruesi thekson se vendimi për vazhdim të paraburgimit ka rrjedhë si pasojë e zvarritjes së procedurës nga prokurori, i cili, sipas parashtruesit, *“... tek pas 5 muajve ka kuptuar se nuk është kompetent ta hetojë rastin dhe ia ka transferuar Prokurorisë Speciale”*. Lidhur me këtë pikë, parashtruesi pretendon se *“Gjykata e Apelit, në aktvendimin e saj, nuk ka trajtuar këtë pretendim të mbrojtjes fare, duke mos e njoftuar atë me shkrim mbi arsyet e privimit përtej mënyrës së përcaktuar me ligj (KPPK).”* Më tutje, parashtruesi konsideron se: *“... dështimi i Gjykatës Supreme për t’ia bërë këtë njoftim me shkrim Parashtruesit të Kërkesës se pse zvarritja e procedurës nuk po i atribuohet prokurorit, i ka cenuar atij të drejtën për liri dhe siguri që i garantohet me Nenin 29 të Kushtetutës”*.
26. Në lidhje me shkeljen e pretenduar nga parashtruesi i kërkesës të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës pohon se Gjykata Supreme i ka cenuar atij të drejtën e garantuar me nenin 31.2 të Kushtetutës, sepse *“Gjykata Supreme ka pasur obligim të mos aprovojë vazhdimin e paraburgimit përtej afatit 8-mujor, ose së paku, të arsyetojë se pse ky vazhdim nuk mund ti atribuohet prokurorit”*.
27. Parashtruesi, përveç kërkesës për të anuluar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 26/2014, të 31 janarit 2014, kërkon që Gjykata të vendosë masë të përkohshme që *“... pezullon zbatimin e aktgjyqimit të sfiduar të Gjykatës Supreme deri në shpalljen e aktgjyqimit të Gjykatës Kushtetuese në këtë rast;”*.
28. Parashtruesipërfundon duke kërkuar nga Gjykata që:

“ - Kërkesën e Paraqitësit të Kërkesës ta konstatojë të pranueshme;

- Duke pasur parasysh shkeljet serioze të të drejtave kushtetuese gjatë procedurës penale dhe dëmit të pariparueshëm që do të shkaktonte vazhdimi i qëndrimit të Paraqitësit të Kërkesës në paraburgim, të lëshojë aktvendim për masë të përkohshme në Përputhje me Nenin 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe Neneve 54 dhe 55 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, që pezullon zbatimin e sfiduar të Gjykatës Supreme deri në shpalljen e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në këtë rast;

- Të urdhërojë lirimin e menjëhershëm të Paraqitësit të Kërkesës nga paraburgimi,

- Të konstatojë cenimin e të drejtave individuale të Parashtruesit të garantuara me Nenet 29 dhe 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe Nenet 5 dhe 6 të Konventës Evropiane, si rezultat i shkeljeve nga Gjykata Supreme të një mori të drejtash të garantuara për Paraqitësin e Kërkesës me këto instrumente dhe Kodin e Procedurës Penale të Kosovës; dhe

- Të përcaktojë qfarëdo mase tjetër juridike që kjo Gjykatë e nderuar e vlerëson si të bazuar juridikisht dhe të arsyeshme.”

Pranueshmëria e kërkesës

29. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

30. Në këtë drejtim, neni 113, paragrafi 7, i Kushtetutës parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

31. Përveç kësaj, neni 49 i Ligjit parasheh se *“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”.*

32. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Pml. nr. është nxjerrë më 31 janar 2014 dhe se parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesën e tij në Gjykatë më 21 shkurt 2014.

33. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh se:

(3) *“Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: (c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar.”*

(4) *“Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie”.

34. Në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme ka shkelur obligimet e saj që dalin nga neni 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] dhe nga neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës, si dhe nga neni 5 [E drejta për liri dhe siguri] dhe nga neni 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të KEDNJ-së kryesisht për shkak se ka miratuar vazhdimin e paraburgimit përtej afatit prej tetë muajsh.

35. Përkitazi me pretendimin e parashtruesit për shkeljen e nenit 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], Kushtetuta përcakton:

“29.1. Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente, si në vijim:

[...]

(2) për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një vepre tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjyqimit në mënyrën e përcaktuar me ligj;

[...].”

36. Në këto rrethana, Gjykata, vëren se, Gjykata Supreme ka arsyetuar vendimin e saj, si me poshtë:

“[...]

Edhe sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, qëndron baza ligjore për vazhdimin e paraburgimit siç me të drejtë kanë vlerësuar gjykata e shkallës së dytë, si dhe kanë dhënë arsye të mjaftueshme mbi bazën ligjore për të cilën ia kanë vazhduar paraburgimit të pandehurit [...].

Për shkak të rrethanave të lartcekura, dalin të pabazuara edhe pretendimet e mbrojtësit të të pandehurit edhe në lidhje me ndërprerjen e paraburgimit apo caktimit të ndonjë mase alternative [...], është e pamjaftueshme zhvillimin dhe për rrjedhën normale dhe të papenguar të procedurës penale për fazën në të cilën ndodhet procedura penale”.

37. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Gjykata Supreme dhe gjykatat e instancave më të ulëta kanë arsyetuar vendimet e tyre për sa i përket vazhimit të paraburgimit të parashtruesit të kërkesës.
38. Gjykata po ashtu vëren se ajo që parashtruesi ngre çështje të ligjshmërisë, e jo të kushtetutshmërisë.
39. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë (kushtetutshmërinë).
40. Gjykata Kushtetuese nuk mund ta zëvendësojë rolin e gjykatave të rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse, si të së drejtës procedurale, ashtu edhe të asaj materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih, gjithashtu rastin KI70/11 të parashtruesve Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
41. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se arsyetimet e dhëna në vendimet e instancave më të ulëta dhe të Gjykatës Supreme për ta hedhur poshtë kërkesën e parashtruesit, për mbrojtje në liri apo zëvendësim të paraburgimit me ndonjë masë tjetër alternative, janë të qarta. Për më tepër, Gjykata gjen se procedurat e gjykatave të rregullta nuk ishin të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

42. Në të vërtetë i mbetet gjykatave të përcaktojnë nëse, në bazë të rrethanave të rastit, kohëzgjatja e paraburgimit ka tejkaluar kufirin e arsyeshëm. Me fjalë tjera, gjykatat kanë pushtet për të vendosur se çfarë është e arsyeshme në rrethanat e caktuara (shih, *mutatis mutandis*, Wemhoff kundër Gjermanisë, 7 GJEDNJ (ser. A) tek 23, 1968). Në rastin e tanishëm, arsyet e prokurorisë dhe gjykatave për të arsyetuar vazhdimin e paraburgimit i referohen peshës së veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës, rrezikut të ikjes të apo përsëritjes së veprës, apo kryerjes së ndonjë vepre të ngjashme nga parashtruesi i kërkesës. Këto arsye duken që i atribuohen ndërlikueshmërisë së rastit, duke i bërë kësaj Gjykate të pamundur vlerësimin që zvarritja e procedurave është e paarsyeshme (shih, *mutatis mutandis*, Boddaert kundër Belgjikës, Ap. Nr. 12919/87, miratuar më 12 tetor 1992 dhe shih rastin KI20/13, parashtrues Rifat Osmani, Aktvendim për papranueshmëri i 12 marsit 2013).
43. Duke iu referuar shkeljeve të pretenduara lidhur me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës më tutje pohon se Gjykata Supreme i ka cenuar atij të drejtën e garantuar me nenet e lartcekura sepse “*Gjykata Supreme ka pasur obligim të mos aprovojë vazhdimin e paraburgimit përtej afatit 8-mujor, ose së paku, të arsyetojë se pse ky vazhdim nuk mund ti atribuohet prokurorit*”.
44. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet kuptimit të akuzës penale, të zhvilluar nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, sipas të cilës përcaktohet se “*është njoftimi zyrtar që i jepet një individ nga autoriteti kompetent me një pretendim se ai ka kryer një vepër penale ose ndonjë veprim tjetër i cili bart implikimin e një pretendimi të tillë dhe i cili gjithashtu ndikon në thelb në situatën e të dyshuarit*” (shih, Corgliano kundër Italisë, App. nr 8309/78, GJEDNJ, Aktgjykimi i 10 dhjetorit 1982, par. 34).
45. Gjykata më tej vëren se procedura hetimore është në zhvillim e sipër dhe aktakuza nuk është ngritur ende. Gjykata nuk mund të pajtohet me argumentin e parashtruesit në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe për këtë arsye Gjykata konsideron se bazuar në rrethanat e kërkesës dhe fazën e procedurës, neni 6 i KEDNJ-së nuk është i aplikueshëm siç pretendohet nga parashtruesi i kërkesës.
46. Bazuar në arsyetimin e lartcekur dhe duke iu referuar fazës së tanishme të procedurës, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit nuk është arsyetuar *prima facie*.

47. Prandaj, Gjykata përfundon se kërkesa është e papranueshme.

Kërkesa për masë të përkohshme

48. Parashtruesi gjithashtu kërkon nga Gjykata që të shqiptojë masë të përkohshme, për të pezulluar Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme dhe për të urdhëruar lirimin e menjëhershëm të parashtruesit të kërkesës nga paraburgimi.
49. Në këtë drejtim, parashtruesi pretendon se kjo është e domosdoshme *“duke pasur parasysh shkeljet serioze të të drejtave kushtetuese gjatë procedurës penale dhe dëmit të pariparueshëm që do të shkaktonte vazhdimi i qëndrimit të Paraqitësit të Kërkesës në paraburgim”*.
50. Në mënyrë që Gjykata të lejojë një masë të përkohshme, në pajtim me rregullin 55 (4) të Rregullores së punës, ajo duhet të përcaktojë se:

“(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

[...]

Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do ta rekomandojë refuzimin e kërkesës”.

51. Siç u konstatua më lart, kërkesa është e papranueshme dhe, për këtë arsye, nuk ka rast *prima facie* për shqiptimin e masës së përkohshme. Për këto arsye, kërkesa për masë të përkohshme refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 27 të Ligjit dhe rregullat 36 (2) a) dhe 55 (4) të Rregullores së punës, më 24 mars 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Prof. Dr. Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI43/13, Selam Shoshaj dhe Bashkim Krasniqi, Aktvendim i datës 17 tetor 2013 - Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 31/2013, të 13 marsit 2013

Rasti KI43/13, vendimi i 17 tetorit 2013.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, qartazi e pabazuar.

Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr 31/2013, i 13 marsit 2013. Në kohën kur kërkesa ishte parashtruar, parashtruesit ishin në paraburgim sipas aktakuzës së ngritur nga Prokuroria Publike e Qarkut në Prizren nën dyshimin se kishin kryer veprën penale të rrëmbimit në bashkëkryerje. Gjykata Themelore në Prizren urdhëroi paraburgimin e parashtruesve të kërkesës. Ata parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit në Prizren kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore dhe kundër Aktvendimit të kësaj të fundit në Gjykatën Supreme. Të dyja shkallët, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme vërtetuan Vendimin e Gjykatës Themelore duke vlerësuar se paraburgimi, siç ishte urdhëruar nga Gjykata Themelore në Prizren, ishte i ligjshëm.

Parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese me pretendimin se aktgjykimi i kontestuar kishte shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 29 [E Drejta për Liri dhe Siguri] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), si dhe nenin 5 [E Drejta për Liri dhe Siguri] dhe nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

Gjykata Kushtetuese deklaroi kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar. Në arsyetimin e saj, Gjykata Kushtetuese gjeti se gjykatat e rregullta i respektuan plotësisht të drejtat e parashtruesve të kërkesës të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ dhe se parashtruesit e kërkesës nuk kanë dorëzuar ndonjë provë *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në**

Rastin Nr. KI43/13

Parashtrues

Selam Shoshaj dhe Bashkim Krasniqi

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme të Kosovës, Pml. nr. 31/2013, të 13 marsit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues janë z. Selam Shoshaj dhe z. Bashkim Krasniqi nga Prizreni, të cilët në Gjykatën Kushtetuese përfaqësohen nga avokati z. Bashkim Nevzati nga Prizreni.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 31/2013, i 13 marsit 2013, me të cilin refuzohet si e pabazuar kërkesa e parashtruesve për mbrojtjen e ligjshmërisë, e parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Kpn. nr. 254/2012, të 15 shkurtit 2013, dhe të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Kp. nr. 122/2013, të 25 shkurtit 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është procedura penale, gjatë së cilës parashtruesit ishin mbajtur në paraburgim pas aktakuzës, por para gjykimit për veprën penale të rrëmbimit të personit, nga neni 159, paragrafi 2, në lidhje me paragrafin 1 dhe nenin 23 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPPK).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121(në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 28 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 25 mars 2013, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 28 mars 2013, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. 43/13, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. 43/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 17 tetor 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Më 8 maj 2009, Prokuroria Publike e Qarkut në Prizren, me Aktakuzën PP. nr. 250/2012m i kishte akuzuar parashtruesit për kryerjen e veprës penale rrëmbim në bashkëkryerje nga neni 159 paragrafi 2 në lidhje me paragrafin 1 të nenit 23 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.
9. Parashtruesit dhe katër të pandehurit e tjerë akuzoheshin për rrëmbimin e organizuar të G. S. në Prizren më ose rreth 14 shtatorit 2011, dhe mbajtjen e viktimës derisa anëtarët e familjes së tij e paguan shumën prej 100,000 eurosh për lirimin e tij. Përpara se shuma të paguhej, familjes së viktimës i ishin bërë disa thirrje telefonike dhe ata ishin kërcënuar të gjithë. Pas pagimit të shumës, në mëngjesin e 19 shtatorit 2011, viktimë ishte liruar.
10. Tre nga të pandehurit, B. P., B. D., dhe F. R., akuzoheshin për ndihmë parashtruesve në kryerjen rrëmbimit të organizuar, duke shërbyer si vëzhgues, derisa ishte kryer rrëmbimi, duke fshehur prova dhe duke u ofruar mbështetje morale parashtruesve.

11. Dy nga të pandehurit, B. P. dhe E. X., gjithashtu akuzoheshin për veprën e mbajtjes së paautorizuar të armëve.
12. Me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren, P. nr. 124/2012, të 15 shkurtit 2013, parashtruesit u mbajtën në paraburgim për dy muaj. Gjykata Themelore kishte gjetur se ekzistonte dyshimi i bazuar se parashtruesit e kishin rrëmbyer viktimën dhe e kishin mbajtur derisa ishte paguar shuma e të hollave për lirimin e tij disa ditë më vonë. Gjykata kishte konkluduar se ky ishte një krim i rëndë dhe se parashtruesit mund të burgoseshin, nëse më vonë do të shpallehin fajtorë. Gjykata Themelore gjithashtu konstatoi se kryesit e këtij krimi e kishin kërcënuar sigurinë e viktimës dhe familjes së tij si dhe të qytetarëve të tjerë. Për shkak të mënyrës së guximshme në të cilën ky krim ishte kryer, Gjykata Themelore konkludoi se ekzistonte mundësi e madhe që parashtruesit mund ta kryejnë këtë krim përsëri, në qoftë se ata nuk do të ishin në paraburgim. Gjykata gjithashtu gjeti se për shkak të mundësisë së dënimit me burgim të gjatë, në qoftë se parashtruesit do të ishin dënuar për këtë veprë, do të ekzistonte një rrezik serioz që parashtruesit të fshiheshin apo të iknin, në qoftë se ata do të lroheshin nga paraburgimi.
13. Gjykata e Apelit, në Aktvendimin Kp. nr. 122/2013, të 25 shkurtit 2013, e refuzoi ankesën e parashtruesve dhe gjeti se ekzistonte dyshimi i bazuar se parashtruesit kishin kryer veprë penale dhe se Gjykata Themelore ofroi arsye të mjaftueshme për t'i mbajtur parashtruesit në paraburgim dhe se ekzistonte frika e arsyeshme që parashtruesit mund të iknin për shkak të dënimit të gjatë që mund të shqiptohej kundër tyre.
14. Gjykata Supreme e Kosovës, në Aktgjykimin Pml. nr. 31/2013, të 13 marsit 2013, e refuzoi kërkesën e parashtruesve për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P. nr. 124/2012, të 15 shkurtit 2013, dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Kp. nr. 122/2013, të 25 shkurtit 2013. Gjykata Supreme gjeti në mënyrë specifike se ato gjykata nuk e kanë shkelur supozimin e pafajësisë që parashtruesit e kanë si të pandehur në këto procedura. Gjykata Supreme gjithashtu gjeti se ato gjykata thjeshtë gjetën se në bazë të procedurave gjyqësore dhe provave të paraqitura paraprake ekzistonte “*dyshimi i bazuar*,” e jo “*prova përtej dyshimit të bazuar*,” se parashtruesit ishin të përfshirë në veprën penale, për të cilën mentalisht janë duke u gjykuar. Gjykata Supreme gjeti në mënyrë specifike se mbetet ende për t’u përcaktuar në fund të gjykimit se a ekzistonte dëshmia

përtej dyshimit të bazuar se parashtruesit ishin fajtorë për krimin, siç akuzoheshin ata. Gjykata Supreme gjithashtu gjeti se neni 189 i Kodit të Procedurës Penale kërkon nga gjykatat e ulëta që të vendosin lidhur me kërkesën për paraburgim brenda 48 orësh nga paraqitja e ankesës. Gjykata gjeti se nuk kishte asnjë provë se gjykatat e ulëta kishin vepruar pa shqyrtimin e të gjitha provave në çështjen nëse duhej që parashtruesit të mbaheshin në paraburgim në pritje të procedurës së gjyqimit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesit pretendojnë se gjykatat e rregullta kishin shkelur nenin 5 [E Drejta për Liri dhe Siguri] dhe nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut, nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 29 [E Drejta për Liri dhe Siguri] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), duke dështuar të prezumojnë se ata janë të pafajshëm ndaj akuzave të paraqitura kundër tyre në këtë fazë të procedurës penale, gjatë marrjes së vendimeve për paraburgimin dhe për dështimin e shqyrtimeve të detajuara në vendimet e tyre.
16. Parashtruesit akuzojnë gjykatat e rregullta se thjeshtë u angazhuan në praktikën “*copy dhe paste*” në lidhje me mënyrën e arritjes së vendimeve të tyre në lidhje me paraburgimin dhe gjoja dështuan të shpjegojnë pse situata e tyre në lidhje me paraburgimin është ndryshe nga ajo e të pandehurve të tjerë në këtë rast.

Pranueshmëria e kërkesës

17. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesve, Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesit i kanë përmbushur të gjitha kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
18. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

19. Gjykata gjithashtu i referohet neneve 47 dhe 48 të Ligjit. Neni 47 (2) i Ligjit parashikon që:

“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

20. Neni 48 i Ligjit po ashtu parashikon:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

21. Gjithashtu, rregulli 36 (1) a), b) dhe c), dhe (2) a) dhe d) i Rregullores së punës parashikojnë që:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

a) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar;

b) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi; ose

c) kërkesa nuk është qartazi e bazuar.

(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie;

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

22. Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk i kanë përmbushur kushtet e pranueshmërisë për arsyet si në vijim.

23. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e apelit, kur shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është që të interpretojnë ligjin dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr.

30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).

24. Për më tepër, neni 29 i Kushtetutës parasheh në pjesën përkatëse:

1. Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe e sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente, si në vijim:

[...]

(2) për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një veprë tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjykimit në mënyrën e përcaktuar me ligj;

[...]

25. Gjithashtu, neni 5 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) në pjesën përkatëse parasheh:

1. “Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t’i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj:

[...]

Kur është arrestuar dhe paraburgosur për t’u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent, kur ka arsye të besueshme për të dyshuar se ai ka kryer një vepër penale ose kur ka motive të arsyeshme për të besuar se është e domosdoshme që të pengohet të kryejë një vepër penale ose të largohet pas kryerjes së saj”.

26. Në dritën e këtyre dispozitave, Gjykata vëren se, në rastin konkret, tri gjykatat e rregullta të Kosovës konstatuan se kishte dyshim të bazuar se parashtruesit mund të jenë përfshirë në akuzat penale, të paraqitura kundër tyre dhe gjetën se në këto rrethana dhe prova para tyre privimi nga liria ishte i nevojshëm për të parandaluar kryerjen e ndonjë veprë tjetër penale. Po të njëjtat gjykata nuk gjetën se për të pandehurit e tjerë të parashtruesve është i nevojshëm paraburgimi paraprak, sepse rrethanat dhe pjesëmarrja e dyshuar e tyre në krimin e dyshuar ishte më pak serioze se ajo e

parashtruesve dhe me më pak gjasa që ata të kryenin ndonjë krim tjetër dhe/ose të ikin.

27. Për më tepër, neni 31 i Kushtetutës parasheh në pjesën përkatëse:

“Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin [...]”.

ndërsa neni 6 i KEDNJ në pjesën përkatëse me fjalë të ngjashme parasheh:

“Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërish”.

28. Në rastin në shqyrtim, tri gjykatat e rregullta të Kosovës, duke përfshirë Gjykatën Supreme të Kosovës, i respektuan rregullat e procedurës penale dhe i nxorën vendimet e veta lidhur me paraburgimin e vazhduar në bazë të dyshimit të bazuar se parashtruesit mund të kenë kryer krimin, siç akuzohen. Këto gjykata asnjëherë nuk kanë prezumuar se parashtruesit ishin fajtorë. Në të vërtetë, Gjykata Supreme qartë deklaroi se parashtruesit konsideroheshin të pafajshëm dhe se vendimi final në rastin e tyre mund të jetë *“të pafajshëm”*.
29. Përveç kësaj, parashtruesit nuk kanë dorëzuar ndonjë provë *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese (shih, Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, të 31 majit 2005).
30. Në të vërtetë, gjykatat e rregullta bënë gjetjet specifike se:
- a. ekzistonte dyshimi i bazuar se parashtruesit mund të kenë kryer veprën penale, për të cilën ata akuzohen;
 - b. ekzistonte dyshimi i bazuar se, nëse nuk burgosen, parashtruesit mund të ikin ose të kryejnë ndonjë vepër tjetër penale; dhe
 - c. këto gjetje u bënë, duke e ditur se parashtruesit ende supozohen të pafajshëm ndaj akuzave të paraqitura kundër tyre.

31. Duke vepruar në këtë mënyrë, rrjedhimisht gjykatat e rregullta i respektuan plotësisht të drejtat e parashtruesve, sipas Kushtetutës dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
32. Në këto rrethana, Gjykata konkludon se kërkesa nuk i plotëson kriteret e pranueshmërisë, pasi që ajo dështoi të paraqes dhe të mbështesë me prova pretendimin që aktgjykimi i kontestuar ua ka shkelur të drejtat dhe liritë e tyre.
33. Nga kjo rezulton se kërkesa është qartazi e pabazuar në përputhshmëri me rregullin 36 (2) b), i cili përcakton se:

“Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...] faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, neneve 47 dhe 48 të Ligjit, dhe në mbështetje të rregullit 36 (1) c) dhe rregullit 56 (2) të Rregullores së punës, më 17 tetor 2013, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI134/13, Shaban Puka, Aktvendim i datës 11 mars 2014 - Vlerësim i Kushtetushmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, SCEL-10-00013 të 26 dhjetorit 2012, dhe Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme, AC-I-13-0004, të 22 gushtit 2013

Rasti KI134/13, vendimi i 11 marsit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesa individuale, 20% nga privatizimi, qartazi e pabazuar.

Parashtreusi i kërkesës parashtroi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke e kontestuar Aktgjykimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, SCEL-10-00013, i cili pretendohet t'i ketë shkelur të drejtat e tij të njeriut, siç garantohen me Kushtetutë. Megjithatë, parashtruesi nuk saktësoi se cilat dispozita kushtetuese pretendohet të jenë shkelur.

Më 23 korrik 2007, Ndërmarrja shoqërore “Koopërativa Bujqësore – Ferizaj” (në tekstin e mëtejme NSH- Ferizaj) ishte privatizuar. Më 1, 2 dhe 3 shtator 2010, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP-ja) publikoi listën përfundimtare të punëtorëve me të drejta legjitime në 20 % të të ardhurave nga privatizimi.

Më 5 korrik 2011, parashtruesi ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme, që të përfshihej në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejtë legjitime. Afati i fundit për të paraqitur ankesë ishte 27 shtatori 2010, përderisa parashtruesi ushtroi ankesë më 5 korrik 2011.

Duke i shqyrtuar pretendimet e parashtrësit të kërkesës, lidhur me vlerësimin e kushtetushmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, SCEL-10-00013. të 26 dhjetorit 2012, dhe Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme, AC-I-13-0004, të 22 gushtit 2013, Gjykata Kushtetuese vëren se parashtruesi nuk i ka respektuar afatet e parapara me dispozitat ligjore të Rregullores nr. 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore, të cilat janë të zbatueshme në rastin e tij. Parashtruesit i është dhënë mundësia, por ai nuk arriti të ofrojë arsyetim të pranueshëm për vonesat e tij.

Lidhur me pretendimet tjera të parashtrësit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese konstatoi se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk arsyetojnë pretendimin për shkelje të të drejtave të tij kushtetuese dhe se nuk e ka aryetuar mjaftueshëm pretendimin e tij. Prandaj, Gjykata konstatoi se se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk arsyetojnë pretendimin për shkelje të të drejtave të tij kushtetuese, prandaj kërkesa e tij është qartazi e pabazuar.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në**

Rastin nr. KI134/13

Parashtrues

Shaban Puka

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit SCEL-10-00013,
të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, të 26 dhjetorit
2012, dhe Aktgjykimit AC-I-13-0004 të Kolegjit të Ankesave të
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të 22 gushtit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u dorëzua nga z. Shaban Puka (në tekstin e mëtejme: parashtruesi), me vendbanim në fshatin Pleshinë, komuna e Ferizajt.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin SCEL-10-00013, të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, të 26 dhjetorit 2012, i cili është vërtetuar me Aktgjykimin AC-I-13-0004 të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, të 22 gushtit 2013.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit SCEL-10-00013, të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, i cili pretendohet t'i ketë shkelur të drejtat e tij të njeriut, siç garantohen me Kushtetutë. Megjithatë, parashtruesi nuk saktësoi se cilat dispozita kushtetuese pretendohet të jenë shkelur.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 2 nëntor 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 29 dhjetor 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. KI134/13 caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, me Vendimin Nr. KSH. KI134/13, Kryetari caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 11 tetor 2013, parashtruesi ishte njoftuar për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 4 nëntor 2013, parashtruesit i ishte kërkuar të ofrojnë dokumente shtesë në Gjykatë, të cilat ishin përmendur në kërkesë, edhe pse nuk ishin bashkëngjitur. Parashtruesi nuk i ishte përgjigjur kësaj kërkesë.
9. Të njëjtën ditë, Gjykata kërkoi informata shtesë nga Dhoma e Posaçme në lidhje me kërkesën e parashtruesit.
10. Më 3 dhjetor 2013, Gjykata i pranoi informatat e kërkuara nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme.
11. Më 13 mars 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues Altay Suroy, Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova(kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi, i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 23 korrik 2007, Ndërmarrja shoqërore “Kooperativa Bujqësore – Ferizaj” (në tekstin e mëtejme NSH– Ferizaj) ishte privatizuar.
13. Më 1, 2 dhe 3 shtator 2010, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP-ja) publikoi listën përfundimtare të punëtorëve me të drejta legjitime në 20 % të të ardhurave nga privatizimi.
14. Më 5 korrik 2011, parashtruesi ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme, që të përfshihej në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejtë legjitime.
15. Në vërejtjen e saj me shkrim, AKP-ja ka kërkuar nga Dhoma e Posaçme që të refuzojë ankesën si të pabazuar, sepse ankesa është dorëzuar pas më shumë se 20 ditëve pas publikimit të listës së punëtorëve me të drejtë legjitime. Afati i fundit për të paraqitur ankesë ishte 27 shtatori 2010, përderisa parashtruesi ushtroi ankesë më 5 korrik 2011.
16. Më 14 shtator 2011, Dhoma e Posaçme i dërgoi parashtruesit vërejtjen me shkrim të AKP-së dhe kërkoi nga parashtruesi që t'i shpjegojë arsyet e paraqitjes me vonesë të ankesës.
17. Më 26 dhjetor 2012, Dhoma e Posaçme mori Aktgjykimin SCEL-10-00013, në të cilin, ndër të tjera, theksoi:

“Ankesa e Shaban Pukës (Ankuesi COOO5) është e papranueshme; sepse është parashtruar pas afatit për parashtrimin e ankesave. Data e fundit për paraqitje të ankesës në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit ka qenë 27 shtator 2010, ndërsa ankesa e ankuesit është paraqitur me 5 korrik 2011. Afati për kthimin në gjendje të mëparshme që parashihet me Ligjin mbi Procedurën Kontestimore, po ashtu kishte kaluar deri në kohën e paraqitjes së ankesës. Ankuesi (0005) në seancë por edhe në deklaratën e tij ka cekur se arsyeja për vonesën në paraqitjen e ankesës është e natyrës shëndetësore pasi që në kohën e publikimit të listës përfundimtare të punëtorëve me të drejta legjitime ai ka qenë në Prevallë për tu shëruar sipas udhëzimeve të mjekëve”.

[...]

„Kolegji i specializuar nuk mund të konsiderojë si arsye të mjaftueshme deklaratën e Ankuesit; data e publikimit të fundit është 04 shtator 2010 ndërsa Ankesa është parashtruar pas një kohe shumë të gjatë më 05 Korrik 2011, pas me tepër se (7) muaj“.

18. Në letrën e 4 nëntorit 2013, Gjykata kërkoi nga Dhoma e Posaçme si në vijim:

“Në kërkesën e tij, z. Puka ka bashkëngjitur edhe ankesën që ka parashtruar kundër vendimit SCEL-10-00013, mirëpo nuk ka ofruar informata nëse Kolegji i Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës ka vendosur në ankesën e tij.

Në mënyrë që Gjykata Kushtetuese të vendosë në kërkesën e z. Puka, ju lusim që të ofroni informatat dhe dokumentet e nevojshme përkritazi me hapat eventuale të ndërmarrë nga Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme”.

19. Në përgjigjen ndaj kërkesës së Gjykatës për informata shtesë, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme përcaktoi se:

“Në këtë rast, kanë parashtruar ankesë 5 ankues, kundër Aktgjykimit të Kolegjit të specializuar SCEL-10-0013, të 26 dhjetorit 2012. Në mesin e ankuesve ka qenë edhe ankuesi Shaban Puka, nga fshati Pleshinë, KK Ferizaj. Me Aktgjykimin AC-I-13-000, të Kolegjit të Ankesave, të datës 22 gusht 2013, tre ankesa janë aprovuar si të bazuara, ndërsa dy të tjera si pabazuara, siç është rasti edhe me z. Puka.

Në shkallën e parë, ankesa e z. Puka ishte hedhur si e paafatshme, ndërsa në ankesën në shkallën e dytë, ankuesi Shaban Puka nuk e ka arsyetuar me asnjë dëshmi se pse nuk e ka parashtruar ankesën në afatin r paraparë ligjor.

Afati i fundit për parashtrimin e ankesës ishte 27 shtatori 2010, ndërsa ankesa ishte parashtruar më 5 korrik 2011.

Pra, Kolegji i Ankesave ka vendosur dhe është e konfirmuar i është dorëzuar ede z. Puka”.

Ligji**RREGULLORE NR. 2003/13 MBI TRANSFORMIMIN E SË DREJTËS PËR PËRDORIMIN E PRONËS SË PATUNDSHME NË PRONËSI SHOQËRORE**

“10.6 Pas paraqitjes së kërkesës nga individë apo individët me të drejtë të cenuar, ankesa lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime, e përcaktuar nga Agjencia dhe shpërndarja e fondeve nga llogaria e garancimbajtjes e paraparë në paragrafin 10.5, i nënshtrohet shqyrtimit nga Dhoma e Posaçme, në pajtim me nenin 4.1 (g) të Rregullores 2002/13”.

(a) Ankesa duhet të dorëzohet në Dhomën e Posaçme brenda 20 ditëve pas shpalljes përfundimtare në media nga Agjencia, në bazë të paragrafit 10.3, të listës së të punësuarve me të drejta legjitime. Dhoma e Posaçme shqyrton çfarëdo ankese në bazë të përparësisë dhe merr vendim për këto ankesa brenda 40 ditëve pas dorëzimit të tyre”.

Pretendimet e parashtruesit

20. Parashtruesi nuk thirret në asnjë shkelje kushtetuese në veçanti, por ai pretendon: *“Dëshiroj të më njihet e drejta 20% e privatizimit të cilën e kanë gëzuar shokët e mi”.*

Pranueshmëria e kërkesës

21. Gjykata vëren që, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit të kërkesës, duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore.
22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:
- “Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*
23. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës as nuk i ka përshkruar faktet e rastit dhe as nuk i ka mbështetur ankesat e tij. Në vend të

kësaj, ai vetëm ka pretenduar se dëshiron të përfshihet në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejtë legjitime, në mënyrë që të marrë pjesën e 20% që i takon nga të ardhurat e privatizimit të NSH - Ferizaj.

24. Në këtë drejtim, Gjykata merr parasysh rregullin 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:c) kërkesa është qartazi e bazuar”.

25. Gjykata Kushtetuese vëren se parashtruesi nuk i ka respektuar afatet e parapara me dispozitat ligjore të Rregullores nr. 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore, të cilat janë të zbatueshme në rastin e tij. Parashtruesit i është dhënë mundësia, por ai nuk arriti të ofrojë arsyetim të pranueshëm për vonesat e tij.
26. Prandaj, Gjykata konsideron se nuk ka asgjë në kërkesë që tregon se rastit i mungonte paanshmëria, ose që procedurat ishin në ndonjë mënyrë të padrejta (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).
27. Si përfundim, parashtruesi i kërkesës as nuk e ka ndërtuar rastin mbi shkeljet e ndonjë të drejte të tij, të garantuar me Kushtetutë dhe as nuk ka paraqitur ndonjë provë *prima facie* për një shkelje të tillë (shih, Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, të 31 majit 2005).
28. Nga kjo rrjedh se kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, më 11 mars 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI190/13, Ansambli “Shqiponjat e Dukagjinit”, Gjakovë, Aktvendim i datës 14 mars 2014 - Vlerësim i Kushtetutshmërisë së aktit përcjellës të kryetarit të Komunës së Gjakovës, të 8 nëntorit 2011

Rasti KI190/13, vendimi i 14 marsit 2014.

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, mos shterje e mjeteve juridike.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i DKRS-së të Komunës së Gjakovës ka shkelur nenet 23, 26, 27, 48, 50 dhe 55 të Kushtetutës së Kosovës.

Parashtruesi i kërkesës ka kërkuar nga “Gjykata Kushtetuese e Kosovës si arbitri më i lartë kushtetues për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut që ta kthej drejtësinë në vend dhe... kompensim moral dhe material në rast se na takon”.

Gjykata, në këtë drejtim, konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar dëshmi se ka shteruar të gjitha mjetet efektive juridike para se t’i drejtohej me këtë kërkesë Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe me rregullin 36 dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 14 mars 2014, njëzëri deklaroi kërkesën të papranueshme dhe se parashtruesi nuk e ka përmbushur kushtin themelor formal të pranueshmërisë për shterjen e të gjitha mjeteve juridike.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI190/13
Parashtrues
Ansambli “Shqiponjat e Dukagjinit”, Gjakovë
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktit përcjellës
të kryetarit të Komunës së Gjakovës, të 8 nëntorit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Ansambli “Shqiponjat e Dukagjinit” nga Gjakova, të cilin e përfaqëson koordinatori artistik z. Muhamet Morina nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi nuk ka specifikuar qartë se cili është vendimi që konteston, por në formularin për paraqitjen e kërkesës në pjesën e përcaktuar për autoritetin - Gjykatën që ka marrë vendimin, ka shkruar “*akti përcjellës i kryetarit të Komunës së Gjakovës, Pal Lekaj, të 8 nëntorit 2011*”, pa specifikuar datën e pranimi të tij.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktit përcjellës të kryetarit të Komunës së Gjakovës, Pal Lekaj, drejtuar Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport (në tekstin e mëtejme: DKRS), dhe kopjes së parashtruesit, me të cilin kërkonte zgjidhjen e çështjes kontestuese të sigurimit të lokacionit për punën e Ansambli “Shqiponjat e Dukagjinit” nga Gjakova.

Baza juridike

4. Neni 113.7, lidhur me nenin 21.4 të Kushtetutës, neni 47 i Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura në Gjykatë

5. Më 5 nëntor 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 2 dhjetor 2013, Kryetari i Gjykatës me Vendimin Nr. GJR. KI190/13, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 11 dhjetor 2013, Gjykata Kushtetuese formalisht kishte kërkuar nga parashtruesi plotësimin e formularit standard të kërkesës, sipas instruksioneve në formular. Të njëjtën ditë është njoftuar edhe Komuna e Gjakovës për regjistrimin e kësaj kërkesë.
8. Më 23 dhjetor 2013, parashtruesi i kërkesës dërgoi pjesërisht të plotësuar në Gjykatë formularin standard për paraqitjen e kërkesave dhe disa dokumente shtesë.
9. Më 7 shkurt 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Sipas parashtruesit të kërkesës, Ansambli “Shqiponjat e Dukagjinit” është një organizatë joqeveritare (OJQ) nga Gjakova, e cila kultivon “folklorin burimor shqiptar” dhe e cila aktivitetin e vet e ka zhvilluar në kuadër të Pallatit të Kulturës “Asim Vokshi” në Gjakovë.
11. Më 18 prill 2011, parashtruesi i kërkesës është informuar nga drejtori i DKRS-së që t’i largojë mjetet dhe teknikën nga sipërfaqet e punës, sepse objekti do të ketë një renovim. Duket se ky sugjerim është bërë me gojë, sepse nuk ka të bashkëngjitur me kërkesën ndonjë vendim me shkrim.
12. Sipas parashtruesit të kërkesës, anëtarët e Ansamblit nuk janë lejuar më të zhvillojnë aktivitetin e tyre në objekt dhe për më tepër

janë penguar vazhdimisht nga DKRS-ja në ushtrimin veprimtarisë së tyre kulturore.

13. Më 20 maj 2001 dhe më 8 nëntor 2011, parashtruesi ka kërkuar nga kryetari i Komunës, Pal Lekaj, *“ofrimin e ndihmës institucionale për mbarëvajtjen e aktiviteteve të ansamblit ‘Shqiponjat e Dukagjinit’”*.
14. Më 19 tetor 2012, parashtruesi i kërkesës i është drejtuar Avokatit të Popullit me kërkesë kundër Komunës së Gjakovës-DKRS *“për shkak të mospajtimin të hapësirës së nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve kulturore”*.
15. Më 28 gusht 2012, Avokati i Popullit refuzoi kërkesën e parashtruesit, me arsyetimin se pas hetimeve të bëra për këtë rast, Avokati i Popullit është njoftuar nga organet kompetente të Komunës së Gjakovës se kërkesa e parashtruesit tashmë është përmbushur.
16. Më 5 nëntor 2013, parashtruesi i kërkesës, e ka dorëzuar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese, duke kërkuar që Gjykata Kushtetuese t'i japë parashtruesit *“kompensim moral e material”* për shkak të largimit të tyre nga ambientet e punës ku kanë zhvilluar aktivitetin kulturor.

Pretendimet e parashtruesit

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i DKRS-së të Komunës së Gjakovës ka shkelur nenet 23, 26, 27, 48, 50 dhe 55 të Kushtetutës së Kosovës.
18. Parashtruesi i kërkesës ka kërkuar nga *“Gjykata Kushtetuese e Kosovës si arbitri më i lartë kushtetues për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut që ta kthej drejtësinë në vend dhe... kompensim moral dhe material në rast se na takon”*.

Pranueshmëria e kërkesës

19. Për të qenë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse pala i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë, me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës të Gjykatës.
20. Lidhur me këtë, i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, ku përcaktohet:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

21. Gjkata, në këtë drejtim, konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar dëshmi se ka shteruar të gjitha mjetet efektive juridike para se t'i drejtohej me këtë kërkesë Gjykatës Kushtetuese.
22. Duke marrë për bazë Ligjin për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 03/L189), nenin 2.1.4, ku organet lokale të administratës shtetërore përkufizohen si *“organe komunale të administratës shtetërore”*, ndërsa në nenin 4.1.6 të po këtij ligji, është përcaktuar se punët administrative, organet administrative i kryejnë në *“procedurë administrative”*, është fare e qartë se parashtruesi i kërkesës ka pasur në dispozicion mjetet e ankimit të parapara me Ligjin për procedurën administrative.
23. Fakti i thjeshtë se parashtruesi ka dorëzuar parashtresë tek institucioni i Avokatit të Popullit, nuk mund të jetë bazë për të konstatuar se parashtruesi ka shteruar të gjitha mjetet juridike në këtë rast. Ngjashëm me këtë, Gjykata rikujton se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), si rregull të përgjithshëm mban qëndrimin se një parashtresë e thjeshtë tek Ombudspersoni nuk mund të merret interpretohet si shterim i të gjitha mjeteve efektive juridike siç kërkohet me nenin 35 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (shih, rastet *Leander v. Sæden*, Aktgjykimi i 26 marsit 1987, *Marc Montion V France*, Vendimi i 14 majit 1987 etj.). Prandaj, duke marrë parasysh nenin 53 të Kushtetutës për mënyrën e interpretimit të të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutë, Gjykata gjen se nuk ka arsye që në këtë rast të marrë ndonjë qëndrim tjetër.
24. Një prej qëllimeve primare të shterjes së mjeteve juridike është që t'u mundësojë gjykatave kombëtare ose organeve administrative me kompetenca të vendimmarrjes efektive të kenë fillimisht mundësinë që të vendosin për çështjet e shkeljeve eventuale të të drejtave të njeriut dhe pajtueshmërisë së të drejtës së brendshme me Kushtetutën (shih, vendimin e GJEDNJ-së, A, B dhe C kundër Irlandës [DHM], § 142).
25. Gjykata dëshiron të theksojë se themelimi, regjistrimi, udhëheqja e brendshme, veprimtaria, dhe kompetencat tjera të OJQ-së rregullohen me Ligjin për Lirinë e Asociimit në organizatat

joqeveritare, Ligji nr. 04/L-057 i miratuar nga Kuvendi i Kosovës, më 29 gusht 2011.

26. Duke marrë për bazë faktin se parashtruesi nuk e ka përmbushur kushtin themelor formal të pranueshmërisë për shterjen e të gjitha mjeteve juridike, Gjykata, mbështetur në rregullin 36 (1) a), gjen se kërkesa nuk është e përshtatshme për shqyrtimin e mëtejme dhe

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe me rregullin 36 dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 14 mars 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

**KI218/13, Afrim Zeqiri, Aktvendim i datës 14 mars 2014-
Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës
Supreme të Kosovës, Mlc. Rev. nr. 57/2013, të 30 korrikut
2013**

Rasti KI218/13, vendimi i 14 marsit 2014.

Fjalë kyçe: kërkesë individuale, dëmi material, paraburgim, mosshterimi i mjeteve juridike

Me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, C.nr. 65/2004, të 12 tetorit 2009, pjesërisht u pranua kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës dhe u urdhërua si në vijim:

II. DETYROHET i padituri Këshilli Gjyqësor i Kosovës në Prishtinë, që paditësit për shkak të paraburgimit të kundërligjshëm nga data 29.5.2000 e deri më 11.2.2002 (617 ditë), t'ia kompensoj dëmin material në vlerë prej 3.688.10 Euro (tremijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tetë euro e dhjetë cent), si dhe dëmin jomaterial në vlerë prej 100.000 euro (njëqindmijë euro), me kamatë vonesë ligjore 3,5%, e cila pranohet nga bankat e Kosovës në mjetet e deponuara për një vit pa destinim të caktuar, nga dita e marrjes së këtij vendimi e deri në pagesën definitive bashkë me shpenzimet procedurale në vlerë prej 1.365 Euro (njëmijë e treqind e gjashtëdhjetë e pesë euro) – tërë këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kanosjen e përmbarimit me dhunë.

Me Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Mlc. Rev. nr. 57/2013, të 30 korrikut 2013, janë pranuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, e paraqitur nga Prokurori i Shtetit të Republikës së Kosovës dhe revizioni i së paditurës, dhe janë anuluar Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 524/2010, i 18 dhjetorit 2012, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, C.nr. 65/2009, i 12 tetorit 2009, dhe lënda i është kthyer gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Duke vendosur në lidhje me kërkesën e parashtruesit Afrim Zeqiri, Gjykata Kushtetuese vëren se me Vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Mlc. Rev. nr. 57/2013, të 30 korrikut 2013, *“lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim”* në mënyrë që gjykata kompetente të jetë në gjendje të vendosë për objektin e kontestit.

Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për kërkesën e shterimit të mjeteve juridike është që t’iu ofrojë autoriteteve përkatëse, duke përfshirë edhe gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Rregulli bazohet në

supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Prandaj, Gjykata Kushtetuese konstatoi se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me Ligj, që të mund të dorëzojë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese dhe kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me nenin 47.2 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) a) të Rregullores.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI218/13
Parashtrues
Afrim Zeqiri
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës
Supreme
të Kosovës, Mlc. Rev. nr. 57/2013, të 30 korrikut 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË
KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u dorëzua nga z. Afrim Zeqiri (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi), nga fshati Černicë, komuna e Gjilanit, të cilin e përfaqëson avokati z. Bajram Morina nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Mlc. Rev. nr. 57/2013, të 30 korrikut 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Mlc. Rev. nr. 57/2013, të 30 korrikut 2013, me të cilin, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, janë shkelur nenet 7 [Vlerat], 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit], 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruar], 31 [e Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 54 [Mbrotja Gjyqësore e të Drejtave], dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe neni 6 i Konventës

Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore dhe pika 1 e Protokollit I të kësaj Konvente (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 3 dhjetor 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 8 janar 2014, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. KI218/13, caktoi gjyqtarin Robert Carolangjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. KSH. KI218/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova(kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 14 mars 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues Robert Carolan, Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova(kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi, i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 65/2004, të 12 tetorit 2009, pjesërisht u pranua kërkesëpadia e parashtruesit dhe u urdhërua si në vijim:
 - I. *“MIRATOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit Afrim Zeqiri nga fshati Cernicë, Komuna e Gjilanit.*
 - II. *DETYROHET i padituri Këshilli Gjyqësor i Kosovës në Prishtinë, për shkak të paraburgimit të kundërligjshëm nga data 29.5.2000 e deri më 11.2. 2002 (617 ditë), t’ia kompensoj dëmin material në vlerë prej 3.688.10 Euro (*

tremijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tetë euro e dhjetë cent), si dhe dëmin jomaterial ne vlerë prej 100.000 euro (njëqindmijë euro), me kamatë vonesë ligjore 3,5 % e cila pranohet nga bankat e Kosovës në mjetet e deponuara për një vit pa destinim të caktuar, nga e cila pranohet nga bankat e Kosovës në mjetet e deponuara për një vit pa destinim të caktuar, nga dita e marrjes së këtij vendimi e deri në pagesën definitive bashkë me shpenzimet procedurale në vlerë prej 1.365 Euro (njëmijë e treqind e gjashtëdhjetë e pese euro) – tërë këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kanosjen e përmbarimit me dhunë.

III. REFUZOHET SI E PABAZUAR *kërkesëpadia e paditësit mbi shumat e gjykuara si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi sikur edhe kërkesa e tij për shpenzimet mjekësore në vlerë prej 20.000 Euro”.*

9. Me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 524/2010, të 18 dhjetorit 2012, refuzohen si të pabazuara ankesat e të paditurit, dhe vërtetohet Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 85/2004 i 12 dhjetorit 2009.
10. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 524/2010, të 18 dhjetorit 2012, si dhe Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 65/2004, të 12 tetorit 2009, Prokurori i Shtetit të Republikës së Kosovës parashtroi mjetin e jashtëzakonshëm juridik, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, ndërsa i padituri, revizion, për shkak të shkeljeve esenciale të Ligjit për procedurë kontestimore, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimet e goditura të anulohen dhe që çështja juridike të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.
11. Me Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Mlc. Rev. nr. 57/2013, të 30 korrikut 2013, është pranuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, e paraqitur nga Prokurori i Shtetit të Republikës së Kosovës dhe revizioni i së paditurës, dhe janë anuluar Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 524/2010, i 18 dhjetorit 2012, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 65/2009, i 12 tetorit 2009, dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Pretendimet e parashtruesit

12. Parashtruesi i kërkesës „ia bënë me dije Gjykatës Kushtetuese se *Aktvendimi i lartpërmendur i Gjykatës Supreme, si autoritet publik, respektivisht si një prej organeve të shtetit me rastin e vendosjes ka qenë i njëanshëm dhe ka favorizuar Organin tjetër të shtetit - Këshillin Gjyqësor të Kosovës në raport me parashtruesin e kërkesës, edhe pse në bazë të provave të shumta ka qenë në dijeni se bëhet fjalë për paraburgim të paligjshëm, për shkelje të rëndë të dinjitetit dhe të drejtave të njeriut, si dhe të drejtave tjera të garantuara me Kushtetutë, të cilat shkelje po i përmendim në vijim, dhe këtë nenet: 7, 23, 24, 27, 31, 54, i 102 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe neni 6 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore dhe pika 1 e Protokollit të kësaj Konvente (në tekstin e mëtejme: KEDNJ)*
13. Parashtruesi i kërkesës thekson më tej se “Në procedurat e zhvilluara gjyqësore është favorizuar Shteti i Kosovës, respektivisht Këshilli Gjyqësor, si Organ i shtetit të Kosovës, në raport me qytetarin e Kosovës - Afrim Zeqiri, pasi Këshilli Gjyqësor, për të shmangur me çdo kusht përgjegjësisë së tij materiale, ka ndikuar drejtpërdrejt duke e shfrytëzuar pozicionin e vet monopolistik dhe subordinues, bazuar në faktin se Këshilli Gjyqësor është organi që ndikon drejtpërdrejtë në zgjedhjen e gjyqtarëve, duke përfshirë këtu edhe gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Kosovës, të cilët kanë vendosur sikurse në Aktvendimin e kontestues, me çka vërtetohet se Afrim Zeqiri nuk është trajtuar si palë të barabartë në raport me Këshillin Gjyqësor të Kosovës në procedurën që është zhvilluar në Gjykatën Supreme të Kosovës”.
14. Parashtruesi i kërkesës pretendon se “Në rastin konkret, në procedurën e zhvilluar para Gjykatës Supreme të Kosovës, parashtruesi i kësaj kërkesë Afrim Zeqiri, në raport me Këshillin Gjyqësor të Kosovës,
 - është diskriminuar dhe nuk është trajtuar si palë e barabartë para ligjit,
 - nuk i është ofruar mbrojtje e barabartë, pasi me aktvendimin kontestues është favorizuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës, respektivisht i Shtetit të Kosovës në dëm të qytetarit të tij,

- *i është mohuar e drejta për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm në procedurën e marrjes së aktvendimit kontestues”.*

15. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese “...Shfuqizimin -Anulimin e Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Mlc. Re. Nr. 57/2013, te datës 30.07.2013, me të cilin vendim është pranuar Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e Prokurorit të Shtetit të Kosovës dhe Revizioni i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe lënda i është kthyer r për rigjykim Gjykatës së Shkallës së parë, dhe LËNJEN NË FUQI të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, Ac. Nr. 524/2010, të datës 18.12.2012, si dhe Aktgjykimit të Gjykatës Komunale të Prishtinës, C. Nr. 65/2009, të datës 12.10.2009, me të cilin parashtruesit të kësaj kërkesë Afrim Zeqirit nga fshati Cërnica, Komuna e Gjilanit, i është aprovuar si e bazuar Padia për kompensim dëmi material dhe jomaterial në shumën e precizuar në dispozitivin e këtij aktgjykimi”.

Pranueshmëria e kërkesës

16. Gjykata vëren se në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

17. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

18. Si dhe nenin 47 të Ligjit, i cili parasheh:

“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

19. Për më tepër, Gjykata i referohet nenit 36 (1) a) të Rregullores, i cili përcakton:

“(1)Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

- a) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar...“.
20. Duke pasur parasysh këtë, dhe në bazë të dokumenteve të parashtruara në Gjykatën Kushtetuese nga ana e parashtruesit, Gjykata vëren se me Vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Mlc. Rev. nr. 57/2013, të 30 korrikut 2013, *“lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim”* në mënyrë që gjykata kompetente të jetë në gjendje të vendosë për objektin e kontestit.
 21. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për kërkesën e shterimit të mjeteve juridike është që t’iu ofrojë autoriteteve përkatëse, duke përfshirë edhe gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese (shih, rastin Selmouni kundër Francës, nr. 25803194, GJEDNJ, vendimi i 28 korrikut 1999).
 22. Gjykata e zbatoi të njëjtin arsyetim, kur nxori aktvendimin për papranueshmëri, të 27 janarit 2010, në bazë të asaj se nuk janë shteruar të gjitha mjetet juridike në rastin Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K., Prishtinë, kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, Rasti Nr. KI41/09, dhe në aktvendimin për papranueshmëri, të 23 marsit 2010, në rastin Mimoza Kusari-Lila kundër Komisionit Qendror Zgjedhor, Rasti Nr. KI73/09.
 23. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me Ligj, që të mund të dorëzojë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese dhe kërkesa duhet të hidhet si e papranueshme në pajtim me nenin 47.2 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) a) të Rregullores.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 14 mars 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI143/13, Nebih Sejdiu, Vendim për heqjen e kërkesës nga lista i datës 7 shkurt 2014 - Vlerësim i Kushtetushmërisë së një vendimi të paidentifikuar të një organi të paidentifikuar publik

Rasti KI143/13, vendimi i 7 shkurtit 2014

Fjalët kyçe: kërkesa individuale, privatizimi, heqja e kërkesës nga lista.

Parashtreusi i kërkesës parashtroi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke mos kontestuar asnjë vendim të ndonjë organi publik, edhe pse pretendon që janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me ligj dhe me Kushtetutë. Objekt i çështjes është realizimi i pretenduar i së drejtës për të marrë pjesë në 20% nga të ardhurat e privatizimit të NSH “Ramiz Sadiku” (në tekstin e mëtejme: NSH “Ramiz Sadiku”).

Më 9 shtator 2013, parashtreusi parashtroi kërkesë në Gjykatë, duke përdorur *“formularin për dorëzimin e kërkesës”*. Sa i përket përshkrimit të fakteve, ai vetëm shkroi: *“Pagesa e 20% nga shitja e KNI “Ramiz Sadiku”*. Sa i përket arsyetimit të kërkesës dhe shkeljeve të pretenduara të Kushtetutës, ai theksoi: *“Shkelja e të drejtave njerëzore të parapara me Ligjin mbi privatizim dhe Kushtetutë”*. Në fund, në pasqyrën e zgjidhjes së kërkuar, parashtreusi shkroi: *“Pagesa e 20% nga shuma e privatizimit të KNI ‘Ramiz Sadiku’*.”

Duke vendosur për kërkesën e parashtreusit Nebih Sejdiu, Gjykata vëren që parashtreusi ka dështuar të sigurojë dhe parashtrojë ndonjë informatë dhe dokument, që deshmojnë se cilat të drejta dhe liri i janë shkelur dhe nga cili autoritet publik pretendohet të jenë bërë ato shkelje; cili ishte procesi i shterimit të mjeteve juridike dhe cilat ishin pretendimet kryesore dhe në cilat baza ato dëshmohen. Parashtreusi nuk i saktësoi cilat të drejta dhe liri i janë shkelur dhe cilin akt të autoritetit publik ai e konteston. Në të vërtetë, ai nuk ofron as informata për të shpjeguar shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe as aktin e autoritetit publik, që është objekt i shqyrtimit.

Si përmbledhje, Gjykata arrin në përfundim se nuk ka rast apo kontest për t'u shqyrtuar në këtë “kërkesë” dhe, rrjedhimisht, duke mos pasur asnjë arsye për të vazhduar më tej, në pajtim me rregullin 32 (4) të Rregullores, ajo duhet hedhur poshtë.

VENDIM PËR HEQJEN E KËRKESËS NGA LISTA
në
Rastin Nr. KI143/13
Parashtrues
Nebih Sejdiu
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së një vendimi të paidentifikuar
të një
organi të paidentifikuar publik

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga z. Nebih Sejdiu nga Podujeva (në tekstin e mëtejme: parashtruesi).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi nuk konteston asnjë vendim të ndonjë organi publik, edhe pse pretendon që janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me ligj dhe me Kushtetutë.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është realizimi i pretenduar i së drejtës për të marrë pjesë në 20% nga të ardhurat e privatizimit të NSH “Ramiz Sadiku” (në tekstin e mëtejme: NSH “Ramiz Sadiku”).

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenet 20, 22.7, 48 dhe 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në

rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 9 shtator 2013, parashtruesi ka parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 24 shtator 2013, me Vendimin Nr. GJR. KI143/13, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, me Vendimin Nr. KSH. KI143/13, Kryetari, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 21 tetor 2013, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës, si dhe kërkoi nga ai të sqarojë dhe të kompletojë kërkesën, në pajtim me rregullin 36 (4) të Rregullores së punës, përkatësisht: *“t’i dorëzoni në Gjykatë të gjitha dokumentet lidhur me rastin tuaj, dukepërfshirë vendimin të cilin ju e kontestoni”*. Më 6 nëntor, shkresa u kthye në Gjykatë, bashkë me njoftimin që parashtruesi nuk banon në adresën e dhënë në kërkesë.
8. Më 3 dhjetor 2013, parashtruesit i është dorëzuar shkresa e dytë, duke insistuar që ai ta plotësojë dhe ta qartësojë kërkesën e tij, siç ishte kërkuar më parë, me vërejtjen vijuese: *“Nëse ju nuk siguronit informatat dhe dokumentet e kërkuara, (...) Gjykata do të kuptojë se ju nuk jeni i interesuar në procedimin e mëtejme të kërkesës suaj”*.
9. Më 7 shkurt 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 9 shtator 2013, parashtruesi parashtroi kërkesë në Gjykatë, duke përdorur *“formularin për dorëzimin e kërkesës”*. Sa i përket përshkrimit të fakteve, ai vetëm shkroi: *“Pagesa e 20% nga shitja e KNI “Ramiz Sadiku”*. Sa i përket arsyetimit të kërkesës dhe shkeljeve të pretenduara të Kushtetutës, ai theksoi: *“Shkelja e të drejtave njerëzore të parapara me Ligjin mbi privatizim dhe Kushtetutë”*. Në fund, në pasqyrën e zgjidhjes së kërkuar, parashtruesi shkroi: *“Pagesa e 20% nga shuma e privatizimit të KNI ‘Ramiz Sadiku’*.”

11. Parashtruesi bashkëngjiti një kopje të librezës së punës, me të dhënat vijuese: *“Numri i serisë SK.00 148458; Numri i regjistrimit 6456 dhe vendi e data e dhënies Podujevë 14.03.1977”*.
12. Më 21 tetor 2013 dhe më 3 dhjetor 2013, Gjykata kërkoi nga parashtruesi që ta kompletojë dhe ta qartësojë kërkesën. Në datën e dytë të përmendur, parashtruesit i ishte tërhequr vërejtja se nëse nuk i siguron informatat dhe dokumentet e kërkuara, *“Gjykata do të kuptojë se ju nuk jeni i interesuar në procedimin e mëtejshëm të kërkesës suaj”*.

Pretendimet e parashtruesit

13. Parashtruesi pretendon se ka pasur *“shkelje të të drejtave njerëzore të parapara me Ligjin mbi privatizim dhe Kushtetutë”*. Megjithatë, ai nuk tregon se cilat të drejta i janë shkelur ose cili autoritet publik pretendohet ta ketë kryer atë shkelje.
14. Parashtruesi kërkon nga Gjykata: *“Pagesën e 20% nga shuma e privatizimit të KNI ‘Ramiz Sadiku’”*.

Pranueshmëria e kërkesës

15. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i ka plotësuar të gjitha kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
16. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës, i cili përcakton që:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

51. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

17. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 29 [Parashtimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës, i cili përcakton që:

"(...)

(2) Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe: (a) emrin dhe adresën e palës që parashtroi kërkesën; (b) emrin dhe adresën e përfaqësuesit për dorëzimin e dokumenteve, nëse ka; (c) autorizimin për përfaqësuesin ligjor, nëse ka; (d) emrin dhe adresën e palës, ose të palëve kundërshtare, nëse janë të njohura, të cilave u dërgohen dokumentet; (e) mbrojtjen juridike të kërkuar; (f) përmbledhjen e shkurtër të fakteve; (g) arsyetimin procedural dhe substantiv të kërkesës; dhe (h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.

(3) Kërkesës i bashkëngjiten kopjet e çfarëdo dokumenti relevant për të mbështetur atë. Nëse vetëm disa pjesë të dokumentit janë të rëndësishme, atëherë, sipas nevojës, duhet të bashkëngjiten vetëm pjesët e tilla”.

18. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 32 (4), i cili parasheh:

“Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë, kur përcakton se pretendimet në të janë të diskutueshme, ose që nuk përfaqësojnë një rast ose një kontest”.

19. Gjykata vëren që parashtuesi ka dështuar të sigurojë dhe parashtrojë ndonjë informatë dhe dokument, që dëshmojnë se cilat të drejta dhe liri i janë shkelur dhe nga cili autoritet publik pretendohet të jenë bërë ato shkelje; cili ishte procesi i shterimit të mjeteve juridike dhe cilat ishin pretendimet kryesore dhe në cilat baza ato dëshmohen.
20. Gjykata, më tej, vëren se e ashtuquajtura “kërkesë” paraqitet në formën e aprovuar nga Gjykata për ankesa kundër shkeljes së të drejtave të mbrojtura kushtetuese nga autoritetet publike. Megjithatë, kërkesa nuk tregon informatat përkatëse dhe provat relevante në mënyrë që Gjykata t’i shqyrtojë edhe kriteret e pranueshmërisë.
21. Prandaj, duke pasur parasysh natyrën juridike dhe fushëveprimin e Gjykatës Kushtetuese, “kërkesa” nuk bie në shqyrtimin paraprak të Gjykatës; megjithatë, Gjykata do ta marrë atë parasysh për hir të qëllimit shpjegues.

22. Kriteret e pranueshmërisë janë të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore, siç është cekur më lart.
23. Mirëpo, parashtruesi nuk i saktësoi cilat të drejta dhe liri i janë shkelur dhe cilin akt të autoritetit publik ai e konteston. Në të vërtetë, ai nuk ofron as informata për të shpjeguar shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe as aktin e autoritetit publik, që është objekt i shqyrtimit.
24. Për më tepër, parashtruesi as nuk e ka dëshmuar rastin, ku ai e konsideron veten viktimë të shkeljes së Kushtetutës (shih, Scordino kundër Italisë (nr. 1) [DHM], § 179.), dhe as nuk i ka bashkëngjitur informatat dhe dokumentet e nevojshme përcjellëse.
25. Në të vërtetë, procedurat në Gjykatën Kushtetuese janë kundërshtuese për nga natyra. Prandaj, parashtruesi i kërkesës duhet t'i dëshmojë argumentet faktike (duke i ofruar Gjykatës dëshmitë e nevojshme faktike) dhe gjithashtu argumentet ligjore (për të shpjeguar pse dhe si, sipas tij, janë shkelur dispozitat e Kushtetutës). Gjykata është përgjegjëse për vërtetimin e fakteve; përderisa parashtruesi duhet t'i ofrojë Gjykatës informatat dhe dokumentet e nevojshme përcjellëse.
26. Para së gjithash, nga ajo që u tha si më lart, nuk është detyrë e Gjykatës që të ndërtojë rastin në emër të parashtruesit të kërkesës. Përkundrazi, kjo varet nga parashtruesi i kërkesës, i cili duke ngritur çështjen në Gjykatë, së paku të përmbushë të gjitha kriteret për pranueshmërinë e kërkesës.
27. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës është i obliguar që t'i shterojë të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, siç parashihen me nenin 113.7. Qëllimi i rregullit të shterimit është që t'i mundësojë autoritetit publik, duke përfshirë gjykatat e rregullta, që t'i parandalojnë apo t'i korrigjojnë shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Rregulli i shterimit në mënyrë funksionale është i ndërthurur me karakterin e subsidiaritetit të drejtësisë kushtetuese të kornizës procedurale. (shih, Selmouni kundër Francës [DHM], § 74; Kudla kundër Polonisë [DHM], § 152; Andrášik dhe të tjerët kundër Sllovakisë).
28. Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi t'i shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, administrative ose gjyqësore, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo, nëse ka, që të rregullohet një shkelje e tillë e të drejtave themelore.

29. Andaj, parashtruesi i kërkesës është përgjegjës kur rasti i tij shpallet i papranueshëm nga Gjykata Kushtetuese, nëse dështon të shfrytëzojë procedurat e rregullta, apo dështon të raportojë shkeljet e Kushtetutës në procedurë të rregullt. Ai dështim do të kuptohet si mosshfrytëzim i së drejtës për të kundërshtuar më tej shkeljen dhe për t'u ankuar. (shih, Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese në rastin Klo7/09, Demë Kurbogaj dhe Besnik Kurbogaj, Vlerësimi i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 61/07, i 24 nëntorit 2008, paragrafi 18).
30. Në rastin konkret, parashtruesi nuk ka treguar se i ka shteruar të gjitha mjetet e parapara me sistemin e rregullt juridik.
31. Prandaj, duke i marrë parasysh të gjitha sa u thanë më lart, Gjykata duhet të konkludojë se e ashtuquajtura kërkesë duhet të refuzohet paraprakisht si e papranueshme.
32. Gjykata rikujton se, pas njoftimit për regjistrimin e kërkesës së tij, parashtruesi ishte i obliguar që të komunikonte çdo ndryshim në adresën e tij.
33. Për më tepër, parashtruesit të kërkesës i është dërguar një letër e dytë, duke e paralajmëruar atë se, nëse nuk ofron asnjë informatë dhe dokumente, Gjykata do të kuptojë se ai nuk ishte më i interesuar të procedojë me kërkesën e tij. Gjykata më tej vëren se parashtruesi nuk i është përgjigjur letrës së dytë.
34. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se "*kërkesa*" e lartpërmendur nuk e kalon pragun minimal që të konsiderohet si kërkesë, me të cilën çështja e pretenduar është dashur të ngrihet. Për më tepër, Gjykata më tej konsideron se është e ligjshme të supozohet se parashtruesi nuk është më i interesuar për procedim të mëtejshëm të kërkesës e tij.
35. Përveç kësaj, nga mënyra se si "*kërkesa*" është parashtruar, mund të shihet, me qasje të rreptë, si abuzim i së drejtës për t'u ankuar. Gjykata Kushtetuese është e detyruar me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, i cili parasheh "*Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*".
36. Në të vërtetë, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut, përcaktoi se "*çdo sjellje e parashtruesit e cila është qartazi në kundërshtim me qëllimin e të drejtës së kërkesës individuale, siç parashihet në*

Konventë, dhe që e pengon funksionimin e mirëfilltë të Gjykatës apo zhvillimin e mirëfilltë të procedurës para saj përbën abuzim të drejtës së kërkesës” (shih, Mirolubovs dhe të tjerët kundër Lituanisë, paragrafët 62 dhe 65).*

37. Megjithatë, Gjykata konsideron që në këtë fazë nuk këshillohet të miratohet një qasje e tillë e rreptë. Megjithatë, është me rëndësi që parashtruesi ta dijë këtë, pasi duket se e ka keqkuptuar rolin e Gjykatës Kushtetuese dhe natyrën e kornizës së punës së drejtësisë kushtetuese, siç përcaktohet në Kushtetutë, në Ligj dhe në Rregullore të punës.
38. Si përmbledhje, Gjykata arrin në përfundim se nuk ka rast apo kontest për t’u shqyrtuar në këtë “kërkesë” dhe, rrjedhimisht, duke mos pasur asnjë arsye për të vazhduar më tej, në pajtim me rregullin 32 (4) të Rregullores, duhet hedhur poshtë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 32 (4) të Rregullores së punës, më 7 shkurt 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA HEQË NGA LISTA kërkesën;
- II. T’UA komunikojë këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 paragrafin 4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI206/13, Tanasko Đorđević, Milorotka Jelja, Srboljub Đorđević, Serafina Đorđević, Jagoda Janković dhe Milorad Đorđević, Aktvendim i datës 13 mars 2014 - Vlerësim i Kushtetushmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Mlc. nr. 377/2009, të 8 majit 2012

Rasti KI206/13, vendimi i 13 marsit 2014.

Fjalët kyçe: kërkesa individuale, kërkes e papranushme.

Parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke e kontestuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Mlc. nr. 377/2009, të 8 majit 2012, i cili pretendohet ta ketë shkelur të drejtat e tij për mbrojtje të pronës, siç garantohet me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] së Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta). Më 15 nëntor 2013, parashtruesit dorëzuan dokumente shtesë lidhur me kërkesën e tyre, KI79/12, duke theksuar se “*se ata siguruan prova të reja, (...) të cilat kanë të bëjnë me revizion, si mjet i jashtëzakonshëm juridik*”. Parashtruesit theksojnë se “*rasti konkret nuk mund të shqyrtohej me mjet të jashtëzakonshëm juridik dhe as që ishin plotësuar kushtet për një gjë të tillë, por revizioni është bërë me metodën e përgjithshme-refuzimi i kthimit të pronës, duke mos marrë parasysh shkeljet e të drejtave kushtetuese dhe ligjore*”. Përfundimisht, parashtruesit konkludojnë se “*provat e bashkëngjitura qartë tregojnë se në rastet kur është vepruar nëpajtim me dispozitat, rastet e ngjashme janë refuzuar*”.

Në këtë rast, parashtruesit kanë dorëzuar në Gjykatë dokumente shtesë lidhur me kërkesën KI79/12. Sidoqoftë, parashtruesit kanë vepruar ashtu, pasi që raporti paraprak i është dorëzuar Kolegjit shqyrtues nga gjyqtari raportues. Prandaj, në pajtim me rregullin 31 (1) të Rregullores, Gjykata e regjistroi kërkesën e parashtruesve të 15 nëntorit, si kërkesë të re KI206/13.

Duke shqyrtuar kërkesën e parashtruesit përkitazi me vlerësimin e kushtetushmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Mlc. No. 377/2009, të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 8 majit 2012, Gjykata konkludon se dokumentet shtesë të dorëzuara nuk kanë asnjë ndikim në vendimin e meparshëm të Gjykatës në rastin KI79/12. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 36 (3) e) të Rregullores, i cili parasheh se:

“Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur: Gjykata tashme ka nxjerrë një vendim per rastin në

ffjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri”.

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në**

Rastin Nr. KI206/13

Parashtrues

Tanasko Đorđević,

Miloratka Jelić,

Srboljub Đorđević,

Serafina Đorđević,

Jagoda Janković dhe

Milorad Đorđević

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev. Mlc. nr.
377/2009, të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 8 majit 2012**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar

Ivan Čukalović, zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe

Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u dorëzua nga Tanasko Đorđević, Miloratka Jelić, Srboljub Đorđević, Serafina Đorđević, Jagoda Janković dhe Milorad Đorđević, të gjithë nga Prizreni (në tekstin e mëtejme: parashtruesit), të përfaqësuar nga avokati Bashkim Nevzati nga Prizreni.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kontestojnë Aktgjykimin Rev. Mlc. nr. 377/2009, të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 8 majit 2012, i cili u është dorëzuar atyre më 12 korrik 2012.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesit pretendojnë se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme pretendohet të ketë shkelur të drejtën e tyre për mbrojtje të pronës, të garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të

Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Baza juridike për paraqitjen e kërkesës është neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejshmë: Ligji) dhe rregulli 29 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejshmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 24 gusht 2012, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshmë: Gjykata), e cila ishte regjistruar me numrin KI79/12.
6. Më 15 nëntor 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe, në pajtim me rregullin 31 (1) të Rregullores, i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës KI79/12.
7. Të njëjtën ditë, më 15 nëntor 2013, parashtruesit dorëzuan dokumente shtesë lidhur me kërkesën KI79/12, tanimë objekt i shqyrtimit të Gjykatës.
8. Kështu, më 15 nëntor 2013, dokumentet shtesë të dorëzuara u regjistruan si kërkesë e re, KI206/13.
9. Më 3 dhjetor 2013, Kryetari e caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues si gjyqtar raportues, dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
10. Më 24 janar 2014, Gjykata i njoftoi parashtruesit dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës së re.
11. Më 13 mars 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues Almiro Rodrigues, Kolegji shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi, i propozoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 15 nëntor 2013, parashtruesit dorëzuan dokumente shtesë lidhur me kërkesën e tyre, KI79/12, duke theksuar se “*se ata siguruan prova të reja, (...) të cilat kanë të bëjnë me revizion, si*

mjet i jashtëzakonshëm juridik”.Parashtruesit theksojnë se “*rasti konkret nuk mund të shqyrtohet me mjet të jashtëzakonshëm juridik dhe as që ishin plotësuar kushtet për një gjë të tillë, por revizioni është bërë me metodën e përgjithshme-refuzimi i kthimit të pronës, duke mos marrë parasysh shkeljet e të drejtave kushtetuese dhe ligjore*”. Përfundimisht, parashtruesit konkludojnë se “*provat e bashkëngjitura qartë tregojnë se në rastet kur është vepruar në pajtim me dispozitat, rastet e ngjashme janë refuzuar*”.

13. Në të vërtetë, si disa prova të reja, parashtruesit dorëzuan tri (3) aktgjykime të Gjykatës Supreme [Rev 19/2006, Rev 189/2010, Rev 243/2011], të cilat nuk kanë të bëjnë drejtpërdrejt me rastet individuale, KI79/12 dhe KI206/13, dhe asnjë nga parashtruesit nuk janë palë në procedurat e tilla të Gjykatës Supreme.

Pretendimet e parashtruesit

14. Parashtruesit pretendojnë se në dokumentet shtesë të 15 nëntorit 2013, “*revizioni është bërë me metodën e përgjithshme-refuzimi i kthimit të pronës, duke mos marrë parasysh shkeljet e të drejtave kushtetuese dhe ligjore*”.
15. Në kërkesën KI206/13, parashtruesit nuk kanë përmendur asnjë shkelje tjetër të të drejtave të garantuara me Kushtetutë. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesit vazhdojnë t’i mbështesin pretendimet e tyre siç janë qartësuar në rastin KI79/12, gjegjësisht se aktgjykimi i Gjykatës Supreme i shkel të drejtat e tyre për mbrojtjen e pronës, siç garantohen me nenin 46 të Kushtetutës.

Pranueshmëria e kërkesës

16. Gjykata i vlerëson kriteret për pranueshmëri, duke konsideruar se kërkesa KI206/13 është vazhdim i kërkesës KI79/12 dhe prandaj do t’i marrë parasysh veçantitë e kërkesës KI206/13.
17. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 31 (1) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

„Në çfarëdo kohe, para se gjyqtari raportues të ketë paraqitur raportin e tij, pala, e cila e ka parashtruar kërkesën, ose Gjykata, duke vepruar sipas detyrës zyrtare, mund të dorëzojë në Sekretariat përmirësimin e gabimeve teknike ose numerike në materialin e parashtruar”.

18. Në këtë rast, parashtruesit kanë dorëzuar në Gjykatë dokumente shtesë lidhur me kërkesën KI79/12. Sidoqoftë, parashtruesit kanë vepruar ashtu, pasi që raporti paraprak i është dorëzuar Kolegjit shqyrtues nga gjyqtari raportues. Prandaj, në pajtim me rregullin 31 (1) të Rregullores, Gjykata e regjistroi kërkesën e parashtruesve të 15 nëntorit, si kërkesë të re, KI206/13.
19. Sidoqoftë, Gjykata vëren se dokumentet shtesë nuk kanë të bëjnë drejtpërdrejt me rastet individuale të parashtruesve, dhe parashtruesit as që janë palë në aktgjykimet rishtazi të dorëzuara të Gjykatës Supreme.
20. Për më tepër, Gjykata konsideron se dokumentet e tilla shtesë, as nuk përbëjnë pretendim të ri dhe as nuk paraqesin bazë të mjaftueshme dhe relevante për një vendim të ri.
21. Prandaj, Gjykata konkludon se dokumentet shtesë të dorëzuara nuk kanë asnjë ndikim në vendimin e mëparshëm të Gjykatës në rastin KI79/12.
22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 36 (3) e) të Rregullores, i cili parasheh se:

„Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur: Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri”.
23. Në të vërtetë, Gjykata rikujton se ajo është marrë me rastin e përmendur, KI79/12, ku një aktvendim për papranueshmëri ishte publikuar më 6 dhjetor 2013. Gjykata arsyetoi se parashtruesit nuk kanë paraqitur asnjë dëshmi *prima facie* për të mbështetur pretendimet e tyre për shkelje të të drejtave të tyre të garantuara me Kushtetutë. Prandaj, kërkesa KI79/12 ishte shpallur e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (2) a) dhe b) të Rregullores së punës.
24. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se në pajtim me rregullin 36 (3) e) të Rregullores së punës, kërkesa KI206/13 është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe rregullit 36 (3) e) të Rregullores së punës, më 13 mars 2014 njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI196/13, Alisait Qerimi dhe katër të tjerë ktvendim i datës 7 shkurt 2014 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 235/2011, të 12 korrikut 2013

Rasti KI196/13, vendimi i 7 shkurtit 2014.

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit, **qartazi e pabazuar.**

Parashtruesit pretendojnë që me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 235/2011, të 12 korrikut 2013, u janë shkelur të drejtat e mbrojtura me Kushtetutë, neni 24 (Barazia para Ligjit), Neni 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm), Neni 54 (Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave) dhe Neni 49 (E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit) të Kushtetutës, Neni 101 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Neni 6 i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë që parashtruesi i kërkesës të ketë gjykim të drejtë.

Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesit e kërkesës nuk e arsyetojnë në asnjë mënyrë pretendimin për shkelje të të drejtave kushtetuese dhe se parashtruesit e kërkesës nuk e kanë mbështetur mjaftueshëm pretendimin e tyre.

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) b) dhe d) të Rregullores së punës, më 7 shkurt 2014, njëzëri deklaroi kërkesën si të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI196/13
Parashtrues
Alisait Qerimi dhe katër të tjerë
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme të Kosovës, Rev. nr. 235/2011, të 12 korrikut 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë: z. Alisait Qerimi, z. Abdylaziz Ahmeti, z. Nexhat Osmani, z. Fehmi Shala dhe z. Nuhi Robelli, nga komuna e Gjilanit, të cilët me autorizim i përfaqëson z. Alisait Qerimi (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Kontestohet Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 235/2011, i 12 korrikut 2013, të cilin parashtruesit e kërkesës e kanë pranuar më 5 gusht 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 235/2011, të 12 korrikut 2013, i cili i ka vërtetuar aktgjykimet e instancave më të ulëta duke refuzuar si të pabazuar kërkesën e parashtruesve për kthim në vendin e punës me të gjitha të drejtat që u takojnë nga marrëdhënia e punës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatë

5. Më 12 nëntor 2013, parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 2 dhjetor 2013, Kryetari, me Vendimin GJR. Nr. KI196/13, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI196/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
7. Më 11 dhjetor 2013, Gjykata informoi parashtruesit e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e lëndës.
8. Më 19 dhjetor 2013, përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës dorëzoi në Gjykatë autorizimin me të cilin ai i përfaqëson parashtruesit e tjerë.
9. Më 7 shkurt 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 2 shkurt 2011, Gjykata Komunale në Gjiilan, duke vepruar në bazë të kërkesëpadisë së parashtruesve të kërkesës kundër bankës “NLB-Prishtina”, filiali në Gjiilan, me të cilën parashtruesit kanë kërkuar kthimin në vend të punës pranë bankës “NLB-Prishtina”, filiali në Gjiilan, me të gjitha të drejtat që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, nxori Aktgjykimin C. nr. 714/09, me të cilin e hedh poshtë kërkesëpadinë si të pabazuar.
11. Më 14 qershor 2011, Gjykata e Qarkut në Gjiilan, duke vendosur në bazë të ankesës së parashtruesve të kërkesës, nxori Aktgjykimin Ac. nr. 82/11, me të cilin e refuzoi ankesën si të pabazuar dhe e vërtetoi

aktgjykimin e Gjykatës Komunale. Në aktgjykimin e saj, Gjykata e Qarkut, më tej, thekson:

“... kjo gjykatë ka vlerësuar përfundimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe ka gjetur se i njëjti është i drejtë dhe i bazuar në ligj, se ka mbështetje në prova të zhvilluara dhe se janë dhënë arsyet e justifikueshme të cilat edhe kjo gjykatë i pranon...”

Kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vlerësuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga gjykata e shkallës së parë dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale...”

12. Më 12 korrik 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur në bazë të kërkesës për revizion të paraqitur nga parashtruesit e kërkesës, vendosi që revizioni është i pabazuar. Gjykata Supreme, në arsyetimin e saj, thekson:

“... Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se gjykata e instancës më të ulët, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e pabazuar...”

13. Më 10 shtator 2013, parashtruesit i janë drejtuar Prokurorisë Publike të Kosovës me “Iniciativë për ushtrimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë”.
14. Më 23 shtator 2013, Prokurori i Shtetit, nëpërmjet Njoftimit me nr. KMLC. Nr. 98/13, njoftoi parashtruesit e kërkesës se “kanë kaluar afatet për ngritjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesitpretendojnë që me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 235/2011, të 12 korrikut 2013, u janë shkelur të drejtat e mbrojtura me Kushtetutë, neni 24 (Barazia para Ligjit), Neni 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm), Neni 54 (Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave) dhe Neni 49 (E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesioneve) të Kushtetutës, Neni 101 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Neni 6 i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.
16. Parashtruesit përfundojnë duke kërkuar nga Gjykata Kushtetuese:

“Kërkoj që të anulohen aktgjykimet e të gjitha instancave gjyqësore, si ai i Gjykatës komunale në Gjilan C. nr. 714/09 i datës 2 shkurt 2011, ai i Gjykatës së qarkut në Gjilan Ac. nr. 82/11 i datës 14 qershor 2011 dhe ai i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 235/2011 i datës 12 korrik 2013”.

Pranueshmëria e kërkesës

17. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesve, Gjykata para së gjithash duhet të vlerësojë nëse parashtruesit e kërkesës i kanë plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

18. Në këtë drejtim, neni 113, paragrafi 7 i Kushtetutës parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

19. Përveç kësaj, neni 49 i Ligjit parasheh: *“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të llogaritet që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”.*

20. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës për të mbrojtur të drejtat e tyre i janë drejtuar Gjykatës Komunale në Gjilan, Gjykatës së Qarkut në Gjilan, dhe në fund Gjykatës Supreme të Kosovës. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesit e kërkesës, Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 235/2011, të 12 korrikut 2013, e kanë pranuar më 5 gusht 2013 dhe kërkesa në Gjykatë është dorëzuar më 12 nëntor 2013.

21. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesit janë palë e autorizuar dhe i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit të zbatueshëm dhe se kërkesa është dorëzuar brenda afatit prej katër (4) muajve.

22. Sidoqoftë, Gjykata gjithashtu duhet të marrë parasysh rregullin 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: (c) kërkesa është qartazi e bazuar”.

“(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...], ose

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese; ose

[...], ose

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

23. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 235/2011, i 12 korrikut 2013, me të cilin janë vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjiilan, C. nr. 714/09, i 2 shkurtit 2011 dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjiilan, Ac. nr. 82/11, i 14 qershorit 2011, shkel të drejtat e tyre, të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 24 (Barazia para Ligjit), nenin 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm), nenin 54 (Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave) dhe nenin 49 (E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesioneve) të Kushtetutës, nenin 101 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.
24. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese ripërsëritë se sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11 të parashtruesve Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
25. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë që parashtruesi i kërkesës të ketë gjykim të drejtë (shih, *inter alia*, rasti Eduards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).